



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT



Nr. 4229/12 Prot.

Tiranë, më 22.07.2024

URDHËR

Nr. 368, datë 22.07.2024

PËR

**MIRATIMIN E PROGRAMEVE MËSIMORE TË KULTURËS SË PËRGJITHSHME
PËR ARSIMIN E MESËM PROFESIONAL**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 45 të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të shkronjës "a", të nenit 8, të ligjit nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të shkronjës "e", të pikës 5, të kreut III, të vendimit nr. 98, datë 27.02.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)" dhe të urdhrimit nr. 565, datë 05.10.2023 "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit znj. Nina Guga", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e "Programit mësimor të lëndës së gjuhës së huaj të parë, klasa X, Struktura 2+1+1, Struktura 2+2 dhe Bllok 4-vjeçar, të kulturës së përgjithshme për arsimin e mesëm profesional", sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. Miratimin e "Programit mësimor të lëndës së matematikës, klasa X-XI, Struktura 2+1+1, Struktura 2+2 dhe Bllok 4-vjeçar, të kulturës së përgjithshme për arsimin e mesëm profesional", sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
3. Miratimin e "Programit mësimor të lëndës së kimisë, klasa X, Struktura 2+1+1, Struktura 2+2 dhe Bllok 4-vjeçar, të kulturës së përgjithshme për arsimin e mesëm profesional", sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
4. Miratimin e "Programit mësimor të lëndës së biologjisë, klasa X, Struktura 2+1+1, Struktura 2+2 dhe Bllok 4-vjeçar, të kulturës së përgjithshme për arsimin e mesëm profesional", sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
5. Miratimin e "Programit mësimor të lëndës së TIK, klasa X, Struktura 2+1+1, Struktura 2+2 dhe Bllok 4-vjeçar, të kulturës së përgjithshme për arsimin e mesëm profesional", sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.

6. Miratimin e "Programit mësimor të lëndës së historisë, klasa X, Struktura 2+1+1, Struktura 2+2 dhe Bllok 4-vjeçar, të kulturës së përgjithshme për arsimin e mesëm profesional", sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
7. Miratimin e "Programit mësimor të lëndës së gjuhës së huaj të parë, klasa XI, Struktura 2+1+1, Struktura 2+2 dhe Bllok 4-vjeçar, të kulturës së përgjithshme për arsimin e mesëm profesional", sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
8. Miratimin e "Programit mësimor të lëndës së historisë, klasa XI, Struktura 2+1+1, Struktura 2+2 dhe Bllok 4-vjeçar, të kulturës së përgjithshme për arsimin e mesëm profesional", sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
9. Miratimin e "Programit mësimor të lëndës së historisë, klasa XII, Struktura 2+1+1, Struktura 2+2 dhe Bllok 4-vjeçar, të kulturës së përgjithshme për arsimin e mesëm profesional", sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
10. Miratimin e "Programit mësimor të lëndës së gjeografisë, klasa XII, Struktura 2+1+1, Struktura 2+2 dhe Bllok 4-vjeçar, të kulturës së përgjithshme për arsimin e mesëm profesional", sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
11. Miratimin e "Programit mësimor të lëndës së biologjisë, klasa XIII, Struktura 2+1+1, Struktura 2+2 dhe Bllok 4-vjeçar, të kulturës së përgjithshme për arsimin e mesëm profesional", sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
12. Miratimin e "Programit mësimor të lëndës së gjeografisë, klasa XIII, Struktura 2+1+1, Struktura 2+2 dhe Bllok 4-vjeçar, të kulturës së përgjithshme për arsimin e mesëm profesional", sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri
13. Miratimin e "Programit mësimor të lëndës së TIK, klasa XIII, Struktura 2+1+1, Struktura 2+2 dhe Bllok 4-vjeçar, të kulturës së përgjithshme për arsimin e mesëm profesional", sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
14. Programet mësimore të mësipërme fillojnë zbatimin në vitin shkollor 2024 - 2025.
15. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, Drejtorja e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

NINA GUGA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA E SIGURIMIT SË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

PROGRAMET E KULTURËS SË PËRGJITHSHME
TË ARSIMIT TË MESËM PROFESIONAL

Lënda: Gjuhë e huaj e parë

Klasa: X

Struktura 2+1+1, Struktura 2+2 dhe Bblok 4-vjeçar

TIRANË, 2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

**PROGRAMET E KULTURËS SË PËRGJITHSHME
TË ARSIMIT TË MESËM PROFESIONAL**

Lënda: Gjuhë e huaj e parë

Klasa: X

Struktura 2+1+1, Struktura 2+2 dhe Bllok 4-vjeçar

2024

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT LËNDOR “GJUHË E HUAJ E PARË”

(Klasa X- Arsimi Profesional për strukturat 2+2; 2+1+1 dhe bllok 4 vjeçar)

1	HYRJE	2
2	KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT LËNDOR “GJUHË E HUAJ”	6
2.1	Qëllimet e programit lëndor “Gjuhë e huaj”	9
2.2	Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës “Gjuhë e huaj”	11
2.3	Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës “Gjuhë e huaj”	15
2.4	Lidhja e lëndës “Gjuhë e huaj” me temat ndërkurrikulare	20
2.5	Lidhja e lëndës “Gjuhë e huaj” me fushat e tjera kurrikulare	21
2.6	Kompetencat e lëndës “Gjuhë e huaj”	23
2.7	Rezultatet e të nxënit	25
2.8	Ndarja e orëve mësimore.....	35
3	UDHËZIME METODOLOGJIKE.....	36
4	UDHËZIME PËR VLERËSIMIN.....	38

Koordinoi programin:

Ludmilla Stefani

1 HYRJE

Lënda “Gjuhë e huaj e parë” (anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht) synon zhvillimin gjuhësor dhe letrar i cili është boshti themelor për rritjen intelektuale, sociale dhe emocionale të nxënësit. Më konkretisht, lënda ‘Gjuhë e huaj e parë’, e aftëson nxënësin në përdorimin e gjuhës për të komunikuar, për të përmbushur interesat e tij personale dhe shoqërore, si dhe për të plotësuar kërkesat e shoqërisë dhe të botës së punës.

Mësimi i gjuhës amtare, i letërsisë dhe i gjuhëve të huaja e ndihmon nxënësin të bëhen individ i pavarur, i lirë, i kulturuar, mendimtar kritik dhe krijues, si dhe i vetëdijshëm për identitetin e tij personal dhe kombëtar. Me anë të leximit të teksteve të letërsisë shqipe dhe asaj botërore (në gjuhën shqipe ose në një gjuhë të huaj), nxënësi zhvillon botën e tij emocionale, pasuron përfytyrimet dhe imagjinatën e tij për botën, çmon dhe vlerëson gjuhët dhe kulturën kombëtare e botërore.

Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” nxit dëshirën, kuriozitetin dhe besimin e nxënësit për t’u bërë komunikues i mirë, lexues aktiv e i pavarur dhe shkruar i saktë, origjinal dhe krijues.

Lënda ‘Gjuhë e huaj’ përbëhet nga “Gjuhë e huaj e parë” dhe “Gjuhë e huaj e dytë”.

Gjuha e huaj e parë fillon në shkallën e parë (klasa I) dhe mësohet deri në shkallën e gjashtë (klasa XII).

Gjuha e huaj e dytë fillon të mësohet në shkallën e tretë (klasa VI) dhe vazhdon deri në shkallën e gjashtë (klasa XII). Si gjuhë e huaj e dytë mund të jetë: gjuha frënge, gjuha italiane, gjuha gjermane, gjuha angleze, etj.

Në shkollat e arsimit profesional gjuha e huaj mësohet deri në klasën XIII.

Kompetencat përcaktohen si njohuri, shkathtësi, vlera dhe qëndrime që nxënësi duhet t’i fitojë gjatë procesit mësimor.

Njohuri është një e vërtetë e arsyetuar dhe e provuar sipas kritereve të përcaktuara, e kodifikuar në tekstet akademike e ato shkollore apo në vepra të specializuara si produkt i një ose disa dijetarëve apo praktikienëve, ndërtim mendor i realizuar nga personi gjatë bashkëveprimit me mjedisin ose nga vetëreflektimi për t'u bërë pjesë e trashëgimisë njohëse të tij, si p.sh., njohuri për llojet e teksteve, njohuri gramatikore, njohuri për hartimin e një prezantimi etj.

Shkathtësi është një kapacitet (mendor/fizik) i fituar për të arritur rezultatet e parashikuara, shpesh me shpenzim minimal të kohës dhe energjisë, ose të të dyjave bashkë. Shkathtësia mund të jetë e përgjithshme ose e veçantë, si: të kuptuarit, të interpretuarit, të menduarit në mënyrë kritike dhe krijuese, zgjidhja e problemeve etj.

Qëndrimet janë një mënyrë e përcaktuar e të menduarit, opinionëve dhe ndjenjave ndaj diçkaje, një ideje, personi ose situatë dhe që ndikojnë në sjelljen e individit. Qëndrimet ndikohen nga njohuritë dhe vlerat dhe janë zakonisht shkaktare të sjelljeve (edhe pse lidhjet mes qëndrimeve dhe sjelljeve nuk janë drejtvizore).

Vlerat janë bindje që ruhen thellë lidhur me çfarë është e rëndësishme ose e dëshirueshme. Ato shprehen nëpërmjet qëndrimeve dhe veprimeve praktike të personave. Disa vlera dhe qëndrime janë respektimi i rregullave të etikës gjatë të folurit, shmangia e fyerjeve dhe paragjykimeve, shpirti i iniciativës, serioziteti, vetëbesimi etj.

Puna për ndërtimin e kompetencave kyçe dhe të lëndës ka nisur që në arsimin bazë. Në këtë nivel arsimit nxënësi është pajisur me njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet e domosdoshme për jetën, shoqërinë dhe për botën e punës. Në arsimin e mesëm të lartë, nxënësi has sfida të reja dhe përdor aftësitë gjuhësore të fituara gjatë shkollimit për të reaguar në situata të njohura dhe jo të njohura për të si në klasë/shkollë ashtu edhe dhe jashtë saj duke mbajtur qëndrime dhe zhvilluar vlera.

2 KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT LËNDOR “GJUHË E HUAJ”

Hartimi i programit lëndor mbështetet në dokumentet kryesore kurrikulare: korniza kurrikulare, kurrikula bërthamë dhe plani mësimor i kulturës së përgjithshme për Arsimin Profesional.

Programi shoqërohet me udhëzues dhe dokumente të tjera në ndihmë të mësuesve dhe të hartuesve të teksteve mësimore.

Përdoruesit e programit janë mësuesit, autorët e teksteve, specialistët e arsimit dhe fakultetet e mësuesisë.

Mësuesit do ta përdorin programin e gjuhës së huaj për të krijuar një tablo të qartë rreth asaj se çfarë duhet të nxëjë nxënësi dhe se si duhet të ndërtojnë mësimdhënien për të pajisur nxënësin me kompetencat kyçe dhe ato të lëndës, si dhe për të përmbushur kërkesat e programit. Ky program i ndihmon mësuesit të reflektojnë mbi praktikën e tyre të mësimdhënies dhe të koordinojnë punën dhe përpjekjet e tyre për të përmbushur nevojat e nxënësit në të kuptuarin e lëndës dhe përdorimin praktik të saj edhe jashtë ambienteve shkollore, pasi mësuesit janë modele të cilat nxënësi ndjek në të ardhmen. Mësuesit do ta përdorin këtë program për të përcaktuar e monitoruar objektivat e vendosura për t'u përmbushur nga nxënësi në klasë, në shkollë si edhe në një raport më të gjerë.

Autorët e teksteve do ta përdorin programin lëndor për të hartuar tekste që janë në funksion të realizimit të tij. Leximi i kujdesshëm i programit për çdo shkallë dhe klasë do t'i ndihmojë ata për të siguruar koherencën dhe për të shmangur ngarkesën e panevojshme.

Specialistët e arsimit mund ta përdorin programin lëndor për qëllime inspektimi, monitorimi, vlerësimi, studimi etj. Vlerësuesit e sistemit arsimor do të mbështeten në këtë program për të parë përmbushjen e standardëve lëndore të përcaktuara për këtë klasë.

Fakultetet e mësuesisë mund ta përdorin programin lëndor për të përshtatur kurrikulat e tyre me qëllim përgatitjen efektive të mësuesve të ardhshëm, si dhe për praktikën pedagogjike të studentëve.

Përfituesit e programit janë: nxënësit, prindërit dhe komuniteti.

Nxënësi përfiton të nxënit progresiv, zbaton shprehinë njohurisë, veprimtarisë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat në lëndën përkatëse dhe bëhet përdorues i mirë i gjuhës.

Prindërit dhe komuniteti mund të informohen për kompetencat që duhet të zotërojnë fëmijët e tyre në lëndën e gjuhës së huaj.


Programi lëndor “Gjuhë e huaj e parë” ka në fokus realizimin e kompetencave kyçe dhe të kompetencave të lëndës. Gjatë punës për përmbushjen e kompetencave kyçe dhe kompetencave të lëndës, nëpërmjet gjuhës së huaj do të realizohen temat ndërkurrikulare, të cilat mundësojnë lidhjen e lëndës me jetën e përditshme, shoqërinë dhe botën e punës. Në program, gjithashtu, përshkruhet lidhja e gjuhës së huaj me fushat e tjera, në mënyrë që formimi i nxënësit të mos jetë fragmentar, por tërësor dhe t’i shërbejë formimit të tij të gjithanshëm.

Realizimi i programit në lëndën e gjuhës së huaj mundëson krijimin e një mjedisi të nxëni të përshtatshëm, inkurajues, motivues, gjithpërfshirës dhe të pasur me material të domosdoshme burimore duke përdorur sa më gjërë dhe në mënyrë efektive TIK.

Në program janë përcaktuar njohurisë, aftësitë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet për çdo kompetencë të lëndës si edhe për çdo veprimtari, aftësi dhe shkathtësi gjuhësore që kryen nxënësi për formimin dhe konsolidimin e kompetencave.

Gjithashtu programi i jep mundësinë mësuesit të jetë krijues dhe inovativ në punën e tij duke përdorur metodat, strategjitë dhe përfaqësitë më bashkëkohore në procesin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit. Po kështu, në program janë sugjeruar edhe orët mësimore në përqindje për njohurisë që do merren gjatë vitit shkollor.

Diagrami i mëposhtëm paraqet se si programi i gjuhës së huaj është pjesë integrale e Kornizës Kurikulare e cila synon një mësimdhënie me në qendër nxënësin, zhvillimin dhe përgatitjen e tij për t'u bërë anëtar i shoqërisë së dijes.



Diagrami 1: Korniza Konceptuale e Programit Lëndor "Gjuhë e huaj"

2.1 Qëllimet e programit lëndor “Gjuhë e huaj”

Lënda e gjuhës së huaj në arsimin e mesëm profesional ka si qëllim që nxënësi:

- të ndërgjegjësohet për aspektet kulturore dhe të reflektojë mbi ndryshimet mes praktikave kulturore të vendit ku flitet gjuha e huaj dhe kulturës amtare duke analizuar aspekte të kulturës që studion siç janë institucionet shoqërore dhe politike;
- të zhvillojë më tej aftësinë komunikuese dhe përdorimin e njohurive gjuhësore në situata praktike të jetës së përditshme dhe punës, për të hulumtuar dhe dhënë përgjigje e argumente për çështje të interesit të tij dhe për t’i përgatitur nxënësit për tregun e punës;
- të respektojë traditat dhe vlerat e kulturave të ndryshme;
- të forcojë ndërveprimin në situata reale dhe jashtëshkollore, lidhur me tematikën e trajtuar në situatat mësimore dhe të shkëmbejë informacione të detajuara mbi tema që paraqesin interes për të për të qenë i përgatitur për tregun e punës;
- të konsolidojë bashkëveprimin ndërmjet punës në grup dhe punës së pavarur individuale dhe krijuese edhe me folës të gjuhës të cilën ai mëson;
- të thellojë njohuritë gjuhësore, perceptuese dhe shprehëse, përmes të cilave ai zgjeron njohuritë për botën dhe tregun e punës dhe në të njëjtën kohë formohet intelektualisht;
- të zhvillojë rrjedhshmërinë në gjuhën e huaj përmes praktikës së vazhdueshme të përshtatshme për moshën, interesat dhe nivelin e tij gjuhësor.

Programi lëndor “Gjuhë e huaj e parë” për klasën X, i hartuar në përputhje me Kurrikulën Kombëtare të Gjuhëve Moderne për Arsimin Publik Parauniversitar (viti 2000), si dhe në përputhje me Kuadrin e Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët (KPER), synon të arrijë dhe të realizojë standardet e mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit me qëllim që t’i përgjigjet një shoqërie të hapur sipas kërkesave dhe nevojave që shtrohen përpara mësimin dhe përvetësimit të gjuhës së huaj në vendin tonë. Ky program përfshin njohuritë gjuhësore, ndërlëndore dhe ndërkulturore të përfituara ndër vite.

Lënda e gjuhës së huaj ka për mision aftësimin dhe orientimin e nxënësit për të vepruar në situata të ndryshme komunikimi në këtë gjuhë. Ajo ka për detyrë të zhvillojë te nxënësi aftësitë e gjuhës gjatë përdorimit të saj dhe ta edukojë atë me të kuptuarin, pranimin dhe vlerësimin e kulturës dhe mënyrës së jetesës së popujve të tjerë. Programi hartohet mbi interesat dhe karakteristikat e grupmoshës dhe ndihmon në zhvillimin intelektual dhe socio-kulturor të nxënësit duke e bërë atë të pavarur dhe të aftë të përballojë të nxënit gjatë gjithë jetës. Nxënësi, gjithashtu, mëson dhe bindet se gjuha e huaj, si një subjekt aftësish dhe komunikimi, kërkon kohë dhe praktika të shumëllojshme komunikimi për t’u përvetësuar. Si lëndë akademike, gjuha e huaj është një lëndë kulturash dhe aftësish.

Niveli gjuhësor i gjuhës së huaj në klasën e X të arsimit profesional, bazohet mbi njohuritë dhe konceptet e marra në klasat paraardhëse si dhe në konsolidimin e mëtejshëm të kompetencave kyçe dhe ato të lëndës për këtë shkallë. Nxënësi në këtë klasë synon të arrijë nivelin B1 dhe hedh hapat e para drejt nivelit B1+ duke konsoliduar aftësinë e tij të qenit i pavarur në përdorimin e gjuhës së huaj. Tiparet kryesore të nivelit B1 janë:

- a) aftësia për të marrë pjesë në një bisedë;
- b) të qenit fleksibël në përballje me problemet që dalin në jetën e përditshme.

Më poshtë jepet përshkrimi i nivelit B1 i cili i referohet shkallës globale të Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët.

Përdoruesi i pavarur	B 1	<p>Mund të kuptojë çështjet kryesore të një informacioni standard të qartë për çështje të njohura që hasen rregullisht në shkollë, punë, argëtim etj. Mund t’ia dalë në situata të shfaqura gjatë një udhëtimi në vende ku flitet gjuha që mëson.</p> <p>Mund të prodhojë material të thjeshtë për tema të njohura ose të një fushe të interesit personal.</p> <p>Mund të përshkruajë përvoja dhe ngjarje, ëndrra, shpresa dhe ambicie dhe shkurtimisht jep arsye dhe shpjegime për opinionet dhe planet.</p>
-----------------------------	------------	---

Interesat dhe tematikat në këtë program do të jenë të shumëllojshme (jeta personale e shoqërore, jeta në shkollë e në punë, bota rreth nesh, bota e komunikimit etj.), pasi shkalla e ndërgjegjësimit të nxënësit për domosdoshmërinë e mësimin të gjuhës së huaj është më e lartë dhe lidhet me

problemet e formimit të tij si qytetar bote. Gjithashtu mësuesi në këto shkolla duhet të bëjë pjesë të mësimdhënies tema dhe situata të të nxënit të cilat lidhen me profesionin për të cilin nxënësi është duke studiuar duke e aftësuar atë për karrierë të suksesshme në tregun e punës.

2.2 Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës “Gjuhë e huaj”

Realizimi i kompetencave kyçe të Kornizës Kurrikulare gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies kërkon që mësuesi të lidhë kompetencat kyçe me kompetencat e fushës dhe të lëndës për secilën shkallë. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë metodat, teknikat dhe mjetet e përshtatshme didaktike për realizimin e çdo kompetence dhe rezultati të të nxënit. *Kompetenca përcaktohet si harmonizim i njohurive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve për të trajtuar plotësisht situatat e kontekstit.* Kur nxënësi përmbush kompetencat gjuhësore, ai njëkohësisht është duke zhvilluar edhe kompetencat kyçe. P.sh., gjatë prezantimeve të ndryshme në orët mësimore të kompetencës së të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar, nxënësi përdor edhe mjetet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit dhe realizon kështu edhe kompetencën digjitale. Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës ku bën pjesë lënda e gjuhës së huaj, pasqyrojnë të njëjtën qasje me rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe në këndvështrimin e domosdoshmërisë së tyre në jetë, shoqëri dhe punë.

Gjithashtu e parë në kontekstin e anasjelltë nxënësi ndihmohet nga kompetencat kyçe për të përmbushur sa më mirë kompetencat specifike të lëndës dhe për të realizuar veprimtaritë gjuhësore. Si p.sh kur nxënësi lexon një tekst ai nuk bazohet vetëm tek kompetenca gjuhësore por edhe tek kompetenca e të menduarit ose ajo qytetare bazuar në llojin e tekstit që lexon, ose nëse nxënësi lexon një tekst si pjesë e një programi të të mësuarit ai bazohet te kompetenca e të mësuarit për të nxënë.

Një tjetër shembull do të ishte edhe zhvillimi i një projekti gjatë orës mësimore. Nëse nxënësi bën një projekt si temë mësimore në këtë rast ai jo vetëm zhvillon kompetencat e tij gjuhësore, por gjithashtu kompetencat digjitale dhe qytetare, në varësi të tematikës që ai shtjellon.

Përqasja e adoptuar nga Kuadri i Përbashkët Evropian i Referencave për Gjuhët (KPER) është e orientuar drejt veprimit pasi përdoruesi i gjuhës ose nxënësi konsiderohet si “aktor shoqëror” d.m.th. pjesëtar i shoqërisë i cili ka detyra për të përmbushur (të cilat nuk janë vetëm gjuhësore) në rrethana dhe në një mjedis të caktuar dhe brenda një fushe të caktuar veprimi. Komunikimi realizohet nëpërmjet aktiviteteve gjuhësore të cilat

janë pjesë e një konteksti më të gjerë shoqëror që ju jep atyre kuptim të plotë. Përjasja vepruese merr gjithashtu parasysh burimet njohëse, emocionale, të vullnetshme si edhe tërësinë e aftësive që zotëron dhe vë në jetë çdo individ si një aktor shoqëror.

Në bazë të kësaj përjasjeje çdo formë përdorimi dhe nxënije e një gjuhe mund të përkufizohet si më poshtë.

Përdorimi i një gjuhe, duke përfshirë edhe nxënien e saj, përfshin veprime të kryera nga njerëzit, të cilët si individë dhe si aktorë shoqërorë zhvillojnë një numër kompetencash kyçe dhe në veçanti kompetencën e komunikimit gjuhësor. Nxënësi vë në zbatim kompetencat që zotëron në kontekste dhe kushte të ndryshme dhe kalon vështirësitë për t'u përfshirë në veprimtari gjuhësore të cilat përfshijnë proceset gjuhësore që mundësojnë kuptimin dhe prodhimin e teksteve që lidhen me tema dhe fusha specifike duke mobilizuar strategjitë më të përshtatshme për përmbushjen e detyrave që duhen realizuar. Monitorimi i këtyre veprimeve nga vetë nxënësi çon në përforcimin ose përmirësimin e kompetencave. Kjo përjasje ilustron në figurën e mëposhtme.





Figura 1: Të mësuarit dhe përdorimi i gjuhës së huaj

Kompetencat kyçe nuk lidhen vetëm me gjuhën por kanë të bëjnë me çdo lloj veprimtarie duke përfshirë edhe ato gjuhësoret.

Më konkretisht, për të realizuar lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës mësuesi ndjek këto hapa:

- përzgjedh rezultatin/et e të nxënit për kompetencat kyçe që synon të arrijë nxënësi në shkallën dhe klasën përkatëse;
- përzgjedh rezultatin/et e të nxënit për kompetencat specifike të lëndës që synon të arrijë nxënësi në shkallën dhe klasën përkatëse;
- përshtat rezultatin/et e të nxënit për çdo fushë veprimtarie dhe mënyre të marrjes së gjuhës (me shkrim dhe me gojë): **marrja e informacionit** (të lexuarit, të dëgjuarit), **ndërveprimi** (të folurit ndërveprues, të shkruarit ndërveprues), **produkti** (produkti i të folurit, produkti i të shkruarit) dhe **ndërhyrja** (përmbledhja, interpretimi, perifrazimi, përkthimi etj.);
- përzgjedh përmbajtjen/et mësimore, mjetet didaktike, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënit;
- planifikon mësimdhënien duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do t'i arrijë rezultatet e të nxënit brenda vitit shkollor;
- kryen analiza dhe vlerësime të ecursisë së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave, projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënit për vit mësimor dhe shkallë për fushën “Gjuhët dhe komunikimi”.

Diagrami i mëposhtëm konkretizon lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës të cilat së bashku i ofrojnë nxënësit informacionin në mënyrë efikase dhe bëjnë që nxënësi të përforcojë hap pas hapi arritjet e tij për të lexuar, shkruar dhe komunikuar duke i bërë funksionale dhe të qëndrueshme aspekte të ndryshme të informacionit, kulturës, shkencës dhe teknologjisë.



Diagrami 2: Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës “Gjuhë e huaj”

2.3 Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës “Gjuhë e huaj”

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit

Nxënësi:

- diskuton në grup në mënyrë konstruktive në jo më shumë se 10 minuta, duke dhënë dhe duke marrë informacion për një temë të caktuar nga fushat mësimore ose nga jeta e përditshme;
- transmeton saktë të dhënat e mbledhura për një temë konkrete në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit;
- lexon rrjedhshëm një tekst të njohur në gjuhë të huaj të përbërë prej disa paragrafësh;
- tregon me shembuj konkretë disa nga ngjashmëritë ndërmjet strukturës së fjalisë së gjuhës së huaj dhe gjuhës amtare;
- analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun e përshtatshëm;
- shkruan një tekst në gjuhë të huaj për një temë nga jeta e përditshme, me tre-pesë paragrafë, duke respektuar strukturën, drejtshkrimin dhe elementet e tjera, pastaj e prezanton para të tjerëve me shqiptim të saktë;
- përdor drejt strukturën dhe rregullat standarde të drejtshkrimit të gjuhës së huaj në kontekste dhe forma të ndryshme të shkrimit, si: ese, e-mail (postë elektronike), letra formale dhe joformale etj.;
- përshkruan me gojë dhe me shkrim një ngjarje të lexuar ose të dëgjuar duke ruajtur rrjedhën logjike të saj;
- përdor TIK-un në mënyrë efektive gjatë komunikimit dhe ndërveprimit me të tjerët në jetën e përditshme, duke përfshirë edhe të nxënit e informacioneve të reja dhe kryerjen e detyrave shkollore;
- prezanton para të tjerëve një projekt për një temë të dhënë, të përgatitur vetë ose në grup, duke gërshetuar format e komunikimit verbal dhe elektronik, si dhe veprimin praktik.

Kompetenca e të menduarit

Nxënësi:

- përzgjedh dhe klasifikon informacionin nga burime të ndryshme në bazë të një kriteri të caktuar për një temë konkrete dhe e përdor për marrjen e një vendimi apo për zgjidhjen e një problemi/detyre;
- prezanton në forma të ndryshme të të shprehurit, mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacionit për një temë të caktuar, ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse (p.sh., temë nga kultura, nga arti, nga sporti, nga shëndetësia, nga shoqëria, nga mjedisi etj.);
- krahason të paktën tri burime të ndryshme informacioni për trajtimin e një teme, argumenton saktësinë, rrethanat, gjen ngjashmëritë dhe dallimet duke u bazuar në kriteret e përcaktuara më parë, i prezanton gjetjet kryesore para të tjerëve në forma të ndryshme shprehëse, duke përdorur teknologjinë e informacionit;
- përpunon idenë e vet në një projekt me shkrim për një çështje të caktuar duke propozuar qëllimin, aktivitetet kryesore, afatet, vendin, personat, materialet dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e tyre;
- modelon zgjidhjen e një problemi të dhënë (në klasë apo jashtë saj) për një temë të caktuar, duke e zbërthyer në hapa të vegjël dhe jep sqarime të nevojshme për hapat e ndjekur në zgjidhjen e problemit, duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit;
- argumenton ndërmarrjen e hapave konkretë, të cilët çojnë në përfundimin e një detyre/veprimtarie, në zgjidhjen e një problemi, të ndonjë punimi në klasë/shkollë;
- simulon një situatë për marrjen e një vendimi për jetën e vet ose zgjidhjen e një problemi me interes shoqëror, lidh vendimin me pasojat në mënyrë të përgjegjshme, e prezanton gjatë një debati me moshatarë në një kohëzgjatje të caktuar, duke u bazuar në këtë përvojë, merr vendime dhe iniciativa të dobishme për vete, për shkollën dhe më gjerë.

Kompetenca e të nxënësve

Nxënësi:

- demonstroi shkathtësi në lexim, shkrim dhe komunikim për përmbushjen e kërkesave të ndryshme në kryerjen e një detyre ose aktiviteti;

- regjistron në formë të shkruar, grafike, etj., informacionin/faktet për një temë;
- shfrytëzon në mënyrë efektive përvojat paraprake gjatë zgjidhjes së situatave të ndryshme në jetën e përditshme apo gjatë kryerjes së ndonjë detyre, aktiviteti në gjuhë të huaj;
- shfrytëzon në mënyrë efektive fjalorët, enciklopeditë dhe teknologjinë informative apo burime të tjera për zhvillimin e një ideje /projekti me bazë klase/shkolle ose jashtë saj;
- diskuton dhe ndan përvojat me të tjerët për mënyrat më praktike të shfrytëzimit të përvojave paraprake në arritjen e dijeve të reja;
- paraqet idetë personale para të tjerëve për mënyrën e zhvillimit të një aktiviteti të caktuar, duke dhënë mendime të argumentuara për rezultatet e pritura (në formë skice, grafiku, vizatimi, shkrimi, vepra artistike etj.);
- shfrytëzon në mënyrë të efektshme teknika të ndryshme gjatë të nxënimit të temës së dhënë duke klasifikuar informacionin e njohur nga ai i panjohur, si dhe atë që është i paqartë;
- parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuar për zgjidhjen e një problemi apo detyre të një teme të caktuar;
- përdor elementet e portofolit personal për vetëvlerësimin dhe identifikimin e anëve të forta, i shfrytëzon ato për përparimin në mësimet dhe për orientimin për karrierë;
- shfrytëzon, në mënyrë të pavarur dhe efektive, teknologjinë e informacionit dhe burimet e tjera të informimit për të mbledhur materiale për zgjidhjen e një problemi apo detyre të caktuar, të cilat më pas i analizon, i klasifikon dhe i paraqet para të tjerëve përmes TIK-ut dhe ndonjë forme tjetër të shprehjes.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

Nxënësi:

- përgatit një autobiografi ku prezanton veten me shkrim ose me gojë para të tjerëve, duke vënë theksin te aftësitë, dëshirat, dhe mundësitë, referuar qëllimeve apo projektit individual për karrierën;

- demonstroi shprehje organizative në punët individuale dhe në grup përmes situatave reale në detyrat e veçanta mësimore ose në veprimtari për jetën, për punën dhe për mjedisin, duke menaxhuar potencialin individual dhe atë të grupit;
- harton një projekt me faza të menaxhuara mirë (individualisht ose në grup) duke shkëmbyer, konsultuar dhe informuar të tjerët, si dhe duke identifikuar dhe duke vlerësuar burimet njerëzore, materiale dhe informative, në përputhje me rezultatet e pritshme;
- merr pjesë në aktivitete të ndryshme në nivel klase, shkolle dhe më gjerë (p.sh., konkurse, gara sportive, aktivitete kulturore dhe muzikore etj.), diskuton me të tjerët për rezultatet e arritura dhe për procesin e organizimit, si dhe jep argumente të ndryshme shprehëse se si të rritet pjesëmarrja në aktivitete dhe se si të përmirësohet procesi i organizimit të tyre;
- përdor materiale, burime të ndryshme informimi dhe teknologjinë në shkollë dhe në jetën e përditshme si ndihmë për përparimin në mësim;
- identifikon burime të ndryshme informacioni për arsimim dhe orientim profesional, si dhe zhvillon një plan individual për zhvillimin e karrierës së tij;
- diskuton me një fjalor të thjeshtë për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë, në shkollë dhe mjedise të tjera në një situatë të caktuar, duke prezantuar idetë nëpërmjet shembujve konkretë.

Kompetenca personale

Nxënësi:

- analizon përparësitë dhe dobësitë personale, duke i evidentuar masat përmes të cilave synon të mbështesë zhvillimin personal, në përparësitë që ka dhe masat përmes të cilave synon të përmirësojë dobësitë personale;
- merr pjesë aktivisht në lojëra, debate apo në veprimtari të tjera në klasë dhe në mënyrë konstruktive menaxhon emocionet e veta;
- bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) drejt arritjes së një qëllimi të përbashkët. (projekti/ aktiviteti në bazë klase /shkolle apo jashtë saj);

- ilustron me shembuj para të tjerëve, modelet dhe praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe me gjerë;
- analizon veprimet e veta dhe të kolegëve gjatë një situatë konflikti, duke propozuar alternativa për zgjidhje të drejtë e pa pasoja duke ndarë përvojat, mendimet dhe ndjenjat me anëtarët e grupit;
- gjykon mënyrën e komunikimit, të sjelljeve dhe të qëndrimeve që nxisin konflikte ndërpersonale në klasë, në shkollë apo në shoqëri, duke vënë theksin në faktorët që kanë ndikuar në shfaqjen e saj dhe jep shembuj të menaxhimit dhe të zgjidhjes së konflikteve ndërpersonale në mënyrë konstruktive.

Kompetenca qytetare

Nxënësi:

- shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët, për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar;
- demonstroi veprime të ndryshme që shprehin tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve në komunitetin ku jeton (në klasë, në shkollë, në lagje dhe me gjerë) dhe i shpjegon ato në një debat me të tjerët;
- përgatit në grup një aktivitet dhe drejton forma të ndryshme të diskutimit për pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes demokratike dhe tregon tolerancë dhe respekt për pyetjet dhe komentet e të tjerëve;
- praktikon të drejtat dhe detyrimet si qytetar në situata konkrete të jetës së përditshme, në klasë, shkollë, komunitet ose gjatë diskutimit dhe respektimit të mendimit të tjetrit;
- reagon ndaj personave të cilët shkelin, cenojnë ose mohojnë të drejtat e të tjerëve si dhe arsyeton pasojat e këtyre veprimeve për individin, grupin dhe komunitetin;
- diskuton me të tjerët dhe paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj., si dhe jep propozime për zgjidhjen e ndonjë problemi në komunitet e më gjerë, në një fushë të caktuar;

- demonstroi me sjelljen e tij, me detyra, projekte dhe prezantime shembuj të mbrojtjes së mjedisit natyror dhe propozon alternativa se si të gjithë qytetarët mund të kontribuojnë në mënyra të ndryshme për këtë proces;
- përshkruan dhe shpjegon të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e pjesëtarëve të grupit, dallon rastet kur hyjnë në konflikt me njëri-tjetrin dhe paraqet alternativa të zgjidhjes së tyre.

Kompetenca digjitale

Nxënësi:

- përdor TIK-un për të lehtësuar procesin e të nxënësit dhe për të rritur efektivitetin në mësimdhënie;
- përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive;
- bashkëpunon me moshatarët e tij duke përdorur mjetet digjitale për të përpunuar, krijuar, realizuar dhe demonstruar tema mësimore nëpërmjet pjesëve të filmuara apo të animuara, për të trajtuar tema mësimore, për të zgjidhur çështje dhe probleme që mund të lindin në shkollë dhe jashtë saj;
- zhvillon aftësitë krijuese, duke zbatuar njohuritë e marra në shkencën kompjuterike dhe mediat digjitale;
- diskuton për avantazhet dhe disavantazhet e përdorimit të teknologjive në jetën e individit, shoqërisë apo komunitetit.

2.4 Lidhja e lëndës “Gjuhë e huaj” me temat ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore, me të cilat përballet shoqëria tani dhe në të ardhmen. Ato integrojnë fushat e të nxënësit, të cilat ndihmojnë nxënësin të interpretojë botën dhe të lidhë dijet e marra në shkollë me jetën dhe interesat e tij. Në Kornizën Kurrikulare dhe në Kurrikulën Bërthamë të AML janë përcaktuar temat ndërkurrikulare, të cilat janë:

- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.
- Të drejtat e njeriut.
- Vendimmarrja morale.

- Zhvillimi i qëndrueshëm.
- Mjedisi.
- Ndërvarësia.
- Bashkëjetesa paqësore.

Gjuha e huaj zhvillon te nxënësi njohjen e vlerësimit të kulturës dhe traditës botërore dhe kultivon identitetin dhe krenarinë kombëtare. Tema si: të drejtat e njeriut, vendimmarrja morale, mjedisi, zhvillimi i qëndrueshëm etj. mund të realizohen gjatë orëve mësimore ku mësuesi mund të krijojë situata të të nxënësve gjatë të cilave nxënësi shpreh në formë të ndryshme (ese, poezi, tregime dhe krijime të tjera me tematikë çështjet e mësipërme) mendimet e tij të pavarura dhe të mbështetura me argumente dhe shembuj nga jeta e përditshme.

Punët në grupe dhe projektet që zhvillohen në lëndën e gjuhës së huaj, ndihmojnë në krijimin e aftësive të nxënësit për të jetuar në mënyrë paqësore me të tjerët, me natyrën dhe për të promovuar detyrat dhe të drejtat e individit në një shoqëri të lirë dhe demokratike si dhe për të promovuar historinë e kulturën e kombit të tij dhe të vendit gjuhën e të cilit mëson.

2.5 Lidhja e lëndës “Gjuhë e huaj” me fushat e tjera kurrikulare


Programi lëndor “Gjuhë e huaj e parë” mbështetet në integrimin ndërlëndor. Gjuha e huaj e pajis nxënësin me njohuri, aftësi dhe shkathtësitë që sigurojnë suksesin e tij edhe në fushat dhe lëndët e tjera. Kompetencat gjuhësore janë kompetenca që ndihmojnë nxënësin në procesin e të nxënësve në të gjitha fushat kurrikulare. Konceptet e njohuritë gjuhësore trajtohen e mësohen më mirë në kontekste të caktuara kuptimore dhe ligjërimore, të cilat lidhen ngushtë me fusha tematike të parashtruara në programin e gjuhës së huaj dhe të trajtuara në lëndët e tjera.

Nxënësi zgjeron fjalorin dhe zhvillon aftësinë e të shprehurit qartë me shkrim dhe me gojë në fushat e tjera.

Gjuha e huaj mundëson nxënësin që të kuptojë dhe analizojë tekste ose mesazhe të ndryshme. Duke lexuar tekste të fushave të ndryshme (gjeografi, qytetari etj.) nxënësi zgjeron njohuritë për atë fushë. Leximi dhe analiza e teksteve letrare ndikon në të kuptuarin e ngjarjeve dhe figurave historike si dhe të vlerave shoqërore. Me fushën shoqëria dhe mjedisi janë të lidhura tema si: miqësia, marrëdhëniet familjare, marrëdhëniet në shkollë, koha e lirë, festat etj.

Duke përvetësuar aktet dhe funksionet gjuhësore nxënësi mëson si të komunikojnë me të tjerët në mënyrë korrekte dhe gramatikisht të saktë. Gjithashtu përvetësimi i mirë i gjuhës së huaj ndihmon nxënësin të zhvillojë më tej punën e tij kërkimore në fushat e tij të interesit (histori, shkenca, matematikë etj.) pasi shumë materiale gjenden në gjuhë të huaj. Integrimi i i lëndëve të tjera në gjuhën e huaj ndihmon jo vetëm në lidhjen ndërlëndore por edhe në pasurimin e një leksiku më specifik dhe përdorimin e tij. Lidhja me *shkencat natyrore* p.sh. matematikës dhe gjuhës së huaj shprehet në mësimin numrave, veprimeve matematikore (mbledhja e zbritja, shumëzimi dhe pjesëtimi).

Në lëndën e biologjisë, lidhja bëhet e qartë duke trajtuar tema, si: pjesët e trupit, ushqyerja, shëndeti, mjedisi. Me artet janë të lidhura ngushtë temat mbi sportin, muzikën, modën, pikturën etj. Lidhja me lëndën e TIK-ut, përmes së cilës nxënësi aftësohet të përdorë internetin, e-mail-in, programe të ndryshme, platforma digjitale, aplikacione etj., ndihmon atë të eksplorojë të reja mbi botën që po studion, të prezantojë sa më bukur dhe në mënyrë logjike idetë dhe opinionet e tij dhe të marrë informacion në kohë reale. Më konkretisht, kjo lidhje jepet në diagramin e mëposhtëm.



Diagrami 3: Lidhja e lëndës “Gjuhë e huaj” me fushat e tjera kurrikulare

2.6 Kompetencat e lëndës “Gjuhë e huaj”

Kompetencat e komunikimit gjuhësor janë ato të cilat e fuqizojnë një person të veprojë duke përdorur specifikisht mjetet dhe mënyrat gjuhësore. Për të realizuar qëllimet komunikuese, nxënësi mobilizon të gjitha kapacitetet e tij dhe i kombinon ato me kompetencën e komunikimit gjuhësor. Kompetenca e komunikimit gjuhësor është një sintezë e njohurive të parimeve bazë gramatikore, e njohurive se si gjuha përdoret në ambiente shoqërore për të kryer funksionin komunikues dhe e njohurive se si funksionet komunikuese kombinohen me parimet e ligjërimit.

Përshkrimi i kompetencave të lëndës

Kompetenca e komunikimit gjuhësor përbëhet nga kompetencat e mëposhtme:

Kompetenca gjuhësore nënkupton përvetësimin e rregullave gramatikore, semantike, fonetike, ortografike si dhe pasurimin e fjalorit.

Kompetenca socio-gjuhësore ka të bëjë me dimensionin shoqëror të gjuhës dhe i referohet të mësuarit të akteve të ndryshme të ligjërimit dhe komunikimit në kontekste të ndryshme shoqërore. Këto kontekste kanë të bëjnë me statusin shoqëror, gjininë, moshën e nxënësit si dhe me faktorë të tjerë që influencojnë në stilin dhe regjistrat e gjuhës. Zhvillimi i kësaj kompetence është shumë i rëndësishëm pasi në situata të ndryshme duhen përdorur lloje të ndryshme shprehjesh si edhe duhen mbajtur qëndrime, besime, vlera dhe pikëpamje të ndryshme.

Kompetenca pragmatike ka të bëjë me njohjen e rregullave dhe parimeve sipas të cilave mesazhi komunikues organizohet dhe strukturohet (zhvillimi i temës, lidhja logjike e ideve, koherenca e mendimeve) dhe realizimin e funksioneve komunikuese (kërkimi i informacionit, dhënia e këshillës, kërkimi për ndihmë, rënia dakord, përshëndetjet etj.).

Dy faktorë cilësorë të cilët përcaktojnë suksesin e nxënësit në realizimin e funksioneve komunikuese janë:


- a. Rrjedhshmëria
- b. Saktësia e të shprehurit

Duke u bazuar tek kompetencat kyçe dhe ato të komunikimit gjuhësor, nxënësi përdor aftësi dhe strategji të përshtatshme për përmbushjen e detyrave në veprimtaritë gjuhësore (me shkrim dhe me gojë): marrja e informacionit (të lexuarit, të dëgjuarit), ndërveprimi (të folurit ndërveprues, të shkruarit ndërveprues), produkti (produkti i të folurit, produkti i të shkruarit) dhe ndërhyrja (përmbledhja, interpretimi, perifrazimi, përkthimi

etj.). Kryerja e vazhdueshme e veprimtarive gjuhësore bën që nxënësi të forcojë aftësitë dhe shkathtësitë e **të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit.**

Lidhja midis aftësive, shkathtësive, veprimtarive dhe kompetencave mund të shihet si një lidhje burimore ku nxënësi gjen tek kompetencat mjetet për të realizuar veprimtaritë, por këto të fundit modifikohen dhe shtohen gjatë procesit të komunikimit. Një numër i kufizuar kompetencash i lejon nxënësit të kryejë një numër shumë të madh veprimtarish. Të kuptuarit e këtij dallimi është thelbësor për të bërë të suksesshëm procesin e të mësuarit dhe të nxënimit të gjuhëve.

Përdorimi i gjuhës veçanërisht në ndërveprim me të tjerët lejon përvetësimin e gjuhës, e cila në vetvete përfshin zhvillimin e kompetencave. Të mësuarit e pakontekstualizuar të kompetencave (si p.sh mësimi i rregullave gramatikore) e ndihmon nxënësin, por nuk është i mjaftueshëm për të përdorur gjuhën si një mjet komunikimi.



Diagrami 4: Lidhja e kompetencave të lëndës “Gjuhë e huaj” me veprimtaritë, aftësitë dhe shkathtësitë gjuhësore

2.7 Rezultatet e të nxënit

KOMPETENCA		REZULTATET E TË NXËNIT – NIVELI B1
GJUHËSORE Nxënësi e zotëron gjuhën në atë mënyrë që mund të përshkruajë situata të paparashikuara, të shpjegojë pikat kryesore të një ideje ose problemi me saktësi dhe të shprehë mendimet mbi tema abstrakte dhe kulturore si muzika, filmat etj.	Fjalori	Nxënësi zotëron fjalor të mjaftueshëm për të përshkruar situata të njohura dhe të paparashikuara, shpjegon me saktësi por ndonjëherë edhe me hezitim pikat kryesore të një problemi duke përdorur edhe fjali të përbëra. Nxënësi ka fjalor të mjaftueshëm për t'u shprehur rreth fushave të tij të interesit si familja, interesat, dëshirat, udhëtimet, puna dhe ngjarjet aktuale. Nxënësi demonstroi me saktësi leksikore relativisht të lartë por akoma bën gabime kur shpreh mendime mbi situata të vështira dhe të panjohura për të.
	Saktësia gramatikore	Nxënësi tregon relativisht një shkallë të lartë kontrolli dhe komunikon me saktësi gramatikore në kontekste të njohura si edhe nuk bën gabime që të çojnë në keqkuptime të asaj që do të shprehë. Ndonjëherë nxënësi mund të ndikohet nga gjuha amtare.
	Fonetika	Nxënësi është i qartë në të folur dhe në shqiptimin e fjalëve megjithëse ka raste të pakta kur shqiptimi nuk është i saktë.
	Ortografia	Nxënësi krijon tekste të gjata dhe shkruan pothuajse pa gabime dhe është i saktë në përdorimin e shenjave të pikësimit pavarësisht se ndonjëherë mund të tregojë ndikime të gjuhës amtare.
SOCIO-GJUHËSORE	Aktet e ligjërimit dhe komunikimit	Nxënësi kryen dhe ju përgjigjet një game të gjerë funksionesh gjuhësore duke përdorur shprehjet e zakonshme të një r regjistri neutral. Nxënësi njih rregullat e mirësjelljes dhe vepron në mënyrë të përshtatshme me to. Nxënësi shprehet qartë në

		situatë të ndryshme dhe shmang gabimet në formulimin e ideve. Nxënësi njih mirë ndryshimet midis kulturave, qëndrimeve, vlerave dhe besimeve që mbizotërojnë në vendin e tij dhe në vendet ku flitet gjuha e huaj.
PRAGMATIKE	Fleksibiliteti	Nxënësi përshtat shprehjet e mësuara për t'i përdorur në situatë më pak të njohura dhe të vështira për të.
	Pjesëmarrja në bashkëbisedim	Nxënësi ndërhyt dhe merr fjalën në një bisedë me temë të njohur për të duke përdorur shprehjet e mësuara.
	Zhvillimi i temës	Nxënësi tregon në mënyrë logjike dhe të rrjedhshme një tregim ose përshkrim në mënyrë lineare por ka raste që përdor argumente dhe shembuj të tjerë.
	Koherenca	Nxënësi lidh pjesë të shkurtra dhe të thjeshta në një tekst të plotë në mënyrë lineare duke tentuar për tekste më të komplikuar.

Aspektet cilësore të përdorimit të gjuhës së folur për nivelin B1

	Gama/diapazoni	Saktësia	Rrjedhshmëria	Ndërveprimi	Koherenca/ lidhja logjike
B 1	Zotëron mjaftueshëm fjalor për të shprehur veten duke hezitur dhe duke perifrastuar mbi tema si familja, interesat, puna, shkolla,	Përdor pothuajse saktë një repertor shprehjesh të rutinës së përditshme që përdoren dendur dhe lidhen me situatë të parashikueshme.	Mund të flasë në mënyrë të kuptueshme, megjithëse duket qartë që ndalon për ta menduar atë që do të thotë mirë nga ana gramatikore dhe	Mund të fillojë, vazhdojë dhe përfundojë biseda ballë për ballë mbi tema që janë të njohura për të ose të interesit të tij. Përsërit pjesë të asaj që është thënë për të	Mund të lidhë në mënyrë lineare një numër të vogël dhe të thjeshtë elementësh të folurit.

udhëtimet dhe ngjarjet nga jeta e përditshme.		leksikore si dhe bën korrigjime sidomos kur flet gjatë.	konfirmuar të kuptuarin reciprok.	
---	--	---	-----------------------------------	--

Për përmbushjen e kompetencave të lëndës të cilat çojnë natyrshëm në forcimin e kompetencave kyçe, nxënësit i duhet të konsolidojë njohuritë dhe konceptet e duhura, të aftësohet në shkathtësitë e fituara dhe të mbajë qëndrime dhe të zhvillojë vlera në situata të ndryshme.

Njohuri dhe koncepte

1. Formimi kulturor

- a. **Jeta e përditshme** (*organizimi i një plani ditor dhe i kohës së studimit; kujtime të mrekullueshme- dita më e bukur e jetës sime; qëllimet afatshkurtër dhe afatgjatë. Çfarë dua unë për të ardhmen time etj.*)
- b. **Bota e shkollës dhe e punës** (*Organizimi i një biznesi të vogël; shqetësimet e shoqërisë së sotme si papunësia etj.; Studimet dhe universitetet në vend dhe në botë, profesionet*)
- c. **Jeta personale dhe shoqërore** (*Shanse dhe të drejta të barabarta për gratë dhe burrat, të rinjtë dhe të rriturit; vendlindja; personalitete në shoqëri*)
- d. **Bota rreth nesh** (*Arti dhe kultura; flora dhe fauna; arkeologjia; historia e filmit; programet televizive; zakonet dhe traditat në vendet ku flitet gjuha që po mësohet etj.*)
- e. **Bota e komunikimit** (*rrjetet sociale; interneti; të shkruarit e letrave- letër kërkesë, letër ankesë, letër biznesi, etj.*)

2. Formimi gjuhësor

- a. **Gramatika** (*ndajfoljet; mbiemrat dhe strukturat e tyre; fjalitë e thjeshta dhe të përbëra.; kohët e foljeve; ligjërata e drejtë dhe e zhdrejtë; mënyra veprare dhe jo veprare; foljet modale; fjalitë kushtore etj.*)

- b. **Funksionet gjuhësore** (*dhënia e këshillave; të shprehurit e keqardhjes; theksimi i informacionit; të shprehurit e mendimin ose opinionit personal; vënia në diskutim ose të mos biesh dakord me dikë; të ndalosh dikë të bëjë diçka etj.*)

Aftësi dhe shkathtësi

Të dëgjuarit

Përshkrimi

Nxënësi kupton informacion faktik të drejtpërdrejtë rreth temave të zakonshme të jetës së përditshme dhe botës së punës duke identifikuar si idenë kryesore edhe detajet specifike kur e folura është e artikuluar qartë dhe me aksent të njohur për të. Gjithashtu nxënësi arrin të ndjekë biseda më të zgjeruara argumentuese kur flitet në gjuhë standarde.

Nxënësi:

- ndjek një bisedë të zakonshme megjithëse ndonjëherë ka nevojë për përsëritjen e fjalëve dhe frazave të veçanta;
- ndjek pikat kryesore të një bisede të zgjeruar që zhvillohet rreth tij nëse biseda e dhënë shqiptohet qartë në gjuhë standarde;
- kupton një tregim të shkurtër;
- kupton çështjet kryesore si edhe përmbajtjen e informacionit të lajmeve në radio dhe materialet e regjistruara mbi tema të interesit personal të shprehura ngadalë dhe qartë;
- kupton çështjet kryesore në programet televizive mbi tema të njohura;
- kupton informacionin e thjeshtë teknik si instruksione të përdorimit për pajisjet e përdorimit të përditshëm;
- kupton idetë kryesore të një bisede në një dialekt standard;
- ndjek një leksion ose bisedë mbi fushën e tij të interesit kur tema është e njohur për të dhe prezantimi është i mirëstrukturuar dhe i drejtpërdrejtë.

Të lexuarit

Përshkrimi

Nxënësi lexon tekste faktikë të drejtpërdrejtë me tema që lidhen me fushën e tij të interesit në një shkallë të kënaqshme të kuptuari të teksteve.

Nxënësi ka fjalor të gjerë por mund të ketë vështirësi me shprehjet që hasen rrallë në të lexuar.

Nxënësi:

- kupton çështjet kryesore në artikuj të shkurtër gazetash rreth temave të përditshme;
- lexon dhe të kupton artikuj apo intervista në gazeta dhe revista në të cilat mbahet qëndrim për një temë të veçantë;
- gjen kuptimin e fjalëve ose shprehjeve të panjohura nga konteksti nëse tema është e njohur;
- kap thelbin në tekste të shkurtra për shembull, përmbledhje lajmesh dhe gjen fakte dhe informacione në lidhje me vendin, kohën dhe personazhet;
- kupton informacionin më të rëndësishëm në fletëpalosje të thjeshta;
- kupton udhëzimet e dhëna me shkrim për përdorimin e pajisjeve të ndryshme;
- kupton përshkrimin e ngjarjeve, ndjenjave dhe dëshirave në letra personale aq mirë sa për të mbajtur korrespondencë me shokët e tij;
- kupton mesazhe të shkurtra dhe letra formale të tilla si letra zyrtare dhe biznesi;
- kupton ato pjesë në letrat private që lidhen me ngjarje, ndjenja, urime dhe dëshira;
- kupton subjektin e një tregimi të ndërtuar mirë duke u njohur me episode dhe ngjarjet më të rëndësishme dhe rolin që ato luajnë në histori;
- kupton me vështirësi dhe lexon artikuj në të cilat autori shpreh pikëpamje të caktuara personale;
- kupton përmbledhje që kanë të bëjnë me tema kulturore si filma, libra etj.;
- shqyrton tekste të gjatë për të gjetur informacionin e dëshiruar dhe mbledh informacion nga pjesë të ndryshme të tekstit ose tekste të ndryshëm për të kryer një detyrë të caktuar.

Të folurit

Të folurit ndërveprues

Përshkrimi:

Nxënësi komunikon me besim mbi temat e fushës së tij të interesit duke shkëmbyer, kontrolluar ose konfirmuar informacionin dhe shpjegon se pse diçka është problem. Nxënësi shpreh mendimin e tij mbi tema abstrakte dhe kulturore si filmat, librat, muzika.

Nxënësi:

- kërkon dhe kupton udhëzime të detajuara për të shkruar nga një vend në tjetrin edhe në situata të panjohura për të;
- përballon në të shumtën e rasteve situata që dalin gjatë një udhëtimi ose një konsulte mjekësore;
- shpreh dhe kërkon mendimin personal gjatë një diskutimi me shokë;
- diskuton dhe mbron mendimin e tij në biseda të përgjithshme mbi tema të specialitetit të tij;
- shprehet me mirësjellje nëse është dakord ose jo rreth një teme të caktuar;
- shpreh dhe ju përgjigjet ndjenjave të tilla si : lumturia, trishtimi, interesi dhe indiferenca;
- mban gjallë një bisedë apo diskutim , por nganjëherë e ka të vështirë të shprehet saktësisht për çfarë do të dëshironte;
- hyn edhe i papërgatitur në një bisedë ose intervistë;
- përçon gjatë bisedës shkallë të ndryshme emocioni si edhe vë në dukje rëndësinë që ato kanë për të personalisht;
- komenton shkurt mbi pikëpamjet e të tjerëve;
- sqaron qartë pikëpamjen e tij por ka vështirësi të bëhet pjesë e një debati;
- krahason alternativa të ndryshme dhe shpjegon pse diçka është problem;
- ankohet kur ka blerë një produkt që nuk është sipas dëshirës së tij;
- përmbledh një histori të shkurtër, intervistë duke dhënë mendimin e tij dhe ju përgjigjet pyetjeve për detajet e mëtejshme;
- jep informacion konkret që mund t'i kërkohej gjatë një interviste, konsulte etj.

Produkti i të folurit**Përshkrimi:**

Nxënësi në mënyrë të logjikshme bën përshkrim të një game të gjerë temash brenda fushës së tij të interesit duke e paraqitur atë në vijë lineare. Gjithashtu nxënësi tenton të bëjë përshkrime të qarta dhe të detajuara për një gamë të gjerë temash që lidhen me fushat e tij të interesit duke i zgjeruar idetë dhe mbështetur ato me shembuj.

Nxënësi:

- përshkruan në detaje përvoja , ndjenjat dhe reagimet që lidhen me to;
- përshkruan ëndërra, shpresa, ambicie, urime dhe dëshira;
- përshkruan ngjarje reale ose imagjinare;
- shpjegon dhe jep arsye për planet, synimet dhe veprimet e tija;
- lidh ngjarjet në një subjekt libri ose filmi dhe përshkruan reagimet e tija;
- perifrason gojarisht pasazhe të shkruara shkurt, duke përdorur fjalorin dhe strukturën e një teksti origjinal;
- rrëfen një histori;
- rrëfen detajet e një ngjarjeje të paparashikuar, p.sh një aksident;
- zhvillon një argument aq mirë sa mund të ndiqet pa vështirësi në pjesën më të madhe të kohës;
- mban një fjalim të shkurtër të parapërgatitur mbi tema të jetës së përditshme ose të interesit të tij;
- prezanton mbi një temë të njohur prej tij ku shumica e çështjeve shpjegohen me saktësi.

Të shkruarit

Përshkrimi:

Nxënësi shkruan tekste të plota mbi tema të fushës së tij të interesit duke i lidhur pjesët përbërëse të tij në mënyrë lineare. Gjithashtu nxënësi me vështirësi arrin të vlerësojë informacionin e marrë nga burime të ndryshme dhe të japë argumentet mbështetës. Nxënësi transmeton informacionin dhe idetë mbi tema konkrete dhe abstrakte, pyet dhe jep shpjegime mbi problemet me saktësi logjike.

Nxënësi:

- shkruan tekste të thjeshta të lidhura në mënyrë lineare për tema të interesit të tij duke shprehur pikëpamjet dhe opinionet e tija;
- shkruan tekste të thjeshta rreth përvojave(një udhëtim, një shfaqje në shkollë, një konkurs) për gazetën e shkollës ose të klubit;
- përshkruan një ngjarje reale ose imagjinare;
- fillon të shkruajë përshtypjet e tij mbi një libër, film ose shfaqje;
- shkruan letra personale familjes ose shokëve të tij për t' i pyetur , për t' u dhënë lajme të reja ose për t' u treguar një ngjarje;
- përshkruan me detaje në një letër personale përmbajtjen e një libri , filmi ose komenton për një koncert ose shfaqje;
- shpreh ndjenja si p.sh lumturinë , hidhërimin, interesin, keqardhjen, në një letër;
- përgjigjet me shkrim një lajmërimi dhe pyet për informacion më të plotë ose më specifik rreth mallrave ose shërbimeve. (p.sh një telefon celular, kompjuter ose një kurs mësimor);
- transmeton nëpërmjet faksit ose e-mailit informacion të shkurtër dhe të thjeshtë tek shokët ose të njohurit e tij si dhe u kërkon atyre informacion;
- shkruan CV-në i tij në formë të përmbledhur;
- shkruan saktë dhe shkurt një përmbledhje të artikujve mbi tema të përgjithshme;
- shkruan një përmbledhje të pikave kryesore në informacione nga media dhe burime të tjera;
- shkruan ese të thjeshta mbi temat e tij të interesit;
- shkruan mesazhe që transmetojnë pyetje dhe shpjegime të problemeve.

Vlera dhe qëndrime

Nxënësi:

- demonstroi pavarësi në mendime dhe veprime;
- demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;
- respekton përpjekjet personale dhe ato në grup;
- tregon gatishmëri për të bashkëpunuar;
- ndjek më vëmendje shokët kur flasin dhe respekton radhën e të folurit;
- përzgjedh fjalorin e duhur (nuk fyen, përdor fjalët e mirësjelljes etj.);
- tregon interes në materialet që lexon;
- respekton bashkëfolësit pa dallime gjinie, besimi, ideje;
- respekton përpjekjet personale dhe ato në grup;
- demonstroi bashkëpunim dhe qëndrim etik gjatë punës në grup dhe në diskutime;
- demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;
- vlerëson burime të ndryshme informacioni;
- mban qëndrimin e tij ndaj problemeve që dalin në klasë dhe në shkollë;
- është i paanshëm në marrjen e vendimeve.

Për të kryer detyrat që i jepen nxënësi duhet të përfshihet në veprimtari të shumta gjuhësore dhe të përdorë strategji komunikuese. Strategjitë konsiderohen si nyje lidhëse midis burimeve të nxënësit (kompetencat) dhe se çfarë ai mund të bëjë me ato (veprimtari të komunikuese). Shumica e situatave përfshijnë llojshmëri veprimtarish dhe përdorim të më shumë se një aftësie ose shkathtësie. Për shembull në një orë mësimi, një nxënësi i kërkohet të dëgjojë shpjegimin e mësuesit, të lexojë një tekst me zë ose në heshtje, të ndërveprojë me nxënësit e tjerë në grup, të shkruajë një ushtrim ose ese madje edhe të perifrazojë, shpjegojë etj. Strategjitë janë mjeti që nxënësi përdor për të mobilizuar dhe balancuar të gjitha burimet e tij, të aktivizojë të gjitha aftësitë e tij për të përmbushur plotësisht dhe me sukses detyrat që i jepen.

Strategjitë që përdor nxënësi në veprimtaritë prodhuese (produkti i të folurit/ produkti i të shkruarit)	
Planifikimi	Përsërit dhe provon kombinime dhe shprehje të reja duke kërkuar përshtypjet e të tjerëve.
Kompensimi	Jep dhe shpjegon tiparet e diçkaje konkrete kur nuk e di fjalën e saktë.
Monitorimi dhe korrigjimi	Korrigjon gabimet në kohët e foljeve dhe shprehjeve të cilat mund të çojnë në keqkuptime nëse bashkëfolësi thotë se nuk kupton mesazhin e dhënë.
Strategjitë që përdor nxënësi në veprimtaritë marrëse (të kuptuarit gjatë të dëgjuarit dhe të lexuarit)	
Identifikimi i të dhënave ndihmëse dhe gjetja e kuptimit	Gjen kuptimin e fjalëve të reja nga konteksti mbi tema që kanë të bëjnë me fushën e tij të interesit dhe nxjerr kuptimin e të gjithë fjalisë nëse tema është e njohur për të.
Strategjitë që përdor nxënësi në veprimtaritë ndërvepruese (të folurit ndërveprues/ të shkruarit ndërveprues)	
Marrja e fjalës në bashkëbisedim	Ndërhyn në një diskutim me temë të njohur për të dhe përdor shprehjet e duhura për të marrë fjalën.
Bashkëpunimi	Shfrytëzon një repertor bazë të gjuhës dhe të strategjive për të mbajtur gjallë një bisedë ose diskutim.
Pyetje për t'u qartësuar	Pyet bashkëfolësin të qartësojë ose të shtjellojë atë çka është duke thënë.

2.8 Ndarja e orëve mësimore

Në tabelën e mëposhtme është dhënë koha mësimore për klasën e X, sipas orëve vjetore të përcaktuara në Planin Mësimor të Arsimit Profesional për strukturën bllok 4 vjeçar, strukturën 2+1+1 dhe strukturën 2+2.

Orët Mësimore 36 javë x 3 orë/javë = 108 orë vjetore

Klasa X	Formimi kulturor	Formimi gjuhësor		Projekti dhe Portofoli Evropian i Gjuhëve (PEGJ)	Totali i orëve
		Gramatika	Funksionet gjuhësore		108 orë
	40%	30%	20%	10%	
	43 orë	32 orë	22 orë	11 orë	

Mësuesi ka të drejtë të ndryshojë deri në masën 10% të orëve të përcaktuara në tabelë duke pasur parasysh karakteristikat e çdo klase si edhe përparimin e nxënësve.

Tek orët e formimit kulturor përfshihen pjesët e reja të leximit dhe të dëgjimit të cilat përfshijnë njohuritë që merr nxënësi mbi botën e punës, shkollës, jetës personale, natyrës, udhëtimet, kulturat dhe traditat e vendeve të ndryshme etj. Nëse mësuesi vë re se disa njohuri nuk mund të përvetësohen nga nxënësi brenda një ore mësimore, ai planifikon orë rimarrje për ato njohuri.

Orët e formimit gjuhësor mbi gramatikën përfshijnë njohuritë gramatikore dhe punën me fjalorin që realizohet gjatë vitit. Këtu mund të përfshihen edhe orët e përforsimit të njohurive nëse mësuesi e shikon të nevojshme. Gjithashtu njohuritë gramatikore nuk mund të merren jashtë kontekstit dhe duke patur parasysh që përqasja në kurrikulën bërthamë është të mësuarit nëpërmjet situatave të të nxënësve, këto njohuri mund të ndërthuren edhe gjatë orëve kur fokusi është të folurit ose të shkruarit.

Funksionet gjuhësore ju referohen akteve të komunikimit që nxënësi realizon gjatë procesit të marrjes së gjuhës së huaj dhe mund të realizohen në përputhje me njohuritë dhe shkathtësitë e tjera.

Vlerësimi i nxënësit për realizimin e projektit bëhet i mbështetur edhe në punët e tij me Portofolin Evropian të Gjuhëve. Si rezultat del domosdoshmëri që mësuesi gjatë orëve të projektit të bazohet te Portofoli Evropian i Gjuhëve për të përcaktuar rezultatet e të nxënit dhe veprimtari sipas aftësive gjuhësore.

Teste të detyruara gjatë një viti shkollor janë 3 (tri) të cilat kryhen rreth përfundimit të çdo periudhe.

Planifikimi i orëve mësimore bëhet vjetor (sintetik- bëhet ndarja totale e orëve) si edhe në bazë periudhash tre mujore (analitik- trajtohen temat për çdo orë mësimi).

3 UDHËZIME METODOLOGJIKE

Metodat e mësimdhënies janë mjaft të rëndësishme për të realizuar një mësimdhënie efektive. Përdorimi i tyre shërben për zhvillimin gjuhësor të nxënësve dhe konsolidimin e kompetencave kyçe dhe ato të lëndës.

Mësuesit duhet të përditësojnë njohuritë rreth metodave, teknikave dhe strategjive të mësimdhënies me qëllim që të zhvillojnë tek nxënësi dëshirën për dijen, virtytet njerëzore, ambicien për të qenë i suksesshëm dhe aktiv në jetën e përditshme dhe botën e punës. Metoda, strategji dhe teknika të tilla si: diskutim për njohuritë paraprake, diagrame piramidale, lexim i drejtuar, imagjinata e drejtuar, parashikim me terma paraprake, harta e konceptit, rrjeti i diskutimit, pyetje autorit, ditarët e të nxënit, pyetja sjell pyetjen, puna në çift ose në grup etj., shërbejnë si nxitje për nxënësin dhe si garanci për rezultate të mira në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Përjasja ndaj metodologjive të mësimdhënies dhe mësimnxënies duhet të jetë shumë e gjerë dhe të paraqesë të gjitha mundësitë në mënyrë të qartë dhe transparente duke shmangur dogmatizmin. Mësuesi duhet të përdorë ato metoda që e ndihmojnë atë më shumë të arrijë përbushjen e qëllimit final që është plotësimi i nevojave të nxënësit për t'u bërë një zotërues i mirë i gjuhës.

Mësimdhënia e gjuhës së huaj karakterizohet nga kriteret e mëposhtme:

Mësimdhënie me në qendër nxënësin

Nxënësi është në qendër të procesit të mësimdhënies. Ky proces ndërtohet në varësi të nevojave, aftësive dhe interesave të nxënësit. Nxënësit e një klase nxënë në mënyra të ndryshme: disa individualisht ose në grup, të tjerë nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur ose me anë të mjeteve të ndryshme didaktike. Përpos kësaj, lënda e gjuhës së huaj kërkon që nxënësi të nxëjë konceptet, të zotërojë shprehitë dhe të zbatojë njohuritë gjuhësore. Të dy këto kushte diktojnë nevojën për strategji të ndryshme të mësimdhënies, të cilat përshtaten me objektin e të nxënës dhe nevojat e nxënësit. Qëllimi i çdo strategjie të mësimdhënies është që çdo nxënës të mësojë dhe të zbatojë njohuritë gjuhësore në mënyrë efektive.

Të mësuarit bashkëveprues

Mësuesit sigurojnë një mjedis të pasur dhe nxitës për komunikim dhe ndërveprim mes nxënësve. Ata përdorin metoda, strategji dhe teknika që nxitin të mësuarin bashkëveprues. Nxënësi gjatë orëve të gjuhës së huaj shpesh motivohet të punojnë me nxënës të tjerë. Detyrat e përbashkëta i sigurojnë nxënësit më shumë kohë për të komunikuar dhe për të ndarë përvojat e tij me pjesëtarët e tjerë të grupit. Puna në grupe nxit respektin dhe tolerancën ndaj mendimit të tjetrit si dhe ndikon në përdorimin e formave demokratike për ndarjen e përgjegjësive dhe punës.

Njëherazi edhe shkalla e zotërimit të gjuhës rritet duke forcuar më shumë lidhjen midis kompetencave kyçe dhe atyre të lëndës.

Integrimi

Veprimtaritë gjuhësore si: të lexuarit, të shkruarit, të folurit, të dëgjuarit dhe përdorimi i drejtë i gjuhës trajtohen në mënyrë të integruar që të sigurohen lidhje kuptimplota mes tyre. Ato plotësojnë njëra-tjetrën dhe zhvillohen së bashku për t'a bërë nxënësin të aftë të komunikojë dhe të përdorë njohuritë e marra në situatë të njohura dhe të panjohura për të dhe të zhvillojë aftësitë e tij të të lexuarit, të folurit, të dëgjuarit dhe të shkruarit.

Procesi i rimarrjes së njohurive

Aftësitë dhe shkathtësitë, njohuritë rreth sistemit gjuhësor dhe llojet e ndryshme të teksteve zhvillohen duke u rishikuar çdo vit. Kjo arrihet duke kaluar nga e njohura tek e panjohura dhe nga më e thjeshta te më e vështira. Temat dhe njohuritë do të rimerren në mënyrë të hollësishme dhe ciklike në faza të njëpasnjëshme të programit mësimor. Kjo mundëson që nxënësi të përparojë nga niveli bazë në nivele më të larta të përdorimit të gjuhës.

Situata e të nxënit

Mësuesi duhet të parashikojë situatë të nxëni që të realizojë gjatë një ose disa temave mësimore. Me situatë të nxëni kuptohet ndërtimi i njohurive nëpërmjet një situatë praktike ose reale. Kjo mund të zgjasë një ose disa orë mësimi. Këto situata ndihmojnë që nxënësi t'i përdorë njohuritë e marra në jetën e tij të përditshme pa vështirësi dhe në interes të tij.

Pavarësisht metodave të përdorura mësuesi duhet të ketë parasysh që nxënësi ka fituar:

- kompetencat e duhura;
- aftësinë për t'i përdorur këto kompetenca;
- aftësinë për të përdorur strategjitë e duhura në vënien e kompetencave në veprim.

4 UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

Vlerësimi i nxënësit është ndër komponentët më të rëndësishëm të kurrikulës me bazë kompetencash. Ky vlerësim, bazuar në rezultatet e të nxënit, përfshin gjykimin për arritjet e nxënësit (njohuri, shkathtësi, qëndrime) përkundrejt niveleve të arritjeve.

Roli kryesor i vlerësimit është të përmirësojë të nxënit. Informacioni i siguruar nga vlerësimi i ndihmon mësuesit të kuptojnë anët e dobëta dhe anët e forta të nxënësit në përmbushjen e kompetencave kyçe dhe ato të programit të lëndor për secilën klasë, si dhe u jep mundësi të përmirësojnë mësimdhënien dhe të bëjnë propozime për përmirësimin e programeve.

Në përzgjedhjen e praktikave të vlerësimit, përcaktimin e kohës së përshtatshme për vlerësim dhe përzgjedhjen e materialeve që do të vlerësohen duhet pasur parasysh:

- përcaktimi i qëllimit dhe strategjisë së vlerësimit;
- përzgjedhja e veprimtarive që mundësojnë demonstrimin e formimit dhe konsolidimit të kompetencave;
- përdorimi i vlerësimit për të verifikuar çfarë di aktualisht nxënësi;
- besimi se të gjithë nxënësit mund t'i përmirësojnë arritjet e tyre.

Tradicionalisht, tre koncepte konsiderohen nga më themelorët në vlerësim: vlefshmëria, besueshmëria dhe të qëniti vlerësim i realizueshëm. Mësuesi duhet të ketë parasysh që në vlerësim të jetë i paanshëm dhe transparent.

Vlerësimi i nxënësit ndahet në tre tipa kryesorë:

Vlerësimi diagnostikues që zakonisht kryhet në fillim të vitit shkollor ose para zhvillimit të një grupi orësh, për të identifikuar njohuritë paraprake, interesat ose aftësitë që ka nxënësi rreth asaj për të cilën do të zhvillohet mësimdhënia gjatë vitit shkollor. Ky informacion përdoret për të orientuar praktikën e mësimdhënies dhe mësimnxënies në mënyrë që të përcaktohen strategjitë e të ardhmes. Vlerësimi diagnostikues mund të jetë i shkurtër, i shpejtë, joformal dhe mund të bëhet me gojë dhe me shkrim.

Vlerësimi formues ose i vazhdueshëm është një proces që ndodh gjatë gjithë kohës në klasë dhe informon nxënësit, prindërit dhe mësuesit mbi progresin e nxënësve. Të dhënat dhe informacioni i mbledhur nga vlerësimi formues përdoren për të përmirësuar proceset e mësimdhënies dhe të nxëniti. Fokusi i vlerësimit formues nuk duhet të jetë vetëm vlerësimi me notë i nxënësit. Ky vlerësim mund të jetë edhe me simbole, komente etj.

Vlerësimi përmbledhës ose përfundimtar kryhet më shpesh në fund të një grupi orësh, për të përcaktuar çfarë është mësuar pas një periudhe kohe dhe shoqërohet me notë. Vlerësimet përmbledhëse përdoren jo vetëm për të informuar nxënësit e prindërit për progresin e fëmijëve të tyre, por edhe për të përmirësuar praktikën e mësimdhënies dhe të nxëniti si dhe për të krahasuar arritjet me rezultatet e pritshme të të nxëniti.

Gjatë zbatimit të programit nxënësit duhet t'i jepet mundësia të punojnë individualisht, në çift ose në grup për kryerjen e detyrave të dhëna dhe përmbushjen e kompetencave të lëndës dhe atyre kyçe. Në çdo rast mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit, në tërësi dhe të secilit nxënës, në veçanti.

Mësuesi nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësit në çdo orë mësimi dhe të vendosë nota në regjistër për secilën prej tyre. Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë lirshëm si partnerë rreth përvetësimit të njohurive të fituara në orët e kaluara dhe mirë kryerjes së detyrave në klasë dhe jashtë klase.

Komponentët e vlerësimit janë vlerësim me gojë dhe vlerësim me shkrim. Këto vlerësime bëhen në mënyrë të alternuar me njëri-tjetrin për t'i dhënë mundësi mësuesit të bëjë një vlerësim të saktë dhe të mirëpeshuar për të gjitha veprimtaritë gjuhësore. Mësuesi, në përputhje me parimet themelore të vlerësimit, siguron përdorimin e të gjitha llojeve të vlerësimit, të cilët përcaktohen si të domosdoshëm për të gjykuar në lidhje me arritjet e nxënësve, në funksion të mbështetjes së të nxënësit dhe mësimdhënies.

Vlerësimi i punëve me shkrim është një mjet shumë i rëndësishëm i njohjes së aftësive gjuhësore të nxënësit. Praktikrat e reja sot orientojnë vendosjen e kriterëve dhe të standardeve të përshtatshme dhe të arritshme nga nxënësit. Kështu, duhen kërkuar forma të larmishme vlerësimi, të cilat të pasqyrojnë nivelin real të arritjeve të nxënësit për marrjen e masave për përmirësimin e tij. Mësuesi duhet ta ndjekë gjithë procesin e të shkruarit që nga planifikimi dhe deri tek rishikimi dhe redaktimi. Shënimet e mësuesit janë shumë të rëndësishme për vlerësimin e punëve me shkrim të nxënësve: ato duhet të jenë të tilla që t'i motivojnë ata. Vlerësimi që nxënësit mund t'i bëjnë njëri-tjetrit, është një tjetër formë e rëndësishme që ndihmon mbarëvajtjen e punës në këtë drejtim.

Vetëvlerësimi është element i rëndësishëm në të mësuarin e gjuhës së huaj. Vënia e synimeve të qarta në program mundëson vetëvlerësimin e nxënësit në vazhdimësi. Gjatë vetëvlerësimit në procesin mësimor ndiqen këta hapa:

- mësuesi diskuton me nxënësit atë që ata do të arrijnë në klasë;
- nxënësit vlerësojnë punën e tyre në çifte dhe më pas mësuesi dhe nxënësi bëjnë komentin përfundimtar;
- nxënësit vlerësojnë punën e njëri-tjetrit në grupe duke marrë role të ndryshme, madje ndonjëherë dhe pa nevojën e ndihmës së mësuesit;

- nxënësit mban shënim arritjet e tij duke përdorur edhe gjuhën amtare;
- mësuesi bisedon me nxënësit individualisht dhe i tregon arritjet;
- nxënësi cakton objektivat për të ardhmen;

Nga vetëvlerësimi përfiton si nxënësi, ashtu edhe mësuesi. Njohja e nxënësit me vetëvlerësimin e ndërgjegjëson atë të kuptojë më mirë problemet e të mësuarit dhe i jep mundësi të caktojë objektiva për të ardhmen.

Vetëvlerësimi realizohet gjatë punës me portofolin e gjuhëve.

Portofoli European i Gjuhëve-PEGJ

Portofoli i nxënësit, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë vitit shkollor, kontributeve dhe arritjeve të tij në gjuhën që po mëson, për punën individuale dhe në grup, krijimtarinë, talentin, si dhe për aspekte të gjykimit dhe reflektimit të nxënësit për veten dhe të tjerët.

Portofoli European i Gjuhëve ka dy funksione: a. raportues dhe b. pedagogjik

Ai përbëhet nga tri pjesë:

- Pasaporta gjuhësore** ku nxënësi regjistron nivelet gjuhësore, kualifikimet dhe përvojat ndërkulturore.
- Biografia gjuhësore** ndihmon nxënësin të regjistrojë dhe të reflektojë mbi progresin e tij gjuhësor.
- Dosja** e cila mund të përmbajë punë me shkrim, detyra tematike, projekte lëndore e ndërlëndore, certifikata, diploma etj.

Për informacion të mëtejshëm mbi vlerësimin mësuesi i referohet udhëzimeve përkatëse.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA E SIGURIMIT SË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

PROGRAMET E KULTURËS SË PËRGJITHSHME
TË ARSIMIT TË MESËM PROFESIONAL

Lënda: Matematikë

Klasa: X-XI

Struktura 2+1+1, Struktura 2+2 dhe Blok 4-vjeçar

TIRANË, 2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

**PROGRAMET E KULTURËS SË PËRGJITHSHME
TË ARSIMIT TË MESËM PROFESIONAL**

Lënda: Matematikë

Klasa: X-XI

Struktura 2+1+1, Struktura 2+2 dhe Bllok 4-vjeçar

2024

Përmbajtja e programit

I.	Hyrje	5
II.	Korniza konceptuale e programit.....	6
1.	Qëllimet e arsimit parauniversitar	8
2.	Qëllimi i programit të matematikës	8
3.	Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat matematikore	9
4.	Lidhja e lëndës së matematikës me temat ndërkurrikulare	12
5.	Lidhja e lëndës së matematikës me fushat e tjera kurrikulare	13
6.	Kompetencat matematikore që formohen përmes tematikave të saj	16
7.	Koha mësimore për tematikë për secilën klasë.....	19
III.	Përmbajtja e matematikës për klasën e 10-të dhe 11-të.....	20
	SHKALLA E PESTË – KLASAT 10 DHE 11	22
1.1	Tematika: Numri.....	22
1.2	Tematika: Matja.....	25
1.3	Tematika: Gjeometria	28
1.4	Tematika: Algjebra dhe funksioni	31
1.5	Tematika: Statistika dhe probabiliteti	36
IV.	Udhëzime metodologjike	39
V.	Udhëzime për vlerësimin	43
VI.	Materiale dhe burime mësimore.....	45

Tabelat dhe diagramat

Diagrami 1. Korniza konceptuale e programit 7

Diagrami 2. Lidhja e lëndës së matematikës me fushat e tjera 15

Diagrami 3. Kompetencat matematikore që formohen përmes tematikave 16

Diagrami 4. Situatë e të nxënit dhe lidhja me elementet e programit (shembull)..... 42

Tabela 1. Rezultatet kryesore të të nxënit sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet matematikës për shkallën e pestë dhe për shkallën e gjashtë..... 10

Tabela 2. Kompetencat matematikore që zhvillohen nëpërmjet tematikave 17

Tabela 3. Orë të sugjeruara për çdo tematikë..... 19

Koordinoi programin:

Dorina Rapti

I. Hyrje

Zhvillimet e shumta dhe të vrullshme që po ndodhin në shoqërinë e sotme, ndikojnë thellësisht në të ardhmen e nxënësit. Për të përmbushur kërkesat e kësaj shoqërie në të cilën do të jetojë, nxënësi duhet të përshtatet jo vetëm me aftësinë për të përdorur matematikën dhe teknologjinë në mënyrë efektive, por edhe me aftësinë e përpunimit të sasive të mëdha të informacionit që merr si dhe me aftësinë për të nxënë në mënyrë të pavarur. Matematika e përgatit nxënësin për rolet e tij të ardhshme në shoqëri, nëpërmjet njohurive thelbësore matematikore dhe aftësive të arsytimit, të logjikës, të komunikimit dhe të modelimit; mundëson zhvillimin e personalitetit të nxënësit; mundëson zhvillimin e aftësive për të menduar në mënyrë kritike, për të hulumtuar, duke nxitur kështu kërkshërinë dhe inkurajimin për zbulime; siguron vetëbesimin për zgjidhjen e situatave problemore në jetën e përditshme.

Një nga aspektet më të rëndësishme në kurrikulën e matematikës është zhvillimi i kompetencave matematikore dhe i kompetencave kyçe, të cilat e ndihmojnë nxënësin të kuptojë përdorimin e matematikës në mënyrë efektive. Njohuritë matematike bëhen kuptimplota dhe të fuqishme, nëse marrin jetë në kurrikul dhe zbatohen në situata praktike. Situata të zgjidhjes së problemeve mund të nxirren nga fusha të lidhura ngushtë, si shkenca kompjuterike, biznes, financë, turizëm, biologji, fizikë, teknologji, por edhe nga fusha që mendohet se janë më larg matematikës, si: histori, gjeografi, shkenca sociale ose arte. Është e rëndësishme që kjo lidhje ndërmjet fushave të hulumtohet me kujdes, të analizohet dhe të diskutohet për të theksuar tek nxënësit, përhapjen e njohurive matematikore dhe të menduarit matematik në të gjitha lëndët.

Matematika është një nga shtatë fushat e kurrikulës së arsimit të mesëm të lartë dhe përmban vetëm lëndën e matematikës, e cila tradicionalisht vazhdon të jetë pjesë themelore e arsimit parauniversitar. Në shkallën e pestë (klasat 10 -11) vijohet me integrimin e njohurive nga numri, algjebra, gjeometria dhe sigurohet një zgjerim i mëtejshëm i njohurive nga trigonometria, funksioni dhe statistika e probabiliteti. Në këtë shkallë matematika është edhe në funksion të përgatitjes së nxënësve për studime të mëtejshme të avancuara. ***Matematika, përveç si lëndë shkollore, nëpërmjet forcës së abstragimit, argumentit logjik dhe bukurisë së vërtetimit, paraqitet si një disiplinë intelektuale dhe si një burim kënaqësie estetike.***

II. Korniza konceptuale e programit

Hartimi i programit lëndor rrjedh nga korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar, kurrikula bërthamë dhe plani mësimor i arsimit të mesëm të lartë. Si i tillë ky dokument i shërben:

- **nxënësit** për zhvillimin e kompetencave kyçe të të nxënësve gjatë gjithë jetës dhe të kompetencave të fushës së matematikës, në mënyrë që ai të përballojë sfidat e jetës dhe të integrohet në shoqëri;
- **mësuesit** për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe arritjet e nxënësve në klasë dhe jashtë saj;
- **prindit** për njohjen e rezultateve të pritshme të fëmijës dhe kriteret e vlerësimit në periudha të caktuara;
- **hartuesit** të teksteve mësimore dhe të materialeve ndihmëse për mësuesit dhe nxënësit;
- **inspektorit dhe vlerësuesit** për aspekte të ndryshme të procesit të mësimdhënie -nxënies.

Programi i matematikës ka në thelbin e tij krijimin e kushteve për ndërtimin e **kompetencave të fushës/lëndës**, si dhe të kompetencave kyçe që lidhen me to. Realizimi i **temave ndërkurrikulare** nëpërmjet lëndës së matematikës është një komponent i rëndësishëm i programit për kontributin e matematikës në shoqëri dhe në jetën e përditshme. Në program, gjithashtu, përshkruhet **lidhja e matematikës me fushat e tjera**, në mënyrë që kurrikula e arsimit të mesëm të lartë të shihet si një e tërë për realizimin e qëllimit kryesor të formimit të nxënësve.

Programi përmban edhe **pesë tematikat**, të cilat krijojnë kushte që nxënësi të ndërtojë dhe të zbatojë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, në funksion të kompetencave të lëndës dhe të kompetencave kyçe. Në program paraqitet edhe **koha mësimore për secilën tematikë** e cila ndryshon nga klasa në klasë.

Përdorimi i **metodologjive efikase në mësimdhënien e matematikës** është kusht për zbatimin e programit, për arritjen e kompetencave nga ana e nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin që zotëron brenda vetes. Në këtë program, **vlerësimi i nxënësve** është komponent thelbësor për përmirësimin e arritjeve të nxënësve dhe procesit të të nxënësve.

Programi i matematikës, nga pikëpamja e organizimit të përmbajtjes, paraqitet në diagramin e mëposhtëm:

1. Qëllimet e arsimit parauniversitar

Arsimi parauniversitar krijon kushte dhe mundësi që nxënësi: të ndërtojë dhe të zhvillojë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria demokratike; të zhvillohet në mënyrë të pavarur e të gjithanshme; të kontribuojë në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake dhe të shoqërisë shqiptare dhe të përballet në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës.

Në arsimin parauniversitar nxënësi:

- kultivon identitetin vetjak, kombëtar dhe përkatësinë kulturore;
- përvetëson vlera të përgjithshme kulturore dhe qytetare;
- zhvillon në aspektet intelektuale, etike, fizike, sociale dhe estetike;
- zhvillon përgjegjësi ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit;
- aftëson për jetë dhe për punë, në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;
- aftëson për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- zhvillon shpirtin e sipërmarrjes;
- përdor teknologjitë e reja.

Në këtë kontekst, nxënësi vlerëson matematikën në tërësi si metodë e njohjes së realitetit dhe si pjesë e kulturës njerëzore e progresit shoqëror.

2. Qëllimi i programit të matematikës

Programi i matematikës ka si qëllim të kontribuojë në zhvillimin individual të nxënësit, ta aftësojë atë për të përdorur, lehtësisht dhe në mënyrë organike, njohuritë e shprehite matematike, metodat matematike, arsyetimin matematik në fushat e tjera të të nxënësit. Ai e pajis nxënësin me modelet e të menduarit matematik, me idetë thelbësore dhe strukturat matematikore, me njohuri dhe shprehje matematike të nevojshme për jetën dhe për arsimim të mëtejshëm. Karakteristikë e mënyrës matematikore të të punuarit dhe të të

menduarit është përdorimi i saktë i gjuhës, zhvillimi i koncepteve të qarta, të menduarit logjik, argumentimi, si dhe kuptimi i varësive reciproke ndërmjet dukurive e proceseve. Mësimi i matematikës në arsimin e mesëm të lartë synon që nxënësi të zhvillojë të menduarin logjik dhe kritik, të hulumtojë rreth koncepteve matematike dhe të zbulojë ngjashmëritë, ndryshimet, rregullsitë dhe marrëdhëniet shkak - pasojë ndërmjet dukurive, të zhvillojë imagjinatën dhe të zgjidhë situatat matematikore në mënyra të ndryshme, si dhe të jetë i motivuar për ta studiuar matematikën si fushë që ka rëndësi për jetën sociale dhe profesionale.

3. Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat matematikore

Kompetencat kyçe të të nxënit gjatë gjithë jetës nuk zhvillohen në “vakum”, por janë të “rrënjosura” në kontekste specifike të të mësuarit, të cilat janë të lidhura me secilën prej lëndëve. Ndërtimi dhe zbatimi i kompetencave kyçe nga nxënësit gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies, kërkon që mësuesi të mbajë parasysh lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat matematikore për secilën shkallë. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë situatat e të nxënit, veprimtaritë, metodat dhe mjetet e përshtatshme për procesin e të nxënit. ***Kompetenca përcaktohet si harmonizim i njohurive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve për të trajtuar plotësisht situatat e kontekstit.*** Organizimi i mësimit të matematikës me bazë kompetencat siguron zhvendosjen e fokusit të nxënies nga përmbajtja lëndore (mësuesi në qendër) në atë që nxënësit kanë nevojë të dinë dhe të bëjnë me efikasitet në situata të ndryshme (nxënësi në qendër). Kur nxënësi realizon kompetencat matematikore, ai njëkohësisht është duke zhvilluar edhe kompetencat kyçe. P.sh., kompetenca matematikore “Zgjidhja e situatës problemore” përfshin shumë nga strategjitë e zgjidhjes së situatave të ndryshme problemore në shoqëri dhe në jetën e përditshme. Po kështu, me zhvillimin e kompetencave matematikore, nxënësi zhvillon kompetencat në lidhje me krijimtarinë, inovacionin, përpunimin e informacionit, paraqitjen e detyrave, punën në grup, komunikimin efektiv etj.

Për të realizuar lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e matematikës mësuesi ndjek këto hapa:

- përzgjedh rezultatin/et e të nxënit për kompetencat kyçe që synon të arrijë nxënësi në shkallën përkatëse;
- zberthen në rezultate të nxëni për secilin vit mësimor rezultatin/et e të nxënit për shkallë, për kompetencat kyçe;

- përzgjedh rezultatin/et e të nxënit për shkallë për kompetencat e fushës/ lëndës së matematikës që synon të arrijë nxënësi;
- zbërthen në rezultate të nxëni për kompetencat e fushës/lëndës së matematikës për vit mësimor, rezultatin/et e të nxënit për shkallë;
- përzgjedh përmbajtjen/et mësimore, mjetet didaktike, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënit të kompetencave matematikore në një vit mësimor, si dhe rezultatet e të nxënit për kompetencat kyçe në një vit mësimor;
- planifikon mësimdhënien duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do t'i arrijë rezultatet e të nxënit brenda vitit shkollor;
- kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave, projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënit për vit mësimor dhe shkallë për fushën/lëndën e matematikës.

Tabela 1: Rezultatet kryesore të të nxënit sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet matematikës për shkallën e pestë

<i>Nr.</i>	<i>Shkalla 5, Klasa X-XI</i>
	Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit <i>Nxënësi komunikon në mënyrë efektive</i>
<i>I.2</i>	Diskuton në grup në mënyrë konstruktive, të përmbledhur, duke dhënë dhe duke marrë informacion për një temë të caktuar nga fushat mësimore ose nga jeta e përditshme.
<i>I.8</i>	Prezanton një projekt kurrikular nga fusha e matematikës, të hartuar individualisht dhe në grup, për një temë të caktuar, duke përdorur në mënyrë efektive teknologjinë informative dhe teknologji të tjera.
	Kompetenca e të menduarit <i>Nxënësi mendon në mënyrë krijuese</i>
<i>II.1</i>	Prezanton, mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacioneve duke ofruar argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse.
<i>II.3</i>	Krijon një situatë logjike nga jeta e përditshme, që kërkon zgjidhje matematike apo një problem shkencor, duke u bazuar në njohuritë paraprake, si dhe prezanton procedurën e zgjidhjes së problemit para të tjerëve.
<i>II.4</i>	Modelon zgjidhjen e një problemi të dhënë (në klasë apo jashtë saj) për një temë të caktuar nga matematika, duke e zbërthyer në hapa të

	vegjël dhe jep sqarime të nevojshme për hapat e ndjekur në zgjidhjen e problemit, duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit.
II.6	Gjykon vërtetësinë e një rezultati të dhënë (p.sh., rezultatin e një detyre nga matematika etj.) i cili mund të jetë gjetur me zbatimin e formulave të njohura ose me përdorimin e procedurave të caktuara dhe nxjerr përfundime për vërtetësinë e gjyqimit të dhënë.
	Kompetenca e të nxënit <i>Nxënësi mëson për të nxënë</i>
III.1	Demonstron shkathtësi funksionale në matematikë, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre apo aktiviteti dhe gjatë të nxënit të dijeve të reja.
III.3	Parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuar për zgjidhjen e një problemi apo detyre të një teme të caktuar, bën përmbledhjen e veprimeve të përdorura, të cilat përcaktojnë drejtimin e mëtejshëm të të nxënit për temën apo problemin e caktuar.
III.4	Zgjidh një problem të caktuar mësimor ose një situatë nga jeta e përditshme. Në bazë të një planifikimi të dhënë dhe në bazë të rezultatit të fituar vërteton saktësinë e planifikimit dhe tregon me shembuj se si do të zbatojë strategjinë e ndjekur edhe në kontekste të tjera gjatë të nxënit.
III.8	Paraqet idetë personale para të tjerëve për mënyrën e zhvillimit të një aktiviteti të caktuar, duke dhënë mendime të argumentuara për rezultatet e pritura (në formë skice, grafiku, vizatimi, etj.).
	Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin <i>Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive</i>
IV.4	Demonstron shprehi organizative në punët individuale dhe në ekip përmes situatave reale në detyrat e veçanta mësimore, duke menaxhuar potencialin individual dhe atë të grupit, si dhe kohën, risqet dhe buxhetin në dispozicion.
IV.7	Harton një projekt me faza të mirëmenaxhuara (individualisht ose në grup) duke shkëmbyer, konsultuar dhe informuar të tjerët, si dhe duke identifikuar dhe duke vlerësuar burimet njerëzore, materiale dhe monetare në përputhje me rezultatet e pritshme.
	Kompetenca personale <i>Nxënësi bën jetë të shëndetshme</i>
V.6	Gjykon mënyrën e komunikimit, të sjelljeve dhe të qëndrimeve që nxisin konflikte ndërpersonale në klasë, në shkollë apo në shoqëri, duke vënë theksin në faktorët që kanë ndikuar në shfaqjen e saj dhe jep shembuj të menaxhimit dhe të zgjidhjes së konflikteve

	ndërpersonale në mënyrë konstruktive.
	Kompetenca qytetare <i>Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.</i>
VI.6	Demonstron veprime të ndryshme që shprehin tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve në komunitetin ku jeton (në klasë, në shkollë, në lagje dhe me gjerë) dhe i shpjegon ato në një debat me të tjerët.
	Kompetenca digjitale <i>Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.</i>
VII.2	Përdor mjetet digjitale për të përpunuar, krijuar, realizuar dhe demonstruar tema mësimore nëpërmjet vizualizimeve të filmuara apo të animuara.
VII.3	Gjen, organizon, analizon, përpunon dhe përdor informacionin nga një shumëllojshmëri burimesh dhe mediash.

4. Lidhja e lëndës së matematikës me temat ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore me të cilat përballet shoqëria tani dhe në të ardhmen. Matematika ka një shumëllojshmëri zbatimesh në jetën e përditshme dhe është e lidhur me shumë komponentë të arsimit. Kjo lidhje është e dyfishtë sepse ajo jo vetëm merr në konsideratë shumë nga këto komponentë, por edhe kontribuon në realizimin e tyre. Kështu, në shqyrtimin e temave ndërkurrikulare (*Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave; Të drejtat e njeriut; Vendimmarrja morale; Zhvillimi i qëndrueshëm; Mjedisi; Ndërvarësia; Bashkëjetesa paqësore*) nxënësi duhet të zgjidhë situata dhe probleme, duhet të përdorë arsyetimin matematikor dhe elemente të gjuhës matematikore, në mënyrë që të qartësojë dhe të shpjegojë çështje të ndryshme që lidhen me realizimin e tyre. Përmes situatave të paraqitura në temat ndërkurrikulare, nxënësi ka mundësi të bëjë lidhjet ndërmjet kompetencave matematikore me detyrat e caktuara për realizimin e këtyre temave.

Nxënësi mëson të realizojë disa etapa, kur zgjidh një problem apo situatë dhe kjo aftësi kontribuon në rritjen e tij personale duke e ndihmuar atë të gjejë vendin e tij në shoqëri. Nxënësi mund të përdorë metodat statistikore (anketa, intervista) për të bërë analiza rreth

mendimit të njerëzve, mund të arsyetojë dhe të argumentojë një vendim të caktuar. Kështu, ai mëson të marrë pjesë në jetën shoqërore në klasë dhe në shkollë, zhvillon një qëndrim të hapur ndaj botës duke respektuar diversitetin.

Nxënësi inkurajohet të veprojë aktivisht në mjedisin e tij duke ruajtur një qëndrim kritik ndaj mallrave të konsumit. Duke përdorur të kuptuarit e tij për numrat, financën, interpretimin e përqindjeve, nxënësi mund të ushtrojë gjykimin e tij kritik për konsumimin dhe përdorimin e mallrave të konsumit. Njohuritë statistikore dhe probabiliteti mund ta ndihmojnë nxënësin të interpretojë të dhëna për promovimin e shëndetit të mirë, e traditës dhe të zakoneve të jetesës, si dhe për të ushtruar gjykimin, argumentimin për vendimet e marra.

Nxënësi përdor aftësitë e tij matematikore që kanë të bëjnë me simbole, formula, grafikë për të vepruar në mënyrë aktive në mjedisin e tij. Ai mund të shpjegojë fenomenet në botën e tyre dhe ndërvarësitë e mjedisit dhe botës njerëzore.

5. Lidhja e lëndës së matematikës me fushat e tjera kurrikulare


Lidhja e matematikës me fushat e tjera pasuron situatat e të nxënësve, në të cilat nxënësi zhvillon kompetencat e tij. Zotërimi dhe studimi i *gjuhës* e ndihmon nxënësin të zhvillojë dhe të përdorë kompetencat matematikore. Për më tepër, gjuha është e nevojshme për formimin e koncepteve dhe proceseve matematikore. Aftësitë e mira gjuhësore e lejojnë nxënësin të përmirësojë elementet pamore përfshirë edhe organizimin e grafikëve. Të mësuarit e gjuhës dhe të matematikës janë të ngjashëm në disa pikëpamje: të dyja lëndët përfshijnë situata që u kërkojnë nxënësve të komunikojnë lloje të ndryshme mesazhesh; të dyja lëndët kanë të bëjnë me interpretimin e informacionit, planifikimin, organizimin e ideve dhe përcaktimin e një procedure; të dyja lëndët e ndihmojnë nxënësin të zhvillojë aftësinë për të paraqitur një argument ose një analizë nga këndvështrime të ndryshme; të dyja lëndët përdorin një qasje deduktive.

Në studimin e *shkencave apo të teknologjisë* nxënësi përdor arsyetimin dhe komunikimin me gjuhën e matematikës për të shpjeguar fenomenet me diagrame apo modelime të ndryshme. Në fushën “*Shoqëria dhe mjedisi*” ai përdor interpretimin e informacioneve të dhënave, shkallën, hartën, paraqitjet me diagrame dhe grafikë, periudhat kohore, si dhe përpunimet statistikore. Një lidhje e

qëndrueshme është ajo ndërmjet matematikës dhe e *orientimit për karrierë* duke përfshirë zhvillimin e aftësisë së planifikimit të karrierës dhe të aftësive sipërmarrëse.

Nga ana tjetër, matematika u shërben të gjitha fushave, me koncepte dhe me aftësi. Përmbajtja e matematikës (p.sh.. numrat, funksioni, figurat, kuptimi për hapësirën, statistika, probabiliteti etj.) mund të përdoren në studimin e fushave të tjera. Ajo është një mjet ndihmës i domosdoshëm për shkencat e natyrës, shkencat kompjuterike, por njëkohësisht luan një rol të rëndësishëm në të gjitha fushat e tjera.

Diagrami 2. Lidhja e lëndës së matematikës me fushat e tjera



6. Kompetencat matematikore që formohen përmes tematikave të saj

Bazuar në këtë kurrikul, fusha/ lënda e matematikës synon të përmbushë gjashtë kompetenca, të cilat lidhen me kompetencat kyçe që një nxënës duhet të zotërojë gjatë jetës së tij. Këto kompetenca arrihen nëpërmjet 5 tematikave kryesore.

Diagrami 3. Kompetencat matematikore që formohen përmes tematikave




Tabela 2. Kompetencat matematikore që zhvillohen nëpërmjet tematikave

Kompetencat matematikore	Përshkrimi i kompetencave	Zhvillimi i kompetencave nëpërmjet tematikave
<p>Zgjidhja e situatës problemore</p>	<p>Nxënësi përshkruan dhe zgjidh situata problemore, të nivelit praktik, të marra nga përvojat e përbashkëta të jetës së përditshme dhe të nivelit abstrakt duke zhvilluar kapacitetin e tij intelektual dhe intuitën krijuese.</p> <p>Treguesit kryesorë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përcaktimi i të dhënave të situatës problemore; - modelimi i një situatë problemore; - zbatimi i hapave për zgjidhjen e situatës problemore; - vlefshmëria e zgjidhjes së situatës problemore; - paraqitja e zgjidhjes së situatës problemore. 	<p>Nxënësi përdor numrat, veprimet me to, matjet, konceptet gjeometrike, shprehjet algjebrike, grafikët, interpretimin e problemave, identifikimin e të panjohurave, zgjidhjen e ekuacioneve, diagramët, grafikët, simbolet etj., për zgjidhjen e situatave problemore etj.</p>
<p>Arsyetimi dhe vërtetimi matematik</p>	<p>Nxënësi përdor arsyetimin, argumentimin dhe vërtetimin si aspekte themelore të matematikës. Arsyetimi dhe vërtetimi kanë të bëjnë me organizimin logjik të fakteve, ideve ose koncepteve në mënyrë që nxënësi të arrijë në një rezultat më të besueshëm se intuita.</p> <p>Treguesit kryesorë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - identifikimi i elementeve të situatës matematikore; - përdorimi i koncepteve matematikore dhe proceset e përshtatshme për situatën e dhënë; - arsyetimi për zbatimin e koncepteve dhe proceseve në situatën e dhënë. 	<p>Nxënësi përdor arsyetimin dhe argumentet për veprimet me numrat, fuqitë, rrënjët, funksionet trigonometrike, karakteristikat e planit dhe të hapësirës, shndërrimet gjeometrike, formulat gjeometrike për interpretimin dhe formulimin e konkluzioneve etj.</p>
<p>Të menduarit dhe komunikimi matematik</p>	<p>Nxënësi përdor komunikimin nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit për të organizuar dhe për të qartësuar të menduarin matematik. Nxënësi gjatë komunikimit në gjuhën matematikore demonstroi konceptet, proceset dhe përforcon të kuptuarit e tyre. Ai kupton se kjo gjuhë</p>	<p>Nxënësi përdor komunikimin me forma të ndryshme për përkthimet me simbole, rezultatet e zgjidhjes së problemave, për interpretimin e vetive të figurave e</p>

<p>Lidhja konceptuale</p>	<p>përdoret jo vetëm në lëndë të tjera, por edhe në jetën e përditshme.</p> <p>Treguesit kryesorë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - familjariteti me gjuhën e matematikës; - lidhja e gjuhës së matematikës me gjuhën e përditshme; - interpretimi i koncepteve matematikore. <p>Nxënësi kupton ndërtimin e koncepteve matematike për të formuar një të tërë dhe përdor varësitë ndërmjet këtyre koncepteve. Arsyetimi matematik zhvillon lidhjen ndërmjet koncepteve duke i ndërtuar dhe duke i zbatuar ato në proceset matematikore përkatëse.</p>	<p>trupave, për interpretimin e të dhënave, tabelave, digramëve, për diskutimet e ekuacioneve etj.</p> <p>Nxënësi përdor lidhjet konceptuale të numrave me ekuacionet, shprehjet algjebrike, problemave algjebrike dhe gjeometrike, drejtëzave dhe planeve, matjeve, tabelave të statistikës dhe probabilitetit etj.</p>
<p>Modelimi matematik</p>	<p>Nxënësi përshkruan dhe krijon modele duke përdorur veprimet themelore matematikore në situata të jetës së përditshme. Modelimi është procesi i paraqitjes së situatës nga jeta reale me gjuhën matematikore. Nëpërmjet përdorimit të teknikave përkatëse, gjendet zgjidhja matematikore, e cila më pas interpretohet në jetën reale.</p> <p>Treguesit kryesorë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përcaktimi i situatës në jetën reale; - modelimi në gjuhën matematike; - gjetja e zgjidhjes matematike; - përthimi i zgjidhjes matematike në zgjidhje të situatës në jetën reale. 	<p>Nxënësi modelon me anë të numrave, të simboleve, të shndërrimeve gjeometrike dhe të tabelave. Ai formulon ligjësi, formulon problema nga situata reale, ndërton e përdor formula etj.</p>
<p>Përdorimi i teknologjisë në matematikë</p>	<p>Nxënësi përdor teknologjinë si mjet për të zgjidhur apo për të verifikuar zgjidhjet, si dhe për të mbledhur, komunikuar, interpretuar e zbuluar informacione.</p>	<p>Nxënësi përdor programe kompjuterike për të zgjidhur problema, për të ndërtuar tabela dhe grafikë, për prezantime, hulumtime, përpunime dhënash etj.</p>

7. Koha mësimore për tematikë për secilën klasë

Programi i matematikës është konceptuar për klasën e 10 dhe 11 bashkë. Lënda e matematikës zhvillohet si më poshtë:

Tabela me numrin e javëve mësimore për secilën klasë, për secilën strukturë të Arsimit profesional

STRUKTURA 2+1+1		STRUKTURA 2+2		STRUKTURA Bllok 4-vjeçar	
Klasa X	36 javë	Klasa X	36 javë	Klasa X	36 javë
Klasa XI	34 javë	Klasa XI	34 javë	Klasa XI	36 javë

Në të gjitha strukturat (2+1+1; 2+2; 4 vjet) lënda e matematikës në klasën e 10 zhvillohet me 3 orë në javë secila (45 min), në klasën e 11 zhvillohet me 1 orë në javë (45 min.).

Programi i matematikës specifikon **me afërsi peshën** (orët e sugjeruara) të secilës tematikë, për secilën klasë. Shuma e orëve sugjeruese për secilën tematikë është e barabartë me sasinë e orëve vjetore, të përcaktuara në planin mësimor të arsimit profesional. Pesha më e madhe e programit zhvillohet në klasën e 10-të. **Shpërndarja e orëve ka për qëllim që përdoruesit e programit të orientohen për peshën që zë secila tematikë në raport me orët totale vjetore.** Megjithëse njohuritë përcaktohen për secilën tematikë, **ato trajtohen të integruara dhe të lidhura me njëra – tjetrën.** Brenda shumës së orëve totale, mësuesi planifikon të gjitha veprimtaritë që do të organizojë për një mësimdhënie - nxënie sa më efektive (**njohuritë/shkathësitë për realizimin e kompetencave matematikore, projektet kurrikulare, vetëvlerësime të nxënësve, testet e nxënësve apo edhe veprimtari të tjera në ndihmë të përparimit të nxënësit.**)

Tabela 3: Orë të sugjeruara për çdo tematikë

	Numri	Matja	Gjeometria	Algjebra dhe funksioni	Statistika dhe probabiliteti	Gjithsej orë
Klasa e dhjetë (2+1+1); (2+2) dhe (4 vjet bllok)	23	11	22	37	15	108 orë
Klasa e njëmbëdhjetë (2+1+1) dhe (2+2)	5	5	5	9	10	34 orë
Shkalla e pestë (2+1+1) dhe (2+2)	28	16	27	46	25	142 orë
Klasa e njëmbëdhjetë (4 vjet)	5	5	5	11	10	36 orë
Shkalla e pestë (4 vjet)	28	16	27	48	23	144 orë

Sasia e orëve mësimore për secilën tematikë është rekomanduese. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, ndërsa janë të lirë të ndryshojnë me 10% - 15% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën tematikë.

III. Përmbajtja e matematikës për klasën e 10-të dhe për klasën e 11-të

Programi i matematikës për klasën e 10-të dhe për klasën e 11-të është hartuar i përbashkët sipas tematikave përmbajtësore: **Numri; Matja; Gjeometria; Algjebra dhe funksioni; Statistika dhe probabiliteti.**

Këto tematika janë bazë për të ndërtuar njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera. Tematikat sigurojnë rezultatet e të nxënit, sipas kompetencave matematikore, të paraqitura në tabelë në fillim të çdo tematike.

Për secilën tematikë janë paraqitur njohuritë, shkathtësitë, si dhe qëndrimet e vlerat që duhet të demonstrojë nxënësi në klasën e dhjetë dhe të njëmbëdhjetë.

Tematikat dhe renditja e tyre nuk presupozojnë që përmbajtja vjetore të zhvillohet e ndarë sipas tematikave dhe në këtë renditje. Kombinimi dhe ndarja e koncepteve dhe shprehive matematike në situata të nxëni, kapituj apo grupe temash e njësi mësimore, si dhe

renditja e tyre është e drejtë e përdoruesve të programit (më kryesorët janë mësuesit dhe autorët e teksteve). **Bazuar në burimet e të nxënit (teksti i nxënësit dhe materiale të tjera ndihmëse), mësuesi planifikon pjesën e programit që do të zhvillojë në klasën e 10-të, e cila është pjesa më e madhe e programit dhe pjesën e programit që do të zhvillojë në klasën e 11-të.**

SHKALLA E PESTË – KLASAT 10 DHE 11

Klasa e dhjetë dhe klasa e njëmbëdhjetë

1.1 Tematika: Numri

Përshkrimi i tematikës

Nxënësi përdor shprehitë e nevojshme për të zgjedhur numrat dhe veprimet e përshtatshme në situata të dhëna, për të parashikuar, për të gjetur dhe për të gjykuar rezultatet e veprimeve. Ai zbaton njohuri për marrëdhëniet ndërmjet bashkësive dhe veprimeve me to duke përdorur simbolet matematike, fuqitë dh rrënjët, parashikimin dhe kontrollin e rezultateve të njehsimeve, si dhe njohuri nga financa e jetës së përditshme.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës/lëndës

Zgjidhja problemore

Nxënësi: modelon dhe zgjidh situata problemore, jo të ndërlikuara, me ndihmën ose jo të teknologjisë; demonstroi marrëdhëniet ndërmjet bashkësive; përzgjedh dhe zbaton strategji të përshtatshme për zgjidhjen e problemave të simuluar nga jeta reale dhe me shembuj nga shkencat e tjera.

Arsyetimi dhe vërtetimi matematik

Nxënësi: sugjeron formula të ndryshme; gjykon në vërtetësinë e një rezultati të dhënë i cili mund të jetë gjetur me llogaritje, me zbatimin e formulave të njohura ose me përdorimin e teknologjisë.

Të menduarit dhe komunikimi matematik

Nxënësi: demonstroi zbatimin e numrave realë; përdor simbolet matematike, fuqitë dhe rrënjët për të përshkruar situata të ndryshme nga matematika dhe nga jeta e përditshme; komunikon të menduarin e tij matematik (nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit) duke përdorur: gjuhën e përditshme, fjalorin matematik, paraqitje të ndryshme.

Lidhja konceptuale

Nxënësi: bën lidhje ndërmjet koncepteve e procedurave matematikore; integron njohuritë e shprehitë matematike me situata ose dukuri të marra nga kontekste të tjera (jeta e përditshme, lëndët e tjera, sportet etj.); integron/lidh konceptet e ndryshme matematike në mënyrë që të zgjidhë problema të ndryshme.

Modelimi matematik

Nxënësi: krijon modele që përmbajnë konceptet bazë matematikore si: numër dhjetor, thyesë, përqindje, eksponent, kënde; modelon konceptet matematike lidhur me numrat në situata financiare dhe sipërmarrëse.

Përdorimi i teknologjisë në matematikë

Nxënësi: përdor pajisjet e inputit, outputit, si: usb, cd, dvd, printer; zgjidh detyra matematike duke përdorur aftësitë e fituara në fushën e teknologjisë dhe TIK-ut.

Njohuritë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës	Shkathësitë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës
<p>BASHKËSITË</p> <ul style="list-style-type: none"> - Bashkësitë dhe marrëdhënia ndërmjet tyre - Prerja dhe bashkimi i dy bashkësive - Prodhimi kartezian i dy bashkësive <p>VEPRIMET ME NUMRA</p> <ul style="list-style-type: none"> - Radha e veprimeve duke përfshirë kllapat, fuqitë, rrënjë. - Numrat e thjeshtë, faktorë (pjesëtuesit), shumëfishat, faktorët e përbashkët - Shumëfishat e përbashkët, shumëfishi më i vogël i përbashkët, pjesëtuesi më i madh i përbashkët, faktorët e thjeshtë - Fuqitë e numrave pozitivë, si dhe rrënjët përkatëse 	<p>Nxënësi:</p> <p>BASHKËSITË</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor simbolet përkatëse, diagramin e Venit, për të paraqitur bashkësitë dhe marrëdhënien ndërmjet tyre; - përdor bashkësitë numerike; - paraqet me mënyra të ndryshme një interval numerik; - përdor në zbatime prerjen dhe bashkimin e dy bashkësive; <p>VEPRIMET ME NUMRA</p> <ul style="list-style-type: none"> - zbaton katër veprimet me numrat e plotë, numrat dhjetorë, thyesat (më të vogla dhe më të mëdha se 1), si dhe numrat e përzierë (pozitivë dhe negativë); - njeh dhe përdor marrëdhëniet ndërmjet veprimeve, përfshirë edhe veprimet e anasjellta (p.sh., thjeshtime në shprehje); - përdor radhën e veprimeve duke përfshirë kllapat, fuqitë, rrënjët dhe të anasjelltat; - përdor konceptin dhe fjalorin e duhur për numrat e thjeshtë, faktorët (pjesëtuesit), shumëfishat,

<p>- Numra irracionalë $\sqrt{2}; \sqrt{3}$ etj., dhe π</p> <p>THYESAT, NUMRAT DHJETORË DHE PËRQINDJET</p> <p>- Kthimi i numrave dhjetorë të fundmë në thyesë dhe anasjelltas</p> <p>RAPORTI, PËRPJESTIMI DHE PËRQINDJA</p> <p>- Kuptimi i raportit, përfshirë thjeshtimin në trajtë më të thjeshtë</p> <p>- Raporti si thyesë</p> <p>- Përpjesëtimi si raporte të barabarta</p> <p>- Lidhja e raportit me funksionet lineare</p> <p>- Përqindja si “numër i pjesëve në njëqind”</p> <p>- Përqindja si thyesë ose numër dhjetor</p> <p>- Sasia si përqindje të një sasive tjetër</p> <p>- Interesi i thjeshtë në matematikën financiare</p> <p>- Interesi i përbërë</p>	<p>faktorët e përbashkët, shumëfishat e përbashkët, shumëfishi më i vogël i përbashkët, pjesëtuesi më i madh i përbashkët, faktorët e thjeshtë;</p> <p>- përdor fuqitë e numrave pozitivë, si dhe rrënjët përkatëse (me tregues 2, 3 dhe numra më të mëdhenj), një disa fuqi të para të numrave 2,3,4,5;</p> <p>- kryen veprime me thyesa, me numra irracionalë $\sqrt{2}; \sqrt{3}$ etj., dhe me π;</p> <p>THYESAT DHE NUMRAT DHJETORË</p> <p>- kthen numrat dhjetorë të fundmë në thyesa dhe anasjelltas (p.sh. 3.5 në $\frac{7}{2}$ ose 0.375 në $\frac{3}{8}$);</p> <p>RAPORTI, PËRPJESTIMI DHE PËRQINDJA</p> <p>- shpreh një sasi si “pjesë” të një sasive tjetër në formë të një thyese (në rastet kur thyesa është më e vogël se 1 ose më e madhe se 1);</p> <p>- një dhe përdor kuptimin e raportit, përfshirë thjeshtimin në trajtë më të thjeshtë;</p> <p>- ndan një sasi të dhënë në dy pjesë që paraqiten si dy numra ose si numër dhe një raport;</p> <p>- shpreh ndarjen e një sasive në dy pjesë si raport ose si thyesë;</p> <p>- zbaton raportin në situata problemore nga jeta reale (p.sh ato që përfshijnë këmbimet, krahasimin, ndarjen, përbërjen dhe shkallën);</p> <p>- shpreh si raport ose thyesë një marrëdhënie shumëfishiteti ndërmjet dy sasive;</p> <p>- kupton dhe përdor përpjesëtimin si raporte të barabarta;</p> <p>- lidh raportin me thyesat dhe e shpreh me funksione lineare (p.sh., në një recetë keku: kemi 40g sheqer (y) dhe 50g miell (x), raporti është $4:5 = \frac{4}{5}$. Ekuacioni është $y = \frac{4}{5}x$);</p> <p>- përcakton përqindjen si “numër i pjesëve në njëqind”;</p> <p>- kthen përqindjen në thyesë ose numër dhjetor, duke e interpretuar këtë me shumëfishim;</p> <p>- shpreh një sasi si përqindje të një sasive tjetër;</p>
---	--

- zgjidh situata problemore me përqindje, me rritje dhe me ulje të vlerës në përqindje, duke përfshirë edhe interesin e thjeshtë dhe të përbërë në matematikën financiare;

Qëndrime dhe vlera

Nxënësi:

- paraqet dhe komunikon lirshëm mendimet e tij;
- është inovativ dhe prezanton idetë e reja të tij;
- demonstroi kërshëri dhe kuriozitet për numrat, bashkësitë, fuqitë, rrënjët, raportet etj.;
- organizon lidhjen konceptuale të njohurive;
- përdor imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve;
- vetëvlerësohet, përdor mendimin kritik dhe kritikën konstruktive në situata të ndryshme;
- demonstroi besim në forcat vetjake;
- demonstroi përdorimin e teknologjisë për llogaritje me numra;
- respekton punën e kryer mirë dhe pranimin e opinioneve të tjera (madje edhe të kundërta), duke treguar tolerancë;
- demonstroi vullnet në arritjen e rezultateve;
- respekton përpjekjet personale dhe ato në grup.

1.2 Tematika: Matja

Përshkrimi i tematikës

Nxënësi përqendrohet në matje të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta. Nxënësi kupton dhe zbaton njohuri për trigonometrinë e trekëndëshit dhe gjetjen e syprinave të figurave plane, përafrimin në matje, veprimet me vektorët në plan, largesën ndërmjet dy pikave, si dhe vëllimin e trupave gjeometrikë. Ai përdor, gjithashtu, edhe njohuritë për këndin dhe disa formula trigonometrike për \sin e \cos .

Rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës

Zgjidhja problemore

Nxënësi: përdor simbolet trigonometrike dhe gjeometrike për të përshkruar situata praktike; përzgjedh dhe zbaton strategji të përshtatshme për zgjidhjen e problemave të simuluar nga jeta reale dhe me shembuj nga shkencat e tjera.

Arsyetimi dhe vërtetimi matematik

Nxënësi: përdor arsyetimin, veprimet me mend ose parashikimin për të gjykuar zgjidhjen e një problemi trigonometrik dhe gjeometrik brenda njohurive të mësuara; vërteton teorema të thjeshta, me silogjizëm dhe nga e kundërta.

Të menduarit dhe komunikimi matematik

Nxënësi: kryen matje jo të drejtpërdrejta nëpërmjet formulave trigonometrike dhe gjeometrike; merr informacion nga figura gjeometrike të thjeshta dhe jep informacion nga figura të tilla; shkëmben informacion nga figura gjeometrike të thjeshta dydimensionale në tredimensionale.

Lidhja konceptuale

Nxënësi: bën lidhje ndërmjet koncepteve e procedurave trigonometrike dhe gjeometrike; integron njohuritë e shprehjet matematike me situata ose dukuri të marra nga kontekste të tjera (jeta e përditshme, lëndët e tjera, sportet etj.).

Modelimi matematik

Nxënësi: krijon modele që përmbajnë konceptet bazë në trigonometri dhe gjeometri (kënde, trigonometri e trekëndëshit, vektorë etj.); përdor disa shkathtësi argumentuese lidhur me modelimin dhe zbatimin e formulave.

Përdorimi i teknologjisë në matematikë

Nxënësi zgjidh detyra matematike duke përdorur aftësitë e fituara në fushën e TIK-ut.

Njohuritë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës	Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës
<p>MATJET DHE SAKTËSIA E TYRE</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njësitë standarde të masës, gjatësisë, kohës, parave dhe matjeve të tjera (përfshirë njësitë standarde të përbëra) - Shkalla e zmadhimit (zvogëlimit) dhe shkalla e diagrameve dhe hartave - Rrumbullakimi i numrave dhe i matjeve me një shkallë të përshtatshme saktësie 	<p>Nxënësi:</p> <p>MATJET DHE SAKTËSIA E TYRE</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor njësitë standarde të masës, gjatësisë, kohës, parave dhe matjeve të tjera (përfshirë njësitë standarde të përbëra) duke përdorur numrat dhjetorë, kur është e nevojshme; - përdor shkallën e zmadhimit (zvogëlimit) dhe shkallën e diagrameve dhe hartave; - kontrollon rezultatet duke bërë përafrime dhe parashikime, duke përfshirë përgjigjet e

<p>MATJE DHE NJEHSIME</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njësitë e matjes dhe konceptet përkatëse (gjatësi, syprinë, vëllim, masë, kohë, para etj.) - Perimetri i figurave plane të përbëra - Syprina e trekëndëshit, e paralelogramit, e trapezit - Perimetri dhe syprina e rrethit - Gjatësia e harkut, këndet dhe syprina e sektorit rrethor - Vëllimi i kuboideve dhe i prizmit të drejtë (përfshirë edhe cilindrin) - Syprina e përgjithshme dhe vëllimi i sferës, piramidës, konit. - Kongruenca dhe ngjashmëria e figurave - Teorema e Pitagorës, teoremat e Euklidit dhe formulat trigonometrike bazë në trekëndëshin kënddrejtë (sinus, kosinus dhe tangjent). <p>VEKTORËT</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zhvendosja paralele me anë të vektorëve në plan - Mbledhja dhe zbritja e vektorëve - Shumëzimi i vektorëve me një numër 	<p>fituara me anë të teknologjisë;</p> <p>MATJE DHE NJEHSIME</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor njësitë e matjes dhe konceptet përkatëse (gjatësi, syprinë, vëllim, masë, kohë para etj.); - përdor njësitë e përbëra si shpejtësinë, normat e rrogave, njësitë e çmimeve, densitetin dhe trysninë; - mat segmente dhe kënde në figura gjeometrike, përfshirë interpretimin e hartave dhe vizatimin e figurave me shkallë të ndryshme; - njehson perimetrin e figurave plane të përbëra; - njeh dhe zbaton formula për të njehsuar syprinën e trekëndëshit, paralelogramit, trapezit; - njeh dhe zbaton formulat për perimetrin dhe syprinën e rrethit; - njehson gjatësinë e harkut, këndet dhe syprinën e sektorit qarkor; - njehson vëllimin e kuboideve dhe prizmit të drejtë (përfshirë edhe cilindrin); - njehson syprinën e përgjithshme dhe vëllimin e sferës, piramidës, konit; - zbaton konceptet e kongruencës dhe ngjashmërisë së figurave; - njeh teoremën e Pitagorës, teoremat e Euklidit dhe formulat trigonometrike bazë në trekëndëshin kënddrejtë (sinus, kosinus dhe tangjent); - njeh vlerat e sakta të $\sin \alpha$ dhe $\cos \alpha$ për $\alpha = 0^\circ, 30^\circ, 45^\circ, 60^\circ$, dhe 90°; - njeh vlerat e sakta të $\operatorname{tg} \alpha$ për $\alpha = 0^\circ, 30^\circ, 45^\circ$ dhe 60°; <p>VEKTORËT</p> <ul style="list-style-type: none"> - përshkruan zhvendosjen paralele me anë të vektorëve në plan; - zbaton mbledhjen dhe zbritjen e vektorëve, shumëzimin e vektorëve me një numër.
<p>Qëndrime dhe vlera</p>	

Nxënësi:

- paraqet dhe komunikon lirshëm mendimet e tij;
- është inovativ dhe prezanton idetë e reja të tij;
- demonstroi kërshëri dhe kuriozitet për matjet dhe formula të ndryshme;
- organizon lidhjen konceptuale të njohurive;
- përdor imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve me trigonometri dhe gjeometri;
- vetëvlerësohet dhe përdor mendimin kritik dhe kritikën konstruktive në situata të ndryshme;
- demonstroi pavarësi në mendime dhe në veprime;
- demonstroi vullnet në arritjen e rezultateve;
- respekton përpjekjet personale dhe ato në grup.

1.3 Tematika: Gjeometria

Përshkrimi i tematikës

Nxënësi përdor arsyetimin dhe vërtetimin për të zgjeruar përfytyrimin për lidhjen ndërmjet algjibrës dhe gjeometrisë. Ai përdor njohuritë nga gjeometria në plan, nga shndërrimet gjeometrike dhe nga gjeometria koordinative. Nxënësi interpreton dhe zbaton rastet e kongruencës, ngjashmërisë së trekëndësheve, izometrisë, ekuacionin e vijës në plan (drejtëza, rrethi). Gjithashtu, në këtë tematikë ai përqendrohet edhe në gjeometrinë në hapësirë.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës

Zgjidhja problemore

Nxënësi: përdor simbolet gjeometrike për të përshkruar situata praktike; modelon dhe zgjidh situata problemore, jo të ndërlikuara, me ndihmën ose jo të teknologjisë.

Arsyetimi dhe vërtetimi matematik

Nxënësi: përdor arsyetimin, veprimet me mend ose parashikimin për të gjykuar zgjidhjen e një problemi gjeometrik brenda njohurive të mësuara; vërteton teorema të thjeshta, me silogjizëm dhe nga e kundërta.

Të menduarit dhe komunikimi matematik

Nxënësi: merr informacion nga figura gjeometrike të thjeshta dhe jep informacion nga figura të tilla; shkëmben informacion nga figura gjeometrike të thjeshta dydimensionale në tredimensionale; e mendon matematikën si pjesë e kulturës njerëzore.

Lidhja konceptuale

Nxënësi: bën lidhje ndërmjet koncepteve e procedurave trigonometrike dhe gjeometrike; integron njohuritë e shprehjet matematike me situata ose dukuri të marra nga kontekste të tjera (jeta e përditshme, lëndët e tjera, sportet etj.).

Modelimi matematik

Nxënësi: krijon modele që përmbajnë konceptet bazë në gjeometri (kënde, kongruencë, formula, shndërrimet gjeometrike etj); përdor disa shkathtësi argumentuese lidhur me modelimin dhe zbatimin e formulave.

Përdorimi i teknologjisë në matematikë

Nxënësi zgjidh detyra matematike duke përdorur aftësitë e fituara në fushën e teknologjisë dhe të TIK-ut.

Njohuritë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës	Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës
<p>GJEOMETRIA NË PLAN</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përdorimi i termave dhe simboleve përkatëse gjeometrike. - Përdorimi i mjeteve standarde të vizatimit (vizore dhe kompas) për të ndërtuar: përmesoren e segmentit, drejtëzën pingule me një drejtëz të dhënë të hequr nga një pikë e dhënë, përgjysmoren e këndit). - Kuptimi i largesës së pikës nga një drejtëz - Vetitë e këndeve me kulm të përbashkët: shtuese, plotësuese, kënde të kundërt në kulm etj. - Këndet korresponduese që formohen nga drejtëza paralele - Formula e shumës së këndeve në një trekëndësh 	<p>Nxënësi:</p> <p>GJEOMETRIA NË PLAN</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor termat dhe simbolet përkatëse: pikë, drejtëz, kulm, brinjë, plane, drejtëza paralele, drejtëza pingule, kënde të drejtë, shumëkëndësha, shumëkëndësha të rregullt, shumëkëndësha me drejtëza simetrie dhe/ose boshte rrotullimi; - skicon figurën, nisur nga përshkrimi, dhe përdor simbolet standarde për emërtimin e figurave, këndeve, brinjëve të trekëndëshit; - përdor mjetet standarde të vizatimit (vizore dhe kompast) për të ndërtuar: përmesoren e segmentit, drejtëzën pingule me një drejtëz të dhënë të hequr nga një pikë e dhënë, përgjysmoren e këndit); - përdor elementet më sipër për të ndërtuar figura dhe për të zgjidhur probleme me vende gjeometrike pikash; - njeh konceptin e largesës së pikës nga një drejtëz;

<ul style="list-style-type: none"> - Vetitë dhe përkufizime të llojeve të veçanta të katërkëndëshave përfshirë katrorin, drejtkëndëshin, paralelogramin, trapezin, balonën, rombin, si dhe trekëndësha e figura të tjera në plan - Kongruenca e trekëndëshave të çfarëdoshëm (BKB, KBK, BBB) dhe trekëndëshave kënddrejtë - Kriteret bazë të ngjashmërisë së trekëndëshave - Teorema e Pitagorës dhe teoremat e Euklidit - Vetitë e trekëndëshit dybrinjëshëm - Përkufizimi i rrethit dhe disa veti përkatëse, përfshirë: qendrën, rrezen, kordën, diametrin, perimetrin, tangjenten, harkun, sektorin <p>SHNDËRRIME GJEOMETRIKE</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rrotullimi, simetria, zhvendosja paralele dhe zmadhimi (përfshirë edhe koeficientë thyesorë apo negativë) <p>GJEOMETRIA NË HAPËSIRË</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vetitë e faqeve, brinjëve, kulmeve, syprinave të: kubit, kuboidit, prizmit, cilindrit, piramidës, konit dhe sferës - Pamjet nga drejtime të ndryshme të trupave gjeometrikë 	<ul style="list-style-type: none"> - zbaton vetitë e këndeve me kulm të përbashkët: shtuese, plotësuese, kënde të kundërt në kulm etj.; - kupton dhe përdor këndet korresponduese që formohen nga drejtëza paralele; - nxjerr dhe përdor formulën e shumës së këndeve në një trekëndësh (p.sh. e përdor këtë formulë për të përftuar formulën e shumës së këndeve në çdo shumëkëndësh si dhe të përftojë vetitë e shumëkëndëshave të rregullt); - nxjerr dhe zbaton vetitë dhe përkufizime të llojeve të veçanta të katërkëndëshave përfshirë katrorin, drejtkëndëshin, paralelogramin, trapezin, balonën, rombin, si dhe trekëndësha e figura të tjera në plan duke përdorur fjalorin përkatës të matematikës; - përdor kriteret bazë të kongruencës së trekëndëshave të çfarëdoshëm (BKB, KBK, BBB) dhe trekëndëshave kënddrejtë; - përdor kriteret bazë të ngjashmërisë së trekëndëshave; - bën lidhje të ngjashmërisë (duke përfshirë edhe funksione bazë trigonometrike) me koeficientin e ngjashmërisë; - zbaton vetitë e këndeve, kongruencën e trekëndëshave, ngjashmërinë, vetitë e katërkëndëshave dhe nxjerr përfundime për këndet, brinjët përfshirë teoremën e Pitagorës, teoremat e Euklidit, vetitë e trekëndëshit dybrinjëshëm; - përdor fakte të njohura për të kryer vërtetime të thjeshta; - identifikon dhe zbaton përkufizimin e rrethit dhe disa veti përkatëse, përfshirë: qendrën, rrezen, kordën, diametrin, perimetrin, tangjenten, harkun, sektorin; <p>SHNDËRRIME GJEOMETRIKE</p> <ul style="list-style-type: none"> - identifikon, përshkruan dhe ndërton figura kongruente dhe të ngjashme nëpërmjet rrotullimit, simetrisë, zhvendosjes paralele dhe zmadhimit, duke i konsideruar ato edhe në plan koordinativ;
--	---

GJEOMETRIA NË HAPËSIRË

- dallon dhe përdor vetitë e faqeve, brinjëve, kulmeve, syprinave të: kubit, kuboidit; prizmit, cilindrit, piramidës, konit dhe sferës;
- vizaton dhe interpreton pamje nga drejtime të ndryshme të trupave gjeometrikë.

Qëndrime dhe vlera

Nxënësi:

- demonstroi kërshëri dhe kuriozitet për gjeometrinë dhe shndërrimet gjeometrike;
- organizon lidhjen konceptuale të njohurive;
- përdor imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve në gjeometri dhe trigonometri;
- vetëvlerësohet dhe përdor mendimin kritik dhe kritikën konstruktive në situata të ndryshme;
- demonstroi pavarësi në mendime dhe në veprime;
- demonstroi përdorimin e teknologjisë;
- respekton punën e kryer mirë dhe pranimin e opinioneve të tjera (madje edhe të kundërta) duke treguar tolerancë;
- demonstroi vullnet në arritjen e rezultateve.

1.4 Tematika: Algjebra dhe funksioni

Përshkrimi i tematikës

Nxënësi përdor gjuhën e simboleve e cila shpreh marrëdhëniet matematikore. Ai kupton se si madhësitë lidhen me njëra-tjetrën dhe sesi algjebra i analizon dhe i shpreh në mënyrë sintetike këto marrëdhënie. Nxënësi përdor njohuri për rregullat bazë të shumëzimit, pjesëtimit dhe faktorizimit të polinomeve; interpretimin dhe zgjidhjen e ekuacioneve dhe inekuacioneve të fuqisë së parë dhe të dytë me një ndryshore, si dhe sistemet e tyre. Ai trajton edhe zgjidhjen e sistemeve të ekuacioneve me dy ndryshore. Përshkrimi i relacioneve bëhet duke përdorur gjuhën formale të algjebërës. Nxënësi studion relacionin, përshkrimin dhe interpretimin e funksioneve të ndryshme dhe ndërtimin e grafikut të tyre. Ai trajton zbatime të formulave të termit të përgjithshëm të vargut.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës

Zgjidhja problemore

Nxënësi: përdor simbolet algjebrike për të përshkruar situata praktike; modelon dhe zgjidh situata problemore jo të ndërlikuara, me ndihmën ose jo të teknologjisë.

Arsyetimi dhe vërtetimi matematik

Nxënësi: përdor kundërshebullin për të kundërshtuar, kur është rasti, fjali të jetës së përditshme ose fjali me ndryshore; argumenton shndërrimet; përdor drejt disa rregulla elementare të logjikës e të arsytimit korrekt;

Të menduarit dhe komunikimi matematik

Nxënësi: përdor simbolet algjebrike për të përshkruar situata të ndryshme nga matematika dhe nga jeta e përditshme; përshkruan, shpjegon dhe diskuton me gojë dhe me shkrim, veprimtaritë praktike, hamendjet dhe procesin e zgjidhjes;

Lidhja konceptuale

Nxënësi: bën lidhje ndërmjet koncepteve të algjebres dhe funksionit; integron njohuritë e shprehjetë matematike me situata ose dukuri të marra nga kontekste të tjera (jeta e përditshme, lëndët e tjera, sportet etj.); përdor arsytimin, veprimet me mend ose parashikimin për të gjykuar zgjidhjen e një probleme matematike.

Modelimi matematik

Nxënësi: krijon modele që përmbajnë konceptet bazë të algjebres dhe funksionit (ndryshori, ekuacioni, sistemi, funksionet, vargjet etj.); përdor figurat simbolike përmes vijave dhe grafikëve për përshkrimin dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme në matematikë, në fushat e tjera dhe në jetën e përditshme.

Përdorimi i teknologjisë në matematikë

Nxënësi zgjidh detyra matematike duke përdorur aftësitë e fituara në fushën e teknologjisë dhe TIK-ut.

Njohuritë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës

Shkathësitë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës

SIMBOLET, VEPRIME ALGJEBRIKE DHE FUNKSIONI

- Simbolet algjebrike
- Zëvendësimi i vlerave numerike në formula dhe shprehje algjebrike
- Përdorimi i kuptimeve të shprehjeve, ekuacioneve,

Nxënësi:

SIMBOLET, VEPRIME ALGJEBRIKE DHE FUNKSIONI

- përdor dhe interpreton simbolet algjebrike;
- zëvendëson vlerat numerike në formula dhe shprehje duke përfshirë edhe formula nga shkenca të tjera;

<p>formulave, identiteteve, inekuacioneve, kufizave dhe faktorëve</p> <ul style="list-style-type: none"> - Paraqitja në mënyrë më të thjeshtë e shprehjeve algjebrike. - Formulat elementare të matematikës - Shndërrime të njëvlershme në shprehjet algjebrike - Funksione me të dhëna (bashkësia e përcaktimit) dhe rezultate (bashkësia e vlerave) <p>GRAFIKËT</p> <ul style="list-style-type: none"> - Grafiku i ekuacioneve lineare në planin koordinativ - Trajta $y = kx + t$ për identifikimin e drejtëzave paralele - Ekuacioni i drejtëzës që kalon nëpër dy pika ose që kalon nga një pikë dhe me koeficient këndor (pjerrësi) të dhënë - Koeficientët këndorë dhe pikëprerjet me boshtet koordinative të funksioneve lineare - Rrënjët, pikëprerjet me boshtet koordinative, koordinatat e kulmit të funksionit të fuqisë së dytë - Grafikë të funksioneve lineare, të funksioneve fuqisë së dytë, të funksioneve të thjeshta të fuqisë së tretë, të funksionit përpjesëtimor të zhdrejtë $y = \frac{1}{x}$ me $x \neq 0$ - Grafikët e funksioneve përpjesëtimorë të zhdrejtë dhe grafikë të funksioneve jo elementare - Ekuacione dhe grafikë që përshkruajnë përpjesëtimin e drejtë dhe të zhdrejtë 	<ul style="list-style-type: none"> - kupton dhe përdor konceptet dhe fjalorin e shprehjeve, ekuacioneve, formulave, identiteteve, inekuacioneve, kufizave dhe faktorëve; - paraqet në mënyrë më të thjeshtë shprehjet algjebrike duke: <ul style="list-style-type: none"> ● mbledhur kufizat e ngjashme; ● shumëzuar një kufizë me një kllapë; ● faktorizuar kufizat e përbashkëta; ● zbërthyer prodhimet e dy binomeve; ● faktorizuar shprehjet e fuqisë së dytë të trajtës $x^2 + bx + c$, duke përfshirë edhe diferencën e katrorëve; ● thjeshtuar shprehjet përfshirë shumën, prodhimin, fuqitë dhe vetitë e tyre; - kupton dhe përdor formulat elementare të matematikës; - riorganizon formulat për të ndryshuar subjektin; - njeh ndryshimin ndërmjet ekuacionit dhe identitetit; - argumenton matematikisht shndërrime të njëvlershme në shprehje algjebrike; - interpreton shprehje të thjeshta si funksione me të dhëna (bashkësi përcaktimi) dhe rezultate (bashkësi vlerash); <p>GRAFIKËT</p> <ul style="list-style-type: none"> - punon me koordinatat në të katër kuadrantet; - ndërton grafikët e ekuacioneve lineare në planin koordinativ; - përdor trajtën $y = kx + t$ për të identifikuar drejtëzat paralele; - gjen ekuacionin e drejtëzës që kalon nëpër dy pika, ose që kalon nga një pikë e dhënë dhe me koeficient këndor (pjerrësi) të dhënë; - identifikon dhe interpreton në mënyrë grafike dhe algjebrike koeficientët këndorë dhe pikëprerjet me boshtet koordinative të funksioneve lineare;
---	---

- Pjerrësia e grafikut të një vijë të drejtë si normë ndryshimi.
- Koeficienti këndor (pjerrësia) e grafikut dhe sipërfaqja e kufizuar nga grafikët e funksioneve lineare

ZGJIDHJA E EKUACIONEVE DHE E INEKUACIONEVE

- Ekuacione lineare me një ndryshore (përfshirë ekuacionet me ndryshore në të dyja anët e barazimit)
- Ekuacione të fuqisë së dytë, duke përdorur formulën përkatëse
- Grafiku i ekuacioneve të fuqisë së dytë
- Sistemi i dy ekuacioneve me dy ndryshore (dy ekuacione lineare ose një ekuacion linear dhe ekuacioni tjetër të fuqisë së dytë)
- Zgjidhja grafike e sistemit
- Inekuacione lineare me një ose dy ndryshore
- Bashkësia e zgjidhjeve në boshtin numerik

VARGJET

- Vargu sipas rregullës së kufizave të njëpasnjëshme dhe rregullës kufizë –vend
- Vargjet e numrave trekëndorë, katrorë dhe kubikë
- Progresionet e thjeshta aritmetike, progresione të thjeshta gjeometrike (r^n ku n është numër natyror dhe r është numër racional > 0)
- Vargjet Fibonacci, vargjet e fuqisë së dytë (duke llogaritur diferencën e dytë)

- identifikon dhe interpreton në mënyrë grafike rrënjët, pikëprerjet me boshtet koordinative, koordinatat e kulmit të funksionit të fuqisë së dytë;
- njeh, ndërton dhe interpreton grafikë të funksioneve lineare, të funksioneve të fuqisë së dytë, të funksioneve të thjeshta të fuqisë së tretë, të funksionit përpjesëtimor të zhdrejtë $y = \frac{1}{x}$ me $x \neq 0$;
- vizaton dhe interpreton grafikët (përfshirë grafikët e funksioneve përpjesëtimorë të zhdrejtë, dhe grafikë të funksioneve jo elementare të dhëna në kontekste reale, për të gjetur zgjidhje problemore të përafërta siç janë situata problemore të thjeshta kinematike që përfshijnë rrugë, shpejtësi dhe nxitim;
- njeh dhe përdor ekuacionin e rrethit me qendër në origjinën e boshteve koordinativë;
- gjen ekuacionin e tangjentës së një rrethi në një pikë të dhënë;
- zgjidh situata problemore duke përfshirë përpjesëtimin e drejtë dhe të zhdrejtë, si dhe paraqitjen grafike e algjebrike;
- kupton që nëse X është në përpjesëtim të zhdrejtë me Y , kjo është e njëjtë me pohimin që X është në përpjesëtim të drejtë me $\frac{1}{Y}$;
- interpreton ekuacione që përshkruajnë përpjesëtimin e drejtë dhe të zhdrejtë;
- njeh dhe interpreton grafikë që ilustrojnë përpjesëtime të drejta dhe të zhdrejta;
- interpreton si normë ndryshimi pjerrësinë e grafikut të një vijë të drejtë;
- njehson ose vlerëson koeficientin këndor (pjerrësinë) të grafikut dhe sipërfaqen e kufizuar nga grafikët e funksioneve lineare, interpreton rezultatet në raste të grafikëve rrugë – kohë, shpejtësi – kohë si dhe grafikë linearë të situatave

- Kufiza e n-të në vargjet lineare

financiare;

- interpreton koeficientin këndor (pjerrësinë) të tangjentes në një pikë të një vije të lakuar (si normë ndryshimi në atë pikë);

ZGJIDHJA E EKUACIONEVE DHE INEKUACIONEVE

- zgjidh në mënyrë algjebrike ekuacione lineare me një ndryshore (përfshirë ato ekuacione me ndryshore në të dyja anët e barazimit);
- gjen zgjidhje të përafërta duke përdorur grafikun e ekuacioneve lineare;
- zgjidh në mënyrë algjebrike ekuacione të fuqisë së dytë, duke përdorur formulën përkatëse;
- gjen zgjidhje të përafërta duke përdorur grafikun e ekuacioneve të fuqisë së dytë;
- zgjidh në mënyrë algjebrike sistemin e dy ekuacioneve me dy ndryshore (dy ekuacione lineare ose një ekuacion linear dhe ekuacioni tjetër i fuqisë së dytë);
- gjen zgjidhje të përafërta duke përdorur zgjidhjen grafike të sistemit;
- përkthen situata të thjeshta problemore në shprehje ose formula algjebrike, shkruan një ekuacion (ose një sistem ekuacionesh), zgjidh ekuacionin (sistemin) dhe interpreton zgjidhjen;
- zgjidh inekuacione lineare me një ose dy ndryshore;
- paraqet bashkësinë e zgjidhjeve në boshtin numerik;

VARGJET

- përfiton kufiza të një vargu sipas rregullës së kufizave të njëpasnjëshme dhe rregullës kufizë-vend;
- njeh dhe përdor vargjet e numrave trekëndorë, katrorë dhe kubikë, progresionet e thjeshta aritmetike, vargjet Fibonacci, vargjet e fuqisë së dytë (duke llogaritur diferencën e dytë) dhe progresione të thjeshta gjeometrike (r^n ku n është numër

natyror dhe r është numër racional > 0);
- llogarit kufizën e n -të në vargjet lineare.

Qëndrime dhe vlera

Nxënësi:

- paraqet dhe komunikon lirshëm mendimet e tij;
- demonstroi kërshëri dhe kuriozitet për ekuacionet, funksionet dhe vargjet;
- organizon lidhjen konceptuale të njohurive;
- demonstroi shpirtin e objektivitetit dhe paanësisë;
- përdor imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve me ekuacione;
- vetëvlerësohet, përdor mendimin kritik dhe kritikën konstruktive në situata të thjeshta;
- demonstroi pavarësi në mendime dhe veprime;
- beson në përdorimin e teknologjisë për ndërtimin e grafikëve të funksioneve;
- demonstroi vullnet në arritjen e rezultateve.

1.5 Tematika: Statistika dhe probabiliteti

Përshkrimi i tematikës

Nxënësi në botën e sotme të mbushur me informacion, lexon, kupton dhe interpreton informacionin, në mënyrë që të marrë vendimet e duhura. Në këtë tematikë përfshihen: popullata, kampionimi, individi, ndryshorja (tipari), tipari diskret dhe i vazhdueshëm, paraqitja e të dhënave me tabela dhe grafikë, ngjarje të papajtueshme, probabiliteti i bashkimit të ngjarjeve, korrelacioni etj.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës

Zgjidhja problemore

Nxënësi kryen vërtetime dhe interpretime të tabelave dhe diagrameve të gatshme.

Arsyetimi dhe vërtetimi matematik

Nxënësi përdor drejt disa rregulla elementare të logjikës e të arsyetimit korrekt.

Të menduarit dhe komunikimi matematik

Nxënësi: përdor drejt disa elemente logjike të gjuhës së përditshme, si: *dhe, ose, sjell, nuk, anasjelltas, në qoftë se...atëherë..., të gjithë, të paktën një*; shkëmben informacion nga grafikë, tabela, diagrame.

Lidhja konceptuale

Nxënësi bën lidhje ndërmjet koncepteve e procedurave matematikore.

Modelimi matematik

Nxënësi përdor programet Word dhe Excel për të shkruar tekste, figura, tabela, grafikë.

Përdorimi i teknologjisë në matematikë

Nxënësi: përdor pajisjet e inputit, outputit, si: usb, cd, dvd, tastier, printer; përdor teknologjinë për të analizuar, komunikuar dhe zbuluar informacion matematik; përdor teknologjinë për zbatime të matematikës në shkencat e tjera.

Njohuritë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës

Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës

STATISTIKË

- Popullata dhe kampionimi
- Tabela, diagrame, tabela dendurie, diagrame rrethore dhe piktograme për të kategorizuar të dhëna
- Diagrame me shtylla për të paraqitur të dhëna numerike diskrete jo të grupuara
- Tabela dhe diagrame me vija për një grup të dhënash
- Shpërndarja e të dhënave dhe shpërndarja empirike me një ndryshore
- Mesataret (mesorja, mesatarja aritmetike, moda dhe klasa modale), amplituda
- Skatergrafi i të dhënave me dy ndryshore
- Korrelacioni

Nxënësi:

STATISTIKË

- nxjerr të dhëna për popullatën ose shpërndarjen nga një kampion, ndërkohë që njih kufijtë e kampionimit;
- interpreton dhe ndërton tabela, diagrama, përfshirë edhe tabela dendurie, diagrama rrethore dhe piktogramë për të kategorizuar të dhëna, diagrama me shtylla për të paraqitur të dhëna numerike diskrete jo të grupuara, tabela dhe diagrama me vija për një grup të dhënash, si dhe njih përdorimin e tyre në mënyrë të përshtatshme;
- interpreton, analizon dhe krahason shpërndarjen e të dhënave me shpërndarjet empirike me një ndryshore nëpërmjet:
 - grafikut të përshtatshëm duke përfshirë të dhëna diskrete, të vazhdueshme dhe të grupuara;

PROBABILITETI

- Denduritë e rezultateve në eksperimente probabilitare duke përdorur tabelat dhe pemën e dendurive
- Ngjarjet e rastit, njëlloj të mundshme dhe të pavarura, për të njehsuar rezultatet e pritshme nga eksperimentet
- Shuma e probabiliteteve të të gjitha ngjarjeve elementare është një
- Shuma e probabiliteteve të ngjarjeve dy e nga dy të papajtueshme, bashkimi i të cilave jep hapësirën e rezultateve, është një
- Përdorimi i tabelave, diagramit të Venit
- Hapësira e rezultateve të mundshme teorike për eksperimente të veçanta ose për eksperimente të përbëra me rezultate njësoj të mundshme
- Probabiliteti i ngjarjeve të kombinuara, të varura dhe të pavarura

- mesatareve (mesorja, mesatarja aritmetike, moda dhe klasa modale);
- amplitudës;

- zbaton statistikën për të përshkruar një popullatë;
- përdor dhe interpreton paraqitjen grafike (skatergrafin) e të dhënave me dy ndryshore;
- njeh korrelacionin dhe kupton që korrelacioni nuk ndikon te shkaku;
- bën parashikime;

PROBABILITETI

- përshkruan dhe analizon denduritë e rezultateve në eksperimente probabilitare, duke përdorur tabelat dhe pemën e dendurive;
- zbaton ngjarjet e rastit njëlloj të mundshme dhe të pavarura për të njehsuar rezultatet e pritshme nga eksperimentet;
- lidh denduritë relative të pritshme me probabilitetin teorik, duke përdorur fjalorin e përshtatshëm;
- zbaton vetinë që shuma e probabiliteteve e të gjitha ngjarjeve elementare, është një;
- zbaton vetinë që shuma e probabiliteteve të ngjarjeve dy e nga dy të papajtueshme, bashkimi i të cilave jep hapësirën e rezultateve, është një;
- kupton që sa më shumë rritet numri i provave, aq më shumë denduria relative i afrohet vlerës së probabilitetit teorik;
- numëron bashkësitë dhe kombinimet e tyre në mënyrë sistematike, duke përdorur tabela, diagramin e Venit;
- krijon hapësira rezultatesh të mundshme teorike për eksperimente të veçanta ose për eksperimente të përbëra me rezultate njësoj të mundshme

	<p>dhe i përdor ato për të njehsuar probabilitetin teorik;</p> <ul style="list-style-type: none"> - njehson probabilitetin e ngjarjeve të kombinuara të varura dhe të pavarura, duke përfshirë diagramin pemë dhe paraqitje të tjera.
<p>Qëndrime dhe vlera Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - paraqet dhe komunikon lirshëm mendimet e tij; - është inovativ dhe prezanton idetë e reja të tij; - demonstroi kërshëri për përdorimin e statistikës në analizën e dukurive nga jeta reale; - organizon lidhjen konceptuale të njohurive; - vetëvlerësohet, përdor mendimin kritik dhe kritikën konstruktive në situata të ndryshme; - demonstroi pavarësi në mendime dhe veprime; - demonstroi besim në forcat vetjake; - beson në përdorimin e teknologjisë për përpunimin e informacionit; - demonstroi vullnet në arritjen e rezultateve; - respekton përpjekjet personale dhe ato në grup. 	

IV. Udhëzime metodologjike

Përdorimi i metodologjive efikase në procesin e të nxënësve është kusht në rritjen e cilësisë së arritjeve nga ana e nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin që zotëron brenda vetes. Mësimdhënia e matematikës e cila udhëhiqet nga parimi që “çdo nxënës është i aftë të nxërë matematikë”, synon gjithëpërfshirjen, motivimin, barazinë në të gjitha aspektet dhe bazohet *në mësimdhënien dhe nxënien bazuar në kompetenca, në mësimdhënien me në qendër nxënësin dhe në mësimdhënien e nxënien e integruar.*

Nxënësit e një klase janë të ndryshëm për sa i përket mënyrës se si ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të

pavarur, me anë të mjeteve konkrete etj. Përpos kësaj, lënda e matematikës kërkon që nxënësit të zotërojnë kompetencat, të përvetësojnë konceptet, të zotërojnë shprehitë. Të dyja këto kushte diktojnë nevojën për strategji të ndryshme të mësimdhënies, të cilat përshtaten me objektin e të nxënimit dhe nevojat e nxënësve.

Planifikimi dhe përzgjedhja e metodave të mësimdhënies në mësimin e matematikës mban parasysh:

- kompetencat kryesore të të nxënimit të matematikës;
- lidhjen konceptuale, ruajtjen e koherencës vertikale të njohurive e aftësive në kuptimin që ndërtimi i çdo njohurie dhe edukimi i çdo aftësie mbështeten në ato të mëparshmet;
- formimin dhe forcimin e aftësive bazë matematikore;
- të nxënimit bazuar te hulumtimi dhe te zbulimi;
- rëndësinë e zbatimeve praktike, brenda dhe jashtë klasës, të cilat lidhin konceptet matematike me situata të jetës reale;
- rëndësinë e përdorimit të mjeteve konkrete didaktike dhe të teknologjisë;
- rolin e zgjidhjes së problemave dhe shumëllojshmërisë së strategjive të zgjidhjeve;
- veçoritë e punës individuale dhe të punës në grup;
- dobinë e përdorimit të burimeve të shumëllojshme të informacionit (përfshirë TIK-un);
- nevojën e individit për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- rëndësinë e qëndrimit pozitiv ndaj lëndës së matematikës dhe vlerësimit të përdorimit të gjithanshëm të saj;
- nxitjen e bashkëveprimit mësues-nxënës në kuptimin që në procesin mësimor mësuesi dhe nxënësi plotësojnë njëri-tjetrit.

Një mësimdhënie e mirëmenduar dhe e mirëplanifikuar krijon kushtet e nevojshme për një nxënie të suksesshme dhe lehtëson, si punën e mësuesit, ashtu edhe atë të nxënimit. Kompetencat matematikore të përcaktuara në këtë program janë të ndërlidhura, me sinergji dhe zhvillohen nëpërmjet situatave të të nxënimit që kanë në qendër pjesëmarrjen aktive të nxënësve. Ata janë aktivë, kur përfshihen në veprimtari, hulumtime, ndërtime ose simulime të njohurive, aftësive, krahasime të rezultateve apo nxjerrje konkluzionesh. Për të siguruar këtë pjesëmarrje aktive të nxënësve, mësuesi duhet të krijojë një atmosferë që i bën ata të ndihen të


lirshëm dhe të zhdërvjellët për të zhvilluar njohuritë e tyre në matematikë.

Gjithashtu, është e rëndësishme që nxënësi të punojë me situata të nxëni, ku i kërkohen arsyetime apo përgjigje të pyetjeve të tilla, si: “..pse...?”, “...a është gjithmonë e vërtetë...?”, “..çfarë ndodh kur...?” etj. Në këtë mënyrë ai inkurajohet të reflektojë mbi veprimet e tij dhe të ndërmarrë situata të reja. Përmes situatave të të nxënit, nxënësi eksploron, zbaton dhe integron njohuritë dhe aftësitë matematikore, fiton aftësi intelektuale të nevojshme për të zhvilluar të menduarit matematik, bëhet i vetëdijshëm për aftësitë e tij dhe arrin të ketë një qëndrim të caktuar edhe me njerëzit që e rrethojnë.

Projektet kurrikulare lejojnë nxënësin të zbatojë njohuritë dhe aftësitë që zotëron nga njëra anë, dhe nga ana tjetër nxënësi arrin të krijojë lidhje integruese me fushat/ lëndë të tjera. Edhe prezantimet e projekteve, diskutimet, debatet gjatë realizimit të tyre janë mundësi shumë e mirë për realizimin e kompetencave matematikore, por mbi të gjitha të kompetencave kyçe.

Më poshtë paraqitet diagrami që ilustron realizimin e një situatë të nxëni (shembull) dhe lidhjen e saj me elemente të tjera të programit.

Diagrami 4: Situata e të nxënit dhe lidhja me elementet e programit (shembull)



V. Udhëzime për vlerësimin

Në përputhje me parimet e qasjes së të nxënësve bazuar në kompetenca, vlerësimi konsiderohet si element i mësimdhënies i cili përqendrohet në nivelin e arritjes së kompetencave. Informacioni i siguruar nga vlerësimi i ndihmon mësuesit të kuptojnë anët e dobëta dhe anët e forta të nxënësve në përmbushjen e kompetencave, u jep mundësi të përmirësojnë mësimdhënien dhe të pajisin nxënësin me informacionin përkatës për progresin e tij. Vlerësimi i përmbajtjes lidhet me zotërimin e njohurive dhe demonstrimin e aftësive matematikore nëpërmjet treguesve të besueshëm për progresin e tyre (*p.sh., vetëvlerësimi, intervistë me një listë treguesish, test objektiv, vëzhgim me një listë të plotë treguesish, portofol, prezantim me gojë ose me shkrim, projekt kurrikular etj.*). Në përzgjedhjen e praktikave të vlerësimit, në përcaktimin e kohës së përshtatshme dhe në përzgjedhjen e materialeve duhen pasur parasysh:

- përcaktimi i qëllimit dhe i strategjisë së vlerësimit;
- përzgjedhja e teknikave dhe e instrumenteve të vlerësimit;
- përzgjedhja e veprimtarive që mundësojnë demonstrimin e arritjes së kompetencave;
- përdorimi i vlerësimit për të verifikuar çfarë dinë aktualisht nxënësit;
- dallimi i qartë i qëllimit të detyrës së zgjedhur për vlerësim;
- adresimi i vlerësimit të njohuritë, shprehitë dhe aftësitë;
- reflektimi i besimit që të gjithë nxënësit mund t'i përmirësojnë arritjet;
- informacioni për rezultatet e vlerësimit duhet të motivojë nxënësin, të ndikojë që nxënësi të pranojë se gabimi është pjesë e të nxënësve dhe të ndihmojë progresin e mëtejshëm;
- vlerësimi duhet të konsiderohet si pjesë e procesit të mësimdhënie-nxënies dhe jo si veprimtari më vete;
- vlerësimi ndihmon nxënësin të marrë përgjegjësi për veten e tyre, duke përfshirë strategji të vetëvlerësimit dhe të vlerësimit të njëri - tjetrit;
- vlerësimi të jetë gjithëpërfshirës, në kuptimin që t'u sigurojë mundësinë të gjithë nxënësve të demonstrojnë arritjet e tyre.

Vlerësimi i nxënësve në matematikë është:

Vlerësim diagnostikues që zakonisht kryhet në fillim të shkallës apo vitit shkollor, për të identifikuar njohuritë paraprake, interesat ose aftësitë që kanë nxënësit rreth asaj për të cilën po kryhet vlerësimi. Ky informacion përdoret për të orientuar praktikën e mësimdhënies të mësuesit dhe të nxënësve, në mënyrë që të përcaktohen teknikat korrigjuese. Vlerësimi diagnostikues mund të jetë i shkurtër, i shpejtë, joformal dhe mund të bëhet edhe me gojë.

Vlerësim formues ose vlerësimi për të nxënësit që është një proces që ndodh gjatë gjithë kohës në klasë dhe informon nxënësit dhe prindërit mbi progresin e nxënësve. Të dhënat dhe informacioni i mbledhur nga vlerësimi për të nxënë përdoren për të përmirësuar procesin e mësimdhënies -nxënies. Fokusi i vlerësimit formues nuk duhet të jetë vlerësimi me notë i nxënësit, por duhet të ndihmojë nxënësin që të përmirësojë të nxënësit e tij.

Vlerësim përmbledhës ose vlerësim i të nxënësit që kryhet për të përcaktuar çfarë është mësuar pas një periudhe kohe dhe shoqërohet me notë. Vlerësimet përmbledhëse përdoren jo vetëm për të informuar nxënësit e prindërit për progresin e nxënësve, por edhe për të përmirësuar praktikën e mësimdhënies dhe të nxënësit. Ky vlerësim konsiderohet si vlerësimi i të nxënësit dhe i arritjeve të nxënësit.

Gjatë vlerësimit mësuesi duhet të mbështetet në një sasi të konsiderueshme të dhënash që përfshihen në këto elemente:

- vlerësimi i përgjigjeve me gojë;
- vlerësimi i punës në grup;
- vlerësimi i aktivitetit gjatë debateve në klasë;
- vlerësimi i detyrave të shtëpisë;
- vetëvlerësimi i nxënësit;
- vlerësimi i nxënësve për njëri – tjetrin;
- vlerësimi i portofolëve;
- testet për një grup temash të caktuara;
- testet në përfundim të një kohe të caktuar ose në fund të vitit shkollor.

Detaje që kanë lidhje me vlerësimin në arsimin e mesëm të lartë gjenden në dokumente zyrtare të posaçme për këtë qëllim.

VI. Materiale dhe burime mësimore

Gjatë mësimit të matematikës mësuesi përdor teknologjinë, kompjuter, dvd etj., burime të cilat nxënësi i përdor për të hulumtuar dhe zbuluar informacione rreth njohurive matematikore. Ai përdor mjete pamore, teknologji të nevojshme, programe specifike kompjuterike për të realizuar modelime, prezantime për detyra, projekte dhe aktivitete alternative në lëndën e matematikës.

Mësuesi përdor fjalë dhe fjali të qarta, të sakta dhe me një fjalor të pastër gjuhësor. Mësuesi siguron qasje përmes përdorimit të teksteve dhe të materialeve të përshtatshme me moshën dhe mundësinë e nivelit të të mësuarit. Ai u prezanton/sqaron nxënësve, përmbajtje të caktuara ose shkathtësi që ata duhet të performojnë.

Mësuesi u krijon mundësi nxënësve të demonstrojnë apo të prezantojnë me anë të mediave, detyra dhe projekte të ndryshme kurrikulare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA E SIGURIMIT SË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

PROGRAMET E KULTURËS SË PËRGJITHSHME
TË ARSIMIT TË MESËM PROFESIONAL

Lënda: KIMI
Klasa: X

Struktura 2+1+1, Struktura 2+2 dhe Bblok 4-vjeçar

TIRANË, 2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

**PROGRAMET E KULTURËS SË PËRGJITHSHME
TË ARSIMIT TË MESËM PROFESIONAL**

Lënda: KIMI

Klasa: X

Struktura 2+1+1, Struktura 2+2 dhe Bllok 4-vjeçar

2024

Hyrje

Shkenca është veprimtari intelektual dhe praktike që përfshin studimin sistematik të strukturës dhe të sjelljes së botës fizike dhe natyrore përmes vëzhgimeve dhe eksperimenteve. Mësimi i shkencave natyrore iu ofron nxënësve mundësi për të zhvilluar të kuptuarit e koncepteve dhe të proceseve shkencore, të praktikave më të përdorura nga njeriu për zhvillimin e njohurive shkencore, të kontributit të shkencës në shoqëri dhe të zbatimeve të saj në jetën e përditshme.

Kurrikula e shkencës ndihmon në zhvillimin e kompetencave që u shërbejnë individëve në aspektin personal, social, ekonomik dhe që lidhen me çështje lokale, kombëtare dhe globale.

Kompetencat që zhvillon fusha e shkencave të natyrës, në të gjitha shkallët kontribuojnë në arritjen e kompetencave kyçe, në funksion të të nxënit gjatë gjithë jetës.

Përmbajtja lëndore konceptohet si mjet për realizimin e kompetencave kyçe dhe atyre të fushës nëpërmjet formësimit të situatave të të nxënit.

Nxënësit fillojnë me idetë e tyre se si janë gjërat dhe pastaj i ndryshojnë dhe i zhvillojnë duke i provuar ato praktikisht. Gjatë veprimtarive shkencore, nxënësit ndeshen me mundësitë e ndryshimit, rivendosjes ose sfidës së ideve. Kjo mënyrë e të nxënit bën që nxënësit të zhvillojnë dhe të formojnë të kuptuarit shkencor përmes ideve dhe përvojave të tyre. Idetë dhe konceptet përpunohen për sa kohë nxënësit punojnë në situata problemore dhe zbatojnë metoda kërkimore për t'i zgjidhur problemet. Duke mësuar në këtë mënyrë, ata mund të përjetojnë gëzimin e zbulimit shkencor dhe të ushqejnë kureshtjen për botën që i rrethon. Mësimi i shkencave natyrore lidhet ngushtë me teknologjinë dhe së bashku i formojnë nxënësit në një kontekst më të gjerë. Kurrikula bërthamë e shkencave të natyrës është e detyrueshme për klasën e X të arsimit të profesional.

Në shkallën V, fusha e shkencave natyrore integron njohuri, shkathtësi, qëndrime e vlera nëpërmjet lëndëve: fizikë, kimi, biologji. Në këto shkallë, nxënësit zgjerojnë fushën e njohjes për dukuritë më të zakonshme në jetën dhe veprimtaritë e përditshme, zhvillojnë aftësitë, strategjitë dhe shprehitë e të menduarit të nevojshme për hetimin shkencor dhe skicimin teknologjik. Ata lidhin njohuritë shkencore dhe teknologjike me njëra-tjetrën dhe me jetën, përdorin gjuhën dhe terminologjinë shkencore, si dhe krijojnë bazat konceptuale për të nxënit e mëtejshëm të shkencës.

Kurrikula bërthamë zhvillohet *në shkallën V* dhe fokusohet në zhvillimin e koncepteve të kësaj fushe.

Programi mbështetet në kornizën kurrikulare të arsimit parauniversitar, në kurrikulën bërthamë dhe në planin mësimor të AMU-së. Ai u shërben:

- *nxënësve* për zhvillimin e kompetencave kyçe të të nxënësve gjatë gjithë jetës dhe kompetencave të fushës së shkencave të natyrës;
- *mësuesve* për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e veprimtarive mësimore dhe arritjeve të nxënësve në klasë dhe jashtë saj;
- *prindërve* për njohjen e rezultateve të pritshme të fëmijëve dhe kriterëve të vlerësimit në periudha të caktuara;
- *hartuesve të teksteve mësimore* dhe të materialeve ndihmëse për mësuesit dhe nxënësit.

Zbatimi i programit bëhet duke respektuar parimet e gjithëpërfshirjes në aspektin gjinor, etnik, kulturor, racor, fetar, të paaftësive dhe nevojave të veçanta të nxënësve.

Koordinoi programin:

Elisabeta Paja

Qëllimet e fushës

Qëllimet e fushës së shkencave të natyrës janë konceptuar në funksion të të nxënit gjatë gjithë jetës.

Përmes kësaj fushe nxënësit:

- zhvillojnë njohuritë dhe konceptet bazë për formimin shkencor në fushën e shkencave të natyrës;
- zbulojnë lidhjet e varësisë ndërmjet botës së gjallë dhe mjedisit;
- zbulojnë lidhjet e varësisë ndërmjet botës së gjallë, botës jo të gjallë dhe mjedisit;
- zhvillojnë aftësitë shkencore, mendimin kritik dhe krijues;
- zbatojnë njohuritë dhe aftësitë shkencore në mënyrë analitike, kritike dhe krijuese në problemet që kërkojnë zgjidhje dhe marrje vendimesh;
- vlerësojnë kontributin e shkencës dhe të teknologjisë për mirëqenien e njeriut dhe të shoqërisë;
- ndërgjegjësohen për të bashkëvepruar me mjedisin në mënyrë të përgjegjshme dhe konsensuale;
- përshkruajnë proceset natyrore në kohë dhe në hapësirë;
- përshkruajnë burimet energjetike;
- shpjegojnë proceset përmes katër bashkëveprimeve (gravitetit, elektromagnetik, bërthamor dhe bashkëveprimi i dobët);
- përdorin teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit, si mjet për sigurimin dhe komunikimin e informacionit;
- shpjegojnë rolin e shkencës në zhvillimin e qëndrueshëm, si edhe në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit.

Programi i fushës së shkencave natyrore synon realizimin e kompetencave kyçe të të nxënit dhe të kompetencave të fushës. **Kompetencat e fushës** lidhen me **kompetencat kyçe** nëpërmjet **rezultateve të të nxënit** të secilës prej tyre. Lidhja mes rezultateve të të nxënit të kompetencave të fushës dhe të kompetencave kyçe siguron zhvillimin e ndërsjellë të tyre dhe mundëson integrimin lëndor. Kompetencat e fushës së shkencave natyrore mund të konsiderohen si komponentë të kompetencës së kërkimit shkencor. Ato janë renditur si më poshtë:

Kompetenca 1: Identifikimi i problemeve dhe zgjidhja e tyre

a) *Nxënësi përcakton problemin.*

- Merr parasysh kontekstin e situatës.
- Paraqet problemin.
- Identifikon të dhënat fillestare.
- Identifikon elementet që lidhen me situatën dhe me njëra-tjetrën.
- Reformulon problemin duke përdorur koncepte shkencore dhe teknologjike.
- Propozon një shpjegim ose zgjidhje të mundshme.

b) *Nxënësi zhvillon një plan veprimi.*

- Eksploron disa nga shpjegimet ose zgjidhjet fillestare.
- Zgjedh shpjegimin ose zgjidhjen.
- Identifikon burimet e nevojshme.
- Planifikon hapat e zbatimit.

c) *Nxënësi analizon rezultatet.*

- Kërkon modelet ose marrëdhëniet domethënëse.
- Gjykon përshtatshmërinë e përgjigjes ose zgjidhjes së gjetur.
- Lidh rezultatet dhe konceptet shkencore dhe teknologjike.
- Sugjeron përmirësime nëse është e nevojshme.
- Nxjerr përfundime.

d) *Nxënësi zbaton planin e veprimit.*

- Ndjek hapat e planit të vet.
- Përdor teknikat dhe burimet e përshtatshme.
- Bën teste nëse është e mundur.
- Mbledh të gjitha të dhënat e dobishme dhe mban shënime për vërtetimet e bëra.
- Nëse është e nevojshme, përshtat planin e veprimeve ose zbatimin e tij.
- Zbaton planin e veprimeve.

Kompetenca 2: Përdorimi i mjeteve objekteve dhe procedurave shkencore

a) Nxënësi vendos çështjet shkencore në kontekstin e duhur.

- Identifikon aspekte të kontekstit (p.sh., sociale, mjedisore, historike).
- Bën lidhjen ndërmjet këtyre aspekteve.
- Identifikon ndonjë çështje etike që lidhet me çështjen.
- Parashikon pasojat afatgjata.

b) Nxënësi kupton parimet shkencore mbi të cilat ngrihet çështja.

- Njih parimet shkencore.
- I përshkruan parimet në mënyrë sasiore dhe cilësore.
- Vendos lidhjet mes parimeve duke përdorur konceptet, ligjet ose modelet.

c) Nxënësi formon një opinion për çështjen.

- Kërkon burime të ndryshme dhe merr parasysh këndvështrime të ndryshme.
- Përcakton elementet që mund të ndihmojnë për të formuar opinionin.
- Mbështet opinionin e vet me elementet që ka marrë parasysh.
- Vlerëson opinionin e vet duke marrë parasysh edhe opinionet e të tjerëve.

d) Nxënësi vendos lidhjen mes shkencës dhe teknologjisë.

- Identifikon funksionet e përgjithshme të një objekti, sistemi ose procesi.
- Identifikon elementet përbërëse dhe funksionet e tyre.
- Përshkruan parimet e ndërtimit dhe të funksionimit të një objekti, sistemi, produkti ose procesi.
- Vendos lidhjet mes parimeve shkencore dhe teknologjike duke përdorur konceptet, ligjet ose modelet.
- Paraqet skematikisht parimet sipas të cilave funksionon objekti, sistemi, produkti ose procesi.

Kompetenca 3: Komunikimi me gjuhën dhe terminologjinë e shkencës

a) Nxënësi shkëmben informacion shkencor dhe teknologjik.

- Është i hapur ndaj këndvështrimeve të tjerëve.
- Vlerëson këndvështrimin e vet duke e krahasuar me atë të tjerëve.
- Integron termat shkencore dhe teknologjike në fjalorin e gjuhës së shkruar dhe të folur.

b) Nxënësi interpreton mesazhet shkencore dhe teknologjike.

- Vërteton besueshmërinë e burimeve që shfrytëzon.
- Identifikon informacionin që ka të bëjë me çështjen dhe shpjegimin ose zgjidhjen e saj.
- Kupton përmbajtjen e saktë të fjalëve, përkufizimeve dhe formulimeve.
- Bën lidhjet mes koncepteve dhe paraqitjeve të ndryshme grafike ose simbolike.
- Zgjedh elementet domethënëse.

c) Nxënësi krijon dhe ndan mesazhe shkencore dhe teknologjike.

- Merr parasysh audiencën dhe kontekstin e grupit që merr mesazhin.
- Strukturon mesazhin e tij.
- Përdor tipat e përshtatshëm të gjuhës sipas standardeve dhe marrëveshjeve të vendosura.
- Përdor forma të përshtatshme të prezantimit.
- Demonstron rigorozitet dhe koherencë.

Të tria kompetencat e fushës lidhen me njëra-tjetrën. Nëse kompetenca e parë ka të bëjë me mënyrat e të arsyetuarit që u mundësojnë nxënësve të merren me probleme shkencore, dy kompetencat e tjera i mësojnë ata se si të përdorin instrumentet dhe procedurat e duhura dhe si të komunikojnë

në gjuhën e shkencës dhe të teknologjisë për të zgjidhur problemet. Duke zbatuar mënyrat e të arsyetuarit shkencor, nxënësit kuptojnë natyrën e mjeteve, objekteve dhe procedurave të përdorura në këtë fushë dhe janë të aftë të vlerësojnë ndikimin pozitiv apo negativ të shkencës dhe të teknologjisë në mjedis dhe në shoqëri. Përveç kësaj, në prezantimin e shpjegimeve ose sqarimin e zgjidhjeve të tyre, ata ndërgjegjësohen për rëndësinë e përdorimit të saktë të gjuhës dhe të terminologjisë në shkencë dhe në teknologji.

Këto kompetenca zhvillohen së bashku dhe jo veçmas apo njëra pas tjetrës. Për të realizuar metodat dhe procedurat specifike shkencore, nxënësit njohin konceptet dhe gjuhët që lidhen me to, si dhe aftësohen në përdorimin e tyre. Ata familjarizohen me këto metoda dhe procedura, të cilat kanë kuptim dhe rëndësi sipas konteksteve ku zbatohen.

Kompetencat zhvillohen përmes **tematikave të përbashkëta të fushës** dhe në program zërthehen në njohuri/aftësi, shkathtësi/procedura, qëndrime/vlera. Tematikat e përbashkëta të fushës janë elemente të rëndësishme të programit të fushës së shkencave natyrore, sipas të cilave strukturohet përmbajtja lëndore dhe integrimi konceptual i secilës prej lëndëve brenda fushës, në funksion të zhvillimit të kompetencave. Tematikat e përbashkëta për shkallën e pestë dhe të gjashtë janë: *diversiteti, ciklet, sistemet, ndërveprimet, energjia, shkallëzimi dhe matja, modelet*.

Strukturimi i programit mbi rezultatet e të nxënësve për kompetencë në secilën lëndë dhe në tematika të përbashkëta, të njëjta për të gjitha lëndët e fushës, ndihmon në planifikimin dhe në zhvillimin e situatave të të nxënësve dhe lehtëson vlerësimin e nxënësve për kompetencat kyçe.

Situatat e të nxënësve janë situata që lidhen me kontekstin e të nxënësve. Ato mund të jenë situata në mjedise të mbyllura ose të hapura të nxënësve, brenda shkollës ose jashtë saj. Roli i mësuesit në mësimdhënien përmes situatave është ai i udhëheqësit e i lehtësuesit gjatë nxënies aktive të nxënësve.


Realizimi i **temave ndërkurrikulare** dhe i **lidhjes ndër lëndore** nëpërmjet lëndëve të shkencave natyrore janë, gjithashtu, elemente të rëndësishme të programit.

Metodat, teknikat, strategjitë e të nxënësve në fushën e shkencave natyrore janë faktorë të rëndësishëm për një nxënës të suksesshëm që nxit interesin, gjithëpërfshirjen, ndërveprimin dhe punën kërkimore të nxënësve. Përzgjedhja dhe përdorimi i tyre nga mësuesit bëhet në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve, duke respektuar stilet e ndryshme të të nxënësve.

Vlerësimi, si pjesë integrale e procesit të të nxënit, mat shkallën në të cilën kompetencat janë arritur nga nxënësit. Meqenëse i gjithë procesi i të nxënit në shkencat natyrore mbështetet në kërkimin shkencor, vlerësimi merr shumë forma, të cilat i parashikon dhe i mundëson struktura dhe konceptimi i programit.

Realizimi i programit të fushës së shkencave natyrore kërkon krijimin e një **mjedisi të nxëni**, të përshtatshëm, gjithëpërfshirës, të pasur me materiale dhe burime të domosdoshme, si dhe përdorimin e gjerë të TIK-ut.

Diagrami 1: Korniza konceptuale e programit



1. Lidhja e kompetencave të fushës me kompetencat kyçe

Kompetencat e fushës së shkencave lidhen dukshëm dhe në mënyrë logjike e metodike me kompetencat kyçe dhe me tematikat e fushës, të cilat janë në funksion të zhvillimit të tyre.

Kompetencat e fushës së shkencave natyrore lidhen me kompetencat kyçe nëpërmjet rezultateve të të nxënit të secilës prej tyre. Lidhja mes rezultateve të të nxënit të kompetencave të fushës dhe kompetencave kyçe siguron zhvillimin e ndërsjellët të tyre dhe lehtëson vlerësimin e nxënësve për kompetencat kyçe. Nga ana tjetër, kompetencat e fushës së shkencave natyrore lidhen edhe me njëra-tjetrën. Nëse kompetenca e parë **“Identifikimi i problemeve shkencore dhe zgjidhja e tyre”** ka të bëjë me mënyrat e të arsyetuarit që u mundësojnë nxënësve të merren me probleme shkencore, dy kompetencat e tjera **“Përdorimi i mjeteve, i objekteve dhe i procedurave shkencore”** dhe **“Komunikimi në gjuhën dhe në terminologjinë e shkencës”** u mësojnë atyre se si të përdorin instrumentet dhe procedurat e duhura dhe si të komunikojnë në gjuhën e shkencës dhe të teknologjisë për të zgjidhur problemet. Duke zbatuar mënyrat e të arsyetuarit shkencor, nxënësit do të kuptojnë natyrën e mjeteve, objekteve dhe procedurave të përdorura në këtë fushë dhe do të jetë të aftë të vlerësojnë ndikimin pozitiv apo negativ të shkencës dhe të teknologjisë në mjedis dhe në shoqëri. Përveç kësaj, në prezantimin e shpjegimeve ose sqarimin e zgjidhjeve të tyre, nxënësit do të ndërgjegjësohen për rëndësinë e përdorimit të saktë të gjuhës dhe të terminologjisë në shkencë dhe në teknologji.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet lidhja e rezultateve të të nxënit të kompetencave të fushës me rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe, sipas shkallës V të kurrikulës. Megjithëse paraqiten të ndara në tabelë, nuk ka një kufi të prerë të lidhjes së rezultateve të të nxënit të kompetencave të fushës me rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe, pasi një kufi i tillë nuk ekziston mes kompetencave në vetvete, si tek ato kyçe ashtu edhe tek ato të fushës.

Tabela 1: Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet fushës së shkencave të natyrës për shkallën V

<i>Shkalla V</i> <i>Klasa X</i>
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Nxënësi komunikon në mënyrë efektive
Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">- shprehet përmes një forme komunikimi, për një temë të caktuar në një material (prezantim) prej 200 fjalësh dhe veçon çështjet kryesore;- diskuton në grup në mënyrë konstruktive, në një kohëzgjatje jo më shumë se 10 minuta, duke dhënë dhe duke marrë informacion për një temë të caktuar nga fushat mësimore ose nga jeta e përditshme;- përdor drejt strukturën dhe rregullat e drejtshkrimit në kontekste dhe forma të ndryshme të shkrimit, si: ese, e-mail (postë elektronike), letër formale dhe joformale etj.;- prezanton një projekt artistik, humanitar, eksperimentues etj. nga fusha të ndryshme mësimore, të hartuar individualisht dhe në grup, për një temë të caktuar, duke përdorur në mënyrë efektive teknologjinë informative dhe teknologji të tjera;- përdor TIK-un në mënyrë efektive gjatë komunikimit dhe ndërveprimit me të tjerët në jetën e përditshme, duke përfshirë edhe të nxënit e informacioneve të reja dhe kryerjen e detyrave shkollore.

Kompetenca e të menduarit
Nxënësi mendon në mënyrë krijuese

Nxënësi:

- prezanton në forma të ndryshme të të shprehurit, mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informatave për fusha të ndryshme mësimore apo për një temë të caktuar, ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse (p.sh.: temë nga shkenca, nga kultura, nga arti, nga sporti, nga shëndetësia, nga shoqëria, nga mjedisi etj.);
- krahason të paktën tri burime të ndryshme të informimit për trajtimin e temës së njëjtë, argumenton saktësinë, rrethanat, gjen ngjashmëritë dhe dallimet, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara më parë dhe i prezanton gjetjet kryesore para të tjerëve në forma të ndryshme shprehëse, duke përdorur teknologjinë informative;
- harton një detyrë me tekst, apo krijon një situatë logjike nga jeta e përditshme, e cila përmban një mesazh që kërkon zgjidhje matematikore apo një problem shkencor, duke u bazuar në njohuritë paraprake dhe prezanton mënyrën/procedurën e zgjidhjes së problemit para të tjerëve;
- modelon zgjidhjen e një problemi të dhënë (në klasë, apo jashtë saj) për një temë të caktuar nga një fushë mësimore, duke e zbërthyer në hapa të vegjël dhe jep sqarime të nevojshme për hapat e ndjekur në zgjidhjen e problemit, duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit;
- llogarit me saktësi koston e buxhetit të planifikuar për një aktivitet të caktuar (p.sh.: ekskursion, përvjetor i shkollës, konkurs , program arsimor për TV etj.), e prezanton atë me gojë dhe me shkrim para klasës, duke përdorur arsyetimin matematikor;
- gjykon vërtetësinë e një rezultati të dhënë (p.sh.: rezultatin e një detyre nga matematika, shkencat, shoqëria, mjedisi etj.) i cili mund të jetë gjetur me zbatimin e formulave të njohura ose me përdorimin e procedurave të caktuara dhe nxjerr përfundime për vërtetësinë e gjykimit të dhënë;

- prezanton me sukses rezultatet e punës së një detyre eksperimentale për një temë të caktuar nga ndonjë fushë mësimore (p.sh.: nga shkencat, teknologjia etj.) të realizuar në laborator, në ambientet e shkollës apo diku tjetër, përmes përdorimit të teknologjisë informative dhe jep argumente që lidhin rezultatet e punës eksperimentale me udhëzimet teorike;
- krijon një vepër artistike me pamje dy dhe tredimensionale me mesazhe nga një fushë mësimore dhe shpjegon para moshatarëve hapat e ndjekur për krijimin e veprës;
- krijon një situatë për marrjen e një vendimi për jetën e vet ose zgjidhjen e një problemi me interes shoqëror, lidh vendimin me pasojat në mënyrë të përgjegjshme dhe e prezanton gjatë një debati me moshatarë në një kohëzgjatje të caktuar.

Kompetenca e të nxënit

Nxënësi mëson për të nxënë

Nxënësi:

- demonstroi shkathtësi funksionale në lexim, në shkrim, në matematikë, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre apo aktiviteti dhe gjatë të nxënit të dijeve të reja në ndonjë fushë të caktuar mësimore;
- shfrytëzon në mënyrë efektive përvojat paraprake gjatë zgjidhjes së situatave të ndryshme në jetën e përditshme apo gjatë kryerjes së ndonjë detyre, aktiviteti, në ndonjë fushë të caktuar mësimore. Diskuton dhe ndan përvojat me të tjerët për mënyrat më praktike të shfrytëzimit të përvojave paraprake në arritjen e dijeve të reja;
- parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuar për zgjidhjen e një problemi apo detyre të një teme të caktuar, bën përmbledhjen e së paku dy veprimeve të përdorura, të cilat përcaktojnë drejtimin e mëtejshëm të të nxënit për temën apo problemin e caktuar;
- zgjidh një problem të caktuar mësimor ose një situatë nga jeta e përditshme. Në bazë të një planifikimi të dhënë dhe në bazë të rezultatit të fituar, vërteton saktësinë e planifikimit dhe tregon me shembuj se si do të zbatojë strategjinë e ndjekur edhe në situata dhe kontekste të tjera gjatë të nxënit;

- shfrytëzon, në mënyrë të pavarur dhe efektive, teknologjinë informative dhe burime të tjera të informimit për të mbledhur materiale për zgjidhjen e një problemi apo detyre të caktuar, të cilat më pas i analizon, i klasifikon dhe i paraqet para të tjerëve përmes TIK-ut dhe ndonjë forme tjetër të shprehjes;
- paraqet idetë personale para të tjerëve për mënyrën e zhvillimit të një aktiviteti të caktuar, duke dhënë mendime të argumentuara për rezultatet e pritura (në formë skice, grafiku, vizatimi, shkrimi, vepre artistike etj.);
- shfrytëzon, në mënyrë të pavarur, udhëzimet e dhëna nga ndonjë burim informacioni për të kryer një veprim, aktivitet, detyrë, ose për të zgjidhur një problem që kërkohet prej tij. Vlerëson vetë performancën dhe rezultatin e arritur, duke iu referuar qëllimeve fillestare (p.sh.: burime të informacionit në libër, revistë, enciklopedi, internet, hartë, grafik, skicë, partiturë muzikore, skenar etj.).

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive

Nxënësi:

- përgatit, prezanton, drejton dhe merr pjesë në një fushatë të informimit të qytetarëve për një fushë apo temë të caktuar, duke u mbështetur në ide të reja, bazuar në rezultate të pritshme të përcaktuara qartë (p.sh.: fushatë informimi për mbrojtjen e mjedisit, sigurinë, shëndetin etj.);
- demonstroi shprehje organizative në punët individuale dhe në ekip përmes situatave reale në detyrat e veçanta mësimore, duke menaxhuar potencialin individual dhe atë të grupit, si dhe kohën, rreziqet dhe buxhetin në dispozicion;
- harton një projekt me faza të menaxhuara mirë (individualisht ose në grup) duke shkëmbyer, konsultuar dhe informuar të tjerët si dhe duke identifikuar dhe vlerësuar burimet njerëzore, materiale dhe monetare në përputhje me rezultatet e pritshme;
- analizon gjendjen e mjedisit (në klasë, në shkollë, në komunitet apo më gjerë), pasojat e ndotjes, propozon alternativa për mbikëqyrje

dhe menaxhim të drejtë të gjendjes së vlerësuar më të ndjeshme dhe inicion zgjidhje konkrete.

Kompetenca personale

Nxënësi bën jetë të shëndetshme

Nxënësi:

- analizon përparësitë dhe dobësitë personale, duke evidentuar masat përmes të cilave synon të mbështesë avancimin personal në përparësitë që ka dhe masat përmes të cilave synon të përmirësojë dobësitë personale;
- merr pjesë ose udhëheq një grup pune, që bashkëpunon me përfaqësues të komunitetit për të ndihmuar moshatarët dhe anëtarët e tjerë të komunitetit, të cilët kanë probleme shëndetësore, sociale, ekonomike etj.;
- bën zgjidhje të bazuara në informacione dhe në përvoja të drejta për të mbrojtur shëndetin dhe mirëqenien nga rreziqet e ndryshme në jetën e përditshme (p.sh.: nga përdorimi i duhanit, i alkoolit, i drogave, nga marrëdhëniet e hershme seksuale, nga zgjedhjet e gabuara ushqimore, nga ekspozimi i tepruar ndaj rrezeve të diellit etj.);
- vepron në jetën e përditshme në mënyrë të pavarur dhe të përgjegjshme, duke përzgjedhur mënyra të shëndetshme jetese, dieta të lejuara nga mjeku, ushtrime të koordinuara drejt, apo duke iu përgjigjur në mënyrën e duhur situatave të rrezikshme me të cilat mund të ndeshet në jetën e përditshme.

Kompetenca qytetare

Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët

Nxënësi:

- paraqet në forma të ndryshme të të shprehurit, mënyrën e funksionimit të mjedisit të vet shoqëror në nivel lokal dhe me gjerë, duke dhënë shembuj konkretë se si mund të përmirësohet funksionimi i tij, p.sh.: në strukturën organizative, në rregullat e veprimit, në publikimin e pritshmërive, në bashkëpunimin me qytetarë etj.;
- demonstroi shembuj konkretë të mbrojtjes së mjedisit natyror dhe atij të krijuar nga njeriu në aktivitete të jetës së përditshme në

<p>shtëpi, në klasë, në shkollë dhe në komunitet;</p> <ul style="list-style-type: none"> - diskuton me të tjerët apo në një formë tjetër të të shprehurit paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj., dhe jep propozime për zgjidhjen e ndonjë problemi në komunitet e më gjerë në një fushë të caktuar; - përshkruan në formë verbale ose të shkruar, mundësinë e përdorimit të internetit dhe të informacioneve në mënyrë të përgjegjshme për tema të caktuara dhe argumenton domosdoshmërinë e përdorimit të drejtë të tyre.
<p>Kompetenca digjitale</p> <p>Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin</p>
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive; - përdor mjetet digjitale për të përpunuar, krijuar, realizuar dhe demonstruar tema mësimore; - gjen, organizon, analizon, përpunon dhe përdor informacionin nga një shumëllojshmëri burimesh dhe mediash; - zhvillon aftësitë krijuese, duke zbatuar njohuritë e marra në shkencën kompjuterike dhe në mediat digjitale; - diskuton për përparësitë dhe kufizimet që vijnë nga përdorimi i teknologjive në jetën e individit, shoqërisë apo komunitetit; - tregohet më i pavarur në procesin e mësimdhënies dhe të mësimnxënies.

2. Lidhja e fushës së shkencave natyrore me temat ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare lidhen me çështje madhore me të cilat përballlet shoqëria sot. Kontributi i shkencave të natyrës është i shumanshëm për sa i takon ndikimit në shëndetin e njeriut dhe mirëqenien, mjedisin dhe ekonominë. Ka një lidhje domethënëse midis çështjeve dhe sfidave që trajtojnë temat ndërkurrikulare dhe zbulimeve e arritjeve në shkencë dhe teknologji. Fusha e shkencave të natyrës, përmes situatave të larmishmetë të nxënit, zhvillon kompetencat që lidhen me çdo temë ndërkurrikulare dhe në mënyrë të veçantë me temat: *Mjedisi; Ndërvarësia; Zhvillimi i qëndrueshëm dhe Vendimmarrja morale.*

Fusha e shkencave natyrore i ndihmon nxënësit të kuptojnë çështje të shumta që lidhen me shëndetin, mirëqenien dhe seksualitetin, si dhe i nxit ata për të bërë një jetë të shëndetshme. Nga ana tjetër, ajo i ndërgjegjëson nxënësit për përgjegjshmërinë që kanë në çështje specifike mjedisore, si: përdorimi i burimeve natyrore, ndikimi i njeriut mbi mjedisin, menaxhimi i mbeturinave, çështje etike të lidhura me bioteknologjinë, ndryshimet klimatike dhe biodiversitetin.

Përmes projekteve të ndryshme në fushën e shkencës, nxënësit mund të studiojnë ndikimin social, etik, ekonomik ose mjedisor të saj. Ata nxiten për të bërë pyetje rreth çështjeve që trajtojnë këto tema dhe sjelljes së tyre si konsumatorë të përgjegjshëm.

Zhvillimi i shkathtësive të komunikimit në gjuhën e shkencës i jep nxënësve një perspektivë të re për çështje të caktuara sociale, të cilat mund të përmirësojnë cilësinë e pjesëmarrjes së tyre në klasë, në shkollë apo shoqëri duke respektuar diversitetin.

3. Lidhja e fushës së shkencave natyrore me fushat e tjera kurrikulare

Konceptimi i programit të fushës së shkencave natyrore është mbështetur në parime të mirëfillta të integritetit si mes lëndëve të vetë fushës ashtu dhe të fushës me fushat e tjera. Për t'u siguruar nxënësve një mësim të integruar, është e rëndësishme lidhja e fushës së shkencave natyrore me fushat e tjera dhe specifikisht me lëndët e këtyre fushave. Nxënësit nuk mund ta perceptojnë realitetin dhe të njohin botën që i rrethon vetëm nëpërmjet studimit të lëndëve që i përkasin fushës së shkencave natyrore.

Fusha e shkencave natyrore është e lidhur ngushtë me *fushën e matematikës*. Matematika u siguron nxënësve njohuritë e domosdoshme për studimin e lëndëve të kësaj fushe. Për shembull, kur nxënësi kryen një kërkim shkencor, i duhet shpesh të bëjë matje, llogaritje, të gjejë mesataren aritmetike, të zotërojë koncepte të gjeometrisë së zbatuar, si dhe të vizualizojë hapësirën. Nxënësi përdor aparatit matematik për të shpjeguar ligjet e fizikës dhe për të vendosur lidhjen ndërmjet ndryshoreve, si p.sh., në fizikë, lidhja ndërmjet forcës, masës dhe nxitimit. Interpretimi i ligjeve dhe i dukurive nëpërmjet përdorimit të grafikëve, të simboleve e të formulave matematikore vërteton qartë lidhjen e shkencës së matematikës me shkencat e natyrës. Gjithashtu, duke studiuar shkencat e natyrës nxënësit zhvillojnë kompetencat matematikore të problemzgjdhjes, hetimit, arsytimit logjik, lidhjes konceptuale ndërmjet madhësive dhe modelimeve. Për të analizuar dhe për të vlerësuar rezultatet gjatë studimit të dukurive

dhe të ligjeve në shkencat natyrore, nxënësit duhet të zhvillojnë kompetencën e komunikimit dhe të përdorin drejt gjuhën dhe terminologjinë e shkencës.


Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” i ndihmon nxënësit për zhvillimin e kompetencës së komunikimit në gjuhën dhe në terminologjinë e shkencës. Nxënësi, duke lexuar, shkruar apo shprehur rrjedhshëm mendimet e tij rreth informacioneve shkencore mbi gjithësinë, lëndët, ndotësit e ajrit, ujit, zhvillon saktë kompetencën e komunikimit, që ndjeshëm zhvillohet në **fushën “Gjuhët dhe komunikimi”**.

Por edhe lëndët e shkencave të natyrës kontribuojnë në pasurimin e fjalorit të nxënësve dhe i aftësojnë ata të paraqesin qartë dhe saktë idetë e tyre, me gojë ose me shkrim. Punët praktike dhe eksperimentale, të cilat janë bazë për zhvillimin e kompetencave të kësaj fushe, u japin nxënësve mundësitë që të zhvillojnë kompetencën e komunikimit gjuhësor dhe të pasurojnë fjalorin terminologjik, përmes diskutimeve mbi përshkrimin e punëve praktike dhe laboratorike dhe shpjegimeve të rezultateve të tyre. Termat e ndryshme që përdoren në fushën e shkencave të natyrës janë specifike për fushën dhe ndihmojnë nxënësit për zhvillimin e kompetencës së komunikimit.

Studimi i shkencave lidhet me **fushën e shkencave shoqërore**, pasi nëpërmjet saj nxënësit marrin informacion mbi historinë e zhvillimit të shkencës në periudha të caktuara historike të shoqërive të ndryshme. Duke hedhur vështrimin nga e kaluara historike, ata mund të marrin përgjigje se si ka evoluar natyra dhe gjithësia. Nga ana tjetër, nxënësit vendosin dhe vlerësojnë lidhjen mes shkencave natyrore, teknologjisë dhe shoqërisë dhe përmirësojnë sjelljen për harmonizimin e marrëdhënieve të tyre me mjedisin dhe për ruajtjen e tij.

Fusha e shkencave të natyrës lidhet me **fushën e arteve**, pasi disa teknika specifike të fushës së arteve zbatohen nëse njihen mirë ligjet e fushës së shkencave. P.sh., për të kryer lëvizjet e trupit, një kërcimtar mund të arrijë performancën më të lartë, nëse njeh mirë ligjet e dinamikës dhe zbatimet e tyre. Gjithashtu, duke shfrytëzuar programet e arteve pamore, nxënësit bëhen njohës të mirë të figurave dhe trupave gjeometrikë në hapësirë dhe plan.

TIK-u mbështet hetimin e proceseve në fushën e shkencave dhe lehtëson bashkëpunimin dhe komunikimin e nxënësve me bashkëmoshatarët gjatë procesit të të nxënësve, duke përfshirë edhe të nxënësve në distancë. Për shembull, nëpërmjet përdorimit të TIK-ut nxënësi diskuton dhe ndan idetë me të tjerët, por ka mundësi të konsultohet edhe me ekspertë të fushës, kur e ka të nevojshme. Nxënësi përdor sistemet e duhura kompjuterike për



ndërtimin e tabelave, grafikëve, diagrameve, vizatimin e një plani, përgatitjen e prezantimeve të detyrave praktike dhe projekteve kurrikulare, duke zbatuar në mënyrë krijuese njohuritë që përmbajnë shkencat kompjuterike dhe mediat digjitale.

Diagrami 2. Lidhja e kompetencave të fushës së shkencave natyrore me kompetencat e fushave të tjera



II. TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT

○ TEMATIKAT	Shkalla V
<ul style="list-style-type: none"> ▪ DIVERSITETI 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ KIMIA ▪ Natyra e lëndës ▪ Struktura e atomit ▪ Lidhjet kimike ▪ Sistemi periodik ▪ Identifikimi i joneve dhe gazeve ▪ Kimia organike ▪ Seritë homologe të alkaneve, alkeneve, alkooleve dhe acideve karboksilike
<ul style="list-style-type: none"> ▪ NDËRVEPRIMET 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ KIMIA ▪ Simbolet kimike, formulat dhe barazimet kimike ▪ Stekiometria ▪ Përqendrimi i tretësirave ▪ Acidet, bazat dhe kripërat ▪ Radha e aktivitetit të metaleve ▪ Reaksionet redoks ▪ Elektroliza e përbërjeve jonike në gjendje të shkrirë dhe tretësirë ujore ▪ Kinetika kimike ▪ Reaksionet e thjeshta të alkaneve, alkeneve dhe alkooleve

SHËNIM: Zbatuesit e programit janë të lirë t'i kombinojnë dhe t'i rendisin njohuritë dhe rezultatet e të nxënit brenda tematikës dhe ndërmjet tematikave, sipas planifikimit të tyre. E rëndësishme është që të mundësohet arritja e të gjithë rezultateve të të nxënit nga nxënësit.

III. REZULTATET E TË NXËNIT TË KOMPETENCAVE SIPAS TEMATIKAVE

SHKALLA V

KLASA X

LËNDA: KIMI

36 javë x 2 orë në javë= 72 orë

TEMATIKA: DIVERSITETI

Përshkrimi i tematikës:

Kjo tematikë nënvizon rëndësinë e ruajtjes së shumëllojshmërisë në natyrë. Për të kuptuar më mirë botën, në të cilën jeton, njeriu përpiqet të organizojë botën e gjallë dhe botën jo të gjallë. Ka disa tipare të përbashkëta që lidhin të gjitha qeniet e gjalla dhe faktorë unikë në botën jo të gjallë që e ndihmojnë njeriun t'i klasifikojë ato. Ruajtja e shumëllojshmërisë siguron mbijetesën dhe vazhdimësinë e jetës. Në fokus të kësaj tematike në këto shkallë është diversiteti i kafshëve, bimëve, mikroorganizmave, mjedisit natyror, lëndëve dhe vetive e karakteristikave të tyre

Rezultatet e të nxënit

Diversiteti i lëndëve

Njohuritë dhe konceptet	Aftësitë dhe proceset	Qëndrimet dhe vlerat
Natyra e lëndës	Nxënësi:	Nxënësi:

<ul style="list-style-type: none"> ● Gjendjet e lëndës ● Ndryshimet e gjendjes së lëndës ● Pastërtia e substancave dhe ndarja e tyre nga përzierjet ● Proceset e filtrimit, kristalizimit, distilimit të thjeshtë dhe distilimit të thyesuar ● Kromatografia ● Teknika për përfitim e substancave të pastra 	<ul style="list-style-type: none"> ● përshkruan vetitë dalluese të të ngurtave, të lëngjeve dhe të gazeve; ● përshkruan strukturën e të ngurtave, të lëngjeve dhe të gazeve, bazuar në ndarjen e grimcave, strukturën e tyre dhe llojet e lëvizjes; ● përshkruan ndryshimet e gjendjes, bazuar në dukuritë e shkrirjes, vlimit, avullimit, ngrirjes, kondensimit dhe sublimimit; ● <u>përshkruan</u> trysninë dhe temperaturën e një gazi sipas lëvizjes së grimcave të tij; ● <u>shpjegon</u> ndryshimet e gjendjes, bazuar në teorinë kinetike; ● <u>tregon</u> kuptimin e lëvizjes së çrregullt të grimcave (atome, molekula apo jone në një pezulli, të njohur si lëvizje browniane, si provë për modelin kinetik grimcor të lëndës; ● <u>përshkruan</u> dhe <u>shpjegon</u> difuzionin; ● <u>përshkruan</u> dhe <u>shpjegon</u> varësinë e shpejtësisë së difuzionit nga masa molekulare; 	<ul style="list-style-type: none"> ● <u>tregon</u> interes për të mbledhur të dhëna mbi lëvizjen browniane bazuar në goditjet e rastësishme midis molekulave; ● është <u>i përgjegjshëm</u> gjatë zbatimit në kushte laboratorike të proceseve të filtrimit, kristalizimit dhe distilimit për përfitim e substancave të pastra; ● <u>tregon</u> interes: për të mbledhur informacione; për rëndësinë praktike jo vetëm të kromatografisë; për të dalluar substancat e pastra nga ato të papastra, por edhe të teknikave të tjera.
---	--	--

	<ul style="list-style-type: none"> • <u>shpjegon</u> kuptimin e konceptit “Substancë e pastër”, dallimet ndërmjet përdorimit të përditshëm dhe atij shkencor të termit “Pastërti”; • <u>shpjegon</u> që shumë materiale të dobishme formohen nga përzierjet; • <u>përshkruan</u> , <u>shpjegon</u> dhe jep shembuj për proceset e filtrimit, kristalizimit, distilimit të thjeshtë dhe distilimit të thyesuar; • <u>tregon</u> se kromatografia përfshin një fazë të palëvizshme dhe një fazë të lëvizshme dhe se ndarja varet nga shpërndarja ndërmjet dy fazave; • <u>interpretion</u> kromatografinë; • <u>sugjeron</u> teknika të përshtatshme të pastrimit të substancave të caktuara; • <u>përdor</u> të dhëna të pikës së vlimit për të dalluar substancat e pastra nga ato të papastra; • <u>sugjeron</u> metodat kromatografike për të dalluar substancat e pastra nga substancat e papastra. 	
<p>Struktura e atomit</p> <ul style="list-style-type: none"> • Modeli i atomit • Masa atomike relative 	<p>Nxënësi :</p>	<p>Nxënësi :</p>

<ul style="list-style-type: none"> • Mbështjella elektronike • Izotopet • Tabela periodike 	<ul style="list-style-type: none"> • <u>përshkruan</u> atomin si një grimcë me bërthamën e ngarkuar pozitivisht e rrethuar nga elektronet e ngarkuara negativisht, me rreze bërthamore shumë më të vogël se ajo e atomit dhe me shumicën e masës në bërthamë; • <u>tregon</u> përmasat tipike të atomeve dhe të molekulave të vogla; • <u>përshkruan</u> zhvillimin e modelit të atomit në kohë të ndryshme; • <u>përcakton</u> ngarkesën relative dhe masën relative të protoneve, neutroneve dhe elektroneve; • <u>njehson</u> numrin e protoneve, neutroneve dhe elektroneve në atomet dhe jonet, kur jepet numri atomik dhe numri i masës së izotopeve; • <u>dallon</u> atomin dhe jonin e një elementi, duke bërë bilancin e protoneve dhe elektroneve; • <u>tregon</u> se izotopet e atomeve të të njëjtit element kanë të njëjtë numrin e protoneve, por të ndryshëm numrin e masës; 	<ul style="list-style-type: none"> • <u>tregon</u> interes të mbledhë të dhëna mbi modelet e ndryshme atomike; • <u>tregon dhe vlerëson</u> qëndrimet shkencore, siç janë kreativiteti dhe mendja e hapur në krijimin e modeleve për të shpjeguar natyrën themelore të gjërave dhe gatishmërinë për të rishqyrtuar modelet ekzistuese; • <u>tregon</u> interes të mbledhë të dhëna mbi përdorimin e mjekësor dhe industrial të izotopeve radioaktive si p.sh., përdorimet e karbonit-14 në arkeologji
---	--	--

	<ul style="list-style-type: none"> • <u>kupton</u> se izotopet kanë veti të njëjta sepse kanë të njëjtin numrin e elektroneve në shtresën e jashtme të tyre; • <u>përshkruan</u> tabelën periodike si një sistem për të klasifikuar elementet dhe për të parashikuar përdorimin dhe vetitë e tyre; • <u>shpjegon</u> se vendndodhja e një elementi në tabelën periodike përcaktohet nga shpërndarja e elektroneve në atomet e tij dhe nga numri i tij atomik; • <u>shpjegon</u> sipas izotopeve si ndryshon rregulli të propozuar nga Mendelejevi; • <u>përdor</u> emrat dhe simbolet e 20 elementeve të para, grupet I^A, VII^A dhe VIII^A, si dhe disa elemente të tjera të zakonshme nga Tabela Periodike për shkrimin e formulave dhe balancimin e barazimeve kimike; • <u>shpjegon</u> se reaktiviteti i elementeve është i lidhur me shpërndarjen e elektroneve në atomet e tyre dhe numrin atomik përkatës; 	
--	--	--

	<ul style="list-style-type: none"> • <u>analizon</u> mbi bazën e strukturës atomike, periodat dhe grupet A dhe B në tabelën periodike; • <u>komenton</u> grafikë të ndryshimit të rrezes atomike, potencialit të jonizimit, afërsisë për elektronin, elektronegativitetit në tabelën periodike; • <u>argumenton</u> lidhjet ndërmjet rrezes atomike, potencialit të jonizimit, afërsisë për elektronin dhe elektronegativitetit. 	
<p>Lidhjet kimike</p> <ul style="list-style-type: none"> • Lidhja jonike • Lidhja kovalente 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>përshkruan</u> dhe <u>krahason</u> natyrën dhe formimin e lidhjeve kimike në: komponimet jonike, molekulat e thjeshta, strukturat kovalente me përmasa të mëdha; • <u>shpjegon</u> lidhjet kimike, bazuar në forcat elektrostatike dhe formimin e çifteve të përbashkëta elektronike; • <u>përshkruan</u> formimin e lidhjes jonike midis metaleve dhe jometaleve; • <u>përshkruan</u> strukturën kristalore të përbërjeve jonike si një vendosje të rregullt të alternimit të joneve pozitive dhe negative; 	<p>Nxënësi :</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>demonstron bashkëpunim</u> dhe <u>qëndrim etik</u> gjatë punës në grup dhe diskutimeve; • <u>realizon</u> modelime dhe simulime përmes kompjuterit, për tipa të lidhjeve kimike dhe të formave të molekulave për shembuj të ndryshëm substancash.

	<ul style="list-style-type: none"> • ndërton diagrame të substancave të thjeshta me lidhje jonike dhe me lidhje kovalente; • <u>përshkruan</u> kufizimet e modeleve grafike të lidhjeve kimike; • <u>shpjegon</u> se vetitë e një numri të madh të lëndëve kimike përcaktohen nga lloji i lidhjes kimike që ato përmbajnë; fortësia e lidhjeve të tyre nga forcat ndërmolekulare dhe mënyra e formimit të lidhjeve kimike, duke identifikuar që vetë atomet nuk shfaqin këto veti; • <u>shpjegon</u> dallimet në pikën e shkrirjes dhe pikën e vlimit në përbërjet jonike dhe kovalente, bazuar në forcat tërheqëse. 	
<p>Sistemi periodik</p> <ul style="list-style-type: none"> • Metalet dhe jometalet • Grupi I^A • Grupi VII^A • Grupi VIII^A • Metalet kalimtare 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>përshkruan</u> tabelën periodike si një sistem për të klasifikuar elementet, si dhe përdorimin e saj për të parashikuar vetitë e tyre; • <u>përshkruan</u> metalet dhe jometalet dhe <u>shpjegon</u> dallimet midis tyre në bazë të vetive fizike dhe kimike të tyre; 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>diskuton</u> të dhëna të grumbulluara nga burime të ndryshme informacioni, mbi përdorimin e gazeve të plogët si p.sh., argoni në llamba dhe heliumi në mbushjen e balonave;

	<ul style="list-style-type: none"> • <u>përshkruan</u> vetitë kimike të metaleve si p.sh., bashkëveprimin e tyre me acidet e holluara dhe me oksigjenin; • <u>shpjegon</u> se pozicioni i metaleve dhe jometaleve në tabelën periodike përcakton strukturën elektronike të atomeve të tyre dhe numrin atomik; • <u>parashikon</u> vetitë e elementeve të grupeve I^A, VII^A, VIII^A; • <u>përshkruan</u> gazet e plogët si elemente të grupit VIII^A, gaze monoatomike jo reaktive dhe <u>shpjegon</u> këtë në bazë të strukturës së tyre elektronike; • <u>shpjegon</u> se si vetitë e elementeve të grupeve I^A, VII^A, VIII^A përcaktohen nga shtresa e jashtme elektronike e atomeve të tyre dhe <u>parashikon</u> si ndryshojnë vetitë e elementeve brenda grupeve nga lart poshtë; • <u>parashikon</u> reaksionet e mundshme dhe reaktivitetin e mundshëm të elementeve nga pozicioni i tyre në tabelën periodike; 	<ul style="list-style-type: none"> • <u>grumbullon</u> nga burime të ndryshme informacioni, të dhëna për vetitë e elementeve kimike të një grupi të tabelës periodike.
--	--	---

	<ul style="list-style-type: none"> • <u>përshkruan</u> vetitë e përgjithshme të metaleve kalimtare, pikën e shkrirjes, dendësinë, reaktivitetin, formimin e joneve me ngarkesa të ndryshme dhe përdorimin si katalizatorë, si dhe i <u>ilustron me shembuj</u> duke iu referuar disa prej përfaqësuesve të metaleve kalimtare. 	
<p>Identifikimi i joneve dhe gazeve</p> <ul style="list-style-type: none"> • Identifikimi i joneve nëpërmjet testeve kimike dhe spektroskopike • Identifikimi i gazeve 	<p>Nxënësi :</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>përshkruan</u> testet kimike që identifikojnë kationet dhe anionet në tretësira ujore; • <u>identifikon</u> llojet e kationeve dhe anioneve, bazuar në rezultatet e testeve; • <u>interpret</u> testet e flakës që përdoren për të identifikuar jonet e metaleve, duke përfshirë jonet e litiumit, natriumit, kaliumit, kalciumit dhe bakrit; • <u>përshkruan</u> avantazhet dhe disavantazhet e metodave analitike: ndikimi, saktësia dhe shpejtësia; • <u>interpret</u> rezultatet e një testi analitik të dhënë në formë tabelare ose grafike; 	<p>Nxënësi :</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>demonstron bashkëpunim</u> dhe <u>qëndrim etik</u> gjatë punës në grup dhe diskutimeve; • <u>tregon kujdes</u> duke zbatuar rregullat e sigurisë gjatë punës me pajisjet dhe substancat kimike.

	<ul style="list-style-type: none"> ● <u>përshkruan</u> testet kimike që përdoren për identifikimin e gazeve oksigjen, hidrogjen, dioksid karboni dhe klor. 	
<p>Kimia organike</p> <p>Seritë homologe të alkaneve, alkeneve, alkooleve dhe acideve karboksilike</p> <ul style="list-style-type: none"> - Alkane - Alkene - Alkoole - Acide karboksilike 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● <u>identifikon</u> grupet funksionore dhe përfaqësuesit e serive homologe; ● <u>emërton</u> dhe <u>shkruan</u> formulat e strukturës për katër përfaqësuesit e parë të serisë homologe të alkaneve, alkeneve, alkooleve dhe acideve karboksilike; ● <u>përshkruan</u> konceptin e serisë homologe si një familje e përbërjeve të ngjashme me veti kimike, të ngjashme në sajë të përmbajtjes së të njëjtit grup funksionor; ● <u>përshkruan</u> karakteristikat e përgjithshme të serisë homologe; ● <u>tregon</u> se përbërjet në serinë homologe kanë të njëjtën formulë të përgjithshme; ● <u>përshkruan</u> dhe <u>identifikon</u> izomerinë strukturore. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● <u>demonstron bashkëpunim</u> dhe <u>qëndrim etik</u> gjatë punës në grup dhe gjatë diskutimeve.

TEMATIKA: NDËRVEPRIMET

<p>Përshkrimi i tematikës: Ndërveprimet</p> <p>Studimi i ndërveprimit midis dhe brenda sistemeve zhvillon të kuptuarit e mjedisit dhe të rolit të njeriut në të. Ndërveprimet ndodhin brenda një organizmi, midis organizmave, si dhe midis organizmave dhe mjedisit. Ndërveprimi i njeriut me mjedisin drejton zhvillimin e shkencës dhe të teknologjisë. Në të njëjtën kohë shkenca dhe teknologjia ndikojnë në mënyrën se si njeriu ndërvepron me mjedisin. Të kuptuarit e këtij ndërveprimi ndihmon nxënësin të kuptojë më mirë pasojat pozitive dhe negative të veprimeve të tij dhe të jetë përgjegjës për to.</p> <p>Tema përqendrohet te ndërveprimi brenda dhe ndërmjet bimëve, kafshëve, njeriut dhe mjedisit, mikroorganizmave, atmosferës, sistemit diellor dhe Tokës, forcave, shkencës dhe teknologjisë.</p>		
<p>Rezultatet e të nxënit – Kimi</p> <p>Reaksionet kimike</p>		
<p>Njohuritë dhe konceptet</p>	<p>Aftësitë dhe proceset</p>	<p>Qëndrimet dhe vlerat</p>
<p>Simbolet, formulat dhe barazimet kimike</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Simbolet kimike ● Formulat kimike ● Barazimet kimike 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● <u>përdor</u> simbolet kimike për të shkruar formulat e elementeve dhe komponimeve të thjeshta jonike dhe kovalente; ● <u>nxjerr</u> formulën empirike të një komponimi nga numrat relative të atomeve të pranishëm ose nga një model ose nga një diagram dhe anasjelltas; 	<p>Nxënësi :</p> <ul style="list-style-type: none"> ● <u>demonstron bashkëpunim</u> dhe <u>qëndrim etik</u> gjatë punës në grup dhe gjatë diskutimeve.

	<ul style="list-style-type: none"> • <u>përdor</u> emrat dhe simbolet e elementeve dhe komponimeve të thjeshta, si dhe parimin e ruajtjes së masës për shkrimin e formulave dhe barazimin e reaksioneve dhe gjysmëreaksioneve kimike; • <u>përdor</u> formulat e joneve të thjeshta për të nxjerrë formulën e një komponimi dhe barazon reaksionet jonike. 	
<p>Stekiometria</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ligji i ruajtjes së masës dhe interpretimi sasior i barazimeve kimike • Moli. Vëllimi molar i gazeve • Njehsime stekiometrike në lidhje me molin, masën, reaktantin kufizues, vëllimin e gazeve 	<p>Nxënësi :</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>tregon</u> dhe përdor ligjin e ruajtjes së masës; • <u>shpjegon</u> shembuj të ndryshimeve të vëzhguara në masë, në sisteme të hapura gjatë një reaksioni kimik dhe i <u>sqaron</u> ato duke përdorur modelin e grimcave; • <u>llogarit</u> masat e substancave të veçanta, mbështetur në barazimet e reaksioneve kimike; • <u>tregon</u> dhe <u>përdor</u> numrin e Avogadros dhe përkufizimin e molit; • <u>shpjegon</u> si masa e një substance të dhënë është e lidhur me numrin e moleve të saj dhe e anasjellta; 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>demonstron bashkëpunim</u> dhe <u>qëndrim etik</u> gjatë punës në grup dhe gjatë diskutimeve.

	<ul style="list-style-type: none"> • <u>argumenton</u> stekiometrinë e një barazimi, lidhur me masat e reaktantëve dhe të produkteve dhe <u>shpjegon</u> ndikimin e reaktantit kufizues të reaksionit; • <u>përdor</u> barazimet kimike për të llogaritur masat e reaktantëve dhe të produkteve; • <u>shpjegon</u> si masa e substancës së tretur dhe vëllimi i tretësit janë të lidhura me përqendrimin e tretësirës; • <u>përshkruan</u> lidhjen midis masës molare të gazeve dhe vëllimit të tyre dhe anasjelltas, si dhe njehson vëllimet e gazeve që marrin pjesë në reaksione, duke përdorur vëllimin molar të gazit në kushte normale temperature dhe trysnie (22.4 litër/mol). 	
<p>Përqendrimi i tretësirave</p>	<p>Nxënësi :</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>përshkruan</u> si përqendrimi i një tretësire në mol/litër është i lidhur me masën e substancës së tretur dhe vëllimin e tretësirës; • <u>përshkruan</u> lidhjen ndërmjet vëllimit të tretësirës së një substance me përqendrim të njohur dhe 	<p>Nxënësi :</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>demonstron bashkëpunim dhe qëndrim etik</u> gjatë punës në grup dhe gjatë diskutimeve.

	vëllimit të tretësirës së një substance tjetër që bashkëveprojnë plotësisht me njëra-tjetrën.	
Acidet, bazat dhe kripërat	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● <u>shpjegon</u> se acidet veprojnë me disa metale dhe me karbonatet dhe parashikon produktet e barazimeve kimike, duke u nisur reaktantët e dhënë; ● <u>identifikon</u> se acidet formojnë jonet hidrogjen kur ata treten në ujë dhe tretësirat e bazave përmbajnë jone hidroksid; ● <u>tregon</u> që pH përdoret për të matur aciditetin dhe alkalinitetin relativ; ● <u>përshkruan</u> asnjësimin si bashkëveprim të acideve me baza për të formuar kripë dhe ujë; ● <u>argumenton</u> se asnjësimi mund të përgjithësohet si bashkëveprim i joneve hidrogjen me jonet hidroksid për të formuar ujin; ● <u>përdor</u> dhe <u>shpjegon</u> termat “i holluar” dhe “i përqendruar” që kanë të bëjnë me sasi të substancave, si dhe “i dobët” dhe “i fortë” që 	<p>Nxënësi :</p> <ul style="list-style-type: none"> ● <u>tregon</u> interes për të mbledhur informacione për mbi ndikimin e ndryshimeve të pH;; a) në shëndetin e njeriut si: ndryshimi i pH në gjak, në lëngjet e stomakut etj.; b) në rëndësinë e kontrollit të aciditetit në tokë.

	<p>kanë të bëjnë me shkallën e jonizimit të acideve;</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>tregon</u> se përqendrimi i joneve hidrogjen rritet 10 herë, vlera e pH në një tretësirë ulet 1 herë; • <u>përshkruan</u> neutralitetin, aciditetin dhe alkalinitetin si pasojë e përqendrimit të joneve hidrogjen në vlerën numerike të pH. 	
Radha e aktivitetit të metaleve	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>argumenton</u> si veprimi i metaleve me ujë ose acide të holluara shpjegohet me tendencën e metaleve për të formuar jonet e tyre pozitive; • <u>rendit</u> sipas rritjes së aktivitetit elementet: kalium, natrium, kalcium, magnez, zink, hekur, hidrogjen dhe bakër, bazuar në reaksionet me: <ul style="list-style-type: none"> - ujin; - acidin klorhidrik të holluar; - reduktimin e oksideve të tyre me karbonin; • <u>nxjerr</u> përfundime mbi radhën e aktivitetit të metaleve bazuar në rezultatet eksperimentale. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>demonstron bashkëpunim</u> dhe <u>qëndrim etik</u> gjatë punës në grup dhe gjatë diskutimeve; • <u>tregon kujdes</u> duke zbatuar rregullat e sigurisë gjatë punës me pajisjet dhe me substancat kimike.
Reaksionet redoks	<p>Nxënësi :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Numri i oksidimit 	<p>Nxënësi :</p>

<ul style="list-style-type: none"> • Reaksionet e oksido-reduktimit 	<ul style="list-style-type: none"> • <u>përkufizon</u> oksidimin dhe reduktimin, bazuar në dhënien ose marrjen e oksigjenit; • identifikon substancën që oksidohet dhe atë që reduktohet; • <u>përcakton</u> oksidimin dhe reduktimin bazuar në dhënien ose marrjen e elektroneve; • <u>identifikon</u> agjentët oksidues dhe reduktues në një reaksion redoks. 	<ul style="list-style-type: none"> • <u>tregon</u> interes për të mbledhur informacione mbi agjentët oksidues si p.sh., përdorimi i bikromatit të kaliumit për të provuar sasinë e alkoolit te shoferët etj.
<p>Elektroliza e përbërjeve jonike në gjendje të shkrirë dhe tretësirë ujore</p>	<p>Nxënësi :</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>shpjegon</u> elektrolizën si ndarje të një përbërjeje jonike, të shkrirë ose tretësirë ujore gjatë kalimit të rrymës elektrike; • <u>përshkruan</u> elektrolizën me anë të joneve të pranishëm në tretësirat ujore dhe reaksioneve në elektroda; • <u>tregon</u> që metalet ose hidrogjeni formohen në katodë dhe jometalet formohen në anodë gjatë elektrolizës duke përdorur elektroda inerte; • <u>përcakton</u> produktet e elektrolizës në përbërjet dyjare jonike në gjendje të shkrirë; 	<p>Nxënësi :</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>demonstron bashkëpunim</u> dhe <u>qëndrim etik</u> gjatë punës në grup dhe gjatë diskutimeve.

	<ul style="list-style-type: none"> ● <u>përshkruan</u> rregullat e shkarkimit të joneve të ngjashme në elektroda në elektrolizën e tretësirave ujore; ● <u>përshkruan</u> veshjen e metaleve dhe përdorimet veshjes elektrolitike. 	
<p>Kinetika kimike</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Shpejtësia e reaksionit kimik ● Faktorët kryesorë që ndikojnë në shpejtësinë e reaksioneve kimike ● Katalizatorët 	<p>Nxënësi :</p> <ul style="list-style-type: none"> ● <u>sugjeron</u> metoda praktike për përcaktimin e shpejtësisë së një reaksioni kimik; ● <u>interpret</u> shpejtësinë e një reaksioni kimik, bazuar në diagrame dhe grafikë; ● <u>përshkruan</u> ndikimin e temperaturës, përqendrimit dhe trysnisë, si dhe të sipërfaqes së substancave në shpejtësinë e një reaksioni kimik; ● <u>shpjegon</u> ndikimin e shpejtësisë dhe të energjisë së ndeshjeve ndërmjet grimcave të substancave në shpejtësinë e reaksionit kimik; ● <u>shpjegon</u> ndikimin e përmasës së grimcave të një reaktanti të ngurtë në raport me vëllimin në shpejtësinë e një reaksioni kimik; ● <u>përshkruan</u> karakteristikat e katalizatorëve dhe ndikimin e tyre në shpejtësinë e reaksionit kimik; 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● <u>demonstron bashkëpunim</u> dhe <u>qëndrim etik</u> gjatë punës në grup dhe gjatë diskutimeve; ● <u>tregon</u> interes për të mbledhur informacione për rolin e enzimave si katalizatorë biologjikë dhe rolin e katalizatorit në shpejtësinë e proceseve kimike industriale.

	<ul style="list-style-type: none"> • <u>identifikon</u> katalizatorët në reaksione kimike dhe <u>shpjegon</u> veprimin katalitik bazuar në energjinë e aktivizimit; • <u>përcakton</u> enzimën si katalizatorë në sistemet biologjike. 	
<p>Reaksionet e thjeshta të alkaneve, alkeneve dhe alkooleve</p> <ul style="list-style-type: none"> • Reaksion djegieje • Reaksion adicioni • Reaksion oksidimi 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>parashikon</u> formulën dhe strukturën e produkteve të reaksioneve: <ul style="list-style-type: none"> - të djegies; - të adicionit, - të oksidimit për katër përfaqësuesit e parë të serisë homologe të alkaneve, alkeneve, alkooleve dhe përfaqësues të tjerë; • <u>identifikon</u> që grupet funksionore përcaktojnë reaksionet e komponimeve organike. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>demonstron bashkëpunim</u> dhe <u>qëndrim etik</u> gjatë punës në grup dhe gjatë diskutimeve.

IV. UDHËZIME METODOLOGJIKE

Metodat, teknikat, strategjitë e të nxënit në fushën e shkencave të natyrës janë faktorë të rëndësishëm për një nxënie të suksesshme që nxit interesin, gjithëpërfshirjen, ndërveprimin dhe punën kërkimore të nxënësve. Përzgjedhja dhe përdorimi i tyre nga mësuesit luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e kompetencave të nxënësve, duke respektuar stilet e ndryshme të të nxënit të tyre. Në fushën e shkencave të natyrës, kërkimi shkencor

është baza e kompetencave që zhvillon kjo fushë. Metodat që mund të përdorin lëndët e kësaj fushe përfshijnë: modelimin, vëzhgimin, metodat eksperimentale dhe empirike, formimin e një ideje dhe përdorimin e TIK-ut. Këto metoda nuk mund të përdoren pa u kombinuar me njëra-tjetrën.

Modelimi

Modelimi nënkupton ndërtimin e një situatë abstrakte që është e vështirë për t'u vëzhguar ose e pamundur për t'u parë. Ky modelim paraqitet nëpërmjet një teksti, vizatimi, formule matematikore, ekuacioni kimik apo në formën e një softwar-i programi. Është me shumë rëndësi të kuptohet situata në të cilën është krijuar modelimi. Përveç të tjerave, modelimi duhet t'i ndihmojë nxënësit të kuptojnë realitetin, të shpjegojnë karakteristikat e këtij realiteti dhe të parashikojnë një dukuri.

Metoda e vëzhgimit

Metoda e vëzhgimit është një metodë që i ndihmon nxënësit në formimin e koncepteve shkencore. Nëpërmjet kësaj metode nxënësit bëjnë lidhjen ndërmjet koncepteve abstrakte dhe objekteve, organizmave apo dukurive të botës reale. Kur vëzhgojnë objekte, organizma apo dukuri, nxënësit përdorin njohuritë shkencore. Vëzhgimet i ndihmojnë ata për të krijuar përfytyrime të qëndrueshme për botën që na rrethon. Vëzhgimet në natyrë i nxisin nxënësit të punojnë në mënyrë shkencore, të ngrenë hipoteza dhe t'i testojnë ato. Vëzhgimi është hapi i parë i një hetimi, eksperimenti apo studimi.

Metoda eksperimentale

Metoda eksperimentale fillon me shpjegime teorike shkencore dhe vazhdon me demonstrimin e eksperimentit. Qëllimi i procedurës është të identifikojë dhe të krahasojë elementet e vëzhgueshëm sasiorë dhe të kontrollojë vërtetësinë e hipotezave të ngritura. Gjatë përdorimit të kësaj metode, nxënësit përdorin një sërë aparaturash për të bërë matje, si dhe tregojnë kujdes gjatë përdorimit të tyre.

Metoda empirike

Metoda empirike bazohet në modelet intuitive dhe siguron një mënyrë për të eksploruar elementet e një problemi. Kjo metodë udhëheq ide, hipoteza, teori dhe teknika të reja për një studim kërkimor më të detajuar.

Hetimi

Nxënësit angazhohen në veprimtari, përmes të cilave kuptojnë se si shkencëtarët mendojnë, çfarë bëjnë në një proces vendimmarrjeje, si ngrënë pyetje dhe si planifikojnë hetimin. Përmes të nxënit kërkues, nxënësit aftësohen të përftojnë njohuri dhe të krijojnë një botëkuptim për botën natyrore dhe fizike bazuar në hetimin shkencor. Gjithashtu, nxënësit zbatojnë aftësitë dhe proceset kërkuese, si dhe zhvillojnë qëndrimet dhe vlerat që janë themelore për praktikën e shkencës.

Projektet

Projektet janë veprimtari të nxëni nëpërmjet të cilave nxënësit zbulojnë objektet, proceset apo dukuritë.

Teknologjia e informacionit dhe e komunikimit

Teknologjia e informacionit dhe e komunikimit mbështet procesin kërkues, rrit cilësinë e të nxënit të nxënësve dhe siguron bashkëpunimin mes tyre. Përmes përdorimit të mjeteve digjitale, nxënësit mund të eksplorojnë dhe të perceptojnë konceptet abstrakte, si dhe të zbulojnë marrëdhëniet ndërmjet objekteve dhe dukurive.

STRATEGJITË

Strategjitë e përdorura në shkencë dhe në teknologji mund t'i ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë tri kompetencat e programit. Më poshtë, po listojmë disa prej tyre:

- Identifikimi i elementeve të rëndësishme që lidhen me problemzgjdhjen.
- Ndarja e një problemi kompleks në disa probleme më të thjeshta.

- Përdorimi i arsytimeve (p.sh.: arsyetimi induktiv dhe deduktiv, krahasimi, klasifikimi, etj.).

QËNDRIMET

Qëndrimet janë një faktor i rëndësishëm në zhvillimin e kompetencave.

Disa nga qëndrimet intelektuale janë:

- Kurioziteti;
- Ndjenja e iniciativës;
- Prirja për të ndërmarrë risk intelektual;
- Interesi për prezantimin e ideve të ndryshme;
- Ndjenja e përgjegjësisë për zgjidhje origjinale;
- Ndjenja e gatishmërisë dhe e solidaritetit gjatë punës në grup;
- Kujdesi për shëndetin dhe për sigurinë;
- Objektiviteti;
- Përdorimi i qasjeve të duhura metodike;
- Përdorimi i saktë i gjuhës sipas terminologjive shkencore.

Teknikat janë:

- Përdorimi i instrumenteve matëse;
- Siguria ndaj pajisjeve dhe materialeve laboratorike.

Përdorimi i gjuhës dhe i terminologjisë shkencore

Të lexuarit dhe të shkruarit në shkencë ndihmon nxënësit për ta kuptuar shkencën dhe jo thjesht për të mbajtur mend faktet dhe për t'i riprodhuar ato.

Të lexuarit shkencor ndihmon në shprehjen e ideve dhe të koncepteve, nxit diskutimin, analizën dhe vlerësimin. Leximi i shumëllojshmërisë së materialeve në lidhje me atë çka mësohet në shkollë, i bën nxënësit të mendojnë se informacioni nuk vjen vetëm nga teksti shkollor por edhe nga burime të tjera. Një burim i rëndësishëm duhet të konsiderohet edhe ai i materialeve të shkruara nga shokët.

Gjatë vëzhgimeve të qenieve të gjalla, të dukurive ose gjatë konsultimeve me fotografi, harta, postera e burime të tjera informacioni, nxënësit duhet të nxitin të mbajnë shënime. Në këtë mënyrë, ata do të thellohen e do të kuptojnë më mirë objektin ose dukurinë që vëzhgojnë.

Kërkesa për mbajtjen e shënimeve dhe paraqitjen e gjetjeve gjatë vëzhgimeve dhe eksperimenteve ndihmon pozitivisht në përpunimin e të dhënave dhe përvetësimin e njohurive. Për shënimet dhe paraqitjen e përfundimeve nga nxënësit, mund të parashikohen forma të tilla pune, si: shkrimi i një raporti të shkurtër, përgatitja e një informacioni gojor, realizimi i një vizatimi, tabelle, grafiku etj.

Në shkrimin e relacioneve ose në paraqitjen e informacioneve gojore etj., është mirë që gjithnjë të kërkohet nga nxënësit që të analizojnë, të krahasojnë dhe të përgjithësojnë të dhënat, në mënyrë që të nxitet të kuptuarit e dukurisë ose të objektit të vëzhguar.

Leximi dhe shkrimi rreth asaj çka nxënësit shohin, mendojnë dhe lexojnë duhet të bëhet pjesë e përditshme e regjimit të tyre.

Siguria

Mësuesit janë përgjegjës për sigurinë e nxënësve gjatë veprimtarive në klasë, për nxitjen dhe motivimin e tyre, për rregullat dhe përgjegjësitë e sigurisë. Ata duhet të planifikojnë gjithmonë veprimtari praktike të sigurta dhe t'u tregojnë nxënësve kushtet e sigurisë në përputhje me ato të bordit të shkollës dhe të politikave të Ministrisë së Arsimit dhe të Sportit.

Gjatë veprimtarive në fushën e shkencës, nxënësit: zbatojnë, gjithmonë dhe në mënyrë të ndërjegjshme, rregullat e sigurisë në shkollë, klasë dhe jashtë tyre; identifikojnë paraprakisht kushtet në të cilat veprimtaria mund të mos jetë e sigurt dhe tregojnë se si mund të parandalohen aksidentet

në të gjitha rastet e mundshme; përdorin pajisjet, kimikatet dhe mjetet sipas udhëzimeve; tregojnë vazhdimisht shqetësim për sigurinë e tyre dhe të të tjerëve.

1.1.1.1 Nxënësit me nevoja të veçanta

Organizimi i kurrikulës sipas kompetencave (në fusha të nxëni, në shkallë) dhe me fokus integrimin, i krijon mësuesit hapësirat për të përshtatur mësimdhënien sipas nevojave të veçanta të nxënësve dhe për të personalizuar të nxënit e tyre. Mësuesi duhet të marrë parasysh faktin se nxënësit janë të ndryshëm, kanë motivim, interesa, stile të nxëni, nevoja dhe aftësi të ndryshme etj. Në disa raste, duhen bërë përshtatje të kurrikulës sipas diferencave të zhvillimit brenda një grupi moshor. Mësuesi mund të zgjerojë zhvillimin e kompetencave kyçe, sipas nevojave individuale të nxënësve, për të zvogëluar dhe për të zhdukur diferencat brenda një shkalle të kurrikulës, në fund të saj.

a) Nxënësit me vështirësi në të nxënë

Shumë nxënës me vështirësi në të nxënë arrijnë rezultatet e pritshme të të nxënit njësoj si nxënësit e tjerë, nëse bëhet përshtatja e mënyrës së mësimdhënies dhe e vlerësimit të tyre.

Për të arritur nivelin më të lartë të mundshëm të realizimit të kompetencës, mund të zhvillohen programe të veçanta dhe individuale, për nxënësit me nevoja të veçanta.

Për të përcaktuar se cilët janë nxënësit me nevoja të veçanta ekziston një proces i bazuar në rregullore të miratuara nga MAS-i. Nëpërmjet këtij procesi, prindërit, mësuesit dhe personeli tjetër mbështetës i shkollës identifikojnë nevojat e veçanta të një nxënësi, hartojnë një plan individual arsimor (PIA) që i adresohet këtyre nevojave dhe rishikojnë progresin e nxënësit në përputhje me këtë plan.

Në rastin e nxënësve që formalisht janë përcaktuar si të veçantë, është veçanërisht e rëndësishme që stafi i shkollës, në bashkëpunim me prindërit, të mbështesë të nxënit e tyre. Procedurat dhe teknikat e vlerësimit për nxënësit me nevoja të veçanta duhet të diskutohen herë pas here me prindërit dhe vetë nxënësit. Prindërit duhet të kuptojnë se si ndikojnë këto procedura dhe teknika të përshtatura në vlerësimin e punës së nxënësve.

b) Nxënësit me dhunti dhe të talentuar

Fleksibiliteti i zhvillimit të programit lejon plotësimin e nevojave individuale të nxënësve me dhunti dhe të talentuar.

Mësuesit duhet të krijojnë kushte dhe situata të tilla që nxënësit të shfaqin dhe të zhvillojnë dhuntitë dhe talentet e tyre. Kjo arrihet nëse atyre u krijohen mundësitë të punojnë me një përmbajtje më të thelluar dhe më të zgjeruar, të zhvillojnë në mënyrë të vazhdueshme elemente specifike të kompetencave kyçe dhe specifike të fushës, të fokusohen në çështjet kroskurrikulare dhe të zgjerojnë mjediset dhe materialet e të nxënësve brenda dhe jashtë shkollës.

c) Nxënësit me vështirësi në gjuhën shqipe (pakicat kombëtare dhe emigracioni)

Nxënësit e pakicave kombëtare ose ata që vijnë nga emigracioni zotërojnë gjuhën shqipe në nivele të ndryshme, në grupmosha të ndryshme. Meqenëse programi është për të gjithë nxënësit, nxënësit me vështirësi në gjuhën shqipe duhet të arrijnë rezultatet e të nxënësve si të gjithë nxënësit e tjerë. Këtyre nxënësve duhet t'u jepet mbështetje në formën e kohës shtesë, aq sa u duhet për të mësuar gjuhën shqipe ose t'u ofrohen kurse formale nga shkolla, përgjatë vitit shkollor ose gjatë pushimeve verore.

Në fushën e shkencave natyrore, nxënësit me nevojë të veçanta mund të kenë nevojë për shumëllojshmëri modifikimesh në program dhe në mjedisin e të nxënësve. Modifikimet kanë të bëjnë:

- me lehtësitë që lejojnë lëvizshmërinë e nxënësve me probleme fizike;
- me hartimin e programeve për nxënësit me paaftësi në lexim, që ndoshta kërkojnë më shumë mundësi praktike;
- me përshtatjet e programit për nxënësit që kanë dhunti të veçanta;
- me shënimet vizuale të lidhura me çështjet e sigurisë;
- me strategjitë e vlerësimit që përshtatin shumëllojshmërinë e stileve me nevojat e të nxënësve.

V. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

Vlerësimi është pjesë integrale e procesit të të nxënësve. Ai mat shkallën në të cilën kompetencat janë arritur nga nxënësi. Ai përfshin mbledhjen e informacioneve me anë të teknikave të ndryshme të vlerësimit për arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënësve në nivel klase dhe shkalle të nxënësve.

Me këtë informacion, mësuesi merr vendime për vlerësimin përfundimtar të nxënësve, bazuar në gjykimin e tij për nivelin e zotërimit të kompetencave të fushës së shkencave të natyrës.

Vlerësimi u shërben shumë qëllimeve, ndaj është e rëndësishme që mësuesi t'ia përshtatë llojin e vlerësimit, qëllimit specifik të synuar. Para marrjes së një vendimi në lidhje me një aspekt të caktuar të performancës së nxënësve, mësuesi duhet të sigurojë që mënyra e vlerësimit të përdorur, të zotërojë informacionin që reflekton saktësisht një aspekt të veçantë të performancës që ai ka për qëllim të vlerësojë.

Është thelbësore që vlerësimi të jetë pjesë e procesit të mësimdhënies dhe të nxënësve. I gjithë procesi i të nxënësve në shkencat e natyrës mbështetet në kërkimin shkencor, si i tillë edhe vlerësimi merr shumë forma.

Duke qenë pjesë e procesit të të nxënësve, *vlerësimi formues* përdoret në të gjitha shkallët. Vlerësimi formues u shërben nxënësve për të përmirësuar të nxënësve dhe mësuesve për të përmirësuar metodat e mësimdhënies.

Vlerësimi përmbledhës përdoret për të përcaktuar shkallën në të cilën janë arritur kompetencat. Ai shërben jo vetëm për të informuar nxënësit dhe prindërit për progresin e tyre, por edhe për të përmirësuar praktikën e mësimdhënies dhe të nxënësve.

Vlerësimi diagnostikues zakonisht kryhet në fillim të shkollës apo të vitit shkollor, për të identifikuar njohuritë paraprake, interesat ose aftësitë që kanë nxënësit rreth qëllimit për të cilin po kryhet vlerësimi.

Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i shoku-shokut e bën nxënësin më të vetëdijshëm për përparimin e tij dhe, gjithashtu, i lejon ata të analizojnë dhe të krahasojnë idetë e tyre me ato të shokëve, të mësuesve dhe të prindërve.

Për *vlerësimet me shkrim*, mësuesi duhet të përdorë situata të jetës reale që përfshijnë shkencën në jetën e përditshme, shoqëri dhe mjedis. Situatat e zgjedhura duhet të jenë domethënëse dhe tërheqëse. Përveç *testeve me shkrim*, mësuesit mund të kryejnë vlerësime të bazuara në performancën e nxënësve, duke përdorur mënyrat e mëposhtme, si:

- Punët praktike;
- Modelet dhe maketet;

- Punët laboratorike;
- Posterat;
- Projektet kurrikulare dhe ndërlëndore;
- Debatet;
- Detyrat individuale;
- Esetë;
- Vrojtimet e mësuesit;
- Listat e kontrollit.

VI. MATERIALE DHE BURIME MËSIMORE

Për realizimin e kompetencave në lëndën e shkencave të natyrës, është domosdoshmëri të krijohet një mjedis mësimor i përshtatshëm. Më poshtë paraqitet një listë përmbledhëse e materialeve, burimeve dhe mjediseve të domosdoshme për realizimin e programit të kësaj lënde.

Disa nga mjetet më të përdorshme didaktike janë:

- *Mjetet verbale, tekstet si:* teksti shkollor, libri i mësuesit, fletoret e punës, atlasat, udhëzues profesionalë, fjalorë, gazeta, revista, materiale psiko-pedagogjike, enciklopedi etj.
- *Mjetet pamore natyrore si:* objektet natyrore të gjalla ose jo të gjalla, koleksionet.
- *Mjetet artificiale si:* maketet, modelet, fotografitë, vizatimet, skemat, tabelat, posterat, fotografitë, pikturat, diagramet, mjetet grafike etj.
- *Mjetet audiovizive si:* televizor, film, video, video-projektor, videokasetë, kompjuter, internet, teletekst, CD etj.
- *Mjetet dëgjimore si:* radio, magnetofon, telefon, kasetofon etj.
- *Mjediset mësimore si:* klasa, laborator, kabinetet e punës, natyra, ferma etj.

Këto burime duhet të diskutohen dhe të vlerësohen nga stafi, si një pjesë e planit të tyre për shkencën. Plani duhet të jetë i rëndësishëm për të përzgjedhur burimet e dyta, të cilat ndihmojnë për të mbështetur nxënësit në punët e tyre shkencore, si dhe në kryerjen e vizatimeve apo krijimeve të ndryshme.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR



**PROGRAMET E KULTURËS SË PËRGJITHSHME
TË ARSIMIT TË MESËM PROFESIONAL**

**Lënda: Biologji
Klasa: X**

Struktura 2+1+1, Struktura 2+2 dhe Bblok 4-vjeçar

TIRANË, 2024





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

PROGRAMET E KULTURËS SË PËRGJITHSHME
TË ARSIMIT TË MESËM PROFESIONAL

Lënda: Biologji
Klasa: X

Struktura 2+1+1, Struktura 2+2 dhe Bllok 4-vjeçar

2024

Hyrje

Shkenca është veprimtari intelektuale dhe praktike që përfshin studimin sistematik të strukturës dhe të sjelljes së botës fizike dhe natyrore përmes vëzhgimeve dhe eksperimenteve. Mësimi i shkencave natyrore iu ofron nxënësve mundësi për të zhvilluar të kuptuarit e koncepteve dhe të proceseve shkencore, të praktikave më të përdorura nga njeriu për zhvillimin e njohurive shkencore, të kontributit të shkencës në shoqëri dhe të zbatimeve të saj në jetën e përditshme.

Kurrikula e shkencës ndihmon në zhvillimin e kompetencave që u shërbejnë individëve në aspektin personal, social, ekonomik dhe që lidhen me çështje lokale, kombëtare dhe globale. Kompetencat që zhvillon fusha e shkencave të natyrës, në të gjitha shkallët kontribuojnë në arritjen e kompetencave kyçe, në funksion të të nxënit gjatë gjithë jetës.

Përmbajtja lëndore konceptohet si mjet për realizimin e kompetencave kyçe dhe atyre të fushës nëpërmjet formësimit të situatave të të nxënit. Nxënësit fillojnë me idetë e tyre se si janë gjërat dhe pastaj i ndryshojnë dhe i zhvillojnë duke i provuar ato praktikisht. Gjatë veprimtarive shkencore, nxënësit ndeshen me mundësitë e ndryshimit, rivendosjes ose sfidës së ideve. Kjo mënyrë e të nxënit bën që nxënësit të zhvillojnë dhe të formojnë të kuptuarit shkencor përmes ideve dhe përvojave të tyre. Idetë dhe konceptet përpunohen për sa kohë nxënësit punojnë në situata problemore dhe zbatojnë metoda kërkimore për t'i zgjidhur problemet. Duke mësuar në këtë mënyrë, ata mund të përjetojnë gëzimin e zbulimit shkencor dhe të ushqejnë kureshtjen për botën që i rrethon.

Mësimi i shkencave natyrore lidhet ngushtë me teknologjinë dhe së bashku i formojnë nxënësit në një kontekst më të gjerë.

Programi mbështetet në kornizën kurrikulare të arsimit parauniversitar, në kurrikulën bërthamë dhe në planin mësimor të AML-së. Ai u shërben:

- *nxënësve* për zhvillimin e kompetencave kyçe të të nxënit gjatë gjithë jetës dhe kompetencave të fushës së shkencave të natyrës;
- *mësuesve* për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e veprimtarive mësimore dhe arritjeve të nxënësve në klasë dhe jashtë saj;

- *prindërve* për njohjen e rezultateve të pritshme të fëmijëve dhe kritereve të vlerësimit në periudha të caktuara;
- *hartuesve të teksteve mësimore* dhe të materialeve ndihmëse për mësuesit dhe nxënësit.

Zbatimi i programit bëhet duke respektuar parimet e gjithëpërfshirjes në aspektin gjinor, etnik, kulturor, racor, fetar, të paaftësive dhe nevojave të veçanta të nxënësve.

Koordinoi programin:

Mimoza Milo

I. Qëllimet e fushës

Qëllimet e fushës së shkencave të natyrës janë konceptuar në funksion të të nxënimit gjatë gjithë jetës.

Përmes kësaj fushe nxënësit:

- zhvillojnë njohuritë dhe konceptet bazë për formimin shkencor në fushën e shkencave të natyrës;
- zbulojnë lidhjet e varësisë ndërmjet botës së gjallë dhe mjedisit;
- zbulojnë lidhjet e varësisë ndërmjet botës së gjallë, botës jo të gjallë dhe mjedisit;
- zhvillojnë aftësitë shkencore, mendimin kritik dhe krijues;
- zbatojnë njohuritë dhe aftësitë shkencore në mënyrë analitike, kritike dhe krijuese në problemet që kërkojnë zgjidhje dhe marrje vendimesh;
- vlerësojnë kontributin e shkencës dhe të teknologjisë për mirëqenien e njeriut dhe të shoqërisë;
- ndërgjegjësohen për të bashkëvepruar me mjedisin në mënyrë të përgjegjshme dhe konsensuale;
- përshkruajnë proceset natyrore në kohë dhe në hapësirë;
- përshkruajnë burimet energjetike;
- shpjegojnë proceset përmes katër bashkëveprimeve (gravitetit, elektromagnetik, bërthamor dhe bashkëveprimi i dobët);
- përdorin teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit, si mjet për sigurimin dhe komunikimin e informacionit;
- shpjegojnë rolin e shkencës në zhvillimin e qëndrueshëm, si edhe në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit.

Programi i fushës së shkencave natyrore synon realizimin e kompetencave kyçe të të nxënimit dhe të kompetencave të fushës.

Kompetencat e fushës lidhen me **kompetencat kyçe** nëpërmjet **rezultateve të të nxënës** të secilës prej tyre. Lidhja mes rezultateve të të nxënës të kompetencave të fushës dhe të kompetencave kyçe siguron zhvillimin e ndërsjellë të tyre dhe mundëson integrimin lëndor. Kompetencat e fushës së shkencave natyrore mund të konsiderohen si komponentë të kompetencës së kërkimit shkencor. Ato janë renditur si më poshtë:

Kompetenca 1: Identifikimi i problemeve dhe zgjidhja e tyre

a) Nxënësi përcakton problemin.

- Merr parasysh kontekstin e situatës.
- Paraqet problemin.
- Identifikon të dhënat fillestare.
- Identifikon elementet që lidhen me situatën dhe me njëra-tjetrën.
- Riformulon problemin duke përdorur koncepte shkencore dhe teknologjike.
- Propozon një shpjegim ose zgjidhje të mundshme.

b) Nxënësi zhvillon një plan veprimi.

- Eksploron disa nga shpjegimet ose zgjidhjet fillestare.
- Zgjedh shpjegimin ose zgjidhjen.
- Identifikon burimet e nevojshme.
- Planifikon hapat e zbatimit.

c) Nxënësi analizon rezultatet.

- Kërkon modelet ose marrëdhëniet domethënëse.
- Gjykon përshtatshmërinë e përgjigjes ose zgjidhjes së gjetur.
- Lidh rezultatet dhe konceptet shkencore dhe teknologjike.
- Sugjeron përmirësime nëse është e nevojshme.
- Nxjerr përfundime.

d) Nxënësi zbaton planin e veprimit.

- Ndjek hapat e planit të vet.
- Përdor teknikat dhe burimet e përshtatshme.
- Bën teste nëse është e mundur.
- Mbledh të gjitha të dhënat e dobishme dhe mban shënime për vrojtimet e bëra.
- Nëse është e nevojshme, përshtat planin e veprimeve ose zbatimin e tij.
- Zbaton planin e veprimeve.

Kompetenca 2: Përdorimi i mjeteve objekteve dhe procedurave shkencore

a) Nxënësi vendos çështjet shkencore në kontekstin e duhur.

- Identifikon aspekte të kontekstit (p.sh., sociale, mjedisore, historike).
- Bën lidhjen ndërmjet këtyre aspekteve.
- Identifikon ndonjë çështje etike që lidhet me çështjen.
- Parashikon pasojat afatgjata.

b) Nxënësi kupton parimet shkencore mbi të cilat ngrihet çështja.

- Njeh parimet shkencore.
- I përshkruan parimet në mënyrë sasiore dhe cilësore.
- Vendos lidhjet mes parimeve duke përdorur konceptet, ligjet ose modelet.

c) *Nxënësi formon një opinion për çështjen.*

- Kërkon burime të ndryshme dhe merr parasysh këndvështrime të ndryshme.
- Përcakton elementet që mund të ndihmojnë për të formuar opinionin.
- Mbështet opinionin e vet me elementet që ka marrë parasysh.
- Vlerëson opinionin e vet duke marrë parasysh edhe opinionet e të tjerëve.

d) *Nxënësi vendos lidhjen mes shkencës dhe teknologjisë.*

- Identifikon funksionet e përgjithshme të një objekti, sistemi ose procesi.
- Identifikon elementet përbërëse dhe funksionet e tyre.
- Përshkruan parimet e ndërtimit dhe të funksionimit të një objekti, sistemi, produkti ose procesi.
- Vendos lidhjet mes parimeve shkencore dhe teknologjike duke përdorur konceptet, ligjet ose modelet.
- Paraqet skematikisht parimet sipas të cilave funksionon objekti, sistemi, produkti ose procesi.

Kompetenca 3: Komunikimi me gjuhën dhe terminologjinë e shkencës

a) *Nxënësi shkëmben informacion shkencor dhe teknologjik.*

- Është i hapur ndaj këndvështrimeve të të tjerëve.
- Vlerëson këndvështrimin e vet duke e krahasuar me atë të të tjerëve.

- Integron termat shkencore dhe teknologjike në fjalorin e gjuhës së shkruar dhe të folur.

b) Nxënësi interpreton mesazhet shkencore dhe teknologjike.

- Vërteton besueshmërinë e burimeve që shfrytëzon.
- Identifikon informacionin që ka të bëjë me çështjen dhe shpjegimin ose zgjidhjen e saj.
- Kupton përmbajtjen e saktë të fjalëve, përkufizimeve dhe formulimeve.
- Bën lidhjet mes koncepteve dhe paraqitjeve të ndryshme grafike ose simbolike.
- Zgjedh elementet domethënëse.

c) Nxënësi krijon dhe ndan mesazhe shkencore dhe teknologjike.

- Merr parasysh audiencën dhe kontekstin e grupit që merr mesazhin.
- Strukturon mesazhin e tij.
- Përdor tipat e përshtatshëm të gjuhës sipas standardeve dhe marrëveshjeve të vendosura.
- Përdor forma të përshtatshme të prezantimit.
- Demonstron rigozitet dhe koherencë.

Të tria kompetencat e fushës lidhen me njëra-tjetrën. Nëse kompetenca e parë ka të bëjë me mënyrat e të arsyetuarit që u mundësojnë nxënësve të merren me probleme shkencore, dy kompetencat e tjera i mësojnë ata se si të përdorin instrumentet dhe procedurat e duhura dhe si të komunikojnë në gjuhën e shkencës dhe të teknologjisë për të zgjidhur problemet. Duke zbatuar mënyrat e të arsyetuarit shkencor, nxënësit kuptojnë natyrën e mjeteve, objekteve dhe procedurave të përdorura në këtë fushë dhe janë të aftë të vlerësojnë ndikimin pozitiv apo negativ të shkencës dhe të teknologjisë në mjedis dhe në shoqëri. Përveç kësaj, në prezantimin e

shpjegimeve ose sqarimin e zgjidhjeve të tyre, ata ndërgjegjësohen për rëndësinë e përdorimit të saktë të gjuhës dhe të terminologjisë në shkencë dhe në teknologji.

Këto kompetenca zhvillohen së bashku dhe jo veçmas apo njëra pas tjetrës. Për të realizuar metodat dhe procedurat specifike shkencore, nxënësit njohin konceptet dhe gjuhët që lidhen me to, si dhe aftësohen në përdorimin e tyre. Ata familjarizohen me këto metoda dhe procedura, të cilat kanë kuptim dhe rëndësi sipas konteksteve ku zbatohen.

Kompetencat zhvillohen përmes *tematikave të përbashkëta të fushës* dhe në program zërthehen në njohuri/aftësi, shkathtësi/procedura, qëndrime/vlera. Tematikat e përbashkëta të fushës janë elemente të rëndësishme të programit të fushës së shkencave natyrore, sipas të cilave strukturohet përmbajtja lëndore dhe integrimi konceptual i secilës prej lëndëve brenda fushës, në funksion të zhvillimit të kompetencave. Tematikat e përbashkëta për shkallën e pestë dhe të gjashtë janë: *diversiteti, ciklet, sistemet, ndërveprimet, energjia, shkallëzimi dhe matja, modelet*.

Strukturimi i programit mbi rezultatet e të nxënësve për kompetencë në secilën lëndë dhe në tematika të përbashkëta, të njëjta për të gjitha lëndët e fushës, ndihmon në planifikimin dhe në zhvillimin e situatave të të nxënësve dhe lehtëson vlerësimin e nxënësve për kompetencat kyçe.

Situatat e të nxënësve janë situata që lidhen me kontekstin e të nxënësve. Ato mund të jenë situata në mjedise të mbyllura ose të hapura të nxënësit, brenda shkollës ose jashtë saj. Roli i mësuesit në mësimdhënien përmes situatave është ai i udhëheqësit e i lehtësuesit gjatë nxënies aktive të nxënësve.


Realizimi i *temave ndërkurrikulare* dhe i *lidhjes ndërlëndore* nëpërmjet lëndëve të shkencave natyrore janë, gjithashtu, elemente të rëndësishme të programit.

Metodat, teknikat, strategjitë e të nxënimit në fushën e shkencave natyrore janë faktorë të rëndësishëm për një nxënie të suksesshme që nxit interesin, gjithëpërfshirjen, ndërveprimin dhe punën kërkimore të nxënësit. Përzgjedhja dhe përdorimi i tyre nga mësuesit bëhet në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve, duke respektuar stilet e ndryshme të të nxënimit.

Vlerësimi, si pjesë integrale e procesit të të nxënimit, mat shkallën në të cilën kompetencat janë arritur nga nxënësit.

Realizimi i programit të fushës së shkencave natyrore kërkon krijimin e një **mjedisi të nxëni**, të përshtatshëm, gjithëpërfshirës, të pasur me materiale dhe burime të domosdoshme, si dhe përdorimin e gjerë të TIK-ut.

Diagrami 1: Korniza konceptuale e programit



1. Lidhja e kompetencave të fushës me kompetencat kyçe

Kompetencat e fushës së shkencave lidhen dukshëm dhe në mënyrë logjike e metodike me kompetencat kyçe dhe me tematikat e fushës, të cilat janë në funksion të zhvillimit të tyre.

Kompetencat e fushës së shkencave natyrore lidhen me kompetencat kyçe nëpërmjet rezultateve të të nxënësve të secilës prej tyre. Lidhja mes rezultateve të të nxënësve të kompetencave të fushës dhe kompetencave kyçe siguron zhvillimin e ndërsjellët të tyre dhe lehtëson vlerësimin e nxënësve për kompetencat kyçe. Nga ana tjetër, kompetencat e fushës së shkencave natyrore lidhen edhe me njëra-tjetrën. Nëse kompetenca e parë **“Identifikimi i problemeve shkencore dhe zgjidhja e tyre”** ka të bëjë me mënyrat e të arsyetuarit që u mundësojnë nxënësve të merren me probleme shkencore, dy kompetencat e tjera **“Përdorimi i mjeteve, i objekteve dhe i procedurave shkencore”** dhe **“Komunikimi në gjuhën dhe në terminologjinë e shkencës”** u mësojnë atyre se si të përdorin instrumentet dhe procedurat e duhura dhe si të komunikojnë në gjuhën e shkencës dhe të teknologjisë për të zgjidhur problemet. Duke zbatuar mënyrat e të arsyetuarit shkencor, nxënësit do të kuptojnë natyrën e mjeteve, objekteve dhe procedurave të përdorura në këtë fushë dhe do të jetë të aftë të vlerësojnë ndikimin pozitiv apo negativ të shkencës dhe të teknologjisë në mjedis dhe në shoqëri. Përveç kësaj, në prezantimin e shpjegimeve ose sqarimin e zgjidhjeve të tyre, nxënësit do të ndërgjegjësohen për rëndësinë e përdorimit të saktë të gjuhës dhe të terminologjisë në shkencë dhe në teknologji.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet lidhja e rezultateve të të nxënësve të kompetencave të fushës me rezultatet e të nxënësve të kompetencave kyçe, sipas shkallës V të kurrikulës. Megjithatë paraqiten të ndara në tabelë, nuk ka një kufi të prerë të lidhjes së rezultateve të të nxënësve të kompetencave të fushës me rezultatet e të nxënësve të kompetencave kyçe, pasi një kufi i tillë nuk ekziston mes kompetencave në vetvete, si tek ato kyçe ashtu edhe tek ato të fushës.

Tabela 1: Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet fushës së shkencave të natyrës për shkallën V

<p><i>Shkalla V</i></p> <p><i>Klasa X</i></p>
<p>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</p> <p><i>Nxënësi komunikon në mënyrë efektive</i></p>
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shprehet përmes një forme komunikimi, për një temë të caktuar në një material (prezantim) prej 200 fjalësh dhe veçon çështjet kryesore; - përdor drejt strukturën dhe rregullat e drejtshkrimit në kontekste dhe forma të ndryshme të shkrimit, si: ese, e-mail (postë elektronike), letër formale dhe joformale etj.; - prezanton një projekt artistik, humanitar, eksperimentues etj. nga fusha të ndryshme mësimore, të hartuar individualisht dhe në grup, për një temë të caktuar, duke përdorur në mënyrë efektive teknologjinë informative dhe teknologji të tjera; - përdor TIK-un në mënyrë efektive gjatë komunikimit dhe ndërveprimit me të tjerët në jetën e përditshme, duke përfshirë edhe të nxënit e informacioneve të reja dhe kryerjen e detyrave shkollore.
<p>Kompetenca e të menduarit</p> <p><i>Nxënësi mendon në mënyrë krijuese.</i></p>
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - prezanton në forma të ndryshme të të shprehurit, mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informatave për fusha të ndryshme mësimore apo për një temë të caktuar, ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse (p.sh.: temë nga shkenca, nga kultura, nga arti, nga sporti, nga shëndetësia, nga shoqëria, nga mjedisi etj); - krahason të paktën tri burime të ndryshme të informimit për trajtimin e temës së njëjtë, argumenton saktësinë, rrethanat, gjen

ngjashmëritë dhe dallimet, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara më parë dhe i prezanton gjetjet kryesore para të tjerëve në formë të ndryshme shprehëse, duke përdorur teknologjinë informative;

- harton një detyrë me tekst, apo krijon një situatë logjike nga jeta e përditshme, e cila përmban një mesazh që kërkon zgjidhje matematikore apo një problem shkencor, duke u bazuar në njohuritë paraprake dhe prezanton mënyrën/procedurën e zgjidhjes së problemit para të tjerëve;
- modelon zgjidhjen e një problemi të dhënë (në klasë, apo jashtë saj) për një temë të caktuar nga një fushë mësimore, duke e zbërthyer në hapa të vegjël dhe jep sqarime të nevojshme për hapat e ndjekur në zgjidhjen e problemit, duke përdorur formë të ndryshme të shprehurit;
- gjykon vërtetësinë e një rezultati të dhënë (p.sh.: rezultatin e një detyre nga matematika, shkencat, shoqëria, mjedisi etj.) i cili mund të jetë gjetur me zbatimin e formulave të njohura ose me përdorimin e procedurave të caktuara dhe nxjerr përfundime për vërtetësinë e gjykimit të dhënë;
- prezanton me sukses rezultatet e punës së një detyre eksperimentale për një temë të caktuar nga ndonjë fushë mësimore (p.sh.: nga shkencat, teknologjia etj.) të realizuar në laborator, në ambientet e shkollës apo diku tjetër, përmes përdorimit të teknologjisë informative dhe jep argumente që lidhin rezultatet e punës eksperimentale me udhëzimet teorike;
- krijon një vepër artistike me pamje dy dhe tredimensionale me mesazhe nga një fushë mësimore dhe shpjegon para moshatarëve hapat e ndjekur për krijimin e veprës;
- krijon një situatë për marrjen e një vendimi për jetën e vet ose zgjidhjen e një problemi me interes shoqëror, lidh vendimin me pasojat në mënyrë të përgjegjshme dhe e prezanton gjatë një debati me moshatarë në një kohëzgjatje të caktuar.

Kompetenca e të nxënës

Nxënësi mëson për të nxënë.

Nxënësi:

- demonstroi shkathhtësi funksionale në lexim, në shkrim, në matematikë, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të

ndryshme për kryerjen e një detyre apo aktiviteti dhe gjatë të nxënimit të dijeve të reja në ndonjë fushë të caktuar mësimore;

- shfrytëzon në mënyrë efektive përvojat paraprake gjatë zgjidhjes së situatave të ndryshme në jetën e përditshme apo gjatë kryerjes së ndonjë detyre, aktiviteti, në ndonjë fushë të caktuar mësimore. Diskuton dhe ndan përvojat me të tjerët për mënyrat më praktike të shfrytëzimit të përvojave paraprake në arritjen e dijeve të reja;
- parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuar për zgjidhjen e një problemi apo detyre të një teme të caktuar, bën përmbledhjen e së paku dy veprimeve të përdorura, të cilat përcaktojnë drejtimin e mëtejshëm të të nxënimit për temën apo problemin e caktuar;
- zgjidh një problem të caktuar mësimor ose një situatë nga jeta e përditshme. Në bazë të një planifikimi të dhënë dhe në bazë të rezultatit të fituar, vërteton saktësinë e planifikimit dhe tregon me shembuj se si do të zbatojë strategjinë e ndjekur edhe në situata dhe kontekste të tjera gjatë të nxënimit;
- shfrytëzon, në mënyrë të pavarur dhe efektive, teknologjinë informative dhe burime të tjera të informimit për të mbledhur materiale për zgjidhjen e një problemi apo detyre të caktuar, të cilat më pas i analizon, i klasifikon dhe i paraqet para të tjerëve përmes TIK-ut dhe ndonjë forme tjetër të shprehjes;
- paraqet idetë personale para të tjerëve për mënyrën e zhvillimit të një aktiviteti të caktuar, duke dhënë mendime të argumentuara për rezultatet e pritura (në formë skice, grafiku, vizatimi, shkrimi, vepra artistike etj.);
- shfrytëzon, në mënyrë të pavarur, udhëzimet e dhëna nga ndonjë burim informacioni për të kryer një veprim, aktivitet, detyrë, ose për të zgjidhur një problem që kërkohet prej tij. Vlerëson vetë performancën dhe rezultatin e arritur, duke iu referuar qëllimeve fillestare (p.sh.: burime të informacionit në libër, revistë, enciklopedi, internet, hartë, grafik, skicë, partiturë muzikore, skenar etj).

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive.

Nxënësi:

- përgatit, prezanton, drejton dhe merr pjesë në një fushatë të informimit të qytetarëve për një fushë apo temë të caktuar, duke u

mbështetur në ide të reja, bazuar në rezultate të pritshme të përcaktuara qartë (p.sh.: fushatë informimi për mbrojtjen e mjedisit, sigurinë, shëndetin etj.);

- demonstroi shprehje organizative në punët individuale dhe në ekip përmes situatave reale në detyrat e veçanta mësimore, duke menaxhuar potencialin individual dhe atë të grupit, si dhe kohën, rreziqet dhe buxhetin në dispozicion;
- hartoi një projekt me faza të menaxhuara mirë (individualisht ose në grup) duke shkëmbyer, konsultuar dhe informuar të tjerët si dhe duke identifikuar dhe vlerësuar burimet njerëzore, materiale dhe monetare në përputhje me rezultatet e pritshme;
- analizon gjendjen e mjedisit (në klasë, në shkollë, në komunitet apo më gjerë), pasojat e ndotjes, propozon alternativa për mbikëqyrje dhe menaxhim të drejtë të gjendjes së vlerësuar më të ndjeshme dhe iniciacion zgjidhje konkrete.

Kompetenca personale

Nxënësi bën jetë të shëndetshme.

Nxënësi:

- analizon përparësitë dhe dobësitë personale, duke evidentuar masat përmes të cilave synon të mbështesë avancimin personal në përparësitë që ka dhe masat përmes të cilave synon të përmirësojë dobësitë personale;
- merr pjesë ose udhëheq një grup pune, që bashkëpunon me përfaqësues të komunitetit për të ndihmuar moshatarët dhe anëtarët e tjerë të komunitetit, të cilët kanë probleme shëndetësore, sociale, ekonomike etj.;
- bën zgjidhje të bazuara në informacione dhe në përvoja të drejta për të mbrojtur shëndetin dhe mirëqenien nga rreziqet e ndryshme në jetën e përditshme (p.sh.: nga përdorimi i duhanit, i alkoolit, i drogave, nga marrëdhëniet e hershme seksuale, nga zgjedhjet e gabuara ushqimore, nga ekspozimi i tepruar ndaj rrezeve të diellit etj.);
- vepron në jetën e përditshme në mënyrë të pavarur dhe të përgjegjshme, duke përzgjedhur mënyra të shëndetshme jetese, dieta të lejuara nga mjeku, ushtrime të koordinuara drejt, apo duke iu përgjigjur në mënyrën e duhur situatave të rrezikshme me të cilat mund të ndeshet në jetën e përditshme.

Kompetenca qytetare

Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.

Nxënësi:

- paraqet në forma të ndryshme të të shprehurit, mënyrën e funksionimit të mjedisit të vet shoqëror në nivel lokal dhe me gjerë, duke dhënë shembuj konkretë se si mund të përmirësohet funksionimi i tij, p.sh.: në strukturën organizative, në rregullat e veprimtimit, në publikimin e pritshmërive, në bashkëpunimin me qytetarë etj.;
- demonstroi shembuj konkretë të mbrojtjes së mjedisit natyror dhe atij të krijuar nga njeriu në aktivitete të jetës së përditshme në shtëpi, në klasë, në shkollë dhe në komunitet;
- diskuton me të tjerët apo në një formë tjetër të të shprehurit paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj., dhe jep propozime për zgjidhjen e ndonjë problemi në komunitet e më gjerë në një fushë të caktuar;
- përshkruan në formë verbale ose të shkruar, mundësinë e përdorimit të internetit dhe të informacioneve në mënyrë të përgjegjshme për tema të caktuara dhe argumenton domosdoshmërinë e përdorimit të drejtë të tyre.

Kompetenca digjitale

Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.

Nxënësi:

- përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive;
- përdor mjetet digjitale për të përpunuar, krijuar, realizuar dhe demonstruar tema mësimore;
- gjen, organizon, analizon, përpunon dhe përdor informacionin nga një shumëllojshmëri burimesh dhe mediash;
- zhvillon aftësitë krijuese, duke zbatuar njohuritë e marra në shkencën kompjuterike dhe në medie digjitale;
- diskuton për përparësitë dhe kufizimet që vijnë nga përdorimi i teknologjive në jetën e individit, shoqërisë apo komunitetit;
- tregohet më i pavarur në procesin e mësimdhënies dhe të mësimnxënies.

2. Lidhja e fushës së shkencave natyrore me temat ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare lidhen me çështje madhore me të cilat përballet shoqëria sot. Kontributi i shkencave të natyrës është i shumanshëm për sa i takon ndikimit në shëndetin e njeriut dhe mirëqenien, mjedisin dhe ekonominë. Ka një lidhje domethënëse midis çështjeve dhe sfidave që trajtojnë temat ndërkurrikulare dhe zbulimeve e arritjeve në shkencë dhe teknologji. Fusha e shkencave të natyrës, përmes situatave të larmishme të të nxënësve, zhvillon kompetencat që lidhen me çdo temë ndërkurrikulare dhe në mënyrë të veçantë me temat: *Mjedisi; Ndërvarësia; Zhvillimi i qëndrueshëm dhe Vendimmarrja morale.*

Fusha e shkencave natyrore i ndihmon nxënësit të kuptojnë çështje të shumta që lidhen me shëndetin, mirëqenien dhe seksualitetin, si dhe i nxit ata për të bërë një jetë të shëndetshme. Nga ana tjetër, ajo i ndërgjegjëson nxënësit për përgjegjshmërinë që kanë në çështje specifike mjedisore, si: përdorimi i burimeve natyrore, ndikimi i njeriut mbi mjedisin, menaxhimi i mbeturinave, çështje etike të lidhura me bioteknologjinë, ndryshimet klimatike dhe biodiversitetin.

Përmes projekteve të ndryshme në fushën e shkencës, nxënësit mund të studiojnë ndikimin social, etik, ekonomik ose mjedisor të saj. Ata nxitën për të bërë pyetje rreth çështjeve që trajtojnë këto tema dhe sjelljes së tyre si konsumatorë të përgjegjshëm.

Zhvillimi i shkathtësive të komunikimit në gjuhën e shkencës i jep nxënësve një perspektivë të re për çështje të caktuara sociale, të cilat mund të përmirësojnë cilësinë e pjesëmarrjes së tyre në klasë, në shkollë apo shoqëri duke respektuar diversitetin.

3. Lidhja e fushës së shkencave natyrore me fushat e tjera kurrikulare

Konceptimi i programit të fushës së shkencave natyrore është mbështetur në parime të mirëfillta të integritit si mes lëndëve të vetë fushës ashtu dhe të fushës me fushat e tjera. Për t'u siguruar nxënësve një mësim të integruar, është e rëndësishme lidhja e fushës së shkencave natyrore me fushat e tjera dhe specifikisht me lëndët e këtyre fushave. Nxënësit nuk mund ta perceptojnë realitetin dhe të njohin botën që i rrethon vetëm nëpërmjet studimit të lëndëve që i përkasin fushës së shkencave natyrore.

Fusha e shkencave natyrore është e lidhur ngushtë me *fushën e matematikës*. Matematika u siguron nxënësve njohuritë e domosdoshme për studimin e lëndëve të kësaj fushe. Për shembull, kur nxënësi kryen një kërkim shkencor, i duhet shpesh të bëjë matje, llogaritje, të gjejë mesataren aritmetike, të zotërojë koncepte të gjeometrisë së zbatuar, si dhe të vizualizojë hapësirën. Nxënësi përdor aparatën matematikë për të shpjeguar ligjet e fizikës dhe për të vendosur lidhjen ndërmjet ndryshoreve, si p.sh., në fizikë, lidhja ndërmjet forcës, masës dhe nxitimit. Interpretimi i ligjeve dhe i dukurive nëpërmjet përdorimit të grafikëve, të simboleve e të formulave matematikore vërteton qartë lidhjen e shkencës së matematikës me shkencat e natyrës. Gjithashtu, duke studiuar shkencat e natyrës nxënësit zhvillojnë kompetencat matematikore të problemzgjdhjes, hetimit, arsytimit logjik, lidhjes konceptuale ndërmjet madhësive dhe modelimeve. Për të analizuar dhe për të vlerësuar rezultatet gjatë studimit të dukurive dhe të ligjeve në shkencat natyrore, nxënësit duhet të zhvillojnë kompetencën e komunikimit dhe të përdorin drejt gjuhën dhe terminologjinë e shkencës.

Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” i ndihmon nxënësit për zhvillimin e kompetencës së komunikimit në gjuhën dhe në terminologjinë e shkencës. Nxënësi, duke lexuar, shkruar apo shprehur rrjedhshëm mendimet e tij rreth informacioneve shkencore mbi gjithësinë, lëndët, ndotësit e ajrit, ujit, zhvillon saktë kompetencën e komunikimit, që ndjeshëm zhvillohet në *fushën “Gjuhët dhe komunikimi”*.

Por edhe lëndët e shkencave të natyrës kontribuojnë në pasurimin e fjalorit të nxënësve dhe i aftësojnë ata të paraqesin qartë dhe saktë idetë e tyre, me gojë ose me shkrim. Punët praktike dhe eksperimentale, të cilat janë bazë për zhvillimin e kompetencave të kësaj fushe, u japin nxënësve mundësitë që të zhvillojnë kompetencën e komunikimit gjuhësor dhe të pasurojnë fjalorin terminologjik, përmes diskutimeve mbi përshkrimin e punëve praktike dhe laboratorike dhe shpjegimeve të rezultateve të tyre. Termat e ndryshme që përdoren në fushën e shkencave të natyrës janë specifike për fushën dhe ndihmojnë nxënësit për zhvillimin e kompetencës së komunikimit.

Studimi i shkencave lidhet me *fushën e shkencave shoqërore*, pasi nëpërmjet saj nxënësit marrin informacion mbi historinë e zhvillimit të shkencës në periudha të caktuara historike të shoqërive të ndryshme. Duke hedhur vështrimin nga e kaluara historike, ata mund të marrin përgjigje se si ka evoluar natyra dhe gjithësia. Nga ana tjetër, nxënësit vendosin dhe vlerësojnë lidhjen mes shkencave

natyrore, teknologjisë dhe shoqërisë dhe përmirësojnë sjelljen për harmonizimin e marrëdhënieve të tyre me mjedisin dhe për ruajtjen e tij.

Fusha e shkencave të natyrës lidhet me *fushën e arteve*, pasi disa teknika specifike të fushës së arteve zbatohen nëse njihen mirë ligjet e fushës së shkencave. P.sh., për të kryer lëvizjet e trupit, një kërcimtar mund të arrijë performancën më të lartë, nëse njih mirë ligjet e dinamikës dhe zbatimet e tyre. Gjithashtu, duke shfrytëzuar programet e arteve pamore, nxënësit bëhen njohës të mirë të figurave dhe trupave gjeometrikë në hapësirë dhe plan.

TIK-u mbështet hetimin e proceseve në fushën e shkencave dhe lehtëson bashkëpunimin dhe komunikimin e nxënësve me bashkëmoshatarët gjatë procesit të të nxënës, duke përfshirë edhe të nxënës në distancë. Për shembull, nëpërmjet përdorimit të TIK-ut nxënësi diskuton dhe ndan idetë me të tjerët, por ka mundësi të konsultohet edhe me ekspertë të fushës, kur e ka të nevojshme. Nxënësi përdor sistemet e duhura kompjuterike për ndërtimin e tabelave, grafikëve, diagrameve, vizatimin e një plani, përgatitjen e prezantimeve të detyrave praktike dhe projekteve kurrikulare, duke zbatuar në mënyrë krijuese njohuritë që përmbajnë shkencat kompjuterike dhe mediat digjitale.

Diagrami 2. Lidhja e kompetencave të fushës së shkencave natyrore me kompetencat e fushave të tjera

GJUHËT DHE KOMUNIKIMI

1. Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar
2. Të lexuarit e teksteve të ndryshme
3. Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale
4. Përdorimi i drejtë i gjuhës

MATEMATIKA

1. Zgjidhja problemore
2. Arsyetimi dhe vërtetimi matematik
3. Të menduarit dhe komunikimi matematik
4. Lidhja konceptuale
5. Modelimi matematik
6. Përdorimi i TIK-ut

ARTET

1. Krijimi artistik
2. Performimi dhe interpretimi i veprave artistike
3. Vlerësimi i veprave artistike

SHKENCAT NATYRORE

1. Identifikimi i problemeve dhe zgjidhja e tyre
2. Përdorimi i mjeteve, objekteve dhe procedurave shkencore
3. Komunikimi në gjuhën dhe në terminologjinë e shkencës

SHOQËRIA DHE MJEDISI

Kompetenca shoqërore dhe qytetare

Teknologji dhe TIK

1. Kërkimi dhe gjetja e informacionit
2. Komunikimi dhe bashkëpunimi
3. Mendimi kritik, problemzgjidhja dhe vendimmarrja
4. Kreativiteti dhe inovacioni

EDUKIMI FIZIK, SPORTI DHE SHËNDETI

1. Zhvillimi i aftësive lëvizore në përshtatje me situata të ndryshme lëvizore e sportive
2. Përshtatja e një stili jete aktiv dhe i shëndetshëm

II. REZULTATET E TË NXËNIT TË KOMPETENCAVE SIPAS TEMATIKAVE

KLASA X

LËNDA: Biologji

36 javë x 1 orë në javë= 36 orë

TEMATIKA: SISTEMET

Përshkrimi i tematikës: Një sistem përfaqëson një tërësi pjesësh të cilat punojnë së bashku për të kryer një funksion të caktuar. Ka sisteme në natyrë, si dhe sisteme të ndërtuara nga njeriu. Shembuj të sistemeve në natyrë janë sistemet e trupit të njeriut. Shembuj të sistemeve të ndërtuara nga njeriu janë sistemet elektrike. Njohja e sistemeve e lejon njeriun të kuptojë si funksionon secila pjesë e sistemit dhe se si ndërveprojnë me njëra-tjetrën për të kryer një funksion të caktuar. Kjo temë përqendrohet tek studimi i sistemeve qelizore te bimët dhe kafshët, i sistemit elektrik dhe i sistemeve të matjes.

Rezultatet e të nxënit

Biologjia qelizore

Njohuritë dhe konceptet	Aftësitë dhe proceset	Qëndrimet dhe vlerat
Ndërtimi dhe organizmi i qelizave <ul style="list-style-type: none">• Qeliza bimore dhe shtazore• Qeliza prokariote dhe eukariote• Qeliza burimore te kafshët dhe qelizat meristemmatike te bimët	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">• <u>shpjegon</u> se si strukturat kryesore përbërëse të qelizave eukariote (te bimët dhe te kafshët) dhe qelizave prokariote janë të lidhura me funksionet e tyre, duke përfshirë bërthamën / materialin gjenetik,	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">• <u>diskuton</u> rëndësinë e arritjeve të teknologjisë mikroskopike, si mundësi për të grumbulluar më shumë njohuri për qelizën;• <u>demonstron</u> bashkëpunim dhe qëndrim etik gjatë punës në grup, në kryerjen e

	<p>membranën qelizore, mitokondrinë, kloroplastet dhe plasmidet;</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>përdor</u> preparate të gatshme për të vëzhguar qeliza të ndryshme; 	<p>eksperimenteve.</p>
<p>Transporti qelizor</p> <ul style="list-style-type: none"> • Difuzioni osmoza • Transporti aktiv 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>shpjegon</u> vetitë gjysmëpërshkuese të membranës qelizore (difuzioni, osmoza dhe transporti aktiv); • <u>përshkruan</u> çfarë ndodh me indet bimore kur i vendosim në tretësira me përqendrime të ndryshme; • <u>shpjegon</u> si bimët mbështeten nga presioni i turgorit brendaqelizor; • <u>shpjegon</u> rëndësinë e potencialit të ujit dhe osmozës për qelizat dhe indet e kafshëve. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>diskuton</u> rëndësinë e transportit aktiv, si një proces që kërkon energji sepse substancat transportohen kundër gradientit të përqendrimit; • <u>vlerëson përpjekjet</u> individuale dhe punën në grup në kryerjen e eksperimenteve.

TEMATIKA: CIKLET

Përshkrimi i tematikës: Ciklet		
<p>Në natyrë ka ndryshime që përsëriten në mënyrë ciklike. Shembuj të tyre janë ciklet jetësore të qenieve të gjalla, cikli i ujit etj. Të kuptuarit e këtyre cikleve e ndihmon njeriun të parashikojë ngjarjet dhe proceset dhe të vlerësojë Tokën si një sistem të vetëqëndrueshëm.</p> <p>Kjo temë përqendrohet në ciklet e proceseve jetësore të bimët, kafshët, njeriu, përzierjet dhe ndryshimet e lëndëve, nxehja dhe ftohja.</p>		
Rezultatet e të nxënit		
Ciklet		
Njohuritë dhe konceptet	Aftësitë dhe proceset	Qëndrimet dhe vlerat
Rritja dhe zhvillimi i qelizave <ul style="list-style-type: none">• Ndarja qelizore (mitoza, mejoza)• Diferencimi qelizor• Përdorimi i qelizave burimore në mjekësi	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">• <u>përshkruan</u> procesin e mitozës, përfshirë ciklin qelizor dhe rolin e saj në organizëm;• <u>shpjegon</u> rëndësinë e diferencimit qelizor;• <u>përshkruan</u> kancerin si një sëmundje që shkaktohet si rezultat i ndryshimeve që pësojnë qelizat të cilat çojnë në rritjen e pakontrolluar të tyre dhe në ndarje qelizore;• <u>përshkruan</u> funksionin e qelizave burimore të kafshët në fazën embrionale	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">• diskuton përfitimet e mundshme dhe rreziqet që lidhen me përdorimin e qelizave burimore në mjekësi.

	<p>dhe të rritur dhe meristemmat te bimët;</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>shpjegon</u> rolin e ndarjes me mejozë në përgjysmimin e numrit të kromozomeve për të formuar gametet. 	
<p>Metabolizmi qelizor</p> <ul style="list-style-type: none"> • Enzimat • Proceset e frymëmarrjes aerobe dhe anaerobe • Molekulat biologjike 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>shpjegon</u> mekanizmin e veprimit të enzimave, duke përfshirë qendrën aktive dhe specificitetin e enzimës; • <u>heton</u> dhe <u>përshkruan</u> faktorët që ndikojnë në shpejtësinë e reaksioneve enzimatike; • <u>përshkruan</u> frymëmarrjen qelizore si një reaksion ekzotermik, i cili ndodh vazhdimisht në të gjitha qelizat e gjalla; • <u>krahason</u> proceset e frymëmarrjes aerobe dhe anaerobe; • <u>shpjegon</u> rëndësinë e sheqernave, aminoacideve, acideve yndyrore dhe glicerolit në sintezën dhe në ndarjen e karbohidrateve, lipideve dhe proteinave. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>tregon vëmendje</u> saktësisë, objektivitetit në regjistrimin dhe verifikimin e të dhënave gjatë kryerjes së eksperimenteve.

TEMATIKA: DIVERSITETI

<p>Përshkrimi i tematikës</p> <p>Kjo tematikë nënvizon rëndësinë e ruajtjes së shumëllojshmërisë në natyrë. Për të kuptuar më mirë botën në të cilën jetojmë, njeriu përpaket të organizojë botën e gjallë dhe botën jo të gjallë. Ka disa tipare të përbashkëta që lidhin të gjitha qeniet e gjalla dhe faktorë unikë në botën jo të gjallë që e ndihmojnë njeriun t'i klasifikojë ato. Ruajtja e shumëllojshmërisë siguron mbijetesën dhe vazhdimësinë e jetës.</p> <p>Në fokus të kësaj tematike në këto shkallë është diversiteti i kafshëve, bimëve, mikroorganizmave, mjedisit natyror, lëndëve dhe vetive e karakteristikave të tyre.</p>		
<p>Rezultatet e të nxënit</p>		
<p>Njohuritë dhe konceptet</p>	<p>Aftësitë dhe proceset</p>	<p>Qëndrimet dhe vlerat</p>
<p>Evolucioni, trashëgimia dhe ndryshueshmëria</p>		
<p>Gjenomi dhe shprehja e gjeneve</p> <ul style="list-style-type: none"> • Struktura e AND-së • Gjenomi • Biosinteza e proteinave 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>përshkruan</u> ADN si një polimer të përbërë: <ul style="list-style-type: none"> - nga dy fije që formojnë një heliks të dyfishtë; - nga katër nukleotide të ndryshme: secili nucleotid është i përbërë nga një sheqer dhe grupi fosfatik i përbashkët me një prej katër bazave të ndryshme të lidhura me sheqerin; 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>diskuton</u> dhe <u>vlerëson</u> rëndësinë potenciale që ka në mjekësi të kuptuarit e gjenomës së njeriut; • <u>vlerëson</u> informacionet që lidhen me anomalitë gjenetike dhe diagnostikimin e tyre.

	<ul style="list-style-type: none"> • <u>shpjegon</u> termat, si: gamete, kromozom, gjen, alele, dominant/i fshehur, homozigotë, heterozigotë, gjenotip dhe fenotip; • <u>përshkruan</u> thjesht, se si gjenomi dhe ndërveprimi i tij me mjedisin, ndikojnë në zhvillimin e fenotipit të organizmit; • <u>përshkruan</u> thjesht sintezën e proteinave; • <u>shpjegon</u> thjesht, se struktura e ADN-së ndikon në formimin e proteinave (gjatë biosintezës së proteinave). 	
<p>Trashëgimia</p> <ul style="list-style-type: none"> • Trashëgimia e një gjeni • Trashëgimia poligjenike • Përcaktimi i seksit te njeriu 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>shpjegon</u> trashëgiminë e një gjeni (një tipari); • <u>parashikon</u> rezultatet e kryqkëmbimit të njëfishtë; • <u>shpjegon</u> se shumica e karakteristikave fenotipike janë rezultat i trashëgimisë poligjenike; • <u>përshkruan</u> përcaktimin e seksit tek njeriu. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>vlerëson</u> kontributin e Gregor Mendelit në zhvillimin e gjenetikës.

<p>Ndryshueshmëria dhe evolucioni</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mutacionet, ndikimi i tyre në fenotip • Evolucioni dhe përzgjedhja natyrore 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>tregon</u> që ka, zakonisht, ndryshueshmëri të madhe gjenetike brenda popullatës së një lloji; • <u>shpjegon</u> se llojet e reja lindin si rezultat i mutacioneve të cilat mund të ndikojnë në fenotip ose nuk ndikojnë fare ose ndikojnë pak; • <u>përshkruan</u> evolucionin si një proces të ngadalshëm ndryshimi dhe zhvillimi në kohë, që ka si motor seleksionin natyror që mund të rezultojë në formimin e llojeve të reja; • <u>shpjegon</u> se si evolucioni ndodh nëpërmjet përzgjedhjes natyrore të llojeve duke sjellë fenotipe që përshkruan më mirë mjedisin e tyre. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>diskuton</u> punën e Darvinit dhe të Wallace në zhvillimin e teorisë së evolucionit, me anë të seleksionimit natyror dhe <u>shpjegon</u> ndikimin e këtyre ideve në biologjinë moderne; • <u>vlerëson</u> informacionet dhe qasjet e të tjerëve gjatë diskutimeve mbi teorinë e evolucionit.
<p>Mbarështimi selektiv dhe teknologjia në gjene</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>shpjegon</u> ndikimin e mbarështimit selektiv të bimëve dhe të kafshëve të zbutura që përdoren si ushqim; • <u>përshkruan</u> inxhinierinë gjenetike si një 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>diskuton</u> disa nga përfitimet e mundshme dhe rreziqet që vijnë nga përdorimi i teknologjisë së gjeneve në bujqësinë moderne dhe në

	<p>proces që përfshin modifikimin e gjenomës së një organizmi për të fituar tiparet e dëshirueshme;</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>përshkruan</u> hapat kryesorë në procesin e inxhinierisë gjenetike. 	<p>mjekësi, si dhe <u>vlerëson</u> çështje etike dhe sociale që lidhen me to.</p>
Biodiversiteti		
<p>Biodiversiteti</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndikimi i njeriut në ekosisteme. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>përshkruan</u> ndikimin pozitiv dhe negativ të njeriut në ekosisteme dhe në biodiversitet; • <u>përshkruan</u> disa nga faktorët biologjikë që ndikojnë në nivelin e sigurisë së ushqimit si: rritja e popullsisë njerëzore, ndryshimi I dietave në shtresat më të pasura të popullsisë, dëmtues të rinj të kulturave dhe patogjenë, ndryshimi i mjedisit, qëndrueshmëria dhe kostoja e inputeve bujqësore; • <u>përshkruan</u> dhe <u>diskuton</u> disa zgjidhje të mundshme bioteknologjike dhe bujqësore për të plotësuar kërkesat në rritje të popullsisë njerëzore. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>vlerëson</u> disa nga përfitimet dhe sfidat e ruajtjes së biodiversitetit në nivel lokal dhe global, si dhe sfidat biologjike për rritjen e prodhimit ushqimor duke përdorur më pak burime.

TEMATIKA: NDËRVEPRIMET

Përshkrimi i tematikës: Ndërveprimet

Studimi i ndërveprimit midis dhe brenda sistemeve zhvillon të kuptuarit e mjedisit dhe rolit të njeriut në të. Ndërveprimet ndodhin brenda një organizmi, midis organizmave, si dhe midis organizmave dhe mjedisit. Ndërveprimi i njeriut me mjedisin drejton zhvillimin e shkencës dhe të teknologjisë. Në të njëjtën kohë shkenca dhe teknologjia ndikojnë në mënyrën se si njeriu ndërvepron me mjedisin. Të kuptuarit e këtij ndërveprimi ndihmon nxënësin të kuptojë më mirë pasojat pozitive dhe negative të veprimeve të tij dhe të jetë përgjegjës për to.

Tema fokusohet te ndërveprimi brenda dhe ndërmjet bimëve, kafshëve, njeriut dhe mjedisit, mikroorganizmave, atmosferës, sistemit diellor dhe Tokës, forcave, shkencës dhe teknologjisë.

Rezultatet e të nxënit

Ndërveprimet në ekosisteme

Njohuritë dhe konceptet	Aftësitë dhe proceset	Qëndrimet dhe vlerat
<p>Ekosistemet</p> <ul style="list-style-type: none"> Nivelet e organizimit brenda një ekosistemi Ndikimi i faktorëve abiotikë dhe biotikë në komunitete 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <u>përshkruan</u> nivele të ndryshme të organizimit të një ekosistemi duke u nisur nga niveli i organizimit deri në të gjithë ekosistemin; <u>shpjegon</u> se si ndikojnë disa faktorë abiotikë dhe biotikë në komunitete; <u>përshkruan</u> rëndësinë e ndërvarësisë dhe konkurrencës në një komunitet. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <u>përdor mjete dhe materiale rrethanore</u> për interpretimin e proceseve; <u>vlerëson</u> përpjekjet individuale dhe punën në grup në kryerjen e eksperimenteve.

III. UDHËZIME METODOLOGJIKE

Metodat, teknikat, strategjitë e të nxënimit në fushën e shkencave të natyrës janë faktorë të rëndësishëm për një nxënie të suksesshme që nxit interesin, gjithëpërfshirjen, ndërveprimin dhe punën kërkimore të nxënësve. Përzgjedhja dhe përdorimi i tyre nga mësuesit luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e kompetencave të nxënësve, duke respektuar stilet e ndryshme të të nxënimit të tyre. Në fushën e shkencave të natyrës, kërkimi shkencor është baza e kompetencave që zhvillon kjo fushë. Metodat që mund të përdorin lëndët e kësaj fushe përfshijnë: modelimin, vëzhgimin, metodat eksperimentale dhe empirike, formimin e një ideje dhe përdorimin e TIK-ut. Këto metoda nuk mund të përdoren pa u kombinuar me njëra-tjetrën.

Modelimi

Modelimi nënkupton ndërtimin e një situatë abstrakte që është e vështirë për t'u vëzhguar ose e pamundur për t'u parë. Ky modelim paraqitet nëpërmjet një teksti, vizatimi, formule matematikore, ekuacioni kimik apo në formën e një softwar-i programi. Është me shumë rëndësi të kuptohet situata në të cilën është krijuar modelimi. Përveç të tjerave, modelimi duhet t'i ndihmojë nxënësit të kuptojnë realitetin, të shpjegojnë karakteristikat e këtij realiteti dhe të parashikojnë një dukuri.

Metoda e vëzhgimit

Metoda e vëzhgimit është një metodë që i ndihmon nxënësit në formimin e koncepteve shkencore. Nëpërmjet kësaj metode nxënësit bëjnë lidhjen ndërmjet koncepteve abstrakte dhe objekteve, organizmave apo dukurive të botës reale. Kur vëzhgojnë objekte, organizma apo dukuri, nxënësit përdorin njohuritë shkencore. Vëzhgimet i ndihmojnë ata për të krijuar përfytyrime të qëndrueshme për botën që na rrethon. Vëzhgimet në natyrë i nxisin nxënësit të punojnë në mënyrë shkencore, të ngrenë hipoteza dhe t'i testojnë ato. Vëzhgimi është hapi i parë i një hetimi, eksperimenti apo studimi.

Metoda eksperimentale

Metoda eksperimentale fillon me shpjegime teorike shkencore dhe vazhdon me demonstrimin e eksperimentit. Qëllimi i procedurës është të identifikojë dhe të krahasojë elementet e vëzhgueshëm sasiorë dhe të kontrollojë vërtetësinë e hipotezave të ngritura. Gjatë përdorimit të kësaj metode, nxënësit përdorin një sërë aparaturash për të bërë matje, si dhe tregojnë kujdes gjatë përdorimit të tyre.

Metoda empirike

Metoda empirike bazohet në modelet intuitive dhe siguron një mënyrë për të eksploruar elementet e një problemi. Kjo metodë udhëheq ide, hipoteza, teori dhe teknika të reja për një studim kërkimor më të detajuar.

Hetimi

Nxënësit angazhohen në veprimtari, përmes të cilave kuptojnë se si shkencëtarët mendojnë, çfarë bëjnë në një proces vendimmarrjeje, si ngrenë pyetje dhe si planifikojnë hetimin. Përmes të nxënësve kërkues, nxënësit aftësohen të përftojnë njohuri dhe të krijojnë një botëkuptim për botën natyrore dhe fizike bazuar në hetimin shkencor. Gjithashtu, nxënësit zbatojnë aftësitë dhe proceset kërkuese, si dhe zhvillojnë qëndrimet dhe vlerat që janë themelore për praktikën e shkencës.

Projektet

Projektet janë veprimtari të nxënësve nëpërmjet të cilave nxënësit zbulojnë objektet, proceset apo dukuritë.

Teknologjia e informacionit dhe e komunikimit

Teknologjia e informacionit dhe e komunikimit mbështet procesin kërkues, rrit cilësinë e të nxënësve dhe siguron bashkëpunimin mes tyre. Përmes përdorimit të mjeteve digjitale, nxënësit mund të eksplorojnë dhe të perceptojnë konceptet abstrakte, si dhe të zbulojnë marrëdhëniet ndërmjet objekteve dhe dukurive.

STRATEGJITË

Strategjitë e përdorura në shkencë dhe në teknologji mund t'i ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë tri kompetencat e programit. Më poshtë, po listojmë disa prej tyre:

- Identifikimi i elementeve të rëndësishme që lidhen me problemzgjdhjen.
- Ndarja e një problemi kompleks në disa probleme më të thjeshta.
- Përdorimi i arsytimeve (p.sh.: arsyetimi induktiv dhe deduktiv, krahasimi, klasifikimi, etj.).

QËNDRIMET

Qëndrimet janë një faktor i rëndësishëm në zhvillimin e kompetencave.

Disa nga qëndrimet intelektuale janë:

- kurioziteti;
- ndjenja e iniciativës;
- prirja për të ndërmarrë risk intelektual;
- interesi për prezantimin e ideve të ndryshme;
- ndjenja e përgjegjësisë për zgjidhje origjinale;
- ndjenja e gatishmërisë dhe e solidaritetit gjatë punës në grup;
- kujdesi për shëndetin dhe për sigurinë;
- objektiviteti;
- përdorimi i qasjeve të duhura metodike;
- përdorimi i saktë i gjuhës sipas terminologjive shkencore.

Teknikat janë:

- përdorimi i instrumenteve matëse;
- siguria ndaj pajisjeve dhe materialeve laboratorike.

Përdorimi i gjuhës dhe i terminologjisë shkencore

Të lexuarit dhe të shkruarit në shkencë ndihmon nxënësit për ta kuptuar shkencën dhe jo thjesht për të mbajtur mend faktet dhe për t'i riprodhuar ato.

Të lexuarit shkencor ndihmon në shprehjen e ideve dhe të koncepteve, nxit diskutimin, analizën dhe vlerësimin. Leximi i shumëllojshmërisë së materialeve në lidhje me atë çka mësohet në shkollë, i bën nxënësit të mendojnë se informacioni nuk vjen vetëm nga teksti shkollor por edhe nga burime të tjera. Një burim i rëndësishëm duhet të konsiderohet edhe ai i materialeve të shkruara nga shokët.

Gjatë vëzhgimeve të qenieve të gjalla, të dukurive ose gjatë konsultimeve me fotografi, harta, postera e burime të tjera informacioni, nxënësit duhet të nxiten të mbajnë shënime. Në këtë mënyrë, ata do të thellohen e do të kuptojnë më mirë objektin ose dukurinë që vëzhgojnë.

Kërkesa për mbajtjen e shënimeve dhe paraqitjen e gjetjeve gjatë vëzhgimeve dhe eksperimenteve ndihmon pozitivisht në përpunimin e të dhënave dhe përvetësimin e njohurive. Për shënimet dhe paraqitjen e përfundimeve nga nxënësit, mund të parashikohen forma të tilla pune, si: shkrimi i një raporti të shkurtër, përgatitja e një informacioni gojor, realizimi i një vizatimi, tabele, grafiku etj.

Në shkrimin e relacioneve ose në paraqitjen e informacioneve gojore etj., është mirë që gjithnjë të kërkohet nga nxënësit që të analizojnë, të krahasojnë dhe të përgjithësojnë të dhënat, në mënyrë që të nxitet të kuptuarit e dukurisë ose të objektit të vëzhguar.

Leximi dhe shkrimi rreth asaj çka nxënësit shohin, mendojnë dhe lexojnë duhet të bëhet pjesë e përditshme e regjimit të tyre.

Siguria

Mësuesit janë përgjegjës për sigurinë e nxënësve gjatë veprimtarive në klasë, për nxitjen dhe motivimin e tyre, për rregullat dhe përgjegjësitë e sigurisë. Ata duhet të planifikojnë gjithmonë veprimtari praktike të sigurta dhe t'u tregojnë nxënësve kushtet e sigurisë në përputhje me ato të bordit të shkollës dhe të politikave të Ministrisë së Arsimit dhe të Sportit.

Gjatë veprimtarive në fushën e shkencës, nxënësit: zbatojnë, gjithmonë dhe në mënyrë të ndërgjegjshme, rregullat e sigurisë në shkollë, klasë dhe jashtë tyre; identifikojnë paraprakisht kushtet në të cilat veprimtaria mund të mos jetë e sigurtë dhe tregojnë se si mund të parandalohen aksidentet në të gjitha rastet e mundshme; përdorin pajisjet, kimikatet dhe mjetet sipas udhëzimeve; tregojnë vazhdimisht shqetësim për sigurinë e tyre dhe të tjerëve.

IV. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

Vlerësimi është pjesë integrale e procesit të të nxënësve. Ai mat shkallën në të cilën kompetencat janë arritur nga nxënësi. Ai përfshin mbledhjen e informacioneve me anë të teknikave të ndryshme të vlerësimit për arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënësve në nivel klase dhe shkalle të nxënësve. Me këtë informacion, mësuesi merr vendime për vlerësimin përfundimtar të nxënësve, bazuar në gjykimin e tij për nivelin e zotërimit të kompetencave të fushës së shkencave të natyrës.

Vlerësimi u shërben shumë qëllimeve, ndaj është e rëndësishme që mësuesi t'ia përshtatë llojin e vlerësimit, qëllimit specifik të synuar. Para marrjes së një vendimi në lidhje me një aspekt të caktuar të performancës së nxënësve, mësuesi duhet të sigurojë që mënyra e vlerësimit të përdorur, të zotërojë informacionin që reflekton saktësisht një aspekt të veçantë të performancës që ai ka për qëllim të vlerësojë.

Është thelbësore që vlerësimi të jetë pjesë e procesit të mësimdhënies dhe të nxënësve. I gjithë procesi i të nxënësve në shkencat e natyrës mbështetet në kërkimin shkencor, si i tillë edhe vlerësimi merr shumë forma.

Duke qenë pjesë e procesit të të nxënit, *vlerësimi formues* përdoret në të gjitha shkallët. Vlerësimi formues u shërben nxënësve për të përmirësuar të nxënit dhe mësuesve për të përmirësuar metodat e mësimdhënies.

Vlerësimi përmbledhës përdoret për të përcaktuar shkallën në të cilën janë arritur kompetencat. Ai shërben jo vetëm për të informuar nxënësit dhe prindërit për progresin e tyre, por edhe për të përmirësuar praktikatat e mësimdhënies dhe të nxënit.

Vlerësimi diagnostikues zakonisht kryhet në fillim të shkallës apo të vitit shkollor, për të identifikuar njohuritë paraprake, interesat ose aftësitë që kanë nxënësit rreth qëllimit për të cilin po kryhet vlerësimi.

Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i shoku-shokut e bën nxënësin më të vetëdijshëm për përparimin e tij dhe, gjithashtu, i lejon ata të analizojnë dhe të krahasojnë idetë e tyre me ato të shokëve, të mësuesve dhe të prindërve.

Për *vlerësimet me shkrim*, mësuesi duhet të përdorë situata të jetës reale që përfshijnë shkencën në jetën e përditshme, shoqëri dhe mjedis. Situatat e zgjedhura duhet të jenë domethënëse dhe tërheqëse. Përveç *testeve me shkrim*, mësuesit mund të kryejnë vlerësime të bazuara në performancën e nxënësve, duke përdorur mënyrat e mëposhtme, si:

- punët praktike;
- modelet dhe maketet;
- punët laboratorike;
- posterat;
- projektet kurrikulare dhe ndërlëndore;
- debatet;
- detyrat individuale;
- esetë;

- vrojtimit e mësuesit;
- listat e kontrollit.

V. MATERIALE DHE BURIME MËSIMORE

Për realizimin e kompetencave në lëndën e shkencave të natyrës, është domosdoshmëri të krijohet një mjedis mësimor i përshtatshëm. Më poshtë paraqitet një listë përmbledhëse e materialeve, burimeve dhe mjediseve të domosdoshme për realizimin e programit të kësaj lënde.

Disa nga mjetet më të përdorshme didaktike janë:

- *mjetet verbale, tekstet si:* teksti shkollor, libri i mësuesit, fletoret e punës, atlasat, udhëzues profesionalë, fjalorë, gazeta, revista, materiale psiko-pedagogjike, enciklopedi etj.
- *mjetet pamore natyrore si:* objektet natyrore të gjalla ose jo të gjalla, koleksionet.
- *mjetet artificiale si:* maketet, modelet, fotografitë, vizatimet, skemat, tabelat, posterat, fotografitë, pikturat, diagramet, mjetet grafike etj.
- *mjetet audiovizive si:* televizor, film, video, video-projektor, videokasetë, kompjuter, internet, teletekst, CD etj.
- *mjetet dëgjimore si:* radio, magnetofon, telefon, kasetofon etj.
- *mjediset mësimore si:* klasa, laborator, kabinetet e punës, natyra, ferma etj.

Këto burime duhet të diskutohen dhe të vlerësohen nga stafi, si një pjesë e planit të tyre për shkencën. Plani duhet të jetë i rëndësishëm për të përzgjedhur burimet e dyta, të cilat ndihmojnë për të mbështetur nxënësit në punët e tyre shkencore, si dhe në kryerjen e vizatimeve apo krijimeve të ndryshme.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

PROGRAMET E KULTURËS SË PËRGJITHSHME
TË ARSIMIT TË MESËM PROFESIONAL

Lënda: TIK

Klasa: X

Struktura 2+1+1, Struktura 2+2 dhe Bblok 4-vjeçar

TIRANË, 2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

**PROGRAMET E KULTURËS SË PËRGJITHSHME
TË ARSIMIT TË MESËM PROFESIONAL**

Lënda: TIK

Klasa: X

Struktura 2+1+1, Struktura 2+2 dhe Bllok 4-vjeçar

2024

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

1.	Qëllimet e arsimit parauniversitar	8
2.	Qëllimet e lëndës së TIK-ut në arsimin parauniversitar.....	8
3.	Lidhja e kompetencave kyç me kompetencat e lëndës	10
4.	Rezultatet kryesore të të nxënit sipas kompetencave kyç që realizohen nëpërmjet lëndës së TIK-ut	11
5.	Lidhja e TIK-ut me fushat e tjera kurrikulare	13
6.	Kompetencat e lëndës dhe përshkrimi i tyre	17
7.	Koha mësimore	21
8.	Përmbajta e tematikave të programit mësimor të TIK-ut për klasën e dhjetë.....	22
	8.1 Tematika: Bota e kompjuterit	22
	8.2 Tematika: Përpunimi digjital i të dhënave	24
	8.3 Tematika: Programimi në Web	27
	8.4 Tematika: Programimi dhe Algoritmika	29
	8.5 Tematika: JAVA	32
9.	Udhëzime metodologjike	34
10.	Udhëzime për vlerësimin	35
11.	Materialet dhe burimet e mësimdhënies	39

Koordinoi programin:

Eriksen Mersinllari

I. HYRJE

Në kohët e sotme, teknologjia dhe TIK-u janë kthyer në një mënyrë jetese ndaj së cilës nxënësit shfaqin interes. Arsimi teknologjik është një komponent thelbësor i kurrikulës ku nxënësit zhvillojnë aftësitë digjitale për të përdorur TIK-un në mënyrë efektive dhe të përshtatshme për të pasur akses, për të krijuar dhe komunikuar informacion dhe ide, për të zgjidhur probleme dhe për të punuar së bashku në të gjitha fushat e edukimit në shkollë dhe në jetën përtej shkollës. Aftësia e TIK-ut i përfshin nxënësit në procesin e të mësuarit për teknologjinë digjitale, duke e bërë të vlefshme për ta, për t'ju përshtatur si teknologjive që evoluojnë ashtu dhe tu jap njohuri mbi kufizimin e rreziqeve për veten në një mjedis digjital. Në një mjedis digjital ku ka ndryshime të shpejta dhe të vazhdueshme në mënyrën se si njerëzit ndajnë, përdorin, zhvillojnë dhe komunikojnë me TIK-un, të rinjtë duhet të jenë shumë të aftë në përdorimin e tij. Për të marrë pjesë në një ekonomi të bazuar në dije dhe për të qenë të fuqishëm në një shoqëri teknologjike të sofistikuar për të sotmen dhe në të ardhmen, nxënësve u nevojiten njohuri, aftësi dhe besim në TIK për të realizuar detyrat në shkollë, shtëpi, punë dhe në komunitetet e tyre. Si qytetarë, ata duhet të jenë të aftë të bëjnë gjykime vetjake mbi çështjet që lidhen me ndikimin e teknologjisë në jetët e tyre, në shoqëri dhe në mjedis.

Nxënësit e moshës digjitale vijnë në shkollë me njohuri, gjykime, opinione dhe pyetje të marra nga burime të pafundme digjitale të informacionit të cilat mësuesi duhet t'i konsiderojë si pjesë të kurrikulës në tërësinë e saj.

“TIK-u dhe Teknologjia” janë një formë e veçantë e veprimtarisë krijuese, ku njerëzit ndërveprojnë me mjediset e tyre duke përdorur materialet, inputet dhe proceset e duhura në përgjigje të nevojave, dëshirave dhe mundësive të tyre. Ato integrojnë shprehitë për zgjidhjen e problemeve dhe shprehitë praktike në prodhimin e produkteve dhe të sistemeve të dobishme të pranishme në shumë fusha të të nxënësve, por veçanërisht në fushën e shkencave natyrore.

Teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit janë të shpejta dhe të automatizuara, interaktive dhe multimediale, mbështesin komunikimin e shpejtë dhe përfaqësimin e dijes në shumë audiencë dhe përshtatjen e saj në kontekste të ndryshme. Ato transformojnë mënyrat e të mësuarit dhe të mësuarit të nxënësve, duke i bërë ata më të aftë dhe të përgjegjshëm se si , ku dhe kur ata mësojnë.

II. KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT

Hartimi i programit lëndor rrjedh nga: Korniza Kurrikulare e arsimit të mesëm të lartë, plani mësimor për kurrikulën bërthamë në arsimin e mesëm të lartë si dhe standardet e fushës kurrikulare ku kjo lëndë bën pjesë. Për të siguruar përdorimin sa më të mirë të programit është e vlefshme njohja me dokumentet e lartpërmendura. Te korniza kurrikulare vëmendje e veçantë i duhet kushtuar:

- synimeve të përgjithshme të kurrikulës së arsimit parauniversitar;
- synimeve të temave ndërkurrikulare;
- vlerësimit të nxënësit me notë;
- parimeve të mësimdhënies/mësimnxënies.

Në mënyrë që tërësia e dokumenteve zyrtare (korniza kurrikulare, standardet e fushës së të nxënësve dhe programi lëndor) të zbatohet më së miri në dobi të nxënësve, përdoruesit e kësaj tërësie duhet të njohin thellë programet lëndore të lëndës së TIK-ut për klasat paraardhëse dhe klasat pasardhëse. Gjithashtu, përdoruesve të këtij programi u lind nevoja të njohin standardet e të gjitha fushave të tjera të të nxënësve dhe të gjitha programet e lëndëve të të njëjtit vit. Zbatimi i këtij programi kërkon që kurrikula e TIK-ut të vendosë theksin në rrugën dhe procedurat e veprimit shkencor me objektet mësimore, që metodat verbale të përdorura gjerësisht sot, të zëvendësohen me përdorimin e metodave shkencore. Ajo duhet t'i nxisë nxënësit të jenë aktivë dhe të marrin përgjegjësi për të mësuarit e tyre; të përdorë strategji dhe teknika mësimore që nxitin ndërveprimin, pjesëmarrjen mësimore dhe mbështesin kërkimin me TIK të nxënësve. Zbatimi i programit duhet të bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore, fetare.


Si i tillë ky dokument i shërben:

- ***nxënësve*** për zhvillimin e kompetencave kyçe dhe kompetencave lëndore të TIK-ut, në mënyrë që ata të përballojnë sfidat e jetës dhe të integrohen në shoqëri.
- ***mësuesve*** për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe arritjet e nxënësve në klasë dhe jashtë saj.
- ***prindërve*** për njohjen e rezultateve të pritshme të fëmijëve dhe kriteret e vlerësimit në periudha të caktuara kohore.
- ***hartuesve*** të teksteve mësimore dhe të materialeve ndihmëse për mësuesit dhe nxënësit.

Programi i TIK-ut ka në thelb të tij krijimin e kushteve për ndërtimin e kompetencave të fushës/lëndës si dhe të kompetencave kyçe që lidhen me to. Realizimi i temave ndërkurrikulare nëpërmjet TIK-ut është një komponent i rëndësishëm i programit për kontributin e tij në shoqëri dhe në jetën e përditshme. Në program, gjithashtu, përshkruhet lidhja e TIK-ut me fushat e tjera, në mënyrë që kurrikula e përgjithshme e arsimit profesional të shihet si një e tërë për realizimin e qëllimit kryesor të formimit të nxënësve.

Programi përmban **5 tematika**, të cilat krijojnë kushte që nxënësi të ndërtojë dhe zbatojë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, në funksion të kompetencave të lëndës dhe kompetencave kyçe. Në program paraqitet edhe koha mësimore për secilën tematikë, që ndryshon nga klasa në klasë. Përdorimi i metodologjive efikase në mësimdhënie është kusht për zbatimin e programit, për arritjen e kompetencave nga ana e nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin që zotëron brenda vetes. Në këtë program, vlerësimi i nxënësve është komponent thelbësor për përmirësimin e arritjeve të nxënësve dhe procesit të të nxënit.

Diagrami 1: Korniza konceptuale e programit



1. Qëllimet e arsimit parauniversitar

Arsimi parauniversitar krijon kushte dhe mundësi që nxënësit: të ndërtojnë dhe të zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria demokratike; të zhvillohen në mënyrë të pavarur e të gjithanshme; të kontribuojnë në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake dhe të shoqërisë shqiptare dhe të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës. Në arsimin parauniversitar nxënësit:

- kultivojnë identitetin vetjak, kombëtar dhe përkatësinë kulturore;
- përvetësojnë vlera të përgjithshme kulturore dhe qytetare;
- zhvillohen në aspektet intelektuale, etike, fizike, sociale dhe estetike;
- zhvillojnë përgjegjësi ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit;
- aftësohen për jetë dhe për punë, në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;
- aftësohen për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- zhvillojnë shpirtin e sipërmarrjes;
- përdorin teknologjitë e reja.

2. Qëllimet e lëndës së TIK-ut në arsimin parauniversitar

Natyra dhe fusha e aftësive të TIK-ut nuk është fikse, por është në funksion të zhvillimeve më të reja teknologjike. Kjo është e qartë me shfaqjen e teknologjisë së përparuar të internetit gjatë viteve të fundit dhe ndryshimet që rezultojnë në mënyrat që nxënësit të ndërtojnë njohuritë dhe ndërveprojnë me të tjerët. Nxënësit zhvillojnë aftësi në përdorimin e TIK-ut për punët që lidhen me aksesin e informacionit dhe menaxhimin, krijimin e informacionit dhe prezantimin, zgjidhjen e problemeve, marrjen e vendimeve, komunikimin, të shprehurit krijues dhe arsyetimin empirik. Kjo përfshin kryerjen e hulumtimit duke krijuar produkte multimediale të informacionit, analizimin e të dhënave, hartimin e zgjidhjes së problemeve, kontrollin e proceseve dhe të pajisjeve duke punuar në mënyrë të pavarur dhe në bashkëpunim me të tjerët. Nxënësit zhvillojnë

njohuritë, shkathtësitë dhe dispozitat rreth TIK-ut dhe përdorimit të tij dhe aftësinë për t'i transferuar të gjitha këto mjedise dhe aplikime. Ata mësojnë të përdorin TIK-un me kujdes, duke kuptuar mundësitë e tij, kufizimet dhe ndikimin tek individët, grupet dhe komunitetet.

Qëllimi i programit të fushës së TIK-ut:

Programi i TIK-ut ka për qëllim të zhvillojë njohuritë, të kuptuarit dhe aftësitë për të siguruar nxënësit që, individualisht dhe në bashkëpunim:

- të hetojnë, projektojnë, planifikojnë, menaxhojnë, krijojnë dhe vlerësojnë zgjidhjet;
- të jenë krijues, inovative dhe me iniciativë kur përdorin tradicionalen, bashkëkohoren dhe teknologjitë e reja dhe të kuptojnë se si janë zhvilluar teknologjitë me kalimin e kohës;
- të marrin vendime të informuara dhe etike në lidhje me rolin, ndikimin dhe përdorimin e teknologjive në ekonomi, mjedis dhe shoqëri për një të ardhme të qëndrueshme;
- të angazhohen me besim dhe përgjegjësi që të zgjidhin dhe të manipulojnë me teknologjitë e përshtatshme - materialet, të dhënat, sistemet, komponentët, mjetet dhe pajisjet - kur projektojnë dhe krijojnë zgjidhje;
- të kritikojnë, analizojnë dhe vlerësojnë problemet, nevojat apo mundësitë për të identifikuar dhe për të krijuar zgjidhje.

Kompetencat e fushës

Vazhdimësia e aftësisë TIK të të mësuarit është e organizuar në pesë kompetenca lëndore të ndërlidhura:

- *Hetimi me TIK.*
- *Krijimi me TIK.*
- *Komunikimi me TIK.*
- *Menaxhimi dhe operimi me TIK.*
- *Zbatimi i protokolleve dhe praktikave sociale dhe etike kur përdorin TIK-un.*

3. Lidhja e kompetencave kyç me kompetencat e lëndës

Ndërtimi dhe zbatimi i kompetencave kyçe nga nxënësit gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies, kërkon që mësuesi të mbajë parasysh lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës për secilën shkallë. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë situatat, veprimtaritë, metodat, dhe mjetet e përshtatshme të procesit të të nxënies. ***Kompetenca përcaktohet si integrim i njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve që një nxënës duhet t'i fitojë gjatë procesit të nxënies.*** Kompetenca demonstron nga nxënësi (njohuri), bazohet në performancën e tij (aftësi), si dhe bazohet në perspektivën e sjelljes (qëndrim). Organizimi i mësimit të TIK-ut me bazë kompetencat përqendrohet në atë që nxënësi duhet të dijë, të bëjë saktë dhe të shpjegojë pse e bën. Kur nxënësi realizon kompetencën digjitale, ai njëkohësisht është duke zhvilluar edhe kompetencat kyçe. P.sh. “Zgjidhja problemore” përfshin shumë nga strategjitë e zgjidhjes së situatave të ndryshme problemore në shoqëri dhe në jetën e përditshme duke përdorur teknologjinë.

Për të realizuar lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës së TIK-ut mësuesi ndjek këto hapa:

- përzgjedh rezultatin/et e të nxënies për kompetencat kyçe që synon të arrijë nxënësi;
- zbërthen në rezultate të nxënies për kompetencat kyçe për secilin vit mësimor rezultatin/et e të nxënies për shkallë, për kompetencat kyçe;
- përzgjedh rezultatin/et e të nxënies për shkallë për kompetencat e lëndës së TIK-ut që synon të arrijë nxënësi;
- zbërthen në rezultate të nxënies për kompetencat e lëndës së TIK-ut për vit mësimor;
- përzgjedh përmbajtjen/et mësimore, mjetet digjitale, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënies të kompetencave digjitale në një vit mësimor, si dhe rezultatet e të nxënies për kompetencat kyçe në një vit mësimor;
- planifikon mësimdhënien duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do t'i arrijë rezultatet e të nxënies brenda vitit shkollor;
- kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxëniesve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave, projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënies për vit mësimor.

4. Rezultatet kryesore të të nxënit sipas kompetencave kyç që realizohen nëpërmjet lëndës së TIK-ut

Kompetenca digjitale - Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin

Nxënësi:

- përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive;
- përdor mjetet digjitale për të përpunuar, krijuar, realizuar dhe demonstruar tema mësimore nëpërmjet pjesëve të filmuara apo të animuara;
- gjen, organizon, analizon, përpunon dhe përdor informacionin nga një shumëllojshmëri burimesh dhe mediash;
- merr njohuritë bazë për sistemet e duhura kompjuterike (hardware, software, networks dhe softet e ndryshme);
- zhvillon aftësitë krijuese, duke zbatuar njohuritë e marra në shkencën kompjuterike dhe mediet digjitale;
- diskuton për avantazhet dhe disavantazhet e përdorimit të teknologjive në jetën e individit, shoqërisë apo komunitetit.

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Nxënësi komunikon në mënyrë efektive

Nxënësi:

- përdor TIK-un në mënyrë efektive gjatë komunikimit dhe ndërveprimit me të tjerët në jetën e përditshme, duke përfshirë edhe të nxënit e informacioneve të reja dhe kryerjen e detyrave shkollore.
- prezanton një projekt (artistik, humanitar, eksperimentues etj.) nga fusha të ndryshme mësimore për një temë të caktuar, duke përdorur në mënyrë efektive teknologjinë informative dhe teknologji të tjera.

Kompetenca e të menduarit - Nxënësi mendon në mënyrë krijuese

Nxënësi:

- krahason të paktën tri burime të ndryshme informacioni për trajtimin e një teme, argumenton saktësinë, rrethanat, gjen ngjashmëritë dhe dallimet duke u bazuar në kriteret e përcaktuara më parë, i prezanton gjetjet kryesore para të tjerëve në forma të ndryshme shprehëse, duke përdorur teknologjinë e informacionit;

- prezanton me sukses rezultatet e punës së një detyre eksperimentale për një temë të caktuar nga ndonjë fushë mësimore (p.sh., nga shkencat, nga teknologjia etj.) të realizuar në laborator ose në ambientet e shkollës apo diku tjetër, përmes përdorimit të teknologjisë së informacionit, jep argumente që lidhin rezultatet e punës eksperimentale me udhëzimet teorike;
- skicon me një grup të nxënësish, një faqe të internetit për përdorim interaktiv nga ana e nxënësve lidhur me tema nga fusha të ndryshme mësimore, e mirëmban atë sipas rregullit dhe paraqet një model të nxitjes së moshatarëve që t’i përdorin informacionet në mënyrë të përgjegjshme.

Kompetenca e të nxënit - Nxënësi mëson për të nxënë

Nxënësi:

- shfrytëzon, në mënyrë të pavarur dhe efektive, teknologjinë e informacionit dhe burimet e tjera të informimit për të mbledhur materiale për zgjidhjen e një problemi apo detyre të caktuar, të cilat më pas i analizon, i klasifikon dhe i paraqet para të tjerëve përmes TIK-ut dhe ndonjë forme tjetër të shprehjes;
- paraqet idetë personale para të tjerëve për mënyrën e zhvillimit të një aktiviteti të caktuar, duke dhënë mendime të argumentuara për rezultatet e pritura (në formë skice, grafiku, vizatimi, shkrimi, vepre artistike etj.);
- shfrytëzon, në mënyrë të pavarur, udhëzimet e dhëna në ndonjë burim informacioni për të kryer një veprim, aktivitet, detyrë ose për të zgjidhur një problem që kërkohet prej tij, vlerëson vetë performancën dhe rezultatin e arritur.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin - Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive

Nxënësi:

- përgatit, prezanton, drejton dhe merr pjesë në një fushatë informimi për qytetarët në lidhje me një fushë apo temë të caktuar, duke u mbështetur në ide të reja, bazuar në rezultate të pritshme të përcaktuara qartë (p.sh., fushatë informimi për mbrojtjen e mjedisit, për sigurinë, për shëndetin etj.).

Kompetenca personale - Nxënësi bën jetë të shëndetshme

Nxënësi:

- ndërmerr aktivitete për shmangien e paragjykimeve, stereotipave në shkollë dhe në shoqëri dhe për promovimin e vlerave të qëndrueshme shoqërore, duke ilustruar ato me shembuj pozitivë nga ngjarje e individë të njohur;
- gjykon mënyrën e komunikimit, të sjelljeve dhe të qëndrimeve që nxisin konflikte ndërpersonale në klasë, në shkollë apo në shoqëri, duke vënë theksin në faktorët që kanë ndikuar në shfaqjen e saj dhe jep shembuj të menaxhimit dhe të zgjidhjes së konflikteve ndërpersonale në mënyrë konstruktive.

Kompetenca qytetare - Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët**Nxënësi:**

- përshkruan, me gojë ose me shkrim, mundësinë e përdorimit të internetit dhe të informacioneve në mënyrë të përgjegjshme për tema të caktuara, si dhe argumenton domosdoshmërinë e përdorimit të drejtë.
- demonstroi veprime të ndryshme që shprehin tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve në komunitetin ku jeton (në klasë, në shkollë, në lagje dhe me gjerë) dhe i shpjegon ato në një debat me të tjerët.

5. Lidhja e TIK-ut me fushat e tjera kurrikulare

TIK-u luan një rol të rëndësishëm në të gjitha fushat e tjera. Ai u shërben të gjitha fushave, duke pasuruar situatat e mësimin në të cilat nxënësi zhvillon kompetencat e tij. Përdorimi i teknologjisë ndihmon në përvetësimin më mirë të lëndëve të tjera nga nxënësi duke i bërë ato më të kuptueshme dhe më tërheqëse. Përdorimi i TIK-ut duhet të shihet si një mjet që i ndihmon nxënësit të përqendrohen më gjatë në klasë, pasi informacioni mund të transmetohet në forma të ndryshme: audio-vizive (eksperimentet virtuale, filmat dokumentarë, prezantime PowerPoint, postera, leximi online, shkrimi në Word, ndarja e informacioneve me shkollat e tjera nëpërmjet e-mail-it).

Gjuhët dhe Komunikimi: Në shkollë duhet të ketë një mbështetje të fortë për lidhjen e të mësuarit në lëndën e TIK-ut me të mësuarit e gjuhës dhe komunikimit. Të mësuarit në lëndën e TIK-ut i jep një përparësi të madhe komunikimit të saktë dhe të qartë. Lënda e TIK-ut ka si rrjedhim

përforcimin e të mësuarit të gjuhës dhe komunikimit. Nxënësit duhet të përshkruajnë objektet dhe ngjarjet; të interpretojnë përshkrimet; të lexojnë dhe të japin instruksione; të gjenerojnë dhe eksplorojnë ide me të tjerët; të shkruajnë përshkrime të shkurtra dhe specifitime, tekste reklamash, raporte vlerësimi dhe ndryshimi dhe të marrin pjesë në grupe diskutimi. Në gjuhët dhe komunikimi nxënësi bën korrigjimin në mënyrë automatike të gabimeve ortografike, vendosjen e duhur të sintaksës. Gjatë dërgimit të e-mail-eve shikohet nëse është zgjedhur adresa e saktë dhe nëse është përdorur gjuha e duhur ndaj dërguesit. Gjuhët e huaja mund të përdoren edhe si aftësi ndërkurrikulare. Nxënësve u kërkohet të gjenden informacione nga interneti dhe, më pas, ata mund të hartojnë rregullat e klasës, mund të shkruajnë një bibliografi të vogël për veten, mund të jenë në gjendje të krijojnë një faqe ku të vendosin punime në gjuhë të huaj, si dhe mund të organizojnë postera për tema të ndryshme që prekin jetën e përditshme. Nëpërmjet CD-ROM dhe DVD ata zhvillojnë më shumë fjalorin duke e pasuruar atë dita-ditës. Ana vizuale i ndihmon nxënësit të memorizojnë më shpejt dhe më lehtë shumë fjalë.

Matematika: Kurrikula e lëndës së TIK-ut jep kontekstin brenda të cilit mund të aplikohet dhe të zhvillohet të kuptuarit matematikor, rrjedhshmëria, arsyetimi logjik, mendimi analitik dhe aftësia problem-zgjidhëse.

Nxënësit përdorin TIK-un në lëndën e matematikës për të zhvilluar aftësitë në zgjidhjet problemore, komunikimin dhe arsyetimin. Ata identifikojnë kërkesat e informacionit dhe aksesojnë informacionin; organizojnë, manipulojnë dhe transformojnë të dhëna dhe zhvillojnë interpretimet personale. Ata aplikojnë aftësitë dhe konceptet matematikore dhe numerike dhe përdorin TIK-un për të prodhuar dhe vërtetuar hipoteza për saktësinë dhe paragjykimin. Ata mësojnë për të komunikuar teoritë matematikore, gjetjet dhe kuptimin.

Në matematikë, nxënësit mësojnë metodat statistikore të cilat mund të aplikohen te analizat sasiore të të dhënave në lëndën e TIK-ut. Nxënësit zhvillojnë përdorimin e sistemit metrik në të dyja lëndët; të matematikës dhe TIK-ut. Aftësia për të konvertuar midis njësive metrike te gjatësisë dhe masës dhe shënimit dhjetor në matematikë do t'i mundësojë ata që të paraqesin dhe krahasojnë të dhënat në mënyra të kuptueshme në lëndën e TIK-ut. Nxënësit përdorin kuptimin hapësinor të zhvilluar në matematikë për të aplikuar njohuritë e gjeometrisë, formave dhe këndeve në TIK. Kur konsiderohet një sistem në një gamë të gjerë shkallësh në lëndën e TIK-ut, nxënësit përdorin njohuritë e tyre të kohës dhe intervaleve në matematikë. Lënda e TIK-ut jep mjetet për përpunimet automatike të matematikës të cilat përforcojnë konceptet në matematikë. Aftësia e nxënësve në matematikë për të zgjidhur problemet që përmbajnë ekuacione lineare mund të përdoret në TIK kur studiohen marrëdhëniet sasiore dhe

algoritmet e vizatimit. Në studimin e matematikës nxënësi përdor programin Excel për të hedhur të dhëna matematikore. Ata mund ta realizojnë nëpërmjet vizatimit të grafikëve, të cilët mund të shërbejnë më pas edhe për të realizuar analizën e të dhënave. Krijojnë një database ku hedhim të dhënat për nxënësit: emër, mbiemër, ditëlindja, vendlindja etj. Kjo database mund të përdoret më pas për përlogaritje formulash kur nxënësit të kenë përvetësuar Excel-in.

Shkencat e natyrës: Lënda e TIK-ut plotëson kurrikulën e shkencave të natyrës. Shkencat zhvillojnë ide që kanë të bëjnë me modele, të rregullit dhe organizimit, të stabilitetit dhe ndryshimit, të shkallës dhe matjes, të materies dhe energjisë dhe të sistemeve si aspekte kyçe të pikëpamjes shkencore për botën. Nxënësit mbështeten mbi këto ide kur krijojnë zgjidhje dhe vlerësojnë rolin e teknologjisë në shoqëri.

TIK-u mbështetet te konceptet e biologjisë, kimisë, fizikës për të zgjidhur problemet dhe skicon zgjidhje për të përmbushur nevojat dhe mundësitë njerëzore. Lidhjet me kurrikulën e shkencave të natyrës lejojnë zbatimet e koncepteve shkencore përmes kritikës dhe zbatimit të njohurive parësore për të projektuar zgjidhje të botës reale që janë të kuptueshme për nxënësit. P.sh., nxënësit zbatojnë njohuritë mbi forcat dhe karakteristikat e vetive të materialeve. Ata kryejnë studime të përshtatshme shkencore të materialeve, proceseve dhe prototipeve.

TIK-u jep shume teknika dhe teknologji për të automatizuar mbledhjen, magazinimin dhe analizën e të dhënave shkencore. Zhvillimi i teknologjive dixhitale si data loggers, spreadsheets, databases, teknologjitë e simulimit dhe të imagjinatës kanë qenë boshti për përparimin në shkenca. Ata janë përdorur për të mbledhur dhe organizuar një gamë të gjerë të dhënash dhe për të tërhequr informacion duke filtruar, analizuar dhe vizualizuar volume të mëdha të dhënash numerike, kategorie dhe strukturore. TIK-u u jep nxënësve aftësitë për të përfaqësuar të dhënat në mënyrat që mundësojnë analizat përlogaritëse. Shkencëtarët përdorin teknologjitë digjitale për të zhvilluar software për të simuluar, modeluar, dhe analizuar sisteme biologjike, kimike dhe fizike. Teknologjitë digjitale u japin nxënësve aftësitë për implementuar dhe fituar një botëkuptim më të thellë të koncepteve dhe modeleve në lëndët shkencore duke ndërvepruar me simulimet.

Shoqëria dhe mjedisi: Në fushën e shoqërisë dhe mjedisit nxënësi përdor TIK-un për të investiguar çështje dhe për të zhvilluar njohuritë e tyre për shëndetin fizik, mendor, emocional, social dhe shpirtëror. TIK-u është përdorur si mjet reflektimi dhe komunikimi për të marrë pjesë në komunitetet bashkëpunuese të të mësuarit lokale dhe globale dhe për të paraqitur dhe vlerësuar informacionin tek të tjerët.

Gjithashtu aftësitë e TIK-ut mund të zbatohen duke përdorur një gamë kontekstesh nga kurrikula e lëndës së gjeografisë. Që në vitet e para nxënësit zgjedhin informacion, gjejnë modele dhe veprojnë me sisteme digjitale krahas zhvillimit të kuptimit hapësinor, veçanërisht kur krijojnë, interpretojnë dhe përdorin hartat. Ata kuptojnë shkallën dhe distancën dhe regjistrojnë të dhënat në lidhje me motin. Ata krijojnë produkte dhe sisteme që matin dhe zhvillojnë më tej të kuptuarit e tyre të influencës së klimës dhe kushteve të motit.

Nxënësit përforcojnë aftësitë dhe kuptimin e tyre mbi teknologjitë digjitale kur studiojnë karakteristikat mjedisore të vendeve, proceseve dhe rëndësisë për njeriun. Gjatë kërkimeve ata mbledhin dhe konvertojnë të dhënat në forma të dobishme duke përdorur spreadsheets, grafikë dhe harta të shpërndarjes. Nxënësit konsolidojnë të kuptuarit e tyre mbi mbështetshmërinë gjatë kohës kur studiojnë rëndësinë e mjedisit biofizik për njeriun dhe kur projektojnë, kur dizenojnë dhe manaxhojnë projektet që rrisin të kuptuarit e tyre të balancës delikate ndërmjet veprimit të njeriut dhe mjedisit. Përmes TIK-ut, konceptet dhe të mësuarit që adresohen në lëndën e gjeografisë vihen në kontekst përmes projektimit dhe prodhimit të produkteve, shërbimeve dhe mjediseve përmes projekteve specifike të targetuara që lidhin mjedisin me shoqërinë. Nxënësit kritikojnë, dizajnojnë dhe prodhojnë zgjidhje për mjedise të menaxhuara dhe të konstruara. Të mësuarit është një rritje e mëtejshme përmes aktiviteteve autentike që fokusohen mbi zgjidhjet sipërmarrëse dhe inovative drejt nevojave të pikasura.

Historia jep nja shteg tjetër për të kuptuar se si zhvillohet TIK-u dhe se si zhvillimi i TIK-ut është burim i fakteve historike dhe artefakteve. Krijimi dhe zhvillimi i teknologjive digjitale ka ndikuar dhe ka influencuar në shoqëri dhe rritje të ardhmes.

Nxënësit përdorin TIK-un në histori që të kontrollojnë dhe vlerësojnë informacionin, zhvillojnë arsyet për vlerësimin e pozitive dhe besimeve, diskutojnë çështje dhe thellojnë interpretimet e tyre për çështjet dhe ngjarjet. Nëpërmjet informacionit dhe rrjeteve, nxënësit hetojnë, mendojnë në mënyrë kritike, bashkëpunojnë, marrin vendime dhe ndërmarrin veprime për çështje të rëndësishme. TIK-u i siguron nxënësve një gamë në rritje të informacionit që të zhvillojnë njohuritë e tyre drejt kronologjisë dhe kuptimit të ngjarjeve dhe çështjeve të veçanta.

Zhvillimi i teknologjive gjeo-hapësinore (p.sh. GIS) mundësojnë studim tepër sistematik për ngjarjet, tendencat dhe çështjet.

Artet: Kurrikula e TIK-ut plotëson kurrikulën e arteve, veçanërisht në aplikimin e elementeve dhe parimeve të projektimit të dizenjës në artet pamore dhe në përdorimin e TIK-ut në artet mediatike. Nxënësit përdorin multimedian në një gamë të fushave të të mësuarit në kurrikulën shkollore për të komunikuar prova të të mësuarit të tyre. Nxënësit përdorin TIK-un që të krijojnë, regjistrojnë dhe të rishikojnë produktet artistike, eventet

dhe shfaqjet. Ata shprehin idetë e tyre dhe komunikojnë me të tjerët. Nxënësit përdorin TIK-un në të gjitha format e arteve dhe gjithnjë e më shumë në format e reja artistike të tilla si multimedia. TIK-u mbështet interpretimin, vlerësimin, analizën dhe krijimin e veprave të artit dhe bën ekzaminimin të pozicionimit të artit në shoqëri.

Edukimi fizik, sporte dhe shëndet: Lënda e TIK-ut mban parasysh edhe atë çka nxënësit mësojnë në lëndën e edukimit fizik. Në fashën e lëvizjes dhe aktivitetit fizik të lëndës edukim fizik, nxënësit zhvillojnë dhe praktikojnë aftësi të vogla koordinuese të cilat i ndihmojnë që ata të zhvillojnë dhe të aplikojnë aftësi manipulative në teknologjinë digjitale. Ata përdorin TIK-un si mjet për të regjistruar praktika të tilla si lëvizja (ecja), ushqimi (dieta), sjelljet dhe për të analizuar, paraqitur dhe transformuar të dhënat e mbledhura dhe informacionin.

6. Kompetencat e lëndës dhe përshkrimi i tyre

Bazuar në këtë program mësimor, lënda e TIK-ut synon të përmbushë 5 kompetencat e lëndës, të cilat lidhen me kompetencat kyçe që një nxënës duhet të zotërojë gjatë jetës së tij dhe që arrihen nëpërmjet 5 tematikave kryesore.

Kompetenca: Hetimi me TIK <i>(Kompetenca e të menduarit dhe e të nxënës)</i>	
<i>Hetojnë dhe bëhen konsumatorë kritikë të informacionit.</i>	
Nxënësit : <ul style="list-style-type: none"> ▪ zhvillojnë një pamje ueb për website-n e tyre në vijim të strategjive të hulumtuara; ▪ planifikojnë dhe paraqesin kërkime me bibliografi të shënuar; ▪ analizojnë burime informacioni elektronike, kritikojnë besueshmërinë dhe vlefshmërinë e tyre. 	Klasa 10
<i>Hetojnë duke përdorur strategjitë dhe mjetet e duhura.</i>	

<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ bashkëpunojnë për të zgjidhur problemin dhe konkurrojnë me të tjerët në lojërat interaktive edukative; ▪ punojnë me një komunitet online për të arritur një qëllim të përbashkët kërkimor duke marrë parasysh përgjegjësinë për të integruar të gjithë anëtarët e komunitetit; ▪ demonstrojnë njohuri për sistemet komplekse pas zgjidhjes së problemit në to si dhe në mjediset stimuluese. 	Klasa 10
<p>Kompetenca: Krijimi me TIK (Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin)</p>	
<p><i>Krijojnë, redaktojnë dhe ndajnë informacion dhe ide.</i></p>	
<p>Nxënësit :</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ krijojnë, promovojnë dhe paraqesin një transmetim për një audience të gjerë; ▪ bashkëpunojnë për të planifikuar dhe prezantuar një produkt digjital të rafinuar teknikisht që integron aplikime të përshtatshme të TIK-ut; ▪ marrin përgjegjësinë për redaktimin e një elementi të një produkti digjital të prodhuar në bashkëpunim. 	Klasa 10
<p><i>Bazohen në konventat e njohura për të shprehur ide dhe informacion.</i></p>	
<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ menaxhojnë dhe organizojnë të dhëna duke përdorur mjete të tilla si mail merge; ▪ mbajnë një koleksion të gjerë të produkteve digjitale që përputhen me konventat e prezantimit të TIK-ut; ▪ përshkruajnë idetë e tyre krijuese dhe hartojnë raportin e tyre në lidhje me pronësinë intelektuale 	Klasa 10
<p>Kompetenca: Komunikimi me TIK (Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit)</p>	
<p><i>Shprehin identitetin, komunikojnë në mënyrë të përshtatshme dhe ruajnë sigurinë dhe privatësinë.</i></p>	

<p>Nxënësit :</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ promovojnë respekt për veten dhe të tjerët në komunikime; ▪ diskutojnë sfidat në lidhje me shfaqjen, parandalimin dhe kontrollin e krimit kibernetik; ▪ kuptojnë shqetësimet e paraqitura nga rrjete të veçanta online. 	Klasa 10
<i>Kontribuojnë dhe mësojnë nga të tjerët.</i>	
<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ planifikojnë një projekt këmbimi online, e zbatojnë atë dhe tërheqin pjesëmarrësit në të; ▪ zgjedhin dhe rekomandojnë zgjidhje softuerë bashkëpunuese të përshtatshme për qëllime të veçanta; ▪ bëjnë rekomandime për përdorimin etik të pajisjeve të reja. 	Klasa 10
<p>Kompetenca: Menaxhimi dhe operimi me TIK (Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin)</p>	
<i>Përdor procedurat e njohura për të mbajtur një mjedis TIK të sigurt, të mbrojtur dhe efikas.</i>	
<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ përshkruajnë rreziqet specifike të sistemit të tilla si: mosfunksionimi i celularit dhe se si t'i heqin ato ; ▪ krahasojnë sistemet e përbashkëta të lidhjes të tilla si dial-up, ADSL, Wireless Broadband; ▪ analizojnë dhe krahasojnë përgjegjësinë e TIK duke përdorur politikat e organizatave të ndryshme. 	Klasa 10
<i>Kuptojnë se si sistemet dhe komponentët TIK janë përdorur për të ruajtur dhe rifituar informacionin.</i>	
<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ bëjnë dallimin ndërmjet funksioneve të sistemeve operative softuerë dhe aplikacioneve softuerë; ▪ përshkruajnë tiparet kryesore të rrjeteve të një sistemi operativ të tilla si kontrollin e aksesit, shërbimet e dosjeve dhe shkëmbimi. 	Klasa 10
<p>Kompetenca: Zbatimi i protokolleve dhe praktikave sociale dhe etike kur përdorin TIK (Kompetenca personale dhe kompetenca qytetare)</p>	

<i>Njohin pronësinë intelektuale dhe aplikojnë praktika të sigurisë së informacionit digjital.</i>	
<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ identifikojnë dhe përshkruajnë dilemat etike; ▪ përdorin një sërë strategjish për sigurimin dhe mbrojtjen e informacionit. 	Klasa 10
<i>Aplikojnë protokollet personale të sigurisë dhe identifikojnë ndikimin e TIK-ut në shoqëri.</i>	
<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ në mënyrë të pavarur aplikojnë strategjitë e duhura për të mbrojtur të drejtat, identitetin, jetën private dhe sigurinë emocionale të tjerëve gjatë përdorimit të TIK-ut; ▪ vlerësojnë ndikimin e TIK-ut në vendin e punës dhe në shoqëri. 	Klasa 10

7. Koha mësimore

Lënda e TIK-ut zhvillohet për 36 javë mësimore me nga 2 orë secila, pra gjithsej 72 orë për klasën e 10-të. Programi i lëndës së TIK-ut specifikon peshën (orët e sugjeruara) e secilës tematikë për secilën shkallë dhe klasë. Shuma e orëve sugjeruese për secilën tematikë është e barabartë me sasinë e orëve vjetore, të përcaktuara në planin mësimor të arsimit të mesëm të lartë. Kjo ka si qëllim që, përdoruesit e programit të orientohen për peshën që zë secila tematikë në orët totale vjetore.

<i>TIK</i>	Bota e kompjuterit	Përpunimi digjital i të dhënave	Programimi në Web	JAVA	Programimi dhe algoritmika	Orë gjithsej
Klasa 10	10 orë	17 orë	16 orë	7 orë	22 orë	72 orë

Në programin e lëndës së TIK-ut për klasën e dhjetë janë paraqitur përmbajtjet e tematikave:

1. Bota e kompjuterit
2. Përpunimi digjital i të dhënave
3. Programimi në Ueb
4. JAVA
5. Programimi dhe algoritmika

Këto tematika janë bazë për të ndërtuar njohuri, shkathtësi, qëndrime e vlera. Tematikat janë bazë për të siguruar rezultatet e të nxënit sipas kompetencave lëndore. Për secilën klasë janë paraqitur tematikat dhe për çdo tematikë janë përcaktuar njohuritë. Koha për secilën tematikë lidhet së pari me rëndësinë e tematikës dhe së dyti me shkallën e vështirësisë së saj për t'u përvetësuar nga nxënësit. Sasia e orëve mësimore për secilën tematikë është rekomanduese. Mësuesit janë të lirë të ndryshojnë me 10% (më shumë ose më pak) orët e rekomanduara për secilën tematikë. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, si dhe ndarjen e orëve sipas tematikave.

Mësuesit dhe hartuesit e teksteve shkollore janë të lirë t'i organizojnë kapitujt dhe renditjen e tyre, por ajo që është e rëndësishme dhe duhet marrë në konsideratë është se tematikat zgjasin përgjatë gjithë vitit shkollor dhe si të tillë kapitujt e teksteve nuk mund të jenë të ndarë, por duhet të kenë ndërlidhje dhe vazhdimësi. Gjithashtu, mësuesit duhet të marrin në konsideratë që situatat janë në qendër të zhvillimit të orës mësimore dhe nëpërmjet situatave të synohet arritja e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve. Për këtë arsye do të ishte dhe në ndihmë të mësuesit nëse tekstet do të ishin të pasura me situata praktike të marra nga jeta e përditshme.

8. Përmbajta e tematikave të programit mësimor të TIK-ut për klasën e dhjetë.

8.1 Tematika: Bota e kompjuterit

Përshkrimi i tematikës

Nxënësit zhvillojnë aftësitë e tyre, kreativitetin dhe njohuritë në shkenca kompjuterike, mediat digjitale dhe të teknologjisë së informacionit. Në këtë tematikë nxënësit marrin njohuritë dhe aftësitë e ndërtimit, funksionimit dhe përdorimit të kompjuterit. Ata do të njihen me zhvillimin e sotëm shoqëror. Identifikimi dhe zgjidhja e problemeve ndërmjet komponentëve kompjuterike dhe bashkëveprimi ndërmjet tyre. Rregullat bazë të punës në kompjuter. Nxënësit zhvillojnë njohuri dhe aftësi, që kanë të bëjnë me konceptin e informacionit, klasifikimi dhe llojet e informacionit, matja e informacionit. Disa nga programet aplikative më të përdorshme dhe klasifikimi i tyre në paketa. Rregullat bazë të funksionimit të rrjetit, tipet dhe tipologjinë e rrjeteve.

Rezultatet e të nxënësve për kompetencat e lëndës

Zbatimi i protokolleve dhe praktikave sociale dhe etike kur përdorin TIK:

- *identifikon ndikimin e TIK-ut në shoqëri: vlerëson ndikimin e TIK-ut në vendin e punës dhe në shoqëri, dhe diskuton për rolin e tij në të ardhmen dhe se si ata mund të ndikojnë në përdorimin e tij.*

Menaxhimi dhe Operimi TIK:

<ul style="list-style-type: none"> - <i>zgjedh dhe përdor hardware dhe software</i>: argumenton zgjedhjen dhe optimizon funksionimin e një sërë pajisjesh të zgjedhura dhe funksioneve software për të përfunduar detyra të veçanta, për qëllime të ndryshme dhe në kontekste të ndryshme shoqërore; - <i>kupton sistemet TIK</i>: zbaton të kuptuarit e komponentëve TIK të sistemit të rrjetit për të bërë ndryshime në funksionet, proceset, procedurat dhe pajisjet për të përshtatur qëllimin e zgjidhjes; - <i>menaxhon të dhënat digjitale</i>: Menaxhon dhe ruan të dhëna të sigurta në disa medime magazinimi dhe formate. 	
Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës	Aftësitë për realizimin e kompetencave të lëndës
<ul style="list-style-type: none"> ▪ ruajnë punën rregullisht dhe aderojnë protokollet back-up; ▪ kërkojnë ndihmë kur është e domosdoshme (zgjidhin problemet gjatë punës); ▪ janë të vetëdijshëm për parimet ergonomike; ▪ njohin tipet e rrjeteve dhe topologjinë e tyre; ▪ vlerësojnë se cilat pajisje hyrëse, dalje dhe magazinimi janë më të përshtatshme për detyrën; ▪ vlerësojnë tipet e ndryshme të kanaleve të transmetimit; ▪ interpretojnë terminologjinë bazë të kompjuterit; ▪ njohin komponentët e rrjetit. 	<p><i>Nxënësit</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ demonstrojnë kuptim të rreziqeve të sigurisë në rrjet strategjive mbrojtëse dhe parandaluese; ▪ zbatojnë progresionet e zgjidhjes problemore dhe riparimit për funksionimin efikas të mjeteve; ▪ identifikojnë shqetësimet e shëndetit dhe sigurisë në punë dhe zgjidhjet për mjediset TIK; ▪ ruajnë skedarë në një strukturë të qartë logjike duke demonstruar njohuri të konventave për madhësinë, tipin dhe emërimin e skedarit; ▪ kuptojnë fushën e TIK-ut mjaftueshëm për të qenë konsumatorë efektivë të produkteve dhe shërbimeve TIK; ▪ demonstrojnë kuptim të koncepteve bazë të rrjeteve (network
<p>Qëndrimi dhe vlerat</p> <p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ janë të përgjegjshëm kur përdorin mjetet dhe pajisjet teknologjike; ▪ ndjekin rregullat e laboratorit të TIK-ut; 	

- ndajnë ide dhe bashkëpunojnë me të tjerët;
- kuptojnë rëndësinë e TIK-ut në aspekte të ndryshme të jetës së përditshme;
- tregojnë interes për koncepte dhe njohuri të reja në fushën e teknologjisë;
- zbatojnë rregullat e mirëmbajtjes së kompjuterit;
- janë të vetëdijshëm për parimet ergonomike;
- janë të vetëdijshëm se si pajisje hyrëse, dalëse dhe magazinimi punojnë së bashku;
- marrin në konsideratë pajtueshmërinë e software-ve dhe hardware-ve.

Aktivite të sugjeruara

- Diskutime në grup për zgjedhjen e strategjisë se ku dhe sa herë do të bëhet magazinimi i të dhënave: në partitionin e ri, memorien e jashtme (usb, hard disk) ose në internet (cloud).
- Me ndihmën e mësuesit/es bëhet përzgjedhja e programit Free ose Open Source të përshtatshme për lehtësimin dhe automatizimin e backup-it.
- Diskutim mbi rolin dhe zhvillimin e kompjuterit në jetën e përditshme. Analizë e varësisë nga kompjuteri.
- Avantazhet dhe disavantazhet në fushat e komunikimit, teknologjisë, sociologjisë, shëndetit etj.

8.2 Tematika: Përpunimi digjital i të dhënave

Përshkrimi i tematikës

Nxënësit marrin njohuri dhe aftësi që kanë të bëjnë me: funksionet kryesore të disa programeve aplikative të sistemit operativ Windows, faqet e punës për disa nga këto programe dhe elementet kryesore të paraqitjes së tyre. Kuptimi për prezantimet dhe përse shërbejnë ato. Identifikimi i vizatimeve efektive për prezantime të thjeshta. Shtimi i një informacioni në një slide. Ndryshimi i pamjes së një slide. Ndryshimi i paraqitjes së

një prezantimi, animacionet. Nxënësi krijon prezantime të mundësuar me grafikë, krijon animacione të shkurtra. Publikon animacionet e realizuara nëpërmjet FLASH.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat e lëndës

Krijimi me TIK:

- *gjeneron ide, plane dhe procese:* zgjedh dhe përdor TIK-un për të artikuluar idetë dhe konceptet dhe planifikon zhvillimin e zgjidhjeve komplekse;
- *gjeneron zgjidhje për sfidat dhe detyrat në fushën e mësim:* harton, modifikon dhe menaxhon zgjidhje komplekse digjitale ose rezultate krijuese multimediale ose transformime të dhënash për një gamë audiencash dhe qëllimesh.

Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës

- planifikojnë për krijimet dhe përzgjedhin mjetet TIK të përshtatshme;
- vlerësojnë produktet;
- përdorin wizard-e;
- përpunojnë tekst, muzikë dhe grafikë;
- përdorin organizues grafik dhe storyboard për planifikim;
- njihen me programin FLASH;
- krijojnë dhe integrojnë skenarë në FLASH;
- përdorin Macromedia FLASH për krijimin e animacioneve;
- publikojnë skenarë;
- shtojnë një File në Dok HTML;
- përpunojnë të dhëna (përdorin mjetet e FLASH për të krijuar dhe modifikuar vizatimet artistike në skenarë);

Aftësitë për realizimin e kompetencave të lëndës

Nxënësi:

- krijojnë produkte digjitale që të informojnë, argëtojnë, ndikojnë apo të bindin;
- përcaktojnë karakteristikat e cilësisë së projektimit për një produkt TIK dhe ndjekin specifikimet për të krijuar një produkt;
- përdorin funksione redaktimi të avancuara për të përpunuar një produkt digjital për rezultatet e dëshiruara;
- mbledhin, analizojnë, paraqesin, organizojnë dhe administrojnë të dhëna me mjete digjitale;
- krijojnë produkte digjitale që ilustrojnë një përdorim të gjerë të rregullave të përshtatshme për llojin e tekstit;
- demonstrojnë njohuri të ligjeve për pronësisë intelektuale dhe të drejtën e autorit.

- mbledhin të dhëna dhe i paraqesin ato duke përdorur TIK-un;
- bëjnë një prezantim të shkurtër në PowerPoint rreth realizimit të skenarit.

Qëndrimi dhe vlerat

Nxënësit:

- demonstrojnë aftësi prodhuese;
- konsiderojnë reagimet e audiencës;
- vlerësojnë, monitorojnë dhe përcaktojnë performancën;
- respektojnë krijimtarinë dhe pronën e të tjerëve;
- demonstrojnë njohuri të ligjeve për pronësisë intelektuale dhe të drejtën e autorit;
- marrin në konsideratë pronësinë intelektuale dhe ligjet që mbrojnë të drejtën e autorit.

Aktivitete të sugjeruara

- Në orë praktike presin disa këngë të preferuara për një kuic në klasë.
- Për orët autoriale mund të incizojnë vetë nxënësit punën në kompjuter.
- Nxënësit duke eksploruar dhe duke përdorur mundësitë grafike të PowerPoint-it për të zmadhuar prezantimin e tekstit, për të shkuar përtej me grafikë, ngjyra e sinjale, kuptojnë se cilat efekte do ta largojnë nga qëllimet e prezantimit.
- Në klasë krahasohen 2-3 lloje të prezantimeve për të arritur në atë më idealin.
- Nxënësit realizojnë një prezantim në klasë mbi ditë ose tema të shënuara, si: Dita e Verës, Dita e Pavarësisë, festat e fundvitit, prezantim të një shteti, ekskursioni, të një personazhi etj.
- Në bazë të tematikës përzgjidhen paraqitja, pamja, diagramet, tabelat, animacionet dhe vetitë e tyre, gjithnjë duke pasur parasysh rregullat e prezantimit.

8.3 Tematika: Programimi në Web

Përshkrimi i tematikës

Në këtë tematikë nxënësit marrin njohuri dhe aftësi që kanë të bëjnë me: konceptin e programimit në Ueb, funksionimin e detajuar të të gjithë elementëve të Ueb-it, rolin e HTML/CSS, JavaScript dhe të aplikacioneve në WEB.

Në këtë temë trajtohen ato njohuri të HTML/CSS që shërbejnë për krijimin e një faqe ueb funksionale. Prezantohet JavaScript si një gjuhë skript dhe e interpretueshme që realizon komponentët dinamik të një faqe Ueb. Shpjegohet roli që ka gjuha PHP në rritjen e performancës së Ueb-it . Gjithashtu, shpjegohet koncepti i aplikacioneve në Ueb për të bërë dallimin me elementët e tjerë të tij.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat e lëndës

- menaxhojnë dhe organizojnë të dhëna duke përdorur mjete gjuhen e programimit;
- mbajnë një koleksion të gjerë të produkteve digjitale që përputhen me konventat e prezantimit të TIK-ut, dhe i transformojnë ato sipas programeve të kërkuar.

Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës

- kuptojnë mënyrën se si është ndërtuar Ueb-i duke u nisur nga shembuj të thjeshtë;
- kuptojnë një tjetër koncept për editimin e tekstit WYSIWG (What you See is What You Get) që përfaqësohet nga programe si Word;
- njohin platforma të ndryshme komerciale për të krijuar faqet e tyre Ueb si DreamWaver, FrontPage, etj.;
- mësojnë si integrohet HTML me CSS;

Aftësitë për realizimin e kompetencave të lëndës

Nxënësi:

- krijojnë faqe WEB ne HTML duke përdorur Editor të thjeshtë si NotePad++;
- përzgjedhin individualisht platformat më të përshtatshme për ndërtimin e faqeve Ueb;
- ndërtojnë faqe Ueb dinamike duke përdorur JS;
- rrisin krijimtarinë dhe mundësinë e tyre për të ndërtuar faqe ueb më profesionale;

- mësojnë si të vendosin text, figura, link-e dhe tabela, ne faqen ueb duke përdorur HTML/CSS;
- njohin element më të avancuar të formatimit të tekstit si krijimi i listave, rregullimi i marxhinave të faqes dhe ndërtimi i tabelave;
- mësojnë të ndërtojnë formularët dhe njohin tipet e ndryshme të tyre;
- mësojnë rreth kornizave (frames) dhe bashkësive të kornizave (FrameSet) në HTML;
- kuptojnë nocionin e faqeve Ueb Statike dhe atyre dinamike;
- njohin bazat e JavaScript (JS), kuptojnë nocionin e një gjuhe Script dhe të interpretueshme;
- integrojnë JavaScript në HTML dhe krijojnë faqe dinamike;
- njohin elementët e një faqe WEB që mund të ndërtohen me JavaScript;
- njihen me konceptin e gjuhës PHP dhe avantazheve të saj në ueb;
- njohin elementët dhe hapat që duhen ndjekur për publikimit të një faqe ueb;
- njihen me konceptin e aplikacioneve në ueb si Java-applets.

- bëjnë dallimin midis gjuhëve të programimit të orientuara për ueb dhe atyre për aplikacione;
- strukturojnë konceptin për WEB dhe skemën inxhinierike të ndërtimit të tij.

Qëndrimi dhe vlerat

Nxënësit:

- kanë një koncept shumë të strukturuar dhe inxhinierik për ndërtimin e ueb-it dhe funksionimin e tij;
- rrisin kreativitetin duke krijuar faqe ueb të larmishme në saj të njohurive të plota mbi elementët e ndërtimit të faqeve ueb;
- adaptohen lehtë ndaj platformave të ndryshme komerciale që ekzistojnë në treg për ndërtimin e faqeve ueb;
- përzgjedhin platformat që u përshtaten më mirë gjë që çon në nxitjen e vlerësimit kritik.

Aktivite të sugjeruara

- nxënësit kanë njohuri për ndërtimin e faqeve ueb. në një orë praktike nxënësit realizojnë një faqe ueb me të gjithë komponentët që ato kanë mësuar duku i përshtatur një tematike, si p.sh. gatimit, turizmit, apo edhe një sitë mbi aktivitetin e tyre si nxënës;
- reflektim dhe diskutim për platformat më të mira për ndërtimin e faqeve ueb sipas eksperiencës së tyre;
- diskutojnë për mundësitë e publikimit të faqes tyre ueb, opsionet më të lira, çfarë duhet bërë për të pasur një domain;
- përdorin template të gatshme në internet për ndërtimin e faqeve ueb;
- akumulojnë informacion mbi site-t më të përdorura për shkarkimin e template të gatshme, tutorialeve më të mira për HTML/CSS dhe forumeve më të përdorura për të postuar pyetje të ndryshme apo për të gjetur përgjigje.

8.4 Tematika: Programimi dhe Algoritmika

Përshkrimi i tematikës

Në këtë tematikë nxënësit zhvillojnë dhe aplikojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre që kanë të bëjnë me : Konceptet elementare të programimit, çfarë janë gjuhët e programimit, përse shërbejnë ato. Ne si përdorues apo si programues? Synohet që kjo tematikë ti aftësojë nxënësit të kuptojnë fazat e krijimit të një programi të thjeshtë, siç janë njohja dhe analiza e problemit, krijimi i algoritmit përkatës, hartimi i kodit të programit, ekzekutimi dhe testimi i tij. Nëpërmjet algoritmeve nxënësit zhvillojnë arsyetimin logjik pa u ngarkuar me probleme të vështira programimi. Ata fillimisht do njohin konceptin e bllokskemës dhe algoritmit, më pas do t'u ofrohet mundësia që të njihen me sintaksën bazë të një gjuhe programimi mjaft të përdorur siç është gjuha C++, duke u dhënë mundësi të krijojnë programet e tyre të thjeshta.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat e lëndës

Kreativiteti dhe inovacioni duke përdorur teknologjinë: përdor kompjuterin për të zhvilluar të menduarit krijues dhe konstruktiv apo për të nxitur inovacionin dhe kreativitetin.

- *Kërkimi dhe gjetja e informacionit:* përcakton strategjinë e kërkimit të informacionit; duke përdorur kompjuterin gjen, organizon, analizon, vlerëson, përpunon dhe përdor informacionin nga një shumëllojshmëri e burimeve dhe mediave; përzgjedh burimet e informacionit apo mjetet digjitale bazuar në përshtatshmërinë tyre për kryerjen dhe zgjidhjen e një sërë detyrave.
- *Mendimi kritik, zgjidhja e problemit dhe vendimmarrja:* vlerëson sistemet e informacionit dhe zgjidhjet e tyre në termat e mbledhjes së kërkesave, të rejave dhe qëndrueshmërisë.
- *Operacionet bazë dhe konceptet teknologjike:* Shpjegon se si sistemet e informacionit dhe zgjidhjet e tyre përmbushin nevojat duke marrë parasysh qëndrueshmërinë.

Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës

- familjarizohen me konceptet dhe praktikat kompjuterike dhe analizojnë një algoritëm të thjeshtë për zgjidhjen e disa problemeve;
- njohin si të shkruajnë algoritmet;
- ndërtojnë bllokskemat e algoritmeve përkatëse;
- njohin gjuhët e programimit dhe konceptet bazë të tyre;
- konceptojnë programimet kompjuterike në kontekstin e Scratch.(duke u nisur nga një projekt bosh, deri në finalizimin e tij);
- njohin fazat që kalon një program;

Aftësitë për realizimin e kompetencave të lëndës

Nxënësi:

- konceptojnë algoritmet dhe prezantimin e tyre në diagrame dhe vlerësojnë algoritmet dhe programet përmes gjurmimit dhe testimit të rasteve;
- kuptojnë disa algoritme kyçe që reflektojnë të menduarit kompjuterik për shembull, ato për klasifikim dhe kërkim;
- përdorin arsyetim logjik për të krahasuar dobinë e algoritmeve alternative për të njëjtin problem;
- zbatojnë konceptet e programimit modular, duke aplikuar funksionet dhe procedurat;

<ul style="list-style-type: none"> ▪ krijojnë eksperiencë për gjetjen e burimeve/metodave të ndryshme që mbështesin krijimet e tyre kompjuterike; ▪ futen në konceptet e programimit dhe praktikojnë kompilimin dhe ekzekutimin duke punuar në projekte të tyre; ▪ njohin strukturat e të dhënave, nocionet e konstanteve dhe variabileve, tipeve standarte, dhe operacioneve të hyrjeve dhe daljeve; ▪ përzgjedhin strukturat e të dhënave për zgjidhjen e problemeve të ndryshme; ▪ njohin mjetet që duhen për të ndërtuar një program; ▪ ekzekutojnë ushtrime të thjeshta në gjuhën Scratch; ▪ përdorin software dhe burime online për të krijuar produkte; ▪ përdorin një gamë të gjerë të mjeteve TIK për produktet; ▪ krijojnë me materiale të importuara. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ përdorin të paktën një gjuhë programimi, për të zgjidhur një sërë problemesh që lidhen me lëndët e tjera; ▪ forcojnë arsyetimin logjik duke u mbështetur në logjikën Booleane.
<p>Qëndrimi dhe vlerat</p> <p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ ka qëndrim aktiv drejt mbledhjes dhe organizimit të informacionit; ▪ vlerëson aspektet pozitive të teknologjive për korrigjimin e informacionit; ▪ është i motivuar të kërkojë informacion dhe ta paraqesë për aspekte të ndryshme të jetës së tij/asaj; ▪ është kurioz rreth sistemeve të informimit dhe funksioneve të tyre. 	
<p>Aktivitete të sugjeruara</p>	

- Analizojnë dhe përshkruajnë një gjuhë programimi që përdoret më shumë. Bëjnë një historik të shkurtër se për çfarë ajo është dizenuar. Përshkruajnë kodin e burimit, algoritmet specifik dhe logjikën formale brenda saj. Diskutojnë për rëndësinë e njohjes së gjuhëve të programimit.

8.5 Tematika: JAVA

Përshkrimi i tematikës

Nxënësit marrin njohurit për të programuar nëpërmjet gjuhës JAVA, dhe mësojnë të krijojnë programe të thjeshta duke përdorur këtë gjuhë, ata zhvillojnë njohuri thelbësore rreth karakteristikave kryesore të kësaj gjuhe programimi, si sintaksa e saj e veçantë dhe paradigmat e programimit të orientuar nga objekti. Nxënësit eksplorojnë dhe testojnë mjete të ndryshme për të zhvilluar programe në Java, duke përfshirë mjete të integruara për zhvillues (IDEs). Gjithashtu, ata kuptojnë dhe aplikojnë tipet e ndryshme të programeve në Java, duke përfshirë aplikacione dhe applets.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat e lëndës

- Zhvillojnë programe të thjeshta duke përdorur sintaksën dhe konceptet e programimit objekt në Java.
- Zhvillojnë aftësi për të analizuar dhe zgjidhur probleme të ndryshme duke përdorur një përfaqje sistematike dhe të strukturuar.
- Aplikojnë konceptet e programimit të orientuar nga objekti, duke përfshirë klasat, objektet, trashëgiminë, polimorfizmin, dhe inkapsulimin.

Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës

- njohin karakteristikat kryesore të programit JAVA;
- njohin dhe testojnë platforma (Integrated Development Environment) të ndryshme për ndërtimin e programeve në Java;
- kuptojnë tipet e programeve të JAVA-s : Java për aplikacione dhe për Ueb (java applications dhe applets);

Aftësitë për realizimin e kompetencave të lëndës

Nxënësi:

- njohin dhe adaptohen ndaj platformave të ndryshme në treg për ndërtimin e programeve;
- testojnë programet, identifikojnë problemet dhe vetë-korrigjohen;
- kontribuojnë zgjidhjen e problemeve të hasura gjatë kompilimit dhe ekzekutimit të programeve;

<ul style="list-style-type: none"> ▪ njohin nocionin e programimit të orientuar nga objekti; ▪ krijojnë një program të thjeshtë në JAVA duke implementuar konceptet e programimit objekt. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ forcojnë aftësinë për të qenë preciz dhe për të pasur një logjik të pastër për zgjidhjen e problemeve; ▪ demonstrojnë ndërgjegjësim për të rejat e fundit teknologjike dhe pajisjet e reja.
<p>Qëndrimi dhe vlerat</p> <p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ rritja e shkallës së pavarësisë në punë; ▪ ndërgjegjësohen për dallimin midis gjuhëve të programimit në ueb dhe atyre të aplikacioneve; ▪ forcojnë arsyetimin logjik për zgjidhjen e problemeve; ▪ ndërgjegjësohen për ndihmën ndaj kolegëve. 	
<p>Aktivitete të sugjeruara</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Lejoni nxënësit të zgjedhin temat e tyre për të zhvilluar aplikacione të vogla në Java. Nxënësit mund të punojnë në projektet e tyre, duke përdorur njohuritë e tyre për të krijuar aplikacione të ndryshme dhe për të ndjekur një proces të strukturuar të zhvillimit të programit. ▪ Ofroni ushtrime të ndryshme për zgjidhjen e problemeve në Java për të lejuar nxënësit të praktikojnë njohuritë e tyre dhe për të zgjeruar aftësitë e tyre në programim. 	

9. Udhëzime metodologjike

Përdorimi i metodologjive efikase në procesin e të nxënësve është kusht në rritjen e cilësisë së arritjeve nga ana e nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin që zotëron brenda vetes. Mësimdhënia në lëndën e TIK-ut, synon gjithëpërfshirjen, motivimin, barazinë në të gjitha aspektet dhe bazohet në mësimdhënien dhe nxënien bazuar në kompetenca, në mësimdhënien me në qendër nxënësin dhe në mësimdhënien e nxënien e integruar.

Nxënësit e një klase janë të ndryshëm për sa i përket mënyrës se si ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve konkrete etj. Përpos kësaj, lënda e TIK-ut kërkon që nxënësit të zotërojnë kompetencat kyç, të përvetësojnë konceptet, të zotërojnë shprehjet. Të dyja këto kushte diktojnë nevojën për strategji të ndryshme të mësimdhënies, të cilat përshtaten me objektin e të nxënësve dhe nevojat e nxënësve.

Një mësimdhënie e mirëmenduar dhe e mirëplanifikuar krijon kushtet e nevojshme për një nxënie të suksesshme dhe lehtëson, si punën e mësuesit, ashtu edhe atë të nxënësit. Nxënësit janë aktivë, kur përfshihen në veprimtari, hulumtime, ndërtime ose simulime të njohurive, aftësive, krahasime të rezultateve apo nxjerrje konkluzionesh. Për të siguruar këtë pjesëmarrje aktive të nxënësve, mësuesi duhet të krijojë një atmosferë që i bën ata të ndihen të lirshëm dhe të zhdërvjellët për të zhvilluar njohuritë e tyre në këtë lëndë.

Projektet kurrikulare lejojnë nxënësin të zbatojë njohuritë dhe aftësitë që zotëron nga njëra anë, dhe nga ana tjetër nxënësi arrin të krijojë lidhje integruese me fushat/ lëndët e tjera. Edhe paraqitjet e projekteve, diskutimet, gjatë realizimit të tyre janë mundësi shumë e mirë për përvetësimin e njohurive dhe aftësive të marra në lëndën e TIK-ut por mbi të gjitha të kompetencave kyçe.

Ora e mësimi duhet të bazohet në një tematikë të përshtatur për moshën e nxënësit. Kompjuteri përdoret si mjet për të luajtur me programet, qoftë lojëra zbavitëse mësimore, qoftë programe për shkrim, prerje, prezantime, kërkim në internet ose komunikim. Në këtë mënyrë nxitet kreativiteti, zhvillohet motorika dhe nxitet të menduarit për zgjidhjen e problemeve. Suksesi i kësaj ore mësimore pasqyrohet sidomos në lirinë e fituar të nxënësit për t'i përdorur mjetet e TIK-ut. Nëpërmjet punës në grupe nxënësi vlerëson bashkëpunimin me shokët e shoqet e klasës, krijon lirshmërinë e vendimmarrjes dhe të përgjegjësisë ndaj komunitetit. Njohuritë e përftuara gjatë orës mësimore bëhen më konkrete dhe më të realizueshme nëse detyrat lidhen edhe me veprimtaritë në shkollë dhe me veprimtaritë që nxënësit mund të realizojnë jashtë shkollës. Puna në grup jep mundësi për

debat ose konsultim. Kështu zhvillohet përgjegjësia ndaj komunitetit ose komunikimi me të tjerë, duke fituar siguri vetjake, aftësi në përdorimin e saktë të mjeteve të TIK-ut me një synim të caktuar.

Për nxënësit do të ishin të përshtatshme edhe metodat gjysmë kërkimore për një problem të caktuar. Këto metoda i nxisin nxënësit të kërkojnë vetë në fillim zgjidhjen e problemit dhe më pas, të punojnë në grup për zgjidhjen e plotë të tij. Gjatë këtyre hapave mësuesi ka rolin e lehtësuesit dhe i ndihmon ata të shkojnë drejt zgjidhjes së duhur. Për zhvillimin sa më të mirë të kompetencës digjitale të nxënësit po dhe të kompetencave të tjera kyçe është rëndësishme që gjithë ora e mësimit të jetë e bazuar në situata konkrete të cilat e kërkojnë zgjidhjen e problemit nëpërmjet të mësuarit duke bërë gjithashtu përpunimin e njohurive nëpërmjet punëve praktike.

10. Udhëzime për vlerësimin

Në përputhje me parimet e qasjes së të nxënësive bazuar në kompetenca, vlerësimi konsiderohet si element i mësimdhënies i cili përqendrohet në nivelin e arritjes së kompetencave. Informacioni i siguruar nga vlerësimi i ndihmon mësuesit të kuptojnë anët e dobëta dhe anët e forta të nxënësve në përmbushjen e kompetencave, u jep mundësi të përmirësojnë mësimdhënien dhe të pajisin nxënësin me informacionin përkatës për progresin e tij. Vlerësimi i përmbajtjes lidhet me zotërimin e njohurive dhe demonstrimin e aftësive digjitale nëpërmjet treguesve të besueshëm për progresin e tyre. Në përzgjedhjen e praktikave të vlerësimit, në përcaktimin e kohës së përshtatshme dhe në përzgjedhjen e materialeve duhen pasur parasysh:

- përcaktimi i qëllimit dhe i strategjisë së vlerësimit;
- përzgjedhja e teknikave dhe e instrumenteve të vlerësimit;
- përzgjedhja e veprimtarive që mundësojnë demonstrimin e arritjes së kompetencave;
- përdorimi i vlerësimit për të verifikuar çfarë dinë aktualisht nxënësit;
- dallimi i qartë i qëllimit të detyrës së zgjedhur për vlerësim;
- adresimi i vlerësimit të njohuritë, shprehjet dhe aftësitë ;
- reflektimi i besimit që të gjithë nxënësit mund t'i përmirësojnë arritjet;
- informacioni për rezultatet e vlerësimit motivon nxënësin, të pranojë se gabimi është pjesë e të nxënësive dhe të ndihmojë progresin e mëtejshëm;

- vlerësimi duhet të konsiderohet si pjesë e procesit të mësimdhënie-nxënies dhe jo si veprimtari më vete;
- vlerësimi ndihmon nxënësin të marrë përgjegjësi për veten e tyre, duke përfshirë strategji të vetëvlerësimit dhe të vlerësimit të njëri - tjetrit;
- vlerësimi të jetë gjithëpërfshirës, në kuptimin që t'u sigurojë mundësinë të gjithë nxënësve të demonstrojnë arritjet e tyre.

Vlerësimi është pjesë integrale e procesit të të nxënit. Ai mat shkallën në të cilën kompetencat janë arritur nga nxënësi. Ai përfshin mbledhjen e informacioneve me anë të teknikave të ndryshme të vlerësimit për arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënit në nivel klase dhe shkalle të nxënësit. Me këtë informacion, mësuesi merr vendime për vlerësimin përfundimtar të nxënësve, bazuar në gjykimin e tij për nivelin e zotërimit të kompetencave të lëndës nga ana e nxënësit. Ndërsa vlerësimi u shërben shumë qëllimeve, është e rëndësishme që mësuesi t'ia përshtatë llojin e vlerësimit, qëllimit specifik të synuar. Para marrjes së një gjykimi në lidhje me një aspekt të caktuar të performancës së nxënësit, mësuesi duhet të sigurojë që mënyra e vlerësimit të përdorur të sigurojë informacionin që reflekton saktësisht një aspekt të veçantë të performancës që ka për qëllim të vlerësojë mësuesi. Përdorimi i TIK-ut gjithashtu ndihmon bërjen e vlerësimeve dhe raporteve më efektive për nxënësit dhe mësuesit. Gjatë procesit të vlerësimit në klasë mësuesit duhet të kenë në fokus vlerësimin e arritjeve të nxënësve dhe realizimit të kompetencave kyçe, por dhe kompetencave lëndore.

Vlerësim diagnostikues që zakonisht kryhet në fillim të shkollës apo vitit shkollor, për të identifikuar njohuritë paraprake, interesat ose aftësitë që kanë nxënësit rreth asaj për të cilën po kryhet vlerësimi. Ky informacion përdoret për të orientuar praktikatat e mësimdhënies të mësuesit dhe të nxënit e nxënësve, në mënyrë që të përcaktohen teknikat korrigjuese.


Vlerësim formues ose vlerësimi për të nxënit që është një proces që ndodh gjatë gjithë kohës në klasë dhe informon nxënësit dhe prindërit mbi progresin e nxënësve. Të dhënat dhe informacioni i mbledhur nga vlerësimi për të nxënë përdoren për të përmirësuar procesin e mësimdhënie - nxënies. Fokusi i vlerësimit formues nuk duhet të jetë vlerësimi me notë i nxënësit, por duhet të ndihmojë nxënësin që të përmirësojë të nxënësit e tij.

Vlerësim përmbledhës ose vlerësim i të nxënit që kryhet për të përcaktuar çfarë është mësuar pas një periudhe kohe dhe shoqërohet me notë. Vlerësimet përmbledhëse përdoren jo vetëm për të informuar nxënësit e prindërit për progresin e nxënësve, por edhe për të përmirësuar praktikatat

e mësimdhënies dhe të nxënit. Ky vlerësim konsiderohet si vlerësimi i të nxënit dhe i arritjeve të nxënësit. Gjatë vlerësimit mësuesi duhet të mbështetet në një sasi të konsiderueshme të dhënash që përfshihen në këto elemente:

- vlerësimi i përgjigjeve të dhëna nga nxënësi;
- vlerësimi i punës në grup;
- vlerësimi i aktivitetit gjatë debateve në klasë;
- vlerësimi i detyrave të shtëpisë;
- vetëvlerësimi i nxënësit;
- vlerësimi i nxënësve për njëri – tjetrin;
- vlerësimi i detyrave praktike;
- detyrat përmbledhëse në përfundim të një kohe të caktuar ose në fund të vitit shkollor.

Hapat që mund të ndiqen për krijimin e një metodologjie vlerësimi që ndihmon në krijimin dhe vlerësimin e situatës



11. Materialet dhe burimet e mësimdhënies

Si në të gjitha lëndët, tekstet shkollore ofrojnë një burim të vlefshëm për mësimdhënien dhe të nxënit, megjithatë shumë nga aftësitë praktike të TIK-ut mësohen më mirë nëpërmjet demonstrimit të mësuesve. Për arritjen me sukses të kompetencave në fushën e TIK-ut dhe teknologjisë është e rëndësishme të përdoren materiale dhe burime mësimore që japin një informacion të kuptueshëm për moshën e nxënësit dhe që e ndihmojnë atë të zhvillojë aftësi, shkathësi, njohuri dhe qëndrime të nevojshme për të mësuarin gjatë gjithë jetës. Njëri nga burimet e thjeshta mësimore, që përdoret shpesh nga nxënësit dhe mësuesit, është teksti mësimor. Mirëpo me zhvillimin e shpejtë të teknologjisë dhe të shtimit të informacionit digjital, mësuesi duhet ta shohë tekstin më tepër si një burim nxitës, por jo të mjaftueshëm për të zhvilluar kompetencat kyçe të nxënësit. Mësuesit mund të bashkëpunojnë online me mësues të shkollave të tjera për të gjetur burime të besueshme informacioni, që u vijnë në ndihmë jo vetëm nxënësve për të zhvilluar aftësitë e tyre, por edhe mësuesve për të zhvilluar një qasje të re metodike. Nëpërmjet rritjes së shumëllojshmërisë së burimeve në nxësim më shumë nxënësit të zhvillojnë mendimin kritik, krijues dhe problemzgjdhës gjatë procesit mësimor. Disa nga burimet që mund të përdoren nga mësuesit për zhvillimin e orës mësimore mund të jenë: bibliotekat elektronike, broshurat informuese apo ndërgjegjësuese, enciklopeditë, software elektronike në funksion të mësimdhënies/mësimnxënies, studimet shkencore me fokus të teknologjia dhe TIK-u, etj... Gjithashtu në bashkëpunim me nxënësit dhe shkollat mund të organizohen seminare të ndryshme mësimore dhe punimet më të mira të publikohen dhe t'u vihen në dispozicion të gjitha shkollave. Në ditët e sotme, ndodh shpesh që nxënësi të jetë një hap përpara mësuesit për sa u përket informacioneve elektronike, prandaj mësuesit mund të krijojnë forume mësimore bashkë me nxënësit për të krijuar materiale në ndihmë të procesit mësimor.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA E SIGURIMIT SË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

PROGRAMET E KULTURËS SË PËRGJITHSHME
TË ARSIMIT TË MESËM PROFESIONAL

Lënda: Histori
Klasa: X

Struktura 2+1+1, Struktura 2+2 dhe Bllok 4-vjeçar

TIRANË, 2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

PROGRAMET E KULTURËS SË PËRGJITHSHME

TË ARSIMIT TË MESËM PROFESIONAL

Lënda: Histori

Klasa: X

Struktura 2+1+1, Struktura 2+2 dhe Bllok 4-vjeçar

2024

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT TË HISTORISË

1. HYRJE

2. KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT

2.1. Qëllimi i programit të historisë

2.2. Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës

2.3. Lidhja e lëndës së historisë me temat ndërkurrikulare

2.4. Lidhja e lëndës së historisë me fushat/lëndët e tjera kurrikulare

2.5. Kompetencat dhe konceptet historike

2.6. Cilësitë historike të nxënësit

3. KLASA X

3.1. Përmbajtja e kurrikulës

3.2. Rezultatet e të nxënit për kompetencat dhe konceptet historike

3.3. Koha mësimore

3.4. Klasa e dhjetë, aftësi/shkathtësi, qëndrime, koncepte dhe veprimtari të sugjeruara

4. UDHËZIME METODOLOGJIKE

4.1. Materiale dhe burime mësimore

5. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

Aneks 1. Rekomandimet Rek (2001)15 e Komitetit të Ministrave të Shteteve anëtare lidhur me mësimin e historisë në Evropë në shekullin XXI.

TABELA, DIAGRAMA DHE FIGURA

Diagrami 1.	Korniza konceptuale e programit
Diagrami 2.	Rezultatet kryesore të të nxënit sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së historisë
Diagrami 3.	Lidhja ndërmjet lëndës së historisë dhe fushave/lëndëve të tjera
Diagrami 4.	Kompetencat dhe konceptet e lëndës së historisë
Diagrami 5.	Cilësitë historike të nxënësit
Tabela 1.	Kompetencat e lëndës dhe përshkrimi i tyre
Tabela 2.	Konceptet e lëndës dhe përshkrimi
Tabela 3.	Rezultatet e të nxënit për kompetencat dhe konceptet historike
Tabela 4.	Koha mësimore për tematikë për klasën dhjetë
Tabela 5.	Përforcimi i qasjes kërkimore
Figura 1.	Procesi i kërkimit historik

Koordinoi programin:
Ines Todhe

1. HYRJE

Lënda e historisë është thelbësore në zhvillimin e qytetarëve, të cilët i kuptojnë çështjet aktuale me zgjuarsi, nëpërmjet kuptimit, analizës dhe përfundimeve të nxjerra nga përvojat e së shkuarës.

Studimi i lëndës së historisë i ndihmon nxënësit të zhvillojnë një ndjenjë humanizmi të gjerë, të kuptojnë zhvillimin e personalitetit të tyre, mënyrën si ata ngjasojnë dhe diferencohen nga të tjerët në raport me kohën dhe me hapësirën, të dallojnë diferencën midis supozimit dhe faktit, të mos besojnë në përgjigjen e paargumentuar dhe të respektojnë vërtetësinë e burimeve historike, duke dalluar analogjinë false, të njohin abuzimet nga “mësimet” historike, të peshojnë pasojat që vijnë prej tyre, si dhe të marrin parasysh se padija për të shkuarën na bën “të burgosurit” e saj.

Ndryshimi është aspekti thelbësor i historisë dhe për këtë arsye është dhe një ndër konceptet bazë të studimit në programin e historisë. Ndërsa lëndë të tjera të fushës “Shoqëria dhe Mjedisi” studiojnë aspekte të ndryshme të jetës së njerëzimit, si: institucionet, traditat kulturore, ekonominë, ligjet etj., lënda e historisë kryesisht, synon të merret me shpjegimin e mënyrës se si të gjitha këto aspekte janë zhvilluar dhe kanë ndryshuar gjatë historisë së tyre. Në këtë mënyrë, nxënësit do të mësojnë rëndësinë që ka ndryshimi për të gjitha përvojat njerëzore, për kompleksitetin dhe mënyrat e ndryshme në të cilat bashkëveprojnë të gjitha këto përvoja.

Detyra e programit të historisë është të drejtojë nxënësit për t'u bërë pjesëtarë të përgjegjshëm të shoqërisë, të cilët dinë se si të trajtojnë në mënyrë kritike një fenomen të epokës së tyre dhe të së shkuarës. Nëpërmjet programit të historisë, nxënësit kuptojnë se kultura e tyre dhe kulturat e tjera përbëjnë rezultatin e një procesi historik.

Programi i historisë i ndihmon nxënësit që të bëhen të ditur, të logjikshëm, kureshtarë, të balancuar, të ndjeshëm dhe individë të aftë për të dhënë argumente dhe vendime të arsyetuara mirë.

Këto cilësi mbështesin nxënësit në zhvillimin e qëllimeve, kompetencave kyçe dhe rezultateve të dëshiruara të arsimit parauniversitar, në mënyrë që ata të jenë individë të përgatitur, të aftë për të kontribuar ndaj kombit dhe të aftë për t'iu përgjigjur zhvillimeve globale.

2. KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT

Hartimi i programit për lëndën e historisë në arsimin profesional rrjedh nga Korniza Kurrikulare e arsimit parauniversitar, kurrikulat bërthamë, plani mësimor, dhe Rekomandimet Rek (2001)15 të Komitetit të Ministrave të Shteteve anëtare lidhur me mësimin e historisë në Evropë në shekullin XXI¹.


Si i tillë ky dokument i shërben:

- **Nxënësit** për zhvillimin e kompetencave kyçe të të nxënës gjatë gjithë jetës dhe të kompetencave të lëndës së historisë, në mënyrë që ai të përballojë sfidat e jetës dhe të integrohet në shoqëri.
- **Mësuesit** për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe arritjet e nxënësit në klasë dhe jashtë saj.
- **Prindit** për njohjen e rezultateve të pritshme të fëmijëve dhe kriteret e vlerësimit në periudha të caktuara.
- **Hartuesit** të teksteve mësimore dhe të materialeve ndihmëse për mësuesit dhe nxënësit, të cilët përmes përmbushjes së qëllimeve të programit në tekstet e tyre, bëhen një faktor i rëndësishëm progresi në mësimdhënien e lëndës së historisë dhe në ndërtimin e kompetencave të lëndës dhe kompetencave kyçe të të nxënës gjatë gjithë jetës.

Programi i historisë në qendër të tij vendos krijimin e kushteve për ndërtimin e kompetencave të lëndës dhe të kompetencave kyçe që lidhen me to, për të gjithë nxënësit e arsimit bazë.

Programi paraqet temat ndërkurrikulare, ku realizimi i tyre nëpërmjet lëndës së historisë është një komponent i rëndësishëm i programit për kontributin e historisë në shoqëri dhe në jetën e përditshme. Programi përshkruan lidhjen e historisë me fushat e tjera.

Diagrami 1. Korniza konceptuale e programit



2.1. Qëllimet e programit të historisë

Programi i historisë në arsimin profesional ka për qëllim të pajisë nxënësit me aftësi dhe cilësi intelektuale nëpërmjet zhvillimit dhe ndërtimit të një sërë konceptesh dhe kompetencash lëndore, të cilat u krijojnë atyre mundësi të analizojnë në mënyrë kritike informacionin, lidhjet shkak-pasojë, të interpretojnë burimet, të ndërtojnë shpjegime të arsyetuara dhe argumentuara dhe të vlerësojnë interpretimet e ndryshme për të shkuarën.

Programi i historisë në arsimin profesional lidh vlerat e të mësuarit të historisë me qëllimet e arsimit parauniversitar, me kompetencat kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës dhe Rekomandimet Rek (2001)15 të Komitetit të Ministrave të Shteteve anëtare, për mësimdhënien e historisë në shekullin e XXI, duke ndërtuar tek nxënësi konceptet, kompetencat dhe cilësitë historike, nëpërmjet:

- pajisjes me dijet dhe kompetencat e nevojshme historike për të kuptuar të tashmen dhe ndikimin e saj në zhvillimet historike të së ardhmes;
- krijimit të mundësive për të ndërtuar dije, shkathtësi, qëndrime dhe vlera, për zhvillimin e qytetërimeve antike, mesjetare moderne dhe bashkëkohore në vend, rajon dhe botë;
- angazhimit në mënyrë aktive në kërkimin historik me qëllim që të zhvillojë vetëbesimin, reflektimin dhe mendimin kritik;
- zhvillimit të aftësive/shkathtësive të kërkimit historik, duke u bazuar në burime historike për studimin e ngjarjeve të ndryshme të historisë;
- interpretimit të efektit të kohës, të vazhdimësisë dhe të ndryshimit në marrëdhëniet historike dhe rolin e tyre në perspektivat e së ardhmes;
- interpretimit të historisë së shoqërisë njerëzore në të kaluarën, në mënyrë që nxënësit të kuptojnë të sotmen;
- kuptimit se si dhe pse ngjarje dhe çështje të veçanta historike janë interpretuar në mënyra të ndryshme;

- zhvillimit të aftësive për të analizuar dhe për të interpretuar informacionin historik në mënyrë kritike dhe të përgjegjshme, nëpërmjet dialogut, kërkimit të së vërtetës dhe përmes debatit të hapur, sidomos për çështje të ndjeshme historike;
- ndërveprimet me individë dhe grupe individësh të kulturave të ndryshme për të njohur të kaluarën dhe për të kuptuar ndërveprimin e saj me të sotmen, duke nxënë, analizuar dhe menduar në mënyrë kritike;
- mundësimin të ndërtimit të identitetit individual dhe kolektiv përmes njohjes dhe krahasimit të trashëgimisë së tyre historike të përbashkët;
- vlerësimin të pozitës së qytetërimit shqiptar në raport me qytetërimet botërore;
- argumentimin të vlerave të trashëgimisë historike, duke e vlerësuar këtë trashëgimi si pjesë të përcaktimit të identitetit të një populli;
- zhvillimit të aftësive qytetare, të cilat kontribuojnë në rritjen e tyre personale si individë, në përgatitjen e tyre në jetë, në punë dhe në shoqëri;
- ndërtimit të aftësive për të kuptuar, organizuar dhe komunikuar dijet e tyre historike përmes mënyrave të ndryshme dhe përdorimit të mediave të ndryshme;
- pajisjes me kompetencat e duhura për të kontribuar në mënyrë aktive dhe me përgjegjësi si qytetarë lokalë dhe globalë në ndërtimin e perspektivës;
- forcimit të ndjenjës së identitetit kombëtar dhe të respektit për historinë kombëtare, me qëllim zgjerimin e përmasave evropiane në studimin e historisë.

2.2. Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës

Ndërtimi dhe zbatimi i kompetencave kyçe nga nxënësit gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies, kërkon që mësuesi të mbajë parasysh lidhjen e kompetencave kyçe, me kompetencat e lëndës për secilën shkallë të kurrikulës. Kompetenca përcaktohet si integrimi i njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve që një nxënës duhet t'i fitojë gjatë procesit të nxënies. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje,

mësuesi duhet të përzgjedhë situatat, veprimtaritë, metodat, dhe mjetet e përshtatshme të procesit të të nxënit. Nëpërmjet studimit të historisë, nxënësit mësojnë se si të paraqesin një problem, që ata e kanë realizuar nëpërmjet përvetësimit dhe ndërtimit të dijeve dhe kompetencave historike, për një temë të caktuar.

Kur nxënësi zbaton kompetencat historike, ai njëkohësisht është duke zbatuar dhe kompetencat kyçe. P.sh. kompetenca historike “Kërkimi historik”, përfshin shumë nga strategjitë e zgjidhjes së situatave të ndryshme problemore në shoqëri dhe në jetën e përditshme. Për të zgjidhur problemin, ata duhet të kërkojnë, të mbledhin, të gjejnë, dhe të sintetizojnë informacione nga burimet primare, sekondare dhe informacionet me gojë, me shkrim, dhe ato vizuale.

Ata duhet të dinë ku të kërkojnë informacion, cilat informacione do t'i ndihmojnë ata për të ndërtuar një argument, si të interpretojnë informacionin e gjetur, si të strukturojnë marrëdhëniet komplekse shkakore, si të vlerësojnë saktësinë e burimit dhe si të krahasojnë gjetjet e tyre me faktet historike. Ata mësojnë të komunikojnë gjetjet e tyre dhe i komunikojnë ato për audiencë të ndryshme. Pra gjatë zhvillimit të kompetencave historike, nxënësi zhvillon gjithashtu kompetencat kyçe në lidhje me zgjidhjen e problemit, krijimtarinë, inovacionin, përpunimin e informacionit, prezantimin e detyrave, punën në grup, komunikimin efektiv etj.

Për të realizuar lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës mësuesi ndjek këto hapa:

- përzgjedh përmbajtjen mësimore, mjetet didaktike, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënit të kompetencave të historisë në një vit mësimor, si dhe rezultatet e të nxënit për kompetencat kyçe në një vit mësimor;
- planifikon mësimdhënien, duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do të arrijë rezultatet e të nxënit, për kompetencat kyçe brenda vitit shkollor;
- kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave, projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënit për vit mësimor dhe shkallë, për lëndën e historisë.

Diagrami 2. Rezultatet kryesore të të nxënit sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së historisë

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit

- Zhvillon kompetencën e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.
- Përdor funksionet gjuhësore të teksteve historike, duke përfshirë fjalorin historik, fjali të ndërtuara saktë për përshkrimin e ngjarjeve, fjali komplekse për shpjegimin e marrëdhënieve shkak-pasojë, përdorimin e gjerë të emrave, ndajfoljeve dhe mbiemrave për të përshkruar vendet, njerëzit dhe ngjarjet.

Kompetenca e të menduarit

- Zhvillon kompetencën e të menduarit për realizimin e kërkimit historik.
- Zhvillon mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të interpretuar të shkuarën nëpërmjet informacionit, për të dhënë argumenta bazuar në burime dhe për të saktësuar saktësinë e burimeve;
- Zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës, që janë të diskutueshme.
- Analizon të dhënat numerike për të kuptuar të shkuarën, për shembull për të kuptuar shkakun dhe pasojën, vazhdimësinë dhe ndryshimin.
- Ndërton dhe interpretojnë grafikë, diagrame, tabela statistikore, për paraqitjen e të dhënave historike.

Kompetenca e të nxënit

- Zhvillon kompetencën e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.
- Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme, i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
- Parashtron pyetje kërkimore dhe përgjigjet duke u bazuar në argumenta dhe burime.
- Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet për një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
- Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike.
- Vlerëson pikëpamjet e ndryshme si dhe menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e burimeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre në histori.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

- Zhvillon kompetencën për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin për të identifikuar dhe vlerësuar burimet e nevojshme për interpretimin e ngjarjes historike.
- Harton hapat që duhet të ndjekë për realizimin e një kërkimi historik për një ngjarje të dhënë.
- Zhvillon një kërkim individual ose në grup për kryerjen e një veprimtarie në histori.
- Diskuton individualisht ose në grup për rëndësinë që ka e shkuara në kuptimin e të tashmes dhe perspektivat e të ardhmes.
- Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një veprimtarie të përbashkët.

Kompetenca personale

- Zhvillon kompetencën personale për të kuptuar veten dhe të tjerët, ndryshimet dhe ngjashmëritë, për të menaxhuar marrëdhëniet ndërmjet njëri-tjetrit, vlerësuar pikëpamjet e të tjerëve qofshin këto dhe të ndryshme nga të tija;
- Kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave.
- Përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj. për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij.

Kompetenca qytetare

- Zhvillon kompetencën qytetare për të shqyrtuar në mënyrë kritike sjelljet, motivet dhe veprimet e njerëzve në të shkuarën që mund të jenë rezultat i ndryshimit të qëndrimeve shoqërore dhe standardeve të ndryshme.
- Shqyrton burimet historike për të kuptuar ngjarjet dhe zhvillimet që kanë ndikuar në shoqëri dhe grupe të ndryshme kulturore në kohëra të ndryshme, dhe shpjegon natyrën, shkaqet dhe pasojat e konflikteve dhe ndërvarësinë kulturore.
- Kupton se si qytetërimet dhe shoqëritë janë formuar nga grupe njerëzish me kultura të ndryshme, identifikon dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet kulturave të ndryshme dhe kultivon respekt ndaj kulturave të ndryshme nga e tija.
- Shqyrton burimet historike për të kuptuar çështjet shoqërore dhe se si parime të ndryshme kanë ndikuar në çështjet njerëzore.
- Zhvillon mirëkuptimin ndërkulturor, duke vlerësuar kulturat, gjuhët dhe besimet e ndryshme.
- Kupton perspektivat, besimet dhe qëndrimet e njerëzve në të shkuarën e në të tashmen dhe rëndësinë e njohjes së historisë së tyre dhe të tjerëve.
- Shpjegon orijentimin dhe zhvillimin e identitetit kombëtar duke vlerësuar trashëgiminë material dhe shpirtërore.
- Shqyrton një sërë burimesh që paraqesin perspektiva të ndryshme kulturore në mënyrë që të zhvillojë kuptimin historik.

Kompetenca digjitale

- Zhvillon kompetencën digjitale për të kërkuar, për të përzgjedhur, për të analizuar dhe për të komunikuar informacion historik.
- Akseson një sërë burimesh digjitale të informacionit dhe analizon në mënyrë kritike këto burime historike.
- Komunikon, prezanton dhe parashtron njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet.
- Bashkëpunon, diskuton dhe debaton me të tjerët për të ndërtuar konceptet dhe kompetencat historike.

2.3. Lidhja e lëndës së historisë me temat ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare, të cilat integrojnë fushat kurrikulare të të nxënësve, janë tema madhore, me të cilat përballet shoqëria tani dhe në të ardhmen. Zhvillimi i tyre ndihmon nxënësit të interpretojnë botën dhe të rritin lidhjen e arsimit me jetën dhe me interesat e saj. Trajtimi i këtyre temave në lëndën e historisë synon ndërtimin e disa njohurive specifike, zbatimin e disa aftësive, vlerave e qëndrimeve të caktuara të nxënësit për zhvillimin e tyre si qytetarë të së ardhmes, të cilët do të jenë të aftë për të bashkëvepruar në paqe me kultura të ndryshme, të aftë për të kontribuar në ndërtimin e një shoqërie demokratike dhe të aftë për të funksionuar në një botë të ndërvarur, duke nxitur zhvillimin e qëndrueshëm të saj.

Kurrikula e historisë është projektuar për të plotësuar nevojat e nxënësve duke paraqitur një program bashkëkohor. Temat ndërkurrikulare:

- identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave,
- të drejtat e njeriut, vendimmarrja morale,

- zhvillimi i qëndrueshëm,
- mjedisi, ndërvarësia,
- bashkëjetesa paqësore.

ofrojnë dimensione, të cilat pasurojnë programin mësimor nëpërmjet zhvillimit të përmbajtjes së fokusuar që përshtatet natyrshëm brenda tematikave të historisë.

Integrimi i këtyre temave gjatë zhvillimit të koncepteve dhe kompetencave historike aftëson nxënësit:

- për t'u bërë qytetarë aktivë dhe të përgjegjshëm në dimensionet lokale, kombëtare, rajonale, evropiane e globale, duke u mundësuar atyre të ndërtojnë identitetin individual dhe kolektiv përmes njohjes së trashëgimisë së tyre historike të përbashkët;
- për të ndërvepruar me individë dhe grupe individësh të kulturave të ndryshme, për të njohur të kaluarën dhe për të kuptuar ndërveprimin e saj me të sotmen, duke nxënë, analizuar dhe menduar në mënyrë kritike;
- për t'u edukuar me ndenjen e mirëkuptimit dhe të besimit të ndërsjellë midis popujve, nëpërmjet studimit të kulturës, të shkëmbimeve të shumanshme dhe të trashëgimisë;
- për të ndihmuar në formimin e një të ardhmeje më të mirë përmes kuptimit të asaj se si e shkuara ka lidhje me të tashmen dhe për të marrë vendime për një zhvillimi të qëndrueshëm të perspektivave historike;
- për të zhvilluar aftësitë qytetare, të cilat kontribuojnë në rritjen e tyre personale si individë, në përgatitjen e tyre në jetë, në punë dhe në shoqëri.

Gjatë realizimit të temave ndërkurrikuar nxënësi duhet të zgjidhë situata, duhet të përdorë aftësitë e mendimit kritik, krijues, të përdorë kompetencat historike si: kërkimin, përdorimin e burimeve, interpretimin dhe komunikimin për të shpjeguar, argumentuar dhe parashikuar perspektivat për çështje të ndryshme që lidhen me këto tema ndërkurrikulare.

2.4. Lidhja e historisë me fushat/lëndët e tjera kurrikulare

Lënda e historisë është një nga lëndët kryesore të fushës shoqëria dhe mjedisi. Njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat në lëndët e fushës shoqëria dhe mjedisi dhe në lëndët e tjera të fushave të të nxënit si: atyre të shkencave natyrore, arteve, gjuhës dhe komunikimit, matematikës, teknologjisë dhe TIK-ut, etj., integrohen mjaft mirë me ato të historisë. Integrimi i tyre mund të shikohet në nivelin e tematikave, të koncepteve dhe të kompetencave.

Lënda e historisë dhe lëndët e tjera duhet të integrohen në mënyrë të ndërsjellë me njëra-tjetrën. Vetëm në këtë mënyrë do të mund të realizohen si duhet kompetencat kyçe të të nxënit dhe qëllimet e shkollës dhe të shoqërisë, në fushën e arsimit.

Çfarë do të thotë kjo?

- Së pari, historia mund të përdorë njohuritë, konceptet dhe aftësitë, që trajtohen në lëndët e tjera për të ndërtuar, për të konkretizuar dhe për të argumentuar më mirë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat e saj.
- Së dyti, lëndët e tjera duhet të përdorin dijet dhe kompetencat historike për të aktualizuar dhe për të kuptuar më mirë çështjet e tyre në diskutim, si dhe për të nxitur përgjegjësinë dhe motivimin qytetar të nxënësve në shkollë dhe në bashkësinë ku jetojnë.

Diagrami 3. Lidhja ndërmjet lëndës së historisë dhe fushave/lëndëve të tjera

SHOQËRIA DHE MJEDISI

- Përdor hartën, globin dhe busullën për lokalizimin e territoreve ku kanë lindur dhe janë zhvilluar ngjarjet historike.
- Lexon dhe interpreton harta të ndryshme historike dhe gjeografike.
- Orientohet në hapësirë nëpërmjet hartës dhe globit, për të lokalizuar një territor të caktuar me vlera historike.
- Përcakton në hartë vendndodhjen e qytetërimeve ne periudha të ndryshme historike.
- Argumenton rëndësinë e relievit dhe të klimës në zhvillimin e qytetërimeve.
- Shpjegon termat migrim i jashtëm dhe i brendshëm i popullsisë, për të treguar lëvizjet e popujve dhe pasojat që ato sjellin në qytetërimi, gjatë periudhave të ndryshme të historisë.
- Tregon ç 'është mjedisi gjeografik, për të kuptuar ndikimin e tij në zhvillimin e qytetërimeve.
- Shpjegon konceptet: liri, barazi, të drejta, ligj, komb, shtet, etni, demokraci dhe kushtetutë, për të Shpjeguar zhvillimin historik të qytetërimeve.
- Analizon dhe interpreton organizimin e familjes, të institucioneve dhe të shoqërisë, për të përcaktuar tiparet e jetës së përditshme përgjatë periudhave historike.
- Shpjegon format e sistemeve të qeverisjes, për të shpjeguar organizimin shtetëror gjatë periudhave historike.
- Interpretimet e ndryshme fetare (politeizmi, monoteizmi, krishterimi, islamizmi)
- për të shpjeguar rolin e fesë në histori.

TIK

- Shfrytëzon simbolet për shkrimin e shekujve me shifra romake në kompjuter.
- Përdor programet kompjuterike për shkrimin e një materiali historik.
- Përdor programet kompjuterike për prezantimin e një detyre në histori.
- Përdor internetin për nxjerrjen e të dhënave për ngjarje dhe për figura historike.
- Përdor programet kompjuterike për të ndarë mendime detyra dhe informacionin historik me moshatarët e tij.

GJUHËT DHE KOMUNIKIMI

- Interpreton tekste dhe forma të ndryshme të komunikimit, përfshirë atë historik.
- Shpreh opinione, arsyeton, diskuton, argumenton dhe bën debate argumentuese me tematikë historike.
- Përzgjedh informacionin e duhur historik në tekst.
- Shfrytëzon rregullat e drejtshkrimit për shkrimin e një materiali historik.
- Dallon gjinitë e ndryshme letrare: ditarin, kujtimet dhe romanin historik.
- Shfrytëzon veprat letrare-artistike, si burim informacioni historik.
- Përdor folklorin shqiptar si burim historik.
- Përdor veprën e rilindësve për të vlerësuar rolin që luajtën ata në historinë e Shqipërisë.

MATEMATIKË

- Ndërton dhe interpreton grafikë, diagrame, tabela statistikore, për paraqitjen e të dhënave historike.
- Përdor numrat e shifrat romake për leximin dhe për shkrimin e shekujve.
- përdor numrat negativë dhe pozitivë për të kryer veprime për llogaritjen e kohës.
- Përdor boshtin numerik për interpretimin e shkallës së kohës.
- Vendos në boshtin numerik vitet para dhe pas Krishtit.

SHKENCAT E NATYRËS

- Reflekton dhe diskuton për rrjedhojat shoqërore të zhvillimeve shkencore.
- Vlerëson rolin qendror të shkencës në botën e sotme.
- Kupton karakterin kontradiktor të shkencës dhe faktin që shkencëtarët kanë pikëpamje të ndryshme dhe kundërshtuese si për faktet që përdoren në shkencë ashtu edhe për rreziqet që rrjedhin prej zhvillimeve shkencore.
- Kupton çështjet e ndryshme rreth shkencës dhe mjedisit, për shembull.
- Kupton ndikimin e përparimeve teknike në shoqëri, për shembull: ndikimi i internetit.

2.5.Kompetencat dhe konceptet e lëndës së historisë

Programi nëpërmjet të gjithë tematikave të tij zhvillon dhe ndërton një numër kompetencash dhe konceptesh, të cilat mbështesin studimin e historisë. Kompetencat historike janë procese dhe aftësi thelbësore që përfshihen në të gjithë programin e historisë nëpërmjet tematikave dhe nëpërmjet tematikave dhe veprimtarive të sugjeruara. Nxënësit duhet të kuptojnë, të zhvillojnë dhe të ndërtojnë kompetencat dhe konceptet historike si dhe të aftësohen për ti përdorur ato në mënyrë që të thellojnë dhe të zgjerojnë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat e tyre në lëndën e historisë duke arritur progres.

Kompetenca historike janë:

1. Kërkimi historik.
2. Përdorimi i burimeve.
3. Analiza shkak - pasojë.
4. Interpretimi historik.
5. Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën.

Koncepte kyçe historike janë:

1. Kuptimi kronologjik.
2. Ndryshimi dhe vazhdimësia.
3. Shumëllojshmëria kulturore, etnike dhe fetare.
4. Rëndësia.

Nxënësit aftësohen të demonstrojnë kompetencat historike për ndërtimin e ngjarjes historike. Ata shtrojnë pyetje rreth ngjarjeve, çështjeve apo zhvillimeve, krahasojnë aspekte të ndryshme të periudhave, ngjarjeve dhe çështjeve të marra në studim, për të kuptuar

ndryshimin dhe vazhdimësinë, shqyrtojnë shkaqet dhe pasojat e ngjarjeve dhe situatave historike, vendosin rëndësinë historike të një ngjarjeje në shoqëri, interpretojnë dhe marrin informacion nga burime të ndryshme për të mbështetur kërkimin historik, identifikojnë pikëpamjet e ndryshme historike, organizojnë dhe komunikojnë në mënyrë koherente dijet historike.

Të mësuarit dhe ndërmarrja e aktiviteteve në histori kontribuon në arritjen e qëllimeve të programit mësimor për të gjithë nxënësit, për t'u bërë:

- nxënës të suksesshëm që kënaqen nga mësimi dhe bëjnë përparim e arritje;
- individë me besim, të cilët janë në gjendje të jetojnë të sigurt, të shëndetshëm dhe të aftë të përmbushin kërkesat e jetës;
- qytetarë të përgjegjshëm që japin kontribut pozitiv në shoqëri.

Diagrami 4. Kompetencat dhe konceptet e lëndës së historisë




Tabela 1. Kompetencat e lëndës dhe përshkrimi i tyre

PËRSHKRIMI I KOMPETENCAT HISTORIKE				
Kërkimi historik	Përdorimi i burimeve	Interpretimi historik	Analiza shkak-pasojë	Shpjegimi & komunikimi për të shkuarën
<p>Kërkimi historik përfshin strukturimin e kërkesave në lloje të ndryshme pyetjesh dhe çështjesh historike. Nxënësit duhet të fillojnë të hartojnë dhe të përmirësojnë pyetjet e tyre për të strukturuar një shqyrtim për zhvillimin e hipotezave, për përzgjedhjen dhe dhënien e fakteve për të nxjerrë dhe për të justifikuar konkluzionet e tyre. Nxënësit mund të përdorin njohuritë e tyre të fituara për të sugjeruar hipoteza, ose mund të sugjerojnë hipoteza në fillim të temës, bazuar në supozimet dhe vlerat e tyre, të cilat ata pastaj i testojnë kundrejt provave.</p>	<p>Njohja e së kaluarës bazohet në fakte historike, në prova, të cilat rrjedhin nga burime të sakta historike dhe jo nga supozime paraprake në lidhje me vlefshmërinë dhe me besueshmërinë e burimeve historike të përdorura. Kjo përfshin vlerësimin e vlerës dhe besueshmërinë e dëshmive, duke studiuar prejardhjen e qëllimeve dhe gjuhën e burimeve.</p>	<p>Interpretimi ka të bëjë me të kuptuarit se si historianët dhe të tjerët formojnë interpretime. Njerëzit përfaqësojnë dhe interpretojnë të kaluarën në mënyra të ndryshme, duke përfshirë fotografi, shfaqje, filma, tregime, muze etj. Interpretimet reflektojnë rrethanat në të cilat ato bëhen, dëshmitë në dispozicion, si dhe synimet e atyre që i bëjnë këto interpretime (p.sh.: shkrimtarë, arkeologë, historianë dhe film krijues).</p>	<p>Analiza shkak-pasojë përfshin identifikimin dhe vlerësimin e rëndësisë relative të faktorëve të ndryshëm, si dhe bërjen e lidhjeve shpjeguese ndërmjet shkakut dhe pasojës, duke pasur parasysh marrëdhënien ndërmjet argumenteve shkakësore, dëshmive dhe interpretimeve.</p>	<p>Nxënësit zhvillojnë dëgjimin, leximin dhe shkrimin si aftësi për të kujtuar, për të përzgjedhur, për të klasifikuar dhe për të organizuar informacionin historik, duke përdorur me saktësi terminologjinë historike për përshkrimin dhe për shpjegimin e ngjarjeve në të shkuarën. Nxënësit duhet të përdorin edhe teknologjitë e reja ekzistuese sipas nevojave të tyre.</p>

Tabela 2. Konceptet e lëndës dhe përshkrimi i tyre

PËRSHKRIMI I KONCEPTET HISTORIKE			
Kuptimi kronologjik	Ndryshimi & vazhdimësia	Shumëllojshmëria kulturore, etnike & fetare	Rëndësia
<p>Kuptimi kronologjik është thelbësor në ndërtimin dhe në shpjegimin e ngjarjeve historike, çka përfshin përdorimin e saktë të datave për të krijuar vijimësinë e ngjarjeve në një shqyrtim, duke përdorur termat dhe fjalorin e saktë kronologjik, si dhe duke ditur emrat dhe karakteristikat kryesore të periudhave të studiuara. Nxënësit duhet të identifikojnë ndryshimet brenda dhe gjatë periudhave, duke bërë lidhjet midis tyre.</p>	<p>Kuptimi i ndryshimit dhe i vazhdimësisë është i lidhur ngushtë me identifikimin dhe shpjegimin e ndryshimit, e vazhdimësisë brenda dhe përgjatë periudhave historike, si dhe me kuptimin e temave dhe çështjeve gjithëpërfshirëse të periudhave historike.</p>	<p>Shumëllojshmëria kulturore, etnike dhe fetare ka të bëjë me të kuptuarin e përvojave, ideve, besimit dhe vlerave të ndryshme të njerëzve dhe të shoqërive në të shkuarën dhe se si të gjitha këto kanë formësuar botën. Nxënësit duhet të njihen me shumëllojshmërinë kulturore, etnike dhe fetare të shoqërive të ndryshme. Shumëllojshmëria ekziston brenda dhe ndërmjet grupeve për shkak të dallimeve kulturore, etnike, rajonale, gjuhësore, sociale, ekonomike, teknologjike, politike dhe fetare. Njohja e kulturave duhet të arrihet nëpërmjet studimit të individëve dhe të grupeve të ndryshme shoqërore, si p.sh.: njohjes të pakicave kombëtare, të shoqërive evropiane dhe atyre joevropiane.</p>	<p>Rëndësia ka të bëjë me vlerësimin e një ngjarjeje historike. Ajo vlerëson pse gjykimet në lidhje me rëndësinë e ngjarjeve historike, çështjeve dhe njerëzve kanë ndryshuar me kalimin e kohës. Gjithashtu, ajo merr parasysh identifikimin e kritereve të përdorura për vlerësimin e rëndësisë së një çështjeje, ngjarje apo personazhi historik, si dhe vlerëson se si këto kritere dhe vlera janë përdorur në përshkrimet e së shkuarës dhe shpjegimin e së tashmes. Deklaratat rreth rëndësisë janë interpretime që mund të bazohen në vendime të kontestueshme rreth ngjarjeve, çështjeve dhe figurave historike, ato shpesh janë të lidhura me sistemet e vlerave të periudhës, në të cilën është shkruar interpretimi.</p>

2.6.Cilësitë historike të nxënësit

Lënda e historisë i ndihmon nxënësit që të bëhen të ditur, të logjikshëm, kureshtarë, të balancuar, të ndjeshëm, dhe individë të aftë për të dhënë argumente dhe për të marrë vendime të arsyetuara mirë.

Diagrami 5. Cilësitë historike të nxënësit



Kurrikula e historisë synon t'i pajisë nxënësit me këto cilësi të rëndësishme në mënyrë që t'i mbështesë ata, jo vetëm në zotërimin e dijeve dhe kompetencave historike, por dhe në arritjen e rezultateve të dëshiruara dhe në realizimin e qëllimeve të arsimit parauniversitar, për t'i bërë ata të aftë për të përmbushur studimet e tyre të mëtejshme, si dhe për të nxënit gjatë gjithë jetës.

Për të zhvilluar cilësitë historike, mësuesi gjatë mësimit të historisë duhet t'u ofrojë nxënësve mundësi për të kërkuar, për të shqyrtuar, për të vlerësuar aspekte të ndryshme historike dhe për të përdorur TIK-un, si pjesë përbërëse e të mësuarit të tyre. Krijimi i këtyre mundësive rrit angazhimin e nxënësve me kuptimin dhe përdorimin e njohurive të lëndës, koncepteve, kompetencave historike dhe kompetencave kyçe.

Mësuesi i ofron mundësi nxënësit:

- për të kërkuar aspekte për historinë qytetërimi botërore në periudhën bashkëkohore dhe për të kuptuar se si ato lidhen me një kontekst të gjerë historik;
- për të shqyrtuar rrugët, në të cilat e kaluara i ka ndihmuar të formojnë identitetin, kulturat e përbashkëta, vlerat dhe qëndrimet sot;
- për të vlerësuar përmes vizitave ku është e mundur, rolin e muzeve, galerive, arkivave historike në ruajtjen dhe paraqitjen e së shkuarës;
- për të përdorur TIK-un, për të kërkuar informacion për të shkuarën në lidhje me datat, personazhet, objektet, ngjarjet dhe proceset historike, si dhe për të përzgjedhur, klasifikuar, organizuar dhe paraqitur gjetjet.

Nxënësi:

- kërkon aspekte për historinë e qytetërimi botërorë në periudhën bashkëkohore për të kuptuar se si ngjarjet lidhen me një kontekst të gjerë historik. Duke bërë kërkime mbi historinë e qytetërimi në periudhën bashkëkohore, nxënësit i krijohet mundësia të përdorë burimet për të kuptuar lidhjet e brendshme e të jashtme midis ngjarjeve dhe shoqërive të ndryshme, marrëdhëniet shkak-pasojë, si dhe lidhjet e qytetërimit të popullit shqiptar me qytetërimet botërore;

- eksploron marrëdhëniet për të kuptuar që idetë, vlerat, besimet rrjedhin nga një proces ndryshimi dhe ndërveprimi i vazhdueshëm, gjykon mbi të përbashkëtat dhe diversitetin e kulturave, duke vlerësuar se kulturat janë gjithmonë në ndryshim si rezultat i kontaktit me kulturat e tjera. Në këtë mënyrë nxënësit përgatiten për jetën në një shoqëri të ndryshme dhe me shumë etni, në një botë gjithnjë e më të ndërvarur;
- vlerëson përmes vizitave ku është e mundur rolin e muzeve, galerive, arkivave historike në ruajtjen dhe paraqitjen e së shkuarës. Kjo përfshin përdorimin e muzeve, galerive, arkivave dhe vende historike për të gjeneruar dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve rreth të shkuarës dhe për të ngjallur interesin e nxënësve, në mënyrë që ata në jetën e tyre përtej shkollës, të vazhdojnë përdorimin e këtyre burimeve;
- përdor TIK-un për të kërkuar informacion për të shkuarën në lidhje me datat, personazhet, objektet, ngjarjet dhe proceset historike, si dhe për të përzgjedhur, klasifikuar, organizuar dhe paraqitur gjetjet. Kjo përfshin: vlerësimin e faqeve të internetit, duke marrë parasysh prejardhjen e materialeve dhe duke vlerësuar vlerën e tyre, si dhe përdorimin e TIK-ut për të kërkuar të dhëna historike, për të përzgjedhur, për të klasifikuar, për të organizuar dhe për të prezantuar informacionin. Nxënësi duhet të ketë mundësi për të ripunuar, për të ristrukturuar punën e tyre dhe për të reflektuar mbi këtë proces.

3. KLASA E DHJETË

Nëpërmjet programit të historisë nxënësit zhvillojnë dhe ndërtojnë njohuritë, aftësitë/shkathtësi, qëndrimet dhe vlerat e tyre në njohjen dhe kuptimin e karakteristikave kryesore të periudhës bashkëkohore, identifikojnë ngjarjet idetë dhe figurat historike që i dhanë formë zhvillimit të konteksteve politike, ekonomike, sociale dhe kulturore, bëjnë lidhjet midis historisë së shqiptarëve dhe historisë së qytetërimeve botërore për periudhën historike të marrë në studim, përdorin kronologjinë dhe fjalorin e duhur historik, kuptojnë procesin e ndryshimit, duke treguar ndryshimin dhe/ose zhvillimin brenda dhe gjatë periudhës të studimit, si dhe mbështeten në burimet historike (burimet tekstuale, vizuale, objektet dhe mjedisin historik) dhe teknologjinë, për të nxjerrë përfundime të arsyetuara dhe logjike.

3.1.Përmbajtja e kurrikulës për klasën e 10-të

Në klasën e 10-të, programi “Historia e Qytetërimeve Botërore” trajton modele të qytetërimeve botërore në periudhën bashkëkohore. Ky program nëpërmjet modeleve të marra në studim shpjegon ngjarjet kryesore, nëpër të cilat ka kaluar zhvillimi i shoqërisë botërore në periudhën bashkëkohore. Ai trajton mënyrat e jetesës, botën materiale, mënyrën e organizmit ekonomik, politik dhe kulturor si dhe botën shpirtërore të këtyre qytetërimeve për të kuptuar lidhjen midis këtyre qytetërimeve dhe vazhdimësinë e tyre në të ardhmen. Përmbajtja e dhënë në këtë programe historisë ofron mundësi për zhvillimin dhe ndërtimin e koncepteve, njohurive, aftësive/shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave, të cilat janë të ndërlidhura me njëra –tjetrën dhe duhet të jepen në mënyrë të integruar në të gjithë tematikat e përcaktuara në program, me qëllim ndërtimin dhe zbatimin e kompetencave të lëndës dhe kompetencave kyçe. Tematikat dhe veprimtaritë e sugjeruara të dhëna në program janë bazë për të siguruar rezultatet e të nxënës, sipas koncepteve dhe kompetencave historike. Për secilën tematikë janë paraqitur njohuritë, aftësitë/shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat për klasën e 10-të.

3.2.Rezultatet e të nxënës për konceptet dhe kompetencat historike

Përgjatë gjithë programit të historisë zhvillohen njohuritë, aftësitë/shkathtësitë, qëndrimet e vlerat që duhet të zotërojë nxënësi për ndërtimin e koncepteve historike: *Kuptimi kronologjik. Ndryshimi dhe vazhdimësia. Shumëllojshmëria kulturore, etnike dhe fetare, rëndësia dhe realizimin e kompetencave historike: Kërkimi historik. Përdorimi i burimeve. Analiza shkak-pasojë. Interpretimi. Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën.*

Tabela 3. Rezultatet e të nxënit për kompetencat dhe konceptet historike për klasën e 10-të të arsimit profesional

KLASA e 10-të				
REZULTATET E TË NXËNIT PËR KOMPETENCAT HISTORIKE				
Kërkimi historik	Përdorimi i burimeve	Interpretimi historik	Shkaku dhe pasoja	Shpjegimi dhe komunikimi
<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon dhe shqyrton, individualisht dhe si pjesë e një grupi, pyetje specifike historike për periudhën e dy Luftërave Botërore dhe për periudhën bashkëkohore ose çështje që i përkasin këtyre periudhave, duke bërë testimin e hipotezave; • reflekton në mënyrë kritike për pyetje ose çështje historike që i 	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon tipat e burimeve historike si një domosdoshmëri në punën e historianit dhe në dhënien e përgjigjeve të argumentuara për ndërtimin e ngjarjes historike; • vlerëson historinë gojore, me anë të së cilës dëshmitë gojore për ngjarjet e fundit historike mund ta bëjnë historinë më të gjallë në sytë e nxënësve; • kërkon, duke vlerësuar burimet alternative, për ndërtimin e ngjarjes historike në periudhën e dy Luftërave Botërore dhe në periudhën bashkëkohore; • identifikon, zgjedh dhe përdor një sërë burimesh historike, duke përfshirë burimet tekstuale, vizuale, objektet dhe mjedisin historik për të 	<ul style="list-style-type: none"> • Kupton pse historianët dhe të tjerët i kanë interpretuar ngjarjet, njerëzit dhe situatat historike që i përkasin periudhës së dy Luftërave Botërore dhe periudhës bashkëkohore në mënyra të ndryshme; • shpjegon se si dhe pse ngjarjet historike janë interpretuar në mënyra të ndryshme nëpërmjet një sërë mediesh; • shqyrton një sërë interpretimesh të së kaluarës që i përkasin periudhës së dy 	<ul style="list-style-type: none"> • Analizon ngjarjet historike që i përkasin periudhës së dy Luftërave Botërore dhe periudhës bashkëkohore në lidhjet e tyre shkak-pasojë; • shpjegon pasojat në përfundimin e ngjarjeve, të situatave dhe të ndryshimeve historike që i përkasin periudhës së dy Luftërave Botërore dhe 	<ul style="list-style-type: none"> • Paraqet shpjegime për periudhën bashkëkohore që janë koherente, të strukturuar dhe të arsyetuara, duke përdorur kronologjinë dhe fjalorin e duhur historik; • komunikon njohuritë historike për periudhat e marra në studim në mënyra të ndryshme, duke përdorur kronologjinë dhe fjalorin e duhur historik.

përkasin periudhave të marra në studim;	argumentuar interpretimin e tij në lidhje me ngjarje apo çështje të caktuara që i përkasin periudhës së dy Luftërave Botërore dhe periudhës bashkëkohore; <ul style="list-style-type: none"> vlerëson burimet e përdorura për të arritur përfundime të arsyetuara dhe logjike për periudhën e dy Luftërave Botërore dhe për periudhën bashkëkohore. 	Luftërave Botërore dhe periudhës bashkëkohore për të vlerësuar vlefshmërinë e tyre.	periudhës bashkëkohore.	
---	---	---	-------------------------	--

REZULTATET E TË NXËNIT PËR KONCEPTET HISTORIKE

Kuptimi kronologjik	Ndryshimi dhe vazhdimësia	Shumëllojshmëria kulturore, etnike dhe fetare	Rëndësia
<ul style="list-style-type: none"> Përdor saktë datat dhe fjalorin e duhur historik për periudhën e dy Luftërave Botërore dhe për periudhën bashkëkohore; kupton organizimin kronologjik të historisë dhe vendos njerëzit dhe ngjarjet në periudhën e saktë historike, duke kuptuar dhe duke shpjeguar marrëdhëniet historike; ndërton linjën e kohës, duke vendosur në të ngjarjet e rëndësishme historike të periudhave të marra në studim; kryen veprime për llogaritjen e kohës; krijon një tabelë kronologjike (për vendin dhe botën) për periudhën e dy Luftërave Botërore dhe për periudhën bashkëkohore, 	<ul style="list-style-type: none"> Shpjegon ndryshimin dhe vazhdimësinë e ngjarjeve historike brenda dhe përtej periudhave historike; analizon shkallën dhe ritmin e ndryshimit, nëse ndryshimi arriti në progres dhe nëse po, për kë ngjarje historike u arrit ky progres; analizon arsyet dhe rezultatet e ngjarjeve, e situatave dhe ndryshimeve historike për periudhën e dy Luftërave Botërore dhe për periudhën bashkëkohore; kupton dhe ndërgjegjësohet për veçoritë e prirjeve historike të cilat sollën progresin e shoqërisë në shkallë kombëtare, evropiane dhe botërore. 	<ul style="list-style-type: none"> Kupton se njerëzit dhe shoqëritë e përfshira në të njëjtën ngjarje mund të kenë përvoja dhe pikëpamje të ndryshme për të njëjtën ngjarje historike. 	<ul style="list-style-type: none"> Vlerëson rëndësinë e ngjarjeve, të njerëzve dhe të zhvillimeve historike që i përkasin periudhës së dy Luftërave Botërore dhe periudhës bashkëkohore.

duke e pasuruar atë në vazhdimësi me informacionin e ri.			
--	--	--	--

3.3.Koha mësimore

Në klasën e dhjetë për të gjitha strukturat e arsimit profesional, lënda e historisë zhvillohet për 36 javë mësimore me 1 orë në javë, pra gjithsej 36 orë mësimore vjetore.

Tabela 4. Koha mësimore e sugjeruar

KLASA e 10-të	
Tematika	Orë të sugjeruara¹
1. Periudha tronditjeve të mëdha (1914-1945)	15
2. Qytetërimet bashkëkohore (1945 – sot)	21

¹ Për secilën tematikë është dhënë një numër i sugjeruar orësh mësimore. Theksojmë që mësuesi është i lirë të vendosë vetë për shpërndarjen e orëve mësimore për secilën tematikë të programit, në varësi të strukturës së arsimit profesional, të metodologjisë, të vlerësimit dhe të nevojave të nxënësve në klasë.

KLASA E 10-të

TEMATIKA1. PERIUDHA TRONDITJEVE TË MËDHA (1914-1945)

PËRSHKRIMI I TEMATIKËS

Përmes kësaj tematike nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi/shkathtësi, qëndrime dhe vlera mbi tronditjet dhe krizat që çuan në fillimin e luftërave botërore. Nxënësit kuptojnë, analizojnë dhe gjejnë për shkaqet dhe pasojat e Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore. Nxënësit gjejnë dhe mbajnë qëndrim për pasojat e holokaustit, vlerësojnë trashëgiminë e luftërave botërore në jetën ekonomike, politike dhe shoqërore të qytetërimit botëror. Kjo tematikë i mëson nxënësve përpjekjet e bëra për kapërcimin e krizave veçanërisht atyre ekonomike, si dhe krijon te ata bindjen se çdo konflikt rajonal apo me shtrirje më të gjerë sjell kosto negative për të ardhmen e shoqërisë. Tematika krijon një tablo të qartë për drejtimet e ndryshme në fushën e artit, kulturës dhe mënyrave të jetesës në shoqërinë dy sistemeve (demokratike dhe totalitare). Për tematikën e dhënë më poshtë janë parashikuar dhe orë mësimore për veprimtari të cilat jepen në rubrikën “Veprimtari praktike”. Këto orë mësuesi dhe autori i tekstit i integron brenda orëve të tematikës. Tematika së bashku me veprimtaritë realizojnë kompetencat lëndore dhe kompetencat kyçe për të nxënësit gjatë gjithë jetës.

Klasa e 10-të

Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës

Klasa e 10-të

Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të lëndës

<p>Fillimet e krizave të shek. XX-të. Lufta dhe paqja (1914-1920)</p> <p>Bashkimi Sovjetik (BRSS)</p> <p>Fashizmi në Itali</p>	<p>Fillimet e krizave të shek. XX-të. Lufta dhe paqja (1914-1920)</p> <ul style="list-style-type: none"> - analizon shkaqet që çuan në fillimin e Luftës së Parë Botërore; - përcakton në hartë frontet kryesore në të cilat u zhvillua Lufta e Parë Botërore; - analizon konceptin e planit të SHBA-së për paqen në botë (14 pikat e Willsonit); - gjykon mbi vendimet më të rëndësishme të Konferencës së Paqes së arritur në Versajë; - pasqyron hartën e re politike të Evropës pas Luftës së Parë Botërore. - gjykon pasojat politike, ekonomike, sociale dhe psikologjike të Luftës së Parë Botërore dhe të traktateve të paqes në përfundim të saj. <p>Bashkimi Sovjetik (BRSS)</p> <ul style="list-style-type: none"> - shpjegon shkaqet dhe rrjedhojat e revolucionit të vitit 1917 në Rusi; - analizon shkaqet e ardhjes në pushtet të qeverive totalitare në Bashkimin Sovjetik, - analizon tiparet e sistemit politik në BRSS; - analizojë politikën e Stalinit si pika kulmore e zbatimit të diktaturës së proletariatit dhe të luftës së klasave; - gjykon mbi tiparet e sistemit ekonomik në BRSS; - analizon tiparet social-kulturore të shoqërisë totalitare në BRSS. <p>Fashizmi në Itali</p> <ul style="list-style-type: none"> - shpjegon kushtet historike të ardhjes në pushtet të Musolinit; - analizon tiparet e sistemit politik në Italinë fashiste; - shpjegojë tiparet e politikës së jashtme dhe të brendshme të fashizmit në Itali; - analizon tiparet e sistemit ekonomik në Italinë fashiste; - analizon tiparet social-kulturore të shoqërisë në Italinë fashiste;
---	---

<p>Gjermania</p>	<ul style="list-style-type: none"> - shpjegon kushtet historike të ardhjes në pushtet të Hitlerit; - analizon tiparet e politikës së jashtme dhe të brendshme të nazizmit në Gjermani; - gjykon antisemitizmin e Hitlerit, që solli holokaustin, duke gjykuar për rrjedhojat e tij; - analizon arsyet e militarizimit të ekonomisë si faktor për daljen nga kriza ekonomike.
<p>SHBA, modeli i një shteti liberal</p>	<p>SHBA, modeli i një shteti liberal</p> <ul style="list-style-type: none"> - analizon tiparet e sistemit politik në SHBA; - analizon shkaqet dhe tiparet e krizës së viteve 1929 – 1933 në SHBA; - gjykon mbi “Kursin e Ri të Rusveltit si model për të dalë nga kriza ekonomike; - analizon strukturën e shoqërisë amerikane në periudhën midis dy luftërave botërore duke shqyrtuar aspektet e jetës së përditshme; - analizon shkaqet, synimet dhe arritjet e lëvizjeve feministe në SHBA, duke evidentuar përpjekjet e tyre për barazi sociale dhe politike;
<p>Franca</p>	<p>Franca</p> <ul style="list-style-type: none"> - analizon tiparet e sistemit politik në Francë; - analizon tiparet e sistemit ekonomik në Francë; - analizon shkaqet, tiparet e krizës së viteve 1929 – 1933 në Francë dhe rrugët e daljes nga kriza; - analizon tiparet social-kulturore të shoqërisë në Francë.
<p>Turqia, krijimi i një shteti laik kombëtar</p>	<p>Turqia, krijimi i një shteti kombëtar laik</p> <ul style="list-style-type: none"> - vlerëson rolin e Qemal Ataturkut në krijimin e shtetit laik kombëtar turk; - analizon reformat e Ataturkut në evropianizimin e Turqisë; - analizon strukturën e shoqërisë turke në periudhën midis dy luftërave botërore duke vlerësuar ndryshimet që ajo pësoi.
<p>Lufta e Dytë Botërore(1939-1945)</p>	<p>Lufta e Dytë Botërore(1939-1945)</p> <ul style="list-style-type: none"> - shpjegon shkaqet që çuan në fillimin e Luftës së Dytë Botërore dhe karakterin e saj; - përcakton në hartë frontet kryesore të Luftës së Dytë Botërore; - shpjegon rolin e grupeve të rezistencës gjatë Luftës së Dytë Botërore; - analizon trashëgiminë e Luftës së Dytë Botërore: <ul style="list-style-type: none"> ➤ pasojat ekonomike, ➤ pasojat sociale, ➤ pasojat psikologjike; pasojat e holokausti;

KONCEPTE DHE TERMA

demokraci, komunizëm, fashizëm, antisemitizmi, nazizëm, imperializëm, social-demokraci, racizëm, proteksionizëm, mandat, protektorat, ekonomi socialiste, krizë ekonomike, shoqëri civile, diktaturë, diktatura e proletariatit, lufta e klasave; etatizëm; Stalinizmi; kult individit, Shteti i mirëqenies në Angli, Fronti Popullor në Francë, Marrëveshja e re (Kursi i ri i Rusveltit) në SHBA, kensianizmi.

VEPRIMTARI PRAKTIKE PËR TEMATIKËN “PERIUDHA TRONDITJEVE TË MËDHA (1914-1945)”

Kontributi i shqiptarëve në mbrojtjen e hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore.

- vlerëson kontributin e shqiptarëve në mbrojtjen e popullsisë hebraike gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Shoqëria, arti dhe kultura

- diskuton mbi tiparet social-kulturore të shoqërisë totalitare me ato të shoqërisë demokratike, duke gjykuar për këto tipare në plan krahasues;
- diskuton mbi karakteristikat e artit dhe të kulturës gjatë gjysmës së parë të shek. XX.

Ballkani në periudhën midis dy luftërave

- diskuton mbi tiparet e jetës politike në Ballkan në periudhën midis dy luftërave, duke evidencuar të përbashkëtat dhe veçantitë;
- krahason zhvillimet ekonomike, politike, shoqërore ndërmjet Ballkanit dhe Evropës Perëndimore;

TEMATIKA 2. QYTETËRIMET BASHKËKOHORE (1945 – SOT)

PËRSHKRIMI I TEMATIKËS

Përmes kësaj tematike nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi/shkathtësi, qëndrime dhe vlera mbi zhvillimet politike, ekonomike e shoqërore të dy blloqeve të krijuara pas Luftës së Dytë Botërore, bllokut perëndimor dhe bllokut lindor. Nxënësit nëpërmjet modeleve të marra në studim analizojnë dhe krahasojnë tiparet politike, ekonomike dhe shoqërore të këtyre dy blloqeve. Ata vlerësojnë rolin dhe rëndësinë e Bashkimit Evropian, shpjegojnë prirjet e qytetërimeve sot, si ndryshime në strukturën sociale dhe zhvillimin e klasës së mesme, rritjen e rolit të gruas në qeverisje; globalizmin, uniformitetin, zhvillimin e shkencës, teknologjisë, kulturës, artit dhe arsimit, për të evidentuar prirjen dhe perspektivën e qytetërimeve të sotme. Për tematikën e dhënë më poshtë janë parashikuar dhe orë mësimore për veprimtari të cilat jepen në rubrikën “Veprimtari praktike”. Këto orë mësuesi dhe autori i tekstit i integron brenda orëve të tematikës. Tematika së bashku me veprimtaritë/projektet realizojnë kompetencat lëndore dhe kompetencat kyçe për të nxënësit gjatë gjithë jetës.

Klasa e 10^{-të}

Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës

Klasa e 10^{-të}

Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të lëndës

<p>Bota menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore (1945 – 1946)</p> <p>BRSSS gjatë viteve 1945 – 1990</p> <p>ShBA gjatë viteve 1945 – 2000</p> <p>Procesi i dekolonizimit</p> <p>Italia gjatë viteve 1945 – 2000</p> <p>Franca gjatë viteve 1945 – 2000</p>	<p>Bota menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore (1945 – 1946)</p> <ul style="list-style-type: none"> - analizon kushtet historike të krijimit, karakterin dhe qëllimet e OKB-së; - tregon procesin e arritjes së paqes dhe analizon vendimet kryesore të konferencës së Jaltës, Potsdamit dhe Parisit; - gjykon mbi ndryshimet që sollën këto vendime në botën e pasluftës. <p>BRSSS gjatë viteve 1945 – 1990</p> <ul style="list-style-type: none"> - analizon tiparet e sistemit politik në BRSS; - analizon veçoritë e politikave të brendshme dhe të jashtme të BRSS; - shpjegon marrëdhëniet e BRSS me bllokun lindor dhe bllokun perëndimor; - analizon tiparet e sistemit ekonomik në BRSS; - gjykon mbi tiparet social-kulturore të shoqërisë në BRSS; - arsyeton mbi rolin e udhëheqësve politikë në ndryshimet e politikave të brendshme dhe të jashtme. <p>SHBA gjatë viteve 1945 – 2000</p> <ul style="list-style-type: none"> - analizon tiparet e sistemit politik në ShBA; - analizon veçoritë e politikave të brendshme dhe të jashtme të ShBA-së; - analizon tiparet e sistemit ekonomik në ShBA; - shpjegon marrëdhëniet e ShBA-së me bllokun perëndimor dhe BRSS; - gjykon mbi tiparet social-kulturore të shoqërisë në ShBA; - vlerëson rolin e lëvizjeve sociale në emancipimin e shoqërisë amerikane; - arsyeton mbi rolin e liderëve politikë në zhvillimet e brendshme dhe të jashtme. <p>Procesi i dekolonizimit</p> <ul style="list-style-type: none"> - shpjegon kushtet historike në të cilat u zhvillua procesi i dekolonizimit; - përcakton në hartë lindjen e shteteve kombëtare si pasojë e procesit të dekolonizimit; - evidenton rrugët dhe veçoritë e realizmit të këtij procesi; - vlerëson rolin e elitës vendase në këtë proces. <p>Italia gjatë viteve 1945 – 2000</p> <ul style="list-style-type: none"> - shpjegon rrugët dhe veçoritë e rimëkëmbjes politike dhe shoqërore të Italisë; - evidenton faktorët e “mrekullisë ekonomike” të Italisë; - shpjegon procesin e përfshirjes së Italisë në organizmat e përbashkëta Euroatlantike. <p>Franca gjatë viteve 1945 – 2000</p> <ul style="list-style-type: none"> - analizon tiparet e sistemit politik, ekonomik dhe shoqëror në Francë; - evidenton qëndrimin e Francës ndaj procesit të dekolonizimit;
---	---

<p>Britania e Madhe gjatë viteve 1945 – 2000</p>	<ul style="list-style-type: none"> - shpjegon procesin e përfshirjes së Francës në organizmat e përbashkëta Euroatlantike dhe evidenton rolin e saj si iniciatorë në Komitetin Evropian të Çelikut dhe Qymyrit. <p>Britania e Madhe gjatë viteve 1945 – 2000</p> <ul style="list-style-type: none"> - analizon tiparet e sistemit politik, ekonomik dhe shoqëror në Britaninë e Madhe; - evidenton qëndrimin e Britanisë ndaj procesit të dekolonizimit; - shpjegon procesin e përfshirjes së Britanisë në organizmat e përbashkëta Euroatlantike.
<p>Gjermania gjatë viteve 1945 – 1991</p>	<p>Gjermania gjatë viteve 1945 – 1991</p> <ul style="list-style-type: none"> - shpjegon procesin e krijimit të dy Gjermanive; - evidenton përplasjen e dy superfuqive në këtë proces; - shpjegon rrugët dhe veçoritë e rimëkëmbjes politike, ekonomike dhe shoqërore të Republikës Federale Gjermane; - shpjegon faktorët që çuan në integrimin e Republikës Federale Gjermane në organizmat e përbashkëta Euroatlantike; - shpjegon faktorët që çuan në bashkimin e dy Gjermanive.
<p>Jugosllavia gjatë viteve 1945 – 1990</p>	<p>Jugosllavia gjatë viteve 1945 – 1990</p> <ul style="list-style-type: none"> - analizon tiparet e sistemit politik në Jugosllavi; - analizon veçoritë e politikave të brendshme dhe të jashtme të Jugosllavisë; - evidenton tiparet e politikës nacionale në Jugosllavi; - analizon tiparet e sistemit ekonomik dhe shoqëror në Jugosllavi; - shpjegon rolin e Jugosllavisë në organizimin e Lëvizjes së Vendeve të Paangazhuara.
<p>Blloku lindor gjatë viteve 1945 – 1989</p>	<p>Blloku lindor gjatë viteve 1945 – 1989</p> <ul style="list-style-type: none"> - shpjegon rrugët e vendosjes së regjimeve komuniste në Evropën Qendrore dhe Lindore; - shpjegon dallimet dhe tiparet e përbashkëta të organizimit politik, ekonomik dhe shoqëror të shteteve socialiste të bllokut lindor; - evidenton lëvizjet politike dhe shoqërore të bllokut lindor për tu shkëputur nga varësia e BRSS; - shpjegon arsyet që çuan drejt integritimit ekonomik dhe politiko-ushtarak të shteteve të bllokut komunist.
<p>Revolucionet demokratike në shtetet e Evropës Qendrore dhe Lindore</p>	<p>Revolucionet demokratike në shtetet e Evropës Qendrore dhe Lindore</p> <ul style="list-style-type: none"> - shpjegon rrugën e transformimeve drejt demokracisë të shteteve ish-komuniste, duke evidentuar elementet e shoqërive demokratike post-komuniste; - evidenton në hartën politike të Evropës, ndryshimet territoriale pas rënies së murit të Berlinit;

<p>Shpërbërja e BRSS dhe e Jugosllavisë</p> <p>Bashkimi Evropian</p> <p>Prirjet e qytetërimeve sot</p>	<ul style="list-style-type: none"> - evidenton dallimet dhe ngjashmërinë ndërmjet shteteve të Evropës Qendrore dhe Lindore në periudhën e trazicionit. <p>Shpërbërja e BRSS dhe e Jugosllavisë</p> <ul style="list-style-type: none"> - analizon shkaqet dhe rrjedhimet e ndryshimeve territoriale në Evropë: shpërbërja e BRSS-së dhe e Jugosllavisë, duke evidentuar si përfundim të procesit pavarësinë e Kosovës. <p>Bashkimi Evropian</p> <ul style="list-style-type: none"> - evidenton Traktatin e Mahstrtit, si vazhdues të procesit të integritimit evropian dhe krijuesin e Bashkimit Evropian; - vlerëson rolin dhe rëndësinë e Bashkimit Evropian; - liston në mënyrë skematike institucionet kryesore vendimmarrëse të Bashkimit Evropian, duke evidentuar misionin e tyre; - analizon procesin e zgjerimit të Bashkimit Evropian. <p>Prirjet e qytetërimeve sot</p> <ul style="list-style-type: none"> - analizon format dhe mënyrat e ndryshme të jetesës në qytetërimet e sotme, duke gjykuar mbi raportet trashëgimi dhe tendencat e reja sot; - analizon arsyet e rritjes së rolit të gruas në jetën shoqërore dhe politike sot; - përcakton elementet e globalizmit, duke analizuar ndikimin e tyre në perspektivën e shoqërisë globale; - evidenton tiparet dhe prirjet e reja të artit, kulturës dhe arsimit; - evidenton prirjet e zhvillimit të shkencës dhe teknologjisë drejt zbulimit të kozmosit, modernizimit dhe automatizimit të jetës.
<p>KONCEPTE DHE TERMA</p> <p>Luftë e Ftohtë, Perde e Hekurt, superfuqi, revizionizëm, imperializëm, sovranitet i kufizuar, disident, bllok, detantë, dekolonizim, Commonwealth, bashkekzistencë paqësore, denazistifikim, çmilitarizim, të drejtat e njeriut, armë bërthamore, garë armatimesh, ekonomi mikse, globalizëm, hipi, integrim evropian, lëvizje anti-raciale, lëvizje feministë, lëvizje studentore, shpërbërje, ost-politika, politikë dirizhiste, neokonservatorizëm, neoliberalizëm, socializëm me fytyrë njerëzore, vetë administrim, Glasnost, Perestrojkë, kursi i kufirit të ri, Korpusi i Paqes, terrorizëm, uniformitet, vende të paangazhuara,</p>	
<p>VEPRIMTARI PRAKTIKE PËR TEMATIKËN“QYTETËRIMET BASHKËKOHORE (1945 – SOT)”</p> <p><i>Gjallërimi i të rinjve-kërkesat e studentëve për hapësira të reja.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - diskuton për karakterin e lëvizjeve studentore në vitin 1968 në Evropën Perëndimore dhe të diskutojë në klasë rreth tyre. <p><i>Konferenca e Helsinkit dhe të drejtat e njeriut.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - vlerëson rolin e Konferencës së Helsinkit në promovimin dhe ruajtjen e të drejtave të njeriut. 	

Republika e Pavarur e Kosovës- një e drejtë e mohuar për një popullsi në shumicë.

- diskuton mbi rrugën e zhvillimit historik që ka përshkuar Kosova drejt Pavarësisë.

KLASA E 10-të

QËNDRIMET DHE VLERAT

- Vlerëson rëndësinë e historisë në kuptimin e ngjarjeve të së shkuarës.
- Demonstron aftësitë bazë të kërkimit historik.
- Vlerëson rëndësinë që ka e shkuara në ndërtimin e të tashmes.
- Vlerëson rëndësinë e burimeve historike në ndërtimin objektiv të ngjarjes historike.
- Shtron pyetje dhe gjen përgjigje, vlerëson burimet, identifikon dhe analizon interpretime të ndryshme dhe gjykon bazuar në argumente.
- Respekton saktësinë e burimeve historike dhe dallon diferencën midis faktit dhe supozimit.
- Vlerëson rolin e figurave historike në zhvillimin e shteteve.
- Vlerëson arritjet e qytetërimeve botërore në art, kulturë dhe arsim.
- Vlerëson trashëgiminë kulturore botërore.
- Demonstron, përmes studimit të historisë, aftësitë qytetare, të cilat kontribuojnë në rritjen e tyre personale si individë, në përgatitjen e tyre në jetë, në punë dhe në shoqëri.
- Vlerëson gamën e burimeve historike dhe të informacionit si: dokumentet, burimet e shtypura, historinë gojore, mediat e ndryshme, pikturat, muzetë, galeritë, fotografitë, muzikën dhe internetin, si baza për studimin dhe përshkrimin e një ngjarjeje historike.
- Vlerëson shkaqet dhe pasojat e Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore.
- Respekton origjinën historike dhe kupton dobinë e larmisë etnike dhe kulturore të shoqërisë.
- Vlerëson kontributin e shqiptarëve në mbrojtjen e popullsisë hebraike gjatë Luftës së Dytë Botërore.
- Vlerëson rolin dhe rëndësinë e Bashkimit Evropian në përparimin e vendeve të BE-së.
- Vlerëson prirjet e qytetërimeve sot, si ndryshime në strukturën sociale dhe zhvillimin e klasës së mesme, rritjen e rolit të gruas në qeverisje; globalizmin, uniformitetin, zhvillimin e shkencës, kulturës, artit, arsimit dhe teknologjisë.
- Demonstron gatishmëri për të pranuar njerëzit nga komunitete të ndryshme.
- Shfaq krenari për vendin e tij.
- Vlerëson dhe respekton larminë në shoqëri, si dhe kontributin e kulturave dhe grupeve të ndryshme fetare e shoqërore.
- Tregon se disa ngjarje dhe ndryshime mund të interpretohen në mënyra të ndryshme dhe shpjegojnë arsyet e mundshme për këtë interpretim.
- Vlerëson dhe respekton pikëpamjet e të tjerëve.
- Tregon integritet në aksesimin dhe përdorimin etik të informacionit.
- Paraqet dhe komunikon lirshëm mendimet e tij.

- Është krijues dhe prezanton idetë e reja të tij.
- Demonstron interes dhe kuriozitet për historinë.
- Demonstron shpirtin e objektivitetit dhe paanësisë.
- Vetë vlerësohet dhe përdor mendimin kritik dhe kritikën konstruktive në situata të thjeshta.
- Demonstron pavarësi dhe besim në vetvete.
- Respekton punën e kryer mirë dhe pranimin e opinioneve të tjera (madje edhe të kundërta) duke treguar tolerancë.
- Demonstron vullnet në arritjen e rezultateve.
- Respekton përpjekjet personale dhe ato në grup.

4. UDHËZIME METODOLOGJIKE

Përdorimi i një numri të larmishëm rrugësh dhe metodash në mësimin e historisë nga mësuesit është një përbërës thelbësor në procesin e zbatimit të kurrikulës së historisë, në arritjen e rezultateve të parashikuara të të nxënësve, në aftësimin e nxënësve për ndërtimin dhe demonstrimin e kompetencave kyçe të të nxënësve dhe kompetencave e koncepteve historike, në lidhjen e historisë me lëndët dhe fushat e tjera të të nxënësve, në integrimin e temave ndërkurrikulare, si dhe në zotërimin e cilësive historike për përmbushjen me sukses të qëllimeve arsimore.

Të nxënësve në lëndën e historisë mund të realizohet vetëm me anë të pjesëmarrjes aktive të nxënësve në procesin e të nxënësve, në mënyrë që ata të kuptojnë, të vlerësojnë e të përdorin përmbajtjen e synuar për të ndërtuar mbi të njohuri e aftësi të reja në situata të ndryshme me të cilat do të përballen në të ardhmen.

Edhe pse të nxënësve në mënyrë të pavarur mbetet i rëndësishëm, po aq rëndësi ka edhe dhënia e mundësive me anë të metodologjisë së mësimdhënies për të ndërvepruar me njëri-tjetrin dhe me mjedisin ku jetojnë. Për këtë, shkolla duhet të ofrojë një mjedis mbështetës ku të njihet e të vlerësohet kontributi i secilit nxënës.

Mësuesi duhet të zbatojë në klasë teknika aktive të mësimdhënies dhe të nxënësve. Ai duhet të organizojë aktivitete, të udhëzojë nxënësit për të marrë pjesë në to dhe të mundësojë pjesëmarrjen aktive dhe kuptimplote të nxënësve. Në këtë mënyrë nxënësit do të zhvillojnë ndjenjën e përgjegjësisë për të nxënësve e tyre, duke formësuar kështu aftësitë e para për të nxënësve gjatë gjithë jetës.

Në klasën e 10 – të, të arsimit profesional, format, metodat, strategjitë dhe teknikat e të mësuarit, duhet të jenë të shumta e të larmishme. Ato zgjidhen në përshtatje me përmbajtjen lëndore, me nivelin e nxënësve, me veçoritë e temave të ndryshme mësimore dhe në varësi të gjendjes së materialeve burimore dhe didaktike. Metodatat dhe teknikat e mësimdhënies që mund të zbatohen gjatë një ore mësimi, janë të shumta. Si të tilla mund të përdoren:

Mësimi zbulues, nëpërmjet të cilit kalohet nga njohuritë elementare në përgjithësime, nga hipotezat në gjetjen e origjinës së dukurive, nga problemet e thjeshta në zgjidhjen e tyre.

Biseda, e cila do të ishte më e efektshme për ato tema ku nxënësit kanë njohuri paraprake të bollshme që fitohen nëpërmjet rrugëve të shumta të informacionit masiv;

Shpjegimi, i cili mund të jetë i suksesshëm në të gjitha ato veprimtari të përbashkëta të mësuesit e nxënësve që synojnë të kuptuarit e njohurive për zhvillimin në kohë e në hapësirë të dukurive dhe të proceseve historike.

Diskutimi është një nga metodatat më të thjeshta që përdoret në realizimin e veprimtarive në klasë, kur është fjala për të mundësuar procesin e pjesëmarrjes sa më të gjerë të nxënësve në mësim. Diskutimi është një përzierje e shpjegimeve, mësues-nxënës, e shkëmbimit të pikëpamjeve dhe pyetjeve ndërmjet tyre, e transferimit dhe integritit të njohurive dhe aftësive. Diskutimi me të gjithë klasën është një mënyrë shumë e mirë për mësuesin/en dhe për nxënësit për të zbuluar se cilat janë qëndrimet e tyre rreth çështjeve, ngjarjeve dhe koncepteve të ndryshme që trajtohen në lëndën e historisë. Gjithashtu, diskutimi është një rast shumë i mirë për të praktikuar të dëgjuarit të nxënësit, të folurën me radhë dhe aftësi të tjera që nevojiten në punën në grup.

Puna me faktet dhe përdorimi i burimeve: Përdorimi i strukturuar i dokumenteve historike ndihmon nxënësin të zhvillojë përvojën për vlerësimin e fakteve dhe aftësinë për të formuluar gjykime të arsyeshme, ndaj mësuesi i historisë duhet ti nxisë nxënësit të përdorin burime të larmishme për njohjen e fakteve historike dhe mësimin e tyre kritik e analitik e, në mënyrë të veçantë si :

- arkivat, duke lejuar në këtë mënyrë të shfrytëzohen dokumente origjinale;

- kinemaja dhe prodhimtaria audiovizuale, qoftë dokumentare, qoftë fantastike;
- bibliotekën;
- teknologjitë e informacionit, që duhet të përbëjnë objektin e një trajtimi kritik, individual e kolektiv, për të cilin mësuesi luan një rol themelor ;
- llojet e ndryshme të muzeve dhe vendet përkujtimore, që ndikojnë në përkapjen në mënyrë të qartë nga ana e nxënësve të ngjarjeve të fundit, konkretisht në përmasën e tyre të përditshme ;
- historia gojore, me anë të së cilës dëshmitë gojore për ngjarjet e fundit historike mund ta bëjnë historinë më të gjallë në sytë e të rinjve, si dhe mund t'u lënë vend pikëpamjeve e perspektivave të atyre që nuk kanë marrë pjesë në “ historinë e shkruar”.

Studimi kërkimor: Përfshirja në kërkim është pjesë përbërëse e programit të historisë. Duke njohur dhe duke përvetësuar mënyrën se si punojnë historianët, nxënësit zhvillojnë aftësinë për ta zbatuar atë gjerësisht në lëndën e historisë dhe në fusha të tjera.

Përdorimi i kërkimit historik u paraqet nxënësve një mënyrë për të bërë hulumtime, për të organizuar dhe për të shpjeguar ngjarjet që kanë ndodhur. Kërkimi historik është procesi i "të bërit histori". Ai është një proces ciklik (Figura. 1), që fillon me shtrimin e pyetjeve historike, pasohet nga gjetja dhe analiza e burimeve historike për të krijuar fakte dhe dëshmi historike. Dëshmia historike përdoret më pas për të ndërtuar interpretimet historike që kërkojnë t'iu përgjigjen pyetje historike.

Figura 1. Procesi i kërkimit historik



Përdorimi i kërkimit historik duhet të jetë në qendër të mësimin të historisë dhe mësuesit duhet t'i krijojnë mundësinë nxënësit për të mësuar aftësitë e nevojshme përmes praktikës dhe angazhimit në kërkimin historik. Përdorimi i pyetjeve në çdo njësi mësimore siguron një pikë kontakti për nxënësit për të kërkuar, sistemuar dhe analizuar informacion në përgjigje të çështjeve që hulumtohen në programin mësimor. Qasja kërkimore, kur zbatohet në mënyrë efektive, zhvillon cilësitë historike dhe aftëson nxënësit të jenë të pavarur, krijues dhe mendimtarë kritik. Ajo nxiti demonstrimin e kompetencave historike dhe kompetencave kyçe të të nxënësit. Tabela e mëposhtme paraqet një përforsim të qasjes kërkimore për të ndihmuar mësuesit në përdorimin e kësaj qasje.

Tabela 5. Përforcimi i qasjes kërkimore

Faza kërkimore	Cilësitë historike të një nxënësi	Qëllimi
1. Bën pyetje historike	<ul style="list-style-type: none"> • Kureshtar 	<p>Më e rëndësishme për procesin e kërkimit është pikënisja. Mësuesit duhet të udhëhiqen nga treguesit e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • angazhojnë interesin e nxënësve; • identifikojnë pyetjet që do të kërkojnë;(një pyetje e përgjithshme kërkimore e ndjekur nga nën-pyetje); • planifikojnë procesin e kërkimit; • përshkruajnë rezultatin.
2. Identifikon dhe gjen burimet përkatëse	<ul style="list-style-type: none"> • I logjikshëm • I balancuar 	<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit vendosin cilat burime janë të dobishme, cilat nuk janë dhe cilat duhen trajtuar me kujdes (me anë të një shembulli mësuesit udhëzojnë paraprakisht nxënësit); • Nxënësit krijojnë fakte dhe dëshmi historike;
3. Analizon lidhjen shkak-pasojë	<ul style="list-style-type: none"> • I logjikshëm • I arsyetuar • I ditur 	<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit analizojnë lidhjet shkak-pasojë për ndërtimin e ngjarjes duke u bazuar në burimet e gjetura;
4. Ndërton interpretime historike, vlerëson burimet dhe jep argumente	<ul style="list-style-type: none"> • I logjikshëm • I balancuar • Metodik • I arsyetuar • I ditur 	<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit mbajnë shënime nga studimi i tyre për burimet. • Nëpërmjet reflektimit dhe diskutimit të drejtuar nga mësuesi, nxënësit janë në gjendje të zhvillojnë përgjigjet për pyetjet hetimore;
5. Kontrollon interpretimet e nxjerra dhe/ose interpretimin e tanishëm historik	<ul style="list-style-type: none"> • I balancuar • I arsyetuar • I ditur 	<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit tregojnë zgjerimin, thellimin dhe transferimin e dijeve të tyre;
6. Shpjegimi dhe komunikimi	<ul style="list-style-type: none"> • I logjikshëm • I arsyetuar • Metodik • I balancuar • I ditur 	<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit shpjegojnë dhe prezantojnë përgjigjet e pyetjeve të tyre nëpërmjet mediave të ndryshme (me shkrim; me gojë; TIK); • Nxënësit respektojnë mendimet e shokëve të tyre qofshin ato dhe të ndryshme nga të tyre.

Nxënësit duhet të nxiten për të ndërmarrë, sipas nivelit që kanë dhe rrethanave, kërkime individuale me qëllim që të stimulohen kërshtëria dhe fryma e tyre vetëvepruese në vjeljen e të dhënave si dhe mendimi i tyre sintetizues.

Në rrafshin grupor të nxënësve, të klasës apo shkollës, zhvillimi i projekteve kërkimore kolektive duhet të nxitet më tej, me qëllim që të krijohen kushtet e dialogut dhe ballafaqimit të hapur e tolerant të mendimeve.

Trajtimi ndërdisiplinor dhe shumë disiplinor. Mësimi i historisë duhet të përdorë në çdo rast potencialin edukativ të një trajtimi ndërdisiplinor e shumë disiplinor, duke vendosur lidhje me lëndët e tjera që përbëjnë tërësinë e kurrikulës shkollore, konkretisht me letërsinë, gjeografinë, shkencat shoqërore, përfshirë edhe lëndët shkencore.

Veprimtaritë praktike ose projektet kurrikulare kërkojnë zbatimin e më shumë se një metode dhe teknike, si: kërkimi, intervista, vrojtimi, studimi i rastit, etj. Këto metoda e vënë theksin në ndërtimin e kompetencave të lëndës dhe kompetencave kyçe për të nxënësit gjatë gjithë jetës si dhe në demonstrimin e aftësive/shkathtësive, kryesisht aftësisë së punës me dokumentet historike, punës kërkimore, aftësisë për të punuar në grup, aftësisë për të zgjidhur problemin, etj.,.

Trajtimi ndërkombëtar dhe ndërkufitar. Sipas rrethanave, kërkohet të përkrahet zbatimi i projekteve ndërkombëtare dhe ndërkufitare, mbështetur mbi studimin e një teme të përbashkët, si dhe trajtimet krahasuese apo kryerja e një detyre të përbashkët në shumë shkolla të vendeve të ndryshme, duke përfituar konkretisht nga mundësitë e reja që japin teknologjitë e informacionit dhe vendosja e lidhjeve dhe këmbimeve shkollore.

Mësimi dhe ruajtja në kujtesë. Krahas nxjerrjes në pah të arritjeve pozitive që kanë karakterizuar shekullin XX, si përdorimi paqësor i shkencave për një art më të mirë të jetuari dhe zhvillimi i demokracisë e të drejtave të njeriut, është e nevojshme të merren të gjitha masat edukative për të parandaluar përsëritjen apo mohimin e ngjarjeve shkatërrimtare që kanë ndodhur gjatë këtij shekulli si: Holokaustin, gjenocidin, spastrimet etnike, krimet e tjera kundër njerëzimit, dhunimet masive të të drejtave të njeriut dhe të vlerave themelore me të cilat është lidhur në mënyrë të veçantë Këshilli i Evropës. *Për këtë qëllim, duhet :*

- të ndihmohen nxënësit për t'u njohur e ndërgjegjësuar me faktet dhe me shkaqet e atyre faktorëve që kanë karakterizuar në mënyrën më të errët historinë e Evropës në veçanti dhe atë të botës në përgjithësi;
- të reflektohet mbi ideologjitë që kanë çuar në to dhe mbi mjetet që bëjnë të mundur të shmanget përsëritja e fakteve të tilla;
- të sigurohet zbatimi i vendimit të ministrave të edukimit (Krakovi2000) lidhur me caktimin në shkolla të një dite përkujtimore të Holokaustit dhe për parandalimin e krimeve kundër njerëzimit;
- të kujtojnë ashtu si Evropa, 27 janarin, si ditën përkujtimore të viktimave të Holokaustit dhe 23 gushtin, si ditën përkujtimore për viktimat e regjimeve totalitare naziste dhe komuniste.

Teknologjitë e informacionit e të komunikimit. Në kontekstin e përdorimit shumë të zgjeruar të teknologjive të informacionit dhe komunikimit nga ana e të rinjve, si gjatë jetës së tyre shkollore ashtu edhe jashtëshkollore, ka rëndësi të zhvillohet një pedagogji dhe metodologji që mban parasysh faktin që këto teknologji:

- përbëjnë burimet e pashmangshme në mësimin e historisë ;
- shtrojnë çështje themelore, konkretisht atë të besueshmërisë së burimeve ;
- u lejojnë mësuesve dhe nxënësve të depërtojnë në burime origjinale dhe interpretime të shumëllojta;
- zgjerojnë më së miri mundësinë për t'u futur në informacione dhe të dhëna historike;
- shumëfishojnë dhe lehtësojnë rastet e bashkëpunimit e të dialogut.

Nga ana tjetër, duhet gjithashtu të krijohen kushtet e nevojshme që mësuesi:

- të mund t'u vijë në ndihmë nxënësve gjatë procesit selektiv për të vlerësuar besueshmërinë e burimeve të informacionit;
- të mund të marrë masat e nevojshme për luftën kundër përhapjes së përmbajtjeve raciste, në mënyrë të veçantë nëpërmjet sistemit internet, duke respektuar normat ligjore dhe lirinë e shprehjes;
- të mund të bëjë përpjekje gjatë orës së mësimin për analizë kritike, duke u mbështetur në larmi pikëpamjesh dhe interpretimesh ndërkulturore;
- të mund të nxisë nxënësit për të zhvilluar kompetencat e tyre, si analizat kritike dhe arsyetimin nëpërmjet analogjisë.

Gjatë orëve të ndryshme të mësimi, metodat e teknikat ndërthuren me njëra-tjetrën, aq sa shpesh nuk mund t'i dallosh kufijtë midis tyre, prandaj, vëmendja e veçantë e mësuesit duhet drejtuar te lidhja organike e metodave dhe e teknikave të veçanta që ai përdor brenda një ore mësimi.

Në ndihmë të zbatimit të këtyre metodologjive, në program parashtrihen një sërë veprimtarish të sugjeruara, të cilat i ndihmojnë nxënësit në zotërimin e kompetencave dhe në arritjen e rezultateve të të nxënit të parashikuara në program.

Mësuesi duhet të tregojnë kujdes të veçantë që nxënësit të nxiten vazhdimisht të reflektojnë në mënyrë kritike mbi ecurinë e të nxënit dhe punës së tyre në shkollë dhe të transferojnë ata çka kanë mësuar në situata jetësore brenda dhe jashtë shkollës.

Mundësia për të marrë pjesë dhe për të përfituar nga përvojat e lëndës së historisë ashtu si nga çdo lëndë tjetër në shkollë, duhet t'u ofrohet të gjithë nxënësve pa përjashtuar askënd për asnjë shkak. Mësimdhënia duhet të bazohet në interesin më të lartë të nxënësit dhe duhet të sigurojë trajtimin e barabartë me dinjitet e respekt të gjithsecilit.

Nxënësit me nevoja të veçanta

Organizimi i kurrikulës sipas kompetencave, në fusha të nxëni, në shkallë, dhe me fokus integrimin, u krijon mësuesve hapësirat për të përshtatur mësimdhënien sipas nevojave të veçanta të nxënësve dhe për të personalizuar të nxënit e tyre. Mësuesit duhet të marrin parasysh faktin se nxënësit janë të ndryshëm, kanë motivim, interesa, stile të nxëni, nevoja dhe aftësi të ndryshme etj. Në disa raste duhen bërë përshtatje të kurrikulës sipas diferencave të zhvillimit brenda një grupi moshor. Mësuesit mund të zgjerojnë zhvillimin e kompetencave kyçe si ato të komunikimit, të menduarit dhe shoqërore sipas nevojave individuale të nxënësve, për të zvogëluar dhe zhdukur diferencat brenda një shkalle të kurrikulës, në fund të saj.

Nxënësit me vështirësi në të nxënë

Shumë nxënës me vështirësi arrijnë rezultatet e pritshme të të nxënit njësoj si nxënësit e tjerë, nëse bëhen përshtatje në mënyrën e mësimdhënies dhe të vlerësimit të tyre.

Për të arritur nivelin më të lartë të mundshëm të realizimit të kompetencës, mund të zhvillohen programe të veçanta, individuale, për nxënësit me nevoja të veçanta.

Në rastin e nxënësve që formalisht janë përcaktuar si të veçantë, është veçanërisht e rëndësishme që stafi i shkollës, në bashkëpunim me prindërit, të mbështesë të nxënërit e tyre. Procedurat dhe teknikat e vlerësimit për nxënës me nevoja të veçanta duhet të diskutohen herë pas here me prindërit dhe vetë nxënësit. Prindërit duhet të kuptojnë se si ndikojnë këto procedura dhe teknika të përshtatura në vlerësimin e punës së nxënësve.

Nxënësit e talentuar

Fleksibiliteti i zhvillimit të programit lejon plotësimin e nevojave individuale të nxënësve të talentuar.

Mësuesit duhet t'u krijojnë kushte dhe situata të tilla që nxënësit të shfaqin dhe të zhvillojnë talentet e tyre. Kjo arrihet nëse atyre u krijohen mundësitë të punojnë me një përmbajtje më të thelluar dhe zgjeruar, të zhvillojnë në mënyrë të vazhdueshme elemente specifike të kompetencave kyçe (p.sh.: aftësitë e nivelit të lartë konjitiv të kompetencës së të menduarit) dhe specifike të fushës, të fokusohen në çështjet kroskurrikulare, të zgjerojnë mjediset dhe materialet e të nxënëit brenda dhe jashtë shkollës.

4.1. Materiale dhe burime mësimore

Përdorimi i mjeteve mësimore në mësimdhënien dhe në procesin e të nxënëit në lëndën e historisë, ndihmon në konkretizimin e ideve dhe të dukurive, në aplikimin e metodave dhe strategjive të mësimdhënies si dhe e bën mësimin më interesant dhe më rezultativ për nxënësit. Përdorimi i suksesshëm i metodave dhe i teknikave të lartpërmendura, nuk mund të realizohet pa mjetet e nevojshme didaktike, të cilat janë të llojeve të ndryshme, si: harta historike të përgjithshme ose tematike, atlase, albume, foto, skica, filma mësimorë, videokaseta, kompjuter, aparat projekcioni, CD, DVD, TIK, etj. Këto mjete po zënë gjithnjë e më shumë vendin që u takon për konkretizimin e një sërë ngjarjesh historike, të cilat janë vështirë të kuptohen pa një konkretizim audioviziv etj.

5. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

Vlerësimi është një aspekt i rëndësishëm i lëndës së historisë. Në përputhje me parimet e qasjes së të nxënësve bazuar në kompetenca, vlerësimi konsiderohet si element i mësimdhënies i cili përqendrohet në nivelin e arritjes së kompetencave, fokusohet në matjen e njohurive e aftësive, në arritjen e rezultateve të të nxënësve dhe në nivelin e përmbushjes së kompetencave. Informacioni i siguruar nga vlerësimi, e ndihmon mësuesin të evidentojë përparimin e nxënësve, të vlerësojë se sa të përshtatshme e të dobishme janë metodat e mësimdhënies që ai përdor, të përmirësojë mësimdhënien dhe t'i pajisë nxënësit me informacionin përkatës për progresin e tyre.

Vlerësimi është një informacion i rëndësishëm që u shërben nxënësve për të ndjekur vetë ecurinë e tyre në këtë lëndë, për të njohur anët e tyre të forta dhe vështirësitë që hasin në zotërimin e njohurive dhe kompetencave, në mënyrë që të punojnë përkatësisht për përfundimin dhe kapërcimin e tyre. Vlerësimi është një informacion i rëndësishëm edhe për prindërit, me anë të të cilit ata mund të ndihmojnë më mirë në edukimin e fëmijëve të tyre.

I domosdoshëm është vlerësimi i përmbajtjes të lëndës lidhur me zotërimin e njohurive dhe demonstrimin e aftësive historike nëpërmjet treguesve të besueshëm për progresin e tyre. (*p.sh. vetëvlerësimi, intervistë me një listë treguesish, testi objektiv, vëzhgimi i kërkimit historik me një listë të saktë treguesish, prezantimi me gojë ose me shkrim, projekti kurrikular etj.*).

Në përzgjedhjen e praktikave të vlerësimit, në përcaktimin e kohës së përshtatshme, në përzgjedhjen e materialeve për vlerësim mësuesi duhet të ketë parasysh:

- përcaktimin e qëllimit dhe strategjisë së vlerësimit;
- përzgjedhjen e veprimtarive, që mundësojnë demonstrimin e arritjes së kompetencave;
- përdorimin e vlerësimit për të verifikuar çfarë dinë aktualisht nxënësit;
- dallimin qartë të qëllimit të detyrës së zgjedhur për vlerësim.

Vlerësimi i nxënësve duhet të nxjerrë në pah arritjet e tyre, në mënyrë që ata të inkurajohen të mësojnë me më shumë dëshirë. Ai duhet të konsiderohet si një mjet në ndihmë të nxënësve, i cili i ndihmon ata të njohin më mirë aftësitë e tyre në të nxënë, të zhvillojnë e të përdorin talentet dhe aftësitë në mënyra sa më të dobishme. Nxënësit vetë duhet të jenë pjesë e procesit të vlerësimit të arritjeve të tyre. Me anë të vlerësimit, mësuesi informohet rreth çfarë dhe si po mësojnë nxënësit, çka e ndihmon atë të planifikojë mësimdhënien në vijim dhe të përgatisë materiale ose të rishikojë metodologjinë e mësimdhënies për t'iu përshtatur nevojave të nxënësve. Vlerësimi nga ana e mësuesit duhet të marrë në konsideratë edhe aftësinë e nxënësve për të përcaktuar e arritur objektiva për veten.

Mësuesi i historisë vlerëson saktësinë e informacionit të paraqitur nga nxënësit, aftësitë e tyre për të diskutuar, debatuar, krahasuar, argumentuar dhe parashikuar, duke mbajtur qëndrim vetjak ndaj një ngjarjeje ose figure të caktuar historike. Në lëndën e historisë, mësuesi duhet të vlerësojë aftësinë e nxënësve për të punuar në grup si dhe aftësinë e tyre për të vlerësuar nga secili nxënës punën e anëtarëve të tjerë të grupit.

Mësuesi i historisë duhet të vlerësojë përdorimin e burimeve alternative nga nxënësit, ballafaqimin e tyre dhe forcën argumentuese ndaj një çështjeje të diskutueshme ose të debatueshme në histori. Kriter vlerësimi për nxënësit në lëndën e historisë është edhe përfshirja e tyre në debat, duke respektuar mendimet e kundërta të njëri-tjetrit, të bazuara mbi argumente ose fakte historike.

a. Vëzhgimi

Mësuesi vlerëson ecurinë e nxënësve duke i vëzhguar ata gjatë punës individuale ose në grup si dhe ndërveprimin e tyre gjatë veprimtarive të ndryshme në klasë dhe në shkollë. *Mësuesi vëzhgon aspekte të tilla si:*

- aftësinë e nxënësve për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për të bashkëpunuar në grup;
- ndërveprimet e nxënësve me njëri-tjetrin dhe me të rriturit;
- cilësinë e prezantimit të punimeve;
- interesat, aftësitë ose talentet e veçanta të nxënësve;
- pjesëmarrjen dhe interesin që shprehin nxënësit në veprimtari e aktivitete të ndryshme;
- përgjegjësinë vetjake dhe shoqërore që shfaqin nxënësit;

- përkushtimin dhe këmbënguljen e nxënësve në kryerjen e detyrave të ndryshme;
- nivelin e ndërjegjësimit të nxënësve për vështirësitë që mund të kenë të tjerët dhe gatishmërinë për t'i ndihmuar ata;
- pyetjet që shtrojnë nxënësit, përgjigjet dhe sugjerimet që nxënësit u japin pyetjeve të mësuesit dhe nxënësve të tjerë;
- sjellje të caktuara, si: aftësitë drejtuese, niveli i vetëbesimit, të shprehurit në mënyrë të drejtpërdrejtë e të hapur, gatishmëria për të përballuar rreziqe, sfida e vështirësi;
- pjekurinë fizike dhe emocionale;
- aftësinë për të vetë-vlerësuar ecurinë në shkollë.

Mësuesi mund t'i mbajë shënim vëzhgimet për secilin nxënës, në mënyrë që të mund të krijojë një pamje të përgjithshme të ecurisë së zhvillimit të tyre. Kjo i shërben mësuesit edhe për t'ia komunikuar ecurinë e nxënësve prindërve të tyre ose në raste kur nxënësi ndryshon shkollë, ky lloj vlerësimi mund të ndahet me mësuesin e ri ose me mësuesit pasues të ciklit në vijim.

Vëzhgimi ndihmon vetë mësuesin i cili, pasi ka kuptuar nevojat e veçanta të secilit nxënës, duhet të rishikojë metodologjitë e mësimdhënies, në mënyrë që ato të lehtësojnë të nxënit e gjithsecilit.

b. Detyrat dhe testet

Me anë të detyrave të ndryshme që mësuesi u jep nxënësve në klasë, ai arrin të vlerësojë si procesin e punës, ashtu edhe nivelin e të kuptuarit të njohurive të reja nga ana e nxënësve. Me anë të detyrave, mësuesi mund të vlerësojë edhe aftësinë e nxënësve për t'i përdorur dijet e marra në situata nga më të ndryshmet. Detyrat në klasë mund të jenë projekte në grup ose punë individuale.

Një shembull i detyrës në klasë mund të jetë dhënia e një situatë, e cila kërkon zgjidhje, ku nxënësit duhet të marrin një vendim së bashku dhe ta mbrojnë atë. Gjatë punës në grup të nxënësve, mësuesi vlerëson demonstrimin e kompetencave dhe aftësinë e gjithsecilit për të punuar në grup.

Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin e komunikimit me shkrim dhe mund të realizohet jo vetëm me laps e letër, por edhe në rrugë elektronike. Mësuesi planifikon testime periodike me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimore, që përbëhen nga një ose disa tematika, të cilët i bashkojnë rezultate të ndërlidhura të të nxënit. Në përshtatje me qëllimin e vlerësimit me shkrim, ai përdor lloje të ndryshme

testesh, që nga minitestet pak minuta për një rezultat të veçuar të të nxënësve, tek ato një orësh; teste me alternativa ose me zhvillim; detyra tematike, projekte kurrikulare etj. Një formë e parashtrimit me shkrim nga nxënësit është edhe testimi përfundimtar.

Mësuesi mund t'i përdorë testet me shkrim në fund të një tematike si një teknikë vlerësimi dhe vetëvlerësimi nga ana e nxënësve, pra t'i lejojë ata t'i korrigjojnë vetë testet për të reflektuar e për t'u ndërgjegjësuar mbi aftësitë e tyre dhe vështirësitë që ata hasin.

c. Projektet

Projektet i ndihmojnë nxënësit të përqendrohen në një temë të caktuar të programit, për shembull në njohjen e komunitetit ku ata jetojnë dhe studimin e tij në detaje. Me anë të projektit, mësuesi vlerëson aftësinë e nxënësve për të kërkuar informacion, për të mbledhur, për ta përpunuar dhe për ta prezantuar atë. Puna me projekte mundëson edhe vlerësimin e bashkëpunimit të nxënësve me njëri-tjetrin gjatë punës grup. Realizimi i një projekti është tregues edhe i përgjegjësisë vetjake dhe të grupit si dhe i përkushtimit dhe interesit të secilit nxënës.

d. Paraqitja dhe prezantimi i punimeve

Shpjegimi, paraqitja dhe prezantimi i punimeve të ndryshme që nxënësit realizojnë gjatë lëndës së historisë është për mësuesin tregues i aftësive të tyre për të mbledhur informacion, për ta përpunuar dhe për ta paraqitur atë. Gjatë paraqitjes dhe prezantimit të punimeve, nxënësit vlerësohen edhe për shtjellimin e këndvështrimeve të tyre, mbrojtjen e këtyre këndvështrimeve dhe mbajtjen e qëndrimit vetjak ose në grup ndaj një çështjeje të caktuar. Me anë të kësaj teknike vlerësohen kompetencat historike dhe kompetencat kyçe si ajo e komunikimit dhe e të menduarit. Në punimet e nxënësve me grupe të vogla, mësuesi/ja parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënës në veçanti. Mësuesi nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimore dhe të vendosë nota në regjistër për secilën orë mësimore. Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë lirshëm, si partnerë, rreth përvetësimit të njohurive të fituara në orët e kaluara dhe kryerjes sa më mirë të detyrave jashtë klase. Herë pas here mësuesi duhet të vlerësojë me notë, duke ua bërë të qartë nxënësve që në fillim qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

Pavarësisht zgjedhjes nga ana e mësuesit të teknikave të vlerësimit, qofshin këto formale ose joformale, vlerësimi duhet domosdoshmërisht të synojë përmirësimin e përvojave të nxënësve. Vlerësimi i nxënësit përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënësit nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Nxënësi vlerësohet me notë, ndërsa demonstroi arritjet e tij me gojë, me shkrim ose nëpërmjet veprimtarive dhe produkteve të tjera, si: veprimtari praktike, raste studimore, shkrimi i një eseje, prodhimi i një CD-je, hartimi i një maketi për një ngjarje ose figurë të caktuar historike, projekte etj.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në njohuritë/aftësitë/qëndrimet e programit lëndor dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato njohuri, aftësi dhe qëndrime që nuk përshkruhen në program.

ANEKS 1

Me qëllim që t'u vijë në ndihmë autorëve të teksteve të historisë dhe mësuesve të historisë në realizimin me sukses të këtij programi, në përvetësimin e dijeve dhe demonstrimin e kompetencave të lëndës dhe kompetencave kyçe për të nxënëit gjatë gjithë jetës, paraqiten në këtë aneks, Rekomandimet Rek (2001)15 e Komitetit të Ministrave të Shteteve anëtare lidhur me mësimin e historisë në Evropën e shekullit të XXI.

Recommendation Rec(2001)15 of the Committee of Ministers to member states on history teaching in twenty-first-century Europe

KËSHILLI I EVROPËS

KOMITETI I MINISTRAVE

Rekomandimet Rek (2001)15 e Komitetit të Ministrave të Shteteve anëtare lidhur me mësimin e historisë në Evropë në shekullin XXI

(miratuar nga Komiteti i Ministrave, më 31 tetor 2001, në mbledhjen 771 të të Deleguarve të Ministrave)

Komiteti i Ministrave, në bazë të nenit 15.b. të Statutit të Këshillit të Evropës,

- duke pasur parasysh se qëllimi i Këshillit të Evropës është të realizojë një bashkim përherë e më të ngushtë midis anëtarëve të tij;
- duke vlerësuar Konventën kulturore evropiane nënshkruar në Paris, më 19 dhjetor 1954, që u bën thirrje shteteve të saj nënshkruese të nxisin studimin e historisë dhe të qytetërimit të palëve të tjera kontraktuese dhe ta zhvillojë atë në territorin e këtyre palëve kontraktuese ;
- duke rikujtuar Samitet e Vjenës (1993) dhe të Strasburgut (1997), gjatë të cilave kryetarët e shteteve e të qeverive të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës :

- ✓ shprehën dëshirën ta shohin Këshillin e Evropës plotësisht në gjendje të ndihmojë për të përballur sfidat e shoqërisë së shekullit XXI ;
- ✓ shprehën nevojën për të përforcuar mirëkuptimin e ndërsjellë dhe besimin midis popujve, në mënyrë të veçantë nëpërmjet një programi për mësimin e historisë, duke synuar heqjen e paragjytimeve dhe vlerësimin e ndikimeve pozitive të ndërsjella midis vendeve, feve e ideve të ndryshme, gjatë zhvillimit historik të Evropës;
- duke theksuar se falsifikimet dhe manipulimet ideologjike të historisë janë të papajtueshme me parimet themelore të Këshillit të Evropës përcaktuar nga Statuti i tij ;
- duke vlerësuar rekomandimet e Asamblesë parlamentare lidhur me përmasën evropiane të edukimit (Rekomandimi 1111 (1989)), përsa i përket historisë dhe mësimin të historisë në Evropë (Rekomandimi 1283 (1996)) ;
- duke rikujtuar Rezolutën n° 1 miratuar gjatë sesionit të 19-të të konferencës së përhershme të ministrave evropianë të edukimit lidhur me temën « Prirje dhe përputhshmëri për edukimin në Evropë » (Kristiansand, Norvegji, 1997), si dhe konkluzionet e rezolutat e sesionit 20-të të Konferencës së përhershme të ministrave evropianë të Edukimit lidhur me projektin « Të mësojmë e të shpjegojmë historinë e Evropës së shekullit XX » (Krakovi, Poloni, 2000) ;
- duke rikujtuar deklaratën e miratuar gjatë Konferencës informale të ministrave të Edukimit të Evropës Jug-Lindore, (Strasburg, 1999) me anë të së cilës u rekomandua të ndërmerren aksione pragmatike në fushat për të cilat Këshilli i Evropës ka një përvojë të gjatë e të njohur, konkretisht ndër të tjera mësimin e historisë ;
- duke marrë në konsideratë deklaratën e miratuar gjatë Konferencës rajonale të ministrave të Edukimit të shteteve të Kaukazit (Tbilisi, Gjeorgji, 2000) ;
- nisur nga Rekomandimi n° R (98) 5 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve anëtare lidhur me pedagogjinë trashëgimore, në të cilin Ministrat pohojnë se aksionet pedagogjike mbi trashëgiminë janë mjet i privilegjuar për t'i dhënë kuptim së ardhmes nëpërmjet një vështrimi më të mirë të së shkuarës ;
- duke u mbështetur në Rezolutën (98) 4 të Komitetit të Ministrave për itineraret kulturore të Këshillit të Evropës ;

- duke pasur parasysh Rekomandimin n° R (2000)1 të Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve anëtare mbi nxitjen e bashkëpunimit ndërkufitar midis kolektiviteteve apo autoriteteve territoriale në fushën kulturore, në të cilin ministrat theksojnë se veprimtaritë ndërkufitare u vijnë të rinjve në ndihmë për të krijuar një përfytyrim të ndërkufishëm, duke i bërë ata të ndjeshëm ndaj larmisë së traditave kulturore e historike ;
- nisur nga rezolutat e Konferencës së 5^{-të} evropiane të ministrave përkatës të trashëgimisë kulturore (Portorož, Slloveni, 2001), në të cilat ministrat theksuan edhe një herë se mësimi i historisë duhet të mbështetet mbi kuptimin dhe shpjegimin e trashëgimisë, dhe të nxjerrë në pah karakterin ndërnacional të trashëgimisë ;
- duke pasur parasysh Rekomandimin n° R (2000) 13 të Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve anëtare për një politikë evropiane në fushën e komunikimit të arkivave, në të cilin ministrat, pasi vërejnë interesin në rritje të publikut për historinë dhe pasi theksojnë se një njohje më e mirë e historisë evropiane të vonshme mund të ndihmojë në parandalimin e konflikteve, bëjnë thirrje për një politikë evropiane në fushën e komunikimit të arkivave, mbështetur mbi parime që janë në përputhje me vlerat demokratike ;
- duke pasur në konsideratë Rekomandimin n° R (97) 20 të Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare lidhur me « gjuhën e urrejtjes », në të cilin gjuha e urrejtjes përkufizohet si përcaktuese e të gjitha formave shprehëse që përhapin, nxitin, shtyjnë a përlligjin urrejtjen racore, ksenofobinë apo antisemitizmin, dhe në të cilin ministrat vërejnë se gjuha e urrejtjes mund të ketë një efekt më të dëmshëm kur përhapet nëpërmjet mediave;
- duke mos harruar punimet e mëparshme të Këshillit të Evropës në fushën e mësimimit të historisë që mbështeten mbi idenë e ri pajtimit e të ndikimeve të ndërsjella pozitive midis popujve si punimet e kryera në periudhën e pasluftës, të cilat e vunë theksin në heqjen nga tekstet e historisë të njëanshmërive e paragjykimeve, punimet e njëpasnjëshme të projektit « Historia në Evropën e re », dhe programin « Mësimi i historisë dhe nisma e re e Sekretarit të Përgjithshëm », program që ndihmoi republikat e ish-Bashkimit sovjetik në përpunimin e metodologjive për modernizimin e mësimimit të historisë, në nxjerrjen e teksteve të reja dhe rrjedhimisht ri përshtatjen e formimit të mësuesve;

- duke u njohur me përfundimet e projektit « Të mësojmë e të shpjegojmë historinë e Evropës së shekullit XX » dhe me tërësinë e materialit pedagogjik në përdorim të mësuesve, që u paraqitën gjatë Konferencës përfundimtare të projektit « Vështrime të kryqëzuara mbi shekullin XX », mbajtur simbolikisht në Shtëpinë e Historisë së Republikës federale të Gjermanisë (Haus der Geschichte, Bon, Gjermani, 2001);
- duke vërejtur se projekti « Të mësojmë e të shpjegojmë historinë e Evropës së shekullit XX » lejoi ndër të tjera:
 - ✓ të bëhen përparime të ndjeshme në përpunimin e një koncepti pluralist e tolerant të mësimit të historisë, konkretisht nëpërmjet zhvillimit të aftësive kërkimore individuale dhe analizës;
 - ✓ të vihen në dukje novacionet pedagogjike mbështetur si në teknologjitë e informacionit, ashtu edhe në burimet e reja didaktike;
 - ✓ të përpunohen shembuj trajtesash të hapura për çështjet e brishta të historisë së Evropës së shekullit XX.

U rekomandon qeverive të shteteve anëtare, brenda strukturave të tyre kushtetuese, rrethanave kombëtare a vendore dhe sistemit të tyre edukativ:

- të frymëzohen nga parimet që parashtrohen në shtojcën e këtij rekomandimi, në kuadrin e reformave të mësimit të historisë së sotme a të ardhme dhe të reformave lidhur me formimin e mësuesve të historisë;
- të bëjnë të mundur që, sipas procedurave të përshtatshme kombëtare, rajonale dhe lokale, organizmat e duhura publike e private të vendit të tyre të vihen në dijeni të parimeve që theksohen në këtë rekomandim nëpërmjet dokumenteve referues që përbëjnë bazën e tyre, veçanërisht tërësia e materialeve pedagogjike të përpunuara nga projekti « Të mësojmë e të arsimojmë historinë e Evropës së shekullit XX »;
- të zhvillojnë, sipas modaliteteve që duhen përcaktuar, veprimtari në fushën e mësimit të historisë, me qëllim që të forcohen marrëdhëniet e besimit e të tolerancës në gjirin e vetë shteteve dhe ndërmjet tyre, dhe t'u bëhet ballë sfidave të shekullit XXI;
- të përdorin gjithashtu, në mënyrë të integruar, projekte të tjera të Këshillit të Evropës, në mënyrë të veçantë atë të « Edukimit me qytetari demokratike » dhe punimet e realizuara në fushën e trashëgimisë kulturore.

I kërkon Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës t'ua bëj të ditur këtë rekomandim Shteteve palë të Konventës kulturore evropiane që nuk janë anëtare të Këshillit të Evropës.

Shtojcë për Rekomandimin Rek (2001)15

1. Objektivat e mësimit të historisë në shekullin XXI

Mësimi i historisë në një Evropë demokratike:

- duhet të zërë një vend themelor për formimin e individit si qytetar përgjegjës e aktiv për zhvillimin e respektit për tërë llojet e dallimeve, respekt i mbështetur mbi mirëkuptimin e identitetit kombëtar dhe të parimeve të tolerancës;
- duhet të jetë një faktor vendimtar pajtimi, mirënjohjeje, mirëkuptimi e besimi të ndërsjellë midis popujve;
- duhet të luajë rol kryesor në zhvillimin e vlerave të tilla themelore si toleranca, mirëkuptimi reciprok, të drejtat e njeriut dhe demokracia;
- duhet të përbëjë një nga elementët thelbësorë në ndërtimin e Evropës së bashkuar duke u bazuar në trashëgiminë historike e kulturore të përbashkët, pasuruar me larminë që e karakterizon, qoftë edhe në aspektet e veta konfliktuale dhe shpesh dramatike;
- duhet të jetë pjesë e një politike arsimore e cila luan një rol të drejtpërdrejtë në përparimin dhe zhvillimin e të rinjve, në perspektivën e ndërtimit, së bashku me ta, të një Evrope të së nesërme, si dhe me zhvillimin paqësor të shoqërive njerëzore në një perspektivë globale, brenda frymës së mirëkuptimit dhe besimit të ndërsjellë;
- duhet të lejojë të zhvillohet tek të rinjtë aftësia intelektuale për të analizuar e interpretuar informacionin në mënyrë kritike dhe me përgjegjshmëri, nëpërmjet dialogut, nëpërmjet kërkimit të dëshmive historike dhe nëpërmjet debatit të hapur e të bazuar në perspektivë të shumfishta, sidomos për çështje të ndjeshme e të diskutueshme historike;
- duhet t'i lejojë qytetarit evropian të nxjerrë në pah identitetin e vet individual e kolektiv, nëpërmjet trashëgimisë së përbashkët historike në dimensionet e saj lokale, rajonale, kombëtare, evropiane dhe globale;

- duhet të jetë një instrument për parandalimin e krimeve kundër njerëzimit.

2. Shtrembërimet e historisë

Mësimi i historisë nuk mund të jetë mjet manipulimi ideologjik, propagande apo nxitjeje të vlerave ultranacionaliste, ksenofobe, raciste apo antisemitiste e jotolerante.

Kërkimet historike dhe vetë historia që mësohet në shkollë, në asnjë rast, dhe me çfarëdo qëllimi qoftë, nuk mund të pajtohen me vlerat themelore dhe Statutin e Këshillit të Evropës po qe se ato lejojnë a popullarizojnë paraqitje të gabuara të historisë, nëpërmjet njërës a tjetrit prej mashtrimeve të mëposhtme :

- falsifikimit të fakteve historike, statistikave të rreme, pamjeve të trukuara, etj.;
- ngulimit mbi një ngjarje të caktuar për të përligjur a fashitur një ngjarje tjetër;
- shtrembërimit të së shkuarës për qëllime propagande;
- interpretimit të tepruar nationalist të së shkuarës, që mund të krijojë "ne" dhe "ata", ndarje në dy pjesë;
- shtrembërimeve burimore historike;
- mohimit të fakteve historike;
- mosveprimi me fakte të vërteta historike.

3. Dimensioni evropian në mësimin e historisë

Duke qenë se ndërtimi evropian është, sa shprehje e një vendimi të hyrë lirshëm nga vetë evropianët, po aq sa dhe një realitet historik, do të ishte e përshtatshme në këtë rast:

- të nxirren në pah marrëdhëniet historike të vijueshme midis rrafshve lokale, rajonale, kombëtare e evropiane;
- të mbështetet mësimi i çasteve apo fakteve të historisë, përmasa evropiane e të cilave është e dukshme – në mënyrë të veçantë ngjarjet dhe rrymat historike e kulturore themeluese të ndërgjegjes evropiane;
- të zhvillohen me të gjitha mjetet e mundshme, veçanërisht nëpërmjet teknologjive të informacionit, projektet e bashkëpunimit e të këmbimit midis shkollave mbi tema që kanë të bëjnë me historinë e Evropës;

- të rritet interesi i nxënësve për historinë e vendeve të tjera evropiane;
- të prezantohen dhe zhvillohen mësimdhënie në lidhje me historinë e ndërtimit të vetë Evropës.

Për të zhvilluar përmasën evropiane gjatë mësimit të historisë në një Evropë të zgjeruar, demokratike e paqësore, lypset:

- të mbahen parasysh rezultatet e punimeve të kryera në kuadrin e projektit “Të mësojmë e të arsimojmë historinë e Evropës së shekullit XX” të Këshillit të bashkëpunimit kulturor, si në përmbajtjen e tyre, ashtu edhe në trajtimin metodologjik;
- të ndërmerren, mbi bazën e programeve të Këshillit të Evropës, nisma lidhur me reformën e mësimit të historisë dhe përpunimin e teksteve të reja, si dhe të udhëzuesve metodologjikë, në kuadrin e veprimtarive për zhvillimin dhe forcimin e stabilitetit demokratik;
- të ndërmerren, mbi bazën e programeve të Këshillit të Evropës, nisma lidhur me sensibilizimin dhe pedagogjinë e trashëgimisë;
- të veprohet për shpërndarjen sa më të gjerë të materialit pedagogjik krijuar në kuadrin e projektit “Të mësojmë e të shpjegojmë historinë e Evropës së shekullit XX”, duke përdorur teknologjitë e duhura të informacionit dhe komunikimit;
- të fuqizohet ndihma për përgatitjen e programeve të reja shkollore dhe të normave për mësimdhënien e historisë, duke përfshirë përpunimin e teksteve të reja shkollore, konkretisht në Federatën e Ruisë, në vendet e Kaukazit, të Evropës Jug-Lindore dhe të rajonit të Detit të Zi;
- të përfitohet nga programi i Këshillit të Evropës për formimin e vazhdueshëm të personelit edukativ, me qëllim që të fitohen njohuri të reja në një kontekst evropian, gjatë të cilit mësuesit të mund të ballafaqojnë pikëpamjet dhe përvojat e tyre.

4. Përmbajtja e programeve

Mësimdhënia e historisë, ndërkohë që duhet të shmangë akumulimin e njohurive enciklopedike, duhet të përfshijë:

- sensibilizimin lidhur me përmasën evropiane, të mbajtur parasysh që gjatë përpunimit të programeve dhe kjo, me qëllim që nxënësit të fitojnë një “ndërgjegje evropiane” të hapur mbi botën;
- zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, të një gjykimi të pavarur e objektiv, dhe kundërvënien ndaj manipulimeve;

- ngjarjet dhe çastet e shënuara të historisë së Evropës, studiuar në rrafshet vendore, kombëtare, evropiane e botërore nëpërmjet periudhave dhe fakteve veçanërisht domethënëse;
- studimin e të gjitha dimensioneve të historisë së Evropës, jo vetëm politike, por edhe ekonomike, shoqërore e kulturore;
- zhvillimin e frymës kërkimore dhe të kërkuesit, konkretisht duke përdorur pedagogjinë e njohjes, në kuadrin e studimit të trashëgimisë, që lejon në këtë mënyrë të nxirren në pah ndikimet ndërkulturore;
- zhdukjen e paragjyqimeve dhe stereotipeve, duke theksuar në programe ndikimet e ndërsjella pozitive midis vendeve të ndryshme, feve dhe shkollave doktrinarë në zhvillimin historik të Evropës;
- studimin kritik të shtrembërimeve të historisë, qoftë nëpërmjet mohimit të një fakti të dukshëm historik, qoftë nëpërmjet falsifikimit, shmangies, mosnjohjes, apo përdorimit ideologjik;
- studimin e çështjeve të diskutueshme, nëpërmjet mbajtjes parasysh të fakteve, të mendimeve e të pikëpamjeve të ndryshme, si dhe kërkimit të së vërtetës.

5. Metodatat e mësimin

Përdorimi i burimeve

Do jetë me vend të përdoren burimet didaktike më të larmishme për njohjen e fakteve historike dhe mësimin e tyre kritik e analitik e, në mënyrë të veçantë:

- arkivat, të hapura për publikun, veçanërisht në vendet e Evropës qendrore e lindore, duke lejuar në këtë mënyrë të shfrytëzohen tashmë dokumente origjinale, kur asnjëherë më parë nuk ka ndodhur një gjë e tillë;
- kinemaja dhe prodhimtaria audiovizuale, qoftë dokumentare, qoftë fantastike;
- teknologjitë e informacionit, që duhet të përbëjnë objektin e një trajtimi kritik, individual e kolektiv, për të cilin mësuesi luan një rol themelor;
- llojet e ndryshme të muzeve të shekullit XX, ngritur gjithandej nëpër Evropë, dhe vendet përkujtimore, që ndikojnë në përkapjen në mënyrë të qartë nga ana e nxënësve të ngjarjeve të fundit, konkretisht në përmasën e tyre të përditshme;

- historia gojore, me anë të së cilës dëshmitë gojore për ngjarjet e fundit historike mund ta bëjnë historinë më të gjallë në sytë e të rinjve, si dhe mund t'u lënë vend pikëpamjeve e perspektivave të atyre që nuk kanë marrë pjesë në « historinë e shkruar ».

Kërkimi individual

Nxënësit duhet të nxiten për të ndërmarrë, sipas nivelit që kanë dhe rrethanave, kërkime individuale, me qëllim që të stimulohen kërshtëria dhe fryma e tyre vetëvepruese në vjeljen e të dhënave si dhe mendimi i tyre sintetizues.

Kërkimi kolektiv

Në rrafshin grupor të nxënësve, të klasës apo shkollës, zhvillimi i projekteve kërkimore a arsimore aktive duhet të nxitet më tej, me qëllim që të krijohen kushtet e dialogut dhe ballafaqimit të hapur e tolerant të mendimeve.

Trajtimi ndërdisiplinor dhe shumëdisiplinor

Mësimi i historisë duhet të përdorë në çdo rast potencialin edukativ të një trajtimi ndërdisiplinor e shumëdisiplinor, duke vendosur lidhje me disiplinat e tjera që përbëjnë tërësinë e programit shkollor, konkretisht me letërsinë, gjeografinë, shkencat shoqërore, filozofinë, artet, përfshirë edhe disiplinat shkencore.

Trajtimi ndërkombëtar dhe ndërkufitar

Sipas rrethanave, lypset të përkrahët zbatimi i projekteve ndërkombëtare dhe ndërkufitare, mbështetur mbi studimin e një teme të përbashkët si dhe trajtimet krahasuese apo kryerja e një detyre të përbashkët në shumë shkolla të vendeve të ndryshme, duke përfituar konkretisht nga mundësitë e reja që japin teknologjitë e informacionit dhe vendosja e lidhjeve dhe këmbimeve shkollë.

6. Mësimi dhe ruajtja në kujtesë

Krahas nxjerrjes në pah të arritjeve pozitive që kanë karakterizuar shekullin XX, si përdorimi paqësor i shkencave për një art më të mirë të jetuari dhe zhvillimi i demokracisë e të drejtave të njeriut, është e nevojshme të merren të gjitha masat edukative për të parandaluar përsëritjen apo mohimin e ngjarjeve shkatërrimtare që kanë ndodhur gjatë këtij shekulli, domethënë Holokaustin, gjenocidin dhe krimet e tjera kundër njerëzimit, spastrimet etnike, dhunimet masive të të drejtave të njeriut dhe të vlerave themelore me të cilat është lidhur në mënyrë të veçantë Këshilli i Evropës. Për këtë qëllim :

- duhet të ndihmohen nxënësit për t'u njohur e ndërgjegjësuar me faktet dhe me shkaqet e tyre që kanë karakterizuar në mënyrën më të errët historinë e Evropës në veçanti dhe atë të botës në përgjithësi;
- duhet të reflektohet mbi ideologjitë që kanë çuar në to dhe mbi mjetet që bëjnë të mundur të shmangjet përsëritja e fakteve të tilla ;
- duhet të orientohen, zhvillohen e bashkërendohen programet e formimit të vazhdueshëm të personelit edukativ në shtetet anëtare të Këshillit të bashkëpunimit kulturor;
- duhet të lehtësohet futja në dokumentacionin që zotërohet për këtë temë, duke përdorur konkretisht burimet e teknologjive të reja dhe të zhvillohet një rrjet qendrash burimore pedagogjike në këtë fushë;
- duhet të sigurohet zbatimi, ndjekja dhe kontrolli i vendimit të ministrave të Edukimit (Krakovi2000) lidhur me caktimin në shkolla të një dite përkujtimore të Holokaustit dhe për parandalimin e krimeve kundër njerëzimit, në përshtatje me historinë e secilit vend anëtar;
- duhet të pasurohet ndihma e veçantë e Këshillit të Evropës në fushën arsimore brenda Task Forces për bashkëpunimin ndërkombëtar lidhur me mësimin e Holokaustit, përkujtimin dhe kërkimin.

7. Formimi paraparak e i vijueshëm i mësuesve të historisë

Formimi i veçantë dhe i vijueshëm i mësuesve të historisë:

- duhet të formojë e të nxisë mësuesit e historisë për të përdorur metoda komplekse për orën e historisë, duke u thelluar në reflektimin dhe duke u mbështetur në kërkimin;
- duhet të synojë që mësuesit e historisë dhe ata që tashmë janë përfshirë në jetën aktive të njohin tërë produktet, mjetet dhe metodat e fundit, veçanërisht përdorimin e teknologjive të informacionit e komunikimit;
- duhet t'i bëjë mësuesit të ndjeshëm për të zbatuar praktika pedagogjike të cilat, mbi bazën e të dhënave faktike dhe përtej tyre, synojnë që nxënësit të arrijnë të interpretojnë e analizojnë faktet historike dhe ndikimin e tyre mbi të tashmen, në kontekste të ndryshme shoqërore, gjeografike, ekonomike, etj.;

- duhet t'i ndihmojë mësuesit të zbatojnë praktika vlerësuese, të cilat mbajnë parasysh jo vetëm të dhënat që memorizojnë nxënësit, por edhe veprimtaritë që ata janë në gjendje të ndërmarrin, mbi bazën e njohjes të të dhënave në fjalë, si kërkimet, debatet apo analizat e çështjeve për diskutim;
- duhet t'i ndihmojë të konceptojnë e të realizojnë në klasa situata mësimi të një natyre ndërdisiplinore, në bashkëpunim me kolegët e tyre.

Duke qenë se teknologjitë e informacionit dhe komunikimit çojnë në shndërrimin e rolit të mësuesve të historisë, është e rëndësishme:

- të krijohen pika këmbimi, me qëllim që mësuesit të njihen me gamën e gjerë të situatave mësimore në të cilat integrohen rolet e reja në fjalë;
- të mbështetet krijimi i grupeve për kapërcimin e vështirësive, ngurrimeve dhe dyshimeve profesionale lidhur me këto praktika të reja pedagogjike;
- të zhvillohen bankat burimore, që paraqesin jo vetëm dokumentet dhe rrjetet e zotëruese, por edhe vlerën e informacioneve të ardhura nga këto burime dhe dokumente.

Me qëllim që të arrihen këto objektiva dhe të përcaktohet profili i veçantë i mësimi të historisë, lypset:

- t'u jepet institucioneve për formimin e mësuesve të historisë mbështetja e nevojshme për të ruajtur e përmirësuar cilësinë e formimit të tyre, dhe për të zhvilluar profesionalizmin, e në mënyrë të veçantë statusin shoqëror të mësuesve të historisë;
- t'i kushtohet vëmendje e posaçme formimit të mësuesve të historisë sipas parimeve që përmban ky rekomandim;
- të nxiten kërkimet krahasuese lidhur me këto objektiva, struktura e norma të formimit të veçantë, paraprak e të vijueshëm të mësuesve të historisë dhe mbi bazën e kësaj, të gjallërohet bashkëpunimi institucional dhe këmbimi i informacioneve sipas nevojave të domosdoshme për reformat e formimit paraprak e të vijueshëm të mësuesve të historisë;
- të krijohen e fuqizohen partneritetet në tërësinë e institucioneve aktive në fushën e formimit të mësuesve të historisë apo që kanë të bëjnë me këtë formim (veçanërisht mediat), me qëllim që të nxirret në pah misioni dhe përgjegjësia e tyre e veçantë.

8. Teknologjitë e informacionit e të komunikimit

Duke respektuar normat ligjore dhe lirinë e shprehjes, lypset të merren masat e nevojshme për luftën kundër përhapjes së përmbajtjeve raciste, ksenofobe apo revizioniste, në mënyrë të veçantë nëpërmjet sistemit Internet.

Në kontekstin e përdorimit shumë të zgjeruar të teknologjive të informacionit dhe komunikimit nga ana e të rinjve, si gjatë jetës së tyre shkollore ashtu edhe jashtëshkollore, ka rëndësi të zhvillohet një pedagogji dhe metodologji që mban parasysh faktin që këto teknologji:

- përbëjnë burimet e pashmangshme në mësimin e historisë;
- shtrojnë çështje themelore, konkretisht atë të besueshmërisë së burimeve;
- u lejojnë mësuesve dhe nxënësve të depërtojnë në burime origjinale dhe interpretime të shumëllojta;
- zgjerojnë më së miri mundësinë për t'u futur në informacione dhe të dhëna historike;
- shumëfishojnë dhe lehtësojnë rastet e bashkëpunimit e të dialogut.

Nga ana tjetër, do duhet gjithashtu të krijohen kushtet e nevojshme që mësuesit:

- të mund t'u vijnë në ndihmë vetë nxënësve, gjatë procesit selektiv, për të vlerësuar besueshmërinë e burimeve të informacionit dhe vetë informacionet si të tilla;
- të mund të bëjnë gjatë orës së mësimin përçarje për analizë kritike, duke u mbështetur në larmi pikëpamjesh dhe interpretimesh ndërkulturore;
- të mund të nxisin nxënësit për të zhvilluar kompetencat e tyre, si analizat kritike dhe arsyetimin nëpërmjet analogjisë.

ⁱ Recommendation Rec(2001)15 of the Committee of Ministers to member states on history teaching in twenty-first-century Europe; Recommendation CM/Rec (2011)6 of the Committee of Ministers to member states on intercultural dialogue and the image of the other in history teaching



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA E SIGURIMIT SË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

PROGRAMET E KULTURËS SË PËRGJITHSHME
TË ARSIMIT TË MESËM PROFESIONAL

Lënda: Gjuhë e huaj e parë

Klasa: XI

Struktura 2+1+1, Struktura 2+2 dhe Blok 4-vjeçar

TIRANË, 2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

**PROGRAMET E KULTURËS SË PËRGJITHSHME
TË ARSIMIT TË MESËM PROFESIONAL**

Lënda: Gjuhë e huaj e parë

Klasa: XI

Struktura 2+1+1, Struktura 2+2 dhe Bllok 4-vjeçar

2024

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT LËNDOR “GJUHË E HUAJ E PARË”

(Klasa XI- Arsimi Profesional për strukturat 2+2; 2+1+1 dhe bllok 4 vjeçar)

1	HYRJE	4
2	KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT LËNDOR “GJUHË E HUAJ”	6
2.1	Qëllimet e programit lëndor “Gjuhë e huaj”	9
2.2	Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës “Gjuhë e huaj”	11
2.3	Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës “Gjuhë e huaj”	15
2.4	Lidhja e lëndës “Gjuhë e huaj” me temat ndërkurrikulare	20
2.5	Lidhja e lëndës “Gjuhë e huaj” me fushat e tjera kurrikulare	21
2.6	Kompetencat e lëndës “Gjuhë e huaj”	22
2.7	Rezultatet e të nxënit	25
2.8	Ndarja e orëve mësimore.....	35
3	UDHËZIME METODOLOGJIKE.....	37
4	UDHËZIME PËR VLERËSIMIN.....	39

Koordinoi programin:

Ludmilla Stefani

1 HYRJE

Lënda “Gjuhë e huaj e parë” (anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht) synon zhvillimin gjuhësor dhe letrar i cili është boshti themelor për rritjen intelektuale, sociale dhe emocionale të nxënësit. Më konkretisht, lënda ‘Gjuhë e huaj e parë’, e aftëson nxënësin në përdorimin e gjuhës për të komunikuar, për të përmbushur interesat e tij personale dhe shoqërore, si dhe për të plotësuar kërkesat e shoqërisë dhe të botës së punës.

Mësimi i gjuhës amtare, i letërsisë dhe i gjuhëve të huaja e ndihmon nxënësin të bëhen individ i pavarur, i lirë, i kulturuar, mendimtar kritik dhe krijues, si dhe i vetëdijshëm për identitetin e tij personal dhe kombëtar. Me anë të leximit të teksteve të letërsisë shqipe dhe asaj botërore (në gjuhën shqipe ose në një gjuhë të huaj), nxënësi zhvillon botën e tij emocionale, pasuron përfytyrimet dhe imagjinatën e tij për botën, çmon dhe vlerëson gjuhët dhe kulturën kombëtare e botërore.

Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” nxit dëshirën, kuriozitetin dhe besimin e nxënësit për t’u bërë komunikues i mirë, lexues aktiv e i pavarur dhe shkruer i saktë, origjinal dhe krijues.

Lënda ‘Gjuhë e huaj’ përbëhet nga “Gjuhë e huaj e parë” dhe “Gjuhë e huaj e dytë”.

Gjuha e huaj e parë fillon në shkallën e parë (klasa I) dhe mësohet deri në shkallën e gjashtë (klasa XII).

Gjuha e huaj e dytë fillon të mësohet në shkallën e tretë (klasa VI) dhe vazhdon deri në shkallën e gjashtë (klasa XII). Si gjuhë e huaj e dytë mund të jetë: gjuha frënge, gjuha italiane, gjuha gjermane, gjuha angleze, etj.

Në shkollat e arsimit profesional gjuha e huaj mësohet deri në klasën XIII.

Kompetencat përcaktohen si njohuri, shkathtësi, vlera dhe qëndrime që nxënësi duhet t’i fitojë gjatë procesit mësimor.

Njohuri është një e vërtetë e arsyetuar dhe e provuar sipas kritereve të përcaktuara, e kodifikuar në tekstet akademike e ato shkollore apo në vepra të specializuara si produkt i një ose disa dijetarëve apo praktikienëve, ndërtim mendor i realizuar nga personi gjatë bashkëveprimit me mjedisin ose nga vetëreflektimi për t'u bërë pjesë e trashëgimisë njohëse të tij, si p.sh., njohuri për llojet e teksteve, njohuri gramatikore, njohuri për hartimin e një prezantimi etj.

Shkathtësi është një kapacitet (mendor/fizik) i fituar për të arritur rezultatet e parashikuara, shpesh me shpenzim minimal të kohës dhe energjisë, ose të të dyjave bashkë. Shkathtësia mund të jetë e përgjithshme ose e veçantë, si: të kuptuarit, të interpretuarit, të menduarit në mënyrë kritike dhe krijuese, zgjidhja e problemeve etj.

Qëndrimet janë një mënyrë e përcaktuar e të menduarit, opinionëve dhe ndjenjave ndaj diçkaje, një ideje, personi ose situatë dhe që ndikojnë në sjelljen e individit. Qëndrimet ndikohen nga njohuritë dhe vlerat dhe janë zakonisht shkaktare të sjelljeve (edhe pse lidhjet mes qëndrimeve dhe sjelljeve nuk janë drejtvizore).

Vlerat janë bindje që ruhen thellë lidhur me çfarë është e rëndësishme ose e dëshirueshme. Ato shprehen nëpërmjet qëndrimeve dhe veprimeve praktike të personave. Disa vlera dhe qëndrime janë respektimi i rregullave të etikës gjatë të folurit, shmangia e fyerjeve dhe paragjykimeve, shpirti i iniciativës, serioziteti, vetëbesimi etj.

Puna për ndërtimin e kompetencave kyçe dhe të lëndës ka nisur që në arsimin bazë. Në këtë nivel arsimit nxënësi është pajisur me njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet e domosdoshme për jetën, shoqërinë dhe për botën e punës. Në arsimin e mesëm të lartë, nxënësi has sfida të reja dhe përdor aftësitë gjuhësore të fituara gjatë shkollimit për të reaguar në situata të njohura dhe jo të njohura për të si në klasë/shkollë ashtu edhe dhe jashtë saj duke mbajtur qëndrime dhe zhvilluar vlera.

2 KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT LËNDOR “GJUHË E HUAJ”

Hartimi i programit lëndor mbështetet në dokumentet kryesore kurrikulare: korniza kurrikulare, kurrikula bërthamë dhe plani mësimor i kulturës së përgjithshme për Arsimin Profesional.

Programi shoqërohet me udhëzues dhe dokumente të tjera në ndihmë të mësuesve dhe të hartuesve të teksteve mësimore.

Përdoruesit e programit janë mësuesit, autorët e teksteve, specialistët e arsimit dhe fakultetet e mësuesisë.

Mësuesit do ta përdorin programin e gjuhës së huaj për të krijuar një tablo të qartë rreth asaj se çfarë duhet të nxëjë nxënësi dhe se si duhet të ndërtojnë mësimdhënien për të pajisur nxënësin me kompetencat kyçe dhe ato të lëndës, si dhe për të përmbushur kërkesat e programit. Ky program i ndihmon mësuesit të reflektojnë mbi praktikën e tyre të mësimdhënies dhe të koordinojnë punën dhe përpjekjet e tyre për të përmbushur nevojat e nxënësit në të kuptuarin e lëndës dhe përdorimin praktik të saj edhe jashtë ambienteve shkollore, pasi mësuesit janë modele të cilat nxënësi ndjek në të ardhmen. Mësuesit do ta përdorin këtë program për të përcaktuar e monitoruar objektivat e vendosura për t'u përmbushur nga nxënësi në klasë, në shkollë si edhe në një raport më të gjerë.

Autorët e teksteve do ta përdorin programin lëndor për të hartuar tekste që janë në funksion të realizimit të tij. Leximi i kujdesshëm i programit për çdo shkallë dhe klasë do t'i ndihmojë ata për të siguruar koherencën dhe për të shmangur ngarkesën e panevojshme.

Specialistët e arsimit mund ta përdorin programin lëndor për qëllime inspektimi, monitorimi, vlerësimi, studimi etj. Vlerësuesit e sistemit arsimor do të mbështeten në këtë program për të parë përmbushjen e standardeve lëndore të përcaktuara për këtë klasë.

Fakultetet e mësuesisë mund ta përdorin programin lëndor për të përshtatur kurrikulat e tyre me qëllim përgatitjen efektive të mësuesve të ardhshëm, si dhe për praktikën pedagogjike të studentëve.

Përfituesit e programit janë: nxënësit, prindërit dhe komuniteti.

Nxënësi përfiton të nxënit progresiv, zbaton shprehinë njohurisë, veprimtarisë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat në lëndën përkatëse dhe bëhet përdorues i mirë i gjuhës.

Prindërit dhe komuniteti mund të informohen për kompetencat që duhet të zotërojnë fëmijët e tyre në lëndën e gjuhës së huaj.


Programi lëndor “Gjuhë e huaj e parë” ka në fokus realizimin e kompetencave kyçe dhe të kompetencave të lëndës. Gjatë punës për përmbushjen e kompetencave kyçe dhe kompetencave të lëndës, nëpërmjet gjuhës së huaj do të realizohen temat ndërkurrikulare, të cilat mundësojnë lidhjen e lëndës me jetën e përditshme, shoqërinë dhe botën e punës. Në program, gjithashtu, përshkruhet lidhja e gjuhës së huaj me fushat e tjera, në mënyrë që formimi i nxënësit të mos jetë fragmentar, por tërësor dhe t’i shërbejë formimit të tij të gjithanshëm.

Realizimi i programit në lëndën e gjuhës së huaj mundëson krijimin e një mjedisi të nxëni të përshtatshëm, inkurajues, motivues, gjithëpërfshirës dhe të pasur me material të domosdoshme burimore duke përdorur sa më gjerë dhe në mënyrë efektive TIK.

Në program janë përcaktuar njohurisë, aftësitë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet për çdo kompetencë të lëndës si edhe për çdo veprimtari, aftësi dhe shkathtësi gjuhësore që kryen nxënësi për formimin dhe konsolidimin e kompetencave.

Gjithashtu programi i jep mundësinë mësuesit të jetë krijuar dhe inovativ në punën e tij duke përdorur metodat, strategjitë dhe përjasjet më bashkëkohore në procesin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit. Po kështu, në program janë sugjeruar edhe orët mësimore në përqindje për njohurisë që do merren gjatë vitit shkollor.

Diagrami i mëposhtëm paraqet se si programi i gjuhës së huaj është pjesë integrale e Kornizës Kurrikulare e cila synon një mësimdhënie me në qendër nxënësin, zhvillimin dhe përgatitjen e tij për t'u bërë anëtar i shoqërisë së dijes.



Diagrami 1: Korniza Konceptuale e Programit Lëndor “Gjuhë e huaj”

2.1 Qëllimet e programit lëndor “Gjuhë e huaj”

Lënda e gjuhës së huaj në arsimin e mesëm profesional ka si qëllim që nxënësi:

- të ndërgjegjësohet për aspektet kulturore dhe të reflektojë mbi ndryshimet mes praktikave kulturore të vendit ku flitet gjuha e huaj dhe kulturës amtare duke analizuar aspekte të kulturës që studion siç janë institucionet shoqërore dhe politike;
- të zhvillojë më tej aftësinë komunikuese dhe përdorimin e njohurive gjuhësore në situata praktike të jetës së përditshme, për të hulumtuar dhe dhënë përgjigje e argumente për çështje të interesit të tij;
- të respektojë traditat dhe vlerat e kulturave të ndryshme;
- të forcojë ndërveprimin në situata reale dhe jashtëshkollore, lidhur me tematikën e trajtuar në situatat mësimore dhe të shkëmbejë informacione të detajuara mbi tema që paraqesin interes për të për të qenë i përgatitur për tregun e punës;
- të konsolidojë bashkëveprimin ndërmjet punës në grup dhe punës së pavarur individuale dhe krijuese edhe me folës të gjuhës të cilën ai mëson;
- të thellojë njohuritë gjuhësore, perceptuese dhe shprehëse, përmes të cilave ai zgjeron njohuritë për botën dhe tregun e punës dhe në të njëjtën kohë formohet intelektualisht;
- të zhvillojë rrjedhshmërinë në gjuhën e huaj përmes praktikës së vazhdueshme të përshtatshme për moshën, interesat dhe nivelin e tij gjuhësor.

Programi lëndor “Gjuhë e huaj e parë” për klasën XI, i hartuar në përputhje me Kurrikulën Kombëtare të Gjuhëve Moderne për Arsimin Publik Parauniversitar (viti 2000), si dhe në përputhje me Kuadrin e Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët (KPER), synon të arrijë dhe të

realizojë standardet e mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit me qëllim që t'i përgjigjet një shoqërie të hapur sipas kërkesave dhe nevojave që shtrohen përpara mësimin dhe përvetësimit të gjuhës së huaj në vendin tonë. Ky program përfshin njohuritë gjuhësore, ndërlëndore dhe ndërkulturore të përfituara ndër vite.

Lënda e gjuhës së huaj ka për mision aftësimin dhe orientimin e nxënësit për të vepruar në situata të ndryshme komunikimi në këtë gjuhë. Ajo ka për detyrë të zhvillojë te nxënësi aftësitë e gjuhës gjatë përdorimit të saj dhe ta edukojë atë me të kuptuarin, pranimin dhe vlerësimin e kulturës dhe mënyrës së jetesës së popujve të tjerë. Programi hartohet mbi interesat dhe karakteristikat e grupmoshës dhe ndihmon në zhvillimin intelektual dhe socio-kulturor të nxënësit duke e bërë atë të pavarur dhe të aftë të përballojë të nxënit gjatë gjithë jetës. Nxënësi, gjithashtu, mëson dhe bindet se gjuha e huaj, si një subjekt aftësish dhe komunikimi, kërkon kohë dhe praktika të shumëllojshme komunikimi për t'u përvetësuar. Si lëndë akademike, gjuha e huaj është një lëndë kulturash dhe aftësish.

Niveli gjuhësor i gjuhës së huaj në klasën e XI të arsimit profesional, bazohet mbi njohuritë dhe konceptet e marra në klasat paraardhëse si dhe në konsolidimin e mëtejshëm të kompetencave kyçe dhe ato të lëndës për këtë shkallë. Nxënësi në këtë klasë forcon aftësinë e tij të të qenit i pavarur në përdorimin e gjuhës së huaj. Ai forcon njohuritë e B1+. Tiparet kryesore janë ato të B1 (a. aftësia për të marrë pjesë në një bisedë b. të qenit fleksibël në përballje me problemet që dalin në jetën e përditshme) por duke shtuar sasinë e informacionit dhe njohurive që merren.

Më poshtë jepet përshkrimi i nivelit B1 i cili i referohet shkallës globale të Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët.

Përdoruesi i pavarur	B 1	Mund të kuptojë çështjet kryesore të një informacioni standard të qartë për çështje të njohura që hasen rregullisht në shkollë, punë, argëtim etj. Mund t'ia dalë në situata të shfaqura gjatë një udhëtimi në vende ku flitet gjuha që mëson. Mund të prodhojë material të thjeshtë për tema të njohura ose të një fushe të interesit personal.
-----------------------------	------------	---

		Mund të përshkruajë përvoja dhe ngjarje, ëndrra, shpresa dhe ambicie dhe shkurtimisht jep arsye dhe shpjegime për opinionet dhe planet.
--	--	---

Interesat dhe tematikat në këtë program do të jenë të shumëllojshme (jeta personale e shoqërore, jeta në shkollë e në punë, bota rreth nesh, bota e komunikimit etj.), pasi shkalla e ndërgjegjësimit të nxënësit për domosdoshmërinë e mësimit të gjuhës së huaj është më e lartë dhe lidhet me problemet e formimit të tij si qytetar bote. Gjithashtu mësuesi në këto shkolla duhet të bëjë pjesë të mësimdhënies tema dhe situata të të nxënit të cilat lidhen me profesionin për të cilin nxënësi është duke studiuar duke e aftësuar atë për karrierë të suksesshme në tregun e punës.

2.2 Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës “Gjuhë e huaj”

Realizimi i kompetencave kyçe të Kornizës Kurrikulare gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies kërkon që mësuesi të lidhë kompetencat kyçe me kompetencat e fushës dhe të lëndës për secilën shkallë. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë metodat, teknikat dhe mjetet e përshtatshme didaktike për realizimin e çdo kompetence dhe rezultati të të nxënit. *Kompetenca përcaktohet si harmonizim i njohurive, shkathësive, vlerave dhe qëndrimeve për të trajtuar plotësisht situatat e kontekstit.* Kur nxënësi përmbush kompetencat gjuhësore, ai njëkohësisht është duke zhvilluar edhe kompetencat kyçe. P.sh., gjatë prezantimeve të ndryshme në orët mësimore të kompetencës së të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar, nxënësi përdor edhe mjetet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit dhe realizon kështu edhe kompetencën digjitale. Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës ku bën pjesë lënda e gjuhës së huaj, pasqyrojnë të njëjtën qasje me rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe në këndvështrimin e domosdoshmërisë së tyre në jetë, shoqëri dhe punë.

Gjithashtu e parë në kontekstin e anasjelltë nxënësi ndihmohet nga kompetencat kyçe për të përmbushur sa më mirë kompetencat specifike të lëndës dhe për të realizuar veprimtaritë gjuhësore. Si p.sh kur nxënësi lexon një tekst ai nuk bazohet vetëm tek kompetenca gjuhësore por edhe tek

kompetenca e të menduarit ose ajo qytetare bazuar në llojin e tekstit që lexon, ose nëse nxënësi lexon një tekst si pjesë e një programi të të mësuarit ai bazohet te kompetenca e të mësuarit për të nxënë.

Një tjetër shembull do të ishte edhe zhvillimi i një projekti gjatë orës mësimore. Nëse nxënësi bën një projekt si temë mësimore në këtë rast ai jo vetëm zhvillon kompetencat e tij gjuhësore, por gjithashtu kompetencat digjitale dhe qytetare, në varësi të tematikës që ai shtjellon.

Përfaqja e adoptuar nga Kuadri i Përbashkët Evropian i Referencave për Gjuhët (KPER) është e orientuar drejt veprimit pasi përdoruesi i gjuhës ose nxënësi konsiderohet si “aktor shoqëror” d.m.th. pjesëtar i shoqërisë i cili ka detyra për të përmbushur (të cilat nuk janë vetëm gjuhësore) në rrethana dhe në një mjedis të caktuar dhe brenda një fushe të caktuar veprimi. Komunikimi realizohet nëpërmjet aktiviteteve gjuhësore të cilat janë pjesë e një konteksti më të gjerë shoqëror që ju jep atyre kuptim të plotë. Përfaqja vepruese merr gjithashtu parasysh burimet njohëse, emocionale, të vullnetshme si edhe tërësinë e aftësive që zotëron dhe vë në jetë çdo individ si një aktor shoqëror.

Në bazë të kësaj përfaqseje çdo formë përdorimi dhe nxënieje e një gjuhe mund të përkufizohet si më poshtë.

Përdorimi i një gjuhe, duke përfshirë edhe nxënien e saj, përfshin veprime të kryera nga njerëzit, të cilët si individë dhe si aktorë shoqërorë zhvillojnë një numër kompetencash kyçe dhe në veçanti kompetencën e komunikimit gjuhësor. Nxënësi vë në zbatim kompetencat që zotëron në kontekste dhe kushte të ndryshme dhe kalon vështirësitë për t'u përfshirë në veprimtari gjuhësore të cilat përfshijnë proceset gjuhësore që mundësojnë kuptimin dhe prodhimin e teksteve që lidhen me tema dhe fusha specifike duke mobilizuar strategjitë më të përshtatshme për përmbushjen e detyrave që duhen realizuar. Monitorimi i këtyre veprimeve nga vetë nxënësi çon në përfortimin ose përmirësimin e kompetencave. Kjo përfaqje ilustron në figurën e mëposhtme.




Figura 1:


Të mësuarit dhe përdorimi i gjuhës së huaj

Kompetencat kyçe nuk lidhen vetëm me gjuhën por kanë të bëjnë me çdo lloj veprimtarie duke përfshirë edhe ato gjuhësoret.

Më konkretisht, për të realizuar lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës mësuesi ndjek këto hapa:

- përzgjedh rezultat/et e të nxënit për kompetencat kyçe që synon të arrijë nxënësi në shkallën dhe klasën përkatëse;
- përzgjedh rezultat/et e të nxënit për kompetencat specifike të lëndës që synon të arrijë nxënësi në shkallën dhe klasën përkatëse;
- përshtat rezultat/et e të nxënit për çdo fushë veprimtarie dhe mënyre të marrjes së gjuhës (me shkrim dhe me gojë): **marrja e informacionit** (të lexuarit, të dëgjuarit), **ndërveprimi** (të folurit ndërveprues, të shkruarit ndërveprues), **produkti** (produkti i të folurit, produkti i të shkruarit) dhe **ndërhyrja** (përmbledhja, interpretimi, perifraximi, përkthimi etj.);
- përzgjedh përmbajtjen/et mësimore, mjetet didaktike, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënit;
- planifikon mësimdhënien duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do t'i arrijë rezultatet e të nxënit brenda vitit shkollor;
- kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave, projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënit për vit mësimor dhe shkallë për fushën “Gjuhët dhe komunikimi”.

diagrame i mëposhtëm konkretizon lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës të cilat së bashku i ofrojnë nxënësit informacionin në mënyrë efektive dhe bëjnë që nxënësi të përforcojë hap pas hapi arritjet e tij për të lexuar, shkruar dhe komunikuar duke i bërë funksionale dhe të qëndrueshme aspekte të ndryshme të informacionit, kulturës, shkencës dhe teknologjisë.



Diagrami 2: Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës “Gjuhë e huaj”

2.3 Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës “Gjuhë e huaj”

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit

Nxënësi:

- diskuton në grup në mënyrë konstruktive në jo më shumë se 10 minuta, duke dhënë dhe duke marrë informacion për një temë të caktuar nga fushat mësimore ose nga jeta e përditshme;
- transmeton saktë të dhënat e mbledhura për një temë konkrete në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit;
- lexon rrjedhshëm një tekst të njohur në gjuhë të huaj të përbërë prej disa paragrafësh;
- tregon me shembuj konkretë disa nga ngjashmëritë ndërmjet strukturës së fjalisë së gjuhës së huaj dhe gjuhës amtare;
- analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun e përshtatshëm;
- shkruan një tekst në gjuhë të huaj për një temë nga jeta e përditshme, me tre-pesë paragrafë, duke respektuar strukturën, drejtshkrimin dhe elementet e tjera, pastaj e prezanton para të tjerëve me shqiptim të saktë;
- përdor drejt strukturën dhe rregullat standarde të drejtshkrimit të gjuhës së huaj në kontekste dhe forma të ndryshme të shkrimit, si: ese, e-mail (postë elektronike), letra formale dhe joformale etj.;
- përshkruan me gojë dhe me shkrim një ngjarje të lexuar ose të dëgjuar duke ruajtur rrjedhën logjike të saj;
- përdor TIK-un në mënyrë efektive gjatë komunikimit dhe ndërveprimit me të tjerët në jetën e përditshme, duke përfshirë edhe të nxënit e informacioneve të reja dhe kryerjen e detyrave shkollore;
- prezanton para të tjerëve një projekt për një temë të dhënë, të përgatitur vetë ose në grup, duke gërshetuar format e komunikimit verbal dhe elektronik, si dhe veprimin praktik.

Kompetenca e të menduarit

Nxënësi:

- përzgjedh dhe klasifikon informacionin nga burime të ndryshme në bazë të një kriteri të caktuar për një temë konkrete dhe e përdor për marrjen e një vendimi apo për zgjidhjen e një problemi/detyre;
- prezanton në forma të ndryshme të të shprehurit, mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacionit për një temë të caktuar, ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse (p.sh., temë nga kultura, nga arti, nga sporti, nga shëndetësia, nga shoqëria, nga mjedisi etj.);
- krahason të paktën tri burime të ndryshme informacioni për trajtimin e një teme, argumenton saktësinë, rrethanat, gjen ngjashmëritë dhe dallimet duke u bazuar në kriteret e përcaktuara më parë, i prezanton gjetjet kryesore para të tjerëve në forma të ndryshme shprehëse, duke përdorur teknologjinë e informacionit;
- përpunon idenë e vet në një projekt me shkrim për një çështje të caktuar duke propozuar qëllimin, aktivitetet kryesore, afatet, vendin, personat, materialet dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e tyre;
- modelon zgjidhjen e një problemi të dhënë (në klasë apo jashtë saj) për një temë të caktuar, duke e zbërthyer në hapa të vegjël dhe jep sqarime të nevojshme për hapat e ndjekur në zgjidhjen e problemit, duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit;
- argumenton ndërmarrjen e hapave konkretë, të cilët çojnë në përfundimin e një detyre/veprimtarie, në zgjidhjen e një problemi, të ndonjë punimi në klasë/shkollë;
- simulon një situatë për marrjen e një vendimi për jetën e vet ose zgjidhjen e një problemi me interes shoqëror, lidh vendimin me pasojat në mënyrë të përgjegjshme, e prezanton gjatë një debati me moshatarë në një kohëzgjatje të caktuar, duke u bazuar në këtë përvojë, merr vendime dhe iniciativa të dobishme për vete, për shkollën dhe më gjerë.

Kompetenca e të nxënësve

Nxënësi:

- demonstroi shkathtësi në lexim, shkrim dhe komunikim për përmbushjen e kërkesave të ndryshme në kryerjen e një detyre ose aktiviteti;

- regjistron në formë të shkruar, grafike, etj., informacionin/faktet për një temë;
- shfrytëzon në mënyrë efektive përvojat paraprake gjatë zgjidhjes së situatave të ndryshme në jetën e përditshme apo gjatë kryerjes së ndonjë detyre, aktiviteti në gjuhë të huaj;
- shfrytëzon në mënyrë efektive fjalorët, enciklopeditë dhe teknologjinë informative apo burime të tjera për zhvillimin e një ideje /projekti me bazë klase/shkolle ose jashtë saj;
- diskuton dhe ndan përvojat me të tjerët për mënyrat më praktike të shfrytëzimit të përvojave paraprake në arritjen e dijeve të reja;
- paraqet idetë personale para të tjerëve për mënyrën e zhvillimit të një aktiviteti të caktuar, duke dhënë mendime të argumentuara për rezultatet e pritura (në formë skice, grafiku, vizatimi, shkrimi, vepra artistike etj.);
- shfrytëzon në mënyrë të efektshme teknika të ndryshme gjatë të nxëniet të temës së dhënë duke klasifikuar informacionin e njohur nga ai i panjohur, si dhe atë që është i paqartë;
- parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuar për zgjidhjen e një problemi apo detyre të një teme të caktuar;
- përdor elementet e portofolit personal për vetëvlerësimin dhe identifikimin e anëve të forta, i shfrytëzon ato për përparimin në mësimet dhe për orientimin për karrierë;
- shfrytëzon, në mënyrë të pavarur dhe efektive, teknologjinë e informacionit dhe burimet e tjera të informimit për të mbledhur materiale për zgjidhjen e një problemi apo detyre të caktuar, të cilat më pas i analizon, i klasifikon dhe i paraqet para të tjerëve përmes TIK-ut dhe ndonjë forme tjetër të shprehjes.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

Nxënësi:

- përgatit një autobiografi ku prezanton veten me shkrim ose me gojë para të tjerëve, duke vënë theksin te aftësitë, dëshirat, dhe mundësitë, referuar qëllimeve apo projektit individual për karrierën;

- demonstroi shprehje organizative në punët individuale dhe në grup përmes situatave reale në detyrat e veçanta mësimore ose në veprimtari për jetën, për punën dhe për mjedisin, duke menaxhuar potencialin individual dhe atë të grupit;
- harton një projekt me faza të menaxhuara mirë (individualisht ose në grup) duke shkëmbyer, konsultuar dhe informuar të tjerët, si dhe duke identifikuar dhe duke vlerësuar burimet njerëzore, materiale dhe informative, në përputhje me rezultatet e pritshme;
- merr pjesë në aktivitete të ndryshme në nivel klase, shkolle dhe më gjerë (p.sh., konkurse, gara sportive, aktivitete kulturore dhe muzikore etj.), diskuton me të tjerët për rezultatet e arritura dhe për procesin e organizimit, si dhe jep argumente të ndryshme shprehëse se si të rritet pjesëmarrja në aktivitete dhe se si të përmirësohet procesi i organizimit të tyre;
- përdor materiale, burime të ndryshme informimi dhe teknologjinë në shkollë dhe në jetën e përditshme si ndihmë për përparimin në mësim;
- identifikon burime të ndryshme informacioni për arsimim dhe orientim profesional, si dhe zhvillon një plan individual për zhvillimin e karrierës së tij;
- diskuton me një fjalor të thjeshtë për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë, në shkollë dhe mjedise të tjera në një situatë të caktuar, duke prezantuar idetë nëpërmjet shembujve konkretë.

Kompetenca personale

Nxënësi:

- analizon përparësitë dhe dobësitë personale, duke i evidentuar masat përmes të cilave synon të mbështesë zhvillimin personal, në përparësitë që ka dhe masat përmes të cilave synon të përmirësojë dobësitë personale;
- merr pjesë aktivisht në lojëra, debate apo në veprimtari të tjera në klasë dhe në mënyrë konstruktive menaxhon emocionet e veta;
- bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) drejt arritjes së një qëllimi të përbashkët. (projekti/ aktiviteti në bazë klase /shkolle apo jashtë saj);

- ilustron me shembuj para të tjerëve, modelet dhe praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe me gjerë;
- analizon veprimet e veta dhe të kolegëve gjatë një situatë konflikti, duke propozuar alternativa për zgjidhje të drejtë e pa pasoja duke ndarë përvojat, mendimet dhe ndjenjat me anëtarët e grupit;
- gjykon mënyrën e komunikimit, të sjelljeve dhe të qëndrimeve që nxisin konflikte ndërpersonale në klasë, në shkollë apo në shoqëri, duke vënë theksin në faktorët që kanë ndikuar në shfaqjen e saj dhe jep shembuj të menaxhimit dhe të zgjidhjes së konflikteve ndërpersonale në mënyrë konstruktive.

Kompetenca qytetare

Nxënësi:

- shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët, për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar;
- demonstroi veprime të ndryshme që shprehin tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve në komunitetin ku jeton (në klasë, në shkollë, në lagje dhe me gjerë) dhe i shpjegon ato në një debat me të tjerët;
- përgatit në grup një aktivitet dhe drejton forma të ndryshme të diskutimit për pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes demokratike dhe tregon tolerancë dhe respekt për pyetjet dhe komentet e të tjerëve;
- praktikon të drejtat dhe detyrimet si qytetar në situata konkrete të jetës së përditshme, në klasë, shkollë, komunitet ose gjatë diskutimit dhe respektimit të mendimit të tjetrit;
- reagon ndaj personave të cilët shkelin, cenojnë ose mohojnë të drejtat e të tjerëve si dhe arsyeton pasojat e këtyre veprimeve për individin, grupin dhe komunitetin;
- diskuton me të tjerët dhe paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj., si dhe jep propozime për zgjidhjen e ndonjë problemi në komunitet e më gjerë, në një fushë të caktuar;

- demonstroi me sjelljen e tij, me detyra, projekte dhe prezantime shembuj të mbrojtjes së mjedisit natyror dhe propozon alternativa se si të gjithë qytetarët mund të kontribuojnë në mënyra të ndryshme për këtë proces;
- përshkruan dhe shpjegon të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e pjesëtarëve të grupit, dallon rastet kur hyjnë në konflikt me njëri-tjetrin dhe paraqet alternativa të zgjidhjes së tyre.

Kompetenca digjitale

Nxënësi:

- përdor TIK-un për të lehtësuar procesin e të nxënës dhe për të rritur efektivitetin në mësimdhënie;
- përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive;
- bashkëpunon me moshatarët e tij duke përdorur mjetet digjitale për të përpunuar, krijuar, realizuar dhe demonstruar tema mësimore nëpërmjet pjesëve të filmuara apo të animuara, për të trajtuar tema mësimore, për të zgjidhur çështje dhe probleme që mund të lindin në shkollë dhe jashtë saj;
- zhvillon aftësitë krijuese, duke zbatuar njohuritë e marra në shkencën kompjuterike dhe mediat digjitale;
- diskuton për avantazhet dhe disavantazhet e përdorimit të teknologjive në jetën e individit, shoqërisë apo komunitetit.

2.4 Lidhja e lëndës “Gjuhë e huaj” me temat ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore, me të cilat përballet shoqëria tani dhe në të ardhmen. Ato integrojnë fushat e të nxënës, të cilat ndihmojnë nxënësin të interpretojë botën dhe të lidhë dijet e marra në shkollë me jetën dhe interesat e tij. Në Kornizën Kurrikulare dhe në Kurrikulën Bërthamë të AML janë përcaktuar temat ndërkurrikulare, të cilat janë:

- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.
- Të drejtat e njeriut.
- Vendimmarrja morale.

- Zhvillimi i qëndrueshëm.
- Mjedisi.
- Ndërvarësia.
- Bashkëjetesa paqësore.

Gjuha e huaj zhvillon te nxënësi njohjen e vlerësimit të kulturës dhe traditës botërore dhe kultivon identitetin dhe krenarinë kombëtare. Tema si: të drejtat e njeriut, vendimmarrja morale, mjedisi, zhvillimi i qëndrueshëm etj. mund të realizohen gjatë orëve mësimore ku mësuesi mund të krijojë situata të të nxënësve gjatë të cilave nxënësi shpreh në formë të ndryshme (ese, poezi, tregime dhe krijime të tjera me tematikë çështjet e mësipërme) mendimet e tij të pavarura dhe të mbështetura me argumente dhe shembuj nga jeta e përditshme.

Punët në grupe dhe projektet që zhvillohen në lëndën e gjuhës së huaj, ndihmojnë në krijimin e aftësive të nxënësit për të jetuar në mënyrë paqësore me të tjerët, me natyrën dhe për të promovuar detyrat dhe të drejtat e individit në një shoqëri të lirë dhe demokratike si dhe për të promovuar historinë e kulturën e kombit të tij dhe të vendit gjuhën e të cilit mëson.

2.5 Lidhja e lëndës “Gjuhë e huaj” me fushat e tjera kurrikulare

Programi lëndor “Gjuhë e huaj e parë” mbështetet në integrimin ndërlëndor. Gjuha e huaj e pajis nxënësin me njohuri, aftësi dhe shkathtësitë që sigurojnë suksesin e tij edhe në fushat dhe lëndët e tjera. Kompetencat gjuhësore janë kompetenca që ndihmojnë nxënësin në procesin e të nxënësve në të gjitha fushat kurrikulare. Konceptet e njohuritë gjuhësore trajtohen e mësohen më mirë në kontekste të caktuara kuptimore dhe ligjërimore, të cilat lidhen ngushtë me fusha tematike të parashtruara në programin e gjuhës së huaj dhe të trajtuara në lëndët e tjera.

Nxënësi zgjeron fjalorin dhe zhvillon aftësinë e të shprehurit qartë me shkrim dhe me gojë në fushat e tjera.

Gjuha e huaj mundëson nxënësin që të kuptojë dhe analizojë tekste ose mesazhe të ndryshme. Duke lexuar tekste të fushave të ndryshme (gjeografi, qytetari etj) nxënësi zgjeron njohuritë për atë fushë. Leximi dhe analiza e teksteve letrare ndikon në të kuptuarin e ngjarjeve dhe figurave historike si dhe të vlerave shoqërore. Me fushën shoqëria dhe mjedisi janë të lidhura tema si: miqësia, marrëdhëniet familjare, marrëdhëniet në shkollë, koha e lirë, festat etj.


Duke përvetësuar aktet dhe funksionet gjuhësore nxënësi mëson si të komunikojnë me të tjerët në mënyrë korrekte dhe gramatike të saktë. Gjithashtu përvetësimi i mirë i gjuhës së huaj ndihmon nxënësin të zhvillojë më tej punën e tij kërkimore në fushat e tij të interesit (histori,shkenca, matematikë etj) pasi shumë materiale gjenden në gjuhë të huaj. Integrimi i i lëndëve të tjera në gjuhën e huaj ndihmon jo vetëm në lidhjen ndërlëndore por edhe në pasurimin e një leksiku më specifik dhe përdorimin e tij. Lidhja me *shkencat natyrore* p.sh. matematikës dhe gjuhës së huaj shprehet në mësimin numrave, veprimeve matematikore (mbledhja e zbritja, shumëzimi dhe pjesëtimi).

Në lëndën e biologjisë, lidhja bëhet e qartë duke trajtuar tema, si: pjesët e trupit, ushqyerja, shëndeti, mjedisi. Me artet janë të lidhura ngushtë temat mbi sportin, muzikën, modën, pikturën etj. Lidhja me lëndën e TIK-ut, përmes së cilës nxënësi aftësohet të përdorë internetin, e-mail-in, programe të ndryshme, platforma digjitale, aplikacione etj., ndihmon atë të eksplorojë të reja mbi botën që po studion, të prezantojë sa më bukur dhe në mënyrë logjike idetë dhe opinionet e tij dhe të marrë informacion në kohë reale. Më konkretisht, kjo lidhje jepet në diagramin e mëposhtëm.

2.6 Kompetencat e lëndës “Gjuhë e huaj”

Kompetencat e komunikimit gjuhësor janë ato të cilat e fuqizojnë një person të veprojë duke përdorur specifikisht mjetet dhe mënyrat gjuhësore.

Për të realizuar qëllimet komunikuese, nxënësi mobilizon të gjitha kapacitetet e tij dhe i kombinon ato me kompetencën e komunikimit gjuhësor. Kompetenca e komunikimit gjuhësor është një sintezë e njohurive të parimeve bazë gramatikore, e njohurive se si gjuha përdoret në ambiente shoqërore për të kryer funksionin komunikues dhe e njohurive se si funksionet komunikuese kombinohen me parimet e ligjëritimit.



Diagrami 3: Lidhja e lëndës “Gjuhë e huaj” me fushat e tjera kurrikulare

Përshkrimi i kompetencave të lëndës

Kompetenca e komunikimit gjuhësor përbëhet nga kompetencat e mëposhtme:

Kompetenca gjuhësore nënkupton përvetësimin e rregullave gramatikore, semantike, fonetike, ortografike si dhe pasurimin e fjalorit.

Kompetenca socio-gjuhësore ka të bëjë me dimensionin shoqëror të gjuhës dhe i referohet të mësuarit të akteve të ndryshme të ligjërimit dhe komunikimit në kontekste të ndryshme shoqërore. Këto kontekste kanë të bëjnë me statusin shoqëror, gjininë, moshën e nxënësit si dhe me faktorë të tjerë që influencojnë në stilin dhe regjistrat e gjuhës. Zhvillimi i kësaj kompetence është shumë i rëndësishëm pasi në situata të ndryshme duhen përdorur lloje të ndryshme shprehjesh si edhe duhen mbajtur qëndrime, besime, vlera dhe pikëpamje të ndryshme.

Kompetenca pragmatike ka të bëjë me njohjen e rregullave dhe parimeve sipas të cilave mesazhi komunikues organizohet dhe strukturohet (zhvillimi i temës, lidhja logjike e ideve, koherenca e mendimeve) dhe realizimin e funksioneve komunikuese (kërkimi i informacionit, dhënia e këshillës, kërkimi për ndihmë, rënia dakord, përshëndetjet etj.).

Dy faktorë cilësorë të cilët përcaktojnë suksesin e nxënësit në realizimin e funksioneve komunikuese janë:


- a. Rrjedhshmëria
- b. Saktësia e të shprehurit

Duke u bazuar tek kompetencat kyçe dhe ato të komunikimit gjuhësor, nxënësi përdor aftësi dhe strategji të përshtatshme për përmbushjen e detyrave në veprimtaritë gjuhësore (me shkrim dhe me gojë): marrja e informacionit (të lexuarit, të dëgjuarit), ndërveprimi (të folurit ndërveprues, të shkruarit ndërveprues), produkti (produkti i të folurit, produkti i të shkruarit) dhe ndërhyrja (përmbledhja, interpretimi, perifrazimi, përkthimi

etj.). Kryerja e vazhdueshme e veprimtarive gjuhësore bën që nxënësi të forcojë aftësitë dhe shkathtësitë e **të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit.**

Lidhja midis aftësive, shkathtësive, veprimtarive dhe kompetencave mund të shihet si një lidhje burimore ku nxënësi gjen tek kompetencat mjetet për të realizuar veprimtaritë, por këto të fundit modifikohen dhe shtohen gjatë procesit të komunikimit. Një numër i kufizuar kompetencash i lejon nxënësit të kryejë një numër shumë të madh veprimtarish. Të kuptuarit e këtij dallimi është thelbësor për të bërë të suksesshëm procesin e të mësuarit dhe të nxënimit të gjuhëve.

Përdorimi i gjuhës veçanërisht në ndërveprim me të tjerët lejon përvetësimin e gjuhës, e cila në vetvete përfshin zhvillimin e kompetencave. Të mësuarit e pakontekstualizuar të kompetencave (si p.sh mësimi i rregullave gramatikore) e ndihmon nxënësin, por nuk është i mjaftueshëm për të përdorur gjuhën si një mjet komunikimi.



Diagrami 4: Lidhja e kompetencave të lëndës “Gjuhë e huaj” me veprimtaritë, aftësitë dhe shkathtësitë gjuhësore

2.7 Rezultatet e të nxënit

KOMPETENCA		REZULTATET
GJUHËSORE Nxënësi e zotëron gjuhën në atë mënyrë që mund të përshkruajë situata të paparashikuara, të shpjegojë pikat kryesore të një ideje ose problemi me saktësi dhe të shprehë mendimet mbi tema abstrakte dhe kulturore si muzika, filmat etj.	Fjalori	Nxënësi zotëron fjalor të mjaftueshëm për të përshkruar situata të njohura dhe të paparashikuara, shpjegon me saktësi por ndonjëherë edhe me hezitim pikat kryesore të një problemi duke përdorur edhe fjali të përbëra. Nxënësi ka fjalor të mjaftueshëm për t'u shprehur rreth fushave të tij të interesit si familja, interesat, dëshirat, udhëtimet, puna dhe ngjarjet aktuale. Nxënësi demonstroi me saktësi leksikore relativisht të lartë por akoma bën gabime kur shpreh mendime mbi situata të vështira dhe të panjohura për të.
	Saktësia gramatikore	Nxënësi tregon relativisht një shkallë të lartë kontrolli dhe komunikoni me saktësi gramatikore në kontekste të njohura si edhe nuk bën gabime që të çojnë në keqkuptime të asaj që do të shprehë. Ndonjëherë nxënësi mund të ndikohet nga gjuha amtare.
	Fonetika	Nxënësi është i qartë në të folur dhe në shqiptimin e fjalëve megjithëse ka raste të pakta kur shqiptimi nuk është i saktë.
	Ortografia	Nxënësi krijon tekste të gjata dhe shkruan pothuajse pa gabime dhe është i saktë në përdorimin e shenjave të pikësimit pavarësisht se ndonjëherë mund të tregojë ndikime të gjuhës amtare.
SOCIO-GJUHËSORE	Aktet e ligjërimit dhe komunikimit	Nxënësi kryen dhe ju përgjigjet një game të gjerë funksionesh gjuhësore duke përdorur shprehjet e zakonshme të një regjistri neutral. Nxënësi njih rregullat e mirësjelljes dhe vepron në mënyrë të përshtatshme me to. Nxënësi shprehet qartë në

		situatë të ndryshme dhe shmang gabimet në formulimin e ideve. Nxënësi njih mirë ndryshimet midis kulturave, qëndrimeve, vlerave dhe besimeve që mbizotërojnë në vendin e tij dhe në vendet ku flitet gjuha e huaj.
PRAGMATIKE	Fleksibiliteti	Nxënësi përshtat shprehjet e mësuara për t'i përdorur në situatë më pak të njohura dhe të vështira për të.
	Pjesëmarrja në bashkëbisedim	Nxënësi ndërhyt dhe merr fjalën në një bisedë me temë të njohur për të duke përdorur shprehjet e mësuara.
	Zhvillimi i temës	Nxënësi tregon në mënyrë logjike dhe të rrjedhshme një tregim ose përshkrim në mënyrë lineare por ka raste që përdor argumente dhe shembuj të tjerë.
	Koherenca	Nxënësi lidh pjesë të shkurtra dhe të thjeshta në një tekst të plotë në mënyrë lineare duke tentuar për tekste më të komplikuar.

Aspektet cilësore të përdorimit të gjuhës së folur për nivelin B1

	Gama/diapazoni	Saktësia	Rrjedhshmëria	Ndërveprimi	Koherenca/ lidhja logjike
B 1	Zotëron mjaftueshëm fjalor për të shprehur veten duke hezituar dhe duke perifrastuar mbi tema si familja, interesat, puna, shkolla,	Përdor pothuajse saktë një repertor shprehjesh të rutinës së përditshme që përdoren dendur dhe lidhen me situatë të parashikueshme.	Mund të flasë në mënyrë të kuptueshme, megjithëse duket qartë që ndalon për ta menduar atë që do të thotë mirë nga ana gramatikore dhe	Mund të fillojë, vazhdojë dhe përfundojë biseda ballë për ballë mbi temë që janë të njohura për të ose të interesit të tij. Përsërit pjesë të asaj që është thënë për të	Mund të lidhë në mënyrë lineare një numër të vogël dhe të thjeshtë elementësh të folurit.

	udhëtimet dhe ngjarjet nga jeta e përditshme.		leksikore si dhe bën korrigjime sidomos kur flet gjatë.	konfirmuar të kuptuarin reciprok.	
--	---	--	---	-----------------------------------	--

Për përmbushjen e kompetencave të lëndës të cilat çojnë natyrshëm në forcimin e kompetencave kyçe, nxënësit i duhet të konsolidojë njohuritë dhe konceptet e duhura, të aftësohet në shkathtësitë e fituara dhe të mbajë qëndrime dhe të zhvillojë vlera në situata të ndryshme.

Njohuri dhe koncepte:

1. Formimi kulturor:

- a. Jeta e përditshme** (*organizimi i një plani ditor dhe i kohës së studimit; kujtime të mrekullueshme- dita më e bukur e jetës sime; qëllimet afatshkurtër dhe afatgjatë. Çfarë dua unë për të ardhmen time etj.*)
- b. Bota e shkollës dhe e punës** (*Organizimi i një biznesi të vogël; shqetësimet e shoqërisë së sotme si papunësia etj.; Studimet dhe universitetet në vend dhe në botë, profesionet*)
- c. Jeta personale dhe shoqërore** (*Shanse dhe të drejta të barabarta për gratë dhe burrat, të rinjtë dhe të rriturit; vendlindja; personalitete në shoqëri*)
- d. Bota rreth nesh** (*Arti dhe kultura; flora dhe fauna; arkeologjia; historia e filmit; programet televizive; zakonet dhe traditat në vendet ku flitet gjuha që po mësohet etj.*)
- e. Bota e komunikimit** (*rrjetet sociale; interneti; të shkruarit e letrave- letër kërkesë, letër ankesë, letër biznesi, etj.*)

2. Formimi gjuhësor:

- a. **Gramatika** (ndajfoljet; mbiemrat dhe strukturat e tyre; fjalitë e thjeshta dhe të përbëra.; kohët e foljeve; ligjërata e drejtë dhe e zhdrejtë; mënyra veprare dhe jo veprare; foljet modale; fjalitë kushtore etj.)
- b. **Funksionet gjuhësore** (dhënia e këshillave; të shprehurit e keqardhjes; theksimi i informacionit; të shprehurit e mendimin ose opinionit personal; vënia në diskutim ose të mos biesh dakord me dikë; të ndalosh dikë të bëjë diçka etj.)

Aftësi dhe shkathtësi:

Të dëgjuarit

Përshkrimi:

Nxënësi kupton informacion faktik të drejtpërdrejtë rreth temave të zakonshme të jetës së përditshme dhe botës së punës duke identifikuar si idenë kryesore edhe detajet specifike kur e folura është e artikuluar qartë dhe me aksent të njohur për të. Gjithashtu nxënësi arrin të ndjekë biseda më të zgjeruara argumentuese kur flitet në gjuhë standarde.

Nxënësi:

- ndjek një bisedë të zakonshme megjithëse ndonjëherë ka nevojë për përsëritjen e fjalëve dhe frazave të veçanta;
- ndjek pikat kryesore të një bisede të zgjeruar që zhvillohet rreth tij nëse biseda e dhënë shqiptohet qartë në gjuhë standarde;
- kupton një tregim të shkurtër;
- kupton çështjet kryesore si edhe përmbajtjen e informacionit të lajmeve në radio dhe materialet e regjistruara mbi tema të interesit personal të shprehura ngadalë dhe qartë;
- kupton çështjet kryesore në programet televizive mbi tema të njohura;
- kupton informacionin e thjeshtë teknik si instruksione të përdorimit për pajisjet e përdorimit të përditshëm;
- kupton idetë kryesore të një bisede në një dialekt standard;

- Ndjek një leksion ose bisedë mbi fushën e tij të interesit kur tema është e njohur për të dhe prezantimi është i mirëstrukturuar dhe i drejtpërdrejtë.

Të lexuarit

Përshkrimi:

Nxënësi lexon tekste faktikë të drejtpërdrejtë me tema që lidhen me fushën e tij të interesit në një shkallë të kënaqshme të kuptuari të teksteve.

Nxënësi ka fjalor të gjerë por mund të ketë vështirësi me shprehjet që hasen rrallë në të lexuar.

Nxënësi:

- kupton çështjet kryesore në artikuj të shkurtër gazetash rreth temave të përditshme;
- lexon dhe të kupton artikuj apo intervista në gazeta dhe revista në të cilat mbahet qëndrim për një temë të veçantë;
- gjen kuptimin e fjalëve ose shprehjeve të panjohura nga konteksti nëse tema është e njohur;
- kap thelbin në tekste të shkurtra për shembull, përmbledhje lajmesh dhe gjen fakte dhe informacione në lidhje me vendin, kohën dhe personazhet;
- kupton informacionin më të rëndësishëm në fletëpalosje të thjeshta;
- kupton udhëzimet e dhëna me shkrim për përdorimin e pajisjeve të ndryshme;
- kupton përshkrimin e ngjarjeve, ndjenjave dhe dëshirave në letra personale aq mirë sa për të mbajtur korrespondencë me shokët e tij;
- kupton mesazhe të shkurtra dhe letra formale të tilla si letra zyrtare dhe biznesi;
- kupton ato pjesë në letrat private që lidhen me ngjarje, ndjenja, urime dhe dëshira;
- kupton subjektin e një tregimi të ndërtuar mirë duke u njohur me episode dhe ngjarjet më të rëndësishme dhe rolin që ato luajnë në histori;
- kupton me vështirësi dhe lexon artikuj në të cilat autori shpreh pikëpamje të caktuara personale;

- kupton përmbledhje që kanë të bëjnë me tema kulturore si filma, libra etj.;
- shqyrton tekste të gjatë për të gjetur informacionin e dëshiruar dhe mbledh informacion nga pjesë të ndryshme të tekstit ose tekste të ndryshëm për të kryer një detyrë të caktuar;

Të folurit

Të folurit ndërveprues:

Përshkrimi:

Nxënësi komunikon me besim mbi temat e fushës së tij të interesit duke shkëmbyer, kontrolluar ose konfirmuar informacionin dhe shpjegon se pse diçka është problem. Nxënësi shpreh mendimin e tij mbi tema abstrakte dhe kulturore si filmat, librat, muzika.

Nxënësi:

- kërkon dhe kupton udhëzime të detajuara për të shkruar nga një vend në tjetrin edhe në situata të panjohura për të;
- përballon në të shumtën e rasteve situata që dalin gjatë një udhëtimi ose një konsulte mjekësore;
- shpreh dhe kërkon mendimin personal gjatë një diskutimi me shokë;
- diskuton dhe mbron mendimin e tij në biseda të përgjithshme mbi tema të specialitetit të tij;
- shprehet me mirësjellje nëse është dakord ose jo rreth një teme të caktuar;
- shpreh dhe ju përgjigjet ndjenjave të tilla si : lumturia, trishtimi, interesi dhe indiferenca;
- mban gjallë një bisedë apo diskutim , por nganjëherë e ka të vështirë të shprehet saktësisht për çfarë do të dëshironte;
- hyn edhe i papërgatitur në një bisedë ose intervistë;
- përçon gjatë bisedës shkallë të ndryshme emocioni si edhe vë në dukje rëndësinë që ato kanë për të personalisht;
- komenton shkurt mbi pikëpamjet e të tjerëve;
- sqaron qartë pikëpamjen e tij por ka vështirësi të bëhet pjesë e një debati;

- krahason alternativa të ndryshme dhe shpjegon pse diçka është problem;
- ankohet kur ka blerë një produkt që nuk është sipas dëshirës së tij;
- përmbledh një histori të shkurtër, intervistë duke dhënë mendimin e tij dhe ju përgjigjet pyetjeve për detajet e mëtejshme;
- jep informacion konkret që mund t'i kërkohet gjatë një interviste, konsulte etj.

Produkti i të folurit:

Përshkrimi:

Nxënësi në mënyrë të logjikshme bën përshkrim të një game të gjerë temash brenda fushës së tij të interesit duke e paraqitur atë në vijë lineare. Gjithashtu nxënësi tenton të bëjë përshkrime të qarta dhe të detajuara për një gamë të gjerë temash që lidhen me fushat e tij të interesit duke i zgjeruar idetë dhe mbështetur ato me shembuj.

Nxënësi:

- përshkruan në detaje përvoja , ndjenjat dhe reagimet që lidhen me to;
- përshkruan ëndërra, shpresa, ambicie, urime dhe dëshira;
- përshkruan ngjarje reale ose imagjinare;
- shpjegon dhe jep arsye për planet, synimet dhe veprimet e tija;
- lidh ngjarjet në një subjekt libri ose filmi dhe përshkruan reagimet e tija;
- perifrason gojarisht pasazhe të shkruara shkurt, duke përdorur fjalorin dhe strukturën e një teksti origjinal;
- rrëfen një histori;
- rrëfen detajet e një ngjarjeje të paparashikuar, p.sh një aksident;
- zhvillon një argument aq mirë sa mund të ndiqet pa vështirësi në pjesën më të madhe të kohës;
- mban një fjalim të shkurtër të parapërgatitur mbi tema të jetës së përditshme ose të interesit të tij;
- prezanton mbi një temë të njohur prej tij ku shumica e çështjeve shpjegohen me saktësi.

Të shkruarit

Përshkrimi:

Nxënësi shkruan tekste të plota mbi tema të fushës së tij të interesit duke i lidhur pjesët përbërëse të tij në mënyrë lineare. Gjithashtu nxënësi me vështirësi arrin të vlerësojë informacionin e marrë nga burime të ndryshme dhe të japë argumentet mbështetës. Nxënësi transmeton informacionin dhe idetë mbi tema konkrete dhe abstrakte, pyet dhe jep shpjegime mbi problemet me saktësi logjike.

Nxënësi:

- shkruan tekste të thjeshta të lidhura në mënyrë lineare për tema të interesit të tij duke shprehur pikëpamjet dhe opinionet e tija;
- shkruan tekste të thjeshta rreth përvojave(një udhëtim, një shfaqje në shkollë, një konkurs) për gazetën e shkollës ose të klubit;
- përshkruan një ngjarje reale ose imagjinare;
- fillon të shkruajë përshtypjet e tij mbi një libër, film ose shfaqje;
- shkruan letra personale familjes ose shokëve të tij për t' i pyetur , për t' u dhënë lajme të reja ose për t' u treguar një ngjarje;
- përshkruan me detaje në një letër personale përmbajtjen e një libri , filmi ose komenton për një koncert ose shfaqje;
- shpreh ndjenja si p.sh lumturinë , hidhërimin, interesin, keqardhjen, në një letër;
- përgjigjet me shkrim një lajmërimi dhe pyet për informacion më të plotë ose më specifik rreth mallrave ose shërbimeve. (p.sh një telefon celular, kompjuter ose një kurs mësimor);
- transmeton nëpërmjet faksit ose e-mailit informacion të shkurtër dhe të thjeshtë tek shokët ose të njohurit e tij si dhe u kërkon atyre informacion;
- shkruan CV-në i tij në formë të përmbledhur;
- shkruan saktë dhe shkurt një përmbledhje të artikujve mbi tema të përgjithshme;
- shkruan një përmbledhje të pikave kryesore në informacione nga media dhe burime të tjera;
- shkruan ese të thjeshta mbi temat e tij të interesit;
- shkruan mesazhe që transmetojnë pyetje dhe shpjegime të problemeve.

Vlera dhe qëndrime:

Nxënësi:

- demonstroi pavarësi në mendime dhe veprime;
- demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;
- respekton përpjekjet personale dhe ato në grup;
- tregon gatishmëri për të bashkëpunuar;
- ndjek më vëmendje shokët kur flasin dhe respekton radhën e të folurit;
- përzgjedh fjalorin e duhur (nuk fyen, përdor fjalët e mirësjelljes etj.);
- tregon interes në materialet që lexon;
- respekton bashkëfolësit pa dallime gjinie, besimi, ideje;
- respekton përpjekjet personale dhe ato në grup;
- demonstroi bashkëpunim dhe qëndrim etik gjatë punës në grup dhe në diskutime;
- demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;
- vlerëson burime të ndryshme informacioni;
- mban qëndrimin e tij ndaj problemeve që dalin në klasë dhe në shkollë;
- është i paanshëm në marrjen e vendimeve.

Për të kryer detyrat që i jepen nxënësi duhet të përfshihet në veprimtari të shumta gjuhësore dhe të përdorë strategji komunikuese. Strategjitë konsiderohen si nyje lidhëse midis burimeve të nxënësit (kompetencat) dhe se çfarë ai mund të bëjë me ato (veprimtari të komunikuese). Shumica e situatave përfshijnë llojshmëri veprimtarish dhe përdorim të më shumë se një aftësie ose shkathësie. Për shembull në një orë mësimi, një nxënësi i kërkohet të dëgjojë shpjegimin e mësuesit, të lexojë një tekst me zë ose në heshtje, të ndërveprojë me nxënësit e tjerë në grup, të shkruajë një ushtrim ose ese madje edhe të perifrazojë, shpjegojë etj. Strategjitë janë mjeti që nxënësi përdor për të mobilizuar dhe balancuar të gjitha burimet e tij, të aktivizojë të gjitha aftësitë e tij për të përmbushur plotësisht dhe me sukses detyrat që i jepen.

Strategjitë që përdor nxënësi në veprimtaritë prodhuese (produkti i të folurit/ produkti i të shkruarit)	
Planifikimi	Përsërit dhe provon kombinime dhe shprehje të reja duke kërkuar përshtypjet e të tjerëve.
Kompensimi	Jep dhe shpjegon tiparet e diçkaje konkrete kur nuk e di fjalën e saktë.
Monitorimi dhe korrigjimi	Korrigjon gabimet në kohët e foljeve dhe shprehjeve të cilat mund të çojnë në keqkuptime nëse bashkëfolësi thotë se nuk kupton mesazhin e dhënë.
Strategjitë që përdor nxënësi në veprimtaritë marrëse (të kuptuarit gjatë të dëgjuarit dhe të lexuarit)	
Identifikimi i të dhënave ndihmëse dhe gjetja e kuptimit	Gjen kuptimin e fjalëve të reja nga konteksti mbi tema që kanë të bëjnë me fushën e tij të interesit dhe nxjerr kuptimin e të gjithë fjalisë nëse tema është e njohur për të.
Strategjitë që përdor nxënësi në veprimtaritë ndërvepruese (të folurit ndërveprues/ të shkruarit ndërveprues)	
Marrja e fjalës në bashkëbisedim	Ndërhyn në një diskutim me temë të njohur për të dhe përdor shprehjet e duhura për të marrë fjalën.
Bashkëpunimi	Shfrytëzon një repertor bazë të gjuhës dhe të strategjive për të mbajtur gjallë një bisedë ose diskutim.
Pyetje për t`u qartësuar	Pyet bashkëfolësin të qartësojë ose të shtjellojë atë çka është duke thënë.

2.8 Ndarja e orëve mësimore

Në tabelën e mëposhtme është dhënë koha mësimore për klasën e XI, sipas orëve vjetore të përcaktuara në Planin Mësimor të Arsimit Profesional për strukturën bllok 4 vjeçar.

Orët Mësimore 36 javë x 1 orë/javë = 36 orë vjetore

Klasa	Formimi kulturor	Formimi gjuhësor		Projekti dhe Portofoli Evropian i Gjuhëve (PEGJ)	Totali i orëve
		Gramatika	Funksionet gjuhësore		
XI					36 orë
	40%	30%	20%	10%	
	14 orë	11 orë	7 orë	4 orë	

Në tabelën e mëposhtme është dhënë koha mësimore për klasën e XI, sipas orëve vjetore të përcaktuara në Planin Mësimor të Arsimit Profesional për strukturën 2+1+1 dhe 2+2.

Orët Mësimore 34 javë x 1 orë/javë = 34 orë vjetore

Klasa	Formimi kulturor	Formimi gjuhësor		Projekti dhe Portofoli Evropian i Gjuhëve (PEGJ)	Totali i orëve
		Gramatika	Funksionet gjuhësore		
XI					34 orë
	40%	30%	20%	10%	
	13 orë	10 orë	7 orë	4 orë	

Mësuesi ka të drejtë të ndryshojë deri në masën 10% të orëve të përcaktuara në tabelë duke pasur parasysh karakteristikat e çdo klase si edhe përparimin e nxënësve.

Tek orët e formimit kulturor përfshihen pjesët e reja të leximit dhe të dëgjimit të cilat përfshijnë njohuritë që merr nxënësi mbi botën e punës, shkollës, jetës personale, natyrës, udhëtimet, kulturat dhe traditat e vendeve të ndryshme etj. Nëse mësuesi vë re se disa njohuri nuk mund të përvetësohen nga nxënësi brenda një ore mësimore, ai planifikon orë rimarrje për ato njohuri.

Orët e formimit gjuhësor mbi gramatikën përfshijnë njohuritë gramatikore dhe punën me fjalorin që realizohet gjatë vitit. Këtu mund të përfshihen edhe orët e përfundimit të njohurive nëse mësuesi e shikon të nevojshme. Gjithashtu njohuritë gramatikore nuk mund të merren jashtë kontekstit dhe duke patur parasysh që përfaqësojnë në kurrikulën bërthamë është të mësuarit nëpërmjet situatave të të nxënësit, këto njohuri mund të ndërthuren edhe gjatë orëve kur fokusi është të folurit ose të shkruarit.

Funksionet gjuhësore ju referohen akteve të komunikimit që nxënësi realizon gjatë procesit të marrjes së gjuhës së huaj dhe mund të realizohen në përputhje me njohuritë dhe shkathtësitë e tjera.

Vlerësimi i nxënësit për realizimin e projektit bëhet i mbështetur edhe në punët e tij me Portofolin Evropian të Gjuhëve. Si rezultat del domosdoshmëri që mësuesi gjatë orëve të projektit të bazohet te Portofoli Evropian i Gjuhëve për të përcaktuar rezultatet e të nxënësit dhe veprimtari sipas aftësive gjuhësore.

Teste të detyruara gjatë një viti shkollor janë 3 (tri) të cilat kryhen rreth përfundimit të çdo periudhe.

Planifikimi i orëve mësimore bëhet vjetor (sintetik- bëhet ndarja totale e orëve) si edhe në bazë periudhash tre mujore (analitik- trajtohen temat për çdo orë mësimi).

3 UDHËZIME METODOLOGJIKE

Metodat e mësimdhënies janë mjaft të rëndësishme për të realizuar një mësimdhënie efektive. Përdorimi i tyre shërben për zhvillimin gjuhësor të nxënësve dhe konsolidimin e kompetencave kyçe dhe ato të lëndës.

Mësuesit duhet të përditësojnë njohuritë rreth metodave, teknikave dhe strategjive të mësimdhënies me qëllim që të zhvillojnë tek nxënësi dëshirën për dijen, virtytet njerëzore, ambicien për të qenë i suksesshëm dhe aktiv në jetën e përditshme dhe botën e punës. Metoda, strategji dhe teknika të tilla si: diskutim për njohuritë paraprake, diagrame piramidale, lexim i drejtuar, imagjinata e drejtuar, parashikim me terma paraprake, harta e konceptit, rrjeti i diskutimit, pyetje autorit, ditarët e të nxënësit, pyetja sjell pyetjen, puna në çift ose në grup etj., shërbejnë si nxitje për nxënësin dhe si garanci për rezultate të mira në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Përfaqja ndaj metodologjive të mësimdhënies dhe mësimnxënies duhet të jetë shumë e gjerë dhe të paraqesë të gjitha mundësitë në mënyrë të qartë dhe transparente duke shmangur dogmatizmin. Mësuesi duhet të përdorë ato metoda që e ndihmojnë atë më shumë të arrijë përbushjen e qëllimit final që është plotësimi i nevojave të nxënësit për t`u bërë një zotërues i mirë i gjuhës.

Mësimdhënia e gjuhës së huaj karakterizohet nga kriteret e mëposhtme:

Mësimdhënie me në qendër nxënësin

Nxënësi është në qendër të procesit të mësimdhënies. Ky proces ndërtohet në varësi të nevojave, aftësive dhe interesave të nxënësit. Nxënësit e një klase nxënë në mënyra të ndryshme: disa individualisht ose në grup, të tjerë nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur ose me anë të mjeteve të ndryshme didaktike. Përpos kësaj, lënda e gjuhës së huaj kërkon që nxënësi të nxijë konceptet, të zotërojë shprehitë dhe të zbatojë njohuritë gjuhësore. Të dy këto kushte diktojnë nevojën për strategji të ndryshme të mësimdhënies, të cilat përshtaten me objektin e të nxënësit dhe nevojat e nxënësit. Qëllimi i çdo strategjie të mësimdhënies është që çdo nxënës të mësojë dhe të zbatojë njohuritë gjuhësore në mënyrë efektive.

Të mësuarit bashkëveprues

Mësuesit sigurojnë një mjedis të pasur dhe nxitës për komunikim dhe ndërveprim mes nxënësve. Ata përdorin metoda, strategji dhe teknika që nxitin të mësuarin bashkëveprues. Nxënësi gjatë orëve të gjuhës së huaj shpesh motivohet të punojnë me nxënësit e tjerë. Detyrat e përbashkëta i sigurojnë nxënësit më shumë kohë për të komunikuar dhe për të ndarë përvojat e tij me pjesëtarët e tjerë të grupit. Puna në grupe nxit respektin dhe tolerancën ndaj mendimit të tjetrit si dhe ndikon në përdorimin e formave demokratike për ndarjen e përgjegjësive dhe punës.

Njëherazi edhe shkalla e zotërimit të gjuhës rritet duke forcuar më shumë lidhjen midis kompetencave kyçe dhe atyre të lëndës.

Integrimi

Veprimtaritë gjuhësore si: të lexuarit, të shkruarit, të folurit, të dëgjuarit dhe përdorimi i drejtë i gjuhës trajtohen në mënyrë të integruar që të sigurohen lidhje kuptimplota mes tyre. Ato plotësojnë njëra-tjetrën dhe zhvillohen së bashku për ta bërë nxënësin të aftë të komunikojë dhe të përdorë njohuritë e marra në situata të njohura dhe të panjohura për të dhe të zhvillojë aftësitë e tij të të lexuarit, të folurit, të dëgjuarit dhe të shkruarit.

Procesi i rimarrjes së njohurive

Aftësitë dhe shkathtësitë, njohuritë rreth sistemit gjuhësor dhe llojet e ndryshme të teksteve zhvillohen duke u rishikuar çdo vit. Kjo arrihet duke kaluar nga e njohura tek e panjohura dhe nga më e thjeshta te më e vështira. Temat dhe njohuritë do të rimerren në mënyrë të hollësishme dhe ciklike në faza të njëpasnjëshme të programit mësimor. Kjo mundëson që nxënësi të përparojë nga niveli bazë në nivele më të larta të përdorimit të gjuhës.

Situata e të nxënit

Mësuesi duhet të parashikojë situatë të nxëni që të realizojë gjatë një ose disa temave mësimore. Me situatë të nxëni kuptohet ndërtimi i njohurive nëpërmjet një situatë praktike ose reale. Kjo mund të zgjasë një ose disa orë mësimi. Këto situata ndihmojnë që nxënësi t'i përdorë njohuritë e marra në jetën e tij të përditshme pa vështirësi dhe në interes të tij.

Pavarësisht metodave të përdorura mësuesi duhet të ketë parasysh që nxënësi ka fituar:

- kompetencat e duhura;
- aftësinë për t'i përdorur këto kompetenca;
- aftësinë për të përdorur strategjitë e duhura në vënien e kompetencave në veprim.

4 UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

Vlerësimi i nxënësit është ndër komponentët më të rëndësishëm të kurrikulës me bazë kompetencash. Ky vlerësim, bazuar në rezultatet e të nxënit, përfshin gjykimin për arritjet e nxënësit (njohuri, shkathtësi, qëndrime) përkundrejt niveleve të arritjeve.

Roli kryesor i vlerësimit është të përmirësojë të nxënit. Informacioni i siguruar nga vlerësimi i ndihmon mësuesit të kuptojnë anët e dobëta dhe anët e forta të nxënësit në përmbushjen e kompetencave kyçe dhe ato të programit të lëndor për secilën klasë, si dhe u jep mundësi të përmirësojnë mësimdhënien dhe të bëjnë propozime për përmirësimin e programeve.

Në përzgjedhjen e praktikave të vlerësimit, përcaktimin e kohës së përshtatshme për vlerësim dhe përzgjedhjen e materialeve që do të vlerësohen duhet pasur parasysh:

- përcaktimi i qëllimit dhe strategjisë së vlerësimit;

- përzgjedhja e veprimtarive që mundësojnë demonstrimin e formimit dhe konsolidimit të kompetencave;
- përdorimi i vlerësimit për të verifikuar çfarë di aktualisht nxënësi;
- besimi se të gjithë nxënësit mund t'i përmirësojnë arritjet e tyre.

Tradicionalisht, tre koncepte konsiderohen nga më themelorët në vlerësim: vlefshmëria, besueshmëria dhe të qenit vlerësim i realizueshëm. Mësuesi duhet të ketë parasysh që në vlerësim të jetë i paanshëm dhe transparent.

Vlerësimi i nxënësit ndahet në tre tipa kryesorë:

Vlerësimi diagnostikues që zakonisht kryhet në fillim të vitit shkollor ose para zhvillimit të një grupi orësh, për të identifikuar njohuritë paraprake, interesat ose aftësitë që ka nxënësi rreth asaj për të cilën do të zhvillohet mësimdhënia gjatë vitit shkollor. Ky informacion përdoret për të orientuar praktikën e mësimdhënies dhe mësimnxënies në mënyrë që të përcaktohen strategjitë e të ardhmes. Vlerësimi diagnostikues mund të jetë i shkurtër, i shpejtë, joformal dhe mund të bëhet me gojë dhe me shkrim.

Vlerësimi formues ose i vazhdueshëm është një proces që ndodh gjatë gjithë kohës në klasë dhe informon nxënësit, prindërit dhe mësuesit mbi progresin e nxënësve. Të dhënat dhe informacioni i mbledhur nga vlerësimi formues përdoren për të përmirësuar proceset e mësimdhënies dhe të nxënies. Fokusi i vlerësimit formues nuk duhet të jetë vetëm vlerësimi me notë i nxënësit. Ky vlerësim mund të jetë edhe me simbole, komente etj.

Vlerësimi përmbledhës ose përfundimtar kryhet më shpesh në fund të një grupi orësh, për të përcaktuar çfarë është mësuar pas një periudhe kohe dhe shoqërohet me notë. Vlerësimet përmbledhëse përdoren jo vetëm për të informuar nxënësit e prindërit për progresin e fëmijëve të tyre, por edhe për të përmirësuar praktikën e mësimdhënies dhe të nxënies si dhe për të krahasuar arritjet me rezultatet e pritshme të të nxënies.

Gjatë zbatimit të programit nxënësit duhet t'i jepet mundësia të punojnë individualisht, në çift ose në grup për kryerjen e detyrave të dhëna dhe përmbushjen e kompetencave të lëndës dhe atyre kyçe. Në çdo rast mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit, në tërësi dhe të secilit nxënës, në veçanti.

Mësuesi nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësit në çdo orë mësimi dhe të vendosë nota në regjistër për secilën prej tyre. Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë lirshëm si partnerë rreth përvetësimit të njohurive të fituara në orët e kaluara dhe mirë kryerjes së detyrave në klasë dhe jashtë klase.

Komponentët e vlerësimit janë vlerësim me gojë dhe vlerësim me shkrim. Këto vlerësime bëhen në mënyrë të alternuar me njëri-tjetrin për t'i dhënë mundësi mësuesit të bëjë një vlerësim të saktë dhe të mirëpeshuar për të gjitha veprimtaritë gjuhësore. Mësuesi, në përputhje me parimet themelore të vlerësimit, siguron përdorimin e të gjitha llojeve të vlerësimit, të cilët përcaktohen si të domosdoshëm për të gjykuar në lidhje me arritjet e nxënësve, në funksion të mbështetjes së të nxënësit dhe mësimdhënies.

Vlerësimi i punëve me shkrim është një mjet shumë i rëndësishëm i njohjes së aftësive gjuhësore të nxënësi. Praktikrat e reja sot orientojnë vendosjen e kriterëve dhe të standardeve të përshtatshme dhe të arritshme nga nxënësi. Kështu, duhen kërkuar forma të larmishme vlerësimi, të cilat të pasqyrojnë nivelin real të arritjeve të nxënësit për marrjen e masave për përmirësimin e tij. Mësuesi duhet ta ndjekë gjithë procesin e të shkruarit që nga planifikimi dhe deri tek rishikimi dhe redaktimi. Shënimet e mësuesit janë shumë të rëndësishme për vlerësimin e punëve me shkrim të nxënësve: ato duhet të jenë të tilla që t'i motivojnë ata. Vlerësimi që nxënësit mund t'i bëjnë njëri-tjetrit, është një tjetër formë e rëndësishme që ndihmon mbarëvajtjen e punës në këtë drejtim.

Vetëvlerësimi është element i rëndësishëm në të mësuarin e gjuhës së huaj. Vënia e synimeve të qarta në program mundëson vetëvlerësimin e nxënësit në vazhdimësi. Gjatë vetëvlerësimit në procesin mësimor ndiqen këta hapa:

- mësuesi diskuton me nxënësit atë që ata do të arrijnë në klasë;

- nxënësit vlerësojnë punën e tyre në çifte dhe më pas mësuesi dhe nxënësi bëjnë komentin përfundimtar;
- nxënësit vlerësojnë punën e njëri-tjetrit në grupe duke marrë role të ndryshme, madje ndonjëherë dhe pa nevojën e ndihmës së mësuesit;
- nxënësit mban shënime arritjet e tij duke përdorur edhe gjuhën amtare;
- mësuesi bisedon me nxënësit individualisht dhe i tregon arritjet;
- nxënësi cakton objektivat për të ardhmen;

Nga vetëvlerësimi përfiton si nxënësi, ashtu edhe mësuesi. Njohja e nxënësit me vetëvlerësimin e ndërgjegjëson atë të kuptojë më mirë problemet e të mësuarit dhe i jep mundësi të caktojë objektiva për të ardhmen.

Vetëvlerësimi realizohet gjatë punës me portofolin e gjuhëve.

Portofoli Europian i Gjuhëve-PEGJ

Portofoli i nxënësit, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë vitit shkollor, kontributeve dhe arritjeve të tij në gjuhën që po mëson, për punën individuale dhe në grup, krijimtarinë, talentin, si dhe për aspekte të gjykimit dhe reflektimit të nxënësit për veten dhe të tjerët.

Portofoli Europian i Gjuhëve ka dy funksione: a. raportues dhe b. pedagogjik

Ai përbëhet nga tri pjesë:

- Pasaporta gjuhësore** ku nxënësi regjistron nivelet gjuhësore, kualifikimet dhe përvojat ndërkulturore.
- Biografia gjuhësore** ndihmon nxënësin të regjistrojë dhe të reflektojë mbi progresin e tij gjuhësor.
- Dosja** e cila mund të përmbajë punë me shkrim, detyra tematike, projekte lëndore e ndërlëndore, certifikata, diploma etj.

Për informacion të mëtejshëm mbi vlerësimin mësuesi i referohet udhëzimeve përkatëse.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA E SIGURIMIT SË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

PROGRAMET E KULTURËS SË PËRGJITHSHME
TË ARSIMIT TË MESËM PROFESIONAL

Lënda: Histori

Klasa: XI

Struktura 2+1+1, Struktura 2+2 dhe Bllok 4-vjeçar

TIRANË, 2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

**PROGRAMET E KULTURËS SË PËRGJITHSHME
TË ARSIMIT TË MESËM PROFESIONAL**

Lënda: Histori

Klasa: XI

Struktura 2+1+1, Struktura 2+2 dhe Bllok 4-vjeçar

2024

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT TË HISTORISË

1. HYRJE

2. KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT

2.1. Qëllimi i programit të historisë

2.2. Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës

2.3. Lidhja e lëndës së historisë me temat ndërkurrikulare

2.4. Lidhja e lëndës së historisë me fushat/lëndët e tjera kurrikulare

2.5. Kompetencat dhe konceptet historike

2.6. Cilësitë historike të nxënësit

3. KLASA 11

3.1. Përmbajtja e kurrikulës

3.2. Rezultatet e të nxënit për kompetencat dhe konceptet historike

3.3. Koha mësimore

3.4. Klasa e njëmbëdhjetë, aftësi/shkathtësi, qëndrime, koncepte dhe veprimtari të sugjeruara

4. UDHËZIME METODOLOGJIKE

4.1. Materiale dhe burime mësimore

5. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

Aneks 1. Rekomandimet Rek (2001)15 e Komitetit të Ministrave të Shteteve anëtare lidhur me mësimin e historisë në Evropë në shekullin XXI.

TABELA, DIAGRAMA DHE FIGURA

Diagrami 1.	Korniza konceptuale e programit
Diagrami 2.	Rezultatet kryesore të të nxënit sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së historisë
Diagrami 3.	Lidhja ndërmjet lëndës së historisë dhe fushave/lëndëve të tjera
Diagrami 4.	Kompetencat dhe konceptet e lëndës së historisë
Diagrami 5.	Cilësitë historike të nxënësit
Tabela 1.	Kompetencat e lëndës dhe përshkrimi i tyre
Tabela 2.	Konceptet e lëndës dhe përshkrimi
Tabela 3.	Rezultatet e të nxënit për kompetencat dhe konceptet historike
Tabela 4.	Koha mësimore
Tabela 5.	Përforcimi i qasjes kërkimore
Figura 1.	Procesi i kërkimit historik

Koordinoi programin:
Ines Todhe

1. HYRJE

Lënda e historisë është thelbësore në zhvillimin e qytetarëve, të cilët i kuptojnë çështjet aktuale me zgjuarsi, nëpërmjet kuptimit, analizës dhe përfundimeve të nxjerra nga përvojat e së shkuarës.

Studimi i lëndës së historisë i ndihmon nxënësit të zhvillojnë një ndjenjë humanizmi të gjerë, të kuptojnë zhvillimin e personalitetit të tyre, mënyrën si ata ngjasojnë dhe diferencohen nga të tjerët në raport me kohën dhe me hapësirën, të dallojnë diferencën midis supozimit dhe faktit, të mos besojnë në përgjigjen e paargumentuar dhe të respektojnë vërtetësinë e burimeve historike, duke dalluar analogjinë false, të njohin abuzimet nga “mësimet” historike, të peshojnë pasojat që vijnë prej tyre, si dhe të marrin parasysh se padija për të shkuarën na bën “të burgosurit” e saj.

Ndryshimi është aspekti thelbësor i historisë dhe për këtë arsye është dhe një ndër konceptet bazë të studimit në programin e historisë. Ndërsa lëndë të tjera të fushës “Shoqëria dhe Mjedisi” studiojnë aspekte të ndryshme të jetës së njerëzimit, si: institucionet, traditat kulturore, ekonominë, ligjet etj., lënda e historisë kryesisht, synon të merret me shpjegimin e mënyrës se si të gjitha këto aspekte janë zhvilluar dhe kanë ndryshuar gjatë historisë së tyre. Në këtë mënyrë, nxënësit do të mësojnë rëndësinë që ka ndryshimi për të gjitha përvojat njerëzore, për kompleksitetin dhe mënyrat e ndryshme në të cilat bashkëveprojnë të gjitha këto përvoja.

Detyra e programit të historisë është të drejtojë nxënësit për t’u bërë pjesëtarë të përgjegjshëm të shoqërisë, të cilët dinë se si të trajtojnë në mënyrë kritike një fenomen të epokës së tyre dhe të së shkuarës. Nëpërmjet programit të historisë, nxënësit kuptojnë se kultura e tyre dhe kulturat e tjera përbëjnë rezultatin e një procesi historik.

Programi i historisë i ndihmon nxënësit që të bëhen të ditur, të logjikshëm, kureshtarë, të balancuar, të ndjeshëm dhe individë të aftë për të dhënë argumente dhe vendime të arsyetuara mirë.

Këto cilësi mbështesin nxënësit në zhvillimin e qëllimeve, kompetencave kyçe dhe rezultateve të dëshiruara të arsimit parauniversitar, në mënyrë që ata të jenë individë të përgatitur, të aftë për të kontribuar ndaj kombit dhe të aftë për t’iu përgjigjur zhvillimeve globale.

2. KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT

Hartimi i programit për lëndën e historisë në arsimin profesional rrjedh nga Korniza Kurrikulare e arsimit parauniversitar, kurrikulat bërthamë, plani mësimor, dhe Rekomandimet Rek (2001)15 të Komitetit të Ministrave të Shteteve anëtare lidhur me mësimin e historisë në Evropë në shekullin XXI¹.


Si i tillë ky dokument i shërben:

- **Nxënësit** për zhvillimin e kompetencave kyçe të të nxënit gjatë gjithë jetës dhe të kompetencave të lëndës së historisë, në mënyrë që ai të përballojë sfidat e jetës dhe të integrohet në shoqëri.
- **Mësuesit** për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe arritjet e nxënësit në klasë dhe jashtë saj.
- **Prindit** për njohjen e rezultateve të pritshme të fëmijëve dhe kriteret e vlerësimit në periudha të caktuara .
- **Hartuesit** të teksteve mësimore dhe të materialeve ndihmëse për mësuesit dhe nxënësit, të cilët përmes përmbushjes së qëllimeve të programit në tekstet e tyre, bëhen një faktor i rëndësishëm progresi në mësimdhënien e lëndës së historisë dhe në ndërtimin e kompetencave të lëndës dhe kompetencave kyçe të të nxënit gjatë gjithë jetës.

Programi i historisë në qendër të tij vendos krijimin e kushteve për ndërtimin e kompetencave të lëndës dhe të kompetencave kyçe që lidhen me to, për të gjithë nxënësit e arsimit bazë.

Programi paraqet temat ndërkurrikulare, ku realizimi i tyre nëpërmjet lëndës së historisë është një komponent i rëndësishëm i programit për kontributin e historisë në shoqëri dhe në jetën e përditshme. Programi përshkruan lidhjen e historisë me fushat e tjera

Diagrami 1. Korniza konceptuale e programit



2.1. Qëllimet e programit të historisë

Programi i historisë në arsimin profesional ka për qëllim të pajisë nxënësit me njohuri, aftësi dhe qëndrime nëpërmjet zhvillimit dhe ndërtimit të një sërë konceptesh dhe kompetencash lëndore, të cilat u krijojnë atyre mundësi të analizojnë në mënyrë kritike informacionin, lidhjet shkak-pasojë, të interpretojnë burimet, të ndërtojnë shpjegime të arsyetuara dhe argumentuara dhe të vlerësojnë interpretimet e ndryshme për të shkuarën.

Programi i historisë lidh vlerat e të mësuarit të historisë me qëllimet e arsimit parauniversitar, me kompetencat kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës dhe Rekomandimet Rek (2001)15 të Komitetit të Ministrave të Shteteve anëtare, për mësimdhënien e historisë në shekullin e XXI, duke ndërtuar tek nxënësi konceptet, kompetencat dhe cilësitë historike, nëpërmjet:

- pajisjes me dijet dhe kompetencat e nevojshme historike për të kuptuar të tashmen dhe ndikimin e saj në zhvillimet historike të së ardhmes;
- krijimit të mundësive për të ndërtuar dije, shkathtësi, qëndrime dhe vlera, për zhvillimin e qytetërimeve antike, mesjetare moderne dhe bashkëkohore në vend, rajon dhe botë;
- angazhimit në mënyrë aktive në kërkimin historik me qëllim që të zhvillojë vetëbesimin, reflektimin dhe mendimin kritik;
- zhvillimit të aftësive/shkathtësive të kërkimit historik, duke u bazuar në burime historike për studimin e ngjarjeve të ndryshme të historisë;
- interpretimit të efektit të kohës, të vazhdimësisë dhe të ndryshimit në marrëdhëniet historike dhe rolin e tyre në perspektivat e së ardhmes;
- interpretimit të historisë së shoqërisë njerëzore në të kaluarën, në mënyrë që nxënësit të kuptojnë të sotmen;
- kuptimit se si dhe pse ngjarje dhe çështje të veçanta historike janë interpretuar në mënyra të ndryshme;

- zhvillimit të aftësive për të analizuar dhe për të interpretuar informacionin historik në mënyrë kritike dhe të përgjegjshme, nëpërmjet dialogut, kërkimit të së vërtetës dhe përmes debatit të hapur, sidomos për çështje të ndjeshme historike;
- ndërveprimet me individë dhe grupe individësh të kulturave të ndryshme për të njohur të kaluarën dhe për të kuptuar ndërveprimin e saj me të sotmen, duke nxënë, analizuar dhe menduar në mënyrë kritike;
- mundësimin të ndërtimit të identitetit individual dhe kolektiv përmes njohjes dhe krahasimit të trashëgimisë së tyre historike të përbashkët;
- vlerësimin të pozitës së qytetërimit shqiptar në raport me qytetërimet botërore;
- argumentimin të vlerave të trashëgimisë historike, duke e vlerësuar këtë trashëgimi si pjesë të përcaktimit të identitetit të një populli;
- zhvillimit të aftësive qytetare, të cilat kontribuojnë në rritjen e tyre personale si individë, në përgatitjen e tyre në jetë, në punë dhe në shoqëri;
- ndërtimit të aftësive për të kuptuar, organizuar dhe komunikuar dijet e tyre historike përmes mënyrave të ndryshme dhe përdorimit të mediave të ndryshme;
- pajisjes me kompetencat e duhura për të kontribuar në mënyrë aktive dhe me përgjegjësi si qytetarë lokalë dhe globalë në ndërtimin e perspektivës;
- forcimit të ndjenjës së identitetit kombëtar dhe të respektit për historinë kombëtare, me qëllim zgjerimin e përmasave evropiane në studimin e historisë.

2.2. Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës

Ndërtimi dhe zbatimi i kompetencave kyçe nga nxënësit gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies, kërkon që mësuesi të mbajë parasysh lidhjen e kompetencave kyçe, me kompetencat e lëndës për secilën shkallë të kurrikulës. Kompetenca përcaktohet si integrimi i njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve që një nxënës duhet t'i fitojë gjatë procesit të nxënies. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje,

mësuesi duhet të përzgjedhë situatat, veprimtaritë, metodat, dhe mjetet e përshtatshme të procesit të të nxënit. Nëpërmjet studimit të historisë, nxënësit mësojnë se si të paraqesin një problem, që ata e kanë realizuar nëpërmjet përvetësimit dhe ndërtimit të dijeve dhe kompetencave historike, për një temë të caktuar.

Kur nxënësi zbaton kompetencat historike, ai njëkohësisht është duke zbatuar dhe kompetencat kyçe. P.sh. kompetenca historike “Kërkimi historik”, përfshin shumë nga strategjitë e zgjidhjes së situatave të ndryshme problemore në shoqëri dhe në jetën e përditshme. Për të zgjidhur problemin, ata duhet të kërkojnë, të mbledhin, të gjejnë, dhe të sintetizojnë informacione nga burimet primare, sekondare dhe informacionet me gojë, me shkrim, dhe ato vizuale.

Ata duhet të dinë ku të kërkojnë informacion, cilat informacione do t'i ndihmojnë ata për të ndërtuar një argument, si të interpretojnë informacionin e gjetur, si të strukturojnë marrëdhëniet komplekse shkakore, si të vlerësojnë saktësinë e burimit dhe si të krahasojnë gjetjet e tyre me faktet historike. Ata mësojnë të komunikojnë gjetjet e tyre dhe i komunikojnë ato për audiencë të ndryshme. Pra gjatë zhvillimit të kompetencave historike, nxënësi zhvillon gjithashtu kompetencat kyçe në lidhje me zgjidhjen e problemit, krijimtarinë, inovacionin, përpunimin e informacionit, prezantimin e detyrave, punën në grup, komunikimin efektiv etj.

Për të realizuar lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës mësuesi ndjek këto hapa:

- përzgjedh përmbajtjen mësimore, mjetet didaktike, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënit të kompetencave të historisë në një vit mësimor, si dhe rezultatet e të nxënit për kompetencat kyçe në një vit mësimor;
- planifikon mësimdhënien, duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do të arrijë rezultatet e të nxënit, për kompetencat kyçe brenda vitit shkollor;
- kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave, projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënit për vit mësimor dhe shkallë, për lëndën e historisë.

-

Diagrami 2. Rezultatet kryesore të të nxënit sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së historisë

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit

- Zhvillon kompetencën e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.
- Përdor funksionet gjuhësore të teksteve historike, duke përfshirë fjalorin historik, fjali të ndërtuara saktë për përshkrimin e ngjarjeve, fjali komplekse për shpjegimin e marrëdhënive shkak-pasojë, përdorimin e gjerë të emrave, ndajfoljeve dhe mbiemrave për të përshkruar vendet, njerëzit dhe ngjarjet.

Kompetenca e të menduarit

- Zhvillon kompetencën e të menduarit për realizimin e kërkimit historik.
- Zhvillon mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të interpretuar të shkuarën nëpërmjet informacionit, për të dhënë argumenta bazuar në burime dhe për të saktësuar saktësinë e burimeve.
- Zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës, që janë të diskutueshme.
- Analizon të dhënat numerike për të kuptuar të shkuarën, për shembull për të kuptuar shkakun dhe pasojën, vazhdimësinë dhe ndryshimin.
- Ndërton dhe interpretojnë grafikë, diagrame, tabela statistikore, për paraqitjen e të dhënave historike.

Kompetenca e të nxënit

- Zhvillon kompetencën e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.
- Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme, i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
- Parashtron pyetje kërkimore dhe përgjigjet duke u bazuar në argumenta dhe burime.
- Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet për një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
- Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike.
- Vlerëson pikëpamjet e ndryshme si dhe menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e burimeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre në histori.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

- Zhvillon kompetencën për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin për të identifikuar dhe vlerësuar burimet e nevojshme për interpretimin e ngjarjes historike.
- Harton hapat që duhet të ndjekë për realizimin e një kërkimi historik për një ngjarje të dhënë.
- Zhvillon një kërkim individual ose në grup për kryerjen e një veprimtarie në histori.
- Diskuton individualisht ose në grup për rëndësinë që ka e shkuara në kuptimin e të tashmes dhe perspektivat e të ardhmes.
- Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një veprimtarie të përbashkët.

Kompetenca personale

- Zhvillon kompetencën personale për të kuptuar veten dhe të tjerët, ndryshimet dhe ngjashmëritë, për të menaxhuar marrëdhëniet ndërmjet njëri-tjetrit, vlerësuar pikëpamjet e të tjerëve qofshin këto dhe të ndryshme nga të tija;
- Kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave.
- Përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj. për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij.

Kompetenca qytetare

- Zhvillon kompetencën qytetare për të shqyrtuar në mënyrë kritike sjelljet, motivet dhe veprimet e njerëzve në të shkuarën që mund të jenë rezultat i ndryshimit të qëndrimeve shoqërore dhe standardeve të ndryshme.
- Shqyrton burimet historike për të kuptuar ngjarjet dhe zhvillimet që kanë ndikuar në shoqëri dhe grupe të ndryshme kulturore në kohëra të ndryshme, dhe shpegon natyrën, shkaqet dhe pasojat e konflikteve dhe ndërvarësinë kulturore.
- Kupton se si qytetërimet dhe shoqëritë janë formuar nga grupe njerëzish me kultura të ndryshme, identifikon dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet kulturave të ndryshme dhe kultivon respekt ndaj kulturave të ndryshme nga e tija.
- Shqyrton burimet historike për të kuptuar çështjet shoqërore dhe se si parime të ndryshme kanë ndikuar në çështjet njerëzore.
- Zhvillon mirëkuptimin ndërkulturor, duke vlerësuar kulturat, gjuhët dhe besimet e ndryshme.
- Kupton perspektivat, besimet dhe qëndrimet e njerëzve në të shkuarën e në të tashmen dhe rëndësinë e njohjes së historisë së tyre dhe të tjerëve.
- Shpjegon origjinën dhe zhvillimin e identitetit kombëtar duke vlerësuar trashëgiminë material dhe shpirtërore.
- Shqyrton një sërë burimesh që paraqesin perspektiva të ndryshme kulturore në mënyrë që të zhvillojë kuptimin historik.

Kompetenca digjitale

- Zhvillon kompetencën digjitale për të kërkuar, për të përzgjedhur, për të analizuar dhe për të komunikuar informacion historik.
- Akseson një sërë burimesh digjitale të informacionit dhe analizon në mënyrë kritike këto burime historike.
- Komunikon, prezanton dhe parashtron njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet.
- Bashkëpunon, diskuton dhe debaton me të tjerët për të ndërtuar konceptet dhe kompetencat historike.

2.3. Lidhja e lëndës së historisë me temat ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare, të cilat integrojnë fushat kurrikulare të të nxënësve, janë tema madhore, me të cilat përballet shoqëria tani dhe në të ardhmen. Zhvillimi i tyre ndihmon nxënësit të interpretojnë botën dhe të rritin lidhjen e arsimit me jetën dhe me interesat e saj. Trajtimi i këtyre temave në lëndën e historisë synon ndërtimin e disa njohurive specifike, zbatimin e disa aftësive, vlerave e qëndrimeve të caktuara të nxënësit për zhvillimin e tyre si qytetarë të së ardhmes, të cilët do të jenë të aftë për të bashkëvepruar në paqe me kultura të ndryshme, të aftë për të kontribuar në ndërtimin e një shoqërie demokratike dhe të aftë për të funksionuar në një botë të ndërvarur, duke nxitur zhvillimin e qëndrueshëm të saj.

Kurrikula e historisë është projektuar për të plotësuar nevojat e nxënësve duke paraqitur një program bashkëkohor. Temat ndërkurrikulare:

- identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave,
- të drejtat e njeriut, vendimmarrja morale,

- zhvillimi i qëndrueshëm,
- mjedisi, ndërvarësia,
- bashkëjetesa paqësore

ofrojnë dimensione, të cilat pasurojnë programin mësimor nëpërmjet zhvillimit të përmbajtjes së fokusuar që përshtatet natyrshëm brenda tematikave të historisë.

Integrimi i këtyre temave gjatë zhvillimit të koncepteve dhe kompetencave historike aftëson nxënësit:

- për t'u bërë qytetarë aktivë dhe të përgjegjshëm në dimensionet lokale, kombëtare, rajonale, evropiane e globale, duke u mundësuar atyre të ndërtojnë identitetin individual dhe kolektiv përmes njohjes së trashëgimisë së tyre historike të përbashkët;
- për të ndërvepruar me individë dhe grupe individësh të kulturave të ndryshme, për të njohur të kaluarën dhe për të kuptuar ndërveprimin e saj me të sotmen, duke nxënë, analizuar dhe menduar në mënyrë kritike;
- për t'u edukuar me ndenjen e mirëkuptimit dhe të besimit të ndërsjellë midis popujve, nëpërmjet studimit të kulturës, të shkëmbimeve të shumanshme dhe të trashëgimisë;
- për të ndihmuar në formimin e një të ardhmeje më të mirë përmes kuptimit të asaj se si e shkuara ka lidhje me të tashmen dhe për të marrë vendime për një zhvillim të qëndrueshëm të perspektivave historike;
- për të zhvilluar aftësitë qytetare, të cilat kontribuojnë në rritjen e tyre personale si individë, në përgatitjen e tyre në jetë, në punë dhe në shoqëri.

Gjatë realizimit të temave ndërkurrikulare nxënësi duhet të zgjidhë situata, duhet të përdorë aftësitë e mendimit kritik, krijues, të përdorë kompetencat historike si: kërkimin, përdorimin e burimeve, interpretimin dhe komunikimin për të shpjeguar, argumentuar dhe parashikuar perspektivat për çështje të ndryshme që lidhen me këto tema ndërkurrikulare.

2.4. Lidhja e historisë me fushat/lëndët e tjera kurrikulare

Lënda e historisë është një nga lëndët kryesore të fushës shoqëria dhe mjedisi. Njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat në lëndët e fushës shoqëria dhe mjedisi dhe në lëndët e tjera të fushave të të nxënit si: atyre të shkencave natyrore, arteve, gjuhës dhe komunikimit, matematikës, teknologjisë dhe TIK-ut, etj., integrohen mjaft mirë me ato të historisë. Integrimi i tyre mund të shikohet në nivelin e tematikave, të koncepteve dhe të kompetencave.

Lënda e historisë dhe lëndët e tjera duhet të integrohen në mënyrë të ndërsjellë me njëra-tjetrën. Vetëm në këtë mënyrë do të mund të realizohen si duhet kompetencat kyçe të të nxënit dhe qëllimet e shkollës dhe të shoqërisë, në fushën e arsimit.

Çfarë do të thotë kjo?

- Së pari, historia mund të përdorë njohuritë, konceptet dhe aftësitë, që trajtohen në lëndët e tjera për të ndërtuar, për të konkretizuar dhe për të argumentuar më mirë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat e saj.
- Së dyti, lëndët e tjera duhet të përdorin dijet dhe kompetencat historike për të aktualizuar dhe për të kuptuar më mirë çështjet e tyre në diskutim, si dhe për të nxitur përgjegjësinë dhe motivimin qytetar të nxënësve në shkollë dhe në bashkësinë ku jetojnë.

Diagrami 3. Lidhja ndërmjet lëndës së historisë dhe fushave/lëndëve të tjera

SHOQËRIA DHE MJEDISI

- Përdor hartën, globin dhe busullën për lokalizimin e territoreve ku kanë lindur dhe janë zhvilluar ngjarjet historike.
- Lexon dhe interpreton harta të ndryshme historike dhe gjeografike.
- Orientohet në hapësirë nëpërmjet hartës dhe globit, për të lokalizuar një territor të caktuar me vlera historike.
- Përcakton në hartë vendndodhjen e qytetërimeve ne periudha të ndryshme historike.
- Argumenton rëndësinë e relievit dhe të klimës në zhvillimin e qytetërimeve.
- Shpjegon termat migrim i jashtëm dhe i brendshëm i popullsisë, për të treguar lëvizjet e popujve dhe pasojat që ato sjellin në qytetërimi, gjatë periudhave të ndryshme të historisë.
- Tregon ç 'është mjedisi gjeografik, për të kuptuar ndikimin e tij në zhvillimin e qytetërimeve.
- Shpjegon konceptet: liri, barazi, të drejta, ligj, komb, shtet, etni, demokraci dhe kushtetutë, për të Shpjeguar zhvillimin historik të qytetërimeve.
- Analizon dhe interpreton organizimin e familjes, të institucioneve dhe të shoqërisë, për të përcaktuar tiparet e jetës së përditshme përgjatë periudhave historike.
- Shpjegon format e sistemeve të qeverisjes, për të shpjeguar organizimin shtetëror gjatë periudhave historike.
- Interpretimet e ndryshme fetare (politeizmi, monoteizmi, krishterimi, islamizmi)
- për të shpjeguar rolin e fesë në histori.

TIK

- Shfrytëzon simbolet për shkrimin e shekujve me shifra romake në kompjuter.
- Përdor programet kompjuterike për shkrimin e një materiali historik.
- Përdor programet kompjuterike për prezantimin e një detyre në histori.
- Përdor internetin për nxjerrjen e të dhënave për ngjarje dhe për figura historike.
- Përdor programet kompjuterike për të ndarë mendime detyra dhe informacionin historik me moshatarët e tij.

GJUHËT DHE KOMUNIKIMI

- Interpreton tekste dhe forma të ndryshme të komunikimit, përfshirë atë historik.
- Shpreh opinione, arsyeton, diskuton, argumenton dhe bën debate argumentuese me tematikë historike.
- Përzgjedh informacionin e duhur historik në tekst.
- Shfrytëzon rregullat e drejtshkrimit për shkrimin e një materiali historik.
- Dallon gjinitë e ndryshme letrare: ditarin, kujtimet dhe romanin historik.
- Shfrytëzon veprat letrare-artistike, si burim informacioni historik.
- Përdor folklorin shqiptar si burim historik.
- Përdor veprën e rilindësve për të vlerësuar rolin që luajtën ata në historinë e Shqipërisë.

MATEMATIKË

- Ndërton dhe interpreton grafikë, diagrame, tabela statistikore, për paraqitjen e të dhënave historike.
- Përdor numrat e shifrat romake për leximin dhe për shkrimin e shekujve.
- përdor numrat negativë dhe pozitivë për të kryer veprime për llogaritjen e kohës.
- Përdor boshtin numerik për interpretimin e shkallës së kohës.
- Vendosi në boshtin numerik vitet para dhe pas Krishtit.

SHKENCAT E NATYRËS

- Reflekton dhe diskuton për rrjedhojat shoqërore të zhvillimeve shkencore.
- Vlerëson rolin qendror të shkencës në botën e sotme.
- Kupton karakterin kontradiktor të shkencës dhe faktin që shkencëtarët kanë pikëpamje të ndryshme dhe kundërshtuese si për faktet që përdoren në shkencë ashtu edhe për rreziqet që rrjedhin prej zhvillimeve shkencore.
- Kupton çështjet e ndryshme rreth shkencës dhe mjedisit, për shembull.
- Kupton ndikimin e përparimeve teknike në shoqëri, për shembull: ndikimi i internetit.

2.5.Kompetencat dhe konceptet e lëndës së historisë

Programi nëpërmjet të gjithë tematikave të tij zhvillon dhe ndërton një numër kompetencash dhe konceptesh, të cilat mbështesin studimin e historisë. Kompetencat historike janë procese dhe aftësi thelbësore që përfshihen në të gjithë programin e historisë nëpërmjet tematikave dhe nëpërmjet tematikave dhe veprimtarive të sugjeruara. Nxënësit duhet të kuptojnë, të zhvillojnë dhe të ndërtojnë kompetencat dhe konceptet historike si dhe të aftësohen për ti përdorur ato në mënyrë që të thellojnë dhe të zgjerojnë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat e tyre në lëndën e historisë duke arritur progres.

Kompetenca historike janë:

1. Kërkimi historik.
2. Përdorimi i burimeve.
3. Analiza shkak - pasojë.
4. Interpretimi historik.
5. Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën.

Koncepte kyçe historike janë:

1. Kuptimi kronologjik.
2. Ndryshimi dhe vazhdimësia.
3. Shumëllojshmëria kulturore, etnike dhe fetare.
4. Rëndësia.

Nxënësit aftësohen të demonstrojnë kompetencat historike për ndërtimin e ngjarjes historike. Ata shtrojnë pyetje rreth ngjarjeve, çështjeve apo zhvillimeve, krahasojnë aspekte të ndryshme të periudhave, ngjarjeve dhe çështjeve të marra në studim, për të kuptuar

ndryshimin dhe vazhdimësinë, shqyrtojnë shkaqet dhe pasojat e ngjarjeve dhe situatave historike, vendosin rëndësinë historike të një ngjarjeje në shoqëri, interpretojnë dhe marrin informacion nga burime të ndryshme për të mbështetur kërkimin historik, identifikojnë pikëpamjet e ndryshme historike, organizojnë dhe komunikojnë në mënyrë koherente dijet historike.

Të mësuarit dhe ndërmarrja e aktiviteteve në histori kontribuon në arritjen e qëllimeve të programit mësimor për të gjithë nxënësit, për t'u bërë:

- nxënës të suksesshëm që kënaqen nga mësimi dhe bëjnë përparim e arritje;
- individë me besim, të cilët janë në gjendje të jetojnë të sigurt, të shëndetshëm dhe të aftë të përmbushin kërkesat e jetës;
- qytetarë të përgjegjshëm që japin kontribut pozitiv në shoqëri.

Diagrami 4. Kompetencat dhe konceptet e lëndës së historisë




Tabela 1. Kompetencat e lëndës dhe përshkrimi i tyre

PËRSHKRIMI I KOMPETENCAT HISTORIKE				
Kërkimi historik	Përdorimi i burimeve	Interpretimi historik	Analiza shkak-pasojë	Shpjegimi & komunikimi për të shkuarën
<p>Kërkimi historik përfshin strukturimin e kërkesave në lloje të ndryshme pyetjesh dhe çështjesh historike. Nxënësit duhet të fillojnë të hartojnë dhe të përmirësojnë pyetjet e tyre për të strukturuar një shqyrtim për zhvillimin e hipotezave, për përzgjedhjen dhe dhënien e fakteve për të nxjerrë dhe për të justifikuar konkluzionet e tyre. Nxënësit mund të përdorin njohuritë e tyre të fituara për të sugjeruar hipoteza, ose mund të sugjerojnë hipoteza në fillim të temës, bazuar në supozimet dhe vlerat e tyre, të cilat ata pastaj i testojnë kundrejt provave.</p>	<p>Njohja e së kaluarës bazohet në fakte historike, në prova, të cilat rrjedhin nga burime të sakta historike dhe jo nga supozime paraprake në lidhje me vlefshmërinë dhe me besueshmërinë e burimeve historike të përdorura. Kjo përfshin vlerësimin e vlerës dhe besueshmërinë e dëshmive, duke studiuar prejardhjen e qëllimeve dhe gjuhën e burimeve.</p>	<p>Interpretimi ka të bëjë me të kuptuarit se si historianët dhe të tjerët formojnë interpretime. Njerëzit përfaqësojnë dhe interpretojnë të kaluarën në mënyra të ndryshme, duke përfshirë fotografi, shfaqje, filma, tregime, muze etj. Interpretimet reflektojnë rrethanat në të cilat ato bëhen, dëshmitë në dispozicion, si dhe synimet e atyre që i bëjnë këto interpretime (p.sh.: shkrimtarë, arkeologë, historianë dhe film krijues).</p>	<p>Analiza shkak-pasojë përfshin identifikimin dhe vlerësimin e rëndësisë relative të faktorëve të ndryshëm, si dhe bërjen e lidhjeve shpjeguese ndërmjet shkakut dhe pasojës, duke pasur parasysh marrëdhënien ndërmjet argumenteve shkakësore, dëshmive dhe interpretimeve.</p>	<p>Nxënësit zhvillojnë dëgjimin, leximin dhe shkrimin si aftësi për të kujtuar, për të përzgjedhur, për të klasifikuar dhe për të organizuar informacionin historik, duke përdorur me saktësi terminologjinë historike për përshkrimin dhe për shpjegimin e ngjarjeve në të shkuarën. Nxënësit duhet të përdorin edhe teknologjitë e reja ekzistuese sipas nevojave të tyre.</p>


Tabela 2. Konceptet e lëndës dhe përshkrimi i tyre

PËRSHKRIMI I KONCEPTET HISTORIKE			
Kuptimi kronologjik	Ndryshimi & vazhdimësia	Shumëllojshmëria kulturore, etnike & fetare	Rëndësia
<p>Kuptimi kronologjik është thelbësor në ndërtimin dhe në shpjegimin e ngjarjeve historike, çka përfshin përdorimin e saktë të datave për të krijuar vijimësinë e ngjarjeve në një shqyrtim, duke përdorur termat dhe fjalorin e saktë kronologjik, si dhe duke ditur emrat dhe karakteristikat kryesore të periudhave të studiuara. Nxënësit duhet të identifikojnë ndryshimet brenda dhe gjatë periudhave, duke bërë lidhjet midis tyre.</p>	<p>Kuptimi i ndryshimit dhe i vazhdimësisë është i lidhur ngushtë me identifikimin dhe shpjegimin e ndryshimit, e vazhdimësisë brenda dhe përgjatë periudhave historike, si dhe me kuptimin e temave dhe çështjeve gjithëpërfshirëse të periudhave historike.</p>	<p>Shumëllojshmëria kulturore, etnike dhe fetare ka të bëjë me të kuptuarin e përvojave, ideve, besimit dhe vlerave të ndryshme të njerëzve dhe të shoqërive në të shkuarën dhe se si të gjitha këto kanë formësuar botën. Nxënësit duhet të njihen me shumëllojshmërinë kulturore, etnike dhe fetare të shoqërive të ndryshme. Shumëllojshmëria ekziston brenda dhe ndërmjet grupeve për shkak të dallimeve kulturore, etnike, rajonale, gjuhësore, sociale, ekonomike, teknologjike, politike dhe fetare. Njohja e kulturave duhet të arrihet nëpërmjet studimit të individëve dhe të grupeve të ndryshme shoqërore, si p.sh.: njohjes të pakicave kombëtare, të shoqërive evropiane dhe atyre joevropiane.</p>	<p>Rëndësia ka të bëjë me konsiderimin dhe me vlerësimin e një ngjarjeje historike. Ajo vlerëson pse gjykimet në lidhje me rëndësinë e ngjarjeve historike, çështjeve dhe njerëzve kanë ndryshuar me kalimin e kohës. Gjithashtu, ajo merr parasysh identifikimin e kriterëve të përdorura për vlerësimin e rëndësisë së një çështjeje, ngjarje apo personazhi historik, si dhe vlerëson se si këto kriterë dhe vlera janë përdorur në përshkrimet e së shkuarës dhe shpjegimin e së tashmes. Deklaratat rreth rëndësisë janë interpretime që mund të bazohen në vendime të kontestueshme rreth ngjarjeve, çështjeve dhe figurave historike, ato shpesh janë të lidhura me sistemet e vlerave të periudhës, në të cilën është shkruar interpretimi.</p>

2.6. Cilësitë historike të nxënësit

Lënda e historisë i ndihmon nxënësit që të bëhen të ditur, të logjikshëm, kureshtarë, të balancuar, të ndjeshëm, dhe individë të aftë për të dhënë argumente dhe për të marrë vendime të arsyetuara mirë.

Diagrami 5. Cilësitë historike të nxënësit



Kurrikula e historisë synon t'i pajisë nxënësit me këto cilësi të rëndësishme në mënyrë që t'i mbështesë ata, jo vetëm në zotërimin e dijeve dhe kompetencave historike, por dhe në arritjen e rezultateve të dëshiruara dhe në realizimin e qëllimeve të arsimit parauniversitar, për t'i bërë ata të aftë për të përmbushur studimet e tyre të mëtejshme, si dhe për të nxënësit gjatë gjithë jetës.

Për të zhvilluar cilësitë historike, mësuesi gjatë mësimit të historisë duhet t'u ofrojë nxënësve mundësi për të kërkuar, për të shqyrtuar, për të vlerësuar aspekte të ndryshme historike dhe për të përdorur TIK-un, si pjesë përbërëse e të mësuarit të tyre. Krijimi i këtyre mundësive rrit angazhimin e nxënësve me kuptimin dhe përdorimin e njohurive të lëndës, koncepteve, kompetencave historike dhe kompetencave kyçe.

Mësuesi i ofron mundësi nxënësit:

- për të kërkuar aspekte për historinë e shqiptarëve dhe historinë qytetërimi botërore në antikitet, në mesjetë, në periudhën moderne dhe në periudhën bashkëkohore dhe për të kuptuar se si ato lidhen me një kontekst të gjerë historik;
- për të shqyrtuar rrugët, në të cilat e kaluara i ka ndihmuar të formojnë identitetin, kulturat e përbashkëta, vlerat dhe qëndrimet sot;
- për të vlerësuar përmes vizitave ku është e mundur, rolin e muzeve, galerive, arkivave historike në ruajtjen dhe paraqitjen e së shkuarës;
- për të përdorur TIK-un, për të kërkuar informacion për të shkuarën në lidhje me datat, personazhet, objektet, ngjarjet dhe proceset historike, si dhe për të përzgjedhur, klasifikuar, organizuar dhe paraqitur gjetjet.

Nxënësi:

- Kërkon aspekte për historinë e qytetërimi në antikitet, në mesjetë, në periudhën moderne dhe në periudhën bashkëkohore për vendin, Evropën dhe më gjerë për të kuptuar se si ngjarjet lidhen me një kontekst të gjerë historik. Duke bërë kërkime mbi historinë e qytetërimi në antikitet, në mesjetë, në periudhën moderne dhe në periudhën bashkëkohore, nxënësit i krijohet mundësia të përdorë burimet për të kuptuar lidhjet e brendshme e të jashtme midis ngjarjeve, periudhave dhe shoqërive të ndryshme,

marrëdhëniet shkak-pasojë, si dhe lidhjet e qytetërimit të popullit shqiptar me qytetërimet botërore, duke krijuar te nxënësi bindjen se qytetërimet e sotme janë një vazhdimësi progresive e qytetërimeve të hershme, pra e sotmja e ka burimin tek e kaluara dhe është e lidhur me të.

- Shqyrton rrugët në të cilat e kaluara i ka ndihmuar të formojnë identitetin, kulturat e përbashkëta, vlerat dhe qëndrimet sot. Kjo përfshin: eksplorimin e marrëdhëniet në mes të kaluarës dhe të tashmes, të kuptuarit që idetë, vlerat, besimet rrjedhin nga një proces ndryshimi dhe ndërveprimi i vazhdueshëm, duke vlerësuar atë që njerëzit brenda një kulture kanë të përbashkët, si dhe diversitetin e tyre, duke vlerësuar se kulturat janë gjithmonë në ndryshim si rezultat i kontaktit me kulturat e tjera. Duke studiuar rrugët në të cilat e kaluara ndihmon për të formuar identitetet, kulturat e përbashkëta, vlerat dhe qëndrimet sot, nxënësit përgatiten për jetën në një shoqëri të ndryshme dhe me shumë etni, në një botë gjithnjë e më të ndërvarur.
- Vlerëson përmes vizitave ku është e mundur rolin e muzeve, galerive, arkivave historike në ruajtjen dhe paraqitjen e së shkuarës. Kjo përfshin përdorimin e muzeve, galerive, arkivave dhe vende historike për të gjeneruar dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve rreth të shkuarës dhe për të ngjallur interesin e nxënësve, në mënyrë që ata në jetën e tyre përtej shkollës, të vazhdojnë përdorimin e këtyre burimeve.
- Përdor TIK-un për të kërkuar informacion për të shkuarën në lidhje me datat, personazhet, objektet, ngjarjet dhe proceset historike, si dhe për të përzgjedhur, klasifikuar, organizuar dhe paraqitur gjetjet. Kjo përfshin: vlerësimin e faqeve të internetit, duke marrë parasysh prejardhjen e materialeve dhe duke vlerësuar vlerën e tyre, si dhe përdorimin e TIK-ut për të kërkuar të dhëna historike, për të përzgjedhur, për të klasifikuar, për të organizuar dhe për të prezantuar informacionin. Nxënësi duhet të ketë mundësi për të ripunuar, për të ristrukturuar punën e tyre dhe për të reflektuar mbi këtë proces.

3. Klasa e njëmbëdhjetë

Programi i historisë i përgatit nxënësit për të ardhmen, i pajis ata me cilësi dhe kompetenca, që janë të çmuara për jetën, rrit mundësinë e arsimit të mëtejshëm dhe zhvillon aftësitë për të marrë pjesë në një shoqëri demokratike. Ai inkurajon mirëkuptimin reciprok të origjinës historike dhe të diversiteteve etnike, kulturore dhe fetare. Programi i historisë synon që të krijojë te nxënësi bindjen se qytetërimi i sotëm është një vazhdimësi progresive e qytetërimit të hershëm, pra e sotmja e ka burimin tek e kaluara dhe është e lidhur me të. Ruajtja e kronologjisë zbaton kriterin shkencor të zhvillimit të ngjarjeve mbi lidhjen shkak – pasojë dhe vazhdimësinë progresive të rrjedhës historike. Trajtesa tematike e historisë shpreh natyrën përzgjedhëse (selektive) të programit, i cili nuk ka si qëllim të mbulojë gjithë ngjarjet e historisë, gjë që do të sillte një ngarkesë të panevojshme për nxënësin, por të trajtojë problemet thelbësore, modelet historike që përbëjnë rrënjët e qytetërimit të sotëm. Ky program e ndihmon nxënësin që të kuptojë më mirë realitetin e sotëm dhe ngjarjet aktuale që ndodhin, t'i analizojë ato në mënyrë kritike, duke bërë lidhjen e të sotmes me të shkuarën historike dhe me perspektivat e së ardhmes.

Programi i historisë për të gjitha strukturat e arsimit profesional, në klasën e 11-të trajton historinë e Shqiptarëve në periudhën parahistorike, antike dhe mesjetare, në mënyrë që nxënësit të kuptojnë jetën dhe ngjarjet e së shkuarës, lidhjen e tyre me të tashmen dhe me të ardhmen, si dhe ndërvarësinë ndërmjet qytetërimeve.

3.1.Përmbajtja e kurrikulës për klasën e 11-të

Në klasën e 11-të, programi “Historia e shqiptarëve” trajton tërë aspektet e jetës shoqërore si shteti, ligji, zhvillimi ekonomik, shoqëria, kultura materiale dhe shpirtërore si dhe veprimtaritë e jetës së përditshme nga periudha parahistorike deri në periudhën moderne, duke u përpjekur të vendosë një raport të baraspeshuar ndërmjet këtyre fushave të jetës. Nxënësi nëpërmjet tij kupton ligjësitë themelore të organizimit, të funksionimit dhe të zhvillimit të shoqërisë shqiptare, analizon ngjarjet dhe personalitetet që i dhanë tiparet kryesore,

përshpejtuan dhe thelluan proceset politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore si dhe vlerëson ndikimin e ndërsjellë të kulturave dhe të ngjarjeve historike të popullit shqiptar me ato të popujve të tjerë rajonalë dhe më tej. Ky program e ndihmon nxënësin që të kuptojë më mirë realitetin e sotëm dhe ngjarjet aktuale që ndodhin, duke i kuptuar ato në mënyrë kritike, për të bërë lidhjen e së sotmes me të shkuarën historike dhe me perspektivat e së ardhmes.

Përmbajtja e dhënë në programin e historisë ofron mundësi për zhvillimin dhe ndërtimin e koncepteve, njohurive, aftësive/shkathësive, qëndrimeve dhe vlerave, të cilat janë të ndërlidhura me njëra – tjetrën dhe duhet të jepen në mënyrë të integruar në të gjithë tematikat e përcaktuara në program, me qëllim ndërtimin dhe zbatimin e kompetencave të lëndës dhe kompetencave kyçe. Tematikat dhe veprimtaritë e sugjeruara të dhëna në program janë bazë për të siguruar rezultatet e të nxënit, sipas koncepteve dhe kompetencave historike. Për secilën tematikë janë paraqitur njohuritë, aftësitë/shkathësitë, qëndrimet dhe vlerat për klasën e 11-të, të arsimit profesional.

3.2.Rezultatet e të nxënit për konceptet dhe kompetencat historike

Përgjatë gjithë programit të historisë zhvillohen njohuritë, aftësitë/shkathësitë, qëndrimet e vlerat që duhet të zotërojë nxënësi për ndërtimin e koncepteve historike: *Kuptimi kronologjik. Ndryshimi dhe vazhdimësia. Shumëllojshmëria kulturore, etnike dhe fetare, rëndësia dhe realizimin e kompetencave historike: Kërkimi historik. Përdorimi i burimeve. Analiza shkak-pasojë. Interpretimi. Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën.*

Tabela 3. Rezultatet e të nxënit për kompetencat dhe konceptet historike për klasën e 11-të dhe të 12-të të arsimit profesional

REZULTATET E TË NXËNIT PËR KOMPETENCAT HISTORIKE				
Kërkimi historik	Përdorimi i burimeve	Interpretimi historik	Shkaku dhe pasoja	Shpjegimi dhe komunikimi
<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon dhe shqyrton, individualisht dhe si pjesë e një grupi, pyetje specifike historike për periudhën parahistorike, antike mesjetare, moderne dhe bashkëkohore ose çështje që u përkasin këtyre periudhave, duke bërë testimin e hipotezave; • reflekton në mënyrë kritike për pyetje ose çështje historike që i përkasin periudhës parahistorike, 	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon tipat e burimeve historike si një domosdoshmëri në punën e historianit dhe në dhënien e përgjigjeve të argumentuara për ndërtimin e ngjarjes historike; • vlerëson historinë gojore, me anë të së cilës dëshmitë gojore për ngjarjet e fundit historike mund ta bëjnë historinë më të gjallë në sytë e nxënësve, si dhe mund t’u lënë vend pikëpamjeve e perspektivave të atyre që nuk kanë marrë pjesë në “historinë e shkruar”; • kërkon, duke vlerësuar burimet alternative, për ndërtimin e ngjarjes historike për periudhën parahistorike, antike mesjetare, moderne dhe bashkëkohore; • identifikon, zgjedh dhe përdor një sërë burimesh historike, duke përfshirë burimet tekstuale, vizuale, objektet dhe mjedisin historik për të 	<ul style="list-style-type: none"> • Kupton pse historianët dhe të tjerët i kanë interpretuar ngjarjet, njerëzit dhe situatat historike që i përkasin periudhës parahistorike, antike mesjetare, moderne dhe bashkëkohore në mënyra të ndryshme; • shpjegon se si dhe pse ngjarjet historike janë interpretuar në mënyra të ndryshme nëpërmjet një sërë mediash; • shqyrton një sërë interpretimesh të së kaluarës që i përkasin periudhës parahistorike, antike mesjetare, moderne dhe bashkëkohore për 	<ul style="list-style-type: none"> • Analizon ngjarjet historike që i përkasin periudhës parahistorike, antike mesjetare, moderne dhe bashkëkohore në lidhjet e tyre shkak-pasojë; • shpjegon pasojat në përfundimin e ngjarjeve, të situatave dhe të ndryshimeve historike që i përkasin periudhës parahistorike, antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore. 	<ul style="list-style-type: none"> • Paraqet shpjegime për periudhën parahistorike, antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore që janë koherente, të strukturuar dhe të arsyetuara, duke përdorur kronologjinë dhe fjalorin e duhur historik; • komunikon njohuritë historike për periudhën parahistorike, antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore në mënyra të ndryshme, duke

antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore;	argumentuar interpretimin e tij në lidhje me ngjarje apo çështje të caktuara që i përkasin periudhave parahistorike, antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore; <ul style="list-style-type: none"> • vlerëson burimet e përdorura për të arritur përfundime të arsyetuara dhe logjike për periudhën parahistorike, antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore. 	të vlerësuar vlefshmërinë e tyre.		përdorur kronologjinë dhe fjalorin e duhur historik.
--	---	-----------------------------------	--	--

REZULTATET E TË NXËNIT PËR KONCEPTET HISTORIKE

Kuptimi kronologjik	Ndryshimi dhe vazhdimësia	Shumëllojshmëria kulturore, etnike dhe fetare	Rëndësia
<ul style="list-style-type: none"> • Përdor saktë datat dhe fjalorin e duhur historik për periudhën parahistorike, antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore; • kupton organizimin kronologjik të historisë dhe vendos ngjarjet në periudhën e saktë historike (parahistorike, antike, mesjetare, moderne, bashkëkohore), duke kuptuar dhe duke shpjeguar marrëdhëniet historike; • ndërton linjën e kohës, duke vendosur në të periudhat historike dhe ngjarjet e rëndësishme historike të historisë së shqiptarëve; • kryen veprime për llogaritjen e kohës; 	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon ndryshimin dhe vazhdimësinë e ngjarjeve historike brenda dhe përtej periudhave historike (parahistorike, antike, mesjetare, moderne, bashkëkohore); • analizon shkallën dhe ritmin e ndryshimit, nëse ndryshimi arriti në progres dhe nëse po, për kë për ngjarje historike që i përkasin periudhës parahistorike, antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore; • analizon arsyet dhe rezultatet e ngjarjeve, e situatave dhe ndryshimeve historike për periudhën parahistorike, antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore; 	<ul style="list-style-type: none"> • Kupton se njerëzit dhe shoqëritë e përfshira në të njëjtën ngjarje historike që i përket periudhës parahistorike, antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore mund të kenë përvoja dhe pikëpamje të ndryshme për të 	<ul style="list-style-type: none"> • Vlerëson rëndësinë e ngjarjeve, të njerëzve dhe të zhvillimeve historike që i përkasin periudhës parahistorike, antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore

• krijon një tabelë kronologjike (për Shqipërinë) të periudhave historike, duke e pasuruar atë në vazhdimësi me informacionin e ri.	• kupton dhe ndërgjegjësohet për veçoritë e prirjeve historike sipas periudhave (antike, mesjetare, moderne, bashkëkohore), të cilat sollën progresin në shoqërinë shqiptare.	njëjtën ngjarje historike.	në kontekstin e tyre historik dhe në ditët e sotme.
---	---	----------------------------	---

3.3.Koha mësimore

Në klasën e njëmbëdhjetë të arsimit profesional, lënda e historisë zhvillohet me 1 orë në javë, për 34 javë mësimore ose 36 javë mësimore në varësi të strukturës së arsimit profesional.

Tabela 4. Koha mësimore e sugjeruar¹

KLASA 11		
Nr.	Tematika	Orë të sugjeruara ²
1.	Parahistoria dhe antikiteti në territoret Shqiptare	9
2.	Territoret Shqiptare në mesjetë	8
3.	Shqiptarët në fund të Shek. XIV – fillimi i Shek. XX	15
4.	Shqipëria dhe shqiptarët 1912 – 1939	2

¹ Koha mësimore e sugjeruar është dhënë për një strukturë e cila ka 36 javë mësimore vjetore. Mësuesi këto orë i përshtat edhe për strukturat që kanë më pak javë mësimore vjetore.

² Për secilën tematikë është dhënë një numër i sugjeruar orësh mësimore. Theksojmë që mësuesi është i lirë të vendosë vetë për shpërndarjen e orëve mësimore për secilën tematikë të programit, në varësi të strukturës së arsimit profesional, të metodologjisë, të vlerësimit dhe të nevojave të nxënësve në klasë.

KLASA 11-të

TEMATIKA 1. PARAHISTORIA DHE ANTIKITETI NË TERRITORET SHQIPTARE

Përshkrimi i tematikës

Përmes kësaj tematike, nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi/shkathtësi, qëndrime dhe vlera mbi periudhën parahistorike, avancimin e kulturave të para dhe mënyrën e jetesës në parahistori. Nëpërmjet kësaj tematike nxënësit do të kuptojnë dhe gjykojnë për ndryshimet që solli lindja e bujqësisë dhe zbulimi i metalit në jetën e njeriut. Kjo tematikë do t'i pajisë nxënësit me njohuri dhe me shprehje për ilirët dhe qytetërimin e tyre, shtrirjen, mënyrat e jetesës, organizimin shtetëror, kulturën ilire dhe ndikimi e kulturave fqinje greke dhe romake në territorin ilir.

Për tematikën e dhënë më poshtë janë parashikuar dhe orë veprimtarish të sugjeruara të cilat jepen në rubrikën “Veprimtari të sugjeruara³”. Këto orë kanë për qëllim të vendosin nxënësin në pozitën e një historiani, si një zbulues (eksplorues) dhe mbledhës faktesh e dokumentesh, përzgjedhës, gjurmues (hulumtues) e vlerësues, i aftë për të mbajtur qëndrimin e tij për ngjarje të ndryshme historike, duke u bazuar në burime historike. Nëpërmjet tyre nxënësi demonstroi kompetencat e lëndës dhe kompetencat kyçe të zhvilluara gjatë orëve mësimore. Këto orë mësuesi dhe autori i tekstit i integron brenda orëve të tematikës. Tematika së bashku me veprimtaritë realizojnë kompetencat lëndore dhe kompetencat kyçe për të nxënësit gjatë gjithë jetës.

Klasa 11 Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës	Klasa 11 Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të lëndës
Periudha parahistorike Gjurmë të parahistorisë në territoret shqiptare	<ul style="list-style-type: none">identifikon ekzistencën e kulturave parahistorike dhe avancimin e këtyre kulturave;përcakton në hartë qendrat e banuara parahistorike;evidenton veçoritë e organizimit shoqëror në parahistori;shpjegon shkaqet dhe pasojat e ndryshimit të shoqërisë në parahistori;shpjegon procesin e kalimit nga epoka e gurit në atë të metaleve;gjykon ndryshimet që solli lindja e bujqësisë dhe zbulimi i metaleve në jetën e njeriut.
Qytetërimi ilir Ilirët: prejardhja dhe shtrirja e tyre Organizimi ekonomik dhe shoqëror i ilirëve	<ul style="list-style-type: none">evidenton tezat e ndryshme për etnogjenezën e ilirëve;përcakton në hartë shtrirjen e fiseve kryesore ilire;evidenton tiparet e qytetërimit ilir;

³ Mësuesi zhvillon me nxënësit për çdo tematikë të programit një veprimtari të sugjeruar.

<p>Shteti Ilir</p> <p>Shteti i Epirit</p> <p>Mbretëria Dardane</p> <p>Iliria nën Perandorinë Romake</p>	<ul style="list-style-type: none"> • përcakton në hartë shtrirjen e kolonive greke në territorin ilir; • gjykon rolin që luajtën kolonitë greke në shkëmbimin kulturor ndërmjet dy qytetërimeve; • dallon tiparet ekonomike e shoqërore të fiseve ilire nga shek. V deri në shek. II para Krishtit; • përcakton format e organizimit dhe mënyrat e jetesës së shoqërisë ilire; • përcakton format kryesore të organizimit shtetëror në territoret ilire (konfederata fisnore dhe mbretëritë ilire); • vlerëson kontributin e mbretërive ilire dhe drejtuesve të tyre në zhvillimin e qytetërimit ilir; • përcakton në hartë shtrirjen e shtetit të Epirit; • shpjegon format kryesore të organizimit politik, ekonomik dhe shoqëror të shtetit të Epirit; • vlerëson rolin e shtetit të Epirit në qytetërimin ilir; • përcakton në hartë shtrirjen e mbretërisë Dardane; • shpjegon tiparet kryesore të organizimit politik, ekonomik dhe shoqëror të mbretërisë Dardane; • vlerëson rolin e mbretërisë së Dardanisë në qytetërimin ilir; • gjykon mbi ndryshimet që pësoi jeta dhe kultura ilire gjatë sundimit romak; • vlerëson disa burime historike për kulturën ilire, gjuhën, simbolet, monedhat, ndërtime, veshjet, veglat e punës, armët, praktikat e varrimit dhe besimin.
<p>Koncepte dhe terma</p>	
<p>Parahistori, paleolit, neolit, eneolit, bronz; matriarkat, patriarkat, etnogjenezë, Ilir; mbretëri, paganizëm, autokton, barbar, tuma, urna, terrakota, federata fisnore; palafite; bazileu; shtet federativ; Lidhje Molose; Aleanca Epirote, provincë; kolonë; koloni helene;</p>	
<p>Veprimtari të sugjeruara për tematikën “Parahistoria dhe antikiteti në territoret shqiptare”</p>	
<p><i>Nga pellazgët te ilirët</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • ballafaqon tezat pro dhe kundër, të prejardhjes së ilirëve; 	

Ose:

Vizitë në muze ose në një zonë arkeologjike /historike

- vëzhgon gjurmë të qytetërimit ilir në territoret shqiptare;

Ose:

Burimet e shkruara greke e romake për Ilirinë

- gjykon mbi burimet e shkruara greke e romake për zhvillimin e qytetërimit Ilir.

TEMATIKA 2. TERRITORET SHQIPTARE NË MESJETË

Përshkrimi i tematikës

Përmes kësaj tematike, nxënësit demonstronë njohuri, aftësi/shkathtësi, qëndrime dhe vlera mbi territoret shqiptare në mesjetë. Kjo tematikë ka për qëllim të shpjegojë vazhdimësinë ilire-arbërore, ndarjen e Perandorisë Romake dhe ndryshimet që pësuan territoret shqiptare në Perandorinë Bizantine. Tematika përshkruan veçoritë kryesore të principatave arbërore gjatë shek. XII-XV (Principata e Arbrit, Balshajve, Topiajve, Kastriotëve, si dhe ndryshimet kryesore që solli zhvillimi i marrëdhënieve feudale në territoret arbërore. Nëpërmjet kësaj tematike nxënësit njihen me karakteristikat kryesore të qyteteve mesjetare arbërore, kulturën, artin dhe shoqërinë gjatë mesjetës.

Për tematikën e dhënë më poshtë janë parashikuar dhe orë veprimtarish të sugjeruara të cilat jepen në rubrikën “Veprimtari të sugjeruara”. Këto orë mësuesi dhe autori i tekstit i integron brenda orëve të tematikës. Tematika së bashku me veprimtaritë realizojnë kompetencat lëndore dhe kompetencat kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës.

Klasa 11 Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës	Klasa 11 Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të lëndës
Mesjeta e hershme arbërore, vazhdimësia etno-kulturore (shek. V-X) Arbëria mes Bizantit dhe Perëndimit: <ul style="list-style-type: none">• zhvillimet politike (shek. XI-XIV)• ekonomia dhe shoqëria në qytetin dhe fshatin mesjetar arbëror. Organizmi politik në Arbërinë e shek. XIV-XV	<ul style="list-style-type: none">• shqyrton të dhënat arkeologjike dhe historike që tregojnë vazhdimësinë ilire-arbërore;• gjykon për pasojat e dyndjeve sllave në Ballkan dhe territoret shqiptare;• evidenton ndryshimet që pësuan territoret shqiptare në Perandorinë Bizantine;• përshkruan tiparet kryesore të organizimit politik e shoqëror të Principatës së Arbrit;• vlerëson rolin e Principatës së Arbrit si organizim shtetëror;• analizon faktorët që ndikuan në lindjen e marrëdhënieve feudale;

<p>Arti, kultura, besimi, letërsia dhe arsimit në Arbërinë mesjetare</p>	<ul style="list-style-type: none"> • përcakton karakteristikat e qytetit dhe fshatit mesjetar arbëror dhe përshkruan mënyrat e jetesës në to; • përcakton në hartë shtrirjen e Principatave Arbërore (shek. XIV-XV); • analizon veçoritë ekonomike, politike dhe shoqërore të principatave shqiptare gjatë shek. XIV-XV; • tregon disa nga aspektet e zhvillimit të artit, kulturës, letërsisë dhe arsimit në Arbërinë mesjetare; • përcakton kushtet e përhapjes dhe organizimit të besimit të krishterë në Arbërinë mesjetare.
<p>Koncepte dhe terma</p> <p>Arbër; asimilim; sllavë; principatë; kodikë; pronja; bashтина; statut; kultura e Komanit; vasalitet; sundim dinastik, epitaf; ikonë, despot, Despotat, korporatë, metropol i Ilirikut; toponimi.</p>	
<p>Veprimtari të sugjeruara për tematikën “Territoret shqiptare në mesjetë”</p> <p><i>Despotati i Epirit</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • vlerëson krijimin e despotatit të Epirit; • tregon ecurinë historike të despotatit; • prezanton faktorët e rënies së despotatit dhe rivendosjes së sundimit bizantin. <p><i>Ose:</i></p> <p><i>Diskutim:</i> Arti, kultura dhe besimi në Arbërinë mesjetare</p> <ul style="list-style-type: none"> • rendit disa të dhëna për kulturën arbërore, si: gjuhën, simbolet, besimin, monedhat, ndërtimet, veshjet, veglat e punës, armët; marrëdhëniet martesore; etj.; 	

TEMATIKA 3. SHQIPTARËT NË FUND TË SHEK. XIV – FILLIMIN E SHEK. XX

Përshkrimi i tematikës

Përmes kësaj tematike, nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi/shkathtësi, qëndrime dhe vlera mbi historinë e shqiptarëve në periudhën e fundshekullit të XIV deri në fillim të shekullit XX. Ajo evidenton momentet kryesore të qëndrimit të klasës feudale shqiptare dhe ballkanike ndaj sulmeve të para osmane; shpjegon momentet kryesore të jetës dhe veprimtarisë së Gjergj Kastriot Skënderbeut, shkaqet e thirrjes së kuvendit të Lezhës, rëndësinë e tij; tiparet e shtetit nën drejtimin e Gjergj Kastriot Skënderbeut, tiparet e jetës së përditshme, marrëdhëniet e tij me shtetet e tjera dhe vlerëson rëndësinë historike që pati periudha e Skënderbeut. Tematika analizon zhvillimin ekonomik e shoqëror të qyteteve shqiptare në shek. XVII-XVIII dhe faktorët që ndikuan në përhapjen e islamizmit në tokat shqiptare. Ajo tregon rrugën e formimit të pashallëqeve (Shkodrës, Janinës) dhe reformat e ndërmarra nga to, si

dhe aspekte të jetës së përditshme në këto pashallëqe. Tematika përshkruan zhvillimin e artit, e kulturës, e arkitekturës, e arsimit dhe fesë gjatë kësaj periudhe.

Përmes kësaj tematike, nxënësit aftësohen për periudhën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare: evidentojnë kushtet historike të lindjes së Rilindjes Kombëtare dhe rolin e elitës intelektuale shqiptare në zhvillimin e ndërgjegjes kombëtare; vlerësojnë programin e Rilindjes Kombëtare, platformën dhe organizimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, momentet kyçe të lëvizjes kulturore-arsimore evidenton rëndësinë e mësonjëtores së Korçës, Kongresit të Manastirit dhe atë të Elbasani; shpjegojnë veçoritë e kryengritjeve antiosmane gjatë viteve 1911-1912 dhe karakterin kombëtar dhe autonomist të Memorandumit të Greçes. Analizojnë evolucionin e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare deri në shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë.

Për tematikën e dhënë më poshtë janë parashikuar dhe orë veprimtarish të sugjeruara të cilat jepen në rubrikën “Veprimtari të sugjeruara”. Këto orë mësuesi dhe autori i tekstit i integron brenda orëve të tematikës. Tematika së bashku me veprimtaritë realizojnë kompetencat lëndore dhe kompetencat kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës.

<p style="text-align: center;">Klasa 11</p> <p style="text-align: center;">Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës</p>	<p style="text-align: center;">Klasa 11</p> <p style="text-align: center;">Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të lëndës</p>
<p>Ardhja e osmanëve në Ballkan dhe qëndresa ballkano-arbërore (fundi i shek. XIV – fillimi i shek. XV)</p> <p>Gjergj Kastriot Skënderbeut dhe Besëlidhja e Lezhës</p> <p>Qëndresa e shqiptarëve kundër osmanëve dhe diplomacia e shtetit të Skënderbeut</p>	<ul style="list-style-type: none"> • përcakton arsyet e ardhjes së osmanëve në Ballkan dhe territoret shqiptare; • vlerëson qëndrimin e klasës feudale shqiptare dhe asaj ballkanike ndaj sulmeve të para osmane; • evidenton përpjekjet për qëndresë ndaj osmanëve; • përcakton momentet kryesore të jetës dhe veprimtarisë së Gjergj Kastriot Skënderbeut; • shpjegon shkaqet e thirrjes së Kuvendit të Lezhës; • analizon vendimet e Kuvendit të Lezhës duke vlerësuar rëndësinë e tyre; • analizon tiparet e shtetit nën drejtimin e Gjergj Kastriot Skënderbeut; • gjykon mbi marrëdhëniet e Skënderbeut me shtetet e tjera dhe vlerëson rolin e tij si diplomat; • vlerëson rëndësinë historike të periudhës së Skënderbeut për kohën dhe të ardhmen;
<p>Territoret shqiptare gjatë sundimit osman (shek. XVI-shek. XVIII)</p> <p>Pashallëku i Shkodrës (1757-1831)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • shpjegon organizimin administrativ, legjislativ, ekonomik dhe shoqëror, të territoreve shqiptare nën Perandorinë Osmane;

<p>Pashallëku i Janinës (1787 - 1822)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • analizon zhvillimin ekonomik e shoqëror të qyteteve shqiptare në shek. XVII-XVIII; • përcakton faktorët që ndikuan në përhapjen e islamizmit në tokat shqiptare; • tregon në hartë shtrirjen e Pashallëkut të Shkodrës dhe Janinës; • shpjegon rrugën e formimit të Pashallëkut të Shkodrës dhe reformat e ndërmarra në këtë pashallëk; • gjykon mbi marrëdhëniet e këtij Pashallëku me Perandorinë Osmane dhe Evropën; • tregon rrugën e formimit të Pashallëkut të Janinës dhe reformat e ndërmarra në këtë pashallëk; • gjykon mbi marrëdhëniet e këtij Pashallëku me Perandorinë Osmane dhe Evropën; • evidenton disa aspekte të jetës së përditshme në këto pashallëqe; • vlerëson rëndësinë e këtyre pashallëqeve në procesin e shtetformimit dhe ndërtimit të identitet kombëtar të shqiptarëve; • përshkruan karakteristika të kulturës, arkitekturës, arsimit dhe besimit gjatë kësaj periudhe;
<p>Rilindja Kombëtare dhe tiparet e programit politik të Rilindësve shqiptarë</p> <p>Shqiptarët gjatë periudhës së Tanzimatit (1839-1879)</p> <p>Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe veprimtaria e saj</p> <p>Përpyjekjet e shqiptarëve për gjuhë dhe shkollë shqipe përgjatë shek. XIX</p> <p>Khonturqit dhe shqiptarët (1908-1912)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • shpjegon kushtet historike të fillesave të Rilindjes Kombëtare Shqiptare; • evidenton rolin e elitës intelektuale shqiptare në zhvillimin e ndërgjegjes kombëtare; • shpjegon tiparet e programit politik të rilindësve shqiptarë; • analizon kushtet dhe shkaqet që çuan në lindjen e çështjes shqiptare; • evidenton reformat e Tanzimatit dhe ndikimin e tyre në çështjen shqiptare; • gjykon mbi vendimet e Traktatit të Shën Stefanit dhe Kongresit të Berlinit; • shpjegon organizmin dhe platformën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit; • evidenton përpyjekjet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për mbrojtjen e tërësisë tokësore shqiptare; • gjykon mbi rolin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në ndërkombëtarizimin e çështjes kombëtare shqiptare dhe rritjes e vetëdijes kombëtare tek shqiptarët

<p>Kuvendi i Vlorës dhe Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë</p>	<ul style="list-style-type: none"> • evidenton përpjekjet e para të Rilindësve për ngritjen arsimore e kulturore të shqiptarëve; • evidenton përpjekjet për zhvillimin e arsimit në viset shqiptare, duke shpjeguar rolin e klerit në të; • përcakton momentet kyçe të lëvizjes kulturore-arsimore (1878-1900): • shpjegon ndikimin e Revolucionit të Turqve të Rinj në lëvizjen kulturore, arsimore dhe politike shqiptare; • argumenton vlerat e Kongresit të Manastirit dhe faktorët që përcaktuan fitoren e alfabetit latin; • gjykon mbi rëndësinë e Kongresit të Elbasanit (1909); • shpjegon kushtet që çuan në kryengritjet antiosmane të viteve 1910-1912; • analizon karakterin kombëtar dhe autonomist të Memorandumit të Greçës (1911); • përcakton karakterin e Luftës së parë Ballkanike dhe qëndrimin e shqiptarëve ndaj saj; • shpjegon kalimin nga platforma autonomiste në atë të Pavarësisë; • analizon vendimet e Kuvendit Kombëtar të Vlorës; • vlerëson rëndësinë e Shpalljes së Pavarësisë;
<p style="text-align: center;">Koncepte dhe terma</p> <p>Koalicion antiosman; territore vasale; Besëlidhje; ferman; sanxhak bej; haraç; vasalitet; diplomaci; aleanca; timar; spahinj; raja; esnafë; vilajet; ejalet; sanxhakë; nahije; kaza; pashallëk; sheriat; kanunname; venome; statut; vezir; islamizim; divani; vali, kleri, pashë, islamizim, lëvizje kombëtare; Rilindje Kombëtare; nacionalizëm; ideologji; Kanuni i Lidhjes së Prizrenit; Traktati i Shën Stefanit; Kongresi i Berlinit; diasporë; autonomi; pavarësi.</p>	
<p style="text-align: center;">Veprimtari të sugjeruara për tematikën “Shqiptarët në fund të shek. XIV – shek. XV”</p> <p>Figura e Gjergj Kastriot Skënderbeut përmes letërsisë dhe artit shqiptar e botëror</p> <ul style="list-style-type: none"> • sjell aspekte të jetës dhe veprimtarisë së Skënderbeut nëpërmjet kinematografisë, teatrit, operës, letërsisë, pikturës, dhe skulpturës. <p>Ose:</p> <p>Roli i gruas në Rilindjen Kombëtare Shqiptare</p> <ul style="list-style-type: none"> • evidenton rolin e grave gjatë Rilindjes Kombëtare Shqiptare për zhvillimin e arsimit dhe kulturës shqiptare. <p>Ose:</p>	

Roli i diasporës në zgjimin e ndërgjegjes Kombëtare Shqiptare

- evidenton disa figura të rëndësishme të diasporës Shqiptare dhe vlerëson rolin e tyre në zhvillimin e ndërgjegjes kombëtare.

**Klasa 11-të
Qëndrimet dhe vlerat**

- Demonstron aftësitë bazë të kërkimit historik.
- Vlerëson rëndësinë që ka e shkuara në ndërtimin e të tashmes.
- Vlerëson rëndësinë e burimeve historike në ndërtimin objektiv të ngjarjes historike.
- Shtron pyetje dhe gjen përgjigje, vlerëson burimet, identifikon dhe analizon interpretime të ndryshme dhe gjykon bazuar në argumente.
- Respekton saktësinë e burimeve historike dhe dallon diferencën midis faktit dhe supozimit.
- Vlerëson pozitën e qytetërimit shqiptar brenda qytetërimit botëror.
- Forcon ndjenjën e identitetit kombëtar dhe të respektit për historinë kombëtare.
- Vlerëson zhvillimin e qytetërimit ilir.
- Vlerëson aftësinë e Skënderbeut në formimin e shtetit.
- Vlerëson marrëdhëniet e Skënderbeut me shtetet e tjera.
- Vlerëson rëndësinë historike që pati periudha e Skënderbeut.
- Vlerëson zhvillimin e marrëdhënieve feudale në territoret arbërore.
- Vlerëson rëndësinë e Pashallëkut të Shkodrës dhe të Janinës.
- Vlerëson rolin e Rilindjes kombëtare dhe rëndësinë e shpalljes së Pavarësisë.
- Demonstron, përmes studimit të historisë, aftësitë qytetare, të cilat kontribuojnë në rritjen e tyre personale si individë, në përgatitjen e tyre në jetë, në punë dhe në shoqëri.
- Vlerëson rëndësinë e historisë në kuptimin e ngjarjeve të së shkuarës.
- Vlerëson gamën e burimeve historike dhe të informacionit, si: dokumentet, burimet e shtypura, historinë gojore, mediat e ndryshme, pikturat, muzetë, galeritë, fotografitë, muzikën dhe internetin, si baza për studimin dhe përshkrimin e një ngjarjeje historike.
- Respekton origjinën historike dhe kupton dobinë e larmisë etnike dhe kulturore të shoqërisë.
- Demonstron gatishmëri për të pranuar njerëzit nga komunitete të ndryshme.
- Shfaq krenari për vendin e tij.
- Vlerëson dhe respekton larminë në shoqëri, si dhe kontributin e kulturave dhe grupeve të ndryshme fetare e shoqërore.

- Tregon se disa ngjarje dhe ndryshime mund të interpretohen në mënyra të ndryshme dhe shpjegojnë arsyet e mundshme për këtë interpretim.
- Vlerëson dhe respekton pikëpamjet e të tjerëve.
- Tregon integritet në aksesimin dhe përdorimin etik të informacionit.
- Paraqet dhe komunikon lirshëm mendimet e tij.
- Është krijues dhe prezanton idetë e reja të tij.
- Demonstron interes dhe kuriozitet për historinë.
- Demonstron shpirtin e objektivitetit dhe paanësisë.
- Vetë vlerësohet dhe përdor mendimin kritik dhe kritikën konstruktive në situata konkrete.
- Demonstron pavarësi dhe besim në vetvete.
- Respekton punën e kryer mirë dhe pranimin e opinioneve të tjera (madje edhe të kundërta) duke treguar tolerancë.
- Demonstron vullnet në arritjen e rezultateve.
- Respekton përpjekjet personale dhe ato në grup.

4. UDHËZIME METODOLOGJIKE

Përdorimi i një numri të larmishëm rrugësh dhe metodash në mësimin e historisë nga mësuesit është një përbërës thelbësor në procesin e zbatimit të kurrikulës së historisë, në arritjen e rezultateve të parashikuara të të nxënit, në aftësimin e nxënësve për ndërtimin dhe demonstrimin e kompetencave kyçe të të nxënit dhe kompetencave e koncepteve historike, në lidhjen e historisë me lëndët dhe fushat e tjera të të nxënit, në integrimin e temave ndërkurikulare, si dhe në zotërimin e cilësive historike për përmbushjen me sukses të qëllimeve arsimore.

Të nxënit në lëndën e historisë mund të realizohet vetëm me anë të pjesëmarrjes aktive të nxënësve në procesin e të nxënit, në mënyrë që ata të kuptojnë, të vlerësojnë e të përdorin përmbajtjen e synuar për të ndërtuar mbi të njohuri e aftësi të reja në situata të ndryshme me të cilat do të përballen në të ardhmen.

Edhe pse të nxënit në mënyrë të pavarur mbetet i rëndësishëm, po aq rëndësi ka edhe dhënia e mundësive me anë të metodologjisë së mësimdhënies për të ndërvepruar me njëri-tjetrin dhe me mjedisin ku jetojnë. Për këtë, shkolla duhet të ofrojë një mjedis mbështetës ku të njihet e të vlerësohet kontributi i secilit nxënës.

Mësuesi duhet të zbatojë në klasë teknika aktive të mësimdhënies dhe të nxënit. Ai duhet të organizojë aktivitete, të udhëzojë nxënësit për të marrë pjesë në to dhe të mundësojë pjesëmarrjen aktive dhe kuptimplote të nxënësve. Në këtë mënyrë nxënësit do të zhvillojnë ndjenjën e përgjegjësisë për të nxënit e tyre, duke formësuar kështu aftësitë e para për të nxënit gjatë gjithë jetës.

Në klasën e 11-të të arsimit profesional format, metodat, strategjitë dhe teknikat e të mësuarit, duhet të jenë të shumta e të larmishme. Ato zgjidhen në përshtatje me përmbajtjen lëndore, me nivelin e nxënësve, me veçoritë e temave të ndryshme mësimore dhe në varësi të gjendjes së materialeve burimore dhe didaktike.

Metodat dhe teknikat e mësimdhënies që mund të zbatohen gjatë një ore mësimi, në klasën e 11-të janë të shumta. Si të tilla mund të përdoren:

Mësimi zbulues nëpërmjet të cilit kalohet nga njohuritë elementare në përgjithësime, nga hipotezat në gjetjen e origjinës së dukurive, nga problemet e thjeshta në zgjidhjen e tyre;

Biseda, e cila do të ishte më e efektshme për ato tema ku nxënësit kanë njohuri paraprake të bollshme që fitohen nëpërmjet rrugëve të shumta të informacionit masiv;

Shpjegimi, i cili mund të jetë i suksesshëm në të gjitha ato veprimtari të përbashkëta të mësuesit e nxënësve që synojnë të kuptuarit e njohurive për zhvillimin në kohë e në hapësirë të dukurive dhe të proceseve historike;

Diskutimi është një nga metodat më të thjeshta që përdoret në realizimin e veprimtarive në klasë, kur është fjala për të mundësuar procesin e pjesëmarrjes sa më të gjerë të nxënësve në mësim. Diskutimi është një përzierje e shpjegimeve, mësues-nxënës, e shkëmbimit të pikëpamjeve dhe pyetjeve ndërmjet tyre, e transferimit dhe integritit të njohurive dhe aftësive. Diskutimi me të gjithë klasën është një mënyrë shumë e mirë për mësuesin/en dhe për nxënësit për të zbuluar se cilat janë qëndrimet e tyre rreth çështjeve, ngjarjeve dhe

koncepteve të ndryshme që trajtohen në lëndën e historisë. Gjithashtu, diskutimi është një rast shumë i mirë për të praktikuar të dëgjuarit të nxënësit, të folurën me radhë dhe aftësi të tjera që nevojiten në punën në grup.


Puna me faktet dhe përdorimi i burimeve: Përdorimi i strukturuar i dokumenteve historike ndihmon nxënësin të zhvillojë përvojën për vlerësimin e fakteve dhe aftësinë për të formuluar gjykime të arsyeshme, ndaj mësuesi i historisë duhet ti nxisë nxënësit të përdorin burime të larmishme për njohjen e fakteve historike dhe mësimin e tyre kritik e analitik e, në mënyrë të veçantë si :

- arkivat, duke lejuar në këtë mënyrë të shfrytëzohen dokumente origjinale;
- kinemaja dhe prodhimtaria audiovizuale, qoftë dokumentare, qoftë fantastike;
- bibliotekën;
- teknologjitë e informacionit, që duhet të përbëjnë objektin e një trajtimi kritik, individual e kolektiv, për të cilin mësuesi luan një rol themelor ;
- llojet e ndryshme të muzeve dhe vendet përkujtimore, që ndikojnë në përkapjen në mënyrë të qartë nga ana e nxënësve të ngjarjeve të fundit, konkretisht në përmasën e tyre të përditshme ;
- historia gojore, me anë të së cilës dëshmitë gojore për ngjarjet e fundit historike mund ta bëjnë historinë më të gjallë në sytë e të rinjve, si dhe mund t'u lënë vend pikëpamjeve e perspektivave të atyre që nuk kanë marrë pjesë në “ historinë e shkruar”.

Studimi kërkimor: Përfshirja në kërkim është pjesë përbërëse e programit të historisë. Duke njohur dhe duke përvetësuar mënyrën se si punojnë historianët, nxënësit zhvillojnë aftësinë për ta zbatuar atë gjerësisht në lëndën e historisë dhe në fusha të tjera.

Përdorimi i kërkimit historik u paraqet nxënësve një mënyrë për të bërë hulumtime, për të organizuar dhe për të shpjeguar ngjarjet që kanë ndodhur. Kërkimi historik është procesi i "të bërit histori". Ai është një proces ciklik (Figura. 1), që fillon me shtrimin e pyetjeve historike, pasohet nga gjetja dhe analiza e burimeve historike për të krijuar fakte dhe dëshmi historike. Dëshmia historike përdoret më pas për të ndërtuar interpretimet historike që kërkojnë t'u përgjigjen pyetje historike.

Figura 1. Procesi i kërkimit historik



Përdorimi i kërkimit historik duhet të jetë në qendër të mësimit të historisë dhe mësuesit duhet t'i krijojnë mundësinë nxënësit për të mësuar aftësitë e nevojshme përmes praktikës dhe angazhimit në kërkimin historik. Përdorimi i pyetjeve në çdo njësi mësimore siguron një pikë kontakti për nxënësit për të kërkuar, sistemuar dhe analizuar informacion në përgjigje të çështjeve që hulumtohen në programin mësimor. Qasja kërkimore, kur zbatohet në mënyrë efektive, zhvillon cilësitë historike dhe aftëson nxënësit të jenë të pavarur, krijues

dhe mendimtarë kritik. Ajo nxit demonstrimin e kompetencave historike dhe kompetencave kyçe të të nxënësve. Tabela e mëposhtme paraqet një përforcim të qasjes kërkimore për të ndihmuar mësuesit në përdorimin e kësaj qasje.

Tabela 5. Përforcimi i qasjes kërkimore

Faza kërkimore	Cilësitë historike të një nxënësi	Qëllimi
1. Bën pyetje historike	<ul style="list-style-type: none"> • Kureshtar 	<p>Më e rëndësishme për procesin e kërkimit është pikënisja. Mësuesit duhet të udhëhiqen nga treguesit e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • angazhojnë interesin e nxënësve; • identifikojnë pyetjet që do të kërkojnë; (një pyetje e përgjithshme kërkimore e ndjekur nga nën-pyetje); • planifikojnë procesin e kërkimit; • përshkruajnë rezultatin.
2. Identifikon dhe gjen burimet përkatëse	<ul style="list-style-type: none"> • I logjikshëm • I balancuar 	<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit vendosin cilat burime janë të dobishme, cilat nuk janë dhe cilat duhen trajtuar me kujdes (me anë të një shembulli mësuesit udhëzojnë paraprakisht nxënësit) • Nxënësit krijojnë fakte dhe dëshmi historike;
3. Analizon lidhjen shkak-pasojë	<ul style="list-style-type: none"> • I logjikshëm • I arsyetuar • I ditur 	<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit analizojnë lidhjet shkak-pasojë për ndërtimin e ngjarjes duke u bazuar në burimet e gjetura;
4. Ndërton interpretime historike, vlerëson burimet dhe jep argumente	<ul style="list-style-type: none"> • I logjikshëm • I balancuar • Metodik • I arsyetuar • I ditur 	<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit mbajnë shënime nga studimi i tyre për burimet. • Nëpërmjet reflektimit dhe diskutimit të drejtuar nga mësuesi, nxënësit janë në gjendje të zhvillojnë përgjigjet për pyetjet hetimore;
5. Kontrollon interpretimet e nxjerra dhe/ose interpretimin e tanishëm historik	<ul style="list-style-type: none"> • I balancuar • I arsyetuar • I ditur 	<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit tregojnë zgjerimin, thellimin dhe transferimin e dijeve të tyre;

6. Shpjegimi dhe komunikimi	<ul style="list-style-type: none"> • I logjikshëm • I arsyetuar • Metodik • I balancuar • I ditur 	<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit shpjegojnë dhe prezantojnë përgjigjet e pyetjeve të tyre nëpërmjet mediave të ndryshme (me shkrim; me gojë; TIK); • Nxënësit respektojnë mendimet e shokëve të tyre qofshin ato dhe të ndryshme nga të tyre;
-----------------------------	--	--

Nxënësit duhet të nxiten për të ndërmarrë, sipas nivelit që kanë dhe rrethanave, kërkime individuale me qëllim që të stimulohen kërshtëria dhe fryma e tyre vetëvepruese në vjeljen e të dhënave si dhe mendimi i tyre sintetizues.

Në rrafshin grupor të nxënësve, të klasës apo shkollës, zhvillimi i projekteve kërkimore kolektive duhet të nxitet më tej, me qëllim që të krijohen kushtet e dialogut dhe ballafaqimit të hapur e tolerant të mendimeve.

Trajtimi ndërdisiplinor dhe shumëdisiplinor. Mësimi i historisë duhet të përdorë në çdo rast potencialin edukativ të një trajtimi ndërdisiplinor e shumëdisiplinor, duke vendosur lidhje me lëndët e tjera që përbëjnë tërësinë e kurrikulës shkollore, konkretisht me letërsinë, gjeografinë, shkencat shoqërore, përfshirë edhe lëndët shkencore.

Veprimtaritë praktike ose projektet kurrikulare kërkojnë zbatimin e më shumë se një metode dhe teknike, si: kërkimi, intervista, vrojtimi, studimi i rastit, etj. Këto metoda e vënë theksin në ndërtimin e kompetencave të lëndës dhe kompetencave kyçe për të nxënësit gjatë gjithë jetës si dhe në demonstrimin e aftësive/shkathtësive, kryesisht aftësisë së punës me dokumentet historike, punës kërkimore, aftësisë për të punuar në grup, aftësisë për të zgjidhur problemin, etj.

Trajtimi ndërkombëtar dhe ndërkufitar. Sipas rrethanave, kërkohet të përkrahët zbatimi i projekteve ndërkombëtare dhe ndërkufitare, mbështetur mbi studimin e një teme të përbashkët, si dhe trajtimet krahasuese apo kryerja e një detyre të përbashkët në shumë shkolla të vendeve të ndryshme, duke përfutur konkretisht nga mundësitë e reja që japin teknologjitë e informacionit dhe vendosja e lidhjeve dhe këmbimeve shkollore.

Mësimi dhe ruajtja në kujtesë. Krahas nxjerrjes në pah të arritjeve pozitive që kanë karakterizuar shekullin XX, si përdorimi paqësor i shkencave për një art më të mirë të jetuari dhe zhvillimi i demokracisë e të drejtave të njeriut, është e nevojshme të merren të gjitha masat edukative për të parandaluar përsëritjen apo mohimin e ngjarjeve shkatërrimtare që kanë ndodhur gjatë këtij shekulli si:

Holokaustin, gjenocidin, spastrimet etnike, krimet e tjera kundër njerëzimit, dhunimet masive të të drejtave të njeriut dhe të vlerave themelore me të cilat është lidhur në mënyrë të veçantë Këshilli i Evropës. *Për këtë qëllim, duhet :*

- të ndihmohen nxënësit për t'u njohur e ndërgjegjësuar me faktet dhe me shkaqet e atyre faktorëve që kanë karakterizuar në mënyrën më të errët historinë e Evropës në veçanti dhe atë të botës në përgjithësi;
- të reflektohet mbi ideologjitë që kanë çuar në to dhe mbi mjetet që bëjnë të mundur të shmanget përsëritja e fakteve të tilla;
- të sigurohet zbatimi i vendimit të ministrave të edukimit (Krakovi2000) lidhur me caktimin në shkolla të një dite përkujtimore të Holokaustit dhe për parandalimin e krimeve kundër njerëzimit;
- të kujtojë ashtu si Evropa, 27 janarin, si ditën përkujtimore të viktimave të Holokaustit dhe 23 gushtin, si ditën përkujtimore për viktimat e regjimeve totalitare naziste dhe komuniste.

Teknologjitë e informacionit e të komunikimit. Në kontekstin e përdorimit shumë të zgjeruar të teknologjive të informacionit dhe komunikimit nga ana e të rinjve, si gjatë jetës së tyre shkollore ashtu edhe jashtëshkollore, ka rëndësi të zhvillohet një pedagogji dhe metodologji që mban parasysh faktin që këto teknologji:

- përbëjnë burimet e pashmangshme në mësimin e historisë;
- shtrojnë çështje themelore, konkretisht atë të besueshmërisë së burimeve;
- u lejojnë mësuesve dhe nxënësve të depërtojnë në burime origjinale dhe interpretime të shumëllojta;
- zgjerojnë më së miri mundësinë për t'u futur në informacione dhe të dhëna historike;
- shumëfishojnë dhe lehtësojnë rastet e bashkëpunimit e të dialogut.

Nga ana tjetër, duhet gjithashtu të krijohen kushtet e nevojshme që mësuesi:

- të mund t'u vijë në ndihmë nxënësve gjatë procesit selektiv për të vlerësuar besueshmërinë e burimeve të informacionit;
- të mund të marrë masat e nevojshme për luftën kundër përhapjes së përmbajtjeve raciste, në mënyrë të veçantë nëpërmjet sistemit internet, duke respektuar normat ligjore dhe lirinë e shprehjes;

- të mund të bëjë përpjekje gjatë orës së mësimit për analizë kritike, duke u mbështetur në larmi pikëpamjesh dhe interpretimesh ndërkulturore;
- të mund të nxisë nxënësit për të zhvilluar kompetencat e tyre, si analizat kritike dhe arsyetimin nëpërmjet analogjisë.

Gjatë orëve të ndryshme të mësimit, metodat e teknikat ndërthuren me njëra-tjetrën, aq sa shpesh nuk mund t'i dallosh kufijtë midis tyre, prandaj, vëmendja e veçantë e mësuesit duhet drejtuar te lidhja organike e metodave dhe e teknikave të veçanta që ai përdor brenda një ore mësimi.

Në ndihmë të zbatimit të këtyre metodologjive, në program parashtrohen një sërë veprimtarish të sugjeruara, të cilat i ndihmojnë nxënësit në zotërimin e kompetencave dhe në arritjen e rezultateve të të nxënës të parashikuara në program.

Mësuesi duhet të tregojnë kujdes të veçantë që nxënësit të nxiten vazhdimisht të reflektojnë në mënyrë kritike mbi ecurinë e të nxënës dhe punës së tyre në shkollë dhe të transferojnë ata çka kanë mësuar në situata jetësore brenda dhe jashtë shkollës.

Mundësia për të marrë pjesë dhe për të përfituar nga përvojat e lëndës së historisë ashtu si nga çdo lëndë tjetër në shkollë, duhet t'u ofrohet të gjithë nxënësve pa përjashtuar askënd për asnjë shkak. Mësimdhënia duhet të bazohet në interesin më të lartë të nxënësit dhe duhet të sigurojë trajtimin e barabartë me dinjitet e respekt të gjithsecilit.

Nxënësit me nevoja të veçanta

Organizimi i kurrikulës sipas kompetencave, në fusha të nxëni, në shkallë, dhe me fokus integrimin, u krijon mësuesve hapësirat për të përshtatur mësimdhënien sipas nevojave të veçanta të nxënësve dhe për të personalizuar të nxënës e tyre. Mësuesit duhet të marrin parasysh faktin se nxënësit janë të ndryshëm, kanë motivim, interesa, stile të nxëni, nevoja dhe aftësi të ndryshme etj. Në disa raste duhen bërë përshtatje të kurrikulës sipas diferencave të zhvillimit brenda një grupi moshor. Mësuesit mund të zgjerojnë zhvillimin e kompetencave kyçe si ato të komunikimit, të menduarit dhe shoqërore sipas nevojave individuale të nxënësve, për të zvogëluar dhe zhdukur diferencat brenda një shkalle të kurrikulës, në fund të saj.

Nxënësit me vështirësi në të nxënë

Shumë nxënës me vështirësi arrijnë rezultatet e pritshme të të nxënës njësoj si nxënësit e tjerë, nëse bëhen përshtatje në mënyrën e

mësimdhënies dhe të vlerësimit të tyre.

Për të arritur nivelin më të lartë të mundshëm të realizimit të kompetencës, mund të zhvillohen programe të veçanta, individuale, për nxënësit me nevoja të veçanta.

Në rastin e nxënësve që formalisht janë përcaktuar si të veçantë, është veçanërisht e rëndësishme që stafi i shkollës, në bashkëpunim me prindërit, të mbështesë të nxënësit e tyre. Procedurat dhe teknikat e vlerësimit për nxënës me nevoja të veçanta duhet të diskutohen herë pas here me prindërit dhe vetë nxënësit. Prindërit duhet të kuptojnë se si ndikojnë këto procedura dhe teknika të përshtatura në vlerësimin e punës së nxënësve.

Nxënësit e talentuar

Fleksibiliteti i zhvillimit të programit lejon plotësimin e nevojave individuale të nxënësve të talentuar.

Mësuesit duhet t'u krijojnë kushte dhe situata të tilla që nxënësit të shfaqin dhe të zhvillojnë talentet e tyre. Kjo arrihet nëse atyre u krijohen mundësitë të punojnë me një përmbajtje më të thelluar dhe zgjeruar, të zhvillojnë në mënyrë të vazhdueshme elemente specifike të kompetencave kyçe (p.sh.: aftësitë e nivelit të lartë konjitiv të kompetencës së të menduarit) dhe specifike të fushës, të fokusohen në çështjet kroskurrikulare, të zgjerojnë mjediset dhe materialet e të nxënësit brenda dhe jashtë shkollës.

4.1. Materiale dhe burime mësimore

Përdorimi i mjeteve mësimore në mësimdhënien dhe në procesin e të nxënësit në lëndën e historisë, ndihmon në konkretizimin e ideve dhe të dukurive, në aplikimin e metodave dhe strategjive të mësimdhënies si dhe e bën mësimin më interesant dhe më rezultativ për nxënësit. Përdorimi i suksesshëm i metodave dhe i teknikave të lartpërmendura, nuk mund të realizohet pa mjetet e nevojshme didaktike, të cilat janë të llojeve të ndryshme, si: harta historike të përgjithshme ose tematike, atlase, albume, foto, skica, filma mësimorë, videokaseta, kompjuter, aparat projekcioni, CD, DVD, TIK, etj. Këto mjete po zënë gjithnjë e më shumë vendin që u takon për konkretizimin e një sërë ngjarjesh historike, të cilat janë vështirë të kuptohen pa një konkretizim audioviziv etj.

5. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

Vlerësimi është një aspekt i rëndësishëm i lëndës së historisë. Në përputhje me parimet e qasjes së të nxënësve bazuar në kompetenca, vlerësimi konsiderohet si element i mësimdhënies i cili përqendrohet në nivelin e arritjes së kompetencave, fokusohet në matjen e njohurive e aftësive, në arritjen e rezultateve të të nxënësve dhe në nivelin e përmbushjes së kompetencave. Informacioni i siguruar nga vlerësimi, e ndihmon mësuesin të evidentojë përparimin e nxënësve, të vlerësojë se sa të përshtatshme e të dobishme janë metodat e mësimdhënies që ai përdor, të përmirësojë mësimdhënien dhe t'i pajisë nxënësit me informacionin përkatës për progresin e tyre.

Vlerësimi është një informacion i rëndësishëm që u shërben nxënësve për të ndjekur vetë ecurinë e tyre në këtë lëndë, për të njohur anët e tyre të forta dhe vështirësitë që hasin në zotërimin e njohurive dhe kompetencave, në mënyrë që të punojnë përkatësisht për përforcimin dhe kapërcimin e tyre. Vlerësimi është një informacion i rëndësishëm edhe për prindërit, me anë të të cilit ata mund të ndihmojnë më mirë në edukimin e fëmijëve të tyre.

I domosdoshëm është vlerësimi i përmbajtjes të lëndës lidhur me zotërimin e njohurive dhe demonstrimin e aftësive historike nëpërmjet treguesve të besueshëm për progresin e tyre. *(p.sh. vetëvlerësimi, intervistë me një listë treguesish, testi objektiv, vëzhgimi i kërkimit historik me një listë të saktë treguesish, prezantimi me gojë ose me shkrim, projekti kurrikular etj.).*

Në përzgjedhjen e praktikave të vlerësimit, në përcaktimin e kohës së përshtatshme, në përzgjedhjen e materialeve për vlerësim mësuesi duhet të ketë parasysh:

- përcaktimin e qëllimit dhe strategjisë së vlerësimit;
- përzgjedhjen e veprimtarive, që mundësojnë demonstrimin e arritjes së kompetencave;
- përdorimin e vlerësimit për të verifikuar çfarë dinë aktualisht nxënësit;

- dallimin qartë të qëllimit të detyrës së zgjedhur për vlerësim.

Vlerësimi i nxënësve duhet të nxjerrë në pah arritjet e tyre, në mënyrë që ata të inkurajohen të mësojnë me më shumë dëshirë. Ai duhet të konsiderohet si një mjet në ndihmë të nxënësve, i cili i ndihmon ata të njohin më mirë aftësitë e tyre në të nxënë, të zhvillojnë e të përdorin talentet dhe aftësitë në mënyra sa më të dobishme. Nxënësit vetë duhet të jenë pjesë e procesit të vlerësimit të arritjeve të tyre. Me anë të vlerësimit, mësuesi informohet rreth çfarë dhe si po mësojnë nxënësit, çka e ndihmon atë të planifikojë mësimdhënien në vijim dhe të përgatisë materiale ose të rishikojë metodologjinë e mësimdhënies për t'iu përshtatur nevojave të nxënësve. Vlerësimi nga ana e mësuesit duhet të marrë në konsideratë edhe aftësinë e nxënësve për të përcaktuar e arritur objektiva për veten.

Mësuesi i historisë vlerëson saktësinë e informacionit të paraqitur nga nxënësit, aftësitë e tyre për të diskutuar, debatuar, krahasuar, argumentuar dhe parashikuar, duke mbajtur qëndrim vetjak ndaj një ngjarjeje ose figure të caktuar historike. Në lëndën e historisë, mësuesi duhet të vlerësojë aftësinë e nxënësve për të punuar në grup si dhe aftësinë e tyre për të vlerësuar nga secili nxënës punën e anëtarëve të tjerë të grupit.

Mësuesi i historisë duhet të vlerësojë përdorimin e burimeve alternative nga nxënësit, ballafaqimin e tyre dhe forcën argumentuese ndaj një çështjeje të diskutueshme ose të debatueshme në histori. Kriter vlerësimi për nxënësit në lëndën e historisë është edhe përfshirja e tyre në debat, duke respektuar mendimet e kundërta të njëri-tjetrit, të bazuara mbi argumente ose fakte historike.

a. Vëzhgimi

Mësuesi vlerëson ecurinë e nxënësve duke i vëzhguar ata gjatë punës individuale ose në grup si dhe ndërveprimin e tyre gjatë veprimtarive të ndryshme në klasë dhe në shkollë. *Mësuesi vëzhgon aspekte të tilla si:*

- aftësinë e nxënësve për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për të bashkëpunuar në grup;
- ndërveprimet e nxënësve me njëri-tjetrin dhe me të rriturit;
- cilësinë e prezantimit të punimeve;
- interesat, aftësitë ose talentet e veçanta të nxënësve;

- pjesëmarrjen dhe interesin që shprehin nxënësit në veprimtari e aktivitete të ndryshme;
- përgjegjësinë vetjake dhe shoqërore që shfaqin nxënësit;
- përkushtimin dhe këmbënguljen e nxënësve në kryerjen e detyrave të ndryshme;
- nivelin e ndërgjegjësimit të nxënësve për vështirësitë që mund të kenë të tjerët dhe gatishmërinë për t'i ndihmuar ata;
- pyetjet që shtrojnë nxënësit, përgjigjet dhe sugjerimet që nxënësit u japin pyetjeve të mësuesit dhe nxënësve të tjerë;
- sjellje të caktuara, si: aftësitë drejtuese, niveli i vetëbesimit, të shprehurit në mënyrë të drejtpërdrejtë e të hapur, gatishmëria për të përballuar rreziqe, sfida e vështirësi;
- pjekurinë fizike dhe emocionale;
- aftësinë për të vetë-vlerësuar ecurinë në shkollë.

Mësuesi mund t'i mbajë shënim vëzhgimet për secilin nxënë, në mënyrë që të mund të krijojë një pamje të përgjithshme të ecurisë së zhvillimit të tyre. Kjo i shërben mësuesit edhe për t'ia komunikuar ecurinë e nxënësve prindërve të tyre ose në raste kur nxënësi ndryshon shkollë, ky lloj vlerësimi mund të ndahet me mësuesin e ri ose me mësuesit pasues të ciklit në vijim.

Vëzhgimi ndihmon vetë mësuesin i cili, pasi ka kuptuar nevojat e veçanta të secilit nxënë, duhet të rishikojë metodologjitë e mësimdhënies, në mënyrë që ato të lehtësojnë të nxënit e gjithsecilit.

b. Detyrat dhe testet

Me anë të detyrave të ndryshme që mësuesi u jep nxënësve në klasë, ai arrin të vlerësojë si procesin e punës, ashtu edhe nivelin e të kuptuarit të njohurive të reja nga ana e nxënësve. Me anë të detyrave, mësuesi mund të vlerësojë edhe aftësinë e nxënësve për t'i përdorur dijet e marra në situata nga më të ndryshmet. Detyrat në klasë mund të jenë projekte në grup ose punë individuale.

Një shembull i detyrës në klasë mund të jetë dhënia e një situatë, e cila kërkon zgjidhje, ku nxënësit duhet të marrin një vendim së bashku dhe ta mbrojnë atë. Gjatë punës në grup të nxënësve, mësuesi vlerëson demonstrimin e kompetencave dhe aftësinë e gjithsecilit për të punuar në grup.

Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin e komunikimit me shkrim dhe mund të realizohet jo vetëm me laps e letër, por edhe në rrugë elektronike. Mësuesi planifikon testime periodike me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimore, që përbëhen nga një ose disa tematika, të cilët i bashkojnë rezultate të ndërlidhura të të nxënësve. Në përshtatje me qëllimin e vlerësimit me shkrim, ai përdor lloje të ndryshme testesh, që nga minitestet pak minutëshe për një objektiv të veçantë të të nxënësve, tek ato një orësh; teste me alternativa ose me zhvillim; detyra tematike, projekte kurrikulare etj. Një formë e parashtrimit me shkrim nga nxënësit është edhe testimi përfundimtar.

Mësuesi mund t'i përdorë testet me shkrim në fund të një tematike si një teknikë vlerësimi dhe vetëvlerësimi nga ana e nxënësve, pra t'i lejojë ata t'i korrigjojnë vetë testet për të reflektuar e për t'u ndërgjegjësuar mbi aftësitë e tyre dhe vështirësitë që ata hasin.

c. Projektet

Projektet i ndihmojnë nxënësit të përqendrohen në një temë të caktuar të programit, për shembull në njohjen e komunitetit ku ata jetojnë dhe studimin e tij në detaje. Me anë të projektit, mësuesi vlerëson aftësinë e nxënësve për të kërkuar informacion, për të mbledhur, për ta përpunuar dhe për ta prezantuar atë. Puna me projekte mundëson edhe vlerësimin e bashkëpunimit të nxënësve me njëri-tjetrin gjatë punës grup. Realizimi i një projekti është tregues edhe i përgjegjësisë vetjake dhe të grupit si dhe i përkushtimit dhe interesit të secilit nxënës.

d. Paraqitja dhe prezantimi i punimeve

Shpjegimi, paraqitja dhe prezantimi i punimeve të ndryshme që nxënësit realizojnë gjatë lëndës së historisë është për mësuesin tregues i aftësive të tyre për të mbledhur informacion, për ta përpunuar dhe për ta paraqitur atë. Gjatë paraqitjes dhe prezantimit të punimeve, nxënësit vlerësohen edhe për shtjellimin e këndvështrimeve të tyre, mbrojtjen e këtyre këndvështrimeve dhe mbajtjen e qëndrimit vetjak ose në grup ndaj një çështjeje të caktuar. Me anë të kësaj teknike vlerësohen kompetencat historike dhe kompetencat kyçe si ajo e komunikimit dhe e të menduarit. Në punimet e nxënësve me grupe të vogla, mësuesi/ja parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënës në veçanti. Mësuesi nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimore dhe të vendosë nota në regjistër për secilën orë mësimore. Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë lirshëm, si partnerë, rreth

përvetësimin të njohurive të fituara në orët e kaluara dhe kryerjes sa më mirë të detyrave jashtë klase. Herë pas here mësuesi duhet të vlerësojë me notë, duke ua bërë të qartë nxënësve që në fillim qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

Pavarësisht zgjedhjes nga ana e mësuesit të teknikave të vlerësimit, qofshin këto formale ose joformale, vlerësimi duhet domosdoshmërisht të synojë përmirësimin e përvojave të nxënësve. Vlerësimi i nxënësit përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënësit nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Nxënësi vlerësohet me notë, ndërsa demonstron arritjet e tij me gojë, me shkrim ose nëpërmjet veprimtarive dhe produkteve të tjera, si: veprimtari praktike, raste studimore, shkrimi i një eseje, prodhimi i një CD-je, hartimi i një maketi për një ngjarje ose figurë të caktuar historike, projekte etj.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në njohuritë/aftësitë/qëndrimet e programit lëndor dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato njohuri, aftësi dhe qëndrime që nuk përshkruhen në program.

ANEKS 1

Me qëllim që t'u vijë në ndihmë autorëve të teksteve të historisë dhe mësuesve të historisë në realizimin me sukses të këtij programi, në përvetësimin e dijeve dhe demonstrimin e kompetencave të lëndës dhe kompetencave kyçe për të nxënësit gjatë gjithë jetës, paraqiten në këtë aneks, Rekomandimet Rek (2001)15 e Komitetit të Ministrave të Shteteve anëtare lidhur me mësimin e historisë në Evropën e shekullit të XXI.

Recommendation Rec(2001)15 of the Committee of Ministers to member states on history teaching in twenty-first-century Europe

KËSHILLI I EVROPËS

KOMITETI I MINISTRAVE

Rekomandimet Rek (2001)15 e Komitetit të Ministrave të Shteteve anëtare lidhur me mësimin e historisë në Evropë në shekullin XXI

(miratuar nga Komiteti i Ministrave, më 31 tetor 2001, në mbledhjen 771 të të Deleguarve të Ministrave)

Komiteti i Ministrave, në bazë të nenit 15.b. të Statutit të Këshillit të Evropës,

- duke pasur parasysh se qëllimi i Këshillit të Evropës është të realizojë një bashkim përherë e më të ngushtë midis anëtarëve të tij;
- duke vlerësuar Konventën kulturore evropiane nënshkruar në Paris, më 19 dhjetor 1954, që u bën thirrje shteteve të saj nënshkruese të nxisin studimin e historisë dhe të qytetërimit të palëve të tjera kontraktuese dhe ta zhvillojë atë në territorin e këtyre palëve kontraktuese ;
- duke rikujtuar Samitet e Vjenës (1993) dhe të Strasburgut (1997), gjatë të cilave kryetarët e shteteve e të qeverive të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës :

- ✓ shprehën dëshirën ta shohin Këshillin e Evropës plotësisht në gjendje të ndihmojë për të përballur sfidat e shoqërisë së shekullit XXI ;
- ✓ shprehën nevojën për të përforcuar mirëkuptimin e ndërsjellë dhe besimin midis popujve, në mënyrë të veçantë nëpërmjet një programi për mësimin e historisë, duke synuar heqjen e paragjytimeve dhe vlerësimin e ndikimeve pozitive të ndërsjella midis vendeve, feve e ideve të ndryshme, gjatë zhvillimit historik të Evropës;
- duke theksuar se falsifikimet dhe manipulimet ideologjike të historisë janë të papajtueshme me parimet themelore të Këshillit të Evropës përcaktuar nga Statuti i tij ;
- duke vlerësuar rekomandimet e Asamblesë parlamentare lidhur me përmasën evropiane të edukimit (Rekomandimi 1111 (1989)), përsa i përket historisë dhe mësimin të historisë në Evropë (Rekomandimi 1283 (1996)) ;
- duke rikujtuar Rezolutën n° 1 miratuar gjatë sesionit të 19-të të konferencës së përhershme të ministrave evropianë të edukimit lidhur me temën « Prirje dhe përputhshmëri për edukimin në Evropë » (Kristiansand, Norvegji, 1997), si dhe konkluzionet e rezolutat e sesionit 20-të të Konferencës së përhershme të ministrave evropianë të Edukimit lidhur me projektin « Të mësojmë e të shpjegojmë historinë e Evropës së shekullit XX » (Krakovi, Poloni, 2000) ;
- duke rikujtuar deklaratën e miratuar gjatë Konferencës informale të ministrave të Edukimit të Evropës Jug-Lindore, (Strasburg, 1999) me anë të së cilës u rekomandua të ndërmerren aksione pragmatike në fushat për të cilat Këshilli i Evropës ka një përvojë të gjatë e të njohur, konkretisht ndër të tjera mësimin e historisë ;
- duke marrë në konsideratë deklaratën e miratuar gjatë Konferencës rajonale të ministrave të Edukimit të shteteve të Kaukazit (Tbilisi, Gjeorgji, 2000) ;
- nisur nga Rekomandimi n° R (98) 5 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve anëtare lidhur me pedagogjinë trashëgimore, në të cilin Ministrat pohojnë se aksionet pedagogjike mbi trashëgiminë janë mjet i privilegjuar për t'i dhënë kuptim së ardhmes nëpërmjet një vështrimi më të mirë të së shkuarës ;
- duke u mbështetur në Rezolutën (98) 4 të Komitetit të Ministrave për itineraret kulturore të Këshillit të Evropës ;

- duke pasur parasysh Rekomandimin n° R (2000)1 të Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve anëtare mbi nxitjen e bashkëpunimit ndërkufitar midis kolektiviteve apo autoriteteve territoriale në fushën kulturore, në të cilin ministrat theksojnë se veprimtaritë ndërkufitare u vijnë të rinjve në ndihmë për të krijuar një përfytyrim të ndërkufishëm, duke i bërë ata të ndjeshëm ndaj larmisë së traditave kulturore e historike ;
- nisur nga rezolutat e Konferencës së 5^{-të} evropiane të ministrave përkatës të trashëgimisë kulturore (Portorož, Slloveni, 2001), në të cilat ministrat theksuan edhe një herë se mësimi i historisë duhet të mbështetet mbi kuptimin dhe shpjegimin e trashëgimisë, dhe të nxjerrë në pah karakterin ndërnacional të trashëgimisë ;
- duke pasur parasysh Rekomandimin n° R (2000) 13 të Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve anëtare për një politikë evropiane në fushën e komunikimit të arkivave, në të cilin ministrat, pasi vërejnë interesin në rritje të publikut për historinë dhe pasi theksojnë se një njohje më e mirë e historisë evropiane të vonshme mund të ndihmojë në parandalimin e konflikteve, bëjnë thirrje për një politikë evropiane në fushën e komunikimit të arkivave, mbështetur mbi parime që janë në përputhje me vlerat demokratike ;
- duke pasur në konsideratë Rekomandimin n° R (97) 20 të Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare lidhur me « gjuhën e urrejtjes », në të cilin gjuha e urrejtjes përkufizohet si përcaktuese e të gjitha formave shprehëse që përhapin, nxitin, shtyjnë a përlligjin urrejtjen racore, ksenofobinë apo antisemitizmin, dhe në të cilin ministrat vërejnë se gjuha e urrejtjes mund të ketë një efekt më të dëmshëm kur përhapet nëpërmjet mediave ;
- duke mos harruar punimet e mëparshme të Këshillit të Evropës në fushën e mësimin të historisë që mbështeten mbi idenë e ri pajtimit e të ndikimeve të ndërsjella pozitive midis popujve si punimet e kryera në periudhën e pasluftës, të cilat e vunë theksin në heqjen nga tekstet e historisë të njëanshmërive e paragjykimeve, punimet e njëpasnjëshme të projektit « Historia në Evropën e re », dhe programin « Mësimi i historisë dhe nisma e re e Sekretarit të Përgjithshëm », program që ndihmoi republikat e ish-Bashkimit sovjetik në përpunimin e metodologjive për modernizimin e mësimin të historisë, në nxjerrjen e teksteve të reja dhe rrjedhimisht ri përshtatjen e formimit të mësuesve ;

- duke u njohur me përfundimet e projektit « Të mësojmë e të shpjegojmë historinë e Evropës së shekullit XX » dhe me tërësinë e materialit pedagogjik në përdorim të mësuesve, që u paraqitën gjatë Konferencës përfundimtare të projektit « Vështrime të kryqëzuara mbi shekullin XX », mbajtur simbolikisht në Shtëpinë e Historisë së Republikës federale të Gjermanisë (Haus der Geschichte, Bon, Gjermani, 2001) ;
- duke vërejtur se projekti « Të mësojmë e të shpjegojmë historinë e Evropës së shekullit XX » lejoi ndër të tjera :
 - ✓ të bëhen përparime të ndjeshme në përpunimin e një koncepti pluralist e tolerant të mësimi të historisë, konkretisht nëpërmjet zhvillimit të aftësive kërkimore individuale dhe analizës ;
 - ✓ të vihen në dukje novacionet pedagogjike mbështetur si në teknologjitë e informacionit, ashtu edhe në burimet e reja didaktike;
 - ✓ të përpunohen shembuj trajtesash të hapura për çështjet e brishta të historisë së Evropës së shekullit XX,

U rekomandon qeverive të shteteve anëtare, brenda strukturave të tyre kushtetuese, rrethanave kombëtare a vendore dhe sistemit të tyre edukativ :

- të frymëzohen nga parimet që parashtrohen në shtojcën e këtij rekomandimi, në kuadrin e reformave të mësimi të historisë së sotme a të ardhme dhe të reformave lidhur me formimin e mësuesve të historisë;
- të bëjnë të mundur që, sipas procedurave të përshtatshme kombëtare, rajonale dhe lokale, organizmat e duhura publike e private të vendit të tyre të vihen në dijeni të parimeve që theksohen në këtë rekomandim nëpërmjet dokumenteve referues që përbëjnë bazën e tyre, veçanërisht tërësia e materialeve pedagogjike të përpunuara nga projekti « Të mësojmë e të arsimojmë historinë e Evropës së shekullit XX »;
- të zhvillojnë, sipas modaliteteve që duhen përcaktuar, veprimtari në fushën e mësimi të historisë, me qëllim që të forcohen marrëdhëniet e besimit e të tolerancës në gjirin e vetë shteteve dhe ndërmjet tyre, dhe t'u bëhet ballë sfidave të shekullit XXI;
- të përdorin gjithashtu, në mënyrë të integruar, projekte të tjera të Këshillit të Evropës, në mënyrë të veçantë atë të « Edukimit me qytetari demokratike » dhe punimet e realizuara në fushën e trashëgimisë kulturore ;

I kërkon Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës t'ua bëj të ditur këtë rekomandim Shteteve palë të Konventës kulturore evropiane që nuk janë anëtare të Këshillit të Evropës.

Shtojcë për Rekomandimin Rek (2001)15

1. Objektivat e mësimit të historisë në shekullin XXI

Mësimi i historisë në një Evropë demokratike:

- duhet të zërë një vend themelor për formimin e individit si qytetar përgjegjës e aktiv për zhvillimin e respektit për tërë llojet e dallimeve, respekt i mbështetur mbi mirëkuptimin e identitetit kombëtar dhe të parimeve të tolerancës;
- duhet të jetë një faktor vendimtar pajtimi, mirënjohjeje, mirëkuptimi e besimi të ndërsjellë midis popujve;
- duhet të luajë rol kryesor në zhvillimin e vlerave të tilla themelore si toleranca, mirëkuptimi reciprok, të drejtat e njeriut dhe demokracia;
- duhet të përbëjë një nga elementët thelbësorë në ndërtimin e Evropës së bashkuar duke u bazuar në trashëgiminë historike e kulturore të përbashkët, pasuruar me larminë që e karakterizon, qoftë edhe në aspektet e veta konfliktuale dhe shpesh dramatike;
- duhet të jetë pjesë e një politike arsimore e cila luan një rol të drejtpërdrejtë në përparimin dhe zhvillimin e të rinjve, në perspektivën e ndërtimit, së bashku me ta, të një Evrope të së nesërme, si dhe me zhvillimin paqësor të shoqërive njerëzore në një perspektivë globale, brenda frymës së mirëkuptimit dhe besimit të ndërsjellë;
- duhet të lejojë të zhvillohet tek të rinjtë aftësia intelektuale për të analizuar e interpretuar informacionin në mënyrë kritike dhe me përgjegjshmëri, nëpërmjet dialogut, nëpërmjet kërkimit të dëshmive historike dhe nëpërmjet debatit të hapur e të bazuar në perspektivë të shumëfishta, sidomos për çështje të ndjeshme e të diskutueshme historike;
- duhet t'i lejojë qytetarit evropian të nxjerrë në pah identitetin e vet individual e kolektiv, nëpërmjet trashëgimisë së përbashkët historike në dimensionet e saj lokale, rajonale, kombëtare, evropiane dhe globale;
- duhet të jetë një instrument për parandalimin e krimeve kundër njerëzimit.

2. Shtrembërimet e historisë

Mësimi i historisë nuk mund të jetë mjet manipulimi ideologjik, propagande apo nxitjeje të vlerave ultra nacionalistë, ksenofobe, raciste apo antisemitiste e jo tolerantë.

Kërkimet historike dhe vetë historia që mësohet në shkollë, në asnjë rast, dhe me çfarëdo qëllimi qoftë, nuk mund të pajtohen me vlerat themelore dhe Statutin e Këshillit të Evropës po qe se ato lejojnë a popullarizojnë paraqitje të gabuara të historisë, nëpërmjet njërit a tjetrit prej mashtrimeve të mëposhtme :

- falsifikimit të fakteve historike, statistikave të rreme, pamjeve të trukuara, etj.;
- ngulimit mbi një ngjarje të caktuar për të përlligjur a fashitur një ngjarje tjetër;
- shtrembërimit të së shkuarës për qëllime propagande;
- interpretimit të tepruar nacionalist të së shkuarës, që mund të krijojë "ne" dhe "ata", ndarje në dy pjesë;
- shtrembërimeve burimore historike;
- mohimit të fakteve historike;
- mosveprimi me fakte të vërteta historike.

3. Dimensioni evropiane në mësimin e historisë

Duke qenë se ndërtimi evropian është, sa shprehje e një vendimi të hyrë lirshëm nga vetë evropianët, po aq sa dhe një realitet historik, do të ishte e përshtatshme në këtë rast :

- të nxirren në pah marrëdhëniet historike të vijueshme midis rrafshve lokale, rajonale, kombëtare e evropiane;
- të mbështetet mësimi i çasteve apo fakteve të historisë, përmasa evropiane e të cilave është e dukshme – në mënyrë të veçantë ngjarjet dhe rrymat historike e kulturore themeluese të ndërgjegjes evropiane;
- të zhvillohen me të gjitha mjetet e mundshme, veçanërisht nëpërmjet teknologjive të informacionit, projektet e bashkëpunimit e të këmbimit midis shkollave mbi tema që kanë të bëjnë me historinë e Evropës;
- të rritet interesi i nxënësve për historinë e vendeve të tjera evropiane;

- të prezantohen dhe zhvillohen mësimdhënie në lidhje me historinë e ndërtimit të vetë Evropës.

Për të zhvilluar përmasën evropiane gjatë mëimit të historisë në një Evropë të zgjeruar, demokratike e paqësore, lypset :

- të mbahen parasysh rezultatet e punimeve të kryera në kuadrin e projektit “Të mësojmë e të arsimojmë historinë e Evropës së shekullit XX” të Këshillit të bashkëpunimit kulturor, si në përmbajtjen e tyre, ashtu edhe në trajtimin metodologjik;
- të ndërmerren, mbi bazën e programeve të Këshillit të Evropës, nisma lidhur me reformën e mëimit të historisë dhe përpunimin e teksteve të reja, si dhe të udhëzuesve metodologjikë, në kuadrin e veprimtarive për zhvillimin dhe forcimin e stabilitetit demokratik;
- të ndërmerren, mbi bazën e programeve të Këshillit të Evropës, nisma lidhur me sensibilizimin dhe pedagogjinë e trashëgimisë;
- të veprohet për shpërndarjen sa më të gjerë të materialit pedagogjik krijuar në kuadrin e projektit “Të mësojmë e të shpjegojmë historinë e Evropës së shekullit XX”, duke përdorur teknologjitë e duhura të informacionit dhe komunikimit;
- të fuqizohet ndihma për përgatitjen e programeve të reja shkollore dhe të normave për mësimdhënien e historisë, duke përfshirë përpunimin e teksteve të reja shkollore, konkretisht në Federatën e Ruisë, në vendet e Kaukazit, të Evropës Jug-Lindore dhe të rajonit të Detit të Zi;
- të përfitohet nga programi i Këshillit të Evropës për formimin e vazhdueshëm të personelit edukativ, me qëllim që të fitohen njohuri të reja në një kontekst evropian, gjatë të cilit mësuesit të mund të ballafaqojnë pikëpamjet dhe përvojat e tyre.

4. Përmbajtja e programeve

Mësimdhënia e historisë, ndërkohë që duhet të shmangë akumulimin e njohurive enciklopedike, duhet të përfshijë:

- sensibilizimin lidhur me përmasën evropiane, të mbajtur parasysh që gjatë përpunimit të programeve dhe kjo, me qëllim që nxënësit të fitojnë një “ndërgjegje evropiane” të hapur mbi botën;
- zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, të një gjykimi të pavarur e objektiv, dhe kundërvënien ndaj manipulimeve;
- ngjarjet dhe çastet e shënuara të historisë së Evropës, studiuar në rrafshet vendore, kombëtare, evropiane e botërore nëpërmjet periudhave dhe fakteve veçanërisht domethënëse;

- studimin e të gjitha dimensioneve të historisë së Evropës, jo vetëm politike, por edhe ekonomike, shoqërore e kulturore;
- zhvillimin e frymës kërkimore dhe të kërkërisë, konkretisht duke përdorur pedagogjinë e njohjes, në kuadrin e studimit të trashëgimisë, që lejon në këtë mënyrë të nxirren në pah ndikimet ndërkulturore;
- zhdukjen e paragjytimeve dhe stereotipive, duke theksuar në programe ndikimet e ndërsjella pozitive midis vendeve të ndryshme, feve dhe shkollave doktrinoe në zhvillimin historik të Evropës;
- studimin kritik të shtrembërimeve të historisë, qoftë nëpërmjet mohimit të një fakti të dukshëm historik, qoftë nëpërmjet falsifikimit, shmangies, mosnjohjes, apo përdorimit ideologjik;
- studimin e çështjeve të diskutueshme, nëpërmjet mbajtjes parasysht të fakteve, të mendimeve e të pikëpamjeve të ndryshme, si dhe kërkimit të së vërtetës.

5. Metodatat e mësimimit

Përdorimi i burimeve

Do jetë me vend të përdoren burimet didaktike më të larmishme për njohjen e fakteve historike dhe mësimin e tyre kritik e analitik e, në mënyrë të veçantë:

- arkivat, të hapura për publikun, veçanërisht në vendet e Evropës qendrore e lindore, duke lejuar në këtë mënyrë të shfrytëzohen tashmë dokumente origjinale, kur asnjëherë më parë nuk ka ndodhur një gjë e tillë;
- kinemaja dhe prodhimtaria audiovizuale, qoftë dokumentare, qoftë fantastike;
- teknologjitë e informacionit, që duhet të përbëjnë objektin e një trajtimi kritik, individual e kolektiv, për të cilin mësuesi luan një rol themelor;
- llojet e ndryshme të muzeve të shekullit XX, ngritur gjithandej nëpër Evropë, dhe vendet përkujtimore, që ndikojnë në përkapjen në mënyrë të qartë nga ana e nxënësve të ngjarjeve të fundit, konkretisht në përmasën e tyre të përditshme;
- historia gojore, me anë të së cilës dëshmitë gojore për ngjarjet e fundit historike mund ta bëjnë historinë më të gjallë në sytë e të rinjve, si dhe mund t'u lënë vend pikëpamjeve e perspektivave të atyre që nuk kanë marrë pjesë në « historinë e shkruar ».

Kërkimi individual

Nxënësit duhet të nxiten për të ndërmarrë, sipas nivelit që kanë dhe rrethanave, kërkime individuale, me qëllim që të stimulohen kërshtëria dhe fryma e tyre vetëvepruese në vjeljen e të dhënave si dhe mendimi i tyre sintetizues.

Kërkimi kolektiv

Në rrafshin grupor të nxënësve, të klasës apo shkollës, zhvillimi i projekteve kërkimore a arsimore aktive duhet të nxitet më tej, me qëllim që të krijohen kushtet e dialogut dhe ballafaqimit të hapur e tolerant të mendimeve.

Trajtimi ndërdisiplinor dhe shumëdisiplinor

Mësimi i historisë duhet të përdorë në çdo rast potencialin edukativ të një trajtimi ndërdisiplinor e shumëdisiplinor, duke vendosur lidhje me disiplinat e tjera që përbëjnë tërësinë e programit shkollor, konkretisht me letërsinë, gjeografinë, shkencat shoqërore, filozofinë, artet, përfshirë edhe disiplinat shkencore.

Trajtimi ndërkombëtar dhe ndërkufitar

Sipas rrethanave, lypset të përkrahët zbatimi i projekteve ndërkombëtare dhe ndërkufitare, mbështetur mbi studimin e një teme të përbashkët si dhe trajtimet krahasuese apo kryerja e një detyre të përbashkët në shumë shkolla të vendeve të ndryshme, duke përfituar konkretisht nga mundësitë e reja që japin teknologjitë e informacionit dhe vendosja e lidhjeve dhe këmbimeve shkollore.

6. Mësimi dhe ruajtja në kujtesë

Krahas nxjerrjes në pah të arritjeve pozitive që kanë karakterizuar shekullin XX, si përdorimi paqësor i shkencave për një art më të mirë të jetuari dhe zhvillimi i demokracisë e të drejtave të njeriut, është e nevojshme të merren të gjitha masat edukative për të parandaluar përsëritjen apo mohimin e ngjarjeve shkatërrimtare që kanë ndodhur gjatë këtij shekulli, domethënë Holokaustin, gjenocidin dhe krimet e tjera kundër njerëzimit, spastrimet etnike, dhunimet masive të të drejtave të njeriut dhe të vlerave themelore me të cilat është lidhur në mënyrë të veçantë Këshilli i Evropës. Për këtë qëllim:

- duhet të ndihmohen nxënësit për t'u njohur e ndërgjegjësuar me faktet dhe me shkaqet e tyre që kanë karakterizuar në mënyrën më të errët historinë e Evropës në veçanti dhe atë të botës në përgjithësi;

- duhet të reflektohet mbi ideologjitë që kanë çuar në to dhe mbi mjetet që bëjnë të mundur të shmangët përsëritja e fakteve të tilla ;
- duhet të orientohen, zhvillohen e bashkërendohen programet e formimit të vazhdueshëm të personelit edukativ në shtetet anëtare të Këshillit të bashkëpunimit kulturor;
- duhet të lehtësohet futja në dokumentacionin që zotërohet për këtë temë, duke përdorur konkretisht burimet e teknologjive të reja dhe të zhvillohet një rrjet qendrash burimore pedagogjike në këtë fushë;
- duhet të sigurohet zbatimi, ndjekja dhe kontrolli i vendimit të ministrave të Edukimit (Krakovi2000) lidhur me caktimin në shkolla të një dite përkujtimore të Holokaustit dhe për parandalimin e krimeve kundër njerëzimit, në përshtatje me historinë e secilit vend anëtar;
- duhet të pasurohet ndihma e veçantë e Këshillit të Evropës në fushën arsimore brenda Task Forces për bashkëpunimin ndërkombëtar lidhur me mësimin e Holokaustit, përkujtimin dhe kërkimin.

7. Formimi paraprak e i vijueshëm i mësuesve të historisë

Formimi i veçantë dhe i vijueshëm i mësuesve të historisë:

- duhet të formojë e të nxisë mësuesit e historisë për të përdorur metoda komplekse për orën e historisë, duke u thelluar në reflektimin dhe duke u mbështetur në kërkimin;
- duhet të synojë që mësuesit e historisë dhe ata që tashmë janë përfshirë në jetën aktive të njohin tërë produktet, mjetet dhe metodat e fundit, veçanërisht përdorimin e teknologjive të informacionit e komunikimit;
- duhet t'i bëjë mësuesit të ndjeshëm për të zbatuar praktika pedagogjike të cilat, mbi bazën e të dhënave faktike dhe përtej tyre, synojnë që nxënësit të arrijnë të interpretojnë e analizojnë faktet historike dhe ndikimin e tyre mbi të tashmen, në kontekste të ndryshme shoqërore, gjeografike, ekonomike, etj.;

- duhet t'i ndihmojë mësuesit të zbatojnë praktika vlerësuese, të cilat mbajnë parasysh jo vetëm të dhënat që memorizojnë nxënësit, por edhe veprimtaritë që ata janë në gjendje të ndërmarrin, mbi bazën e njohjes të të dhënave në fjalë, si kërkimet, debatet apo analizat e çështjeve për diskutim;
- duhet t'i ndihmojë të konceptojnë e të realizojnë në klasa situata mësimi të një natyre ndërdisiplinore, në bashkëpunim me kolegët e tyre.

Duke qenë se teknologjitë e informacionit dhe komunikimit çojnë në shndërrimin e rolit të mësuesve të historisë, është e rëndësishme:

- të krijohen pika këmbimi, me qëllim që mësuesit të njihen me gamën e gjerë të situatave mësimore në të cilat integrohen rolet e reja në fjalë;
- të mbështetet krijimi i grupeve për kapërcimin e vështirësive, ngurrimeve dhe dyshimeve profesionale lidhur me këto praktika të reja pedagogjike;
- të zhvillohen bankat burimore, që paraqesin jo vetëm dokumentet dhe rrjetet e zotërueshme, por edhe vlerën e informacioneve të ardhura nga këto burime dhe dokumente.

Me qëllim që të arrihen këto objektiva dhe të përcaktohet profili i veçantë i mësimi të historisë, lypset:

- t'u jepet institucioneve për formimin e mësuesve të historisë mbështetja e nevojshme për të ruajtur e përmirësuar cilësinë e formimit të tyre, dhe për të zhvilluar profesionalizmin, e në mënyrë të veçantë statusin shoqëror të mësuesve të historisë;
- t'i kushtohet vëmendje e posaçme formimit të mësuesve të historisë sipas parimeve që përmban ky rekomandim;
- të nxiten kërkimet krahasuese lidhur me këto objektiva, struktura e norma të formimit të veçantë, paraprak e të vijueshëm të mësuesve të historisë dhe mbi bazën e kësaj, të gjallërohet bashkëpunimi institucional dhe këmbimi i informacioneve sipas nevojave të domosdoshme për reformat e formimit paraprak e të vijueshëm të mësuesve të historisë;
- të krijohen e fuqizohen partneritetet në tërësinë e institucioneve aktive në fushën e formimit të mësuesve të historisë apo që kanë të bëjnë me këtë formim (veçanërisht mediat), me qëllim që të nxirret në pah misioni dhe përgjegjësia e tyre e veçantë.

8. Teknologjitë e informacionit e të komunikimit

Duke respektuar normat ligjore dhe lirinë e shprehjes, lypset të merren masat e nevojshme për luftën kundër përhapjes së përmbajtjeve raciste, ksenofobe apo revizioniste, në mënyrë të veçantë nëpërmjet sistemit Internet.

Në kontekstin e përdorimit shumë të zgjeruar të teknologjive të informacionit dhe komunikimit nga ana e të rinjve, si gjatë jetës së tyre shkollore ashtu edhe jashtëshkollore, ka rëndësi të zhvillohet një pedagogji dhe metodologji që mban parasysh faktin që këto teknologji :

- përbëjnë burimet e pashmangshme në mësimin e historisë;
- shtrojnë çështje themelore, konkretisht atë të besueshmërisë së burimeve;
- u lejojnë mësuesve dhe nxënësve të depërtojnë në burime origjinale dhe interpretime të shumëllojta;
- zgjerojnë më së miri mundësinë për t'u futur në informacione dhe të dhëna historike;
- shumëfishojnë dhe lehtësojnë rastet e bashkëpunimit e të dialogut

Nga ana tjetër, do duhet gjithashtu të krijohen kushtet e nevojshme që mësuesit:

- të mund t'u vijnë në ndihmë vetë nxënësve, gjatë procesit selektiv, për të vlerësuar besueshmërinë e burimeve të informacionit dhe vetë informacionet si të tilla;
- të mund të bëjnë gjatë orës së mësimin përçarje për analizë kritike, duke u mbështetur në larmi pikëpamjesh dhe interpretimesh ndërkulturore;
- të mund të nxisin nxënësit për të zhvilluar kompetencat e tyre, si analizat kritike dhe arsyetimin nëpërmjet analogjisë.

ⁱ Recommendation Rec(2001)15 of the Committee of Ministers to member states on history teaching in twenty-first-century Europe; Recommendation CM/Rec (2011)6 of the Committee of Ministers to member states on intercultural dialogue and the image of the other in history teaching



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA E SIGURIMIT SË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

PROGRAMET E KULTURËS SË PËRGJITHSHME
TË ARSIMIT TË MESËM PROFESIONAL

Lënda: Histori

Klasa: XII

Struktura 2+1+1, Struktura 2+2 dhe Bllok 4-vjeçar

TIRANË, 2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

**PROGRAMET E KULTURËS SË PËRGJITHSHME
TË ARSIMIT TË MESËM PROFESIONAL**

Lënda: Histori

Klasa: XII

Struktura 2+1+1, Struktura 2+2 dhe Bllok 4-vjeçar

2024

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT TË HISTORISË

1. HYRJE

2. KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT

2.1. Qëllimi i programit të historisë

2.2. Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës

2.3. Lidhja e lëndës së historisë me temat ndërkurrikulare

2.4. Lidhja e lëndës së historisë me fushat/lëndët e tjera kurrikulare

2.5. Kompetencat dhe konceptet historike

2.6. Cilësitë historike të nxënësit

3. KLASA 12

3.1. Përmbajtja e kurrikulës

3.2. Rezultatet e të nxënit për kompetencat dhe konceptet historike

3.3. Koha mësimore

3.4. Klasa e dymbëdhjetë, aftësi/shkathtësi, qëndrime, koncepte dhe veprimtari të sugjeruara

4. UDHËZIME METODOLOGJIKE

4.1. Materiale dhe burime mësimore

5. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

Aneks 1. Rekomandimet Rek (2001)15 e Komitetit të Ministrave të Shteteve anëtare lidhur me mësimin e historisë në Evropë në shekullin XXI.

TABELA, DIAGRAMA DHE FIGURA

Diagrami 1.	Korniza konceptuale e programit
Diagrami 2.	Rezultatet kryesore të të nxënit sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së historisë
Diagrami 3.	Lidhja ndërmjet lëndës së historisë dhe fushave/lëndëve të tjera
Diagrami 4.	Kompetencat dhe konceptet e lëndës së historisë
Diagrami 5.	Cilësitë historike të nxënësit
Tabela 1.	Kompetencat e lëndës dhe përshkrimi i tyre
Tabela 2.	Konceptet e lëndës dhe përshkrimi
Tabela 3.	Rezultatet e të nxënit për kompetencat dhe konceptet historike
Tabela 4.	Koha mësimore
Tabela 5.	Përforcimi i qasjes kërkimore
Figura 1.	Procesi i kërkimit historik

Koordinoi programin:
Ines Todhe

1. HYRJE

Lënda e historisë është thelbësore në zhvillimin e qytetarëve, të cilët i kuptojnë çështjet aktuale me zgjuarsi, nëpërmjet kuptimit, analizës dhe përfundimeve të nxjerra nga përvojat e së shkuarës.

Studimi i lëndës së historisë i ndihmon nxënësit të zhvillojnë një ndjenjë humanizmi të gjerë, të kuptojnë zhvillimin e personalitetit të tyre, mënyrën si ata ngjasojnë dhe diferencohen nga të tjerët në raport me kohën dhe me hapësirën, të dallojnë diferencën midis supozimit dhe faktit, të mos besojnë në përgjigjen e paargumentuar dhe të respektojnë vërtetësinë e burimeve historike, duke dalluar analogjinë false, të njohin abuzimet nga “mësimet” historike, të peshojnë pasojat që vijnë prej tyre, si dhe të marrin parasysh se padija për të shkuarën na bën “të burgosurit” e saj.

Ndryshimi është aspekti thelbësor i historisë dhe për këtë arsye është dhe një ndër konceptet bazë të studimit në programin e historisë. Ndërsa lëndë të tjera të fushës “Shoqëria dhe Mjedisi” studiojnë aspekte të ndryshme të jetës së njerëzimit, si: institucionet, traditat kulturore, ekonominë, ligjet etj., lënda e historisë kryesisht, synon të merret me shpjegimin e mënyrës se si të gjitha këto aspekte janë zhvilluar dhe kanë ndryshuar gjatë historisë së tyre. Në këtë mënyrë, nxënësit do të mësojnë rëndësinë që ka ndryshimi për të gjitha përvojat njerëzore, për kompleksitetin dhe mënyrat e ndryshme në të cilat bashkëveprojnë të gjitha këto përvoja.

Detyra e programit të historisë është të drejtojë nxënësit për t’u bërë pjesëtarë të përgjegjshëm të shoqërisë, të cilët dinë se si të trajtojnë në mënyrë kritike një fenomen të epokës së tyre dhe të së shkuarës. Nëpërmjet programit të historisë, nxënësit kuptojnë se kultura e tyre dhe kulturat e tjera përbëjnë rezultatin e një procesi historik.

Programi i historisë i ndihmon nxënësit që të bëhen të ditur, të logjikshëm, kureshtarë, të balancuar, të ndjeshëm dhe individë të aftë për të dhënë argumente dhe vendime të arsyetuara mirë.

Këto cilësi mbështesin nxënësit në zhvillimin e qëllimeve, kompetencave kyçe dhe rezultateve të dëshiruara të arsimit parauniversitar, në mënyrë që ata të jenë individë të përgatitur, të aftë për të kontribuar ndaj kombit dhe të aftë për t’iu përgjigjur zhvillimeve globale.

2. KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT

Hartimi i programit për lëndën e historisë në arsimin profesional rrjedh nga Korniza Kurrikulare e arsimit parauniversitar, kurrikulat bërthamë, plani mësimor dhe Rekomandimet Rek (2001)15 të Komitetit të Ministrave të Shteteve anëtare lidhur me mësimin e historisë në Evropë në shekullin XXIⁱ.


Si i tillë ky dokument i shërben:

- **Nxënësit** për zhvillimin e kompetencave kyçe të të nxënit gjatë gjithë jetës dhe të kompetencave të lëndës së historisë, në mënyrë që ai të përballojë sfidat e jetës dhe të integrohet në shoqëri.
- **Mësuesit** për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe arritjet e nxënësit në klasë dhe jashtë saj.
- **Prindit** për njohjen e rezultateve të pritshme të fëmijëve dhe kriteret e vlerësimit në periudha të caktuara .
- **Hartuesit** të teksteve mësimore dhe të materialeve ndihmëse për mësuesit dhe nxënësit, të cilët përmes përmbushjes së qëllimeve të programit në tekstet e tyre, bëhen një faktor i rëndësishëm progresi në mësimdhënien e lëndës së historisë dhe në ndërtimin e kompetencave të lëndës dhe kompetencave kyçe të të nxënit gjatë gjithë jetës.

Programi i historisë në qendër të tij vendos krijimin e kushteve për ndërtimin e kompetencave të lëndës dhe të kompetencave kyçe që lidhen me to, për të gjithë nxënësit e arsimit bazë.

Programi paraqet temat ndërkurrikulare, ku realizimi i tyre nëpërmjet lëndës së historisë është një komponent i rëndësishëm i programit për kontributin e historisë në shoqëri dhe në jetën e përditshme. Programi përshkruan lidhjen e historisë me fushat e tjera.

Diagrami 1. Korniza konceptuale e programit



2.1. Qëllimet e programit të historisë

Programi i historisë në arsimin profesional ka për qëllim të pajisë nxënësit me aftësi dhe cilësi intelektuale nëpërmjet zhvillimit dhe ndërtimit të një sërë konceptesh dhe kompetencash lëndore, të cilat u krijojnë atyre mundësi të analizojnë në mënyrë kritike informacionin, lidhjet shkak-pasojë, të interpretojnë burimet, të ndërtojnë shpjegime të arsyetuara dhe argumentuara dhe të vlerësojnë interpretimet e ndryshme për të shkuarën.

Programi i historisë në arsimin profesional lidh vlerat e të mësuarit të historisë me qëllimet e arsimit parauniversitar, me kompetencat kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës dhe Rekomandimet Rek (2001)15 të Komitetit të Ministrave të Shteteve anëtare, për mësimdhënien e historisë në shekullin e XXI, duke ndërtuar tek nxënësi konceptet, kompetencat dhe cilësitë historike, nëpërmjet:

- pajisjes me dijet dhe kompetencat e nevojshme historike për të kuptuar të tashmen dhe ndikimin e saj në zhvillimet historike të së ardhmes;
- krijimit të mundësive për të ndërtuar dije, shkathtësi, qëndrime dhe vlera, për zhvillimin e qytetërimeve antike, mesjetare moderne dhe bashkëkohore në vend, rajon dhe botë;
- angazhimit në mënyrë aktive në kërkimin historik me qëllim që të zhvillojë vetëbesimin, reflektimin dhe mendimin kritik;
- zhvillimit të aftësive/shkathtësive të kërkimit historik, duke u bazuar në burime historike për studimin e ngjarjeve të ndryshme të historisë;
- interpretimit të efektit të kohës, të vazhdimësisë dhe të ndryshimit në marrëdhëniet historike dhe rolin e tyre në perspektivat e së ardhmes;
- interpretimit të historisë së shoqërisë njerëzore në të kaluarën, në mënyrë që nxënësit të kuptojnë të sotmen;
- kuptimit se si dhe pse ngjarje dhe çështje të veçanta historike janë interpretuar në mënyra të ndryshme;

- zhvillimit të aftësive për të analizuar dhe për të interpretuar informacionin historik në mënyrë kritike dhe të përgjegjshme, nëpërmjet dialogut, kërkimit të së vërtetës dhe përmes debatit të hapur, sidomos për çështje të ndjeshme historike;
- ndërveprimet me individë dhe grupe individësh të kulturave të ndryshme për të njohur të kaluarën dhe për të kuptuar ndërveprimin e saj me të sotmen, duke nxënë, analizuar dhe menduar në mënyrë kritike;
- mundësimin të ndërtimit të identitetit individual dhe kolektiv përmes njohjes dhe krahasimit të trashëgimisë së tyre historike të përbashkët;
- vlerësimin të pozitës së qytetërimit shqiptar në raport me qytetërimet botërore;
- argumentimin të vlerave të trashëgimisë historike, duke e vlerësuar këtë trashëgimi si pjesë të përcaktimit të identitetit të një populli;
- zhvillimit të aftësive qytetare, të cilat kontribuojnë në rritjen e tyre personale si individë, në përgatitjen e tyre në jetë, në punë dhe në shoqëri;
- ndërtimit të aftësive për të kuptuar, organizuar dhe komunikuar dijet e tyre historike përmes mënyrave të ndryshme dhe përdorimit të mediave të ndryshme;
- pajisjes me kompetencat e duhura për të kontribuar në mënyrë aktive dhe me përgjegjësi si qytetarë lokalë dhe globalë në ndërtimin e perspektivës;
- forcimit të ndjenjës së identitetit kombëtar dhe të respektit për historinë kombëtare, me qëllim zgjerimin e përmasave evropiane në studimin e historisë.

2.2. Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës

Ndërtimi dhe zbatimi i kompetencave kyçe nga nxënësit gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies, kërkon që mësuesi të mbajë parasysh lidhjen e kompetencave kyçe, me kompetencat e lëndës për secilën shkallë të kurrikulës. Kompetenca përcaktohet si integrimi i njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve që një nxënës duhet t'i fitojë gjatë procesit të nxënies. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje,

mësuesi duhet të përzgjedhë situatat, veprimtaritë, metodat, dhe mjetet e përshtatshme të procesit të të nxënit. Nëpërmjet studimit të historisë, nxënësit mësojnë se si të paraqesin një problem, që ata e kanë realizuar nëpërmjet përvetësimit dhe ndërtimit të dijeve dhe kompetencave historike, për një temë të caktuar.

Kur nxënësi zbaton kompetencat historike, ai njëkohësisht është duke zbatuar dhe kompetencat kyçe. P.sh. kompetenca historike “Kërkimi historik”, përfshin shumë nga strategjitë e zgjidhjes së situatave të ndryshme problemore në shoqëri dhe në jetën e përditshme. Për të zgjidhur problemin, ata duhet të kërkojnë, të mbledhin, të gjejnë, dhe të sintetizojnë informacione nga burimet primare, sekondare dhe informacionet me gojë, me shkrim, dhe ato vizuale.

Ata duhet të dinë ku të kërkojnë informacion, cilat informacione do t'i ndihmojnë ata për të ndërtuar një argument, si të interpretojnë informacionin e gjetur, si të strukturojnë marrëdhëniet komplekse shkakore, si të vlerësojnë saktësinë e burimit dhe si të krahasojnë gjetjet e tyre me faktet historike. Ata mësojnë të komunikojnë gjetjet e tyre dhe i komunikojnë ato për audiencë të ndryshme. Pra gjatë zhvillimit të kompetencave historike, nxënësi zhvillon gjithashtu kompetencat kyçe në lidhje me zgjidhjen e problemit, krijimtarinë, inovacionin, përpunimin e informacionit, prezantimin e detyrave, punën në grup, komunikimin efektiv etj.

Për të realizuar lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës mësuesi ndjek këto hapa:

- përzgjedh përmbajtjen mësimore, mjetet didaktike, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënit të kompetencave të historisë në një vit mësimor, si dhe rezultatet e të nxënit për kompetencat kyçe në një vit mësimor;
- planifikon mësimdhënien, duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do të arrijë rezultatet e të nxënit, për kompetencat kyçe brenda vitit shkollor;
- kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave, projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënit për vit mësimor dhe shkallë, për lëndën e historisë.

Diagrami 2. Rezultatet kryesore të të nxënit sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së historisë

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit

- Zhvillon kompetencën e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.
- Përdor funksionet gjuhësore të teksteve historike, duke përfshirë fjalorin historik, fjali të ndërtuara saktë për përshkrimin e ngjarjeve, fjali komplekse për shpjegimin e marrëdhënive shkak-pasojë, përdorimin e gjerë të emrave, ndajfoljeve dhe mbiemrave për të përshkruar vendet, njerëzit dhe ngjarjet.

Kompetenca e të menduarit

- Zhvillon kompetencën e të menduarit për realizimin e kërkimit historik.
- Zhvillon mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të interpretuar të shkuarën nëpërmjet informacionit, për të dhënë argumenta bazuar në burime dhe për të saktësuar saktësinë e burimeve.
- Zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës, që janë të diskutueshme.
- Analizon të dhënat numerike për të kuptuar të shkuarën, për shembull për të kuptuar shkakun dhe pasojën, vazhdimësinë dhe ndryshimin.
- Ndërton dhe interpretojnë grafikë, diagrame, tabela statistikore, për paraqitjen e të dhënave historike.

Kompetenca e të nxënit

- Zhvillon kompetencën e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.
- Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme, i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
- Parashtron pyetje kërkimore dhe përgjigjet duke u bazuar në argumenta dhe burime.
- Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet për një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
- Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike.
- Vlerëson pikëpamjet e ndryshme si dhe menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e burimeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre në histori.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

- Zhvillon kompetencën për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin për të identifikuar dhe vlerësuar burimet e nevojshme për interpretimin e ngjarjes historike.
- Harton hapat që duhet të ndjekë për realizimin e një kërkimi historik për një ngjarje të dhënë.
- Zhvillon një kërkim individual ose në grup për kryerjen e një veprimtarie në histori.
- Diskuton individualisht ose në grup për rëndësinë që ka e shkuara në kuptimin e të tashmes dhe perspektivat e të ardhmes.
- Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një veprimtarie të përbashkët.

Kompetenca personale

- Zhvillon kompetencën personale për të kuptuar veten dhe të tjerët, ndryshimet dhe ngjashmëritë, për të menaxhuar marrëdhëniet ndërmjet njëri-tjetrit, vlerësuar pikëpamjet e të tjerëve qofshin këto dhe të ndryshme nga të tija.
- Kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave.
- Përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj. për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij.

Kompetenca qytetare

- Zhvillon kompetencën qytetare për të shqyrtuar në mënyrë kritike sjelljet, motivet dhe veprimet e njerëzve në të shkuarën që mund të jenë rezultat i ndryshimit të qëndrimeve shoqërore dhe standardeve të ndryshme.
- Shqyrton burimet historike për të kuptuar ngjarjet dhe zhvillimet që kanë ndikuar në shoqëri dhe grupe të ndryshme kulturore në kohëra të ndryshme, dhe shpegon natyrën, shkaqet dhe pasojat e konflikteve dhe ndërvarësinë kulturore.
- Kupton se si qytetërimet dhe shoqëritë janë formuar nga grupe njerëzish me kultura të ndryshme, identifikon dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet kulturave të ndryshme dhe kultivon respekt ndaj kulturave të ndryshme nga e tija.
- Shqyrton burimet historike për të kuptuar çështjet shoqërore dhe se si parime të ndryshme kanë ndikuar në çështjet njerëzore.
- Zhvillon mirëkuptimin ndërkulturor, duke vlerësuar kulturat, gjuhët dhe besimet e ndryshme.
- Kupton perspektivat, besimet dhe qëndrimet e njerëzve në të shkuarën e në të tashmen dhe rëndësinë e njohjes së historisë së tyre dhe të tjerëve.
- Shpjegon orrijinën dhe zhvillimin e identitetit kombëtar duke vlerësuar trashëgiminë material dhe shpirtërore.
- Shqyrton një sërë burimesh që paraqesin perspektiva të ndryshme kulturore në mënyrë që të zhvillojë kuptimin historik.

Kompetenca digjitale

- Zhvillon kompetencën digjitale për të kërkuar, për të përzgjedhur, për të analizuar dhe për të komunikuar informacion historik.
- Akseson një sërë burimesh digjitale të informacionit dhe analizon në mënyrë kritike këto burime historike.
- Komunikon, prezanton dhe parashtron njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet.
- Bashkëpunon, diskuton dhe debaton me të tjerët për të ndërtuar konceptet dhe kompetencat historike.

2.3. Lidhja e lëndës së historisë me temat ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare, të cilat integrojnë fushat kurrikulare të të nxënësve, janë tema madhore, me të cilat përballet shoqëria tani dhe në të ardhmen. Zhvillimi i tyre ndihmon nxënësit të interpretojnë botën dhe të rritin lidhjen e arsimit me jetën dhe me interesat e saj. Trajtimi i këtyre temave në lëndën e historisë synon ndërtimin e disa njohurive specifike, zbatimin e disa aftësive, vlerave e qëndrimeve të caktuara të nxënësit për zhvillimin e tyre si qytetarë të së ardhmes, të cilët do të jenë të aftë për të bashkëvepruar në paqe me kultura të ndryshme, të aftë për të kontribuar në ndërtimin e një shoqërie demokratike dhe të aftë për të funksionuar në një botë të ndërvarur, duke nxitur zhvillimin e qëndrueshëm të saj.

Kurrikula e historisë është projektuar për të plotësuar nevojat e nxënësve duke paraqitur një program bashkëkohor. Temat ndërkurrikulare:

- identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave,
- të drejtat e njeriut, vendimmarrja morale,

- zhvillimi i qëndrueshëm,
- mjedisi, ndërvarësia,
- bashkëjetesa paqësore.

ofrojnë dimensione, të cilat pasurojnë programin mësimor nëpërmjet zhvillimit të përmbajtjes së fokusuar që përshtatet natyrshëm brenda tematikave të historisë.

Integrimi i këtyre temave gjatë zhvillimit të koncepteve dhe kompetencave historike aftëson nxënësit:

- për t'u bërë qytetarë aktivë dhe të përgjegjshëm në dimensionet lokale, kombëtare, rajonale, evropiane e globale, duke u mundësuar atyre të ndërtojnë identitetin individual dhe kolektiv përmes njohjes së trashëgimisë së tyre historike të përbashkët;
- për të ndërvepruar me individë dhe grupe individësh të kulturave të ndryshme, për të njohur të kaluarën dhe për të kuptuar ndërveprimin e saj me të sotmen, duke nxënë, analizuar dhe menduar në mënyrë kritike;
- për t'u edukuar me ndenjen e mirëkuptimit dhe të besimit të ndërsjellë midis popujve, nëpërmjet studimit të kulturës, të shkëmbimeve të shumanshme dhe të trashëgimisë;
- për të ndihmuar në formimin e një të ardhmeje më të mirë përmes kuptimit të asaj se si e shkuara ka lidhje me të tashmen dhe për të marrë vendime për një zhvillimi të qëndrueshëm të perspektivave historike;
- për të zhvilluar aftësitë qytetare, të cilat kontribuojnë në rritjen e tyre personale si individë, në përgatitjen e tyre në jetë, në punë dhe në shoqëri.

Gjatë realizimit të temave ndërkurrikuar nxënësi duhet të zgjidhë situata, duhet të përdorë aftësitë e mendimit kritik, krijues, të përdorë kompetencat historike si: kërkimin, përdorimin e burimeve, interpretimin dhe komunikimin për të shpjeguar, argumentuar dhe parashikuar perspektivat për çështje të ndryshme që lidhen me këto tema ndërkurrikulare.

2.4. Lidhja e historisë me fushat/lëndët e tjera kurrikulare

Lënda e historisë është një nga lëndët kryesore të fushës shoqëria dhe mjedisi. Njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat në lëndët e fushës shoqëria dhe mjedisi dhe në lëndët e tjera të fushave të të nxënit si: atyre të shkencave natyrore, arteve, gjuhës dhe komunikimit, matematikës, teknologjisë dhe TIK-ut, etj., integrohen mjaft mirë me ato të historisë. Integrimi i tyre mund të shikohet në nivelin e tematikave, të koncepteve dhe të kompetencave.

Lënda e historisë dhe lëndët e tjera duhet të integrohen në mënyrë të ndërsjellë me njëra-tjetrën. Vetëm në këtë mënyrë do të mund të realizohen si duhet kompetencat kyçe të të nxënit dhe qëllimet e shkollës dhe të shoqërisë, në fushën e arsimit.

Çfarë do të thotë kjo?

- Së pari, historia mund të përdorë njohuritë, konceptet dhe aftësitë, që trajtohen në lëndët e tjera për të ndërtuar, për të konkretizuar dhe për të argumentuar më mirë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat e saj.
- Së dyti, lëndët e tjera duhet të përdorin dijet dhe kompetencat historike për të aktualizuar dhe për të kuptuar më mirë çështjet e tyre në diskutim, si dhe për të nxitur përgjegjësinë dhe motivimin qytetar të nxënësve në shkollë dhe në bashkësinë ku jetojnë.

Diagrami 3. Lidhja ndërmjet lëndës së historisë dhe fushave/lëndëve të tjera

SHOQËRIA DHE MJEDISI

- Përdor hartën, globin dhe busullën për lokalizimin e territoreve ku kanë lindur dhe janë zhvilluar ngjarjet historike.
- Lexon dhe interpreton harta të ndryshme historike dhe gjeografike.
- Orientohet në hapësirë nëpërmjet hartës dhe globit, për të lokalizuar një territor të caktuar me vlera historike.
- Përcakton në hartë vendndodhjen e qytetërimeve ne periudha të ndryshme historike.
- Argumenton rëndësinë e relievit dhe të klimës në zhvillimin e qytetërimeve.
- Shpjegon termat migrim i jashtëm dhe i brendshëm i popullsisë, për të treguar lëvizjet e popujve dhe pasojat që ato sjellin në qytetërimi, gjatë periudhave të ndryshme të historisë.
- Tregon ç 'është mjedisi gjeografik, për të kuptuar ndikimin e tij në zhvillimin e qytetërimeve.
- Shpjegon konceptet: liri, barazi, të drejta, ligj, komb, shtet, etni, demokraci dhe kushtetutë, për të Shpjeguar zhvillimin historik të qytetërimeve.
- Analizon dhe interpreton organizimin e familjes, të institucioneve dhe të shoqërisë, për të përcaktuar tiparet e jetës së përditshme përgjatë periudhave historike.
- Shpjegon format e sistemeve të qeverisjes, për të shpjeguar organizimin shtetëror gjatë periudhave historike.
- Interpretimet e ndryshme fetare (politeizmi, monoteizmi, krishterimi, islamizmi) për të shpjeguar rolin e fesë në histori.

TIK

- Shfrytëzon simbolet për shkrimin e shekujve me shifra romake në kompjuter.
- Përdor programet kompjuterike për shkrimin e një materiali historik.
- Përdor programet kompjuterike për prezantimin e një detyre në histori.
- Përdor internetin për nxjerrjen e të dhënave për ngjarje dhe për figura historike.
- Përdor programet kompjuterike për të ndarë mendime detyra dhe informacionin historik me moshatarët e tij.

GJUHËT DHE KOMUNIKIMI

- Interpreton tekste dhe forma të ndryshme të komunikimit, përfshirë atë historik.
- Shpreh opinione, arsyeton, diskuton, argumenton dhe bën debate argumentuese me tematikë historike.
- Përzgjedh informacionin e duhur historik në tekst.
- Shfrytëzon rregullat e drejtshkrimit për shkrimin e një materiali historik.
- Dallon gjinitë e ndryshme letrare: ditarin, kujtimet dhe romanin historik.
- Shfrytëzon veprat letrare-artistike, si burim informacioni historik.
- Përdor folklorin shqiptar si burim historik.
- Përdor veprën e rilindësve për të vlerësuar rolin që luajtën ata në historinë e Shqipërisë.

MATEMATIKË

- Ndërton dhe interpreton grafikë, diagrame, tabela statistikore, për paraqitjen e të dhënave historike.
- Përdor numrat e shifrat romake për leximin dhe për shkrimin e shekujve.
- përdor numrat negativë dhe pozitivë për të kryer veprime për llogaritjen e kohës.
- Përdor boshtin numerik për interpretimin e shkallës së kohës.
- Vendos në boshtin numerik vitet para dhe pas Krishtit.

SHKENCAT E NATYRËS

- Reflekton dhe diskuton për rrjedhojat shoqërore të zhvillimeve shkencore.
- Vlerëson rolin qendror të shkencës në botën e sotme.
- Kupton karakterin kontradiktor të shkencës dhe faktin që shkencëtarët kanë pikëpamje të ndryshme dhe kundërshtuese si për faktet që përdoren në shkencë ashtu edhe për rreziqet që rrjedhin prej zhvillimeve shkencore.
- Kupton çështjet e ndryshme rreth shkencës dhe mjedisit.
- Kupton ndikimin e përparimeve teknike në shoqëri, për shembull: ndikimi i internetit.

2.5.Kompetencat dhe konceptet e lëndës së historisë

Programi nëpërmjet të gjithë tematikave të tij zhvillon dhe ndërton një numër kompetencash dhe konceptesh, të cilat mbështesin studimin e historisë. Kompetencat historike janë procese dhe aftësi thelbësore që përfshihen në të gjithë programin e historisë nëpërmjet tematikave dhe nëpërmjet tematikave dhe veprimtarive të sugjeruara. Nxënësit duhet të kuptojnë, të zhvillojnë dhe të ndërtojnë kompetencat dhe konceptet historike si dhe të aftësohen për ti përdorur ato në mënyrë që të thellojnë dhe të zgjerojnë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat e tyre në lëndën e historisë duke arritur progres.

Kompetenca historike janë:

1. Kërkimi historik.
2. Përdorimi i burimeve.
3. Analiza shkak - pasojë.
4. Interpretimi historik.
5. Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën.

Koncepte kyçe historike janë:

1. Kuptimi kronologjik.
2. Ndryshimi dhe vazhdimësia.
3. Shumëllojshmëria kulturore, etnike dhe fetare.
4. Rëndësia.

Nxënësit aftësohen të demonstrojnë kompetencat historike për ndërtimin e ngjarjes historike. Ata shtrojnë pyetje rreth ngjarjeve, çështjeve apo zhvillimeve, krahasojnë aspekte të ndryshme të periudhave, ngjarjeve dhe çështjeve të marra në studim, për të kuptuar

ndryshimin dhe vazhdimësinë, shqyrtojnë shkaqet dhe pasojat e ngjarjeve dhe situatave historike, vendosin rëndësinë historike të një ngjarjeje në shoqëri, interpretojnë dhe marrin informacion nga burime të ndryshme për të mbështetur kërkimin historik, identifikojnë pikëpamjet e ndryshme historike, organizojnë dhe komunikojnë në mënyrë koherente dijet historike.

Të mësuarit dhe ndërmarrja e aktiviteteve në histori kontribuon në arritjen e qëllimeve të programit mësimor për të gjithë nxënësit, për t'u bërë:

- nxënës të suksesshëm që kënaqen nga mësimi dhe bëjnë përparim e arritje;
- individë me besim, të cilët janë në gjendje të jetojnë të sigurt, të shëndetshëm dhe të aftë të përmbushin kërkesat e jetës;
- qytetarë të përgjegjshëm që japin kontribut pozitiv në shoqëri.

Diagrami 4. Kompetencat dhe konceptet e lëndës së historisë




Tabela 1. Kompetencat e lëndës dhe përshkrimi i tyre

PËRSHKRIMI I KOMPETENCAT HISTORIKE				
Kërkimi historik	Përdorimi i burimeve	Interpretimi historik	Analiza shkak-pasojë	Shpjegimi & komunikimi për të shkuarën
<p>Kërkimi historik përfshin strukturimin e kërkesave në lloje të ndryshme pyetjesh dhe çështjesh historike. Nxënësit duhet të fillojnë të hartojnë dhe të përmirësojnë pyetjet e tyre për të strukturuar një shqyrtim për zhvillimin e hipotezave, për përzgjedhjen dhe dhënien e fakteve për të nxjerrë dhe për të justifikuar konkluzionet e tyre. Nxënësit mund të përdorin njohuritë e tyre të fituara për të sugjeruar hipoteza, ose mund të sugjerojnë hipoteza në fillim të temës, bazuar në supozimet dhe vlerat e tyre, të cilat ata pastaj i testojnë kundrejt provave.</p>	<p>Njohja e së kaluarës bazohet në fakte historike, në prova, të cilat rrjedhin nga burime të sakta historike dhe jo nga supozime paraprake në lidhje me vlefshmërinë dhe me besueshmërinë e burimeve historike të përdorura. Kjo përfshin vlerësimin e vlerës dhe besueshmërinë e dëshmive, duke studiuar prejardhjen e qëllimeve dhe gjuhën e burimeve.</p>	<p>Interpretimi ka të bëjë me të kuptuarit se si historianët dhe të tjerët formojnë interpretime. Njerëzit përfaqësojnë dhe interpretojnë të kaluarën në mënyra të ndryshme, duke përfshirë fotografi, shfaqje, filma, tregime, muze etj. Interpretimet reflektojnë rrethanat në të cilat ato bëhen, dëshmitë në dispozicion, si dhe synimet e atyre që i bëjnë këto interpretime (p.sh.: shkrimtarë, arkeologë, historianë dhe film krijues).</p>	<p>Analiza shkak-pasojë përfshin identifikimin dhe vlerësimin e rëndësisë relative të faktorëve të ndryshëm, si dhe bërjen e lidhjeve shpjeguese ndërmjet shkakut dhe pasojës, duke pasur parasysh marrëdhënien ndërmjet argumenteve shkakësore, dëshmive dhe interpretimeve.</p>	<p>Nxënësit zhvillojnë dëgjimin, leximin dhe shkrimin si aftësi për të kujtuar, për të përzgjedhur, për të klasifikuar dhe për të organizuar informacionin historik, duke përdorur me saktësi terminologjinë historike për përshkrimin dhe për shpjegimin e ngjarjeve në të shkuarën. Nxënësit duhet të përdorin edhe teknologjitë e reja ekzistuese sipas nevojave të tyre.</p>


Tabela 2. Konceptet e lëndës dhe përshkrimi i tyre

PËRSHKRIMI I KONCEPTET HISTORIKE			
Kuptimi kronologjik	Ndryshimi & vazhdimësia	Shumëllojshmëria kulturore, etnike & fetare	Rëndësia
<p>Kuptimi kronologjik është thelbësor në ndërtimin dhe në shpjegimin e ngjarjeve historike, çka përfshin përdorimin e saktë të datave për të krijuar vijimësinë e ngjarjeve në një shqyrtim, duke përdorur termat dhe fjalorin e saktë kronologjik, si dhe duke ditur emrat dhe karakteristikat kryesore të periudhave të studiuara. Nxënësit duhet të identifikojnë ndryshimet brenda dhe gjatë periudhave, duke bërë lidhjet midis tyre.</p>	<p>Kuptimi i ndryshimit dhe i vazhdimësisë është i lidhur ngushtë me identifikimin dhe shpjegimin e ndryshimit, e vazhdimësisë brenda dhe përgjatë periudhave historike, si dhe me kuptimin e temave dhe çështjeve gjithëpërfshirëse të periudhave historike.</p>	<p>Shumëllojshmëria kulturore, etnike dhe fetare ka të bëjë me të kuptuarin e përvojave, ideve, besimit dhe vlerave të ndryshme të njerëzve dhe të shoqërive në të shkuarën dhe se si të gjitha këto kanë formësuar botën. Nxënësit duhet të njihen me shumëllojshmërinë kulturore, etnike dhe fetare të shoqërive të ndryshme. Shumëllojshmëria ekziston brenda dhe ndërmjet grupeve për shkak të dallimeve kulturore, etnike, rajonale, gjuhësore, sociale, ekonomike, teknologjike, politike dhe fetare. Njohja e kulturave duhet të arrihet nëpërmjet studimit të individëve dhe të grupeve të ndryshme shoqërore, si p.sh.: njohjes të pakicave kombëtare, të shoqërive evropiane dhe atyre joevropiane.</p>	<p>Rëndësia ka të bëjë me konsiderimin dhe me vlerësimin e një ngjarjeje historike. Ajo vlerëson pse gjykimet në lidhje me rëndësinë e ngjarjeve historike, çështjeve dhe njerëzve kanë ndryshuar me kalimin e kohës. Gjithashtu, ajo merr parasysh identifikimin e kriterëve të përdorura për vlerësimin e rëndësisë së një çështjeje, ngjarje apo personazhi historik, si dhe vlerëson se si këto kriterë dhe vlera janë përdorur në përshkrimet e së shkuarës dhe shpjegimin e së tashmes. Deklaratat rreth rëndësisë janë interpretime që mund të bazohen në vendime të kontestueshme rreth ngjarjeve, çështjeve dhe figurave historike, ato shpesh janë të lidhura me sistemet e vlerave të periudhës, në të cilën është shkruar interpretimi.</p>

2.6.Cilësitë historike të nxënësit

Lënda e historisë i ndihmon nxënësit që të bëhen të ditur, të logjikshëm, kureshtarë, të balancuar, të ndjeshëm, dhe individë të aftë për të dhënë argumente dhe për të marrë vendime të arsyetuara mirë.

Diagrami 5. Cilësitë historike të nxënësit



Kurrikula e historisë synon t'i pajisë nxënësit me këto cilësi të rëndësishme në mënyrë që t'i mbështesë ata, jo vetëm në zotërimin e dijeve dhe kompetencave historike, por dhe në arritjen e rezultateve të dëshiruara dhe në realizimin e qëllimeve të arsimit parauniversitar, për t'i bërë ata të aftë për të përmbushur studimet e tyre të mëtejshme, si dhe për të nxënësit gjatë gjithë jetës.

Për të zhvilluar cilësitë historike, mësuesi gjatë mësimit të historisë duhet t'u ofrojë nxënësve mundësi për të kërkuar, për të shqyrtuar, për të vlerësuar aspekte të ndryshme historike dhe për të përdorur TIK-un, si pjesë përbërëse e të mësuarit të tyre. Krijimi i këtyre mundësive rrit angazhimin e nxënësve me kuptimin dhe përdorimin e njohurive të lëndës, koncepteve, kompetencave historike dhe kompetencave kyçe.

Mësuesi i ofron mundësi nxënësit:

- për të kërkuar aspekte për historinë e shqiptarëve në parahistori, antikitet, në mesjete, në periudhën moderne dhe në periudhën bashkëkohore dhe për të kuptuar se si ato lidhen me një kontekst të gjerë historik;
- për të shqyrtuar rrugët, në të cilat e kaluara i ka ndihmuar të formojnë identitetin, kulturat e përbashkëta, vlerat dhe qëndrimet sot;
- për të vlerësuar përmes vizitave ku është e mundur, rolin e muzeve, galerive, arkivave historike në ruajtjen dhe paraqitjen e së shkuarës;
- për të përdorur TIK-un, për të kërkuar informacion për të shkuarën në lidhje me datat, personazhet, objektet, ngjarjet dhe proceset historike, si dhe për të përzgjedhur, klasifikuar, organizuar dhe paraqitur gjetjet.

Nxënësi:

- Shqyrton rrugët në të cilat e kaluara i ka ndihmuar të formojnë identitetin, kulturat e përbashkëta, vlerat dhe qëndrimet sot. Kjo përfshin: eksplorimin e marrëdhëniet në mes të kaluarës dhe të tashmes, të kuptuarit që idetë, vlerat, besimet rrjedhin nga një proces ndryshimi dhe ndërveprimi i vazhdueshëm, duke vlerësuar atë që njerëzit brenda një kulture kanë të përbashkët, si dhe diversitetin e tyre, duke vlerësuar se kulturat janë gjithmonë në ndryshim si rezultat i kontaktit me kulturat e tjera. Duke studiuar rrugët në të

cilat e kaluara ndihmon për të formuar identitetet, kulturat e përbashkëta, vlerat dhe qëndrimet sot, nxënësit përgatiten për jetën në një shoqëri të ndryshme dhe me shumë etni, në një botë gjithnjë e më të ndërvarur.

- Vlerëson përmes vizitave ku është e mundur rolin e muzeve, galerive, arkivave historike në ruajtjen dhe paraqitjen e së shkuarës. Kjo përfshin përdorimin e muzeve, galerive, arkivave dhe vende historike për të gjeneruar dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve rreth të shkuarës dhe për të ngjallur interesin e nxënësve, në mënyrë që ata në jetën e tyre përtej shkollës, të vazhdojnë përdorimin e këtyre burimeve.
- Përdor TIK-un për të kërkuar informacion për të shkuarën në lidhje me datat, personazhet, objektet, ngjarjet dhe proceset historike, si dhe për të përzgjedhur, klasifikuar, organizuar dhe paraqitur gjetjet. Kjo përfshin: vlerësimin e faqeve të internetit, duke marrë parasysh prejardhjen e materialeve dhe duke vlerësuar vlerën e tyre, si dhe përdorimin e TIK-ut për të kërkuar të dhëna historike, për të përzgjedhur, për të klasifikuar, për të organizuar dhe për të prezantuar informacionin. Nxënësi duhet të ketë mundësi për të ripunuar, për të ristrukturuar punën e tyre dhe për të reflektuar mbi këtë proces.

3. KLASA E DYMBËDHJETË

Programi i historisë i përgatit nxënësit për të ardhmen, i pajis ata me cilësi dhe kompetenca, që janë të çmuara për jetën, rrit mundësinë e arsimit të mëtijshëm dhe zhvillon aftësitë për të marrë pjesë në një shoqëri demokratike. Ai inkurajon mirëkuptimin reciprok të origjinës historike dhe të diversiteteve etnike, kulturore dhe fetare. Programi i historisë synon që të krijojë te nxënësi bindjen se qytetërimi i sotëm është një vazhdimësi progresive e qytetërimit të hershëm, pra e sotmja e ka burimin tek e kaluara dhe është e lidhur me të. Ruajtja e kronologjisë zbaton kriterin shkencor të zhvillimit të ngjarjeve mbi lidhjen shkak – pasojë dhe vazhdimësinë progresive të rrjedhës historike. Trajtesa tematike e historisë shpreh natyrën përzgjedhëse (selektive) të programit, i cili nuk ka si qëllim të mbulojë gjithë ngjarjet e historisë, gjë që do të sillte një ngarkesë të panevojshme për nxënësin, por të trajtojë problemet thelbësore, modelet historike që përbëjnë rrënjët e qytetërimit të sotëm. Ky program e ndihmon nxënësin që të kuptojë më mirë realitetin e sotëm dhe ngjarjet aktuale që ndodhin, t'i analizojë ato në mënyrë kritike, duke bërë lidhjen e të sotmes me të shkuarën historike dhe me perspektivat e së ardhmes.

Programi i historisë për të gjitha strukturat e arsimit profesional, në klasën e 12-të trajton historinë e Shqiptarëve në periudhën moderne dhe bashkëkohore, në mënyrë që nxënësit të kuptojnë jetën dhe ngjarjet e së shkuarës, lidhjen e tyre me të tashmen dhe me të ardhmen, si dhe ndërvarësinë ndërmjet qytetërimeve.

3.1.Përmbajtja e kurrikulës për klasën e 12-të

Në klasën e 12-të, programi “Historia e shqiptarëve” trajton tërë aspektet e jetës shoqërore si shteti, ligji, zhvillimi ekonomik, shoqëria, kultura materiale dhe shpirtërore si dhe veprimtaritë e jetës së përditshme në periudhën moderne dhe bashkëkohore, duke u përpjekur të vendosë një raport të baraspeshuar ndërmjet këtyre fushave të jetës. Nxënësi nëpërmjet tij kupton ligjësitë themelore të organizimit, të funksionimit dhe të zhvillimit të shoqërisë shqiptare, analizon ngjarjet dhe personalitetet që i dhanë tiparet kryesore, përshpejtuan dhe

thelluan proceset politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore si dhe vlerëson ndikimin e ndërsjellë të kulturave dhe të ngjarjeve historike të popullit shqiptar me ato të popujve të tjerë rajonalë dhe më tej. Ky program e ndihmon nxënësin që të kuptojë më mirë realitetin e sotëm dhe ngjarjet aktuale që ndodhin, duke i kuptuar ato në mënyrë kritike, për të bërë lidhjen e së sotmes me të shkuarën historike dhe me perspektivat e së ardhmes.

Përmbajtja e dhënë në programin e historisë ofron mundësi për zhvillimin dhe ndërtimin e koncepteve, njohurive, aftësive/shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave, të cilat janë të ndërlidhura me njëra – tjetrën dhe duhet të jepen në mënyrë të integruar në të gjithë tematikat e përcaktuara në program, me qëllim ndërtimin dhe zbatimin e kompetencave të lëndës dhe kompetencave kyçe. Tematikat dhe projektet/situatat e sugjeruara të dhëna në program janë bazë për të siguruar rezultatet e të nxënit, sipas koncepteve dhe kompetencave historike. Për secilën tematikë janë paraqitur njohuritë, aftësitë/shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat për klasën 12-të, të arsimit profesional.

3.2.Rezultatet e të nxënit për konceptet dhe kompetencat historike

Përgjatë gjithë programit të historisë zhvillohen njohuritë, aftësitë/shkathtësitë, qëndrimet e vlerat që duhet të zotërojë nxënësi për ndërtimin e koncepteve historike: *Kuptimi kronologjik. Ndryshimi dhe vazhdimësia. Shumëllojshmëria kulturore, etnike dhe fetare, rëndësia dhe realizimin e kompetencave historike: Kërkimi historik. Përdorimi i burimeve. Analiza shkak-pasojë. Interpretimi. Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën.*

Tabela 3. Rezultatet e të nxënit për kompetencat dhe konceptet historike për klasën e 11-të dhe të 12-të të arsimit profesional

REZULTATET E TË NXËNIT PËR KOMPETENCAT HISTORIKE				
Kërkimi historik	Përdorimi i burimeve	Interpretimi historik	Shkaku dhe pasoja	Shpjegimi dhe komunikimi
<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon dhe shqyrton, individualisht dhe si pjesë e një grupi, pyetje specifike historike për periudhën parahistorike, antike mesjetare, moderne dhe bashkëkohore ose çështje që u përkasin këtyre periudhave, duke bërë testimin e hipotezave; • reflekton në mënyrë kritike për pyetje ose çështje historike që i përkasin periudhës parahistorike, antike, mesjetare, 	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon tipat e burimeve historike si një domosdoshmëri në punën e historianit dhe në dhënien e përgjigjeve të argumentuara për ndërtimin e ngjarjes historike; • vlerëson historinë gojore, me anë të së cilës dëshmitë gojore për ngjarjet e fundit historike mund ta bëjnë historinë më të gjallë në sytë e nxënësve, si dhe mund t’u lënë vend pikëpamjeve e perspektivave të atyre që nuk kanë marrë pjesë në “historinë e shkruar”; • kërkon, duke vlerësuar burimet alternative, për ndërtimin e ngjarjes historike për periudhën parahistorike, antike mesjetare, moderne dhe bashkëkohore; • identifikon, zgjedh dhe përdor një sërë burimesh historike, duke përfshirë burimet tekstuale, vizuale, objektet dhe mjedisin historik për të argumentuar interpretimin e tij në 	<ul style="list-style-type: none"> • Kupton pse historianët dhe të tjerët i kanë interpretuar ngjarjet, njerëzit dhe situatat historike që i përkasin periudhës parahistorike, antike mesjetare, moderne dhe bashkëkohore në mënyra të ndryshme; • shpjegon se si dhe pse ngjarjet historike janë interpretuar në mënyra të ndryshme nëpërmjet një sërë mediash; • shqyrton një sërë interpretimeve të së kaluarës që i përkasin periudhës parahistorike, antike mesjetare, moderne dhe bashkëkohore për 	<ul style="list-style-type: none"> • Analizon ngjarjet historike që i përkasin periudhës parahistorike, antike mesjetare, moderne dhe bashkëkohore në lidhjet e tyre shkaku-pasojë; • shpjegon pasojat në përfundimin e ngjarjeve, të situatave dhe të ndryshimeve historike që i përkasin periudhës parahistorike, antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore. 	<ul style="list-style-type: none"> • Paraqet shpjegime për periudhën parahistorike, antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore që janë koherente, të strukturuar dhe të arsyetuara, duke përdorur kronologjinë dhe fjalorin e duhur historik; • komunikon njohuritë historike për periudhën parahistorike, antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore në mënyra të ndryshme, duke përdorur

moderne dhe bashkëkohore;	lidhje me ngjarje apo çështje të caktuara që i përkasin periudhave parahistorike, antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore; <ul style="list-style-type: none"> • vlerëson burimet e përdorura për të arritur përfundime të arsyetuara dhe logjike për periudhën parahistorike, antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore. 	të vlerësuar vlefshmërinë e tyre.		kronologjinë dhe fjalorin e duhur historik.
---------------------------	---	-----------------------------------	--	---

REZULTATET E TË NXËNIT PËR KONCEPTET HISTORIKE

Kuptimi kronologjik	Ndryshimi dhe vazhdimësia	Shumëllojshmëria kulturore, etnike dhe fetare	Rëndësia
<ul style="list-style-type: none"> • Përdor saktë datat dhe fjalorin e duhur historik për periudhën parahistorike, antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore; • kupton organizimin kronologjik të historisë dhe vendos ngjarjet në periudhën e saktë historike (parahistorike, antike, mesjetare, moderne, bashkëkohore), duke kuptuar dhe duke shpjeguar marrëdhëniet historike; • ndërton linjën e kohës, duke vendosur në të periudhat historike dhe ngjarjet e rëndësishme historike të historisë së shqiptarëve; • kryen veprime për llogaritjen e kohës; • krijon një tabelë kronologjike (për Shqipërinë) të periudhave historike, duke e 	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon ndryshimin dhe vazhdimësinë e ngjarjeve historike brenda dhe përtej periudhave historike (parahistorike, antike, mesjetare, moderne, bashkëkohore); • analizon shkallën dhe ritmin e ndryshimit, nëse ndryshimi arriti në progres dhe nëse po, për kë për ngjarje historike që i përkasin periudhës parahistorike, antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore; • analizon arsyet dhe rezultatet e ngjarjeve, e situatave dhe ndryshimeve historike për periudhën parahistorike, antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore; • kupton dhe ndërgjegjësohet për veçoritë e prirjeve historike sipas periudhave (antike, 	<ul style="list-style-type: none"> • Kupton se njerëzit dhe shoqëritë e përfshira në të njëjtën ngjarje historike që i përket periudhës parahistorike, antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore mund të kenë përvoja dhe pikëpamje të ndryshme për të njëjtën ngjarje historike. 	<ul style="list-style-type: none"> • Vlerëson rëndësinë e ngjarjeve, të njerëzve dhe të zhvillimeve historike që i përkasin periudhës parahistorike, antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore në kontekstin e tyre historik

pasuruar atë në vazhdimësi me informacionin e ri.	mesjetare, moderne, bashkëkohore), të cilat sollën progresin në shoqërinë shqiptare.		dhe në ditët e sotme.
---	--	--	-----------------------

3.3.Koha mësimore

Në klasën e dymbëdhjetë të arsimit profesional, lënda e historisë zhvillohet me 1 orë në javë, për 34 javë mësimore ose 36 javë mësimore në varësi të strukturës së arsimit profesional.

Tabela 4. Koha mësimore e sugjeruar¹

KLASA 12 – të		
Nr.	Tematika	Orë të sugjeruara ²
1.	Sfidat e shtetit të pavarur shqiptar 1912 – 1939	11
2.	Shqiptarët dhe Lufta e Dytë Botërore	6
3.	Shqipëria gjatë regjimit komunist 1945 – 1990	12
4.	Rënia e regjimit komunist. Fitorja e demokracisë	7

¹ Koha mësimore e sugjeruar është dhënë për një strukturë e cila ka 36 javë mësimore vjetore. Mësuesi këto orë i përshtat edhe për strukturat që kanë më pak javë mësimore vjetore.

² Për secilën tematikë është dhënë një numër i sugjeruar orësh mësimore. Theksojmë që mësuesi është i lirë të vendosë vetë për shpërndarjen e orëve mësimore për secilën tematikë të programit, në varësi të strukturës së arsimit profesional, të metodologjisë, të vlerësimit dhe të nevojave të nxënësve në klasë.

KLASA 12 – të

TEMATIKA 1. SFIDAT E SHTETIT TË PAVARUR SHQIPTAR 1912 – 1939

Përshkrimi i tematikës

Përmes kësaj tematike, nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi/shkathtësi, qëndrime dhe vlera mbi përpjekjet e shteti shqiptar në vitet 1912-1914, për konsolidimin e pavarësisë dhe njohjen ndërkombëtare të tij. Tematika përshkruan veprimtarinë e qeverisë së përkohshme të Vlorës, liston vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër për statusin, kufijtë dhe organizimin e shtetit shqiptar, shpjegon qëndrimin e qeverisë së përkohshme të Vlorës ndaj vendimeve të Konferencës së Londrës si dhe përshkruan rrethanat e ardhjes së Princ Vidit në Shqipëri dhe arsyet e largimit të tij. Tematika përshkruan pozitën e Shqipërisë gjatë Luftës së Parë Botërore dhe trajtimin e çështjes shqiptare në Konferencën e Paqes në Paris. Tematika trajton zhvillimet politike të shtetit shqiptar 1920-1924 dhe aspekte të jetës social - kulturore në Shqipëri gjatë kësaj periudhe. Nxënësit identifikojnë shkaqet e thirrjes së Kongresit Kombëtar të Lushnjës duke listuar vendimet e këtij kongresi, evidenton lindjen e parlamentarizmit në Shqipëri, liston grupimet politike gjatë viteve 1920-1924, si dhe shpjegon arsyet që shkaktuan acarimin e jetës politike në Shqipëri të cilat kulmuan me Lëvizjen e Qershorit 1924. Ajo trajton organizimin e jetës politike, ekonomike dhe shoqërore të shtetit shqiptar gjatë viteve 1925-1939 dhe gjendjen sociale ekonomike dhe politike të shqiptarëve në Jugosllavi dhe të popullsisë çame në Greqi.

Për tematikën e dhënë më poshtë janë parashikuar dhe orë veprimtarish të sugjeruara³ të cilat jepen në rubrikën “Veprimtari të sugjeruara”. Këto orë mësuesi dhe autori i tekstit i integron brenda orëve të tematikës. Tematika së bashku me veprimtaritë realizojnë kompetencat lëndore dhe kompetencat kyçe për të nxënësit gjatë gjithë jetës.

Klasa 12 Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës	Klasa 12 Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të lëndës
Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj (1912-1914) Konferenca e Ambasadorëve e Londrës (1912-1913) Shqipëria nën qeverisjen e princ Vilhelm Vidit Shqipëria gjatë Luftës së Parë Botërore Shqiptarët e Kosovës, Çamërisë dhe viseve të tjera gjatë viteve 1912-1918	<ul style="list-style-type: none"> • përcakton shtrirjen e pushtetit të qeverisë së përkohshme të Vlorës • përshkruan veprimtarinë e qeverisë së përkohshme të Vlorës. • evidenton vështirësitë e brendshme dhe të jashtme të qeverisë së Vlorës për të ushtruar veprimtarinë e saj; • analizon vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër për statusin, kufijtë dhe organizimin e shtetit shqiptar; • shpjegon rrethanat e ardhjes së Princ Vidit në krye të shtetit shqiptar; • përshkruan organizimin e principatës shqiptarë të princ. Vilhelm Vidi

³ Mësuesi zhvillon me nxënësit për çdo tematikë të programit një veprimtari të sugjeruar.

Çështja shqiptare në Konferencën e Paqes dhe Kongresi i Lushnjës

Shteti shqiptar gjatë viteve 1921-1924

- shpjegon arsyet e dështimit të qeverisjes së princ Vilhelm Vidi dhe largimin e tij;
- përcakton në hartë ndarjen e territorit të Shqipërisë në zona pushtimi gjatë Luftës së Parë Botërore;
- evidenton qëndrimin që mbajtën Fuqitë e Mëdha ndaj Shqipërisë gjatë Luftës së Parë Botërore;
- nxjerr në pah detyrat e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe reagimet e saj duke evidentuar Republikën e Korçës dhe Kongresin e Durrësit.
- përshkruan dhe gjykon qëndrimin e Fuqive të Mëdha ndaj çështjes shqiptare në Konferencën e Paqes në Paris;
- identifikon shkaqet e thirrjes së Kongresit Kombëtar të Lushnjës;
- analizon vendimet e Kongresit të Lushnjës, duke evidentuar rëndësinë e tyre;
- Përshkruan veprimtarinë e qeverisë së Sulejman Delvinës dhe përpjekjet për shtrirjen e autoritetit qeverisës në të gjithë territorin e shtetit shqiptar
- evidenton lindjen e parlamentarizmit në Shqipëri gjatë viteve 1920-1924;
- shpjegon veprimtarinë e grupimeve kryesore politike gjatë viteve 1921-1924;
- evidenton formën e organizimit të shtetit shqiptar sipas Statutit të Zgjeruar të Lushnjës;
- shpjegon arsyet që shkaktuan acarimin e jetës politike në Shqipëri të cilat kulmuan me Lëvizjen e Qershorit të vitit 1924;
- gjykon mbi arsyet e dështimit të Lëvizjes të Qershorit të vitit 1924;
- përshkruan aspekte të jetës social - kulturore në Shqipëri gjatë viteve 1921-1924;

<p>Republika Shqiptare (1925-1928)</p> <p>Monarkia Shqiptare (1928-1939)</p> <p>Lëvizjet politike dhe shoqërore në Shqipëri gjatë viteve 1925-1939</p>	<ul style="list-style-type: none"> • shpjegon rrethanat në të cilat u shpall Republika Shqiptare, duke evidentuar karakteristikat dhe organizimin shtetëror të saj • shpjegon përpjekjet e presidentit Ahmet Zogu për stabilizimin e situatës ekonomike dhe politike në Shqipëri; • përcakton drejtimet kryesore të politikës së jashtme të shtetit shqiptar gjatë viteve 1925-1928; • tregon rrugën e kalimit nga republika në monarki, duke evidentuar ndryshimet në organizimin shtetëror; • shpjegon marrëdhëniet me jashtë të shtetit shqiptar gjatë viteve 1925-1939; • dallon qëndrimin e grupimeve politike e shoqërore ndaj qeverisjes së Zogut në Shqipëri dhe jashtë saj; • përshkruan veçoritë e arsimit, kulturës dhe aspekte të jetës së përditshme gjatë republikës dhe monarkisë.
--	--

Koncepte dhe terma

Qeveri kombëtare; status ndërkombëtar, administrim ndërkombëtar, KNK, lëvizja vorio-epirote, asnjësi, zona pushtimi, Traktati i fshehtë i Londrës, statut, vetëvendosje, parlamentarizëm, Paktet e Tiranës; grupime/parti politike; Republikë; monarki; senat; opozitë; reforma europianizuese; statut; kod civil; kod tregtar; kod penal; autoritarizëm, centralizim; stabilitet.

Veprimtari të sugjeruara për tematikën “Sfidat e shtetit të pavarur shqiptar 1912 – 1939”

Shqiptarët në Jugosllavi dhe Greqi në periudhën midis dy Luftërave Botërore

- përshkruan gjendjen social ekonomike dhe politike të shqiptarëve në Jugosllavi;
- përshkruan gjendjen social ekonomike dhe politike të popullsisë çame në Greqi.

Ose:

Gruaja shqiptare në vitet ‘20-30

- evidenton përpjekjet e shtetit shqiptar në emancipimin e gruas;
- evidenton figurat kryesore femërore që spikatën në fusha të ndryshme në vitet 20-30.

TEMATIKA 2. SHQIPTARËT DHE LUFTA E DYTË BOTËRORE 1939 – 1944

Përshkrimi i tematikës

Përmes kësaj tematike, nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi/shkathtësi, qëndrime dhe vlera mbi pozitën e Shqipërisë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Kjo tematikë evidenton reagimin e grupimeve të ndryshme politike ndaj pushtuesit gjerman, një misionet e huaja që vepruan në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe tregon qëndrimin e shqiptarëve në Kosovë dhe popullsisë çame në Greqi gjatë Luftës së Dytë Botërore. Njëpërmyjet kësaj tematike nxënësit aftësohen të shpjegojnë pasojat e Luftës së Dytë Botërore për Shqipërinë dhe shqiptarët.

Për tematikën e dhënë më poshtë janë parashikuar dhe orë veprimtarish të sugjeruara të cilat jepen në rubrikën “Veprimtari të sugjeruara”. Këto orë mësuesi dhe autori i tekstit i integron brenda orëve të tematikës. Tematika së bashku me veprimtarinë realizojnë kompetencat lëndore dhe kompetencat kyçe për të nxënësit gjatë gjithë jetës.

<p style="text-align: center;">Klasa 12</p> <p style="text-align: center;">Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës</p>	<p style="text-align: center;">Klasa 12</p> <p style="text-align: center;">Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të lëndës</p>
<p>Shqipëria nën pushtimin e Italisë së Musolinit (prill 1939-shtator 1943)</p> <p>Shqipëria nën pushtimin gjerman (shtator 1943-nëntor 1944)</p> <p>Rezistenca shqiptare kundër pushtuesve italianë dhe gjermanë</p> <p>Rrjedhojat e Luftës së Dytë Botërore për Shqipërinë</p>	<ul style="list-style-type: none"> • shpjegon procesin e vendosjes së administratës italiane të pushtimit në Shqipëri; • analizon tiparet e regjimit fashist italian në Shqipëri; • përshkruan format e qëndresës së shqiptarëve kundër pushtuesve italianë; • analizon qëndrimet dhe programet e grupimeve kryesore politike jo fashiste në Shqipëri; • shpjegon mënyrën e administrimit të Shqipërisë gjatë pushtimit gjerman; • përshkruan qëndrimin e grupimeve të ndryshme politike jo fashiste ndaj pushtuesit gjerman; • diskuton mbi rolin dhe qëndrimin e misionëve të huaja që vepruan në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore; • shpjegon pasojat e Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri; • vlerëson qëndresën e armatosur të shqiptarëve gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe të rënët në luftë.

Koncepte dhe terma

Bashkim personal; Asamble Kushtetuese; rezistencë; administratë pushtimi; Konferenca e Pezës; aleatë; mision ushtarak; Konferenca e Mukjes; Front Nacionalçlirimtar; Balli Kombëtar; Legaliteti; lëvizje nacionalçlirimtare; luftë civile; çlirim; dëme lufte; dëshmorë; qeveri kolaboracioniste; Dekalogu; Këshilli i Lartë i Rregjencës; Këshill Kombëtar.

Veprimtari të sugjeruara për tematikën “Shqiptarët dhe lufta e dytë botërore 1939 – 1944

Shqiptarët e Kosovës dhe Çamërisë gjatë Luftës së Dytë Botërore

- tregon qëndrimin e shqiptarëve në Kosovë dhe popullsisë çame në Greqi gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Ose:

Ese: Hebrenjtë dhe Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore

TEMATIKA 3. SHQIPËRIA GJATË REGJIMIT KOMUNIST 1945 – 1990

Përshkrimi i tematikës

Përmes kësaj tematike, nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi/shkathtësi, qëndrime mbi vendosjen e regjimit komunist në Shqipëri, tiparet kryesore të këtij regjimi dhe pasojat që solli për Shqipërinë dhe Shqiptarët regjimi komunist, gjatë viteve 1944-1990. Kjo tematikë përshkruan gjendjen ekonomike, politike dhe aspekte të jetës së përditshme në Kosovë në vitet 1945-1990.

Për tematikën e dhënë më poshtë janë parashikuar dhe orë veprimtarish të sugjeruara të cilat jepen në rubrikën “Veprimtari të sugjeruara”. Këto orë mësuesi dhe autori i tekstit i integron brenda orëve të tematikës. Tematika së bashku me veprimtaritë realizojnë kompetencat lëndore dhe kompetencat kyçe për të nxënësit gjatë gjithë jetës.

Klasa 12 Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës	Klasa 12 Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të lëndës
<p>Vendosja e regjimit komunist në Shqipëri</p> <p>Opozita shqiptare ndaj vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri</p> <p>Politika ekonomike e shtetit shqiptar (1946-1985)</p> <p>Arsimi , kultura dhe shoqëria në Shqipëri gjatë viteve 1945-1990</p> <p>Politika e jashtme e shtetit shqiptar gjatë viteve 1945-1990</p> <p>Tipare të represionit komunist gjatë viteve 1945-1990.</p> <p>Kriza e regjimit komunist (1985-1990)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • përshkruan procesin e vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri; • evidenton masat ekonomike dhe politike që mori regjimi komunist në Shqipëri gjatë viteve 1944-1948 duke gjykuar mbi pasojat e tyre; • shpjegon tiparet e qëndresës së forcave demokratike dhe antikomuniste ndaj regjimit komunist në Shqipëri; • evidenton dhunën e ushtruar nga organet shtetërore ndaj opozitës demokratike dhe antikomuniste; • përcakton diktaturën e proletariatit dhe luftën e klasave si tipar kryesor ideologjik të regjimit komunist; • shpjegon politikat ekonomike të shtetit shqiptar, duke evidentuar shtetëzimin, centralizimin, planifikimin, industrializimin dhe kolektivizimin e bujqësisë si tiparet kryesore të saj; • gjykon mbi pasojat që patën politikat ekonomike në jetën e shqiptarëve;

Shqiptarët në ish-Jugosllavi gjatë viteve 1945-1990

- përshkruan ndryshimet që pësoi shoqëria shqiptare në fushën e arsimit, artit, kulturës, fesë, shëndetësisë, rolit të gruas dhe jetës së përditshme;
- evidenton ideologjizimin e arsimit, artit dhe kulturës shqiptare si pjesë të procesit të krijimit të “njeriut të ri”;
- shpjegon pasojat që pati lufta e klasave dhe shkelja e të drejtave të njeriut gjatë regjimit komunist;
- liston format dhe metodat e ushtrimit të represionit nga shteti i diktaturës së proletariatit;
- shpjegon pozitën ndërkombëtare të Shqipërisë në Konferencën e Paqes në Paris;
- tregon drejtimit kryesore të politikës së jashtme të shtetit shqiptar;
- përshkruan veçoritë e marrëdhënieve ndërshtetërore Shqipëri – Jugosllavi, duke evidentuar faktorët që çuan në prishjen e këtyre marrëdhënieve dhe pasojat;
- shpjegon shkaqet e orientimit të ri politik të qeverisë shqiptare drejt BRSS pas prishjes së marrëdhënieve me Jugosllavinë;
- përshkruan marrëdhëniet me BRSS pas ardhjes së Hrushovit në krye të shtetit sovjetik;
- evidenton faktorët që çuan në prishjen e marrëdhënieve me BRSS-në dhe pasojat;
- shpjegon shkaqet e orientimit të ri politik të qeverisë shqiptare drejt Republikës Popullore të Kinës;
- shpjegon tiparet e marrëdhënieve të qeverisë shqiptare me Kinën dhe ndikimin e tyre në shoqërinë shqiptare;
- shpjegon shkaqet që çuan në prishjen e këtyre marrëdhënieve dhe pasojat e tyre.
- përcakton veçoritë e politikës së qeverisë komuniste shqiptare, të cilat çuan në izolimin e plotë ndërkombëtar të vendit;

	<ul style="list-style-type: none"> • evidenton arsyet që çuan në krizën ekonomike dhe politike të shoqërisë shqiptare në gjysmën e dytë të viteve '80; • identifikon disa nga tiparet e krizës ekonomike dhe përpjekjet e drejtuesve komunistë për të lehtësuar gjendjen; • përshkruan disa nga momentet kryesore të shprehjes së pakënaqësisë popullore kundër diktaturës komuniste; • përshkruan gjendjen ekonomike, politike dhe qëndresën e shqiptarëve në Jugosllavi 1945-1968; • vlerëson Kushtetutën e vitit 1974 për Kosovën; • përshkruan rrugën e rivendosjes së autoritetit serb në Kosovë dhe pasojat e tij në pozitën e popullsisë shqiptare në Jugosllavi; • shqyrton aspekte të jetës së përditshme në Kosovë.
Koncepte dhe terma	
<p>Diktaturë e proletariatit, grupi i deputeteve, pozitë; kryengritje antikomuniste, parti-shtet, kulakë, shtetëzim, ekonomi e centralizuar, luftë klasash, sigurimi i shtetit, gjykatë popullore, republikë popullore, asamble kushtetuese, reforma agrare, KNER, Traktati i Varshavës, bllok i vendeve socialiste, revizionizëm, imperializëm, superfuqi, kolektivizim, industrializim, pronë shtetërore dhe kooperativiste, kult i individit, propagandë, disident, ekonomi e centralizuar dhe e planifikuar, bllokadë ekonomike, vetizolim, shkelje e të drejtave themelore të njeriut, kamp internimi, emancipim i gruas, ateizëm, ideologjizimi komunist.</p>	
Veprimtari të sugjeruara për tematikën “Shqipëria gjatë regjimit komunist 1945 – 1990”	
<p><i>Jeta e përditshme në Shqipërinë komuniste</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan aspekte të jetës së përditshme të shqiptarëve gjatë viteve të regjimit komunist. 	
<p><i>Ose:</i></p>	
<p><i>Fotomontazh mbi përdorimin e dhunës gjatë regjimit komunist</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • vendos fotografi që shprehin këto dukuri: pamje nga burgjet e Spaçit, Burrelit, Qafë Barit etj.; punët e rënda të burgosurve; jetën e të internuarve dhe kampet e internimit. 	

TEMATIKA 4. RËNIA E REGJIMIT KOMUNIST. FITORJA E DEMOKRACISË

Përshkrimi i tematikës

Përmes kësaj tematike, nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi/shkathtësi, qëndrime dhe vlera mbi periudhën e rënies së rrëgjimit komunist në Shqipëri dhe fitores së demokracisë. Nëpërmjet kësaj tematike, nxënësit mësojnë për përpjekjet e Shqipërisë për integrim në strukturat euroatlantike si dhe sfidat e shoqërisë shqiptare në ditët e sotme, gjithashtu ata vlerësojnë rëndësinë që pati për Kosovën shpallja e Pavarësisë. Për tematikën e dhënë më poshtë janë parashikuar dhe orë veprimtarish të sugjeruara të cilat jepen në rubrikën “Veprimtari të sugjeruara”. Këto orë mësuesi dhe autori i tekstit i integron brenda orëve të tematikës. Tematika së bashku me veprimtaritë realizojnë kompetencat lëndore dhe kompetencat kyçe për të nxënësit gjatë gjithë jetës.

<p style="text-align: center;">Klasa 12</p> <p style="text-align: center;">Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës</p>	<p style="text-align: center;">Klasa 12</p> <p style="text-align: center;">Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të lëndës</p>
<p>Lëvizja Studentore e Dhjetorit dhe shpallja e pluralizmit politik</p> <p>Shqipëria gjatë tranzicionit për në demokraci (1990-2013)</p> <p>Proceset e integrimit euro-atlantik i Shqipërisë (1990-2013)</p> <p>Rruga e Kosovës për pavarësi dhe integrim euro-atlantik</p>	<ul style="list-style-type: none"> • përshkruan manifestimet e pakënaqësisë popullore që kulmuan me Lëvizjen e Studentore të Dhjetorit 1990; • përshkruan rrugën që çoi në vendosjen e pluralizmit politik dhe ndërrimin e pushteteve në Shqipëri (1991-1992); • përshkruan veçoritë e sistemit të ri politik ekonomik e shoqëror; • evidenton aspekte të globalizimit në jetën së përditshme në Shqipëri; • tregon sfidat e shtetit shqiptar në rrugën e integrimit euro-atlantik; • shpjegon faktorët që ndikuan në procesin e pavarësimit dhe të integrimit euro-atlantik të Kosovës ; • vlerëson rolin që luajtën ndërkombëtarët në këtë proces; • vlerëson rëndësinë që pati shpallja e Pavarësisë për Kosovën.
<p>Koncepte dhe terma</p> <p>Kriza e regjimit komunist, demokraci, pluralizëm, fushatë elektorale, zgjedhje të lira, liri e shtypit, ekonomi e lirë e tregut, barazi para ligjit, tranzicion, integrimi euroatlantik, NATO, BE, marrëveshje stabilizim – asocimi, Pavarësia e Kosovës, administrim ndërkombëtar, UÇK.</p>	
<p>Veprimtari të sugjeruara për tematikën “Rënia e regjimit komunist. Fitorja e demokracisë”</p> <p><i>Qytetari në demokraci</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Evidenton rolin e qytetarit me të drejtat dhe detyrimet e tij në një sistem demokratik • Analizon raportin shtet – individ në një shoqëri demokratike. 	
<p>Klasa 12 – të</p> <p>Qëndrimet dhe vlerat</p> <ul style="list-style-type: none"> • Demonstron aftësitë bazë të kërkimit historik. 	

- Vlerëson rëndësinë që ka e shkuara në ndërtimin e të tashmes.
- Vlerëson rëndësinë e burimeve historike në ndërtimin objektiv të ngjarjes historike.
- Shtron pyetje dhe gjen përgjigje, vlerëson burimet, identifikon dhe analizon interpretime të ndryshme dhe gjykon bazuar në argumente.
- Respekton saktësinë e burimeve historike dhe dallon diferencën midis faktit dhe supozimit.
- Vlerëson pozitën e qytetërimit shqiptar brenda qytetërimit botëror.
- Forcon ndjenjën e identitetit kombëtar dhe të respektit për historinë kombëtare.
- Vlerëson rolin e Rilindjes kombëtare dhe rëndësinë e shpalljes së Pavarësisë.
- Vlerëson sfidat e shtetit të pavarur shqiptar.
- Vlerëson përpjekjet e shtetit shqiptar për ruajtjen e tërësisë tokësore.
- Vlerëson qëndrimin e delegacioneve shqiptare në Konferencën e Paqes.
- Vlerëson qëndresën e armatosur të shqiptarëve gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe të rënët në luftë.
- Vlerëson lëvizjen demokratike në të gjithë vendin, zgjedhjet e 22 Marsit 1992 dhe fitoren e demokracisë.
- Vlerëson rolin e shtetit shqiptar në sfidën e integritetit evropian.
- Vlerëson shkaqet dhe pasojat e rezistencës së shqiptarëve në Jugosllavi dhe Greqi pas vitit 1913.
- Vlerëson rëndësinë që pati shpallja e Pavarësisë për Kosovën dhe rolin e ndërkombëtarëve në këtë proces.
- Vlerëson zhvillimet politike, ekonomike dhe shoqërore në Republikën e Kosovës sot.
- Respekton kontributin e shoqërisë shqiptare sot, për ndërkombëtarizimin e problemit çam.
- Demonstron, përmes studimit të historisë, aftësitë qytetare, të cilat kontribuojnë në rritjen e tyre personale si individë, në përgatitjen e tyre në jetë, në punë dhe në shoqëri.
- Vlerëson rëndësinë e historisë në kuptimin e ngjarjeve të së shkuarës.
- Vlerëson gamën e burimeve historike dhe të informacionit, si: dokumentet, burimet e shtypura, historinë gojore, mediat e ndryshme, pikturat, muzetë, galeritë, fotografitë, muzikën dhe internetin, si baza për studimin dhe përshkrimin e një ngjarjeje historike.
- Respekton origjinën historike dhe kupton dobinë e larmisë etnike dhe kulturore të shoqërisë.
- Demonstron gatishmëri për të pranuar njerëzit nga komunitete të ndryshme.
- Shfaq krenari për vendin e tij.
- Vlerëson dhe respekton larminë në shoqëri, si dhe kontributin e kulturave dhe grupeve të ndryshme fetare e shoqërore.
- Tregon se disa ngjarje dhe ndryshime mund të interpretohen në mënyra të ndryshme dhe shpjegojnë arsyet e mundshme për këtë interpretim.
- Vlerëson dhe respekton pikëpamjet e të tjerëve.

- Tregon integritet në aksesimin dhe përdorimin etik të informacionit.
- Paraqet dhe komunikon lirshëm mendimet e tij.
- Është krijues dhe prezanton idetë e reja të tij.
- Demonstron interes dhe kuriozitet për historinë.
- Demonstron shpirtin e objektivitetit dhe paanësisë.
- Vetë vlerësohet dhe përdor mendimin kritik dhe kritikën konstruktive në situata të thjeshta.
- Demonstron pavarësi dhe besim në vetvete.
- Respekton punën e kryer mirë dhe pranimin e opinionëve të tjera (madje edhe të kundërta) duke treguar tolerancë.
- Demonstron vullnet në arritjen e rezultateve.
- Respekton përpjekjet personale dhe ato në grup.

4. UDHËZIME METODOLOGJIKE

Përdorimi i një numri të larmishëm rrugësh dhe metodash në mësimin e historisë nga mësuesit është një përbërës thelbësor në procesin e zbatimit të kurrikulës së historisë, në arritjen e rezultateve të parashikuara të të nxënësve, në aftësimin e nxënësve për ndërtimin dhe demonstrimin e kompetencave kyçe të të nxënësve dhe kompetencave e koncepteve historike, në lidhjen e historisë me lëndët dhe fushat e tjera të të nxënësve, në integrimin e temave ndërkurrikulare, si dhe në zotërimin e cilësive historike për përmbushjen me sukses të qëllimeve arsimore.

Të nxënësve në lëndën e historisë mund të realizohet vetëm me anë të pjesëmarrjes aktive të nxënësve në procesin e të nxënësve, në mënyrë që ata të kuptojnë, të vlerësojnë e të përdorin përmbajtjen e synuar për të ndërtuar mbi të njohuri e aftësi të reja në situata të ndryshme me të cilat do të përballen në të ardhmen.

Edhe pse të nxënësve në mënyrë të pavarur mbetet i rëndësishëm, po aq rëndësi ka edhe dhënia e mundësive me anë të metodologjisë së mësimdhënies për të ndërvepruar me njëri-tjetrin dhe me mjedisin ku jetojnë. Për këtë, shkolla duhet të ofrojë një mjedis mbështetës ku të njihet e të vlerësohet kontributi i secilit nxënës.

Mësuesi duhet të zbatojë në klasë teknika aktive të mësimdhënies dhe të nxëniet. Ai duhet të organizojë aktivitete, të udhëzojë nxënësit për të marrë pjesë në to dhe të mundësojë pjesëmarrjen aktive dhe kuptimplote të nxënësve. Në këtë mënyrë nxënësit do të zhvillojnë ndjenjën e përgjegjësisë për të nxëniet e tyre, duke formësuar kështu aftësitë e para për të nxëniet gjatë gjithë jetës.

Në klasën e 12 – të, të arsimit profesional, format, metodat, strategjitë dhe teknikat e të mësuarit, duhet të jenë të shumta e të larmishme. Ato zgjidhen në përshtatje me përmbajtjen lëndore, me nivelin e nxënësve, me veçoritë e temave të ndryshme mësimore dhe në varësi të gjendjes së materialeve burimore dhe didaktike. Metodat dhe teknikat e mësimdhënies që mund të zbatohen gjatë një ore mësimi janë të shumta. Si të tilla mund të përdoren:

Mësimi zbulues nëpërmjet të cilit kalohet nga njohuritë elementare në përgjithësime, nga hipotezat në gjetjen e origjinës së dukurive, nga problemet e thjeshta në zgjidhjen e tyre;

Biseda, e cila do të ishte më e efektshme për ato tema ku nxënësit kanë njohuri paraprake të bollshme që fitohen nëpërmjet rrugëve të shumta të informacionit masiv;

Shpjegimi, i cili mund të jetë i suksesshëm në të gjitha ato veprimtari të përbashkëta të mësuesit e nxënësve që synojnë të kuptuarit e njohurive për zhvillimin në kohë e në hapësirë të dukurive dhe të proceseve historike;

Diskutimi është një nga metodat më të thjeshta që përdoret në realizimin e veprimtarive në klasë, kur është fjala për të mundësuar procesin e pjesëmarrjes sa më të gjerë të nxënësve në mësim. Diskutimi është një përzierje e shpjegimeve, mësues-nxënës, e shkëmbimit të pikëpamjeve dhe pyetjeve ndërmjet tyre, e transferimit dhe integritit të njohurive dhe aftësive. Diskutimi me të gjithë klasën është një mënyrë shumë e mirë për mësuesin/en dhe për nxënësit për të zbuluar se cilat janë qëndrimet e tyre rreth çështjeve, ngjarjeve dhe koncepteve të ndryshme që trajtohen në lëndën e historisë. Gjithashtu, diskutimi është një rast shumë i mirë për të praktikuar të dëgjuarit të nxënësit, të folurën me radhë dhe aftësi të tjera që nevojiten në punën në grup;


Puna me faktet dhe përdorimi i burimeve: Përdorimi i strukturuar i dokumenteve historike ndihmon nxënësin të zhvillojë përvojën për vlerësimin e fakteve dhe aftësinë për të formuluar gjykime të arsyeshme, ndaj mësuesi i historisë duhet ti nxisë nxënësit të përdorin burime të larmishme për njohjen e fakteve historike dhe mësimin e tyre kritik e analitik e, në mënyrë të veçantë si :

- arkivat, duke lejuar në këtë mënyrë të shfrytëzohen dokumente origjinale;
- kinemaja dhe prodhimtaria audiovizuale, qoftë dokumentare, qoftë fantastike;
- bibliotekën;
- teknologjitë e informacionit, që duhet të përbëjnë objektin e një trajtimi kritik, individual e kolektiv, për të cilin mësuesi luan një rol themelor ;
- llojet e ndryshme të muzeve dhe vendet përkujtimore, që ndikojnë në përkapjen në mënyrë të qartë nga ana e nxënësve të ngjarjeve të fundit, konkretisht në përmasën e tyre të përditshme ;
- historia gojore, me anë të së cilës dëshmitë gojore për ngjarjet e fundit historike mund ta bëjnë historinë më të gjallë në sytë e të rinjve, si dhe mund t'u lënë vend pikëpamjeve e perspektivave të atyre që nuk kanë marrë pjesë në “ historinë e shkruar”;

Studimi kërkimor: Përfshirja në kërkim është pjesë përbërëse e programit të historisë. Duke njohur dhe duke përvetësuar mënyrën se si punojnë historianët, nxënësit zhvillojnë aftësinë për ta zbatuar atë gjerësisht në lëndën e historisë dhe në fusha të tjera.

Përdorimi i kërkimit historik u paraqet nxënësve një mënyrë për të bërë hulumtime, për të organizuar dhe për të shpjeguar ngjarjet që kanë ndodhur. Kërkimi historik është procesi i "të bërit histori". Ai është një proces ciklik (Figura. 1), që fillon me shtrimin e pyetjeve historike, pasohet nga gjetja dhe analiza e burimeve historike për të krijuar fakte dhe dëshmi historike. Dëshmia historike përdoret më pas për të ndërtuar interpretimet historike që kërkojnë t'u përgjigjen pyetje historike.

Figura 1. Procesi i kërkimit historik



Përdorimi i kërkimit historik duhet të jetë në qendër të mësimit të historisë dhe mësuesit duhet t'i krijojnë mundësinë nxënësit për të mësuar aftësitë e nevojshme përmes praktikës dhe angazhimit në kërkimin historik. Përdorimi i pyetjeve në çdo njësi mësimore siguron një pikë kontakti për nxënësit për të kërkuar, sistemuar dhe analizuar informacion në përgjigje të çështjeve që hulumtohen në programin mësimor. Qasja kërkimore, kur zbatohet në mënyrë efektive, zhvillon cilësitë historike dhe aftëson nxënësit të jenë të pavarur, krijues dhe mendimtarë kritik. Ajo nxit demonstrimin e kompetencave historike dhe kompetencave kyçe të të nxënit. Tabela e mëposhtme paraqet një përforsim të qasjes kërkimore për të ndihmuar mësuesit në përdorimin e kësaj qasje.

Tabela 5. Përforcimi i qasjes kërkimore

Faza kërkimore	Cilësitë historike të një nxënësi	Qëllimi
1. Bën pyetje historike	<ul style="list-style-type: none"> • Kureshtar 	<p>Më e rëndësishme për procesin e kërkimit është pikënisja. Mësuesit duhet të udhëhiqen nga treguesit e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • angazhojnë interesin e nxënësve; • identifikojnë pyetjet që do të kërkojnë; (një pyetje e përgjithshme kërkimore e ndjekur nga nën-pyetje); • planifikojnë procesin e kërkimit; • përshkruajnë rezultatin.
2. Identifikon dhe gjen burimet përkatëse	<ul style="list-style-type: none"> • I logjikshëm • I balancuar 	<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit vendosin cilat burime janë të dobishme, cilat nuk janë dhe cilat duhen trajtuar me kujdes (me anë të një shembulli mësuesit udhëzojnë paraprakisht nxënësit) • Nxënësit krijojnë fakte dhe dëshmi historike.
3. Analizon lidhjen shkak-pasojë	<ul style="list-style-type: none"> • I logjikshëm • I arsyetuar • I ditur 	<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit analizojnë lidhjet shkak-pasojë për ndërtimin e ngjarjes duke u bazuar në burimet e gjetura.
4. Ndërton interpretime historike, vlerëson burimet dhe jep argumente	<ul style="list-style-type: none"> • I logjikshëm • I balancuar • Metodik • I arsyetuar • I ditur 	<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit mbajnë shënime nga studimi i tyre për burimet. • Nëpërmjet reflektimit dhe diskutimit të drejtuar nga mësuesi, nxënësit janë në gjendje të zhvillojnë përgjigjet për pyetjet hetimore.
5. Kontrollon interpretimet e nxjerra dhe/ose interpretimin e tanishëm historik	<ul style="list-style-type: none"> • I balancuar • I arsyetuar • I ditur 	<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit tregojnë zgjerimin, thellimin dhe transferimin e dijeve të tyre.
6. Shpjegimi dhe komunikimi	<ul style="list-style-type: none"> • I logjikshëm • I arsyetuar • Metodik • I balancuar • I ditur 	<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit shpjegojnë dhe prezantojnë përgjigjet e pyetjeve të tyre nëpërmjet mediave të ndryshme (me shkrim; me gojë; TIK); • Nxënësit respektojnë mendimet e shokëve të tyre qofshin ato dhe të ndryshme nga të tyret.

Nxënësit duhet të nxiten për të ndërmarrë, sipas nivelit që kanë dhe rrethanave, kërkime individuale me qëllim që të stimulohen kërshtëria dhe fryma e tyre vetëvepruese në vjeljen e të dhënave si dhe mendimi i tyre sintetizues.

Në rrafshin grupor të nxënësve, të klasës apo shkollës, zhvillimi i projekteve kërkimore kolektive duhet të nxitet më tej, me qëllim që të krijohen kushtet e dialogut dhe ballafaqimit të hapur e tolerant të mendimeve.

Trajtimi ndërdisiplinor dhe shumëdisiplinor. Mësimi i historisë duhet të përdorë në çdo rast potencialin edukativ të një trajtimi ndërdisiplinor e shumëdisiplinor, duke vendosur lidhje me lëndët e tjera që përbëjnë tërësinë e kurrikulës shkollore, konkretisht me letërsinë, gjeografinë, shkencat shoqërore, përfshirë edhe lëndët shkencore.

Veprimtaritë praktike ose projektet kurrikulare kërkojnë zbatimin e më shumë se një metode dhe teknike, si: kërkimi, intervista, vrojtimi, studimi i rastit, etj. Këto metoda e vënë theksin në ndërtimin e kompetencave të lëndës dhe kompetencave kyçe për të nxënësit gjatë gjithë jetës si dhe në demonstrimin e aftësive/shkathtësive, kryesisht aftësisë së punës me dokumentet historike, punës kërkimore, aftësisë për të punuar në grup, aftësisë për të zgjidhur problemin, etj.

Trajtimi ndërkombëtar dhe ndërkufitar. Sipas rrethanave, kërkohet të përkrahët zbatimi i projekteve ndërkombëtare dhe ndërkufitare, mbështetur mbi studimin e një teme të përbashkët, si dhe trajtimet krahasuese apo kryerja e një detyre të përbashkët në shumë shkolla të vendeve të ndryshme, duke përfituar konkretisht nga mundësitë e reja që japin teknologjitë e informacionit dhe vendosja e lidhjeve dhe këmbimeve shkollore.

Mësimi dhe ruajtja në kujtesë. Krahas nxjerrjes në pah të arritjeve pozitive që kanë karakterizuar shekullin XX, si përdorimi paqësor i shkencave për një art më të mirë të jetuari dhe zhvillimi i demokracisë e të drejtave të njeriut, është e nevojshme të merren të gjitha masat edukative për të parandaluar përsëritjen apo mohimin e ngjarjeve shkatërrimtare që kanë ndodhur gjatë këtij shekulli si: Holokaustin, gjenocidin, spastrimet etnike, krimet e tjera kundër njerëzimit, dhunimet masive të të drejtave të njeriut dhe të vlerave themelore me të cilat është lidhur në mënyrë të veçantë Këshilli i Evropës. *Për këtë qëllim, duhet :*

- të ndihmohen nxënësit për t'u njohur e ndërgjegjësuar me faktet dhe me shkaqet e atyre faktorëve që kanë karakterizuar në mënyrën më të errët historinë e Evropës në veçanti dhe atë të botës në përgjithësi;

- të reflektohet mbi ideologjitë që kanë çuar në to dhe mbi mjetet që bëjnë të mundur të shmangët përsëritja e fakteve të tilla;
- të sigurohet zbatimi i vendimit të ministrave të edukimit (Krakovi2000) lidhur me caktimin në shkolla të një dite përkujtimore të Holokaustit dhe për parandalimin e krimeve kundër njerëzimit;
- të kujtojë ashtu si Evropa, 27 janarin, si ditën përkujtimore të viktimave të Holokaustit dhe 23 gushtin, si ditën përkujtimore për viktimat e regjimeve totalitare naziste dhe komuniste.

Teknologjitë e informacionit e të komunikimit. Në kontekstin e përdorimit shumë të zgjeruar të teknologjive të informacionit dhe komunikimit nga ana e të rinjve, si gjatë jetës së tyre shkollë ashtu edhe jashtëshkollë, ka rëndësi të zhvillohet një pedagogji dhe metodologji që mban parasysh faktin që këto teknologji:

- përbëjnë burimet e pashmangshme në mësimin e historisë ;
- shtrojnë çështje themelore, konkretisht atë të besueshmërisë së burimeve ;
- u lejojnë mësuesve dhe nxënësve të depërtojnë në burime origjinale dhe interpretime të shumëllojta;
- zgjerojnë më së miri mundësinë për t'u futur në informacione dhe të dhëna historike;
- shumëfishojnë dhe lehtësojnë rastet e bashkëpunimit e të dialogut.

Nga ana tjetër, duhet gjithashtu të krijohen kushtet e nevojshme që mësuesi:

- të mund t'u vijë në ndihmë nxënësve gjatë procesit selektiv për të vlerësuar besueshmërinë e burimeve të informacionit;
- të mund të marrë masat e nevojshme për luftën kundër përhapjes së përmbajtjeve raciste, në mënyrë të veçantë nëpërmjet sistemit internet, duke respektuar normat ligjore dhe lirinë e shprehjes;
- të mund të bëjë përpjekje gjatë orës së mësimin për analizë kritike, duke u mbështetur në larmi pikëpamjesh dhe interpretimesh ndërkulturore;
- të mund të nxisë nxënësit për të zhvilluar kompetencat e tyre, si analizat kritike dhe arsyetimin nëpërmjet analogjisë.

Gjatë orëve të ndryshme të mësimi, metodat e teknikat ndërthuren me njëra-tjetrën, aq sa shpesh nuk mund t'i dallosh kufijtë midis tyre, prandaj, vëmendja e veçantë e mësuesit duhet drejtuar te lidhja organike e metodave dhe e teknikave të veçanta që ai përdor brenda një ore mësimi.

Në ndihmë të zbatimit të këtyre metodologjive, në program parashtrihen një sërë veprimtarish të sugjeruara, të cilat i ndihmojnë nxënësit në zotërimin e kompetencave dhe në arritjen e rezultateve të të nxëniti të parashikuara në program.

Mësuesi duhet të tregojnë kujdes të veçantë që nxënësit të nxiten vazhdimisht të reflektojnë në mënyrë kritike mbi ecurinë e të nxëniti dhe punës së tyre në shkollë dhe të transferojnë ata çka kanë mësuar në situata jetësore brenda dhe jashtë shkollës.

Mundësia për të marrë pjesë dhe për të përfituar nga përvojat e lëndës së historisë ashtu si nga çdo lëndë tjetër në shkollë, duhet t'u ofrohet të gjithë nxënësve pa përjashtuar askënd për asnjë shkak. Mësimdhënia duhet të bazohet në interesin më të lartë të nxënësit dhe duhet të sigurojë trajtimin e barabartë me dinjitet e respekt të gjithsecilit.

Nxënësit me nevoja të veçanta

Organizimi i kurrikulës sipas kompetencave, në fusha të nxëni, në shkallë, dhe me fokus integrimin, u krijon mësuesve hapësirat për të përshtatur mësimdhënien sipas nevojave të veçanta të nxënësve dhe për të personalizuar të nxëniti e tyre. Mësuesit duhet të marrin parasysh faktin se nxënësit janë të ndryshëm, kanë motivim, interesa, stile të nxëni, nevoja dhe aftësi të ndryshme etj. Në disa raste duhen bërë përshtatje të kurrikulës sipas diferencave të zhvillimit brenda një grupi moshor. Mësuesit mund të zgjerojnë zhvillimin e kompetencave kyçe si ato të komunikimit, të menduarit dhe shoqërore sipas nevojave individuale të nxënësve, për të zvogëluar dhe zhdukur diferencat brenda një shkalle të kurrikulës, në fund të saj.

Nxënësit me vështirësi në të nxënë

Shumë nxënës me vështirësi arrijnë rezultatet e pritshme të të nxëniti njësoj si nxënësit e tjerë, nëse bëhen përshtatje në mënyrën e mësimdhënies dhe të vlerësimit të tyre.

Për të arritur nivelin më të lartë të mundshëm të realizimit të kompetencës, mund të zhvillohen programe të veçanta, individuale, për nxënësit me nevoja të veçanta.

Në rastin e nxënësve që formalisht janë përcaktuar si të veçantë, është veçanërisht e rëndësishme që stafi i shkollës, në bashkëpunim me prindërit, të mbështesë të nxënërit e tyre. Procedurat dhe teknikat e vlerësimit për nxënës me nevoja të veçanta duhet të diskutohen herë pas here me prindërit dhe vetë nxënësit. Prindërit duhet të kuptojnë se si ndikojnë këto procedura dhe teknika të përshtatura në vlerësimin e punës së nxënësve.

Nxënësit e talentuar

Fleksibiliteti i zhvillimit të programit lejon plotësimin e nevojave individuale të nxënësve të talentuar.

Mësuesit duhet t'u krijojnë kushte dhe situata të tilla që nxënësit të shfaqin dhe të zhvillojnë talentet e tyre. Kjo arrihet nëse atyre u krijohen mundësitë të punojnë me një përmbajtje më të thelluar dhe zgjeruar, të zhvillojnë në mënyrë të vazhdueshme elemente specifike të kompetencave kyçe (p.sh.: aftësitë e nivelit të lartë konjitiv të kompetencës së të menduarit) dhe specifike të fushës, të fokusohen në çështjet kroskurrikulare, të zgjerojnë mjediset dhe materialet e të nxënëit brenda dhe jashtë shkollës.

4.1. Materiale dhe burime mësimore

Përdorimi i mjeteve mësimore në mësimdhënien dhe në procesin e të nxënëit në lëndën e historisë, ndihmon në konkretizimin e ideve dhe të dukurive, në aplikimin e metodave dhe strategjive të mësimdhënies si dhe e bën mësimin më interesant dhe më rezultativ për nxënësit. Përdorimi i suksesshëm i metodave dhe i teknikave të lartpërmendura, nuk mund të realizohet pa mjetet e nevojshme didaktike, të cilat janë të llojeve të ndryshme, si: harta historike të përgjithshme ose tematike, atlase, albume, foto, skica, filma mësimorë, videokaseta, kompjuter, aparat projekcioni, CD, DVD, TIK, etj. Këto mjete po zënë gjithnjë e më shumë vendin që u takon për konkretizimin e një sërë ngjarjesh historike, të cilat janë vështirë të kuptohen pa një konkretizim audioviziv etj.

5. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

Vlerësimi është një aspekt i rëndësishëm i lëndës së historisë. Në përputhje me parimet e qasjes së të nxënësve bazuar në kompetenca, vlerësimi konsiderohet si element i mësimdhënies i cili përqendrohet në nivelin e arritjes së kompetencave, fokusohet në matjen e njohurive e aftësive, në arritjen e rezultateve të të nxënësve dhe në nivelin e përmbushjes së kompetencave. Informacioni i siguruar nga vlerësimi, e ndihmon mësuesin të evidentojë përparimin e nxënësve, të vlerësojë se sa të përshtatshme e të dobishme janë metodat e mësimdhënies që ai përdor, të përmirësojë mësimdhënien dhe t'i pajisë nxënësit me informacionin përkatës për progresin e tyre.

Vlerësimi është një informacion i rëndësishëm që u shërben nxënësve për të ndjekur vetë ecurinë e tyre në këtë lëndë, për të njohur anët e tyre të forta dhe vështirësitë që hasin në zotërimin e njohurive dhe kompetencave, në mënyrë që të punojnë përkatësisht për përfortifikimin dhe kapërcimin e tyre. Vlerësimi është një informacion i rëndësishëm edhe për prindërit, me anë të të cilit ata mund të ndihmojnë më mirë në edukimin e fëmijëve të tyre.

I domosdoshëm është vlerësimi i përmbajtjes të lëndës lidhur me zotërimin e njohurive dhe demonstrimin e aftësive historike nëpërmjet treguesve të besueshëm për progresin e tyre. *(p.sh. vetëvlerësimi, intervistë me një listë treguesish, testi objektiv, vëzhgimi i kërkimit historik me një listë të saktë treguesish, prezantimi me gojë ose me shkrim, projekti kurrikular etj.)*

Në përzgjedhjen e praktikave të vlerësimit, në përcaktimin e kohës së përshtatshme, në përzgjedhjen e materialeve për vlerësim mësuesi duhet të ketë parasysh:

- përcaktimin e qëllimit dhe strategjisë së vlerësimit;
- përzgjedhjen e veprimtarive, që mundësojnë demonstrimin e arritjes së kompetencave;
- përdorimin e vlerësimit për të verifikuar çfarë dinë aktualisht nxënësit;
- dallimin qartë të qëllimit të detyrës së zgjedhur për vlerësim.

Vlerësimi i nxënësve duhet të nxjerrë në pah arritjet e tyre, në mënyrë që ata të inkurajohen të mësojnë me më shumë dëshirë. Ai duhet të konsiderohet si një mjet në ndihmë të nxënësve, i cili i ndihmon ata të njohin më mirë aftësitë e tyre në të nxënë, të zhvillojnë e të përdorin talentet dhe aftësitë në mënyra sa më të dobishme. Nxënësit vetë duhet të jenë pjesë e procesit të vlerësimit të arritjeve të tyre. Me anë të vlerësimit, mësuesi informohet rreth çfarë dhe si po mësojnë nxënësit, çka e ndihmon atë të planifikojë mësimdhënien në vijim dhe të përgatisë materiale ose të rishikojë metodologjinë e mësimdhënies për t'iu përshtatur nevojave të nxënësve. Vlerësimi nga ana e mësuesit duhet të marrë në konsideratë edhe aftësinë e nxënësve për të përcaktuar e arritur objektiva për veten.

Mësuesi i historisë vlerëson saktësinë e informacionit të paraqitur nga nxënësit, aftësitë e tyre për të diskutuar, debatuar, krahasuar, argumentuar dhe parashikuar, duke mbajtur qëndrim vetjak ndaj një ngjarjeje ose figure të caktuar historike. Në lëndën e historisë, mësuesi duhet të vlerësojë aftësinë e nxënësve për të punuar në grup si dhe aftësinë e tyre për të vlerësuar nga secili nxënës punën e anëtarëve të tjerë të grupit.

Mësuesi i historisë duhet të vlerësojë përdorimin e burimeve alternative nga nxënësit, ballafaqimin e tyre dhe forcën argumentuese ndaj një çështjeje të diskutueshme ose të debatueshme në histori. Kriter vlerësimi për nxënësit në lëndën e historisë është edhe përfshirja e tyre në debat, duke respektuar mendimet e kundërta të njëri-tjetrit, të bazuara mbi argumente ose fakte historike.

a. Vëzhgimi

Mësuesi vlerëson ecurinë e nxënësve duke i vëzhguar ata gjatë punës individuale ose në grup si dhe ndërveprimin e tyre gjatë veprimtarive të ndryshme në klasë dhe në shkollë. *Mësuesi vëzhgon aspekte të tilla si:*

- aftësinë e nxënësve për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për të bashkëpunuar në grup;
- ndërveprimet e nxënësve me njëri-tjetrin dhe me të rriturit;
- cilësinë e prezantimit të punimeve;
- interesat, aftësitë ose talentet e veçanta të nxënësve;
- pjesëmarrjen dhe interesin që shprehin nxënësit në veprimtari e aktivitete të ndryshme;
- përgjegjësinë vetjake dhe shoqërore që shfaqin nxënësit;

- përkushtimin dhe këmbënguljen e nxënësve në kryerjen e detyrave të ndryshme;
- nivelin e ndërjegjësimit të nxënësve për vështirësitë që mund të kenë të tjerët dhe gatishmërinë për t'i ndihmuar ata;
- pyetjet që shtrojnë nxënësit, përgjigjet dhe sugjerimet që nxënësit u japin pyetjeve të mësuesit dhe nxënësve të tjerë;
- sjellje të caktuara, si: aftësitë drejtuese, niveli i vetëbesimit, të shprehurit në mënyrë të drejtpërdrejtë e të hapur, gatishmëria për të përballuar rreziqe, sfida e vështirësi;
- pjekurinë fizike dhe emocionale;
- aftësinë për të vetë-vlerësuar ecurinë në shkollë.

Mësuesi mund t'i mbajë shënim vëzhgimet për secilin nxënës, në mënyrë që të mund të krijojë një pamje të përgjithshme të ecurisë së zhvillimit të tyre. Kjo i shërben mësuesit edhe për t'ia komunikuar ecurinë e nxënësve prindërve të tyre ose në raste kur nxënësi ndryshon shkollë, ky lloj vlerësimi mund të ndahet me mësuesin e ri ose me mësuesit pasues të ciklit në vijim.

Vëzhgimi ndihmon vetë mësuesin i cili, pasi ka kuptuar nevojat e veçanta të secilit nxënës, duhet të rishikojë metodologjitë e mësimdhënies, në mënyrë që ato të lehtësojnë të nxënësit e gjithsecilit.

b. Detyrat dhe testet

Me anë të detyrave të ndryshme që mësuesi u jep nxënësve në klasë, ai arrin të vlerësojë si procesin e punës, ashtu edhe nivelin e të kuptuarit të njohurive të reja nga ana e nxënësve. Me anë të detyrave, mësuesi mund të vlerësojë edhe aftësinë e nxënësve për t'i përdorur dijet e marra në situata nga më të ndryshmet. Detyrat në klasë mund të jenë projekte në grup ose punë individuale.

Një shembull i detyrës në klasë mund të jetë dhënia e një situatë, e cila kërkon zgjidhje, ku nxënësit duhet të marrin një vendim së bashku dhe ta mbrojnë atë. Gjatë punës në grup të nxënësve, mësuesi vlerëson demonstrimin e kompetencave dhe aftësinë e gjithsecilit për të punuar në grup.

Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin e komunikimit me shkrim dhe mund të realizohet jo vetëm me laps e letër, por edhe në rrugë elektronike. Mësuesi planifikon testime periodike me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimore, që përbëhen nga një ose disa tematika, të cilët i bashkojnë rezultate të ndërlidhura të të nxënësit. Në përshtatje me qëllimin e vlerësimit me shkrim, ai përdor lloje të ndryshme

testesh, që nga minitestet pak minutëshe për një objektiv të veçuar të të nxënësve, tek ato një orësh, teste me alternativa ose me zhvillim, detyra tematike, projekte kurrikulare etj. Një formë e parashtrimit me shkrim nga nxënësiti është edhe testimi përfundimtar.

Mësuesi mund t'i përdorë testet me shkrim në fund të një tematike si një teknikë vlerësimi dhe vetëvlerësimi nga ana e nxënësve, pra t'i lejojë ata t'i korrigjojnë vetë testet për të reflektuar e për t'u ndërgjegjësuar mbi aftësitë e tyre dhe vështirësitë që ata hasin.

c. Projektet

Projektet i ndihmojnë nxënësiti të përqendrohen në një temë të caktuar të programit, për shembull në njohjen e komunitetit ku ata jetojnë dhe studimin e tij në detaje. Me anë të projektit, mësuesi vlerëson aftësinë e nxënësve për të kërkuar informacion, për të mbledhur, për ta përpunuar dhe për ta prezantuar atë. Puna me projekte mundëson edhe vlerësimin e bashkëpunimit të nxënësve me njëri-tjetrin gjatë punës grup. Realizimi i një projekti është tregues edhe i përgjegjësisë vetjake dhe të grupit si dhe i përkushtimit dhe interesit të secilit nxënës.

d. Paraqitja dhe prezantimi i punimeve

Shpjegimi, paraqitja dhe prezantimi i punimeve të ndryshme që nxënësiti realizojnë gjatë lëndës së historisë është për mësuesin tregues i aftësive të tyre për të mbledhur informacion, për ta përpunuar dhe për ta paraqitur atë. Gjatë paraqitjes dhe prezantimit të punimeve, nxënësiti vlerësohen edhe për shtjellimin e këndvështrimeve të tyre, mbrojtjen e këtyre këndvështrimeve dhe mbajtjen e qëndrimit vetjak ose në grup ndaj një çështjeje të caktuar. Me anë të kësaj teknike vlerësohen kompetencat historike dhe kompetencat kyçe si ajo e komunikimit dhe e të menduarit. Në punimet e nxënësve me grupe të vogla, mësuesi/ja parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënës në veçanti. Mësuesi nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimore dhe të vendosë nota në regjistër për secilën orë mësimore. Si rregull, nxënësiti dhe mësuesiti duhet të bashkëbisedojnë lirshëm, si partnerë, rreth përvetësimit të njohurive të fituara në orët e kaluara dhe kryerjes sa më mirë të detyrave jashtë klase. Herë pas here mësuesi duhet të vlerësojë me notë, duke ua bërë të qartë nxënësve që në fillim qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

Pavarësisht zgjedhjes nga ana e mësuesiti të teknikave të vlerësimit, qofshin këto formale ose joformale, vlerësimi duhet domosdoshmërisht të synojë përmirësimin e përvojave të të nxënësve të nxënësve. Vlerësimi i nxënësiti përshkon gjithë procesin mësimor

dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënësit nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Nxënësi vlerësohet me notë, ndërsa demonstroi arritjet e tij me gojë, me shkrim ose nëpërmjet veprimtarive dhe produkteve të tjera, si: veprimtari praktike, raste studimore, shkrimi i një eseje, prodhimi i një CD-je, hartimi i një maketi për një ngjarje ose figurë të caktuar historike, projekte etj.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në njohuritë/aftësitë/qëndrimet e programit lëndor dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato njohuri, aftësi dhe qëndrime që nuk përshkruhen në program.

ANEKS 1

Me qëllim që t'u vijë në ndihmë autorëve të teksteve të historisë dhe mësuesve të historisë në realizimin me sukses të këtij programi, në përvetësimin e dijeve dhe demonstrimin e kompetencave të lëndës dhe kompetencave kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës, paraqiten në këtë aneks, Rekomandimet Rek (2001)15 e Komitetit të Ministrave të Shteteve anëtare lidhur me mësimin e historisë në Evropën e shekullit të XXI.

Recommendation Rec(2001)15 of the Committee of Ministers to member states on history teaching in twenty-first-century Europe

KËSHILLI I EVROPËS

KOMITETI I MINISTRAVE

Rekomandimet Rek (2001)15 e Komitetit të Ministrave të Shteteve anëtare lidhur me mësimin e historisë në Evropë në shekullin XXI

(miratuar nga Komiteti i Ministrave, me 31 tetor 2001, në mbledhjen 771 të të Deleguarve të Ministrave)

Komiteti i Ministrave, në bazë të nenit 15.b. të Statutit të Këshillit të Evropës,

- duke pasur parasysh se qëllimi i Këshillit të Evropës është të realizojë një bashkim përherë e më të ngushtë midis anëtarëve të tij;
- duke vlerësuar Konventën kulturore evropiane nënshkruar në Paris, më 19 dhjetor 1954, që u bën thirrje shteteve të saj nënshkruese të nxisin studimin e historisë dhe të qytetërimit të palëve të tjera kontraktuese dhe ta zhvillojë atë në territorin e këtyre palëve kontraktuese ;
- duke rikujtuar Samitet e Vjenës (1993) dhe të Strasburgut (1997), gjatë të cilave kryetarët e shteteve e të qeverive të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës :

- ✓ shprehën dëshirën ta shohin Këshillin e Evropës plotësisht në gjendje të ndihmojë për të përballur sfidat e shoqërisë së shekullit XXI ;
- ✓ shprehën nevojën për të përforcuar mirëkuptimin e ndërsjellë dhe besimin midis popujve, në mënyrë të veçantë nëpërmjet një programi për mësimin e historisë, duke synuar heqjen e paragjykimëve dhe vlerësimin e ndikimeve pozitive të ndërsjella midis vendeve, feve e ideve të ndryshme, gjatë zhvillimit historik të Evropës;
- duke theksuar se falsifikimet dhe manipulimet ideologjike të historisë janë të papajtueshme me parimet themelore të Këshillit të Evropës përcaktuar nga Statuti i tij ;
- duke vlerësuar rekomandimet e Asamblesë parlamentare lidhur me përmasën evropiane të edukimit (Rekomandimi 1111 (1989)), përsa i përket historisë dhe mësimin të historisë në Evropë (Rekomandimi 1283 (1996)) ;
- duke rikujtuar Rezolutën n° 1 miratuar gjatë sesionit të 19-të të konferencës së përhershme të ministrave evropianë të edukimit lidhur me temën « Prirje dhe përputhshmëri për edukimin në Evropë » (Kristiansand, Norvegji, 1997), si dhe konkluzionet e rezolutat e sesionit 20-të të Konferencës së përhershme të ministrave evropianë të Edukimit lidhur me projektin « Të mësojmë e të shpjegojmë historinë e Evropës së shekullit XX » (Krakovi, Poloni, 2000) ;
- duke rikujtuar deklaratën e miratuar gjatë Konferencës informale të ministrave të Edukimit të Evropës Jug-Lindore, (Strasburg, 1999) me anë të së cilës u rekomandua të ndërmerren aksione pragmatike në fushat për të cilat Këshilli i Evropës ka një përvojë të gjatë e të njohur, konkretisht ndër të tjera mësimin e historisë ;
- duke marrë në konsideratë deklaratën e miratuar gjatë Konferencës rajonale të ministrave të Edukimit të shteteve të Kaukazit (Tbilisi, Gjeorgji, 2000) ;
- nisur nga Rekomandimi n° R (98) 5 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve anëtare lidhur me pedagogjinë trashëgimore, në të cilin Ministrat pohojnë se aksionet pedagogjike mbi trashëgiminë janë mjet i privilegjuar për t'i dhënë kuptim së ardhmes nëpërmjet një vështrimi më të mirë të së shkuarës ;
- duke u mbështetur në Rezolutën (98) 4 të Komitetit të Ministrave për itineraret kulturore të Këshillit të Evropës ;

- duke pasur parasysh Rekomandimin n° R (2000)1 të Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve anëtare mbi nxitjen e bashkëpunimit ndërkufitar midis kolektiviteteve apo autoriteteve territoriale në fushën kulturore, në të cilin ministrat theksojnë se veprimtaritë ndërkufitare u vijnë të rinjve në ndihmë për të krijuar një përfytyrim të ndërkufishëm, duke i bërë ata të ndjeshëm ndaj larmisë së traditave kulturore e historike ;
- nisur nga rezolutat e Konferencës së 5^{-të} evropiane të ministrave përkatës të trashëgimisë kulturore (Portorož, Slloveni, 2001), në të cilat ministrat theksuan edhe një herë se mësimi i historisë duhet të mbështetet mbi kuptimin dhe shpjegimin e trashëgimisë, dhe të nxjerrë në pah karakterin ndërnacional të trashëgimisë ;
- duke pasur parasysh Rekomandimin n° R (2000) 13 të Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve anëtare për një politikë evropiane në fushën e komunikimit të arkivave, në të cilin ministrat, pasi vërejnë interesin në rritje të publikut për historinë dhe pasi theksojnë se një njohje më e mirë e historisë evropiane të vonshme mund të ndihmojë në parandalimin e konflikteve, bëjnë thirrje për një politikë evropiane në fushën e komunikimit të arkivave, mbështetur mbi parime që janë në përputhje me vlerat demokratike ;
- duke pasur në konsideratë Rekomandimin n° R (97) 20 të Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare lidhur me « gjuhën e urrejtjes », në të cilin gjuha e urrejtjes përkufizohet si përcaktuese e të gjitha formave shprehëse që përhapin, nxitin, shtyjnë a përlligjin urrejtjen racore, ksenofobinë apo antisemitizmin, dhe në të cilin ministrat vërejnë se gjuha e urrejtjes mund të ketë një efekt më të dëmshëm kur përhapet nëpërmjet mediave;
- duke mos harruar punimet e mëparshme të Këshillit të Evropës në fushën e mësimin të historisë që mbështeten mbi idenë e ri pajtimit e të ndikimeve të ndërsjella pozitive midis popujve si punimet e kryera në periudhën e pasluftës, të cilat e vunë theksin në heqjen nga tekstet e historisë të njëanshmërive e paragjykimeve, punimet e njëpasnjëshme të projektit « Historia në Evropën e re », dhe programin « Mësimi i historisë dhe nisma e re e Sekretarit të Përgjithshëm », program që ndihmoi republikat e ish-Bashkimit sovjetik në përpunimin e metodologjive për modernizimin e mësimin të historisë, në nxjerrjen e teksteve të reja dhe rrjedhimisht ri përshtatjen e formimit të mësuesve ;

- duke u njohur me përfundimet e projektit « Të mësojmë e të shpjegojmë historinë e Evropës së shekullit XX » dhe me tërësinë e materialit pedagogjik në përdorim të mësuesve, që u paraqitën gjatë Konferencës përfundimtare të projektit « Vështrime të kryqëzuara mbi shekullin XX », mbajtur simbolikisht në Shtëpinë e Historisë së Republikës federale të Gjermanisë (Haus der Geschichte, Bon, Gjermani, 2001);
- duke vërejtur se projekti « Të mësojmë e të shpjegojmë historinë e Evropës së shekullit XX » lejoi ndër të tjera:
 - ✓ të bëhen përparime të ndjeshme në përpunimin e një koncepti pluralist e tolerant të mësimi të historisë, konkretisht nëpërmjet zhvillimit të aftësive kërkimore individuale dhe analizës;
 - ✓ të vihen në dukje novacionet pedagogjike mbështetur si në teknologjitë e informacionit, ashtu edhe në burimet e reja didaktike;
 - ✓ të përpunohen shembuj trajtesash të hapura për çështjet e brishta të historisë së Evropës së shekullit XX.

U rekomandon qeverive të shteteve anëtare, brenda strukturave të tyre kushtetuese, rrethanave kombëtare a vendore dhe sistemit të tyre edukativ:

- të frymëzohen nga parimet që parashtrohen në shtojcën e këtij rekomandimi, në kuadrin e reformave të mësimi të historisë së sotme a të ardhme dhe të reformave lidhur me formimin e mësuesve të historisë;
- të bëjnë të mundur që, sipas procedurave të përshtatshme kombëtare, rajonale dhe lokale, organizmat e duhura publike e private të vendit të tyre të vihen në dijeni të parimeve që theksohen në këtë rekomandim nëpërmjet dokumenteve referues që përbëjnë bazën e tyre, veçanërisht tërësia e materialeve pedagogjike të përpunuara nga projekti « Të mësojmë e të arsimojmë historinë e Evropës së shekullit XX »;
- të zhvillojnë, sipas modaliteteve që duhen përcaktuar, veprimtari në fushën e mësimi të historisë, me qëllim që të forcohen marrëdhëniet e besimit e të tolerancës në gjirin e vetë shteteve dhe ndërmjet tyre, dhe t'u bëhet ballë sfidave të shekullit XXI;
- të përdorin gjithashtu, në mënyrë të integruar, projekte të tjera të Këshillit të Evropës, në mënyrë të veçantë atë të « Edukimit me qytetari demokratike » dhe punimet e realizuara në fushën e trashëgimisë kulturore;

I kërkon Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës t'ua bëj të ditur këtë rekomandim Shteteve palë të Konventës kulturore evropiane që nuk janë anëtare të Këshillit të Evropës.

Shtojcë për Rekomandimin Rek (2001)15

1. Objektivat e mësimit të historisë në shekullin XXI

Mësimi i historisë në një Evropë demokratike:

- duhet të zërë një vend themelor për formimin e individit si qytetar përgjegjës e aktiv për zhvillimin e respektit për tërë llojet e dallimeve, respekt i mbështetur mbi mirëkuptimin e identitetit kombëtar dhe të parimeve të tolerancës;
- duhet të jetë një faktor vendimtar pajtimi, mirënjohjeje, mirëkuptimi e besimi të ndërsjellë midis popujve;
- duhet të luajë rol kryesor në zhvillimin e vlerave të tilla themelore si toleranca, mirëkuptimi reciprok, të drejtat e njeriut dhe demokracia;
- duhet të përbëjë një nga elementët thelbësorë në ndërtimin e Evropës së bashkuar duke u bazuar në trashëgiminë historike e kulturore të përbashkët, pasuruar me larminë që e karakterizon, qoftë edhe në aspektet e veta konfliktuale dhe shpesh dramatike;
- duhet të jetë pjesë e një politike arsimore e cila luan një rol të drejtpërdrejtë në përparimin dhe zhvillimin e të rinjve, në perspektivën e ndërtimit, së bashku me ta, të një Evrope të së nesërme, si dhe me zhvillimin paqësor të shoqërive njerëzore në një perspektivë globale, brenda frymës së mirëkuptimit dhe besimit të ndërsjellë;
- duhet të lejojë të zhvillohet tek të rinjtë aftësia intelektuale për të analizuar e interpretuar informacionin në mënyrë kritike dhe me përgjegjshmëri, nëpërmjet dialogut, nëpërmjet kërkimit të dëshmive historike dhe nëpërmjet debatit të hapur e të bazuar në perspektivë të shumëfishta, sidomos për çështje të ndjeshme e të diskutueshme historike;
- duhet t'i lejojë qytetarit evropian të nxjerrë në pah identitetin e vet individual e kolektiv, nëpërmjet trashëgimisë së përbashkët historike në dimensionet e saj lokale, rajonale, kombëtare, evropiane dhe globale;
- duhet të jetë një instrument për parandalimin e krimeve kundër njerëzimit.

2. Shtrembërimet e historisë

Mësimi i historisë nuk mund të jetë mjet manipulimi ideologjik, propagande apo nxitjeje të vlerave ultranacionaliste, ksenofobe, raciste apo antisemitiste e jotolerante.

Kërkimet historike dhe vetë historia që mësohet në shkollë, në asnjë rast, dhe me çfarëdo qëllimi qoftë, nuk mund të pajtohen me vlerat themelore dhe Statutin e Këshillit të Evropës po qe se ato lejojnë a popullarizojnë paraqitje të gabuara të historisë, nëpërmjet njërës a tjetrit prej mashtrimeve të mëposhtme :

- falsifikimit të fakteve historike, statistikave të rreme, pamjeve të trukuara, etj.;
- ngulimit mbi një ngjarje të caktuar për të përlligjur a fashitur një ngjarje tjetër;
- shtrembërimit të së shkuarës për qëllime propagande;
- interpretimit të tepruar nationalist të së shkuarës, që mund të krijojë "ne" dhe "ata", ndarje në dy pjesë;
- shtrembërimeve burimore historike;
- mohimit të fakteve historike;
- mosveprimi me fakte të vërteta historike.

3. Dimensioni evropian në mësimin e historisë

Duke qenë se ndërtimi evropian është, sa shprehje e një vendimi të hyrë lirshëm nga vetë evropianët, po aq sa dhe një realitet historik, do të ishte e përshtatshme në këtë rast:

- të nxirren në pah marrëdhëniet historike të vijueshme midis rrafshëve lokale, rajonale, kombëtare e evropiane;
- të mbështetet mësimi i çasteve apo fakteve të historisë, përmasa evropiane e të cilave është e dukshme – në mënyrë të veçantë ngjarjet dhe rrymat historike e kulturore themeluese të ndërgjegjes evropiane;
- të zhvillohen me të gjitha mjetet e mundshme, veçanërisht nëpërmjet teknologjive të informacionit, projektet e bashkëpunimit e të këmbimit midis shkollave mbi tema që kanë të bëjnë me historinë e Evropës;
- të rritet interesi i nxënësve për historinë e vendeve të tjera evropiane;

- të prezantohen dhe zhvillohen mësimdhënie në lidhje me historinë e ndërtimit të vetë Evropës.

Për të zhvilluar përmasën evropiane gjatë mëimit të historisë në një Evropë të zgjeruar, demokratike e paqësore, lypset:

- të mbahen parasysh rezultatet e punimeve të kryera në kuadrin e projektit “Të mësojmë e të arsimojmë historinë e Evropës së shekullit XX” të Këshillit të bashkëpunimit kulturor, si në përmbajtjen e tyre, ashtu edhe në trajtimin metodologjik;
- të ndërmerren, mbi bazën e programeve të Këshillit të Evropës, nisma lidhur me reformën e mëimit të historisë dhe përpunimin e teksteve të reja, si dhe të udhëzuesve metodologjikë, në kuadrin e veprimtarive për zhvillimin dhe forcimin e stabilitetit demokratik;
- të ndërmerren, mbi bazën e programeve të Këshillit të Evropës, nisma lidhur me sensibilizimin dhe pedagogjinë e trashëgimisë;
- të veprohet për shpërndarjen sa më të gjerë të materialit pedagogjik krijuar në kuadrin e projektit “Të mësojmë e të shpjegojmë historinë e Evropës së shekullit XX”, duke përdorur teknologjitë e duhura të informacionit dhe komunikimit;
- të fuqizohet ndihma për përgatitjen e programeve të reja shkollore dhe të normave për mësimdhënien e historisë, duke përfshirë përpunimin e teksteve të reja shkollore, konkretisht në Federatën e Ruisë, në vendet e Kaukazit, të Evropës Jug-Lindore dhe të rajonit të Detit të Zi;
- të përfitohet nga programi i Këshillit të Evropës për formimin e vazhdueshëm të personelit edukativ, me qëllim që të fitohen njohuri të reja në një kontekst evropian, gjatë të cilit mësuesit të mund të ballafaqojnë pikëpamjet dhe përvojat e tyre.

4. Përmbajtja e programeve

Mësimdhënia e historisë, ndërkohë që duhet të shmangë akumulimin e njohurive enciklopedike, duhet të përfshijë:

- sensibilizimin lidhur me përmasën evropiane, të mbajtur parasysh që gjatë përpunimit të programeve dhe kjo, me qëllim që nxënësit të fitojnë një “ndërgjegje evropiane” të hapur mbi botën;
- zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, të një gjykimi të pavarur e objektiv, dhe kundërvënien ndaj manipulimeve;
- ngjarjet dhe çastet e shënuara të historisë së Evropës, studiuar në rrafshet vendore, kombëtare, evropiane e botërore nëpërmjet periudhave dhe fakteve veçanërisht domethënëse;

- studimin e të gjitha dimensioneve të historisë së Evropës, jo vetëm politike, por edhe ekonomike, shoqërore e kulturore;
- zhvillimin e frymës kërkimore dhe të kërkërisë, konkretisht duke përdorur pedagogjinë e njohjes, në kuadrin e studimit të trashëgimisë, që lejon në këtë mënyrë të nxirren në pah ndikimet ndërkulturore;
- zhdukjen e paragjytimeve dhe stereotipive, duke theksuar në programe ndikimet e ndërsjella pozitive midis vendeve të ndryshme, feve dhe shkollave doktrinarë në zhvillimin historik të Evropës;
- studimin kritik të shtrembërimeve të historisë, qoftë nëpërmjet mohimit të një fakti të dukshëm historik, qoftë nëpërmjet falsifikimit, shmangies, mosnjohjes, apo përdorimit ideologjik;
- studimin e çështjeve të diskutueshme, nëpërmjet mbajtjes parasysht të fakteve, të mendimeve e të pikëpamjeve të ndryshme, si dhe kërkimit të së vërtetës.

5. Metodatat e mësimin

Përdorimi i burimeve

Do jetë me vend të përdoren burimet didaktike më të larmishme për njohjen e fakteve historike dhe mësimin e tyre kritik e analitik e, në mënyrë të veçantë:

- arkivat, të hapura për publikun, veçanërisht në vendet e Evropës qendrore e lindore, duke lejuar në këtë mënyrë të shfrytëzohen tashmë dokumente origjinale, kur asnjëherë më parë nuk ka ndodhur një gjë e tillë;
- kinemaja dhe prodhimtaria audiovizuale, qoftë dokumentare, qoftë fantastike;
- teknologjitë e informacionit, që duhet të përbëjnë objektin e një trajtimi kritik, individual e kolektiv, për të cilin mësuesi luan një rol themelor;
- llojet e ndryshme të muzeve të shekullit XX, ngritur gjithandej nëpër Evropë, dhe vendet përkujtimore, që ndikojnë në përkapjen në mënyrë të qartë nga ana e nxënësve të ngjarjeve të fundit, konkretisht në përmasën e tyre të përditshme;
- historia gojore, me anë të së cilës dëshmitë gojore për ngjarjet e fundit historike mund ta bëjnë historinë më të gjallë në sytë e të rinjve, si dhe mund t'u lënë vend pikëpamjeve e perspektivave të atyre që nuk kanë marrë pjesë në « historinë e shkruar ».

Kërkimi individual

Nxënësit duhet të nxiten për të ndërmarrë, sipas nivelit që kanë dhe rrethanave, kërkime individuale, me qëllim që të stimulohen kërshtëria dhe fryma e tyre vetëvepruese në vjeljen e të dhënave si dhe mendimi i tyre sintetizues.

Kërkimi kolektiv

Në rrafshin grupor të nxënësve, të klasës apo shkollës, zhvillimi i projekteve kërkimore a arsimore aktive duhet të nxitet më tej, me qëllim që të krijohen kushtet e dialogut dhe ballafaqimit të hapur e tolerant të mendimeve.

Trajtimi ndërdisiplinor dhe shumëdisiplinor

Mësimi i historisë duhet të përdorë në çdo rast potencialin edukativ të një trajtimi ndërdisiplinor e shumëdisiplinor, duke vendosur lidhje me disiplinat e tjera që përbëjnë tërësinë e programit shkollor, konkretisht me letërsinë, gjeografinë, shkencat shoqërore, filozofinë, artet, përfshirë edhe disiplinat shkencore.

Trajtimi ndërkombëtar dhe ndërkufitar

Sipas rrethanave, lypset të përkrahët zbatimi i projekteve ndërkombëtare dhe ndërkufitare, mbështetur mbi studimin e një teme të përbashkët si dhe trajtimet krahasuese apo kryerja e një detyre të përbashkët në shumë shkolla të vendeve të ndryshme, duke përfituar konkretisht nga mundësitë e reja që japin teknologjitë e informacionit dhe vendosja e lidhjeve dhe këmbimeve shkollore.

6. Mësimi dhe ruajtja në kujtesë

Krahas nxjerrjes në pah të arritjeve pozitive që kanë karakterizuar shekullin XX, si përdorimi paqësor i shkencave për një art më të mirë të jetuari dhe zhvillimi i demokracisë e të drejtave të njeriut, është e nevojshme të merren të gjitha masat edukative për të parandaluar përsëritjen apo mohimin e ngjarjeve shkatërrimtare që kanë ndodhur gjatë këtij shekulli, domethënë Holokaustin, gjenocidin dhe krimet e tjera kundër njerëzimit, spastrimet etnike, dhunimet masive të të drejtave të njeriut dhe të vlerave themelore me të cilat është lidhur në mënyrë të veçantë Këshilli i Evropës. Për këtë qëllim:

- duhet të ndihmohen nxënësit për t'u njohur e ndërgjegjësuar me faktet dhe me shkaqet e tyre që kanë karakterizuar në mënyrën më të errët historinë e Evropës në veçanti dhe atë të botës në përgjithësi;

- duhet të reflektohet mbi ideologjitë që kanë çuar në to dhe mbi mjetet që bëjnë të mundur të shmangët përsëritja e fakteve të tilla;
- duhet të orientohen, zhvillohen e bashkërendohen programet e formimit të vazhdueshëm të personelit edukativ në shtetet anëtare të Këshillit të bashkëpunimit kulturor;
- duhet të lehtësohet futja në dokumentacionin që zotërohet për këtë temë, duke përdorur konkretisht burimet e teknologjive të reja dhe të zhvillohet një rrjet qendrash burimore pedagogjike në këtë fushë;
- duhet të sigurohet zbatimi, ndjekja dhe kontrolli i vendimit të ministrave të Edukimit (Krakovi2000) lidhur me caktimin në shkolla të një dite përkujtimore të Holokaustit dhe për parandalimin e krimeve kundër njerëzimit, në përshtatje me historinë e secilit vend anëtar;
- duhet të pasurohet ndihma e veçantë e Këshillit të Evropës në fushën arsimore brenda Task Forces për bashkëpunimin ndërkombëtar lidhur me mësimin e Holokaustit, përkujtimin dhe kërkimin.

7. Formimi paraprak e i vijueshëm i mësuesve të historisë

Formimi i veçantë dhe i vijueshëm i mësuesve të historisë:

- duhet të formojë e të nxisë mësuesit e historisë për të përdorur metoda komplekse për orën e historisë, duke u thelluar në reflektimin dhe duke u mbështetur në kërkimin;
- duhet të synojë që mësuesit e historisë dhe ata që tashmë janë përfshirë në jetën aktive të njohin tërë produktet, mjetet dhe metodat e fundit, veçanërisht përdorimin e teknologjive të informacionit e komunikimit;
- duhet t'i bëjë mësuesit të ndjeshëm për të zbatuar praktika pedagogjike të cilat, mbi bazën e të dhënave faktike dhe përtej tyre, synojnë që nxënësit të arrijnë të interpretojnë e analizojnë faktet historike dhe ndikimin e tyre mbi të tashmen, në kontekste të ndryshme shoqërore, gjeografike, ekonomike, etj.;

- duhet t'i ndihmojë mësuesit të zbatojnë praktika vlerësuese, të cilat mbajnë parasysh jo vetëm të dhënat që memorizojnë nxënësit, por edhe veprimtaritë që ata janë në gjendje të ndërmarrin, mbi bazën e njohjes të të dhënave në fjalë, si kërkimet, debatet apo analizat e çështjeve për diskutim;
- duhet t'i ndihmojë të konceptojnë e të realizojnë në klasa situata mësimi të një natyre ndërdisiplinore, në bashkëpunim me kolegët e tyre.

Duke qenë se teknologjitë e informacionit dhe komunikimit çojnë në shndërrimin e rolit të mësuesve të historisë, është e rëndësishme:

- të krijohen pika këmbimi, me qëllim që mësuesit të njihen me gamën e gjerë të situatave mësimore në të cilat integrohen rolet e reja në fjalë;
- të mbështetet krijimi i grupeve për kapërcimin e vështirësive, ngurrimeve dhe dyshimeve profesionale lidhur me këto praktika të reja pedagogjike;
- të zhvillohen bankat burimore, që paraqesin jo vetëm dokumentet dhe rrjetet e zotërueshme, por edhe vlerën e informacioneve të ardhura nga këto burime dhe dokumente.

Me qëllim që të arrihen këto objektiva dhe të përcaktohet profili i veçantë i mësimi të historisë, lypset:

- t'u jepet institucioneve për formimin e mësuesve të historisë mbështetja e nevojshme për të ruajtur e përmirësuar cilësinë e formimit të tyre, dhe për të zhvilluar profesionalizmin, e në mënyrë të veçantë statusin shoqëror të mësuesve të historisë;
- t'i kushtohet vëmendje e posaçme formimit të mësuesve të historisë sipas parimeve që përmban ky rekomandim;
- të nxiten kërkimet krahasuese lidhur me këto objektiva, struktura e norma të formimit të veçantë, paraprak e të vijueshëm të mësuesve të historisë dhe mbi bazën e kësaj, të gjallërohet bashkëpunimi institucional dhe këmbimi i informacioneve sipas nevojave të domosdoshme për reformat e formimit paraprak e të vijueshëm të mësuesve të historisë;
- të krijohen e fuqizohen partneritetet në tërësinë e institucioneve aktive në fushën e formimit të mësuesve të historisë apo që kanë të bëjnë me këtë formim (veçanërisht mediat), me qëllim që të nxirret në pah misioni dhe përgjegjësia e tyre e veçantë.

8. Teknologjitë e informacionit e të komunikimit

Duke respektuar normat ligjore dhe lirinë e shprehjes, lypset të merren masat e nevojshme për luftën kundër përhapjes së përmbajtjeve raciste, ksenofobe apo revizioniste, në mënyrë të veçantë nëpërmjet sistemit Internet.

Në kontekstin e përdorimit shumë të zgjeruar të teknologjive të informacionit dhe komunikimit nga ana e të rinjve, si gjatë jetës së tyre shkollore ashtu edhe jashtëshkollore, ka rëndësi të zhvillohet një pedagogji dhe metodologji që mban parasysh faktin që këto teknologji:

- përbëjnë burimet e pashmangshme në mësimin e historisë;
- shtrojnë çështje themelore, konkretisht atë të besueshmërisë së burimeve;
- u lejojnë mësuesve dhe nxënësve të depërtojnë në burime origjinale dhe interpretime të shumëllojta;
- zgjerojnë më së miri mundësinë për t'u futur në informacione dhe të dhëna historike;
- shumëfishojnë dhe lehtësojnë rastet e bashkëpunimit e të dialogut.

Nga ana tjetër, do duhet gjithashtu të krijohen kushtet e nevojshme që mësuesit:

- të mund t'u vijnë në ndihmë vetë nxënësve, gjatë procesit selektiv, për të vlerësuar besueshmërinë e burimeve të informacionit dhe vetë informacionet si të tilla;
- të mund të bëjnë gjatë orës së mësimin përçapje për analizë kritike, duke u mbështetur në larmi pikëpamjesh dhe interpretimesh ndërkulturore;
- të mund të nxisin nxënësit për të zhvilluar kompetencat e tyre, si analizat kritike dhe arsyetimin nëpërmjet analogjisë.

ⁱ Recommendation Rec(2001)15 of the Committee of Ministers to member states on history teaching in twenty-first-century Europe; Recommendation CM/Rec (2011)6 of the Committee of Ministers to member states on intercultural dialogue and the image of the other in history teaching



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT**

AGJENCIA E SIGURIMIT SË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

**PROGRAMET E KULTURËS SË PËRGJITHSHME
TË ARSIMIT TË MESËM PROFESIONAL**

Lënda: Gjeografi

Klasa: XII

Struktura: Bllok 4-vjeçar

TIRANË, 2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

PROGRAMET E KULTURËS SË PËRGJITHSHME
TË ARSIMIT TË MESËM PROFESIONAL

Lënda: Gjeografi

Klasa: XII

Struktura: Blok 4-vjeçar

2024

PËRMBAJTJA

1. FUSHA “SHOQËRIA DHE MJEDISI”	2
2. HYRJE NË PROGRAMIN E GJEOGRAFISË.....	4
3. KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT	6
4. QËLLIMET E PROGRAMIT TË GJEOGRAFISË	8
5. LIDHJA E KOMPETENCAVE KYÇE ME KOMPETENCAT E FUSHËS /LËNDËS	10
6. LIDHJA E LËNDËS SË GJEOGRAFISË ME TEMAT NDËRKURRIKULARE	17
7. LIDHJET E LËNDËS SË GJEOGRAFISË BRENDË FUSHËS DHE ME FUSHAT E TJERA TË TË NXËNIT	19
8. KOMPETENCAT E LËNDËS DHE TEMATIKAT E SAJ	21
9. KOHA MËSIMORE PËR TEMATIKË PËR KLASËN XI.....	23
10. REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS TEMATIKAVE PËR KLASËN XI	24
11. UDHËZIME METODOLOGJIKE	43
12. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN	45
13. MATERIALET DHE BURIMET MËSIMORE.....	46

Koordinoi programin:
Evis Mastori

1. FUSHA “SHOQËRIA DHE MJEDISI”

Arsimi parauniversitar krijon kushte dhe mundësi që nxënësi të ndërtojë dhe të zhvillojë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria demokratike; të zhvillohet në mënyrë të pavarur e të gjithanshme; të kontribuojë në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake dhe të shoqërisë; të përballë në mënyrë të suksesshme me sfidat e jetës.

Në arsimin parauniversitar, nxënësi:

- kultivon identitetin vetjak, kombëtar dhe përkatësinë kulturore;
- përvetëson vlera të përgjithshme kulturore dhe qytetare;
- zhvillohet në aspektet intelektuale, etike, fizike, sociale dhe estetike;
- zhvillon përgjegjësi ndaj vetes, të tjerëve, shoqërisë dhe mjedisit;
- aftësohet për jetë dhe për punë, në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;
- aftësohet për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- zhvillon shpirtin e sipërmarrjes;
- përdor teknologjitë e reja.

Fusha “Shoqëria dhe mjedisi” i krijon nxënësit mundësitë të zhvillojë kompetencat e nevojshme për të përmbushur rolin e tij si anëtar i një shoqërie shumë kulturore dhe demokratike, në një botë gjithnjë e më të ndërvarur. Kompleksiteti i botës shoqërore sot po rritet për shkak se shoqëritë janë në një proces të vazhdueshëm ndryshimi dhe lidhjesh globale, shoqëruar me rritje të lartë të lëvizshmërisë së popullsisë, shumëfishim të kontakteve midis kulturave të ndryshme, qarkullim të shpejtë të informacionit dhe rritje të globalizimit të ekonomisë. Lëndët që përbëjnë fushën “Shoqëria dhe mjedisi” zhvillojnë te nxënësi të menduarin kritik e krijues, pasurojnë

kulturën e tyre dhe i përgatisin të luajnë një rol aktiv në një shoqëri demokratike. Ato nxitin zhvillimin intelektual të nxënësit duke i dhënë mekanizmat konceptualë dhe metodologjikë, të cilat nxënësi mund t'i përdorë në situata të ndryshme.

Përmes kësaj fushe nxënësi zhvillon:

- konceptin e tij hapësinor për botën, për kompleksitetin dhe ndërvarësinë e vendeve dhe rajoneve në botë. Nxënësi aftësohet të vlerësojë pasojat e ndërveprimit të shoqërisë me mjedisin, për të ndërmarrë veprime që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm;
- bazat e qytetarisë duke siguruar kuptimin e ligjshmërisë, të proceseve ekonomike, shoqërore, kulturore dhe të çështjeve që lidhen me to;
- konceptin e kohës, të vazhdimësisë dhe të ndryshimit në këndvështrimin e marrëdhënieve historike dhe zbaton këtë kuptim në analizën e pasojave të veprimeve individuale dhe kolektive në shoqëri, në të kaluarën dhe sot.

Përvojat mësimore të kësaj fushe të nxëni në këtë shkallë i shërbejnë përmbushjes së kompetencave kyçe, me fokus të veçantë kultivimin e identitetit personal, shoqëror, kombëtar e kulturor.

2. HYRJE NË PROGRAMIN E GJEOGRAFISË

Gjeografia është shkencë e vendit, hapësirës dhe mjedisit. Ajo është një mënyrë e strukturuar e zbulimit, analizës dhe shpjegimit të dukurive dhe karakteristikave të Tokës, banorëve të saj dhe marrëdhënieve të ndërsjella midis tyre. Mësimi i gjeografisë i ofron nxënësit mundësi të kuptojë veçoritë natyrore dhe shoqërore të mjedisit gjeografik, diversitetin e vendeve dhe rajoneve në botë, të njerëzve dhe kulturave, ndërvarësinë dhe ndërveprimin si dhe marrëdhëniet e njeriut me mjedisin në nivel lokal, rajonal dhe botëror. Ndryshimet e shumta që po përjeton shoqëria e sotme kanë modifikuar marrëdhënien tonë me mjedisin. Shumëllojshmëria e informacionit dhe shpërndarja e tij marramendëse, shtimi i shkëmbimeve të llojeve të ndryshme, globalizimi i ekonomisë dhe lëvizjet e popullsisë, i bëjnë largësitë më të vogla dhe ndikojnë në mënyrën sipas së cilës ne shohim botën. Në këtë kuptim, lënda e gjeografisë ka një rëndësi të veçantë për përgatitjen e nxënësit për të jetuar dhe për t'u integruar në shoqëri, për kultivimin e identitetit personal, shoqëror, kombëtar dhe edukimin për të jetuar së bashku, për një zhvillim sa më të qëndrueshëm.

Programi i gjeografisë ndihmon në zhvillimin e kompetencave kyçe në funksion të të nxënit gjatë gjithë jetës. Zhvillimi i kompetencave është pikënisja dhe parimi bazë organizativ i këtij programi. Përmbajtja lëndore konceptohet si mjet për realizimin e tyre nëpërmjet zhvillimit të situatave të të nxënit.

Nxënësi përvetëson mjetet dhe “gjuhën” gjeografike teksa hulumton marrëdhënien e njeriut me vendet dhe mjedisin, njëkohësisht zbulon rolin që duhet të përmbushë për zhvillimin e qëndrueshëm. Ai mëson t'u përgjigjet problemeve gjeografike duke përdorur prezantimet hapësinore që ka përdorur më parë, të cilat tashmë i modifikon dhe i zhvillon.

Vëzhgimet dhe puna në terren, puna me hartën, interpretimi i shpërndarjes hapësinore të veçorive natyrore dhe shoqërore në Tokë dhe ndërvarësive midis tyre, zhvillojnë shkathtësitë themelore gjeografike në këtë nivel shkollimi.

Hartimi i programit lëndor rrjedh nga Korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar, Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të lartë dhe plani mësimor i arsimit të mesëm të lartë.

Si i tillë ky dokument i shërben:

- **Nxënësit** për zhvillimin e kompetencave kyçe të të nxënit gjatë gjithë jetës dhe kompetencave të lëndës së gjeografisë, në mënyrë që ai të përballojë sfidat e jetës dhe të integrohet në shoqëri.
- **Mësuesit** për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e veprimtarive mësimore dhe arritjeve të nxënësve në klasë dhe jashtë saj.
- **Prindit** për njohjen e rezultateve të pritshme të fëmijëve dhe kritereve të vlerësimit.
- **Hartuesit të teksteve mësimore** dhe të materialeve ndihmëse për mësuesit dhe nxënësit.

Zbatimi i programit bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore dhe fetare.

3. KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT

Programi i gjeografisë është konceptuar dhe hartuar në funksion të qasjes kurrikulare me bazë kompetencat.

- Ky program krijon kushtet për zhvillimin e *kompetencave kyçe* dhe *kompetencave të lëndës* që lidhen me to. Kompetencat e lëndës lidhen me kompetencat kyçe nëpërmjet rezultateve të të nxënit të secilës prej tyre. Lidhja mes rezultateve të të nxënit të kompetencave të lëndës dhe kompetencave kyçe siguron zhvillimin e ndërsjellë të tyre dhe mundëson integrimin lëndor.
- Kompetencat zhvillohen përmes *tematikave të përbashkëta të fushës* dhe në program zërthehen në njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera. Tematikat e përbashkëta të fushës janë elemente të rëndësishme të programit të gjeografisë sipas të cilave strukturohet përmbajtja lëndore dhe integrimi konceptual brenda fushës, në funksion të zhvillimit të kompetencave. Programi i gjeografisë është i strukturuar rreth dy tematikave të mëdha: “Proceset natyrore dhe shoqërore” dhe “Ndërvlerësia midis njerëzve, rajoneve dhe mjediseve”. Për secilën prej tyre përcaktohen rezultatet e pritshme të shprehur në terma njohurish, shkathtësish dhe qëndrimesh. Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe nuk përmbushen jashtë tematikave. Ato janë marrë në konsideratë në të gjithë procesin e hartimit të rezultateve të të nxënit për tematikë duke qenë pjesë integrale e tyre.
- Strukturimi dhe organizimi i programit për *shkallë kurrikule* synon ta bëjë këtë program më fleksibël, duke i ndihmuar dhe u lënë dorë më të lirë mësuesve për ta zbatuar atë në mënyrë krijuese, si dhe të respektojnë ritmet individuale të nxënësve drejt zotërimit të kompetencave të detajuara në çdo shkallë të kurrikulës.
- Strukturimi i programit mbi rezultatet e të nxënit për kompetencë ndihmon në planifikimin dhe zhvillimin e *situatave të të nxënit* dhe lehtëson vlerësimin e nxënësit për kompetencat kyçe. Situatat e të nxënit janë situata që lidhen me kontekstin e të nxënit. Ato mund të jenë situata në mjedise të mbyllura ose të hapura të nxëni, brenda shkollës ose jashtë saj. Roli i mësuesit në mësimdhënien përmes situatave është ai i udhëheqësit e i lehtësuesit gjatë nxënies aktive të nxënësit.


- Konceptimi i kurrikulës me bazë kompetencat krijon mundësitë dhe kërkon zbatimin e integruar të saj. Programi i gjeografisë krijon mundësi *integrimit brenda fushës dhe me fushat e tjera*, si shkencat e natyrës, matematikën, gjuhët dhe komunikimin etj. Në shumë aspekte, programi i gjeografisë përqendrohet në zhvillimin e temave të mëdha ndërkurrikulare. Ato shërbejnë si çështje kyçe për zhvillimin e kompetencave, integrojnë fushat e të nxënësve dhe synojnë të ndihmojnë nxënësin të lidhë shkollimin e tij me jetën e përditshme.
- Programi sugjeron *metoda, teknika, strategji të mësimdhënies e të nxënies* që nxisin interesin, gjithëpërfshirjen, ndërveprimin dhe punën kërkimore të nxënësve. Përzgjedhja dhe përdorimi i tyre nga mësuesit bëhet në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve, duke respektuar stilet e ndryshme të të nxënësve të tyre.
- *Vlerësimi* si pjesë integrale e procesit të të nxënësve mat shkallën në të cilën kompetencat janë arritur nga nxënësit. Vlerësimi merr shumë forma, të cilat i parashikon dhe mundëson struktura dhe konceptimi i programit.

4. QËLLIMET E PROGRAMIT TË GJEOGRAFISË

Programi i gjeografisë synon që nxënësi:

- të zhvillojë dijet për dukuritë gjeografike, fizike dhe humane, në shkallë të ndryshme, mbi bazën e ballafaqimit të vazhdueshëm të të menduarit kritik e krijues;
- të zhvillojë kuptimin për ligjet e përgjithshme të gjeosistemit dhe të veprojë në përputhje me to për zgjidhjen e problemeve gjeografike të jetës së përditshme;
- të zhvillojë interesin dhe respektin për vendin ku jeton, për vende të tjera, për njerëzit dhe mënyrën si ata ndërveprojnë me njëri-tjetrin dhe mjedisin ku jetojnë;
- të kuptojë mundësitë dhe sfidat e ndërvarësisë globale;
- të zhvillojë shkathtësitë për të qenë përdorues kritik dhe krijues i metodave të kërkimit gjeografik;
- të edukohet si qytetar i informuar, i përgjegjshëm dhe aktiv, i cili mund të kontribuojë për zhvillimin e një bote të qëndrueshme.

Diagrami 1: Korniza konceptuale e programit



5. LIDHJA E KOMPETENCAVE KYÇE ME KOMPETENCAT E FUSHËS /LËNDËS

Ndërtimi dhe zbatimi i kompetencave kyçe nga nxënësi gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies kërkon që mësuesi të mbajë parasysh lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës për secilën shkallë. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë situatat, veprimtaritë, metodat dhe mjetet e përshtatshme të procesit të të nxënit. Kompetenca përcaktohet si ndërthurje e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve që një nxënës duhet të fitojë dhe përdorë gjatë procesit të nxënies.

Kompetenca qytetare

Programi i gjeografisë, si pjesë e fushës “Shoqëria dhe mjedisi”, krijon kushte në mënyrë të veçantë për ndërtimin dhe demonstrimin nga nxënësi të kompetencës qytetare. Përmes kërkimit gjeografik për çështje të tilla, si ndërvarësia, shfrytëzimi i burimeve natyrore, qëndrueshmëria mjedisore në nivel lokal e global etj., nxënësi nxitet të mendojë në mënyrë kritike dhe të marrë vendime që ndihmojnë në zhvillimin e tij si individ.

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit

Programi i gjeografisë krijon mundësi për zhvillimin e shkathtësive komunikuese. Nxënësi përdor materiale të printuara, vizuale dhe digjitale për të eksploruar dukuritë, proceset gjeografike, vendet dhe rajonet. Ai mëson si të vlerësojë këto burime, nxënësi zhvillon dhe përdor në mënyrë progresive fjalorin gjeografik për të komunikuar idetë në mjedise të ndryshme.

Kompetenca e të menduarit

Nxënësi zhvillon të menduarin kritik dhe krijues gjatë vlerësimit të të dhënave dhe përdorimit të tyre, teston shpjegimet dhe analizon argumentet. Ai zhvillon shkathtësi për marrjen e vendimeve dhe strategji që e ndihmojnë të mendojë në mënyrë analitike dhe logjike.

Programi mundëson që nxënësi të kuptojë vlerën dhe procesin e drejtimit të pyetjeve, të jetë krijues e të zhvillojë imagjinatën përmes veprimtarive në klasë dhe vëzhgimeve në terren.

Programi i gjeografisë mundëson zbatimin e shkathtësive matematikore për kryerjen e analizave statistikore, ndërtimin e grafikëve, tabelave, llogaritjen dhe interpretimin e të dhënave. Në punën me hartën, nxënësit punojnë me koncepte numerike, të tilla si: shkalla, largësia, koordinatat, projeksionet.

Kompetenca e të mësuarit

Në procesin e kërkimit gjeografik nxënësi zhvillon kompetencën e të nxënësit. Programi mundëson që nxënësi të shfrytëzojë në mënyrë efektive përvojat paraprake për zgjidhjen e situatave të ndryshme dhe realizimin e veprimtarive; të parashtojë pyetje për çështje të ndryshme dhe të organizojë mendimet për të gjetur përgjigje për një situatë/problem të caktuar gjeografik. Nxënësi aftësohet të paraqesë/skicojë idetë e tij për ecurinë dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarive duke e argumentuar para të tjerëve. Për këtë, shfrytëzon në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në ndonjë burim informacioni, vlerëson vetë performancën dhe rezultatin e arritur, duke iu referuar qëllimeve fillestare.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

Nxënësit vlerësojnë rëndësinë e punës individuale dhe në grup për zhvillimin e komunitetit nëpërmjet shembujve konkretë nga jeta e përditshme, zgjidhin çështje të ndryshme që lidhen me mjedisin gjeografik, analizojnë elementë të situatës, kompleksitetin e saj, vlerësojnë rëndësinë dhe efektivitetin e zgjidhjeve të propozuara nga njëri-tjetri.

Kompetenca personale

Programi i gjeografisë nxit të nxënësit bazuar në kërkim duke zhvilluar aftësinë e nxënësve për të menaxhuar veten. Nxënësit kuptojnë rolin e tyre në procesin e të nxënësit dhe në kryerjen e hetimeve, aftësohen të jenë të pavarur në zbatimin e njohurive, shkathtësive dhe

në marrjen e vendimeve. Përmes punës në bashkëpunim në klasë dhe në terren, nxënësit zhvillojnë aftësitë ndërpersonale dhe mësojnë të vlerësojnë perspektivat e ndryshme të anëtarëve të tjerë të grupit.

Kompetenca digjitale

Nxënësi zhvillon kompetencën digjitale përmes përdorimit të TIK-ut në mënyrë efektive dhe të përshtatshme kur heton, krijon, komunikon idetë dhe informacionin për proceset e dukuritë gjeografike, për vendin e tij, vendet e tjera në botë dhe marrëdhënien e njeriut me mjedisin.

Diagrami 2: Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së gjeografisë

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (*Nxënësi komunikon në mënyrë efektive*)

Nxënësi:

- shprehet përmes një forme të komunikimit, për një temë të caktuar në një material gjeografik (prezantim) prej 200 fjalësh dhe veçon çështjet kryesore të ngritura në material (prezantim);
- përdor drejt strukturën dhe rregullat standarde të drejtshkrimit të gjuhës në kontekste dhe forma të ndryshme të shkrimit, si: ese, e-mail (postë elektronike), letër formale dhe joformale etj;
- prezanton një projekt, të hartuar individualisht dhe në grup, për një temë të caktuar gjeografike duke përdorur në mënyrë efektive teknologjinë e informacionit dhe teknologji të tjera.

Kompetenca e të menduarit (*Nxënësi mendon në mënyrë krijuese*)

Nxënësi:

- prezanton, në forma të ndryshme të të shprehurit, mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacionit për një

temë të caktuar, ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse;

- krahason të paktën tri burime të ndryshme të informimit për trajtimin e temës, argumenton saktësinë, rrethanat, gjen ngjashmëritë dhe dallimet, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara më parë, i prezanton gjetjet kryesore para të tjerëve në forma të ndryshme shprehëse, duke përdorur teknologjinë e informacionit;
- harton një detyrë me tekst, apo krijon një situatë logjike nga jeta e përditshme, e cila përmban një mesazh që kërkon zgjidhje duke u bazuar në njohuritë paraprake, prezanton mënyrën/procedurën e zgjidhjes së problemit para të tjerëve;
- krijon një situatë për marrjen e një vendimi për jetën e vet ose zgjidhjen e një problemi me interes shoqëror, lidh vendimin me pasojat në mënyrë të përgjegjshme, merr vendime dhe iniciativa të dobishme për vete, për shkollën dhe më gjerë.

Kompetenca e të mësuarit (*Nxënësi mëson për të nxënë*)

Nxënësi:

- shfrytëzon në mënyrë efektive përvojat paraprake gjatë zgjidhjes së situatave të ndryshme në jetën e përditshme apo gjatë kryerjes së ndonjë detyre ose veprimtarie në lëndën e gjeografisë, diskuton dhe ndan përvojat me të tjerët për mënyrat më praktike të shfrytëzimit të përvojave paraprake në arritjen e dijeve të reja;
- parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuar për zgjidhjen e një problemi apo detyre të një teme të caktuar, bën përmbledhjen e së paku dy veprimeve të përdorura të cilat përcaktojnë drejtimin e mëtejshëm të të nxënit për temën apo problemin e caktuar;
- zgjidh një problem të caktuar mësimor ose një situatë nga jeta e përditshme;
- në bazë të një planifikimi të dhënë dhe në bazë të rezultatit të fituar vërteton saktësinë e planifikimit dhe tregon me shembuj se si do të zbatojë strategjinë e ndjekur edhe në situata dhe kontekste të tjera gjatë të nxënit;

- shfrytëzon, në mënyrë të pavarur, udhëzimet e dhëna në ndonjë burim informacioni për të kryer një veprim, aktivitet, detyrë ose për të zgjidhur një problem që kërkohet prej tij, vlerëson vetë performancën dhe rezultatin e arritur, duke iu referuar qëllimeve fillestare (p.sh., burime të informacionit në libër, revistë, enciklopedi, internet, hartë, grafik, skicë etj.).

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (*Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive*)

Nxënësi:

- përgatit, prezanton, drejton dhe merr pjesë në një fushatë të informimit të qytetarëve për një temë të caktuar, duke u mbështetur në ide të reja, bazuar në rezultate të pritshme të përcaktuara qartë (p.sh., fushatë informimi për mbrojtjen e mjedisit etj.);
- hulumton dhe analizon forma të ndryshme të sipërmarrjes për mundësi të orientimit për karrierën, si dhe për të kontribuar në të mirë të komunitetit;
- demonstroi shprehje organizative në punët individuale dhe në ekip përmes situatave reale në detyrat e veçanta mësimore apo në veprimtari për jetë, për punë dhe për mjedis duke menaxhuar potencialin individual dhe atë të grupit si dhe kohën, rreziqet dhe buxhetin në dispozicion;
- harton një projekt me faza të menaxhuara mirë (individualisht ose në grup) duke shkëmbyer, konsultuar dhe informuar të tjerët si dhe duke identifikuar dhe vlerësuar burimet njerëzore, materiale dhe monetare në përputhje me rezultatet e pritshme;
- analizon gjendjen e mjedisit (në klasë, në shkollë, në komunitet apo më gjerë), pasojat e ndotjes, propozon alternativa për mbikëqyrje dhe menaxhim të drejtë të gjendjes së vlerësuar më të ndjeshme dhe inicion zgjidhje konkrete.

Kompetenca personale (*Nxënësi bën jetë të shëndetshme*)

Nxënësi:

- analizon përparësitë dhe dobësitë personale duke i evidentuar masat përmes të cilave synon të mbështesë avancimin personal, në

përparësitë që ka dhe masat përmes të cilave synon të përmirësojë dobësitë personale.

Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)

Nxënësi:

- demonstroi shembuj të pjesëmarrjes demokratike dhe drejton forma të ndryshme të diskutimit për pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes demokratike në nivele të ndryshme (p.sh.: në familje, në shkollë, në komunitet, në nivel lokal dhe nivel shtetëror) duke treguar tolerancë dhe respekt për pyetjet dhe komentet e të tjerëve;
- demonstroi shembuj konkretë të mbrojtjes së mjedisit natyror dhe atij të krijuar nga njeriu në veprimtari të jetës së përditshme në shtëpi, në klasë, në shkollë dhe në komunitet, propozon alternativa se si të gjithë qytetarët mund të ndihmojnë në mënyra të ndryshme për këtë proces;
- paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore dhe jep propozime për zgjidhjen e ndonjë problemi në komunitet e më gjerë në një fushë të caktuar.

Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)

Nxënësi:

- përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive;
- gjen, organizon, analizon, përpunon dhe përdor informacionin nga një shumëllojshmëri burimesh të ndryshme;
- përdor mjetet digjitale për të përpunuar, krijuar, realizuar dhe demonstruar tema mësimore nëpërmjet vizualizimeve të filmuara apo të animuara.

Për të realizuar lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës, mësuesi ndjek këto hapa:

- përzgjedh përmbajtjen mësimore, mjetet didaktike, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënësve të kompetencave të gjeografisë në një vit mësimor, si dhe rezultatet e të nxënësve për kompetencat kyçe në një vit mësimor;

- planifikon mësimdhënien duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do të arrijë rezultatet e të nxënit për kompetencat kyçe brenda vitit shkollor;
- kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave, projekteve për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënit për vit mësimor dhe shkallë në lëndën e gjeografisë.

6. LIDHJA E LËNDËS SË GJEOGRAFISË ME TEMAT NDËRKURRIKULARE

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore me të cilat përballet shoqëria. Ato i shërbejnë zhvillimit të kompetencave dhe synojnë të ndihmojnë nxënësin të lidhë shkollimin e tij me jetën e përditshme. Në shumë aspekte, programi i gjeografisë përqendrohet në zhvillimin e temave të mëdha ndërkurrikulare, kryesisht në temat:

- ❖ Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave
- ❖ Zhvillimi i qëndrueshëm
- ❖ Mjedi
- ❖ Ndërvarësia
- ❖ Bashkëjetesa paqësore

Programi ndihmon për edukimin e identitetit kombëtar, njohjen e kulturave, ndërvarësinë dhe bashkëjetesën paqësore.

Duke analizuar marrëdhëniet e shoqërisë me mjedisin nga perspektiva e menaxhimit të përgjegjshëm, nxënësi mëson të vendosë lidhje midis nevojave dhe përdorimit racional të burimeve. Ai ndërgjegjësohet për aspektet shoqërore të konsumit, për implikimet e globalizmit për shoqërinë dhe shpërndarjen e burimeve. Ky ndërgjegjësim e ndihmon nxënësin të kuptojë më mirë ndërvarësinë e mjedisit nga veprimtaria njerëzore. Në këtë mënyrë, programi ndihmon për edukimin për zhvillimin e qëndrueshëm dhe mjedisin.

Përmes studimit të vendeve dhe rajoneve të ndryshme, transferimit të të nxënësve në vendin e tij, nxënësi ndërgjegjësohet për rolin e tij si qytetar. Kjo e ndihmon atë të jetë mendjehapur dhe të respektojë diversitetin. Nxënësi ndërgjegjësohet për të drejtat e tij, ndërvarësinë e njerëzve, konfliktet ndërkombëtare dhe nevojën për të zhvilluar kulturën e paqes.

Zhvillimi i karrierës

Një ndër synimet kryesore të programit të gjeografisë në shkallën e pestë dhe më tej, është të zhvillojë orientimin për karrierat që lidhen me fushën e studimit të gjeografisë dhe dimensione të saj, të tilla si ai i gjeografit, meteorologut, sizmologut etj.

7. LIDHJET E LËNDËS SË GJEOGRAFISË BRENDË FUSHËS DHE ME FUSHAT E TJERA TË TË NXËNIT

Konceptimi i programit të gjeografisë në fushën "Shoqëria dhe mjedisi" është mbështetur në parime të mirëfillta të integritimit. Për t'i siguruar nxënësit zhvillimin e kompetencave, është e rëndësishme lidhja e lëndëve brenda fushës, të cilat ndihmojnë në mënyrë të ndërsjellë njëra-tjetrën.

Lidhja e gjeografisë me historinë i shërben nxënësit të kuptojë më mirë ndryshimet që kanë pësuar kulturat e ndryshme dhe ndikimin e tyre në zhvillimet e vendeve dhe rajoneve, si dhe sfidat e ndërvarësisë globale. Nxënësi hulumton mbi historinë e mendimit gjeografik për të kuptuar evolucionin e ideve dhe teorive.

Lidhja e gjeografisë me qytetarinë. Programi i gjeografisë ndihmon në zhvillimin e dimensioneve të qytetarisë. Ai e sheh botën si bashkësi globale dhe të ndërvarur. Nxënësi identifikon probleme, sugjeron zgjidhje dhe reflekton për marrjen e vendimeve. Gjeografia u jep aktualitet më të madh çështjeve me të cilat merret qytetaria dhe ndihmon në debate për çështje dhe ngjarje të rëndësishme.

Gjeografia është ngushtësisht e lidhur me fushat e tjera të të nxënit.

Si të gjitha lëndët e tjera, gjeografia krijon mundësi të zbatimit të kompetencave që zhvillon fusha "Gjuhët dhe komunikimi". Gjuha është themelore për të nxënin e nxënësve në lëndën e gjeografisë. Nxënësi përzgjedh strategjitë e përshtatshme gjuhësore për të eksploruar, prezantuar dhe komunikuar të kuptuarin e dukurive gjeografike. Ai përdor gjuhën letrare për të shprehur pozicionin e tij qartë dhe në mënyrë koherente. Por njëkohësisht dhe gjeografia ndihmon në zgjerimin dhe përpunimin e fjalorit të nxënësit, duke e nxitur atë të parashtojë qartë dhe saktësisht idetë e tij. Punët praktike, projektet dhe detyrat që nxënësi realizon, i mundësojnë zhvillimin e kompetencës së komunikimit gjuhësor dhe pasurimin e fjalorit terminologjik. Termat e ndryshme, të përdorura në këtë lëndë, janë specifike dhe ndihmojnë nxënësin për zhvillimin e kompetencës së komunikimit përmes përdorimit të gjuhës dhe terminologjisë gjeografike.

Gjithashtu, e rëndësishme është *lidhja e gjeografisë me shkencat e natyrës*. Gjeografia është një urë lidhëse ndërmjet shkencave natyrore dhe shoqërore. Shumë prej njohurive të fushës së shkencave natyrore janë themelore për kuptimin dhe interpretimin e dukurive gjeografike në Tokë; p.sh., zbatimi i ligjit të tërheqjes së gjithësishtme për të shpjeguar tërheqjen e Tokës, Hënës, qëndrimin e planetëve në orbitën rreth Diellit; njohuritë mbi natyrën e valëve gjatësore dhe procesin e përhapjes së tyre në mjedis për të interpretuar valët detare; vetitë dhe përbërja e lëndës për të kuptuar mineralet; zbatimi i periodës së gjysmëzbërthimit dhe metodës së atomeve të shënuara të dukurisë së radioaktivitetit për të përcaktuar moshën absolute të shkëmbinjve etj., janë shembuj të zbatimit të ligjësisë dhe teorive shkencore në dukuritë gjeografike.

Lidhja e gjeografisë me matematikën. Nxënësi zhvillon njohuritë matematikore përmes përdorimit të informacioneve sasiore dhe cilësore, leximit apo ndërtimit të hartave, grafikëve dhe tabelave statistikore. P.sh., nxënësi llogarit mesataren ditore, mujore apo vjetore të temperaturave të ajrit; llogarit kohën lokale e zonale mbi bazën e veprimeve me thyesa; ndërton grafikë të shpërndarjes së reshjeve, temperaturës dhe i interpreton ato. Nxënësi ndërton diagrame që paraqesin strukturën e popullsisë së një vendi apo rajoni, të ekonomisë dhe sektorëve të saj etj.

Lidhja e gjeografisë me TIK-un. Teknologjia e informacionit dhe komunikimit (TIK) mbështet të nxënit në lëndën e gjeografisë përmes realizimit të detyrave të ndryshme, projekteve, kërkimit, përpunimit dhe prezantimit të informacionit. Nxënësi mëson të përzgjedhë informacionin dhe të mbajë qëndrim kritik ndaj tij, të dallojë faktin nga opinioni. Nxënësi mund të përdorë word-processor në shkrimin e materialeve, zbaton hedhjen e të dhënave në tabelë për ndërtimin e grafikëve, përdor power point për prezantimin e një detyre, kërkon në internet harta dhe përcakton vendndodhjen e objekteve të ndryshme.

8. KOMPETENCAT E LËNDËS DHE TEMATIKAT E SAJ

Përmes programit të gjeografisë mundësohet zhvillimi i kompetencave të lëndës, të cilat lidhen me kompetencat kyçe që një nxënës duhet të zotërojë gjatë gjithë jetës. Programi i gjeografisë, nëpërmjet tematikave të tij dhe situatave të të nxënësve, zhvillon dhe ndërton kompetencat e lëndës, të cilat janë pjesë e kërkimit gjeografik.

Tematikat mbi të cilat është organizuar përmbajtja e programit kanë të bëjnë me njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, nëpërmjet të cilave do të realizohen këto kompetenca. Shkathtësitë dhe qëndrimet, ashtu sikurse njohuritë, janë objekt i të nxënësve të rregullt dhe progresiv. Shkathtësitë dhe aftësitë u lejojnë nxënësve, që nën udhëheqjen e mësuesit apo në mënyrë të pavarur, të ndërtojnë, përvetësojnë, organizojnë njohuritë dhe të reflektojnë mbi to.

Disa nga shkathtësitë janë specifike për gjeografinë (p.sh., nxënësit lokalizojnë, orientohen në hapësirë, lexojnë dhe përdorin gjuhën hartografike), ndërsa të tjerat kanë të bëjnë me shkathtësi që gjeografia ndan me fushat e tjera dhe që janë të domosdoshme për të gjithë procesin e të nxënësve (p.sh., komunikojnë me shkrim dhe me gojë, përshkruajnë, identifikojnë etj.). Çdo situatë të nxënësve shoqërohet domosdoshmërisht me shumë prej këtyre shkathtësive.

Programi i gjeografisë zhvillon kompetencat e mëposhtme lëndore, të cilat lidhen me kërkimin gjeografik:

- ❖ *Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike.*
- ❖ *Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit.*
- ❖ *Marrja e vendimeve mbi bazën e informacionit të mbledhur.*

Tabela: Rezultatet e të nxënësve për kompetencat e lëndës

Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike

Nxënësi:

- përcakton një çështje gjeografike për kërkim/hetim;
- formulon pyetje ose jep shpjegim, zgjidhje ose opinion duke përcaktuar disa aspekte thelbësore të çështjes;
- përcakton marrëdhëniet shkak-pasojë të dukurive gjeografike që ndodhin në sistemet natyrore të Tokës dhe dukurive gjeografike që ndodhin në vende dhe rajone të ndryshme.

Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit

Nxënësi:

- përdor burime informacioni që mund të ndryshojnë besueshmërinë e tyre;
- zgjedh burimet më të përshtatshme nga tërësia e burimeve parësore dhe dytësore në dispozicion;
- përcakton metodat, strategjitë ose teknikat e përshtatshme;
- komunikon (me shkrim, me gojë, grafikisht, vizualisht) shpërndarjen hapësinore të dukurive gjeografike, përmes përdorimit të hartave të shkallëve të ndryshme duke përdorur fjalorin e përshtatshëm gjeografik.

Marrja e vendimeve

Nxënësi:

- jep shpjegime në lidhje me çështjen gjeografike të marrë në shqyrtim;
- identifikon pasojat që mund të shoqërojnë zgjidhjen e çështjes;
- identifikon rrugë të ndryshme të veprimit;
- përdor pyetje për të reflektuar në çdo fazë të kërkimit :“Çfarë funksionoi?”, “Si mund të përmirësohet?”.

9. KOHA MËSIMORE

Programi i gjeografisë për klasën XII, Struktura: Bllok 4-vjeçar, zhvillohet në 72 orë mësimore gjithsej (2 orë mësimore/javë x 36 javë).

Klasa XII: Struktura Bllok 4-vjeçar

Tematika	Nëntematikat	Orë të sugjeruara
Ndërvarësia midis njerëzve, rajoneve dhe mjediseve (72 orë)	Hapësira në trajtimin gjeografik rajonal.	4
	Europa, rajoni, Shqipëria dhe trevat e tjera shqiptare.	10
	Tiparet e përgjithshme natyrore të Republikës së Shqipërisë.	9
	Popullsia dhe ekonomia e Republikës së Shqipërisë.	10
	Rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë.	35
	Pabarazitë dhe mundësitë e zhvillimeve rajonale.	4

Në program specifikohen orët e sugjeruara për secilën nëntematikë. Orët e sugjeruara përfshijnë njohuritë e reja, punët praktike, detyrat, vëzhgimet në natyrë, testimet, zhvillimin dhe prezantimin e projektit. Sasia e orëve mësimore për secilën nëntematikë është rekomanduese. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, kurse janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara.

10.REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS TEMATIKAVE

Në programin e gjeografisë janë paraqitur rezultatet e të nxënit për tematikën “Ndërvarësia midis njerëzve, rajoneve dhe mjediseve”, në funksion të zhvillimit të kompetencave.

Rezultatet e të nxënit shprehen në terma njohurish, aftësish dhe qëndrimesh. Kombinimi dhe ndarja e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve në situata të nxëni, kapituj apo grupe temash e njësi mësimore, si dhe renditja e tyre është e drejtë e përdoruesve të programit (më kryesorët janë mësuesit dhe autorët e teksteve).

TEMATIKA: NDËRVARËSIA MIDIS NJERËZVE, RAJONEVE DHE MJEDISEVE

Përshkrimi i tematikës:

Tematika “Ndërvarësia midis njerëzve, rajoneve dhe mjediseve” në këtë klasë zhvillon te nxënësit njohuri, shkathtësi dhe qëndrime të cilat kanë të bëjnë me trajtimin gjeografik rajonal, duke pasur në fokus kryesor hapësirën e vendit tonë, Shqipërinë. Në këtë kuadër, formimi gjeografik i nxënësit fokusohet në tre drejtime: në trajtimin teorik të konceptit të rajonit dhe tipeve të rajoneve; në trajtimin e hierarkisë dhe lidhjeve rajonale midis Europës, rajonit, Shqipërisë dhe trevave të tjera shqiptare; si dhe në trajtimin e detajuar të katër rajoneve gjeografike të Republikës së Shqipërisë, dallimeve dhe mundësive në zhvillimet e ndryshme rajonale të vendit.

Programi synon që nxënësit të aftësohen të zbulojnë dhe argumentojnë lidhjet shkak-pasojë të dukurive dhe proceseve që ndodhin në rajone të ndryshme gjeografike, të zhvillojnë aftësi të kërkimit gjeografik përmes hulumtimit të tipareve dhe veçorive të rajoneve të veçanta të vendit tonë, si dhe të bëjnë gjykime e të zhvillojnë qëndrime në lidhje me perspektivat e zhvillimit të qëndrueshëm rajonal.

Përmes detyrave, punëve praktike, projektit e strategjive të tjera ndërvepruese, përdorimit të teknologjisë së informacionit, nxënësit aftësohen në kërkimin gjeografik dhe zhvillojnë të menduarin kritik e krijues, zhvillojnë shkathtësi të komunikimit dhe të punës në grup. Përmes përdorimit të burimeve të ndryshme, si: harta, fotografi, statistika, diagrame, ilustrime fotosh dhe video etj., nxënësit zbulojnë dhe përvetësojnë informacione dhe koncepte gjeografike si për Shqipërinë në përgjithësi, ashtu edhe për rajonet e saj gjeografike në veçanti.

REZULTATET E TË NXËNIT

NËNTEMATIKA: HAPËSIRA NË TRAJTIMIN GJEOGRAFIK RAJONAL

Njohuritë	Shkathtësitë	Qëndrimet / vlerat
❖ Rëndësia e trajtimit rajonal të hapësirës gjeografike.	<i>Nxënësi:</i> <ul style="list-style-type: none">➤ <u>vlerëson</u> dhe <u>argumenton</u> rëndësinë e trajtimit rajonal të territorit (hapësirës);➤ <u>identifikon</u> kriteret bazë të rajonizimit	<i>Nxënësi:</i> <ul style="list-style-type: none">➤ <u>demonstron</u>, përmes studimit të gjeografisë, aftësitë qytetare, të

<ul style="list-style-type: none"> ❖ Rajoni në kuptimin e tij të përgjithshëm. Kriteret e rajonizimit dhe tipet e rajoneve. ❖ Kuptimi i sotëm europian mbi rajonin në kuadër të BE nën moton: “Bashkëjetesë në diversitet”. Kalimi nga Europa e shteteve drejt asaj të rajoneve. ❖ Zhvillimi i konceptit shqiptar mbi rajonin. Kriteret dhe problematikat e rajonizimit gjeografik në Shqipëri. ❖ Rëndësia e trajtimit rajonal të vendit për integrimin e tij në BE si një nga kriteret e këtij integrimi. 	<p>gjeografik dhe tipet e ndryshëm të rajoneve;</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>shpjegon</u> kuptimin e sotëm europian mbi rajonin nën frymën e respektimit të diversitetit dhe ndërveprimit rajonal; ➤ <u>sjell shembuj</u> të rritjes së ndërvarësisë rajonale përmes proceseve ekonomike, politike, mjedisore dhe shkëmbimeve kulturore në Europë; ➤ <u>interpretton</u> zhvillimin e konceptit shqiptar për rajonin; ➤ <u>identifikon</u> kriteret e rajonizimit gjeografik në Shqipëri; ➤ <u>vlërëson</u> problematikat që shoqërojnë rajonizimin gjeografik të vendit tonë; ➤ <u>argumenton</u> rëndësinë që ka rajonizimi dhe trajtimi i zhvillimeve rajonale të vendit si një nga kriteret për integrimin e tij në BE; ➤ <u>sjell shembuj</u> të standardeve që kanë përmbushur vende të tjera anëtare apo candidate të BE-së me zhvillimet e tyre rajonale. 	<p>cilat ndihmojnë në rritjen personale si individë, në përgatitjen e tyre në jetë, në punë dhe në shoqëri;</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>vlërëson</u> dhe <u>shpreh ndjeshmëri</u> ndaj menaxhimit të qëndrueshëm të rajoneve; ➤ <u>vlërëson</u> dhe <u>respekton</u> pikëpamjet e të tjerëve; ➤ <u>tregon</u> integritet në aksesin dhe përdorimin etik të informacionit; ➤ <u>paraqet</u> dhe <u>komunikon</u> lirshëm mendimet e tij; ➤ <u>demonstron</u> objektivitet dhe paanësi; ➤ <u>demonstron</u> pavarësi dhe besim në vetvete; ➤ <u>respekton</u> përpjekjet personale dhe ato në grup.
--	---	--

NËNTEMATIKA: EUROPA, RAJONI, SHQIPËRIA DHE TREVAT E TJERA SHQIPTARE

<p>❖ Europa: karakteristika të përgjithshme dhe veçori rajonale.</p>	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>argumenton</u> rëndësinë e pozitës gjeografike të Europës dhe rolin e saj për zhvillimin dhe marrëdhëniet me rajonet e tjerë të botës; ➤ <u>përshkruan</u> tiparet më të përgjithshme natyrore, demografike, ekonomike dhe kulturore të Europës; ➤ <u>vlerëson</u> ndërvarësinë midis rajoneve të Europës dhe sjell shembuj të ndërvarësisë dhe bashkëveprimit rajonal; 	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>zhvillon</u> ndjenjën e identitetit kombëtar dhe të respektit e mirëkuptimit për vendet dhe e popujt fqinj e më gjerë;
<p>❖ Europa Juglindore dhe vendi i hapësirës shqiptare në të.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>vlerëson</u> pozitën gjeostrategjike të hapësirës shqiptare në Europën Juglindore dhe rolin e saj për zhvillimin dhe bashkëpunimin ndërrajonal e më gjerë; 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>vlerëson</u> trashëgiminë natyrore dhe kulturore; ➤ <u>vlerëson</u> dhe <u>respekton</u> politikat globale dhe rajonale për zhvillimin e qëndrueshëm;
<p>❖ Hapësira mesdhetare dhe roli i saj në zhvillimin e hapësirave shqiptare.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>vlerëson</u> vendin e rëndësishëm që zë hapësira shqiptare si pjesë e Mesdheut, me tiparet e veçanta që e shoqërojnë natyrën, popullimin dhe ekonominë; 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>vlerëson</u> dhe <u>respekton</u> pikëpamjet e të tjerëve; ➤ <u>tregon</u> integritet në aksesimin dhe përdorimin etik të informacionit;
<p>❖ Trevat shqiptare:</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>analizon</u> pozitën gjeografike të trevave 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>paraqet</u> dhe <u>komunikon</u> lirshëm mendimet e tij; ➤ <u>demonstron</u> pavarësi dhe objektivitet në kryerjen e detyrave;
		<ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>respekton</u> përpjekjet personale

- + përbërja dhe ndryshimet në hartën politike;
- + tipare të zhvillimit rajonal.

❖ Republika e Kosovës:

- + tiparet gjeografike natyrore;
- + tipare të zhvillimit demografik dhe socio-ekonomik.

shqiptare në Europë dhe më gjerë;

- vlërëson rolin e kësaj pozite në veçoritë natyrore gjeografike, në popullimin e trevave dhe zhvillimin ekonomik, dhe pasojat e kësaj pozite në copëtimin e trevave shqiptare;
- analizon ndryshimet që ka pësuar në kohë dhe në hapësirë harta politike e trevave shqiptare;
- argumenton rëndësinë e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis vendeve e popujve fqinjë e më gjerë, në kuadër të perspektivës të të gjitha trevave shqiptare dhe të shteteve ku ato ndodhen në familjen e madhe europiane;
- analizon tiparet e përgjithshme gjeografike natyrore të Republikës së Kosovës:
 - ✓ pozitën gjeografike,
 - ✓ kushtet dhe pasuritë natyrore,
 - ✓ trashëgiminë natyrore;
- analizon tiparet e përgjithshme të zhvillimit demografik dhe socio-ekonomik të

dhe ato në grup.

❖ Trevat e tjera shqiptare në rajon (në Maqedoninë e Veriut, në Mal të Zi, në Serbi, në Greqi):

✚ veçoritë natyrore;

✚ tipare të zhvillimit demografik dhe socio-ekonomik;

✚ tiparet e diferencimit në zhvillimin rajonal.

Republikës së Kosovës:

✓ strukturën dhe ecurinë e numrit të popullsisë (faktorët),

✓ shpërndarjen gjeografike të popullsisë,

✓ zhvillimin e degëve kryesore të ekonomisë dhe shkallën e zhvillimit;

➤ evidenton, me ndihmën e hartës, diferencimin rajonal të Republikës së Kosovës;

➤ vlerëson akset dhe drejtimet e zhvillimit të ardhshëm të Republikës së Kosovës me shanset dhe mundësitë që ofron ajo për integrim rajonal dhe europian;

➤ përshkruan pozitën gjeografike dhe veçoritë kryesore natyrore të trevave të tjera shqiptare, rolin e tyre për zhvillimet rajonale;

➤ analizon tiparet kryesore të zhvillimit demografik dhe social-ekonomik të trevave të tjera shqiptare;

➤ analizon dallimet që ekzistojnë në zhvillimet rajonale midis pjesëve të

❖ Republika e Shqipërisë:

- + pozita gjeografike dhe roli i saj në integrimin rajonal dhe europian;
- + ndryshimet në organizimin administrativo-territorial dhe ndikimi në zhvillimet rajonale.

ndryshme të trevave të tjera shqiptare, faktorët që kanë ndikuar dhe perspektivën e zhvillimit të tyre;

- vlerëson rolin e pozitës gjeografike të Republikës së Shqipërisë për zhvillimin e bashkëpunimit dhe ndërveprimit rajonal e më gjerë, si urë lidhëse midis lindjes dhe perëndimit;
- përshkruan ndryshimet që kanë ndodhur në organizimin administrativo-territorial të vendit tonë;
- analizon organizimin e sotëm administrativo-territorial të Republikës së Shqipërisë;
- argumenton ndikimin e organizimit të sotëm administrativ-territorial të Shqipërisë në zhvillimin dhe integrimin rajonal dhe europian.

NËNTEMATIKA: TIPARET E PËRGJITHSHME NATYRORE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

- ❖ Larmia e mjediseve dhe peizazheve natyrore të Shqipërisë.
- ❖ Evolucioni gjeologjik dhe formimi i truallit.
- ❖ Pasuritë minerare dhe roli i tyre në zhvillimin ekonomik të vendit dhe të rajoneve.
- ❖ Larmia e formave të relievit dhe roli i relievit në ndryshimet rajonale.
- ❖ Klima, elementët kryesorë klimatikë dhe tiparet e tyre.

Nxënësi:

- përshkruan larminë e mjediseve dhe të peizazheve natyrore të Shqipërisë dhe faktorët e përgjithshëm që kanë ndikuar në këtë drejtim;
- analizon etapat e formimit të truallit, përbërjen litologjike dhe strukturore të tij;
- identifikon pasuritë minerare të vendit tonë dhe shpërndarjen gjeografike të tyre, duke përdorur hartën;
- vlerëson rolin e pasurive minerare për zhvillimin ekonomik të vendit;
- identifikon faktorët gjeografikë dhe interpretin rolin e tyre në krijimin e larmisë së formave të relievit;
- interpretin me ndihmën e hartës, shtrirjen e elementëve kryesorë të relievit;
- analizon rolin e relievit në zhvillimet dhe shpërndarjen hapësinore të elementëve demografikë dhe ekonomikë;
- identifikon elementët kryesorë klimatikë

Nxënësi:

- demonstron interes dhe kuriozitet për tiparet natyrore të vendit tonë;
- demonstron ndjeshmëri dhe kujdes për cilësinë e mjedisit natyror;
- është aktiv në shfrytëzimin e informacionit nga burime të ndryshme dhe e përdor atë efektivisht;
- vlerëson menaxhimin e qëndrueshëm dhe përdorimin eficient të burimeve natyrore;
- vlerëson marrjen e masave për të zvogëluar degradimin e habitateve natyrore në vendin tonë;
- vlerëson dhe respekton pikëpamjet e të tjerëve;
- paraqet dhe komunikon lirshëm mendimet e tij;
- respekton përpjekjet personale

- ❖ Pasuritë klimatike dhe ndikimi i tyre në zhvillimin ekonomik të vendit dhe të rajoneve.
- ❖ Larmia dhe pasuria e madhe hidrografike.
- ❖ Roli dhe rëndësia e larmisë hidrografike për zhvillimin ekonomik të vendit dhe të rajoneve të veçanta të tij.
- ❖ Larmia e tokave, vlerat, faktorët e degradimit dhe ndotjes së tyre.
- ❖ Larmia e madhe e florës dhe faunës së Shqipërisë, bazë e rëndësishme për zhvillimin e rajoneve të ndryshme.

dhe tiparet e tyre;

- evidenton tiparet kryesore të klimës së vendit tonë dhe faktorët që ndikojnë në formimin e saj;
- vlerëson rolin dhe ndikimin e klimës në dukuritë e tjera natyrore, në shpërndarjen e popullsisë dhe aktivitetet e saj;
- analizon larminë dhe pasurinë e madhe hidrografike të Shqipërisë dhe faktorët që kanë ndikuar;
- vlerëson rolin e pasurive hidrike për zhvillimin ekonomik të vendit dhe të rajoneve të ndryshëm;
- analizon kushtet dhe faktorët që ndikojnë në larminë e tokave të vendit tonë;
- analizon faktorët dhe kushtet që kanë përcaktuar larminë dhe pasurinë e madhe bimore dhe shtazore të Shqipërisë;
- vlerëson rolin e pasurisë floristike dhe të faunës të vendit tonë për zhvillimin e rajoneve të ndryshme dhe rolin e veprimtarisë njerëzore për ruajtjen dhe

dhe ato në grup.

<p>❖ Trashëgimia natyrore e Shqipërisë – pasuri shumë e rëndësishme për zhvillime të caktuara rajonale.</p>	<p>zhvillimin e biodiversitetit;</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>evidenton</u> disa ndër sitet e trashëgimisë natyrore të vendit tonë; ➤ <u>hulumton</u> në burime të ndryshme informacioni mbi zonat e mbrojtura të vendit tonë, pasurinë që ofrojnë dhe ndikimin e tyre në zhvillimin e turizmit;
<p>❖ Raportet njeri-mjedis dhe ndikimi në gjendjen e peizazheve të ndryshme.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>identifikon</u> faktorët kryesorë dhe pasojat e problemeve mjedisore në vendin tonë; ➤ <u>interpretin</u> faktorët që kanë ndikuar në shkallën e lartë të degradimit dhe shkretimit të tokave si dhe pasojat e tyre; ➤ <u>vlerëson</u> ndikimin e veprimtarisë njerëzore në ndryshimin e peizazheve të ndryshme; ➤ <u>parashikon</u> rrugë të menaxhimit efektiv të këtij ndikimi.

NËNTEMATIKA: POPULLSIA DHE EKONOMIA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

<p>❖ Popullsia dhe vendbanimet. Tiparet e zhvillimit të përgjithshëm demografik.</p> <p>❖ Ecuria e numrit të përgjithshëm të</p>	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>interpretin</u> ecurinë e zhvillimit të popullsisë dhe vendbanimeve; ➤ <u>analizon</u> ecurinë e numrit të përgjithshëm të 	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>vlerëson</u> diversitetin shoqëror, kulturor dhe mjedisor; ➤ <u>vlerëson</u> dhe <u>respekton</u>
--	---	--

popullsisë së Shqipërisë në periudha të ndryshme.

❖ Tiparet e shpërndarjes gjeografike të popullsisë.

❖ Lëvizja natyrore dhe ndikimet e saj në numrin e përgjithshëm të popullsisë.

❖ Migrimet e popullsisë dhe roli i veçantë i tyre në zhvillimet demografike të vendit.

popullsisë së Shqipërisë përgjatë periudhave të ndryshme;

➤ dallon faktorët që ndikojnë në shpërndarjen gjeografike të popullsisë;

➤ interpretton me ndihmën e hartës tiparet e shpërndarjes gjeografike të popullsisë;

➤ analizon tregues të lëvizjes natyrore të popullsisë;

➤ vlerëson ndikimin e lëvizjes natyrore të popullsisë në numrin e përgjithshëm të popullsisë;

➤ hulumton në burime të ndryshme informacioni dhe interpretton grafikë, të dhëna statistikore etj., në lidhje me ecurinë e numrit të përgjithshëm të popullsisë dhe lëvizjen natyrore të saj;

➤ analizon procesin e migrimit si promotorin e të gjitha ndryshimeve demografike të popullsisë shqiptare, duke u ndalur në periudhën pas vitit 1990;

➤ evidenton territoret ku kanë migruar shqiptarët me veçoritë dhe problemet e

pikëpamjet e të tjerëve;

➤ tregon integritet në aksesimin dhe përdorimin etik të informacionit;

➤ komunikon lirshëm mendimet e tij;

➤ respekton përpjekjet personale dhe ato në grup.

❖ Tipare të strukturës cilësore të popullsisë së Shqipërisë (sipas moshës, gjinisë, vendbanimit, etnike, fetare etj.).

❖ Ekonomia e Shqipërisë dhe tipare të zhvillimit të saj në periudha të ndryshme.

❖ Vlerësim i potencialeve natyrore dhe humane të vendit për zhvillimin e tij ekonomik.

❖ Struktura e degëve dhe nëndegëve të ekonomisë.

integritit të tyre;

➤ evidenton tiparet e përgjithshme të strukturës së popullsisë së Shqipërisë, referuar:

- ✓ moshës,
- ✓ gjinisë,
- ✓ vendbanimit,
- ✓ etnisë,
- ✓ fesë;

➤ ndërton dhe analizon grafikë të strukturës së popullsisë dhe hartat e shpërndarjes gjeografike të saj;

➤ përshkruan tiparet e përgjithshme të zhvillimit ekonomik të Shqipërisë, duke analizuar ecurinë e tyre përgjatë periudhave të ndryshme;

➤ vlerëson potencialet natyrore dhe humane të Shqipërisë dhe ndikimin e tyre në shkallën e zhvillimit ekonomik të vendit;

➤ analizon rolin e sektorëve të veçantë të ekonomisë në zhvillimin e Shqipërisë (bujqësinë, industrinë, tregtinë, transportin,

<p>❖ Mundësitë dhe problematikat e zhvillimit të ardhshëm ekonomik.</p>	<p>turizmin, shërbimet dhe artizanatin);</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>vlërëson</u> problemet aktuale dhe perspektivën e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë, në kuadër të integritit rajonal dhe europian; ➤ <u>ndërton</u> dhe <u>analizon</u> grafikët e strukturës së ekonomisë dhe degëve të saj si dhe hartat e shpërndarjes gjeografike të rajoneve kryesore bujqësore dhe industriale të trevave shqiptare. 	
---	---	--

NËNTEMATIKA: RAJONET GJEOGRAFIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

<p>❖ Rajonizimi gjeografik i Shqipërisë. Përcaktimi i rajoneve gjeografike dhe karakteristikat e përgjithshme të tyre.</p> <p>❖ Rajoni Perëndimor: pozita gjeografike, dhe pjesët përbërëse të rajonit.</p> <p>❖ Veçoritë kryesore natyrore të Rajonit</p>	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>identifikon</u> kriteret e rajonizimit gjeografik të Shqipërisë, ndarjen rajonale të saj dhe tipet e rajoneve; ➤ <u>vlërëson</u> rolin e pozitës gjeografike të Rajonit Perëndimor për zhvillimin ekonomik e social të tij dhe për zhvillimin e marrëdhënieve ndër rajonale brenda dhe jashtë Shqipërisë; ➤ <u>përshkruan</u> veçoritë kryesore natyrore të 	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>vlërëson</u> diversitetin natyror, shoqëror dhe kulturor të rajoneve të Shqipërisë; ➤ <u>vlërëson</u> dhe <u>respekton</u> pikëpamjet e të tjerëve; ➤ <u>tregon</u> integritet në aksesimin dhe përdorimin etik të informacionit; ➤ <u>paraqet</u> dhe <u>komunikon</u> lirshëm mendimet e tij;
---	---	--

<p>Perëndimor dhe vlerësimi i tyre për zhvillimin e rajonit.</p> <ul style="list-style-type: none"> ❖ Karakteristikat kryesore të popullimit të Rajonit Perëndimor, me fokus të veçantë rritjen e shpejtë të popullsisë dhe ndryshimet strukturore të saj. ❖ Lëvizjet e shumta të popullsisë drejt rajonit perëndimor, shkaqet dhe pasojat. ❖ Veçoritë e urbanizimit të shpejtë të Rajonit Perëndimor dhe rrjedhojat e tij. ❖ Tiparet e zhvillimit ekonomik të Rajonit Perëndimor dhe ecuria e këtij zhvillimi në periudha të ndryshme. ❖ Struktura e degëve dhe nëndegëve të ekonomisë së rajonit. Roli i tyre në zhvillimin e përgjithshëm. ❖ Trashëgimia natyrore dhe kulturore e Rajonit Perëndimor. ❖ Mundësitë dhe perspektivat e zhvillimit 	<p>Rajonit Perëndimor dhe potencialet natyrore për zhvillim;</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>evidenton</u> karakteristikat kryesore të popullimit të këtij rajoni, me fokus të veçantë rritjen e shpejtë të popullsisë dhe ndryshimet strukturore të saj; ➤ <u>analizon</u> shkaqet e lëvizjes së popullsisë drejt Rajonit Perëndimor dhe pasojat; ➤ <u>analizon</u> urbanizimin e shpejtë të Rajonit Perëndimor dhe rrjedhojat e tij; ➤ <u>vlerëson</u> zhvillimin bujqësor, industrial, të tregtisë, turizmit, transportit etj., të Rajonit Perëndimor; ➤ <u>hulumton</u> në burime të ndryshme informacioni dhe <u>interpretton</u> grafikë, të dhëna statistikore, harta etj., në lidhje me ecurinë e zhvillimit ekonomik të Rajonit Perëndimor në periudha të ndryshme; ➤ <u>vlerëson</u> trashëgiminë natyrore dhe kulturore të Rajonit Perëndimor dhe rolin e saj për zhvillimin e turizmit; ➤ <u>identifikon</u> mundësitë dhe <u>parashikon</u> 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>demonstron</u> pavarësi dhe objektivitet në kryerjen e detyrave; ➤ <u>respekton</u> përpjekjet personale dhe ato në grup.
---	---	---

të mëtejshëm të rajonit.

- ❖ **Rajoni Verior-Verilindor:** veçoritë kryesore natyrore dhe potencialet e shumta natyrore për zhvillimin e tij.
- ❖ Pjesët përbërëse të Rajonit Verior - Verilindor dhe specifikat e tyre rajonale.
- ❖ Tiparet e zhvillimit demografik të Rajonit Verior - Verilindor (numri i popullsisë, shpërndarja e saj, struktura etj).
- ❖ Braktisja masive e Rajonit Verior - Verilindor pas vitit 1990, shkaqet dhe pasojat.
- ❖ Tipare të zhvillimit ekonomik të Rajonit Verior – Verilindor: midis potencialeve të shumta dhe vështirësive të mëdha.
- ❖ Trashëgimia natyrore dhe kulturore e Rajonit Verior - Verilindor.
- ❖ Mundësitë dhe perspektivat e zhvillimit

perspektivën e zhvillimit të Rajonit Perëndimor;

- përshkruan mozaikun natyror të Rajonit Verior - Verilindor dhe potencialet natyrore për zhvillim;
- identifikon tiparet e përgjithshme natyrore të pjesëve përbërëse të Rajonit Verior - Verilindor ;
- evidenton tiparet kryesore të zhvillimit demografik të Rajonit Verior – Verilindor;
- analizon tendencën e ndryshimeve demografike të këtij rajoni me fokus të veçantë braktisjen pas viteve‘90;
- analizon tiparet kryesore të aktivitetit aktual ekonomik të Rajonit Verior - Verilindor;
- vlerëson trashëgiminë natyrore dhe kulturore të Rajonit Verior - Verilindor;
- identifikon mundësitë dhe argumenton

të mëtejshëm të Rajonit Verior - Verilindor.

❖ **Rajoni Juglindor:** pozicioni gjeografik dhe tiparet dalluese natyrore.

❖ Pjesët përbërëse të rajonit dhe rëndësia ndërkufitare e tij për zhvillimin rajonal.

❖ Tiparet e zhvillimit demografik të Rajonit Juglindor.

❖ Lëvizjet e fuqishme migratore të popullsisë së rajonit, veçanërisht pas vitit 1990 dhe efektet e tyre në zhvillimet rajonale.

❖ Potencialet dhe gjendja e zhvillimit

perspektivën e zhvillimit të Rajonit Verior - Verilindor, rolin e korridorit Durrës-Prishtinë në kuadër të këtij zhvillimi dhe të bashkëpunimit rajonal e më gjerë;

➤ ndërton hartën e resurseve natyrore të Rajonit Verior – Verilindor, duke analizuar mundësitë e shfrytëzimit të tyre për zhvillimin social –ekonomik;

➤ vlerëson pozitën gjeografike të Rajonit Juglindor për zhvillimin e bashkëpunimit rajonal;

➤ përshkruan tiparet dalluese natyrore të Rajonit Juglindor;

➤ identifikon pjesët përbërëse të Rajonit Juglindor;

➤ analizon tiparet dalluese dhe tendencën e zhvillimit demografik të Rajonit Juglindor, me fokus të veçantë lëvizjet migratore pas viteve '90;

➤ evidenton disa ndër pasojat e këtyre lëvizjeve në zhvillimet rajonale;

➤ analizon tiparet kryesore të veprimtarisë

ekonomik të Rajonit Juglindor në raport me rajonet e tjera.

❖ Trashëgimia natyrore dhe kulturore e Rajonit Juglindor.

❖ Mundësitë dhe perspektivat e zhvillimit të mëtejshëm të Rajonit Juglindor.

❖ **Rajoni Jugor:** tiparet e përgjithshme natyrore që dallojnë rajonin.

❖ Tiparet e zhvillimit demografik të Rajonit Jugor (numri i popullsisë, shpërndarja e saj, struktura etj.).

❖ Migrimet e popullsisë dhe pasojat e tyre në zhvillimet rajonale.

ekonomike të Rajonit Juglindor, duke e krahasuar dhe me rajonet e tjerë;

➤ vlerëson trashëgiminë natyrore dhe kulturore të Rajonit Juglindor dhe rëndësinë e saj për zhvillimin e turizmit;

➤ identifikon mundësitë dhe argumenton perspektivën e zhvillimit të Rajonit Juglindor;

➤ ndërton hartën e infrastrukturës rrugore të Rajonit Juglindor, duke evidentuar rolin e saj në integrimin dhe bashkëpunimin me shtetet fqinje dhe më gjerë;

➤ vlerëson rëndësinë e pozitës gjeografike ndërkufitare të Rajonit Jugor për zhvillimet rajonale;

➤ përshkruan tiparet e përgjithshme natyrore që dallojnë Rajonin Jugor;

➤ analizon tiparet dalluese të zhvillimit demografik të Rajonit Jugor;

➤ evidenton pasojat e migrimeve të popullsisë së Rajonit Jugor;

❖ Struktura e zhvillimit ekonomik të Rajonit Jugor dhe pasojat ndërrajonale të saj.	➤ <u>dallon</u> tiparet kryesore të veprimtarisë ekonomike të Rajonit Jugor dhe pasojat ndërrajonale të saj;
❖ Trashëgimia natyrore dhe kulturore e Rajonit Jugor.	➤ <u>vlerëson</u> trashëgiminë natyrore dhe kulturore të Rajonit Jugor dhe rëndësinë e saj;
❖ Mundësitë dhe perspektivat e zhvillimit të mëtejshëm të Rajonit Jugor.	➤ <u>identifikon</u> mundësitë dhe argumenton perspektivën e zhvillimit të Rajonit Jugor; ➤ <u>ndërton</u> hartën e zonave kryesore turistike të Rajonit Jugor.

NËNTEMATIKA: PABARAZITË DHE MUNDËSITË E ZHVILLIMIT RAJONAL

❖ Pabarazitë në shkallën e zhvillimit socio-ekonomik midis rajoneve të vendit.	<i>Nxënësi:</i> ➤ <u>përshkruan</u> tiparet dalluese të pabarazive të zhvillimit socio-ekonomik të rajoneve të vendit tonë;	<i>Nxënësi:</i> ➤ <u>demonstron</u> pavarësi dhe objektivitet në kryerjen e detyrave;
❖ Shkaqet dhe faktorët që kanë ndikuar në pabarazitë e theksuara të zhvillimit rajonal, veçanërisht pas vitit 1990.	➤ <u>analizon</u> faktorët që kanë ndikuar në pabarazitë e zhvillimeve rajonale;	➤ <u>tregon</u> integritet në aksesimin dhe përdorimin etik të informacionit;
❖ Drejtimit në të cilat shprehen pabarazitë e zhvillimit rajonal dhe rrugët për zbutjen e tyre.	➤ <u>përcakton</u> drejtimit kryesore të këtyre dallimeve, të tilla si: ✓ popullimi, ✓ zhvillimi ekonomik,	➤ <u>komunikon</u> lirshëm mendimet e tij; ➤ <u>është krijues</u> dhe <u>prezanton</u> idetë e reja të tij; ➤ <u>demonstron</u> objektivitet në

❖ Mundësitë dhe aftësitë konkurruese të Shqipërisë për zhvillimet e ardhshme rajonale.

- ✓ shkalla e urbanizimit,
- ✓ niveli i papunësisë,
- ✓ etj;
- identifikon disa nga rrugët për zbutjen e pabarazive;
- vlerëson potencialet konkurruese të Shqipërisë për zhvillimet e ardhme rajonale (të tilla, si bujqësia, energjia, turizmi etj.).

diskutimet dhe debatet;

- respekton punën e të tjerëve;
- respekton përpjekjet personale dhe ato në grup.

11. UDHËZIME METODOLOGJIKE

Metodat, teknikat, strategjitë e mësimdhënies, në lëndën e gjeografisë, janë faktorë të rëndësishëm për një mësimdhënie të suksesshme që nxit interesin, gjithëpërfshirjen, ndërveprimin dhe punën kërkimore të nxënësve.

Përzgjedhja dhe përdorimi i tyre nga mësuesit bëhet në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve, duke respektuar stilet e ndryshme të të nxënësve të tyre.

Mësimdhënia dhe të nxënësve, bazuar në kompetenca, kërkon që në përzgjedhjen dhe përdorimin e strategjive, teknikave dhe metodave të mësimdhënies, mësuesit e kësaj lënde:

- të marrin parasysh njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet paraprake të nxënësve, që nënkupton përvojat individuale të tij dhe, mbi këtë bazë, të mbështesin e orientojnë të nxënësve të tij;
- të nxitin vërtetimin e drejtpërdrejtë, kureshtjen, arsyetimin dhe gjykimin nëpërmjet demonstrimeve dhe vëzhgimeve në natyrë;
- të nxitin të menduarit kritik, krijues, dhe zgjidhjen e problemeve;
- të motivojnë nxënësve, duke e konsideruar si partner, në kuptimin që në procesin mësimor mësuesi dhe nxënësi janë plotësues të njëri-tjetrit;
- të mbështesin të nxënësve të pavarur dhe në bashkëpunim të nxënësve përmes punës me projekte, punës në grup, punës individuale;
- të mbajnë parasysh integrimin dhe marrëdhënien ndërmjet lëndëve të fushës” Shoqëria dhe mjedisi”, zbatimet e tyre në jetën e përditshme, si dhe lidhjen ndërlëndore;
- të shfrytëzojnë burime të shumëllojshme informacioni dhe ta çmojnë tekstin si një burim të rëndësishëm, por të pamjaftueshëm për përmbushjen e kompetencave të fushës;
- të përdorin TIK-un si mbështetës dhe lehtësues të mësimdhënies dhe të nxënësve.

Rolet që ndërmarrin nxënësi dhe mësuesi në realizimin e kësaj qasje janë:

- ❖ *Nxënësi – veprues dhe i interesuar.* Në gjeografi, nxënësi studion dukuritë dhe proceset gjeografike. Ai nxitet të kërkojë përgjigje për pyetjet që ngre, duke hulumtuar në burime të ndryshme dhe, duke përdorur teknika specifike të gjeografisë. Nxënësi angazhohet të vendosë lidhje ndërmjet asaj që di dhe asaj që zbulon dhe mbi këtë bazë ndërton dijen e tij, bashkëvepron me shokët/shoqet dhe mësuesin, ndan me ta vëzhgimet dhe përvojat e tij. Ai punon individualisht, ose në grup dhe mbështetet nga mësuesi.
- ❖ *Nxënësi si partner.* Partneriteti i mësuesit me nxënësin në mësimdhënie rrit motivimin dhe e bën mësimdhënien më tërheqëse, duke krijuar kushte që ajo të jetë e suksesshme;
- ❖ *Mësuesi - udhëheqës dhe lehtësues.* Mësuesi i gjeografisë ndihmon nxënësit të zbulojnë kënaqësitë e të nxënit. Roli i mësuesit konsiston në udhëheqjen e nxënësve; ai moderon nxënësit në eksplorimin e dukurive gjeografike. Mësuesi vepron si moderator midis dijes dhe nxënësit, duke e ndihmuar nxënësin të përfshihet në procesin e ndërtimit të dijes. Ai krijon kontekste të nxëni, të cilat i aftësojnë nxënësit të përftojnë mjetet e gjeografit. Zbatimi i programit kërkon që mësuesi të përdorë strategji mësimdhënieje duke respektuar stilet e të nxënit të nxënësve. Ai i angazhon nxënësit në ndërtimin e mendimit, duke nxitur diskutimet dhe ballafaqimin e këndvështrimeve të ndryshme.

Mësimdhënia dhe të nxënit në gjeografi duhet të mbështeten në situata të jetës reale. Të nxënit fillon kur ata përpiqen të zgjidhin probleme dhe të eksplorojnë situata të jetës reale për të gjetur përgjigjet e pyetjeve që kanë, ose për të zgjidhur probleme. Të nxënit me situata përfshin pjesëmarrjen e nxënësve në detyra që janë të ngjashme me zbatimet në botën reale. Kërkimi, analiza dhe përzgjedhja e të dhënave duhet të jenë gjithmonë pjesë e situatave të të nxënit. Ato duhet të mbështeten në kërkimin gjeografik, i cili përfshin analizën krahasuese të dukurive gjeografike në shkallë të ndryshme. Këto lloj situatash kërkojnë zhvillimin e shprehive të të pyeturit, analizës, mendimit kritik dhe krijues.

Programi i gjeografisë u krijon nxënësve hapësirë dhe mundësi situatash të nxëni përmes punës dhe vëzhgimeve në terren, diskutimit të çështjeve aktuale në nivel lokal dhe global, të tilla si: ndryshimet klimatike, tërmetet, katastrofat natyrore, përmbytjet, rrëshqitjet e dherave, erozioni i lumenjve, i plazheve etj.; analizave të zhvillimeve demografike dhe ekonomike të vendit dhe rajoneve përbërës etj. Mësuesit duhet të marrin parasysh faktin se nxënësit janë të ndryshëm, kanë motivim, interesa, stile të nxëni, nevoja dhe aftësi të ndryshme etj. Fleksibiliteti i zhvillimit të programit lejon plotësimin e nevojave individuale të nxënësve me vështirësi në të nxënë dhe të nxënësve të talentuar.

12. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

Vlerësimi është pjesë integrale e procesit të mësimdhënies dhe të nxënit. Vlerësimi mat shkallën në të cilën janë arritur (nga nxënësit) njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e dëshiruara. Ai përfshin mbledhjen e informacioneve me anë të teknikave të ndryshme të vlerësimit për arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënit në nivel klase dhe shkalle. Me këtë informacion, mësuesi merr vendime për vlerësimin përfundimtar të nxënësit, bazuar në gjykimin e tij për nivelin e zotërimit nga nxënësi të kompetencave të fushës “Shoqëria dhe mjedisi”. Vlerësimi u shërben mësuesve për të përmirësuar metodat e mësimdhënies, nxënësve për të përmirësuar të nxënit si dhe prindërve për të monitoruar progresin e fëmijëve të tyre në shkollë.

Mësuesit duhet të përdorin situata të jetës reale si pikënisje për vlerësimin e nxënësve. Format e ndryshme të vlerësimit duhet t’u krijojnë mundësi të gjithë nxënësve të vlerësohen në atë mënyrë që është më e përshtatshme për to.

Për vlerësimin e nxënësve, mësuesit duhet të mbështeten në disa parime bazë:

- ❖ Vlerësimi duhet të jetë i ndershëm dhe i paanshëm. Nxënësit duhet t’i jepet mundësia të demonstrojnë shkallën e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve.
- ❖ Vlerësimi duhet t’i ndihmojë nxënësit. Ai duhet t’u japë informacion pozitiv dhe nxitës për t’u përfshirë aktivisht në procesin e të nxënit.

- ❖ Vlerësimi udhëhiqet nga rezultatet e të nxënit dhe shfrytëzon shumëllojshmëri strategjish dhe teknikash vlerësimi.

Disa ndër to mund të jenë:

- ❖ Vlerësimi përmes të pyeturit, diskutimi etj.
- ❖ Vlerësimi përmes punëve praktike.
- ❖ Vlerësimi përmes projekteve kurrikularë, lëndorë ose ndërlëndorë.
- ❖ Vlerësimi me shkrim (detyra të veçanta për grupe nxënësish, testim, detyra në grup ose individualisht).

13. MATERIALET DHE BURIMET MËSIMORE

Përdorimi i mjeteve mësimore në mësimdhënien dhe procesin e të nxënit në fushën “Shoqëria dhe mjedisi” ndihmon në konkretizimin e ideve dhe dukurive, në aplikimin e metodave dhe strategjive të mësimdhënies, si dhe e bën mësimin më interesant dhe më argëtues për nxënësin. Përdorimi i suksesshëm i metodave dhe i teknikave të lartpërmendura nuk mund të realizohet pa mjetet e nevojshme didaktike, të cilat mund të jenë të llojeve të ndryshme, si: harta të përgjithshme ose tematike, atlase, albume, foto, skica, filma mësimorë, kompjuter, aparat projektimi, CD, DVD etj.;

Ndërsa mësuesi është përgjegjës për krijimin e një mjedisi stimulues. Ai duhet të sigurojë që nxënësi të ketë akses në burimet e ndryshme të të nxënit. Lista e burimeve të vlefshme për zhvillimin e kompetencave në gjeografi është e larmishme: muze, harta, plane, piktura, dokumente historike, dokumente audio-vizive etj. Gjithashtu burimet përfshijnë teknologjitë e informacionit dhe komunikimit që nxënësit i përdorin si mjete kërkimi dhe për përgatitjen e projekteve dhe detyrave të ndryshme.

Sugjerime për përdorimin e TIK-ut

- ❖ Përdorimi i postës elektronike për shkëmbim informacioni.
- ❖ Përdorimi i internetit për të shfrytëzuar faqet Web për gjeografinë.

- ❖ Përdorimi i CD-ROM për mbledhjen e informacionit mbi temat që nxënësi studion.
- ❖ Organizimi dhe prezantimi i të dhënave, duke përdorur tipa të ndryshëm software.
- ❖ Përdorimi i simulimeve software.
- ❖ Përdorimi i grafikëve software.
- ❖ Paraqitja grafike e të dhënave.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT**

AGJENCIA E SIGURIMIT SË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

**PROGRAMET E KULTURËS SË PËRGJITHSHME
TË ARSIMIT TË MESËM PROFESIONAL**

Lënda: Biologji

Klasa: XIII

Struktura 2+1+1, Struktura 2+2 dhe Bllok 4-vjeçar

TIRANË, 2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

**PROGRAMET E KULTURËS SË PËRGJITHSHME
TË ARSIMIT TË MESËM PROFESIONAL**

Lënda: Biologji

Klasa: XIII

Struktura 2+1+1, Struktura 2+2 dhe Bllok 4-vjeçar

2024

Hyrje

Shkenca është veprimtari intelektual dhe praktike që përfshin studimin sistematik të strukturës dhe të sjelljes së botës fizike dhe natyrore përmes vëzhgimeve dhe eksperimenteve. Mësimi i shkencave natyrore iu ofron nxënësve mundësi për të zhvilluar të kuptuarit e koncepteve dhe të proceseve shkencore, të praktikave më të përdorura nga njeriu për zhvillimin e njohurive shkencore, të kontributit të shkencës në shoqëri dhe të zbatimeve të saj në jetën e përditshme.

Kurrikula e shkencës ndihmon në zhvillimin e kompetencave që u shërbejnë individëve në aspektin personal, social, ekonomik dhe që lidhen me çështje lokale, kombëtare dhe globale. Kompetencat që zhvillon fusha e shkencave të natyrës, në të gjitha shkallët kontribuojnë në arritjen e kompetencave kyçe, në funksion të të nxënësve gjatë gjithë jetës.

Përmbajtja lëndore konceptohet si mjet për realizimin e kompetencave kyçe dhe atyre të fushës nëpërmjet formësimit të situatave të të nxënësve. Nxënësit fillojnë me idetë e tyre se si janë gjërat dhe pastaj i ndryshojnë dhe i zhvillojnë duke i provuar ato praktikisht. Gjatë veprimtarive shkencore, nxënësit ndeshen me mundësitë e ndryshimit, rivendosjes ose sfidës së ideve. Kjo mënyrë e të nxënësve bën që nxënësit të zhvillojnë dhe të formojnë të kuptuarit shkencor përmes ideve dhe përvojave të tyre. Idetë dhe konceptet përpunohen për sa kohë nxënësit punojnë në situata problemore dhe zbatojnë metoda kërkimore për t'i zgjidhur problemet. Duke mësuar në këtë mënyrë, ata mund të përjetojnë gëzimin e zbulimit shkencor dhe të ushqejnë kureshtjen për botën që i rrethon.

Mësimi i shkencave natyrore lidhet ngushtë me teknologjinë dhe së bashku i formojnë nxënësit në një kontekst më të gjerë.

Programi mbështetet në kornizën kurrikulare të arsimit parauniversitar, në kurrikulën bërthamë dhe në planin mësimor të AML-së. Ai u shërben:

- *nxënësve* për zhvillimin e kompetencave kyçe të të nxënit gjatë gjithë jetës dhe kompetencave të fushës së shkencave të natyrës;
- *mësuesve* për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e veprimtarive mësimore dhe arritjeve të nxënësve në klasë dhe jashtë saj;
- *prindërve* për njohjen e rezultateve të pritshme të fëmijëve dhe kriterëve të vlerësimit në periudha të caktuara;
- *hartuesve të teksteve mësimore* dhe të materialeve ndihmëse për mësuesit dhe nxënësit.

Zbatimi i programit bëhet duke respektuar parimet e gjithëpërfshirjes në aspektin gjinor, etnik, kulturor, racor, fetar, të paaftësive dhe nevojave të veçanta të nxënësve.

Koordinoi programin:
Mimoza Milo

I. Qëllimet e fushës

Qëllimet e fushës së shkencave të natyrës janë konceptuar në funksion të të nxënimit gjatë gjithë jetës.

Përmes kësaj fushe nxënësit:

- zhvillojnë njohuritë dhe konceptet bazë për formimin shkencor në fushën e shkencave të natyrës;
- zbulojnë lidhjet e varësisë ndërmjet botës së gjallë dhe mjedisit;
- zbulojnë lidhjet e varësisë ndërmjet botës së gjallë, botës jo të gjallë dhe mjedisit;
- zhvillojnë aftësitë shkencore, mendimin kritik dhe krijues;
- zbatojnë njohuritë dhe aftësitë shkencore në mënyrë analitike, kritike dhe krijuese në problemet që kërkojnë zgjidhje dhe marrje vendimesh;
- vlerësojnë kontributin e shkencës dhe të teknologjisë për mirëqenien e njeriut dhe të shoqërisë;
- ndërgjegjësohen për të bashkëvepruar me mjedisin në mënyrë të përgjegjshme dhe konsensuale;
- përshkruajnë proceset natyrore në kohë dhe në hapësirë;
- përshkruajnë burimet energjetike;
- shpjegojnë proceset përmes katër bashkëveprimeve (gravitetit, elektromagnetik, bërthamor dhe bashkëveprimi i dobët);
- përdorin teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit, si mjet për sigurimin dhe komunikimin e informacionit;
- shpjegojnë rolin e shkencës në zhvillimin e qëndrueshëm, si edhe në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit.

Programi i fushës së shkencave natyrore synon realizimin e kompetencave kyçe të të nxënimit dhe të kompetencave të fushës. **Kompetencat e fushës** lidhen me **kompetencat kyçe** nëpërmjet **rezultateve të të nxënimit** të secilës prej tyre. Lidhja mes rezultateve të të nxënimit të kompetencave të fushës dhe të kompetencave kyçe siguron zhvillimin e ndërsjellë të tyre dhe mundëson integrimin lëndor. Kompetencat e fushës së shkencave natyrore mund të konsiderohen si komponentë të kompetencës së kërkimit shkencor. Ato janë renditur si më poshtë:

Kompetenca I: Identifikimi i problemeve dhe zgjidhja e tyre

a) *Nxënësi përcakton problemin.*

- Merr parasysh kontekstin e situatës.

- Paraqet problemin.
- Identifikon të dhënat fillestare.
- Identifikon elementet që lidhen me situatën dhe me njëra-tjetrën.
- Reformulon problemin duke përdorur koncepte shkencore dhe teknologjike.
- Propozon një shpjegim ose zgjidhje të mundshme.

b) Nxënësi zhvillon një plan veprimi.

- Eksploron disa nga shpjegimet ose zgjidhjet fillestare.
- Zgjedh shpjegimin ose zgjidhjen.
- Identifikon burimet e nevojshme.
- Planifikon hapat e zbatimit.

c) Nxënësi analizon rezultatet.

- Kërkon modelet ose marrëdhëniet domethënëse.
- Gjykon përshtatshmërinë e përgjigjes ose zgjidhjes së gjetur.
- Lidh rezultatet dhe konceptet shkencore dhe teknologjike.
- Sugjeron përmirësime nëse është e nevojshme.
- Nxjerr përfundime.

d) Nxënësi zbaton planin e veprimit.

- Ndjek hapat e planit të vet.
- Përdor teknikat dhe burimet e përshtatshme.
- Bën teste nëse është e mundur.
- Mbledh të gjitha të dhënat e dobishme dhe mban shënime për vrojtimet e bëra.
- Nëse është e nevojshme, përshtat planin e veprimeve ose zbatimin e tij.
- Zbaton planin e veprimeve.

Kompetenca II: Përdorimi i mjeteve, objekteve dhe procedurave shkencore

a) Nxënësi vendos çështjet shkencore në kontekstin e duhur.

- Identifikon aspekte të kontekstit (p. sh., sociale, mjedisore, historike).

- Bën lidhjen ndërmjet këtyre aspekteve.
- Identifikon ndonjë çështje etike që lidhet me çështjen.
- Parashikon pasojat afatgjata.

b) *Nxënësi kupton parimet shkencore mbi të cilat ngrihet çështja.*

- Njih parimet shkencore.
- I përshkruan parimet në mënyrë sasiore dhe cilësore.
- Vendos lidhjet mes parimeve duke përdorur konceptet, ligjet ose modelet.

c) *Nxënësi formon një opinion për çështjen.*

- Kërkon burime të ndryshme dhe merr parasysh këndvështrime të ndryshme.
- Përcakton elementet që mund të ndihmojnë për të formuar opinionin.
- Mbështet opinionin e vet me elementet që ka marrë parasysh.
- Vlerëson opinionin e vet duke marrë parasysh edhe opinionet e të tjerëve.

d) *Nxënësi vendos lidhjen mes shkencës dhe teknologjisë.*

- Identifikon funksionet e përgjithshme të një objekti, sistemi ose procesi.
- Identifikon elementet përbërëse dhe funksionet e tyre.
- Përshkruan parimet e ndërtimit dhe të funksionimit të një objekti, sistemi, produkti ose procesi.
- Vendos lidhjet mes parimeve shkencore dhe teknologjike duke përdorur konceptet, ligjet ose modelet.
- Paraqet skematikisht parimet sipas të cilave funksionon objekti, sistemi, produkti ose procesi.

Kompetenca III: Komunikimi në gjuhën dhe terminologjinë e shkencës

a) *Nxënësi shkëmben informacion shkencor dhe teknologjik.*

- Është i hapur ndaj këndvështrimeve të të tjerëve.
- Vlerëson këndvështrimin e vet duke e krahasuar me atë të të tjerëve.
- Integron termat shkencore dhe teknologjike në fjalorin e gjuhës së shkruar dhe të folur.

b) *Nxënësi interpreton mesazhet shkencore dhe teknologjike.*

- Vërteton besueshmërinë e burimeve që shfrytëzon.
- Identifikon informacionin që ka të bëjë me çështjen dhe shpjegimin ose zgjidhjen e saj.
- Kupton përmbajtjen e saktë të fjalëve, përkufizimeve dhe formulimeve.
- Bën lidhjet mes koncepteve dhe paraqitjeve të ndryshme grafike ose simbolike.
- Zgjedh elementet domethënëse.

c) *Nxënësi krijon dhe ndan mesazhe shkencore dhe teknologjike.*

- Merr parasysh audiencën dhe kontekstin e grupit që merr mesazhin.
- Strukturon mesazhin e tij.
- Përdor tipat e përshtatshëm të gjuhës sipas standardeve dhe marrëveshjeve të vendosura.
- Përdor forma të përshtatshme të prezantimit.
- Demonstron rigozitet dhe koherencë.

Të tria kompetencat e fushës lidhen me njëra-tjetrën. Nëse kompetenca e parë ka të bëjë me mënyrat e të arsyetuarit që u mundësojnë nxënësve të merren me probleme shkencore, dy kompetencat e tjera i mësojnë ata se si të përdorin instrumentet dhe procedurat e duhura dhe si të komunikojnë në gjuhën e shkencës dhe të teknologjisë për të zgjidhur problemet. Duke zbatuar mënyrat e të arsyetuarit shkencor, nxënësit kuptojnë natyrën e mjeteve, objekteve dhe procedurave të përdorura në këtë fushë dhe janë të aftë të vlerësojnë ndikimin pozitiv apo negativ të shkencës dhe të teknologjisë në mjedis dhe në shoqëri. Përveç kësaj, në prezantimin e shpjegimeve ose sqarimin e zgjidhjeve të tyre, ata ndërgjegjësohen për rëndësinë e përdorimit të saktë të gjuhës dhe të terminologjisë në shkencë dhe në teknologji.

Këto kompetenca zhvillohen së bashku dhe jo veçmas apo njëra pas tjetrës. Për të realizuar metodat dhe procedurat specifike shkencore, nxënësit njohin konceptet dhe gjuhët që lidhen me to, si dhe aftësohen në përdorimin e tyre. Ata familjarizohen me këto metoda dhe procedura, të cilat kanë kuptim dhe rëndësi sipas konteksteve ku zbatohen.

Kompetencat zhvillohen përmes **tematikave të përbashkëta të fushës** dhe në program zërthehen në njohuri/aftësi, shkathtësi/procedura, qëndrime/vlera. Tematikat e përbashkëta të fushës janë elemente të rëndësishme të programit të fushës së shkencave natyrore, sipas të cilave strukturohet përmbajtja lëndore dhe integrimi konceptual i secilës prej lëndëve brenda fushës, në funksion të zhvillimit të kompetencave. Tematikat e përbashkëta për shkallën e pestë dhe të gjashtë janë: *diversiteti, ciklet, sistemet, ndërveprimet, energjia,*

shkallëzimi dhe matja, modelet.

Strukturimi i programit mbi rezultatet e të nxënësve për kompetencë në secilën lëndë dhe në tematika të përbashkëta, të njëjta për të gjitha lëndët e fushës, ndihmon në planifikimin dhe në zhvillimin e situatave të të nxënësve dhe lehtëson vlerësimin e nxënësve për kompetencat kyçe.

Situatat e të nxënësve janë situata që lidhen me kontekstin e të nxënësve. Ato mund të jenë situata në mjedise të mbyllura ose të hapura të nxënësve, brenda shkollës ose jashtë saj. Roli i mësuesit në mësimdhënien përmes situatave është ai i udhëheqësit e i lehtësuesit gjatë nxënësve aktive të nxënësve.


Realizimi i **temave ndërkurrikulare** dhe i **lidhjes ndërlëndore** nëpërmjet lëndëve të shkencave natyrore janë, gjithashtu, elemente të rëndësishme të programit.

Metodat, teknikat, strategjitë e të nxënësve në fushën e shkencave natyrore janë faktorë të rëndësishëm për një nxënës të suksesshëm që nxënësve interesin, gjithëpërfshirjen, ndërveprimin dhe punën kërkimore të nxënësve. Përzgjedhja dhe përdorimi i tyre nga mësuesit bëhet në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve, duke respektuar stilet e ndryshme të të nxënësve.

Vlerësimi, si pjesë integrale e procesit të të nxënësve, mat shkallën në të cilën kompetencat janë arritur nga nxënësve. Meqenëse i gjithë procesi i të nxënësve në shkencat natyrore mbështetet në kërkimin shkencor, vlerësimi merr shumë forma, të cilat i parashikon dhe i mundëson struktura dhe konceptimi i programit.

Realizimi i programit të fushës së shkencave natyrore kërkon krijimin e një **mjedisi të nxënësve**, të përshtatshëm, gjithëpërfshirës, të pasur me materiale dhe burime të domosdoshme, si dhe përdorimin e gjerë të TIK-ut.

Diagrami 1: Korniza konceptuale e programit



1. Lidhja e kompetencave të fushës me kompetencat kyçe

Kompetencat e fushës së shkencave lidhen dukshëm dhe në mënyrë logjike e metodike me kompetencat kyçe dhe me tematikat e fushës, të cilat janë në funksion të zhvillimit të tyre.

Kompetencat e fushës së shkencave natyrore lidhen me kompetencat kyçe nëpërmjet rezultateve të të nxënit të secilës prej tyre. Lidhja mes rezultateve të të nxënit të kompetencave të fushës dhe kompetencave kyçe siguron zhvillimin e ndërsjellët të tyre dhe lehtëson vlerësimin e nxënësve për kompetencat kyçe. Nga ana tjetër, kompetencat e fushës së shkencave natyrore lidhen edhe me njëra-tjetrën. Nëse kompetenca e parë **“Identifikimi i problemeve i problemeve dhe zgjidhja e tyre”** ka të bëjë me mënyrat e të arsyetuarit që u mundësojnë nxënësve të merren me probleme shkencore, dy kompetencat e tjera **“Përdorimi i mjeteve, i objekteve dhe i procedurave shkencore”** dhe **“Komunikimi në gjuhën dhe në terminologjinë e shkencës”** u mësojnë atyre se si të përdorin instrumentet dhe procedurat e duhura dhe si të komunikojnë në gjuhën e shkencës dhe të teknologjisë për të zgjidhur problemet. Duke zbatuar mënyrat e të arsyetuarit shkencor, nxënësit do të kuptojnë natyrën e mjeteve, objekteve dhe procedurave të përdorura në këtë fushë dhe do të jetë të aftë të vlerësojnë ndikimin pozitiv apo negativ të shkencës dhe të teknologjisë në mjedis dhe në shoqëri. Përveç kësaj, në prezantimin e shpjegimeve ose sqarimin e zgjidhjeve të tyre, nxënësit do të ndërgjegjësohen për rëndësinë e përdorimit të saktë të gjuhës dhe të terminologjisë në shkencë dhe në teknologji.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet lidhja e rezultateve të të nxënit të kompetencave të fushës me rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe. Megjithëse paraqiten të ndara në tabelë, nuk ka një kufi të prerë të lidhjes së rezultatevetë të nxënit të kompetencave të fushës me rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe, pasi një kufi i tillë nuk ekziston mes kompetencave në vetvete, si tek ato kyçe ashtu edhe tek ato të fushës.

Tabela 1: Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet fushës së shkencave të natyrës

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit <i>Nxënësi komunikon në mënyrë efektive</i>
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">- shprehet përmes një forme komunikimi, për një temë të caktuar në një material (prezantim) prej 200 fjalësh dhe veçon çështjet kryesore;- diskuton në grup në mënyrë konstruktive, në një kohëzgjatje jo më shumë se 10 minuta, duke dhënë dhe duke marrë informacion për një temë të caktuar nga fushat mësimore ose nga jeta e përditshme;- përdor drejt strukturën dhe rregullat e drejtshkrimit në kontekste dhe forma të ndryshme të shkrimit, si: ese, e-mail (postë elektronike), letër formale dhe joformale etj.;- prezanton një projekt artistik, humanitar, eksperimentues etj. nga fusha të ndryshme mësimore, të hartuar individualisht dhe në grup, për një temë të caktuar, duke përdorur në mënyrë efektive teknologjinë informative dhe teknologji të tjera;- përdor TIK-un në mënyrë efektive gjatë komunikimit dhe ndërveprimit me të tjerët në jetën e përditshme, duke përfshirë edhe të nxënit e informacioneve të reja dhe kryerjen e detyrave shkollore.
Kompetenca e të menduarit <i>Nxënësi mendon në mënyrë krijuese</i>
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">- prezanton në forma të ndryshme të të shprehurit, mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informatave për fusha

të ndryshme mësimore apo për një temë të caktuar, ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse (p.sh.: temë nga shkenca, nga kultura, nga arti, nga sporti, nga shëndetësia, nga shoqëria, nga mjedisi etj.);

- krahason të paktën tri burime të ndryshme të informimit për trajtimin e temës së njëjtë, argumenton saktësinë, rrethanat, gjen ngjashmëritë dhe dallimet, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara më parë dhe i prezanton gjetjet kryesore para të tjerëve në forma të ndryshme shprehëse, duke përdorur teknologjinë informative;
- harton një detyrë me tekst, apo krijon një situatë logjike nga jeta e përditshme, e cila përmban një mesazh që kërkon zgjidhje matematikore apo një problem shkencor, duke u bazuar në njohuritë paraprake dhe prezanton mënyrën/procedurën e zgjidhjes së problemit para të tjerëve;
- modelon zgjidhjen e një problemi të dhënë (në klasë, apo jashtë saj) për një temë të caktuar nga një fushë mësimore, duke e zbërthyer në hapa të vegjël dhe jep sqarime të nevojshme për hapat e ndjekur në zgjidhjen e problemit, duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit;
- llogarit me saktësi koston e buxhetit të planifikuar për një aktivitet të caktuar (p.sh.: ekskursion, përvjetor i shkollës, konkurs , program arsimor për TV etj.), e prezanton atë me gojë dhe me shkrim para klasës, duke përdorur arsyetimin matematikor;
- gjykon vërtetësinë e një rezultati të dhënë (p.sh.: rezultatin e një detyre nga matematika, shkencat, shoqëria, mjedisi etj.) i cili mund të jetë gjetur me zbatimin e formulave të njohura ose me përdorimin e procedurave të caktuara dhe nxjerr përfundime për vërtetësinë e gjykimit të dhënë;
- prezanton me sukses rezultatet e punës së një detyre eksperimentale për një temë të caktuar nga ndonjë fushë mësimore (p.sh.: nga shkencat, teknologjia etj.) të realizuar në laborator, në ambientet e shkollës apo diku tjetër, përmes përdorimit të teknologjisë informative dhe jep argumente që lidhin rezultatet e punës eksperimentale me udhëzimet teorike;
- krijon një vepër artistike me pamje dy dhe tredimensionale me mesazhe nga një fushë mësimore dhe shpjegon para moshatarëve hapat e ndjekur për krijimin e veprës;
- krijon një situatë për marrjen e një vendimi për jetën e vet ose zgjidhjen e një problemi me interes shoqëror, lidh vendimin me

pasojat në mënyrë të përgjegjshme dhe e prezanton gjatë një debati me moshatarë në një kohëzgjatje të caktuar.

Kompetenca e të nxënit

Nxënësi mëson për të nxënë

Nxënësi:

- demonstroi shkathhtësi funksionale në lexim, në shkrim, në matematikë, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre apo aktiviteti dhe gjatë të nxënit të dijeve të reja në ndonjë fushë të caktuar mësimore;
- shfrytëzon në mënyrë efektive përvojat paraprake gjatë zgjidhjes së situatave të ndryshme në jetën e përditshme apo gjatë kryerjes së ndonjë detyre, aktiviteti, në ndonjë fushë të caktuar mësimore. Diskuton dhe ndan përvojat me të tjerët për mënyrat më praktike të shfrytëzimit të përvojave paraprake në arritjen e dijeve të reja;
- parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuar për zgjidhjen e një problemi apo detyre të një teme të caktuar, bën përmbledhjen e së paku dy veprimeve të përdorura, të cilat përcaktojnë drejtimin e mëtejshëm të të nxënit për temën apo problemin e caktuar;
- zgjidh një problem të caktuar mësimor ose një situatë nga jeta e përditshme. Në bazë të një planifikimi të dhënë dhe në bazë të rezultatit të fituar, vërteton saktësinë e planifikimit dhe tregon me shembuj se si do të zbatojë strategjinë e ndjekur edhe në situata dhe kontekste të tjera gjatë të nxënit;
- përgatit me sukses një përmbledhje të dosjes personale (portofolit), me jo më pak se 900 fjalë, për vetëvlerësimin e përparimit të vet në një fushë mësimore të caktuar dhe veçon në fund të përmbledhjes disa çështje që vërtetojnë përparimin e vet dhe disa nevoja të domosdoshme për përmirësimin e avancimit të mëtejshëm;
- shfrytëzon, në mënyrë të pavarur dhe efektive, teknologjinë informative dhe burime të tjera të informimit për të mbledhur materiale për zgjidhjen e një problemi apo detyre të caktuar, të cilat më pas i analizon, i klasifikon dhe i paraqet para të tjerëve përmes TIK-ut dhe ndonjë forme tjetër të shprehjes;
- paraqet idetë personale para të tjerëve për mënyrën e zhvillimit të një aktiviteti të caktuar, duke dhënë mendime të argumentuara

për rezultatet e pritura (në formë skice, grafiku, vizatimi, shkrimi, veprë artistike etj.);

- shfrytëzon, në mënyrë të pavarur, udhëzimet e dhëna nga ndonjë burim informacioni për të kryer një veprim, aktivitet, detyrë, ose për të zgjidhur një problem që kërkohet prej tij. Vlerëson vetë performancën dhe rezultatin e arritur, duke iu referuar qëllimeve fillestare (p.sh.: burime të informacionit në libër, revistë, enciklopedi, internet, hartë, grafik, skicë, partiturë muzikore, skenar etj.).

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive

Nxënësi:

- përgatit, prezanton, drejton dhe merr pjesë në një fushatë të informimit të qytetarëve për një fushë apo temë të caktuar, duke u mbështetur në ide të reja, bazuar në rezultate të pritshme të përcaktuara qartë (p.sh.: fushatë informimi për mbrojtjen e mjedisit, sigurinë, shëndetin etj.);
- demonstroi shprehje organizative në punët individuale dhe në ekip përmes situatave reale në detyrat e veçanta mësimore, duke menaxhuar potencialin individual dhe atë të grupit, si dhe kohën, rreziqet dhe buxhetin në dispozicion;
- harton një projekt me faza të menaxhuara mirë (individualisht ose në grup) duke shkëmbyer, konsultuar dhe informuar të tjerët si dhe duke identifikuar dhe vlerësuar burimet njerëzore, materiale dhe monetare në përputhje me rezultatet e pritshme;
- analizon gjendjen e mjedisit (në klasë, në shkollë, në komunitet apo më gjerë), pasojat e ndotjes, propozon alternativa për mbikëqyrje dhe menaxhim të drejtë të gjendjes së vlerësuar më të ndjeshme dhe inicicion zgjidhje konkrete.

Kompetenca personale

Nxënësi bën jetë të shëndetshme

Nxënësi:

- analizon përparësitë dhe dobësitë personale, duke evidentuar masat përmes të cilave synon të mbështesë avancimin personal në përparësitë që ka dhe masat përmes të cilave synon të përmirësojë dobësitë personale;
- merr pjesë ose udhëheq një grup pune, që bashkëpunon me përfaqësues të komunitetit për të ndihmuar moshatarët dhe anëtarët e

tjerë të komunitetit, të cilët kanë probleme shëndetësore, sociale, ekonomike etj.;

- bën zgjidhje të bazuara në informacione dhe në përvoja të drejta për të mbrojtur shëndetin dhe mirëqenien nga rreziqet e ndryshme në jetën e përditshme (p.sh.: nga përdorimi i duhanit, i alkoolit, i drogave, nga marrëdhëniet e hershme seksuale, nga zgjedhjet e gabuara ushqimore, nga ekspozimi i tepruar ndaj rrezeve të diellit etj.);
- vepron në jetën e përditshme në mënyrë të pavarur dhe të përgjegjshme, duke përzgjedhur mënyra të shëndetshme jetese, dieta të lejuara nga mjeku, ushtrime të koordinuara drejt, apo duke iu përgjigjur në mënyrën e duhur situatave të rrezikshme me të cilat mund të ndeshet në jetën e përditshme.

Kompetenca qytetare

Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët

Nxënësi:

- paraqet në forma të ndryshme të të shprehurit, mënyrën e funksionimit të mjedisit të vet shoqëror në nivel lokal dhe me gjerë, duke dhënë shembuj konkretë se si mund të përmirësohet funksionimi i tij, p.sh.: në strukturën organizative, në rregullat e veprimt, në publikimin e pritshmërive, në bashkëpunimin me qytetarë etj.;
- demonstroi shembuj konkretë të mbrojtjes së mjedisit natyror dhe atij të krijuar nga njeriu në aktivitete të jetës së përditshme në shtëpi, në klasë, në shkollë dhe në komunitet;
- diskuton me të tjerët apo në një formë tjetër të të shprehurit paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj., dhe jep propozime për zgjidhjen e ndonjë problemi në komunitet e më gjerë në një fushë të caktuar;
- përshkruan në formë verbale ose të shkruar, mundësinë e përdorimit të internetit dhe të informacioneve në mënyrë të përgjegjshme për tema të caktuara dhe argumenton domosdoshmërinë e përdorimit të drejtë të tyre.

Kompetenca digjitale

Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin

Nxënësi:

- përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive;
- përdor mjetet digjitale për të përpunuar, krijuar, realizuar dhe demonstruar tema mësimore;
- gjen, organizon, analizon, përpunon dhe përdor informacionin nga një shumëllojshmëri burimesh dhe mediash;
- zhvillon aftësitë krijuese, duke zbatuar njohuritë e marra në shkencën kompjuterike dhe në medie digjitale;
- diskuton për përparësitë dhe kufizimet që vijnë nga përdorimi i teknologjive në jetën e individit, shoqërisë apo komunitetit;
- tregohet më i pavarur në procesin e mësimdhënies dhe të mësimnxënies.

2. Lidhja e fushës së shkencave natyrore me temat ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare lidhen me çështje madhore me të cilat përballet shoqëria sot. Kontributi i shkencave të natyrës është i shumanshëm për sa i takon ndikimit në shëndetin e njeriut dhe mirëqenien, mjedisin dhe ekonominë. Ka një lidhje domethënëse midis çështjeve dhe sfidave që trajtojnë temat ndërkurrikulare dhe zbulimeve e arritjeve në shkencë dhe teknologji. Fusha e shkencave të natyrës, përmes situatave të larmishme të të nxënësve, zhvillon kompetencat që lidhen me çdo temë ndërkurrikulare dhe në mënyrë të veçantë me temat: *Mjedisi; Ndërvarësia; Zhvillimi i qëndrueshëm dhe Vendimmarrja morale.*

Fusha e shkencave natyrore i ndihmon nxënësit të kuptojnë çështje të shumta që lidhen me shëndetin, mirëqenien dhe seksualitetin, si dhe i nxit ata për të bërë një jetë të shëndetshme. Nga ana tjetër, ajo i ndërgjegjëson nxënësit për përgjegjshmërinë që kanë në çështje specifike mjedisore, si: përdorimi i burimeve natyrore, ndikimi i njeriut mbi mjedisin, menaxhimi i mbeturinave, çështje etike të lidhura me bioteknologjinë, ndryshimet klimatike dhe biodiversitetin.

Përmes projekteve të ndryshme në fushën e shkencës, nxënësit mund të studiojnë ndikimin social, etik, ekonomik ose mjedisor të saj. Ata nxiten për të bërë pyetje rreth çështjeve që trajtojnë këto tema dhe sjelljes së tyre si konsumatorë të përgjegjshëm.

Zhvillimi i shkathtësive të komunikimit në gjuhën e shkencës i jep nxënësve një perspektivë të re për çështje të caktuara sociale, të cilat mund të përmirësojnë cilësinë e pjesëmarrjes së tyre në klasë, në shkollë apo shoqëri duke respektuar diversitetin.

3. Lidhja e fushës së shkencave natyrore me fushat e tjera kurrikulare

Konceptimi i programit të fushës së shkencave natyrore është mbështetur në parime të mirëfillta të integritit si mes lëndëve të vetë fushës ashtu dhe të fushës me fushat e tjera. Për t'u siguruar nxënësve një mësim të integruar, është e rëndësishme lidhja e fushës së shkencave natyrore me fushat e tjera dhe specifikisht me lëndët e këtyre fushave. Nxënësit nuk mund ta perceptojnë realitetin dhe të njohin botën që i rrethon vetëm nëpërmjet studimit të lëndëve që i përkasin fushës së shkencave natyrore.

Fusha e shkencave natyrore është e lidhur ngushtë me *fushën e matematikës*. Matematika u siguron nxënësve njohuritë edomosdoshme për studimin e lëndëve të kësaj fushe. Për shembull, kur nxënësi kryen një kërkim shkencor, i duhet shpesh të bëjë matje, llogaritje, të gjejë mesataren aritmetike, të zotërojë koncepte të gjeometrisë së zbatuar, si dhe të vizualizojë hapësirën. Nxënësi përdor aparatit matematik për të shpjeguar ligjet e fizikës dhe për të vendosur lidhjen ndërmjet ndryshoreve, si p.sh., në fizikë, lidhja ndërmjet forcës, masës dhe nxitimit. Interpretimi i ligjeve dhe i dukurive nëpërmjet përdorimit të grafikëve, të simboleve e të formulave matematikore vërteton qartë lidhjen e shkencës së matematikës me shkencat e natyrës. Gjithashtu, duke studiuar shkencat e natyrës nxënësit zhvillojnë kompetencat matematikore të problemzgjdhjes, hetimit, arsytimit logjik, lidhjes konceptuale ndërmjet madhësive dhe modelimeve. Për të analizuar dhe për të vlerësuar rezultatet gjatë studimit të dukurive dhe të ligjeve në shkencat natyrore, nxënësit duhet të zhvillojnë kompetencën e komunikimit dhe të përdorin drejt gjuhën dhe terminologjinë e shkencës.

Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” i ndihmon nxënësit për zhvillimin e kompetencës së komunikimit në gjuhën dhe në terminologjinë shkencës. Nxënësi, duke lexuar, shkruar apo shprehur rrjedhshëm mendimet e tij rreth informacioneve shkencore mbi gjithësinë, lëndët, ndotësit e ajrit, ujit, zhvillon saktë kompetencën e komunikimit, që ndjeshëm zhvillohet në *fushën “Gjuhët dhe komunikimi”*. Por edhe lëndët e shkencave të natyrës kontribuojnë në pasurimin e fjalorit të nxënësve dhe i aftësojnë ata të paraqesin qartë dhe saktë


idetë e tyre, me gojë ose me shkrim. Punët praktike dhe eksperimentale, të cilat janë bazë për zhvillimin e kompetencave të kësaj fushe, u japin nxënësve mundësitë që të zhvillojnë kompetencën e komunikimit gjuhësor dhe të pasurojnë fjalorin terminologjik, përmes diskutimeve mbi përshkrimin e punëve praktike dhe laboratorike dhe shpjegimeve të rezultateve të tyre. Termat e ndryshme që përdoren në fushën e shkencave të natyrës janë specifike për fushën dhe ndihmojnë nxënësit për zhvillimin e kompetencës së komunikimit.

Studimi i shkencave lidhet me *fushën e shkencave shoqërore*, pasi nëpërmjet saj nxënësit marrin informacion mbi historinë e zhvillimit të shkencës në periudha të caktuara historike të shoqërive të ndryshme. Duke hedhur vështrimin nga e kaluara historike, ata mund të marrin përgjigje se si ka evoluar natyra dhe gjithësia. Nga ana tjetër, nxënësit vendosin dhe vlerësojnë lidhjen mes shkencave natyrore, teknologjisë dhe shoqërisë dhe përmirësojnë sjelljen për harmonizimin e marrëdhënieve të tyre me mjedisin dhe për ruajtjen tij.

Fusha e shkencave të natyrës lidhet me *fushën e arteve*, pasi disa teknika specifike të fushës së arteve zbatohen nëse njihen mirë ligjet e fushës së shkencave. P.sh., për të kryer lëvizjet e trupit, një kërcimtar mund të arrijë performancën më të lartë, nëse njeh mirë ligjete dinamikës dhe zbatimet e tyre. Gjithashtu, duke shfrytëzuar programet e arteve pamore, nxënësit bëhen njohës të mirë të figurave dhe trupave gjeometrikë në hapësirë dhe plan.

TIK-u mbështet hetimin e proceseve në fushën e shkencave dhe lehtëson bashkëpunimin dhe komunikimin e nxënësve me bashkëmoshatarët gjatë procesit të të nxënësve, duke përfshirë edhe të nxënësve në distancë. Për shembull, nëpërmjet përdorimit të TIK-ut nxënësi diskuton dhe ndan idetë me të tjerët, por ka mundësi të konsultohet edhe me ekspertë të fushës, kur e ka të nevojshme. Nxënësi përdor sistemet e duhura kompjuterike për ndërtimin e tabelave, grafikëve, diagrameve, vizatimin e një plani, përgatitjen e prezantimeve të detyrave praktike dhe projekteve kurrikulare, duke zbatuar në mënyrë krijuese njohuritë që përmbajnë shkencat kompjuterike dhe mediat digjitale.

Diagrami 2. Lidhja e kompetencave të fushës së shkencave natyrore me kompetencat e fushave të tjera



SHËNIM: Zbatuesit e programit janë të lirë t'i kombinojnë dhe t'i rendisin njohuritë dhe rezultatet e të nxënit brenda tematikës dhe ndërmjet tematikave, sipas planifikimit të tyre. E rëndësishme është që të mundësohet arritja e **të gjithë** rezultateve të të nxënit nga nxënësit.

II. REZULTATET E TË NXËNIT TË KOMPETENCAVE SIPAS TEMATIKAVE

KLASA XIII

LËNDA: BIOLOGJI

32 javë x 1 orë në javë= 32 orë

TEMATIKA: SISTEMET

Përshkrimi i tematikës: Një sistem përfaqëson një tërësi pjesësh të cilat punojnë së bashku për të kryer një funksion të caktuar. Ka sisteme në natyrë, si dhe sisteme të ndërtuara nga njeriu. Shembuj të sistemeve në natyrë janë sistemet e trupit të njeriut. Shembuj të sistemeve të ndërtuara nga njeriu janë sistemet elektrike. Njohja e sistemeve e lejon njeriun të kuptojë si funksionon secila pjesë e sistemit dhe si ndërveprojnë me njëra-tjetrën për të kryer një funksion të caktuar.

Kjo temë përqendrohet tek studimi i sistemeve qelizore te bimët dhe kafshët, i sistemeve të trupave qiellorë dhe i sistemeve të matjes.

Sistemet te njeriu

Njohuritë dhe konceptet

Aftësitë dhe proceset

Qëndrimet dhe vlerat

<p>Koordinimi dhe kontrolli nervor tek njerëzit</p> <ul style="list-style-type: none"> • Parimet e kontrollit dhe koordinimit të sistemit nervor te njeriu • Sistemi nervor qendror • Sistemi nervor periferik • Funksonimi i syrit • Defektet e syrit 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>identifikon</u> në diagramet e sistemit nervor qendror, trurin e madh, trurin e vogël, gjëndrën e hipofizës dhe hipotalamusin, palcën e zgjatur, palcën e kurrizit dhe nervat; • <u>shpjegon</u> se si struktura e sistemit nervor (SNQ, neuronet ndijore, lëvizore dhe receptorët ndijorë) përshtatet me funksionet e tij; • <u>diskuton</u> funksionin e trurit dhe të palcës kurrizore në prodhimin e një përgjigjeje të koordinuar, si rezultat i një stimuli (ngacmimi) specifik; • <u>përshkruan</u> si struktura e një harku reflektor lidhet me funksionin e tij; • <u>përshkruan</u> pjesët kryesore përbërëse të syrit dhe funksionin e secilës pjesë. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • diskuton disa nga kufizimet në trajtimin e dëmtimeve dhe të sëmundjeve në tru dhe në pjesë të tjera të sistemit nervor.
<p>Koordinimi dhe kontrolli hormonal tek</p>	<p>Nxënësi:</p>	<p>Nxënësi:</p>

<p>njerëzit</p> <ul style="list-style-type: none"> • Roli i hormoneve në riprodhim • Metodat hormonale dhe jo hormonale të kontracepsionit 	<ul style="list-style-type: none"> • <u>përshkruan</u> parimet e koordinimit dhe të kontrollit hormonal nga sistemi endokrin te njeriu; • <u>shpjegon</u> rolin e tiroxinës dhe adrenalinës në trup, si shembuj të parimit feedback- negativ; • <u>përshkruan</u> rolin e hormoneve në riprodhimin e njeriut duke përfshirë edhe ciklin menstrual. 	<ul style="list-style-type: none"> • <u>diskuton</u> përdorimin e hormoneve në kontracepsion dhe trajtimin e infertilitetit;
<p>Të ushqyerit te njeriu</p> <ul style="list-style-type: none"> • Dietë e ekuilibruar • Kequshqyerje • Sistem i tretjes • Tretje mekanike • Tretje kimike • Përthithje 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>shpjegon</u> se si ndikojnë moshë, gjinia dhe aktiviteti njerëzor për nevojat dietike të njeriut; • <u>përshkruan</u> ndërtimin dhe funksionet e pjesëve kryesore të aparatit tretës te njeriu; • <u>përshkruan</u> funksionet e llojeve të dhëmbëve te njeriu në tretjen mekanike të ushqimit; • <u>krahason</u> tretjen mekanike me tretjen kimike; • <u>vlerëson</u> rolin e mëlçisë dhe të 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>diskuton</u> ndikimin e kequshqyerjes në shëndetin e njeriut; • <u>vlerëson</u> informacione të marra nga burime të sigurta për trajtimin e pasojave që vijnë nga kequshqyerja.

	<p>pankreasit në tretjen e ushqimit;</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>përshkruan</u> thjesht funksionin e enzimave amilazë, proteazë dhe lipazë në tretjen kimike të ushqimit. 	
Sistemet e transportit		
<p>Sistemi i qarkullimit të gjakut te njeriu</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zemra • Enët e gjakut • Funksionet e gjakut 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>përshkruan</u> sistemin e qarkullimit të gjakut te njeriu në lidhje me sistemin e shkëmbimit të gazeve; • <u>krahason</u> qarkullimin e madh dhe të vogël të gjakut, duke i lidhur ndryshimet me funksionet e ndryshme që kanë secili; • <u>shpjegon</u> se si struktura e zemrës dhe enët e gjakut i janë përshtatur funksioneve të tyre; • <u>heton</u> ndikimin e aktivitetit fizik në shpejtësinë e rrahjes së pulsit; • <u>vëzhgon</u> dhe <u>identifikon</u> qelizat e kuqe dhe të bardha të gjakut, siç shihen në mikroskopin me dritë, në diagrame; 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>demonstron</u> bashkëpunim dhe qëndrim etik gjatë punës në grup dhe diskutimeve.

	<ul style="list-style-type: none"> • <u>shpjegon</u> se si qelizat e kuqe të gjakut, qelizat e bardha të gjakut, trombocitet dhe plazma i janë përshtatur funksioneve të tyre në gjak. 	
<p>Ekskretimi</p> <ul style="list-style-type: none"> • Struktura dhe funksioni i veshkave • Dializa 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>identifikon</u> në diagrame veshkat, ure terët, fshikëzën e urinës, uretrën dhe <u>tregon</u> funksionin e secilës pjesë (nuk janë të nevojshme detaje të strukturës së veshkave dhe nefronit); • <u>tregon</u> produktet e ekskretimit që formohen nga reaksionet metabolike brenda në qeliza; • <u>përshkruan</u> thjesht, ndërtimin e veshkës dhe funksionin në largimin e mbeturinave në formën e uresë. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>mbledh dhe përdor</u> burime të ndryshme dhe të sigurtat informacioni kur diskuton për sëmundje të veshkave dhe trajtimin e tyre.
<p>Homeostaza tek njeriu</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rëndësia e homeostazës • Struktura dhe funksioni i lëkurës • Diabeti 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>shpjegon:</u> - rëndësinë e ruajtjes së një mjedisi të brendshëm e të qëndrueshëm në përgjigje të ndryshimit të brendshëm 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>demonstron</u> bashkëpunim dhe qëndrim etik gjatë punës në grup dhe gjatë diskutimeve.

	<p>dhe të jashtëm;</p> <ul style="list-style-type: none"> - si insulina kontrollon nivelin e sheqerit në gjak; - si glukagoni ndërvepron me insulinën për të kontrolluar nivelin e sheqerit në gjak; • <u>përshkruan</u> funksionin e lëkurës në kontrollin e temperaturës së trupit; • <u>diskuton rolin e</u> veshkave në ruajtjen e bilancit të ujit të trupit; • <u>shpjegon</u> reagimin e trupit ndaj temperaturave të ndryshme dhe trysnisë osmotike. 	
Shëndeti, sëmundjet dhe ilaçet		
<p>Shëndeti, sëmundjet</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sëmundjet ngjitëse • Barrierat mbrojtëse kundër patogjenëve dhe roli i sistemit imunitar 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>përshkruan</u> marrëdhënien mes shëndetit dhe sëmundjes; • <u>diskuton</u> për lloje të ndryshme të sëmundjeve ngjitëse dhe sëmundjeve jo ngjitëse; • <u>përshkruan</u> ndërveprimet ndërmjet llojeve të ndryshme të sëmundjeve; 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>përzgjedh</u> informacionin e saktë nga burime të sigurta kur diskuton rreth infeksioneve të zakonshme të njeriut, përfshirë dhe infeksionet seksualisht të transmetueshme, si HIV / AIDS dhe infeksione të bimët;

	<ul style="list-style-type: none"> • <u>përshkruan</u> mbrojtjen jo specifike të trupit të njeriut ndaj patogjenëve; • <u>shpjegon</u> rolin e sistemit imunitar të trupit të njeriut në mbrojtjen ndaj sëmundjeve; • <u>përshkruan</u> se si prodhohen antitruapat monoklonale; • <u>përshkruan</u> disa nga mënyrat në të cilat mund të përdoren antitruapat monoklonale. 	
<p>Trajtimi, shërimi dhe parandalimi i sëmundjeve</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>shpjegon</u> përdorimin e vaksinave dhe ilaçeve në parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve; • <u>përshkruan</u> procesin e zbulimit dhe prodhimin e ilaçeve të reja si: testimi paraklinik dhe klinik. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>vlerëson</u> burime të ndryshme informacioni kur diskuton për parandalimin e sëmundjeve ngjitëse te njeriu, përfshirë dhe IST.
<p>Sëmundjet e jongjitëse tek njerëzit</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>diskuton</u> për sëmundje jongjitëse te njeriu si: sëmundjet kardiovaskulare, shumë forma të kancerit, disa sëmundje të mushkërive dhe të 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>vlerëson</u> faktorë të mundshëm që favorizojnë zhvillimin e sëmundjeve jongjitëse te njeriu.

	<p>mëlçisë dhe sëmundje të ndikuara nga të ushqyerit, si diabeti i tipit 2;</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>shpjegon</u> ndikimin e stilit të jetesës, si: aktiviteti fizik, dieta, alkooli dhe duhanpirja mbi incidencën e sëmundjeve jo ngjitëse në nivel lokal, kombëtar dhe global. 	
Riprodhimi te njeriu	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>përshkruan</u> strukturën dhe shpjegon funksionin e sistemit riprodhues femëror dhe mashkullor; • <u>përshkruan</u> rolin e placentës dhe lëngut amniotik përkatësisht në ushqimin dhe mbrojtjen e embrionit. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>diskuton</u> rolin e estrogenit dhe testosteronit në zhvillimin e karakteristikave sekondare seksuale.
<p>Frymëmarrja te njeriu</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndërtimi dhe funksionimi i sistemit të frymëkëmbimit. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>identifikon</u> në diagram, laringun, trakenë, bronket, bronkiolet, hojëzat dhe kapilarët lidhur me to; • <u>përshkruan</u> strukturën e toraksit; • <u>heton</u> dhe <u>tregon</u> dallimet midis ajrit të thithur dhe ajrit që del jashtë, 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>vlerëson</u> pasojat e duhanpirjes në sistemin e frymëkëmbimit dhe sistemin e qarkullimit të gjakut.

	<p>gjatë frymënxjerrjes;</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>heton</u> dhe <u>përshkruan</u> ndikimin e aktivitetit fizik në shpejtësinë dhe thellësinë e frymëmarrjes; • <u>tregon</u> rolin e muskujve ndërbrinjorë dhe të diafragmës në ajrosjen e mushkërive; • <u>shpjegon</u> si janë përshtatur hojëzat për shkëmbimin e gazeve përmes difuzionit të ajrit në mushkëri dhe gjakut në kapilarë. 	
--	--	--

III. UDHËZIME METODOLOGJIKE

Metodat, teknikat, strategjitë e të nxënit në fushën e shkencave të natyrës janë faktorë të rëndësishëm për një nxënie të suksesshme që nxit interesin, gjithëpërfshirjen, ndërveprimin dhe punën kërkimore të nxënësve. Përzgjedhja dhe përdorimi i tyre nga mësuesit luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e kompetencave të nxënësve, duke respektuar stilet e ndryshme të të nxënit të tyre. Në fushën e shkencave të natyrës, kërkimi shkencor është baza e kompetencave që zhvillon kjo fushë. Metodat që mund të përdorin lëndët e kësaj fushe përfshijnë: modelimin, vëzhgimin, metodat eksperimentale dhe empirike, formimin e një ideje dhe përdorimin e TIK-ut. Këto metoda nuk mund të përdoren pa u kombinuar me njëra-tjetrën.

Modelimi

Modelimi nënkupton ndërtimin e një situatë abstrakte që është e vështirë për t'u vëzhguar ose e pamundur për t'u parë. Ky modelim paraqitet nëpërmjet një teksti, vizatimi, formule matematikore, ekuacioni kimik apo në formën e një softwar-i programi. Është me shumë rëndësi të kuptohet situata në të cilën është krijuar modelimi. Përveç të tjerave, modelimi duhet t'i ndihmojë nxënësit të kuptojnë realitetin, të shpjegojnë karakteristikat e këtij realiteti dhe të parashikojnë një dukuri.

Metoda e vëzhgimit

Metoda e vëzhgimit është një metodë që i ndihmon nxënësit në formimin e koncepteve shkencore. Nëpërmjet kësaj metode nxënësit bëjnë lidhjen ndërmjet koncepteve abstrakte dhe objekteve, organizmave apo dukurive të botës reale. Kur vëzhgojnë objekte, organizma apo dukuri, nxënësit përdorin njohuritë shkencore. Vëzhgimet i ndihmojnë ata për të krijuar përfytyrime të qëndrueshme për botën që na rrethon. Vëzhgimet në natyrë i nxisin nxënësit të punojnë në mënyrë shkencore, të ngrenë hipoteza dhe t'i testojnë ato. Vëzhgimi është hapi i parë i një hetimi, eksperimenti apo studimi.

Metoda eksperimentale

Metoda eksperimentale fillon me shpjegime teorike shkencore dhe vazhdon me demonstrimin e eksperimentit. Qëllimi i procedurës është të identifikojë dhe të krahasojë elementet e vëzhgueshme sasiore dhe të kontrollojë vërtetësinë e hipotezave të ngritura. Gjatë përdorimit të kësaj metode, nxënësit përdorin një sërë aparaturash për të bërë matje, si dhe tregojnë kujdes gjatë përdorimit të tyre.

Metoda empirike

Metoda empirike bazohet në modelet intuitive dhe siguron një mënyrë për të eksploruar elementet e një problemi. Kjo metodë udhëheq ide, hipoteza, teori dhe teknika të reja për një studim kërkimor më të detajuar.

Hetimi

Nxënësit angazhohen në veprimtari, përmes të cilave kuptojnë se si shkencëtarët mendojnë, çfarë bëjnë në një proces vendimmarrjeje, si ngrenë pyetje dhe si planifikojnë hetimin. Përmes të nxënësve kërkues, nxënësit aftësohen të përftojnë njohuri dhe të krijojnë një botëkuptim për botën natyrore dhe fizike bazuar në hetimin shkencor. Gjithashtu, nxënësit zbatojnë aftësitë dhe proceset kërkuese, si dhe zhvillojnë qëndrimet dhe vlerat që janë themelore për praktikën e shkencës.

Projektet

Projektet janë veprimtari të nxënësve nëpërmjet të cilave nxënësit zbulojnë objektet, proceset apo dukuritë.

Teknologjia e informacionit dhe e komunikimit

Teknologjia e informacionit dhe e komunikimit mbështet procesin kërkues, rrit cilësinë e të nxënësve dhe siguron bashkëpunimin mes tyre. Përmes përdorimit të mjeteve digjitale, nxënësit mund të eksplorojnë dhe të perceptojnë konceptet abstrakte, si dhe të zbulojnë marrëdhëniet ndërmjet objekteve dhe dukurive.

STRATEGJITË

Strategjitë e përdorura në shkencë dhe në teknologji mund t'i ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë tri kompetencat e programit. Më poshtë, po listojmë disa prej tyre:

- Identifikimi i elementeve të rëndësishme që lidhen me problemzgjidhjen.
- Ndarja e një problemi kompleks në disa probleme më të thjeshta.
- Përdorimi i arsytimeve (p.sh.: arsyetimi induktiv dhe deduktiv, krahasimi, klasifikimi, etj.).

QËNDRIMET

Qëndrimet janë një faktor i rëndësishëm në zhvillimin e kompetencave.

Disa nga qëndrimet intelektuale janë:

- kurioziteti;
- ndjenja e iniciativës;
- prirja për të ndërmarrë risk intelektual;
- interesi për prezantimin e ideve të ndryshme;
- ndjenja e përgjegjësisë për zgjidhje origjinale;
- ndjenja e gatishmërisë dhe e solidaritetit gjatë punës në grup;
- kujdesi për shëndetin dhe për sigurinë;
- objektiviteti;
- përdorimi i qasjeve të duhura metodike;
- përdorimi i saktë i gjuhës sipas terminologjive shkencore.

Teknikat janë:

- përdorimi i instrumenteve matëse;
- siguria ndaj pajisjeve dhe materialeve laboratorike.

Përdorimi i gjuhës dhe i terminologjisë shkencore

Të lexuarit dhe të shkruarit në shkencë ndihmon nxënësit për ta kuptuar shkencën dhe jo thjesht për të mbajtur mend faktet dhe për t'i riprodhuar ato.

Të lexuarit shkencor ndihmon në shprehjen e ideve dhe të koncepteve, nxit diskutimin, analizën dhe vlerësimin. Leximi i shumëllojshmërisë së materialeve në lidhje me atë çka mësohet në shkollë, i bën nxënësit të mendojnë se informacioni nuk vjen vetëm

nga teksti shkollor por edhe nga burime të tjera. Një burim i rëndësishëm duhet të konsiderohet edhe ai i materialeve të shkruara nga shokët.

Gjatë vëzhgimeve të qenieve të gjalla, të dukurive ose gjatë konsultimeve me fotografi, harta, postera e burime të tjera informacioni, nxënësit duhet të nxiten të mbajnë shënime. Në këtë mënyrë, ata do të thellohen e do të kuptojnë më mirë objektin ose dukurinë që vëzhgojnë.

Kërkesa për mbajtjen e shënimeve dhe paraqitjen e gjetjeve gjatë vëzhgimeve dhe eksperimenteve ndihmon pozitivisht në përpunimin e të dhënave dhe përvetësimin e njohurive. Për shënimet dhe paraqitjen e përfundimeve nga nxënësit, mund të parashikohen forma të tilla pune, si: shkrimi i një raporti të shkurtër, përgatitja e një informacioni gojor, realizimi i një vizatimi, tabele, grafiku etj.

Në shkrimin e relacioneve ose në paraqitjen e informacioneve gojore etj., është mirë që gjithnjë të kërkohet nga nxënësit që të analizojnë, të krahasojnë dhe të përgjithësojnë të dhënat, në mënyrë që të nxitet të kuptuarit e dukurisë ose të objektit të vëzhguar.

Leximi dhe shkrimi rreth asaj çka nxënësit shohin, mendojnë dhe lexojnë duhet të bëhet pjesë e përditshme e regjimit të tyre.

Siguria

Mësuesit janë përgjegjës për sigurinë e nxënësve gjatë veprimtarive në klasë, për nxitjen dhe motivimin e tyre, për rregullat dhe përgjegjësitë e sigurisë. Ata duhet të planifikojnë gjithmonë veprimtari praktike të sigurta dhe t'u tregojnë nxënësve kushtet e sigurisë në përputhje me ato të bordit të shkollës dhe të politikave të Ministrisë së Arsimit dhe të Sportit.

Gjatë veprimtarive në fushën e shkencës, nxënësit: zbatojnë, gjithmonë dhe në mënyrë të ndërgjegjshme, rregullat e sigurisë në shkollë, klasë dhe jashtë tyre; identifikojnë paraprakisht kushtet në të cilat veprimtaria mund të mos jetë e sigurt dhe tregojnë se si mund të parandalohen aksidentet në të gjitha rastet e mundshme; përdorin pajisjet, kimikatet dhe mjetet sipas udhëzimeve; tregojnë vazhdimisht

shqetësim për sigurinë e tyre dhe të tjerëve.

Nxënësit me nevoja të veçanta

Organizimi i kurrikulës sipas kompetencave (në fusha të nxëni, në shkallë) dhe me fokus integrimin, i krijon mësuesit hapësirat për të përshtatur mësimdhënien sipas nevojave të veçanta të nxënësve dhe për të personalizuar të nxënit e tyre. Mësuesi duhet të marrë parasysh faktin se nxënësit janë të ndryshëm, kanë motivim, interesa, stile të nxëni, nevoja dhe aftësi të ndryshme etj. Në disa raste, duhen bërë përshtatje të kurrikulës sipas diferencave të zhvillimit brenda një grupi moshor. Mësuesi mund të zgjerojë zhvillimin e kompetencave kyçe, sipas nevojave individuale të nxënësve, për të zvogëluar dhe për të zhdukur diferencat brenda një shkalle të kurrikulës, në fund të saj.

a) Nxënësit me vështirësi në të nxënë

Shumë nxënës me vështirësi në të nxënë arrijnë rezultatet e pritshme të të nxënit njësoj si nxënësit e tjerë, nëse bëhet përshtatja e mënyrës së mësimdhënies dhe e vlerësimit të tyre.

Për të arritur nivelin më të lartë të mundshëm të realizimit të kompetencës, mund të zhvillohen programe të veçanta dhe individuale, për nxënësit me nevoja të veçanta.

Për të përcaktuar se cilët janë nxënësit me nevoja të veçanta ekziston një proces i bazuar në rregullore të miratuara nga MAS-i. Nëpërmjet këtij procesi, prindërit, mësuesit dhe personeli tjetër mbështetës i shkollës identifikojnë nevojat e veçanta të një nxënësi, hartojnë një plan individual arsimor (PIA) që i adresohet këtyre nevojave dhe rishikojnë progresin e nxënësit në përputhje me këtë plan.

Në rastin e nxënësve që formalisht janë përcaktuar si të veçantë, është veçanërisht e rëndësishme që stafi i shkollës, në bashkëpunim me prindërit, të mbështesë të nxënit e tyre. Procedurat dhe teknikat e vlerësimit për nxënësit me nevoja të veçanta duhet të diskutohen herë pas here me prindërit dhe vetë nxënësit. Prindërit duhet të kuptojnë se si ndikojnë këto procedura dhe teknika të përshtatura në vlerësimin e punës së nxënësve.

b) Nxënësit me dhunti dhe të talentuar

Fleksibiliteti i zhvillimit të programit lejon plotësimin e nevojave individuale të nxënësve me dhunti dhe të talentuar.

Mësuesit duhet të krijojnë kushte dhe situata të tilla që nxënësit të shfaqin dhe të zhvillojnë dhuntitë dhe talentet e tyre. Kjo arrihet nëse atyre u krijohen mundësitë të punojnë me një përmbajtje më të thelluar dhe më të zgjeruar, të zhvillojnë në mënyrë të vazhdueshme elemente specifike të kompetencave kyçe dhe specifike të fushës, të fokusohen në çështjet kroskurrikulare dhe të zgjerojnë mjediset dhe materialet e të nxënësve brenda dhe jashtë shkollës.

c) Nxënësit me vështirësi në gjuhën shqipe (pakicat kombëtare dhe emigracioni)

Nxënësit e pakicave kombëtare ose ata që vijnë nga emigracioni zotërojnë gjuhën shqipe në nivele të ndryshme, në grupmosha të ndryshme. Meqenëse programi është për të gjithë nxënësit, nxënësit me vështirësi në gjuhën shqipe duhet të arrijnë rezultatet e të nxënësve të tjerë. Këtyre nxënësve duhet t'u jepet mbështetje në formën e kohës shtesë, aq sa u duhet për të mësuar gjuhën shqipe ose t'u ofrohen kurse formale nga shkolla, përgjatë vitit shkollor ose gjatë pushimeve verore.

Në fushën e shkencave natyrore, nxënësit me nevoja të veçanta mund të kenë nevojë për shumëllojshmëri modifikimesh në program dhe në mjedisin e të nxënësve. Modifikimet kanë të bëjnë:

- me lehtësitë që lejojnë lëvizshmërinë e nxënësve me probleme fizike;
- me hartimin e programeve për nxënësit me paaftësi në lexim, që ndoshta kërkojnë më shumë mundësi praktike;
- me përshtatjet e programit për nxënësit që kanë dhunti të veçanta;
- me shënimet vizuale të lidhura me çështjet e sigurisë;
- me strategjitë e vlerësimit që përshtatin shumëllojshmërinë e stileve me nevojat e të nxënësve.

IV. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

Vlerësimi është pjesë integrale e procesit të të nxënësve. Ai mat shkallën në të cilën kompetencat janë arritur nga nxënësi. Ai përfshin mbledhjen e informacioneve me anë të teknikave të ndryshme të vlerësimit për arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënësve në nivel

klase dhe shkalle të nxënësit. Me këtë informacion, mësuesi merr vendime për vlerësimin përfundimtar të nxënësve, bazuar në gjykimin e tij për nivelin e zotërimit të kompetencave të fushës së shkencave të natyrës.

Vlerësimi u shërben shumë qëllimeve, ndaj është e rëndësishme që mësuesi t'ia përshtatë llojin e vlerësimit, qëllimit specifik të synuar. Para marrjes së një vendimi në lidhje me një aspekt të caktuar të performancës së nxënësit, mësuesi duhet të sigurojë që mënyra e vlerësimit të përdorur, të zotërojë informacionin që reflekton saktësisht një aspekt të veçantë të performancës që ai ka për qëllim të vlerësojë.

Është thelbësore që vlerësimi të jetë pjesë e procesit të mësimdhënies dhe të nxënësve. I gjithë procesi i të nxënësve në shkencat e natyrës mbështetet në kërkimin shkencor, si i tillë edhe vlerësimi merr shumë forma.

Duke qenë pjesë e procesit të të nxënësve, *vlerësimi formues* përdoret në të gjitha shkallët. Vlerësimi formues u shërben nxënësve për të përmirësuar të nxënësve dhe mësuesve për të përmirësuar metodat e mësimdhënies.

Vlerësimi përmbledhës përdoret për të përcaktuar shkallën në të cilën janë arritur kompetencat. Ai shërben jo vetëm për të informuar nxënësit dhe prindërit për progresin e tyre, por edhe për të përmirësuar praktikën e mësimdhënies dhe të nxënësve.

Vlerësimi diagnostikues zakonisht kryhet në fillim të shkollës apo të vitit shkollor, për të identifikuar njohuritë paraprake, interesat ose aftësitë që kanë nxënësit rreth qëllimit për të cilin po kryhet vlerësimi.

Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i shoku-shokut e bën nxënësin më të vetëdijshëm për përparimin e tij dhe, gjithashtu, i lejon ata të analizojnë dhe të krahasojnë idetë e tyre me ato të shokëve, të mësuesve dhe të prindërve.

Për *vlerësimet me shkrim*, mësuesi duhet të përdorë situata të jetës reale që përfshijnë shkencën në jetën e përditshme, shoqëri dhe mjedis. Situatat e zgjedhura duhet të jenë domethënëse dhe tërheqëse. Përveç *testeve me shkrim*, mësuesit mund të kryejnë vlerësime

të bazuara në performancën e nxënësve, duke përdorur mënyrat e mëposhtme, si:

- punët praktike;
- modelet dhe maketet;
- punët laboratorike;
- posterat;
- projektet kurrikulare dhe ndërlëndore;
- debatet;
- detyrat individuale;
- esetë;
- vrojtimit e mësuesit;
- portofolin;
- listat e kontrollit.

Mësuesi mund të vlerësojë nxënësin përmes përdorimit të portofolit. Ai është një koleksion sistematik i punës së nxënësit dhe siguron një tablo të plotë të arritjeve të tyre. Puna e mbledhur, ofron të dhëna të shumta për zhvillimin dhe progresin e nxënësve në përvetësimin e njohurive, në të kuptuarit e koncepteve shkencore, zbatimin e shkathtësive të procesit, dhe zhvillimin e qëndrimeve. Ajo, gjithashtu, u ofron nxënësve mundësi për vetëvlerësim dhe reflektim përmes rishikimit të portofoleve të tyre.

V. MATERIALE DHE BURIME MËSIMORE

Për realizimin e kompetencave në lëndën e shkencave të natyrës, është domosdoshmëri të krijohet një mjedis mësimor i përshtatshëm. Më poshtë paraqitet një listë përmbledhëse e materialeve, burimeve dhe mjediseve të domosdoshme për realizimin e programit të kësaj lënde.

Disa nga mjetet më të përdorshme didaktike janë:

- *mjetet verbale, tekstet si:* teksti shkollor, libri i mësuesit, fletoret e punës, atlaset, udhëzues profesionalë, fjalorë, gazeta, revista, materiale psiko-pedagogjike, enciklopedi etj.;
- *mjetet pamore natyrore si:* objektet natyrore të gjalla ose jo të gjalla, koleksionet;

- *mjetet artificiale si:* maketet, modelet, fotografitë, vizatimet, skemat, tabelat, posterat, fotografitë, pikturat, diagramet, mjetet grafike etj.;
- *mjetet audiovizive si:* televizor, film, video, video-projektor, videokasetë, kompjuter, internet, teletekst, CD etj.;
- *mjetet dëgjimore si:* radio, magnetofon, telefon, kasetofon etj.;
- *mjediset mësimore si:* klasa, laborator, kabinetet e punës, natyra, ferma etj.

Këto burime duhet të diskutohen dhe të vlerësohen nga stafi, si një pjesë e planit të tyre për shkencën. Plani duhet të jetë i rëndësishëm për të përzgjedhur burimet e dyta, të cilat ndihmojnë për të mbështetur nxënësit në punët e tyre shkencore, si dhe në kryerjen e vizatimeve apo krijimeve të ndryshme.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT**

AGJENCIA E SIGURIMIT SË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

**PROGRAMET E KULTURËS SË PËRGJITHSHME
TË ARSIMIT TË MESËM PROFESIONAL**

Lënda: Gjeografi

Klasa: XIII

Struktura 2+1+1 dhe Struktura 2+2

TIRANË, 2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

PROGRAMET E KULTURËS SË PËRGJITHSHME
TË ARSIMIT TË MESËM PROFESIONAL

Lënda: Gjeografi

Klasa: XIII

Struktura 2+1+1 dhe Struktura 2+2

2024

PËRMBAJTJA

1. FUSHA “SHOQËRIA DHE MJEDISI”	3
2. HYRJE NË PROGRAMIN E GJEOGRAFISË.....	5
3. KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT	7
4. QËLLIMET E PROGRAMIT TË GJEOGRAFISË	9
5. LIDHJA E KOMPETENCAVE KYÇE ME KOMPETENCAT E FUSHËS /LËNDËS	11
6. LIDHJA E LËNDËS SË GJEOGRAFISË ME TEMAT NDËRKURRIKULARE	18
7. LIDHJET E LËNDËS SË GJEOGRAFISË BRENDË FUSHËS DHE ME FUSHAT E TJERA TË TË NXËNIT.....	19
8. KOMPETENCAT E LËNDËS DHE TEMATIKAT E SAJ	21
9. KOHA MËSIMORE PËR TEMATIKË PËR KLASËN XI.....	24
10. REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS TEMATIKAVE PËR KLASËN XI	25
11. UDHËZIME METODOLOGJIKE	44
12. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN	46
13. MATERIALET DHE BURIMET MËSIMORE.....	47

Koordinoi programin:

Evis Mastori

1. FUSHA “SHOQËRIA DHE MJEDISI”

Arsimi parauniversitar krijon kushte dhe mundësi që nxënësi të ndërtojë dhe të zhvillojë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria demokratike; të zhvillohet në mënyrë të pavarur e të gjithanshme; të kontribuojë në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake dhe të shoqërisë; të përballë në mënyrë të suksesshme me sfidat e jetës.

Në arsimin parauniversitar, nxënësi:

- kultivon identitetin vetjak, kombëtar dhe përkatësinë kulturore;
- përvetëson vlera të përgjithshme kulturore dhe qytetare;
- zhvillohet në aspektet intelektuale, etike, fizike, sociale dhe estetike;
- zhvillon përgjegjësi ndaj vetes, të tjerëve, shoqërisë dhe mjedisit;
- aftësohet për jetë dhe për punë, në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;
- aftësohet për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- zhvillon shpirtin e sipërmarrjes;
- përdor teknologjitë e reja.

Fusha “Shoqëria dhe mjedisi” i krijon nxënësit mundësitë të zhvillojë kompetencat e nevojshme për të përmbushur rolin e tij si anëtar i një shoqërie shumë kulturore dhe demokratike, në një botë gjithnjë e më të ndërvarur. Kompleksiteti i botës shoqërore sot po rritet për shkak se shoqëritë janë në një proces të vazhdueshëm ndryshimi dhe lidhjesh globale, shoqëruar me rritje të lartë të lëvizshmërisë së popullsisë, shumëfishim të kontakteve midis kulturave të ndryshme, qarkullim të shpejtë të informacionit dhe rritje të globalizimit të ekonomisë. Lëndët që përbëjnë fushën “Shoqëria dhe mjedisi” zhvillojnë te nxënësi të menduarin kritik e krijues, pasurojnë

kulturën e tyre dhe i përgatisin të luajnë një rol aktiv në një shoqëri demokratike. Ato nxitin zhvillimin intelektual të nxënësit duke i dhënë mekanizmat konceptualë dhe metodologjikë, të cilat nxënësi mund t'i përdorë në situata të ndryshme.

Përmes kësaj fushe nxënësi zhvillon:

- konceptin e tij hapësinor për botën, për kompleksitetin dhe ndërvarësinë e vendeve dhe rajoneve në botë. Nxënësi aftësohet të vlerësojë pasojat e ndërveprimit të shoqërisë me mjedisin, për të ndërmarrë veprime që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm;
- bazat e qytetarisë duke siguruar kuptimin e ligjshmërisë, të proceseve ekonomike, shoqërore, kulturore dhe të çështjeve që lidhen me to;
- konceptin e kohës, të vazhdimësisë dhe të ndryshimit në këndvështrimin e marrëdhënieve historike dhe zbaton këtë kuptim në analizën e pasojave të veprimeve individuale dhe kolektive në shoqëri, në të kaluarën dhe sot.

Përvojat mësimore të kësaj fushe të nxëni në këtë shkallë i shërbejnë përmbushjes së kompetencave kyçe, me fokus të veçantë kultivimin e identitetit personal, shoqëror, kombëtar e kulturor.

2. HYRJE NË PROGRAMIN E GJEOGRAFISË

Gjeografia është shkencë e vendit, hapësirës dhe mjedisit. Ajo është një mënyrë e strukturuar e zbulimit, analizës dhe shpjegimit të dukurive dhe karakteristikave të Tokës, banorëve të saj dhe marrëdhënieve të ndërsjella midis tyre. Mësimi i gjeografisë i ofron nxënësit mundësi të kuptojë veçoritë natyrore dhe shoqërore të mjedisit gjeografik, diversitetin e vendeve dhe rajoneve në botë, të njerëzve dhe kulturave, ndërvarësinë dhe ndërveprimin si dhe marrëdhëniet e njeriut me mjedisin në nivel lokal, rajonal dhe botëror. Ndryshimet e shumta që po përjeton shoqëria e sotme kanë modifikuar marrëdhënien tonë me mjedisin. Shumëllojshmëria e informacionit dhe shpërndarja e tij marramendëse, shtimi i shkëmbimeve të llojeve të ndryshme, globalizimi i ekonomisë dhe lëvizjet e popullsisë, i bëjnë largësitë më të vogla dhe ndikojnë në mënyrën sipas së cilës ne shohim botën. Në këtë kuptim, lënda e gjeografisë ka një rëndësi të veçantë për përgatitjen e nxënësit për të jetuar dhe për t'u integruar në shoqëri, për kultivimin e identitetit personal, shoqëror, kombëtar dhe edukimin për të jetuar së bashku, për një zhvillim sa më të qëndrueshëm.

Programi i gjeografisë ndihmon në zhvillimin e kompetencave kyçe në funksion të të nxënës gjatë gjithë jetës. Zhvillimi i kompetencave është pikënisja dhe parimi bazë organizativ i këtij programi. Përmbajtja lëndore konceptohet si mjet për realizimin e tyre nëpërmjet zhvillimit të situatave të të nxënës.

Nxënësi përvetëson mjetet dhe “gjuhën” gjeografike teksa hulumton marrëdhënien e njeriut me vendet dhe mjedisin, njëkohësisht zbulon rolin që duhet të përmbushë për zhvillimin e qëndrueshëm. Ai mëson t'u përgjigjet problemeve gjeografike duke përdorur prezantimet hapësinore që ka përdorur më parë, të cilat tashmë i modifikon dhe i zhvillon.

Vëzhgimet dhe puna në terren, puna me hartën, interpretimi i shpërndarjes hapësinore të veçorive natyrore dhe shoqërore në Tokë dhe ndërvarësive midis tyre, zhvillojnë shkathtësitë themelore gjeografike në këtë nivel shkollimi.

Hartimi i programit lëndor rrjedh nga Korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar, Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të lartë dhe plani mësimor i arsimit të mesëm të lartë.

Si i tillë ky dokument i shërben:

- **Nxënësit** për zhvillimin e kompetencave kyçe të të nxënit gjatë gjithë jetës dhe kompetencave të lëndës së gjeografisë, në mënyrë që ai të përballojë sfidat e jetës dhe të integrohet në shoqëri.
- **Mësuesit** për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e veprimtarive mësimore dhe arritjeve të nxënësve në klasë dhe jashtë saj.
- **Prindit** për njohjen e rezultateve të pritshme të fëmijëve dhe kritereve të vlerësimit.
- **Hartuesit të teksteve mësimore** dhe të materialeve ndihmëse për mësuesit dhe nxënësit.

Zbatimi i programit bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore dhe fetare.

3. KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT

Programi i gjeografisë është konceptuar dhe hartuar në funksion të qasjes kurrikulare me bazë kompetencat.

- Ky program krijon kushtet për zhvillimin e *kompetencave kyçe* dhe *kompetencave të lëndës* që lidhen me to. Kompetencat e lëndës lidhen me kompetencat kyçe nëpërmjet rezultateve të të nxënit të secilës prej tyre. Lidhja mes rezultateve të të nxënit të kompetencave të lëndës dhe kompetencave kyçe siguron zhvillimin e ndërsjellë të tyre dhe mundëson integrimin lëndor.
- Kompetencat zhvillohen përmes *tematikave të përbashkëta të fushës* dhe në program zërthehen në njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera. Tematikat e përbashkëta të fushës janë elemente të rëndësishme të programit të gjeografisë sipas të cilave strukturohet përmbajtja lëndore dhe integrimi konceptual brenda fushës, në funksion të zhvillimit të kompetencave. Programi i gjeografisë është i strukturuar rreth dy tematikave të mëdha: “Proceset natyrore dhe shoqërore” dhe “Ndërvlerësia midis njerëzve, rajoneve dhe mjediseve”. Për secilën prej tyre përcaktohen rezultatet e pritshme të shprehur në terma njohurish, shkathtësish dhe qëndrimesh. Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe nuk përmbushen jashtë tematikave. Ato janë marrë në konsideratë në të gjithë procesin e hartimit të rezultateve të të nxënit për tematikë duke qenë pjesë integrale e tyre.
- Strukturimi dhe organizimi i programit për *shkallë kurrikule* synon ta bëjë këtë program më fleksibël, duke i ndihmuar dhe u lënë dorë më të lirë mësuesve për ta zbatuar atë në mënyrë krijuese, si dhe të respektojnë ritmet individuale të nxënësve drejt zotërimit të kompetencave të detajuara në çdo shkallë të kurrikulës.
- Strukturimi i programit mbi rezultatet e të nxënit për kompetencë ndihmon në planifikimin dhe zhvillimin e *situatave të të nxënit* dhe lehtëson vlerësimin e nxënësit për kompetencat kyçe. Situatat e të nxënit janë situata që lidhen me kontekstin e të nxënit. Ato mund të jenë situata në mjedise të mbyllura ose të hapura të nxëni, brenda shkollës ose jashtë saj. Roli i mësuesit në mësimdhënien përmes situatave është ai i udhëheqësit e i lehtësuesit gjatë nxënies aktive të nxënësit.


- Konceptimi i kurrikulës me bazë kompetencat krijon mundësitë dhe kërkon zbatimin e integruar të saj. Programi i gjeografisë krijon mundësi *integrimit brenda fushës dhe me fushat e tjera*, si shkencat e natyrës, matematikën, gjuhët dhe komunikimin, etj. Në shumë aspekte, programi i gjeografisë përqendrohet në zhvillimin e temave të mëdha ndërkurrikulare. Ato shërbejnë si çështje kyçe për zhvillimin e kompetencave, integrojnë fushat e të nxënësve dhe synojnë të ndihmojnë nxënësin të lidhë shkollimin e tij me jetën e përditshme.
- Programi sugjeron *metoda, teknika, strategji të mësimdhënies e të nxënies* që nxisin interesin, gjithëpërfshirjen, ndërveprimin dhe punën kërkimore të nxënësve. Përzgjedhja dhe përdorimi i tyre nga mësuesit bëhet në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve, duke respektuar stilet e ndryshme të të nxënësve të tyre.
- *Vlerësimi* si pjesë integrale e procesit të të nxënësve mat shkallën në të cilën kompetencat janë arritur nga nxënësit. Vlerësimi merr shumë forma, të cilat i parashikon dhe mundëson struktura dhe konceptimi i programit.

4. QËLLIMET E PROGRAMIT TË GJEOGRAFISË

Programi i gjeografisë synon që nxënësi:

- të zhvillojë dijet për dukuritë gjeografike, fizike dhe humane, në shkallë të ndryshme, mbi bazën e ballafaqimit të vazhdueshëm të të menduarit kritik e krijues;
- të zhvillojë kuptimin për ligjet e përgjithshme të gjeosistemit dhe të veprojë në përputhje me to për zgjidhjen e problemeve gjeografike të jetës së përditshme;
- të zhvillojë interesin dhe respektin për vendin ku jeton, për vende të tjera, për njerëzit dhe mënyrën si ata ndërveprojnë me njëri-tjetrin dhe mjedisin ku jetojnë;
- të kuptojë mundësitë dhe sfidat e ndërvarësisë globale;
- të zhvillojë shkathtësitë për të qenë përdorues kritik dhe krijues i metodave të kërkimit gjeografik;
- të edukohet si qytetar i informuar, i përgjegjshëm dhe aktiv, i cili mund të kontribuojë për zhvillimin e një bote të qëndrueshme.

Diagrami 1: Korniza konceptuale e programit



5. LIDHJA E KOMPETENCAVE KYÇE ME KOMPETENCAT E FUSHËS /LËNDËS

Ndërtimi dhe zbatimi i kompetencave kyçe nga nxënësi gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies kërkon që mësuesi të mbajë parasysh lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës për secilën shkallë. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë situatat, veprimtaritë, metodat dhe mjetet e përshtatshme të procesit të të nxënit. Kompetenca përcaktohet si ndërthurje e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve që një nxënës duhet të fitojë dhe përdorë gjatë procesit të nxënies.

Kompetenca qytetare

Programi i gjeografisë, si pjesë e fushës “Shoqëria dhe mjedisi”, krijon kushte në mënyrë të veçantë për ndërtimin dhe demonstrimin nga nxënësi të kompetencës qytetare. Përmes kërkimit gjeografik për çështje të tilla, si ndërvarësia, shfrytëzimi i burimeve natyrore, qëndrueshmëria mjedisore në nivel lokal e global etj., nxënësi nxitet të mendojë në mënyrë kritike dhe të marrë vendime që ndihmojnë në zhvillimin e tij si individ.

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit

Programi i gjeografisë krijon mundësi për zhvillimin e shkathtësive komunikuese. Nxënësi përdor materiale të printuara, vizuale dhe digjitale për të eksploruar dukuritë, proceset gjeografike, vendet dhe rajonet. Ai mëson si të vlerësojë këto burime, nxënësi zhvillon dhe përdor në mënyrë progresive fjalorin gjeografik për të komunikuar idetë në mjedise të ndryshme.

Kompetenca e të menduarit

Nxënësi zhvillon të menduarin kritik dhe krijues gjatë vlerësimit të të dhënave dhe përdorimit të tyre, teston shpjegimet dhe analizon argumentet. Ai zhvillon shkathtësi për marrjen e vendimeve dhe strategji që e ndihmojnë të mendojë në mënyrë analitike dhe logjike.

Programi mundëson që nxënësi të kuptojë vlerën dhe procesin e drejtimit të pyetjeve, të jetë krijues e të zhvillojë imagjinatën përmes veprimtarive në klasë dhe vëzhgimeve në terren.

Programi i gjeografisë mundëson zbatimin e shkathtësive matematikore për kryerjen e analizave statistikore, ndërtimin e grafikëve, tabelave, llogaritjen dhe interpretimin e të dhënave. Në punën me hartën, nxënësit punojnë me koncepte numerike, të tilla si: shkalla, largësia, koordinatat, projeksionet.

Kompetenca e të mësuarit

Në procesin e kërkimit gjeografik nxënësi zhvillon kompetencën e të nxënësit. Programi mundëson që nxënësi të shfrytëzojë në mënyrë efektive përvojat paraprake për zgjidhjen e situatave të ndryshme dhe realizimin e veprimtarive; të parashtojë pyetje për çështje të ndryshme dhe të organizojë mendimet për të gjetur përgjigje për një situatë/problem të caktuar gjeografik. Nxënësi aftësohet të paraqesë/skicojë idetë e tij për ecurinë dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarive duke e argumentuar para të tjerëve. Për këtë, shfrytëzon në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në ndonjë burim informacioni, vlerëson vetë performancën dhe rezultatin e arritur, duke iu referuar qëllimeve fillestare.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

Nxënësit vlerësojnë rëndësinë e punës individuale dhe në grup për zhvillimin e komunitetit nëpërmjet shembujve konkretë nga jeta e përditshme, zgjidhin çështje të ndryshme që lidhen me mjedisin gjeografik, analizojnë elementë të situatës, kompleksitetin e saj, vlerësojnë rëndësinë dhe efektivitetin e zgjidhjeve të propozuara nga njëri-tjetri.

Kompetenca personale

Programi i gjeografisë nxit të nxënësit bazuar në kërkim duke zhvilluar aftësinë e nxënësve për të menaxhuar veten. Nxënësit kuptojnë rolin e tyre në procesin e të nxënësit dhe në kryerjen e hetimeve, aftësohen të jenë të pavarur në zbatimin e njohurive, shkathtësive dhe

në marrjen e vendimeve. Përmes punës në bashkëpunim në klasë dhe në terren, nxënësit zhvillojnë aftësitë ndërpersonale dhe mësojnë të vlerësojnë perspektivat e ndryshme të anëtarëve të tjerë të grupit.

Kompetenca digjitale

Nxënësi zhvillon kompetencën digjitale përmes përdorimit të TIK-ut në mënyrë efektive dhe të përshtatshme kur heton, krijon, komunikon idetë dhe informacionin për proceset e dukuritë gjeografike, për vendin e tij, vendet e tjera në botë dhe marrëdhënien e njeriut me mjedisin.

Diagrami 2: Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së gjeografisë

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (*Nxënësi komunikon në mënyrë efektive*)

Nxënësi:

- shprehet përmes një forme të komunikimit, për një temë të caktuar në një material gjeografik (prezantim) prej 200 fjalësh dhe veçon çështjet kryesore të ngritura në material (prezantim);
- përdor drejt strukturën dhe rregullat standarde të drejtshkrimit të gjuhës në kontekste dhe forma të ndryshme të shkrimit, si: ese, e-mail (postë elektronike), letër formale dhe joformale etj;
- prezanton një projekt, të hartuar individualisht dhe në grup, për një temë të caktuar gjeografike duke përdorur në mënyrë efektive teknologjinë e informacionit dhe teknologji të tjera.

Kompetenca e të menduarit (*Nxënësi mendon në mënyrë krijuese*)

Nxënësi:

- prezanton, në forma të ndryshme të të shprehurit, mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacionit për një

temë të caktuar, ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse;

- krahason të paktën tri burime të ndryshme të informimit për trajtimin e temës, argumenton saktësinë, rrethanat, gjen ngjashmëritë dhe dallimet, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara më parë, i prezanton gjetjet kryesore para të tjerëve në forma të ndryshme shprehëse, duke përdorur teknologjinë e informacionit;
- harton një detyrë me tekst, apo krijon një situatë logjike nga jeta e përditshme, e cila përmban një mesazh që kërkon zgjidhje duke u bazuar në njohuritë paraprake, prezanton mënyrën/procedurën e zgjidhjes së problemit para të tjerëve;
- krijon një situatë për marrjen e një vendimi për jetën e vet ose zgjidhjen e një problemi me interes shoqëror, lidh vendimin me pasojat në mënyrë të përgjegjshme, merr vendime dhe iniciativa të dobishme për vete, për shkollën dhe më gjerë.

Kompetenca e të mësuarit (*Nxënësi mëson për të nxënë*)

Nxënësi:

- shfrytëzon në mënyrë efektive përvojat paraprake gjatë zgjidhjes së situatave të ndryshme në jetën e përditshme apo gjatë kryerjes së ndonjë detyre ose veprimtarie në lëndën e gjeografisë, diskuton dhe ndan përvojat me të tjerët për mënyrat më praktike të shfrytëzimit të përvojave paraprake në arritjen e dijeve të reja;
- parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuar për zgjidhjen e një problemi apo detyre të një teme të caktuar, bën përmbledhjen e së paku dy veprimeve të përdorura të cilat përcaktojnë drejtimin e mëtejshëm të të nxënit për temën apo problemin e caktuar;
- zgjidh një problem të caktuar mësimor ose një situatë nga jeta e përditshme;
- në bazë të një planifikimi të dhënë dhe në bazë të rezultatit të fituar vërteton saktësinë e planifikimit dhe tregon me shembuj se si do të zbatojë strategjinë e ndjekur edhe në situata dhe kontekste të tjera gjatë të nxënit;

- shfrytëzon, në mënyrë të pavarur, udhëzimet e dhëna në ndonjë burim informacioni për të kryer një veprim, aktivitet, detyrë ose për të zgjidhur një problem që kërkohet prej tij, vlerëson vetë performancën dhe rezultatin e arritur, duke iu referuar qëllimeve fillestare (p.sh., burime të informacionit në libër, revistë, enciklopedi, internet, hartë, grafik, skicë etj.).

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (*Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive*)

Nxënësi:

- përgatit, prezanton, drejton dhe merr pjesë në një fushatë të informimit të qytetarëve për një temë të caktuar, duke u mbështetur në ide të reja, bazuar në rezultate të pritshme të përcaktuara qartë (p.sh., fushatë informimi për mbrojtjen e mjedisit etj.);
- hulumton dhe analizon forma të ndryshme të sipërmarrjes për mundësi të orientimit për karrierën, si dhe për të kontribuar në të mirë të komunitetit;
- demonstroi shprehje organizative në punët individuale dhe në ekip përmes situatave reale në detyrat e veçanta mësimore apo në veprimtari për jetë, për punë dhe për mjedis duke menaxhuar potencialin individual dhe atë të grupit si dhe kohën, rreziqet dhe buxhetin në dispozicion;
- harton një projekt me faza të menaxhuara mirë (individualisht ose në grup) duke shkëmbyer, konsultuar dhe informuar të tjerët si dhe duke identifikuar dhe vlerësuar burimet njerëzore, materiale dhe monetare në përputhje me rezultatet e pritshme;
- analizon gjendjen e mjedisit (në klasë, në shkollë, në komunitet apo më gjerë), pasojat e ndotjes, propozon alternativa për mbikëqyrje dhe menaxhim të drejtë të gjendjes së vlerësuar më të ndjeshme dhe inicion zgjidhje konkrete.

Kompetenca personale (*Nxënësi bën jetë të shëndetshme*)

Nxënësi:

- analizon përparësitë dhe dobësitë personale duke i evidentuar masat përmes të cilave synon të mbështesë avancimin personal, në

përparësitë që ka dhe masat përmes të cilave synon të përmirësojë dobësitë personale.

Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)

Nxënësi:

- demonstroi shembuj të pjesëmarrjes demokratike dhe drejton forma të ndryshme të diskutimit për pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes demokratike në nivele të ndryshme (p.sh.: në familje, në shkollë, në komunitet, në nivel lokal dhe nivel shtetëror) duke treguar tolerancë dhe respekt për pyetjet dhe komentet e të tjerëve;
- demonstroi shembuj konkretë të mbrojtjes së mjedisit natyror dhe atij të krijuar nga njeriu në veprimtari të jetës së përditshme në shtëpi, në klasë, në shkollë dhe në komunitet, propozon alternativa se si të gjithë qytetarët mund të ndihmojnë në mënyra të ndryshme për këtë proces;
- paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore dhe jep propozime për zgjidhjen e ndonjë problemi në komunitet e më gjerë në një fushë të caktuar.

Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)

Nxënësi:

- përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive;
- gjen, organizon, analizon, përpunon dhe përdor informacionin nga një shumëllojshmëri burimesh të ndryshme;
- përdor mjetet digjitale për të përpunuar, krijuar, realizuar dhe demonstruar tema mësimore nëpërmjet vizualizimeve të filmuara apo të animuara.

Për të realizuar lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës, mësuesi ndjek këto hapa:

- përzgjedh përmbajtjen mësimore, mjetet didaktike, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënësve të kompetencave të gjeografisë në një vit mësimor, si dhe rezultatet e të nxënësve për kompetencat kyçe në një vit mësimor;

- planifikon mësimdhënien duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do të arrijë rezultatet e të nxënit për kompetencat kyçe brenda vitit shkollor;
- kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave, projekteve për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënit për vit mësimor dhe shkallë në lëndën e gjeografisë.

6. LIDHJA E LËNDËS SË GJEOGRAFISË ME TEMAT NDËRKURRIKULARE

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore me të cilat përballet shoqëria. Ato i shërbejnë zhvillimit të kompetencave dhe synojnë të ndihmojnë nxënësin të lidhë shkollimin e tij me jetën e përditshme. Në shumë aspekte, programi i gjeografisë përqendrohet në zhvillimin e temave të mëdha ndërkurrikulare, kryesisht në temat:

- ❖ Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.
- ❖ Zhvillimi i qëndrueshëm.
- ❖ Mjedisi.
- ❖ Ndërvarësia.
- ❖ Bashkëjetesa paqësore.

Programi ndihmon për edukimin e identitetit kombëtar, njohjen e kulturave, ndërvarësinë dhe bashkëjetesën paqësore.

Duke analizuar marrëdhëniet e shoqërisë me mjedisin nga perspektiva e menaxhimit të përgjegjshëm, nxënësi mëson të vendosë lidhje midis nevojave dhe përdorimit racional të burimeve. Ai ndërgjegjësohet për aspektet shoqërore të konsumit, për implikimet e globalizmit për shoqërinë dhe shpërndarjen e burimeve. Ky ndërgjegjësim e ndihmon nxënësin të kuptojë më mirë ndërvarësinë e mjedisit nga veprimtaria njerëzore. Në këtë mënyrë, programi ndihmon për edukimin për zhvillimin e qëndrueshëm dhe mjedisin.

Përmes studimit të vendeve dhe rajoneve të ndryshme, transferimit të të nxënit në vendin e tij, nxënësi ndërgjegjësohet për rolin e tij si qytetar. Kjo e ndihmon atë të jetë mendjehapur dhe të respektojë diversitetin. Nxënësi ndërgjegjësohet për të drejtat e tij, ndërvarësinë e njerëzve, konfliktet ndërkombëtare dhe nevojën për të zhvilluar kulturën e paqes.

Zhvillimi i karrierës

Një ndër synimet kryesore të programit të gjeografisë në shkallën e pestë dhe më tej, është të zhvillojë orientimin për karrierat që lidhen me fushën e studimit të gjeografisë dhe dimensione të saj, të tilla si ai i gjeografit, meteorologut, sizmologut etj.

7. LIDHJET E LËNDËS SË GJEOGRAFISË BRENDË FUSHËS DHE ME FUSHAT E TJERA TË TË NXËNIT

Konceptimi i programit të gjeografisë në fushën "Shoqëria dhe mjedisi" është mbështetur në parime të mirëfillta të integritimit. Për t'i siguruar nxënësit zhvillimin e kompetencave, është e rëndësishme lidhja e lëndëve brenda fushës, të cilat ndihmojnë në mënyrë të ndërsjellë njëra-tjetrën.

Lidhja e gjeografisë me historinë i shërben nxënësit të kuptojë më mirë ndryshimet që kanë pësuar kulturat e ndryshme dhe ndikimin e tyre në zhvillimet e vendeve dhe rajoneve, si dhe sfidat e ndërvarësisë globale. Nxënësi hulumton mbi historinë e mendimit gjeografik për të kuptuar evolucionin e ideve dhe teorive.

Lidhja e gjeografisë me qytetarinë. Programi i gjeografisë ndihmon në zhvillimin e dimensioneve të qytetarisë. Ai e sheh botën si bashkësi globale dhe të ndërvarur. Nxënësi identifikon probleme, sugjeron zgjidhje dhe reflekton për marrjen e vendimeve. Gjeografia u jep aktualitet më të madh çështjeve me të cilat merret qytetaria dhe ndihmon në debate për çështje dhe ngjarje të rëndësishme.

Gjeografia është ngushtësisht e lidhur me fushat e tjera të të nxënës.

Si të gjitha lëndët e tjera, gjeografia krijon mundësi të zbatimit të kompetencave që zhvillon fusha "Gjuhët dhe komunikimi". Gjuha është themelore për të nxënësin e nxënësve në lëndën e gjeografisë. Nxënësi përzgjedh strategjitë e përshtatshme gjuhësore për të eksploruar, prezantuar dhe komunikuar të kuptuarin e dukurive gjeografike. Ai përdor gjuhën letrare për të shprehur pozicionin e tij qartë dhe në mënyrë koherente. Por njëkohësisht dhe gjeografia ndihmon në zgjerimin dhe përpunimin e fjalorit të nxënësit, duke e nxitur atë të parashtojë qartë dhe saktësisht idetë e tij. Punët praktike, projektet dhe detyrat që nxënësi realizon, i mundësojnë zhvillimin e kompetencës së komunikimit gjuhësor dhe pasurimin e fjalorit terminologjik. Termat e ndryshme, të përdorura në këtë lëndë, janë specifike dhe ndihmojnë nxënësin për zhvillimin e kompetencës së komunikimit përmes përdorimit të gjuhës dhe terminologjisë gjeografike.

Gjithashtu, e rëndësishme është *lidhja e gjeografisë me shkencat e natyrës*. Gjeografia është një urë lidhëse ndërmjet shkencave natyrore dhe shoqërore. Shumë prej njohurive të fushës së shkencave natyrore janë themelore për kuptimin dhe interpretimin e dukurive gjeografike në Tokë; p.sh., zbatimi i ligjit të tërheqjes së gjithësishtme për të shpjeguar tërheqjen e Tokës, Hënës, qëndrimin e planeteve në orbitën rreth Diellit; njohuritë mbi natyrën e valëve gjatësore dhe procesin e përhapjes së tyre në mjedis për të interpretuar valët detare; vetitë dhe përbërja e lëndës për të kuptuar mineralet; zbatimi i periodës së gjysmëzbërthimit dhe metodës së atomeve të shënuara të dukurisë së radioaktivitetit për të përcaktuar moshën absolute të shkëmbinjve etj., janë shembuj të zbatimit të ligjësisë dhe teorive shkencore në dukuritë gjeografike.

Lidhja e gjeografisë me matematikën. Nxënësi zhvillon njohuritë matematikore përmes përdorimit të informacioneve sasiore dhe cilësore, leximit apo ndërtimit të hartave, grafikëve dhe tabelave statistikore. P.sh., nxënësi llogarit mesataren ditore, mujore apo vjetore të temperaturave të ajrit; llogarit kohën lokale e zonale mbi bazën e veprimeve me thyesa; ndërton grafikë të shpërndarjes së reshjeve, temperaturës dhe i interpreton ato. Nxënësi ndërton diagrame që paraqesin strukturën e popullsisë së një vendi apo rajoni, të ekonomisë dhe sektorëve të saj etj.

Lidhja e gjeografisë me TIK-un. Teknologjia e informacionit dhe komunikimit (TIK) mbështet të nxënit në lëndën e gjeografisë përmes realizimit të detyrave të ndryshme, projekteve, kërkimit, përpunimit dhe prezantimit të informacionit. Nxënësi mëson të përzgjedhë informacionin dhe të mbajë qëndrim kritik ndaj tij, të dallojë faktin nga opinioni. Nxënësi mund të përdorë ëord-processor në shkrimin e materialeve, zbaton hedhjen e të dhënave në tabelë për ndërtimin e grafikëve, përdor poëer point për prezantimin e një detyre, kërkon në internet harta dhe përcakton vendndodhjen e objekteve të ndryshme.

8. KOMPETENCAT E LËNDËS DHE TEMATIKAT E SAJ

Përmes programit të gjeografisë mundësohet zhvillimi i kompetencave të lëndës, të cilat lidhen me kompetencat kyçe që një nxënës duhet të zotërojë gjatë gjithë jetës. Programi i gjeografisë, nëpërmjet tematikave të tij dhe situatave të të nxënësve, zhvillon dhe ndërton kompetencat e lëndës, të cilat janë pjesë e kërkimit gjeografik.

Tematikat mbi të cilat është organizuar përmbajtja e programit kanë të bëjnë me njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, nëpërmjet të cilave do të realizohen këto kompetenca. Shkathtësitë dhe qëndrimet, ashtu sikurse njohuritë, janë objekt i të nxënësve të rregullt dhe progresiv. Shkathtësitë dhe aftësitë u lejojnë nxënësve, që nën udhëheqjen e mësuesit apo në mënyrë të pavarur, të ndërtojnë, përvetësojnë, organizojnë njohuritë dhe të reflektojnë mbi to.

Disa nga shkathtësitë janë specifike për gjeografinë (p.sh., nxënësit lokalizojnë, orientohen në hapësirë, lexojnë dhe përdorin gjuhën hartografike), ndërsa të tjerat kanë të bëjnë me shkathtësi që gjeografia ndan me fushat e tjera dhe që janë të domosdoshme për të gjithë procesin e të nxënësve (p.sh., komunikojnë me shkrim dhe me gojë, përshkruajnë, identifikojnë etj.). Çdo situatë të nxënësve shoqërohet domosdoshmërisht me shumë prej këtyre shkathtësive.

Programi i gjeografisë zhvillon kompetencat e mëposhtme lëndore, të cilat lidhen me kërkimin gjeografik:

- ❖ *Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike.*
- ❖ *Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit.*
- ❖ *Marrja e vendimeve mbi bazën e informacionit të mbledhur.*

Tabela: Rezultatet e të nxënit për kompetencat e lëndës

Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike

Nxënësi:

- përcakton një çështje gjeografike për kërkim/hetim;
- formulon pyetje ose jep shpjegim, zgjidhje ose opinion duke përcaktuar disa aspekte thelbësore të çështjes;
- përcakton marrëdhëniet shkak-pasojë të dukurive gjeografike që ndodhin në sistemet natyrore të Tokës dhe dukurive gjeografike që ndodhin në vende dhe rajone të ndryshme.

Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit

Nxënësi:

- përdor burime informacioni që mund të ndryshojnë besueshmërinë e tyre;
- zgjedh burimet më të përshtatshme nga tërësia e burimeve parësore dhe dytësore në dispozicion;
- përcakton metodat, strategjitë ose teknikat e përshtatshme;
- komunikon (me shkrim, me gojë, grafikisht, vizualisht) shpërndarjen hapësinore të dukurive gjeografike, përmes përdorimit të hartave të shkallëve të ndryshme duke përdorur fjalorin e përshtatshëm gjeografik.

Marrja e vendimeve

Nxënësi:

- jep shpjegime në lidhje me çështjen gjeografike të marrë në shqyrtim;
- identifikon pasojat që mund të shoqërojnë zgjidhjen e çështjes;
- identifikon rrugë të ndryshme të veprimit;
- përdor pyetje për të reflektuar në çdo fazë të kërkimit :“Çfarë funksionoi?”, “Si mund të përmirësohet?”.

9. KOHA MËSIMORE

Programi i gjeografisë për klasën e XIII, Struktura 2+1+1 dhe Struktura 2+2, zhvillohet në 64 orë mësimore gjithsej (2 orë mësimore/javë x 32 javë).

Klasa XIII: Struktura 2+1+1 dhe 2+2

Tematika	Nëntematikat	Orë të sugjeruara
Ndërvarësia midis njerëzve, rajoneve dhe mjediseve. (64 orë)	Hapësira në trajtimin gjeografik rajonal.	3
	Europa, rajoni, Shqipëria dhe trevat e tjera shqiptare.	10
	Tiparet e përgjithshme natyrore të Republikës së Shqipërisë.	9
	Popullsia dhe ekonomia e Republikës së Shqipërisë.	10
	Rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë.	30
	Pabarazitë dhe mundësitë e zhvillimeve rajonale.	2

Në program specifikohen orët e sugjeruara për secilën nëntematikë. Orët e sugjeruara përfshijnë njohuritë e reja, punët praktike, detyrat, vëzhgimet në natyrë, testimet, zhvillimin dhe prezantimin e projektit. Sasia e orëve mësimore për secilën nëntematikë është rekomanduese. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, kurse janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara.

10. REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS TEMATIKAVE

Në programin e gjeografisë janë paraqitur rezultatet e të nxënit për tematikën “Ndërvarësia midis njerëzve, rajoneve dhe mjediseve”, në funksion të zhvillimit të kompetencave.

Rezultatet e të nxënit shprehen në terma njohurish, aftësish dhe qëndrimesh. Kombinimi dhe ndarja e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve në situata të nxëni, kapituj apo grupe temash e njësi mësimore, si dhe renditja e tyre është e drejtë e përdoruesve të programit (më kryesorët janë mësuesit dhe autorët e teksteve).

TEMATIKA: NDËRVARËSIA MIDIS NJERËZVE, RAJONEVE DHE MJEDISEVE

Përshkrimi i tematikës:

Tematika “Ndërvarësia midis njerëzve, rajoneve dhe mjediseve” në këtë klasë, zhvillon te nxënësit njohuri, shkathtësi dhe qëndrime të cilat kanë të bëjnë me trajtimin gjeografik rajonal, duke pasur në fokus kryesor hapësirën e vendit tonë, Shqipërinë. Në këtë kuadër, formimi gjeografik i nxënësit fokusohet në tre drejtime: në trajtimin teorik të konceptit të rajonit dhe tipeve të rajoneve; në trajtimin e hierarkisë dhe lidhjeve rajonale midis Europës, rajonit, Shqipërisë dhe trevave të tjera shqiptare; si dhe në trajtimin e detajuar të katër rajoneve gjeografike të Republikës së Shqipërisë, dallimeve dhe mundësive në zhvillimet e ndryshme rajonale të vendit.

Programi synon që nxënësit të aftësohen të zbulojnë dhe argumentojnë lidhjet shkak-pasojë të dukurive dhe proceseve që ndodhin në rajone të ndryshme gjeografike, të zhvillojnë aftësi të kërkimit gjeografik përmes hulumtimit të tipareve dhe veçorive të rajoneve të veçanta të vendit tonë, si dhe të bëjnë gjykime e të zhvillojnë qëndrime në lidhje me perspektivat e zhvillimit të qëndrueshëm rajonal.

Përmes detyrave, punëve praktike, projektit e strategjive të tjera ndërvepruese, përdorimit të teknologjisë së informacionit, nxënësit aftësohen në kërkimin gjeografik dhe zhvillojnë të menduarin kritik e krijues, zhvillojnë shkathtësi të komunikimit dhe të punës në grup. Përmes përdorimit të burimeve të ndryshme, si: harta, fotografi, statistika, diagrame, ilustrime fotosh dhe video etj., nxënësit zbulojnë dhe përvetësojnë informacione dhe koncepte gjeografike si për Shqipërinë në përgjithësi, ashtu edhe për rajonet e saj gjeografike në veçanti.

REZULTATET E TË NXËNIT

NËNTEMATIKA: HAPËSIRA NË TRAJTIMIN GJEOGRAFIK RAJONAL

Njohuritë	Shkathtësitë	Qëndrimet / vlerat
❖ Rëndësia e trajtimit rajonal të hapësirës gjeografike.	<i>Nxënësi:</i> <ul style="list-style-type: none">➤ <u>vlerëson</u> dhe <u>argumenton</u> rëndësinë e trajtimit rajonal të territorit (hapësirës);➤ <u>identifikon</u> kriteret bazë të rajonizimit	<i>Nxënësi:</i> <ul style="list-style-type: none">➤ <u>demonstron</u>, përmes studimit të gjeografisë, aftësitë qytetare, të

<ul style="list-style-type: none"> ❖ Rajoni në kuptimin e tij të përgjithshëm. Kriteret e rajonizimit dhe tipet e rajoneve. ❖ Kuptimi i sotëm europian mbi rajonin në kuadër të BE nën moton: “Bashkëjetesë në diversitet”. Kalimi nga Europa e shteteve drejt asaj të rajoneve. ❖ Zhvillimi i konceptit shqiptar mbi rajonin. Kriteret dhe problematikat e rajonizimit gjeografik në Shqipëri. ❖ Rëndësia e trajtimit rajonal të vendit për integrimin e tij në BE si një nga kriteret e këtij integrimi. 	<p>gjeografik dhe tipet e ndryshëm të rajoneve;</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>shpjegon</u> kuptimin e sotëm europian mbi rajonin nën frymën e respektimit të diversitetit dhe ndërveprimit rajonal; ➤ <u>sjell shembuj</u> të rritjes së ndërvaresisë rajonale përmes proceseve ekonomike, politike, mjedisore dhe shkëmbimeve kulturore në Europë; ➤ <u>interpretin</u> zhvillimin e konceptit shqiptar për rajonin; ➤ <u>identifikon</u> kriteret e rajonizimit gjeografik në Shqipëri; ➤ <u>vlërëson</u> problematikat që shoqërojnë rajonizimin gjeografik të vendit tonë; ➤ <u>argumenton</u> rëndësinë që ka rajonizimi dhe trajtimi i zhvillimeve rajonale të vendit si një nga kriteret për integrimin e tij në BE; ➤ <u>sjell shembuj</u> të standardeve që kanë përmbushur vende të tjera anëtare apo candidate të BE-së me zhvillimet e tyre rajonale. 	<p>cilat ndihmojnë në rritjen personale si individë, në përgatitjen e tyre në jetë, në punë dhe në shoqëri;</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>vlërëson</u> dhe <u>shpreh ndjeshmëri</u> ndaj menaxhimit të qëndrueshëm të rajoneve; ➤ <u>vlërëson</u> dhe <u>respekton</u> pikëpamjet e të tjerëve; ➤ <u>tregon</u> integritet në aksesimin dhe përdorimin etik të informacionit; ➤ <u>paraqet</u> dhe <u>komunikon</u> lirshëm mendimet e tij; ➤ <u>demonstron</u> objektivitet dhe paanësi; ➤ <u>demonstron</u> pavarësi dhe besim në vetvete; ➤ <u>respekton</u> përpjekjet personale dhe ato në grup.
--	--	--

NËNTEMATIKA: EUROPA, RAJONI, SHQIPËRIA DHE TREVAT E TJERA SHQIPTARE

<ul style="list-style-type: none"> ❖ Europa: karakteristika të përgjithshme dhe veçori rajonale. 	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>argumenton</u> rëndësinë e pozitës gjeografike të Europës dhe rolin e saj për zhvillimin dhe marrëdhëniet me rajonet e tjerë të botës; ➤ <u>përshkruan</u> tiparet më të përgjithshme natyrore, demografike, ekonomike dhe kulturore të Europës; ➤ <u>vlerëson</u> ndërvarësinë midis rajoneve të Europës dhe sjell shembuj të ndërvarësisë dhe bashkëveprimit rajonal; 	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>zhvillon</u> ndjenjën e identitetit kombëtar dhe të respektit e mirëkuptimit për vendet dhe e popujt fqinj e më gjerë; ➤ <u>vlerëson</u> trashëgiminë natyrore dhe kulturore; ➤ <u>vlerëson</u> dhe <u>respekton</u> politikat globale dhe rajonale për zhvillimin e qëndrueshëm; ➤ <u>vlerëson</u> dhe <u>respekton</u> pikëpamjet e të tjerëve;
<ul style="list-style-type: none"> ❖ Europa Juglindore dhe vendi i hapësirës shqiptare në të. 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>vlerëson</u> pozitën gjeostrategjike të hapësirës shqiptare në Europën Juglindore dhe rolin e saj për zhvillimin dhe bashkëpunimin ndërrajonal e më gjerë; 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>tregon</u> integritet në aksesimin dhe përdorimin etik të informacionit;
<ul style="list-style-type: none"> ❖ Hapësira mesdhetare dhe roli i saj në zhvillimin e hapësirave shqiptare. 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>vlerëson</u> vendin e rëndësishëm që zë hapësira shqiptare si pjesë e Mesdheut, me tiparet e veçanta që e shoqërojnë natyrën, popullimin dhe ekonominë; 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>paraqet</u> dhe <u>komunikon</u> lirshëm mendimet e tij; ➤ <u>demonstron</u> pavarësi dhe objektivitet në kryerjen e detyrave;
<ul style="list-style-type: none"> ❖ Trevat shqiptare: 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>analizon</u> pozitën gjeografike të trevave 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>respekton</u> përpjekjet personale

+ përbërja dhe ndryshimet në hartën politike;

+ tipare të zhvillimit rajonal.

❖ Republika e Kosovës:

+ tiparet gjeografike natyrore;

+ tipare të zhvillimit demografik dhe socio-ekonomik.

shqiptare në Europë dhe më gjerë;

➤ vlërëson rolin e kësaj pozite në veçoritë natyrore gjeografike, në popullimin e trevave dhe zhvillimin ekonomik, dhe pasojat e kësaj pozite në copëtimin e trevave shqiptare;

➤ analizon ndryshimet që ka pësuar në kohë dhe në hapësirë harta politike e trevave shqiptare;

➤ argumenton rëndësinë e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis vendeve e popujve fqinjë e më gjerë, në kuadër të perspektivës të të gjitha trevave shqiptare dhe të shteteve ku ato ndodhen në familjen e madhe europiane;

➤ analizon tiparet e përgjithshme gjeografike natyrore të Republikës së Kosovës:

✓ pozitën gjeografike,

✓ kushtet dhe pasuritë natyrore,

✓ trashëgiminë natyrore;

➤ analizon tiparet e përgjithshme të zhvillimit demografik dhe socio-ekonomik të

dhe ato në grup.

❖ Trevat e tjera shqiptare në rajon (në Maqedoninë e Veriut, në Mal të Zi, në Serbi, në Greqi):

✚ veçoritë natyrore;

✚ tipare të zhvillimit demografik dhe socio-ekonomik;

✚ tiparet e diferencimit në zhvillimin rajonal.

Republikës së Kosovës:

✓ strukturën dhe ecurinë e numrit të popullsisë (faktorët),

✓ shpërndarjen gjeografike të popullsisë,

✓ zhvillimin e degëve kryesore të ekonomisë dhe shkallën e zhvillimit;

➤ evidenton, me ndihmën e hartës, diferencimin rajonal të Republikës së Kosovës;

➤ vlerëson akset dhe drejtimet e zhvillimit të ardhshëm të Republikës së Kosovës me shanset dhe mundësitë që ofron ajo për integrim rajonal dhe europian;

➤ përshkruan pozitën gjeografike dhe veçoritë kryesore natyrore të trevave të tjera shqiptare, rolin e tyre për zhvillimet rajonale;

➤ analizon tiparet kryesore të zhvillimit demografik dhe social-ekonomik të trevave të tjera shqiptare;

➤ analizon dallimet që ekzistojnë në zhvillimet rajonale midis pjesëve të

❖ Republika e Shqipërisë:

- + pozita gjeografike dhe roli i saj në integrimin rajonal dhe europian;
- + ndryshimet në organizimin administrativo-territorial dhe ndikimi në zhvillimet rajonale.

ndryshme të trevave të tjera shqiptare, faktorët që kanë ndikuar dhe perspektivën e zhvillimit të tyre;

- vlerëson rolin e pozitës gjeografike të Republikës së Shqipërisë për zhvillimin e bashkëpunimit dhe ndërveprimit rajonal e më gjerë, si urë lidhëse midis lindjes dhe perëndimit;
- përshkruan ndryshimet që kanë ndodhur në organizimin administrativo-territorial të vendit tonë;
- analizon organizimin e sotëm administrativo-territorial të Republikës së Shqipërisë;
- argumenton ndikimin e organizimit të sotëm administrativ-territorial të Shqipërisë në zhvillimin dhe integrimin rajonal dhe europian.

NËNTEMATIKA: TIPARET E PËRGJITHSHME NATYRORE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

- ❖ Larmia e mjediseve dhe peizazheve natyrore të Shqipërisë.
- ❖ Evolucioni gjeologjik dhe formimi i truallit.
- ❖ Pasuritë minerare dhe roli i tyre në zhvillimin ekonomik të vendit dhe të rajoneve.
- ❖ Larmia e formave të relievit dhe roli i relievit në ndryshimet rajonale.
- ❖ Klima, elementët kryesorë klimatikë dhe tiparet e tyre.

Nxënësi:

- përshkruan larminë e mjediseve dhe të peizazheve natyrore të Shqipërisë dhe faktorët e përgjithshëm që kanë ndikuar në këtë drejtim;
- analizon etapat e formimit të truallit, përbërjen litologjike dhe strukturore të tij;
- identifikon pasuritë minerare të vendit tonë dhe shpërndarjen gjeografike të tyre, duke përdorur hartën;
- vlerëson rolin e pasurive minerare për zhvillimin ekonomik të vendit;
- identifikon faktorët gjeografikë dhe interpretin rolin e tyre në krijimin e larmisë së formave të relievit;
- interpretin me ndihmën e hartës, shtrirjen e elementëve kryesorë të relievit;
- analizon rolin e relievit në zhvillimet dhe shpërndarjen hapësinore të elementëve demografikë dhe ekonomikë;
- identifikon elementët kryesorë klimatikë

Nxënësi:

- demonstron interes dhe kuriozitet për tiparet natyrore të vendit tonë;
- demonstron ndjeshmëri dhe kujdes për cilësinë e mjedisit natyror;
- është aktiv në shfrytëzimin e informacionit nga burime të ndryshme dhe e përdor atë efektivisht;
- vlerëson menaxhimin e qëndrueshëm dhe përdorimin eficient të burimeve natyrore;
- vlerëson marrjen e masave për të zvogëluar degradimin e habitateve natyrore në vendin tonë;
- vlerëson dhe respekton pikëpamjet e të tjerëve;
- paraqet dhe komunikon lirshëm mendimet e tij;
- respekton përpjekjet personale

- ❖ Pasuritë klimatike dhe ndikimi i tyre në zhvillimin ekonomik të vendit dhe të rajoneve.
- ❖ Larmia dhe pasuria e madhe hidrografike.
- ❖ Roli dhe rëndësia e larmisë hidrografike për zhvillimin ekonomik të vendit dhe të rajoneve të veçanta të tij.
- ❖ Larmia e tokave, vlerat, faktorët e degradimit dhe ndotjes së tyre.
- ❖ Larmia e madhe e florës dhe faunës së Shqipërisë, bazë e rëndësishme për zhvillimin e rajoneve të ndryshme.

dhe tiparet e tyre;

- evidenton tiparet kryesore të klimës së vendit tonë dhe faktorët që ndikojnë në formimin e saj;
- vlerëson rolin dhe ndikimin e klimës në dukuritë e tjera natyrore, në shpërndarjen e popullsisë dhe aktivitetet e saj;
- analizon larminë dhe pasurinë e madhe hidrografike të Shqipërisë dhe faktorët që kanë ndikuar;
- vlerëson rolin e pasurive hidrike për zhvillimin ekonomik të vendit dhe të rajoneve të ndryshëm;
- analizon kushtet dhe faktorët që ndikojnë në larminë e tokave të vendit tonë;
- analizon faktorët dhe kushtet që kanë përcaktuar larminë dhe pasurinë e madhe bimore dhe shtazore të Shqipërisë;
- vlerëson rolin e pasurisë floristike dhe të faunës të vendit tonë për zhvillimin e rajoneve të ndryshme dhe rolin e veprimtarisë njerëzore për ruajtjen dhe

dhe ato në grup.

<p>❖ Trashëgimia natyrore e Shqipërisë – pasuri shumë e rëndësishme për zhvillime të caktuara rajonale.</p>	<p>zhvillimin e biodiversitetit;</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>evidenton</u> disa ndër sitet e trashëgimisë natyrore të vendit tonë; ➤ <u>hulumton</u> në burime të ndryshme informacioni mbi zonat e mbrojtura të vendit tonë, pasurinë që ofrojnë dhe ndikimin e tyre në zhvillimin e turizmit;
<p>❖ Raportet njeri-mjedis dhe ndikimi në gjendjen e peizazheve të ndryshme.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>identifikon</u> faktorët kryesorë dhe pasojat e problemeve mjedisore në vendin tonë; ➤ <u>interpretin</u> faktorët që kanë ndikuar në shkallën e lartë të degradimit dhe shkretimit të tokave si dhe pasojat e tyre; ➤ <u>vlerëson</u> ndikimin e veprimtarisë njerëzore në ndryshimin e peizazheve të ndryshme; ➤ <u>parashikon</u> rrugë të menaxhimit efektiv të këtij ndikimi.

NËNTEMATIKA: POPULLSIA DHE EKONOMIA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

<p>❖ Popullsia dhe vendbanimet. Tiparet e zhvillimit të përgjithshëm demografik.</p> <p>❖ Ecuria e numrit të përgjithshëm të</p>	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>interpretin</u> ecurinë e zhvillimit të popullsisë dhe vendbanimeve; ➤ <u>analizon</u> ecurinë e numrit të përgjithshëm të 	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>vlerëson</u> diversitetin shoqëror, kulturor dhe mjedisor; ➤ <u>vlerëson</u> dhe <u>respekton</u>
--	---	--

<p>popullsisë së Shqipërisë në periudha të ndryshme.</p> <p>❖ Tiparet e shpërndarjes gjeografike të popullsisë.</p> <p>❖ Lëvizja natyrore dhe ndikimet e saj në numrin e përgjithshëm të popullsisë.</p> <p>❖ Migrimet e popullsisë dhe roli i veçantë i tyre në zhvillimet demografike të vendit.</p>	<p>popullsisë së Shqipërisë përgjatë periudhave të ndryshme;</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>dallon</u> faktorët që ndikojnë në shpërndarjen gjeografike të popullsisë; ➤ <u>interpretton</u> me ndihmën e hartës tiparet e shpërndarjes gjeografike të popullsisë; ➤ <u>analizon</u> tregues të lëvizjes natyrore të popullsisë; ➤ <u>vlerëson</u> ndikimin e lëvizjes natyrore të popullsisë në numrin e përgjithshëm të popullsisë; ➤ <u>hulumton</u> në burime të ndryshme informacioni dhe <u>interpretton</u> grafikë, të dhëna statistikore etj., në lidhje me ecurinë e numrit të përgjithshëm të popullsisë dhe lëvizjen natyrore të saj; ➤ <u>analizon</u> procesin e migrimit si promotorin e të gjitha ndryshimeve demografike të popullsisë shqiptare, duke u ndalur në periudhën pas vitit 1990; ➤ <u>evidenton</u> territoret ku kanë migruar shqiptarët me veçoritë dhe problemet e 	<p>pikëpamjet e të tjerëve;</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>tregon</u> integritet në aksesimin dhe përdorimin etik të informacionit; ➤ <u>komunikon</u> lirshëm mendimet e tij; ➤ <u>respekton</u> përpjekjet personale dhe ato në grup.
--	--	---

❖ Tipare të strukturës cilësore të popullsisë së Shqipërisë (sipas moshës, gjinisë, vendbanimit, etnike, fetare etj.).

❖ Ekonomia e Shqipërisë dhe tipare të zhvillimit të saj në periudha të ndryshme.

❖ Vlerësim i potencialeve natyrore dhe humane të vendit për zhvillimin e tij ekonomik.

❖ Struktura e degëve dhe nëndegëve të ekonomisë.

integritit të tyre;

➤ evidenton tiparet e përgjithshme të strukturës së popullsisë së Shqipërisë, referuar:

- ✓ moshës,
- ✓ gjinisë,
- ✓ vendbanimit,
- ✓ etnisë,
- ✓ fesë;

➤ ndërton dhe analizon grafikë të strukturës së popullsisë dhe hartat e shpërndarjes gjeografike të saj;

➤ përshkruan tiparet e përgjithshme të zhvillimit ekonomik të Shqipërisë, duke analizuar ecurinë e tyre përgjatë periudhave të ndryshme;

➤ vlerëson potencialet natyrore dhe humane të Shqipërisë dhe ndikimin e tyre në shkallën e zhvillimit ekonomik të vendit;

➤ analizon rolin e sektorëve të veçantë të ekonomisë në zhvillimin e Shqipërisë (bujqësinë, industrinë, tregtinë, transportin,

<p>❖ Mundësitë dhe problematikat e zhvillimit të ardhshëm ekonomik.</p>	<p>turizmin, shërbimet dhe artizanatin);</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>vlërëson</u> problemet aktuale dhe perspektivën e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë, në kuadër të integritit rajonal dhe europian; ➤ <u>ndërton</u> dhe <u>analizon</u> grafikët e strukturës së ekonomisë dhe degëve të saj si dhe hartat e shpërndarjes gjeografike të rajoneve kryesore bujqësore dhe industriale të trevave shqiptare. 	
---	---	--

NËNTEMATIKA: RAJONET GJEOGRAFIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

<p>❖ Rajonizimi gjeografik i Shqipërisë. Përcaktimi i rajoneve gjeografike dhe karakteristikat e përgjithshme të tyre.</p> <p>❖ Rajoni Perëndimor: pozita gjeografike, dhe pjesët përbërëse të rajonit.</p> <p>❖ Veçoritë kryesore natyrore të Rajonit</p>	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>identifikon</u> kriteret e rajonizimit gjeografik të Shqipërisë, ndarjen rajonale të saj dhe tipet e rajoneve; ➤ <u>vlërëson</u> rolin e pozitës gjeografike të Rajonit Perëndimor për zhvillimin ekonomik e social të tij dhe për zhvillimin e marrëdhënieve ndër rajonale brenda dhe jashtë Shqipërisë; ➤ <u>përshkruan</u> veçoritë kryesore natyrore të 	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>vlërëson</u> diversitetin natyror, shoqëror dhe kulturor të rajoneve të Shqipërisë; ➤ <u>vlërëson</u> dhe <u>respekton</u> pikëpamjet e të tjerëve; ➤ <u>tregon</u> integritet në aksesimin dhe përdorimin etik të informacionit; ➤ <u>paraqet</u> dhe <u>komunikon</u> lirshëm mendimet e tij;
---	---	--

<p>Perëndimor dhe vlerësimi i tyre për zhvillimin e rajonit.</p> <ul style="list-style-type: none"> ❖ Karakteristikat kryesore të popullimit të Rajonit Perëndimor, me fokus të veçantë rritjen e shpejtë të popullsisë dhe ndryshimet strukturore të saj. ❖ Lëvizjet e shumta të popullsisë drejt rajonit perëndimor, shkaqet dhe pasojat. ❖ Veçoritë e urbanizimit të shpejtë të Rajonit Perëndimor dhe rrjedhojat e tij. ❖ Tiparet e zhvillimit ekonomik të Rajonit Perëndimor dhe ecuria e këtij zhvillimi në periudha të ndryshme. ❖ Struktura e degëve dhe nëndegëve të ekonomisë së rajonit. Roli i tyre në zhvillimin e përgjithshëm. ❖ Trashëgimia natyrore dhe kulturore e Rajonit Perëndimor. ❖ Mundësitë dhe perspektivat e zhvillimit 	<p>Rajonit Perëndimor dhe potencialet natyrore për zhvillim;</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>evidenton</u> karakteristikat kryesore të popullimit të këtij rajoni, me fokus të veçantë rritjen e shpejtë të popullsisë dhe ndryshimet strukturore të saj; ➤ <u>analizon</u> shkaqet e lëvizjes së popullsisë drejt Rajonit Perëndimor dhe pasojat; ➤ <u>analizon</u> urbanizimin e shpejtë të Rajonit Perëndimor dhe rrjedhojat e tij; ➤ <u>vlerëson</u> zhvillimin bujqësor, industrial, të tregtisë, turizmit, transportit etj., të Rajonit Perëndimor; ➤ <u>hulumton</u> në burime të ndryshme informacioni dhe <u>interpretton</u> grafikë, të dhëna statistikore, harta etj., në lidhje me ecurinë e zhvillimit ekonomik të Rajonit Perëndimor në periudha të ndryshme; ➤ <u>vlerëson</u> trashëgiminë natyrore dhe kulturore të Rajonit Perëndimor dhe rolin e saj për zhvillimin e turizmit; ➤ <u>identifikon</u> mundësitë dhe <u>parashikon</u> 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>demonstron</u> pavarësi dhe objektivitet në kryerjen e detyrave; ➤ <u>respekton</u> përpjekjet personale dhe ato në grup.
---	---	---

të mëtejshëm të rajonit.

- ❖ **Rajoni Verior-Verilindor:** veçoritë kryesore natyrore dhe potencialet e shumta natyrore për zhvillimin e tij.
- ❖ Pjesët përbërëse të Rajonit Verior - Verilindor dhe specifikat e tyre rajonale.
- ❖ Tiparet e zhvillimit demografik të Rajonit Verior - Verilindor (numri i popullsisë, shpërndarja e saj, struktura etj).
- ❖ Braktisja masive e Rajonit Verior - Verilindor pas vitit 1990, shkaqet dhe pasojat.
- ❖ Tipare të zhvillimit ekonomik të Rajonit Verior – Verilindor: midis potencialeve të shumta dhe vështirësive të mëdha.
- ❖ Trashëgimia natyrore dhe kulturore e Rajonit Verior - Verilindor.
- ❖ Mundësitë dhe perspektivat e zhvillimit

perspektivën e zhvillimit të Rajonit Perëndimor;

- përshkruan mozaikun natyror të Rajonit Verior - Verilindor dhe potencialet natyrore për zhvillim;
- identifikon tiparet e përgjithshme natyrore të pjesëve përbërëse të Rajonit Verior - Verilindor ;
- evidenton tiparet kryesore të zhvillimit demografik të Rajonit Verior – Verilindor;
- analizon tendencën e ndryshimeve demografike të këtij rajoni me fokus të veçantë braktisjen pas viteve‘90;
- analizon tiparet kryesore të aktivitetit aktual ekonomik të Rajonit Verior - Verilindor;
- vlerëson trashëgiminë natyrore dhe kulturore të Rajonit Verior - Verilindor;
- identifikon mundësitë dhe argumenton

të mëtejshëm të Rajonit Verior - Verilindor.

❖ **Rajoni Juglindor:** pozicioni gjeografik dhe tiparet dalluese natyrore.

❖ Pjesët përbërëse të rajonit dhe rëndësia ndërkufitare e tij për zhvillimin rajonal.

❖ Tiparet e zhvillimit demografik të Rajonit Juglindor.

❖ Lëvizjet e fuqishme migratore të popullsisë së rajonit, veçanërisht pas vitit 1990 dhe efektet e tyre në zhvillimet rajonale.

❖ Potencialet dhe gjendja e zhvillimit

perspektivën e zhvillimit të Rajonit Verior - Verilindor, rolin e korridorit Durrës-Prishtinë në kuadër të këtij zhvillimi dhe të bashkëpunimit rajonal e më gjerë;

➤ ndërton hartën e resurseve natyrore të Rajonit Verior – Verilindor, duke analizuar mundësitë e shfrytëzimit të tyre për zhvillimin social –ekonomik;

➤ vlerëson pozitën gjeografike të Rajonit Juglindor për zhvillimin e bashkëpunimit rajonal;

➤ përshkruan tiparet dalluese natyrore të Rajonit Juglindor;

➤ identifikon pjesët përbërëse të Rajonit Juglindor;

➤ analizon tiparet dalluese dhe tendencën e zhvillimit demografik të Rajonit Juglindor, me fokus të veçantë lëvizjet migratore pas viteve '90;

➤ evidenton disa ndër pasojat e këtyre lëvizjeve në zhvillimet rajonale;

➤ analizon tiparet kryesore të veprimtarisë

<p>ekonomik të Rajonit Juglindor në raport me rajonet e tjera.</p> <ul style="list-style-type: none"> ❖ Trashëgimia natyrore dhe kulturore e Rajonit Juglindor. ❖ Mundësitë dhe perspektivat e zhvillimit të mëtejshëm të Rajonit Juglindor. ❖ Rajoni Jugor: tiparet e përgjithshme natyrore që dallojnë rajonin. ❖ Tiparet e zhvillimit demografik të Rajonit Jugor (numri i popullsisë, shpërndarja e saj, struktura etj.). ❖ Migrimet e popullsisë dhe pasojat e tyre në zhvillimet rajonale. 	<p>ekonomike të Rajonit Juglindor, duke e krahasuar dhe me rajonet e tjerë;</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <u>vlerëson</u> trashëgiminë natyrore dhe kulturore të Rajonit Juglindor dhe rëndësinë e saj për zhvillimin e turizmit; ➤ <u>identifikon</u> mundësitë dhe <u>argumenton</u> perspektivën e zhvillimit të Rajonit Juglindor; ➤ <u>ndërton</u> hartën e infrastrukturës rrugore të Rajonit Juglindor, duke evidentuar rolin e saj në integrimin dhe bashkëpunimin me shtetet fqinje dhe më gjerë; ➤ <u>vlerëson</u> rëndësinë e pozitës gjeografike ndërkufitare të Rajonit Jugor për zhvillimet rajonale; ➤ <u>përshkruan</u> tiparet e përgjithshme natyrore që dallojnë Rajonin Jugor; ➤ <u>analizon</u> tiparet dalluese të zhvillimit demografik të Rajonit Jugor; ➤ <u>evidenton</u> pasojat e migrameve të popullsisë së Rajonit Jugor;
--	---

❖ Struktura e zhvillimit ekonomik të Rajonit Jugor dhe pasojat ndërrajonale të saj.	➤ <u>dallon</u> tiparet kryesore të veprimtarisë ekonomike të Rajonit Jugor dhe pasojat ndërrajonale të saj;
❖ Trashëgimia natyrore dhe kulturore e Rajonit Jugor.	➤ <u>vlerëson</u> trashëgiminë natyrore dhe kulturore të Rajonit Jugor dhe rëndësinë e saj;
❖ Mundësitë dhe perspektivat e zhvillimit të mëtejshëm të Rajonit Jugor.	➤ <u>identifikon</u> mundësitë dhe argumenton perspektivën e zhvillimit të Rajonit Jugor; ➤ <u>ndërton</u> hartën e zonave kryesore turistike të Rajonit Jugor.

NËNTEMATIKA: PABARAZITË DHE MUNDËSITË E ZHVILLIMIT RAJONAL

❖ Pabarazitë në shkallën e zhvillimit socio-ekonomik midis rajoneve të vendit.	<i>Nxënësi:</i> ➤ <u>përshkruan</u> tiparet dalluese të pabarazive të zhvillimit socio-ekonomik të rajoneve të vendit tonë;	<i>Nxënësi:</i> ➤ <u>demonstron</u> pavarësi dhe objektivitet në kryerjen e detyrave;
❖ Shkaqet dhe faktorët që kanë ndikuar në pabarazitë e theksuara të zhvillimit rajonal, veçanërisht pas vitit 1990.	➤ <u>analizon</u> faktorët që kanë ndikuar në pabarazitë e zhvillimeve rajonale;	➤ <u>tregon</u> integritet në aksesimin dhe përdorimin etik të informacionit;
❖ Drejtimit në të cilat shprehen pabarazitë e zhvillimit rajonal dhe rrugët për zbutjen e tyre.	➤ <u>përcakton</u> drejtimit kryesore të këtyre dallimeve, të tilla si: ✓ popullimi, ✓ zhvillimi ekonomik,	➤ <u>është krijues</u> dhe <u>prezanton</u> idetë e reja të tij; ➤ <u>demonstron</u> objektivitet në

❖ Mundësitë dhe aftësitë konkurruese të Shqipërisë për zhvillimet e ardhshme rajonale.

- ✓ shkalla e urbanizimit,
- ✓ niveli i papunësisë,
- ✓ etj.;
- identifikon disa nga rrugët për zbutjen e pabarazive;
- vlerëson potencialet konkurruese të Shqipërisë për zhvillimet e ardhme rajonale (të tilla, si bujqësia, energjia, turizmi etj.).

- diskutimet dhe debatet;
- respekton punën e të tjerëve;
- respekton përpjekjet personale dhe ato në grup.

11. UDHËZIME METODOLOGJIKE

Metodat, teknikat, strategjitë e mësimdhënies, në lëndën e gjeografisë, janë faktorë të rëndësishëm për një mësimdhënie të suksesshme që nxit interesin, gjithëpërfshirjen, ndërveprimin dhe punën kërkimore të nxënësve.

Përzgjedhja dhe përdorimi i tyre nga mësuesit bëhet në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve, duke respektuar stilet e ndryshme të të nxënësve të tyre.

Mësimdhënia dhe të nxënësve, bazuar në kompetenca, kërkon që në përzgjedhjen dhe përdorimin e strategjive, teknikave dhe metodave të mësimdhënies, mësuesit e kësaj lënde:

- të marrin parasysh njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet paraprake të nxënësve, që nënkupton përvojat individuale të tij dhe, mbi këtë bazë, të mbështesin e orientojnë të nxënësve të tij;
- të nxitin vrojtimin e drejtpërdrejtë, kureshtjen, arsyetimin dhe gjykimin nëpërmjet demonstrimeve dhe vëzhgimeve në natyrë;
- të nxitin të menduarit kritik, krijues, dhe zgjidhjen e problemeve;
- të motivojnë nxënësve, duke e konsideruar si partner, në kuptimin që në procesin mësimor mësuesi dhe nxënësi janë plotësues të njëri-tjetrit;
- të mbështesin të nxënësve të pavarur dhe në bashkëpunim të nxënësve përmes punës me projekte, punës në grup, punës individuale;
- të mbajnë parasysh integrimin dhe marrëdhënien ndërmjet lëndëve të fushës” Shoqëria dhe mjedisi”, zbatimet e tyre në jetën e përditshme, si dhe lidhjen ndërlëndore;
- të shfrytëzojnë burime të shumëllojshme informacioni dhe ta çmojnë tekstin si një burim të rëndësishëm, por të pamjaftueshëm për përmbushjen e kompetencave të fushës;
- të përdorin TIK-un si mbështetës dhe lehtësues të mësimdhënies dhe të nxënësve.

Rolet që ndërmarrin nxënësi dhe mësuesi në realizimin e kësaj qasje janë:

- ❖ *Nxënësi – veprues dhe i interesuar.* Në gjeografi, nxënësi studion dukuritë dhe proceset gjeografike. Ai nxitet të kërkojë përgjigje për pyetjet që ngre, duke hulumtuar në burime të ndryshme dhe, duke përdorur teknika specifike të gjeografisë. Nxënësi angazhohet të vendosë lidhje ndërmjet asaj që di dhe asaj që zbulon dhe mbi këtë bazë ndërton dijen e tij, bashkëvepron me shokët/shoqet dhe mësuesin, ndan me ta vëzhgimet dhe përvojat e tij. Ai punon individualisht, ose në grup dhe mbështetet nga mësuesi.
- ❖ *Nxënësi si partner.* Partneriteti i mësuesit me nxënësin në mësimdhënie rrit motivimin dhe e bën mësimdhënien më tërheqëse, duke krijuar kushte që ajo të jetë e suksesshme;
- ❖ *Mësuesi - udhëheqës dhe lehtësues.* Mësuesi i gjeografisë ndihmon nxënësit të zbulojnë kënaqësitë e të nxëniet. Roli i mësuesit konsiston në udhëheqjen e nxënësve; ai moderon nxënësit në eksplorimin e dukurive gjeografike. Mësuesi vepron si moderator midis dijes dhe nxënësit, duke e ndihmuar nxënësin të përfshihet në procesin e ndërtimit të dijes. Ai krijon kontekste të nxëni, të cilat i aftësojnë nxënësit të përftojnë mjetet e gjeografit. Zbatimi i programit kërkon që mësuesi të përdorë strategji mësimdhënieje duke respektuar stilet e të nxëniet të nxënësve. Ai i angazhon nxënësit në ndërtimin e mendimit, duke nxitur diskutimet dhe ballafaqimin e këndvështrimeve të ndryshme.

Mësimdhënia dhe të nxëniet në gjeografi duhet të mbështeten në situata të jetës reale. Të nxëniet fillon kur ata përpiqen të zgjidhin probleme dhe të eksplorojnë situata të jetës reale për të gjetur përgjigjet e pyetjeve që kanë, ose për të zgjidhur probleme. Të nxëniet me situata përfshin pjesëmarrjen e nxënësve në detyra që janë të ngjashme me zbatimet në botën reale. Kërkimi, analiza dhe përzgjedhja e të dhënave duhet të jenë gjithmonë pjesë e situatave të të nxëniet. Ato duhet të mbështeten në kërkimin gjeografik, i cili përfshin analizën krahasuese të dukurive gjeografike në shkallë të ndryshme. Këto lloj situatash kërkojnë zhvillimin e shprehive të të pyeturit, analizës, mendimit kritik dhe krijues.

Programi i gjeografisë u krijon nxënësve hapësirë dhe mundësi situatash të nxëni përmes punës dhe vëzhgimeve në terren, diskutimit të çështjeve aktuale në nivel lokal dhe global, të tilla si: ndryshimet klimatike, tërmetet, katastrofat natyrore, përmbytjet, rrëshqitjet e dherave, erozioni i lumenjve, i plazheve etj.; analizave të zhvillimeve demografike dhe ekonomike të vendit dhe rajoneve përbërës etj. Mësuesit duhet të marrin parasysh faktin se nxënësit janë të ndryshëm, kanë motivim, interesa, stile të nxëni, nevoja dhe aftësi të ndryshme etj. Fleksibiliteti i zhvillimit të programit lejon plotësimin e nevojave individuale të nxënësve me vështirësi në të nxënë dhe të nxënësve të talentuar.

12. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

Vlerësimi është pjesë integrale e procesit të mësimdhënies dhe të nxënit. Vlerësimi mat shkallën në të cilën janë arritur (nga nxënësit) njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e dëshiruara. Ai përfshin mbledhjen e informacioneve me anë të teknikave të ndryshme të vlerësimit për arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënit në nivel klase dhe shkalle. Me këtë informacion, mësuesi merr vendime për vlerësimin përfundimtar të nxënësit, bazuar në gjykimin e tij për nivelin e zotërimit nga nxënësi të kompetencave të fushës “Shoqëria dhe mjedisi”. Vlerësimi u shërben mësuesve për të përmirësuar metodat e mësimdhënies, nxënësve për të përmirësuar të nxënit si dhe prindërve për të monitoruar progresin e fëmijëve të tyre në shkollë.

Mësuesit duhet të përdorin situata të jetës reale si pikënisje për vlerësimin e nxënësve. Format e ndryshme të vlerësimit duhet t’u krijojnë mundësi të gjithë nxënësve të vlerësohen në atë mënyrë që është më e përshtatshme për to.

Për vlerësimin e nxënësve, mësuesit duhet të mbështeten në disa parime bazë:

- ❖ Vlerësimi duhet të jetë i ndershëm dhe i paanshëm. Nxënësit duhet t’i jepet mundësia të demonstrojnë shkallën e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve.
- ❖ Vlerësimi duhet t’i ndihmojë nxënësit. Ai duhet t’u japë informacion pozitiv dhe nxitës për t’u përfshirë aktivisht në procesin e të nxënit.

- ❖ Vlerësimi udhëhiqet nga rezultatet e të nxënit dhe shfrytëzon shumëllojshmëri strategjish dhe teknikash vlerësimi.

Disa ndër to mund të jenë:

- ❖ Vlerësimi përmes të pyeturit, diskutimi etj.
- ❖ Vlerësimi përmes punëve praktike.
- ❖ Vlerësimi përmes projekteve kurrikularë, lëndorë ose ndërlëndorë.
- ❖ Vlerësimi me shkrim (detyra të veçanta për grupe nxënësish, testim, detyra në grup ose individualisht).

13. MATERIALET DHE BURIMET MËSIMORE

Përdorimi i mjeteve mësimore në mësimdhënien dhe procesin e të nxënit në fushën “Shoqëria dhe mjedisi” ndihmon në konkretizimin e ideve dhe dukurive, në aplikimin e metodave dhe strategjive të mësimdhënies, si dhe e bën mësimin më interesant dhe më argëtues për nxënësin. Përdorimi i suksesshëm i metodave dhe i teknikave të lartpërmendura nuk mund të realizohet pa mjetet e nevojshme didaktike, të cilat mund të jenë të llojeve të ndryshme, si: harta të përgjithshme ose tematike, atlase, albume, foto, skica, filma mësimorë, videokaseta, kompjuter, aparat projektimi, CD, DVD etj.

Ndërsa mësuesi është përgjegjës për krijimin e një mjedisi stimulues. Ai duhet të sigurojë që nxënësi të ketë akses në burimet e ndryshme të të nxënit. Lista e burimeve të vlefshme për zhvillimin e kompetencave në gjeografi është e larmishme: muze, harta, plane, piktura, dokumente historike, dokumente audio-vizivë, etj. Gjithashtu burimet përfshijnë teknologjitë e informacionit dhe komunikimit që nxënësit i përdorin si mjete kërkimi dhe për përgatitjen e projekteve dhe detyrave të ndryshme.

Sugjerime për përdorimin e TIK-ut

- ❖ Përdorimi i postës elektronike për shkëmbim informacioni.
- ❖ Përdorimi i internetit për të shfrytëzuar faqet Ueb për gjeografinë.

- ❖ Përdorimi i CD-ROM për mbledhjen e informacionit mbi temat që nxënësi studion.
- ❖ Organizimi dhe prezantimi i të dhënave, duke përdorur tipa të ndryshëm software.
- ❖ Përdorimi i simulimeve software.
- ❖ Përdorimi i grafikëve software.
- ❖ Paraqitja grafike e të dhënave.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

PROGRAMET E KULTURËS SË PËRGJITHSHME
TË ARSIMIT TË MESËM PROFESIONAL

Lënda: TIK

Klasa XIII

Struktura 2+1+1, Struktura 2+2 dhe Bllok 4-vjeçar

TIRANË, 2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

**PROGRAMET E KULTURËS SË PËRGJITHSHME
TË ARSIMIT TË MESËM PROFESIONAL**

Lënda: TIK

Klasa XIII

Struktura 2+1+1, Struktura 2+2 dhe Bllok 4-vjeçar

2024

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

1.	Qëllimet e arsimit parauniversitar	8
2.	Qëllimet e lëndës së TIK-ut në arsimin parauniversitar.....	8
3.	Lidhja e kompetencave kyç me kompetencat e lëndës	10
4.	Rezultatet kryesore të të nxënit sipas kompetencave kyç që realizohen nëpërmjet lëndës së TIK-ut.....	11
5.	Lidhja e TIK-ut me fushat e tjera kurrikulare	13
6.	Kompetencat e lëndës dhe përshkrimi i tyre	17
7.	Koha mësimore	21
8.	Përmbajta e tematikave të programit mësimor të TIK-ut për klasën e dhjetë.....	22
	8.1 Tematika: Bota e kompjuterit	22
	8.2 Tematika: Përpunimi digjital i të dhënave	24
	8.3 Tematika: Programimi në Web	26
	8.4 Tematika: Programimi dhe Algoritmika	28
	8.5 Tematika: JAVA	30
9.	Udhëzime metodologjike	32
10.	Udhëzime për vlerësimin	33
11.	Materialet dhe burimet e mësimdhënies	37

Koordinoi programin:

Eriksen Mersinllari

I. HYRJE

Në kohët e sotme, teknologjia dhe TIK-u janë kthyer në një mënyrë jetese ndaj së cilës nxënësit shfaqin interes. Arsimi teknologjik është një komponent thelbësor i kurrikulës ku nxënësit zhvillojnë aftësitë digjitale për të përdorur TIK-un në mënyrë efektive dhe të përshtatshme për të pasur akses, për të krijuar dhe komunikuar informacion dhe ide, për të zgjidhur probleme dhe për të punuar së bashku në të gjitha fushat e edukimit në shkollë dhe në jetën përtej shkollës. Aftësia e TIK-ut i përfshin nxënësit në procesin e të mësuarit për teknologjinë digjitale, duke e bërë të vlefshme për ta, për t'ju përshtatur si teknologjive që evoluojnë ashtu dhe tu jap njohuri mbi kufizimin e rrezeve për veten në një mjedis digjital. Në një mjedis digjital ku ka ndryshime të shpejta dhe të vazhdueshme në mënyrën se si njerëzit ndajnë, përdorin, zhvillojnë dhe komunikojnë me TIK-un, të rinjtë duhet të jenë shumë të aftë në përdorimin e tij. Për të marrë pjesë në një ekonomi të bazuar në dije dhe për të qenë të fuqishëm në një shoqëri teknologjike të sofistikuar për të sotmen dhe në të ardhmen, nxënësve u nevojiten njohuri, aftësi dhe besim në TIK për të realizuar detyrat në shkollë, shtëpi, punë dhe në komunitetet e tyre. Si qytetarë, ata duhet të jenë të aftë të bëjnë gjykime vetjake mbi çështjet që lidhen me ndikimin e teknologjisë në jetët e tyre, në shoqëri dhe në mjedis.

Nxënësit e moshës digjitale vijnë në shkollë me njohuri, gjykime, opinione dhe pyetje të marra nga burime të pafundme digjitale të informacionit të cilat mësuesi duhet t'i konsiderojë si pjesë të kurrikulës në tërësinë e saj.

“TIK-u dhe Teknologjia” janë një formë e veçantë e veprimtarisë krijuese, ku njerëzit ndërveprojnë me mjediset e tyre duke përdorur materialet, inputet dhe proceset e duhura në përgjigje të nevojave, dëshirave dhe mundësive të tyre. Ato integrojnë shprehitë për zgjidhjen e problemeve dhe shprehitë praktike në prodhimin e produkteve dhe të sistemeve të dobishme të pranishme në shumë fusha të të nxënësve, por veçanërisht në fushën e shkencave natyrore.

Teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit janë të shpejta dhe të automatizuara, interaktive dhe multimediale, mbështesin komunikimin e shpejtë dhe përfaqësimin e dijes në shumë audiencë dhe përshtatjen e saj në kontekste të ndryshme. Ato transformojnë mënyrat e të mësuarit dhe të mësuarit të nxënësve, duke i bërë ata më të aftë dhe të përgjegjshëm se si , ku dhe kur ata mësojnë.

II. KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT

Hartimi i programit lëndor rrjedh nga: Korniza Kurrikulare e arsimit të mesëm të lartë, plani mësimor për kurrikulën bërthamë në arsimin e mesëm të lartë si dhe standardet e fushës kurrikulare ku kjo lëndë bën pjesë. Për të siguruar përdorimin sa më të mirë të programit është e vlefshme njohja me dokumentet e lartpërmendura. Te korniza kurrikulare vëmendje e veçantë i duhet kushtuar:

- synimeve të përgjithshme të kurrikulës së arsimit parauniversitar;
- synimeve të temave ndërkurrikulare;
- vlerësimit të nxënësit me notë;
- parimeve të mësimdhënies/mësimnxënies.

Në mënyrë që tërësia e dokumenteve zyrtare (korniza kurrikulare, standardet e fushës së të nxënësve dhe programi lëndor) të zbatohet më së miri në dobi të nxënësve, përdoruesit e kësaj tërësie duhet të njohin thellë programet lëndore të lëndës së TIK-ut për klasat paraardhëse dhe klasat pasardhëse. Gjithashtu, përdoruesve të këtij programi u lind nevoja të njohin standardet e të gjitha fushave të tjera të të nxënësve dhe të gjitha programet e lëndëve të të njëjtit vit. Zbatimi i këtij programi kërkon që kurrikula e TIK-ut të vendosë theksin në rrugën dhe procedurat e veprimit shkencor me objektet mësimore, që metodat verbale të përdorura gjerësisht sot, të zëvendësohen me përdorimin e metodave shkencore. Ajo duhet t'i nxisë nxënësit të jenë aktivë dhe të marrin përgjegjësi për të mësuarit e tyre; të përdorë strategji dhe teknika mësimore që nxitin ndërveprimin, pjesëmarrjen mësimore dhe mbështesin kërkimin me TIK të nxënësve. Zbatimi i programit duhet të bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore, fetare.


Si i tillë ky dokument i shërben:

- **nxënësve** për zhvillimin e kompetencave kyçe dhe kompetencave lëndore të TIK-ut, në mënyrë që ata të përballojnë sfidat e jetës dhe të integrohen në shoqëri;
- **mësuesve** për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe arritjet e nxënësve në klasë dhe jashtë saj;
- **prindërve** për njohjen e rezultateve të pritshme të fëmijëve dhe kriteret e vlerësimit në periudha të caktuara kohore;
- **hartuesve** të teksteve mësimore dhe të materialeve ndihmëse për mësuesit dhe nxënësit.

Programi i TIK-ut ka në thelb të tij krijimin e kushteve për ndërtimin e kompetencave të fushës/lëndës si dhe të kompetencave kyçe që lidhen me to. Realizimi i temave ndërkurrikulare nëpërmjet TIK-ut është një komponent i rëndësishëm i programit për kontributin e tij në shoqëri dhe në jetën e përditshme. Në program, gjithashtu, përshkruhet lidhja e TIK-ut me fushat e tjera, në mënyrë që kurrikula e përgjithshme e arsimit profesional të shihet si një e tërë për realizimin e qëllimit kryesor të formimit të nxënësve.

Programi përmban **5 tematika**, të cilat krijojnë kushte që nxënësi të ndërtojë dhe zbatojë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, në funksion të kompetencave të lëndës dhe kompetencave kyçe. Në program paraqitet edhe koha mësimore për secilën tematikë, që ndryshon nga klasa në klasë. Përdorimi i metodologjive efikase në mësimdhënie është kusht për zbatimin e programit, për arritjen e kompetencave nga ana e nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin që zotëron brenda vetes. Në këtë program, vlerësimi i nxënësve është komponent thelbësor për përmirësimin e arritjeve të nxënësve dhe procesit të të nxënit.

Diagrami 1: Korniza konceptuale e programit



1. Qëllimet e arsimit parauniversitar

Arsimi parauniversitar krijon kushte dhe mundësi që nxënësit: të ndërtojnë dhe të zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria demokratike; të zhvillohen në mënyrë të pavarur e të gjithanshme; të kontribuojnë në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake dhe të shoqërisë shqiptare dhe të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës. Në arsimin parauniversitar nxënësit:

- kultivojnë identitetin vetjak, kombëtar dhe përkatësinë kulturore;
- përvetësojnë vlera të përgjithshme kulturore dhe qytetare;
- zhvillohen në aspektet intelektuale, etike, fizike, sociale dhe estetike;
- zhvillojnë përgjegjësi ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit;
- aftësohen për jetë dhe për punë, në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;
- aftësohen për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- zhvillojnë shpirtin e sipërmarrjes;
- përdorin teknologjitë e reja.

2. Qëllimet e lëndës së TIK-ut në arsimin parauniversitar

Natyra dhe fusha e aftësive të TIK-ut nuk është fikse, por është në funksion të zhvillimeve më të reja teknologjike. Kjo është e qartë me shfaqjen e teknologjisë së përparuar të internetit gjatë viteve të fundit dhe ndryshimet që rezultojnë në mënyrat që nxënësit të ndërtojnë njohuritë dhe ndërveprojnë me të tjerët. Nxënësit zhvillojnë aftësi në përdorimin e TIK-ut për punët që lidhen me aksesin e informacionit dhe menaxhimin, krijimin e informacionit dhe prezantimin, zgjidhjen e problemeve, marrjen e vendimeve, komunikimin, të shprehurit krijues dhe arsyetimin empirik. Kjo përfshin kryerjen e hulumtimit duke krijuar produkte multimediale të informacionit, analizimin e të dhënave, hartimin e zgjidhjes së problemeve, kontrollin e proceseve dhe të pajisjeve duke punuar në mënyrë të pavarur dhe në bashkëpunim me të tjerët. Nxënësit zhvillojnë

njohuritë, shkathtësitë dhe dispozitat rreth TIK-ut dhe përdorimit të tij dhe aftësinë për t'i transferuar të gjitha këto mjedise dhe aplikime. Ata mësojnë të përdorin TIK-un me kujdes, duke kuptuar mundësitë e tij, kufizimet dhe ndikimin tek individët, grupet dhe komunitetet.

Qëllimi i programit të fushës së TIK-ut:

Programi i TIK-ut ka për qëllim të zhvillojë njohuritë, të kuptuarit dhe aftësitë për të siguruar nxënësit që, individualisht dhe në bashkëpunim:

- të hetojnë, projektojnë, planifikojnë, menaxhojnë, krijojnë dhe vlerësojnë zgjidhjet;
- të jenë krijues, inovative dhe me iniciativë kur përdorin tradicionalen, bashkëkohoren dhe teknologjitë e reja dhe të kuptojnë se si janë zhvilluar teknologjitë me kalimin e kohës;
- të marrin vendime të informuara dhe etike në lidhje me rolin, ndikimin dhe përdorimin e teknologjive në ekonomi, mjedis dhe shoqëri për një të ardhme të qëndrueshme;
- të angazhohen me besim dhe përgjegjësi që të zgjidhin dhe të manipulojnë me teknologjitë e përshtatshme - materialet, të dhënat, sistemet, komponentët, mjetet dhe pajisjet - kur projektojnë dhe krijojnë zgjidhje;
- të kritikojnë, analizojnë dhe vlerësojnë problemet, nevojat apo mundësitë për të identifikuar dhe për të krijuar zgjidhje.

Kompetencat e fushës

Vazhdimësia e aftësisë TIK të të mësuarit është e organizuar në pesë kompetenca lëndore të ndërlidhura:

- *Hetimi me TIK.*
- *Krijimi me TIK.*
- *Komunikimi me TIK.*
- *Menaxhimi dhe operimi me TIK.*
- *Zbatimi i protokolleve dhe praktikave sociale dhe etike kur përdorin TIK-un.*

3. Lidhja e kompetencave kyç me kompetencat e lëndës

Ndërtimi dhe zbatimi i kompetencave kyçe nga nxënësit gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies, kërkon që mësuesi të mbajë parasysh lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës për secilën shkallë. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë situatat, veprimtaritë, metodat, dhe mjetet e përshtatshme të procesit të të nxënies. ***Kompetenca përcaktohet si integrim i njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve që një nxënës duhet t'i fitojë gjatë procesit të nxënies.*** Kompetenca demonstron nga nxënësi (njohuri), bazohet në performancën e tij (aftësi), si dhe bazohet në perspektivën e sjelljes (qëndrim). Organizimi i mësimit të TIK-ut me bazë kompetencat përqendrohet në atë që nxënësi duhet të dijë, të bëjë saktë dhe të shpjegojë pse e bën. Kur nxënësi realizon kompetencën digjitale, ai njëkohësisht është duke zhvilluar edhe kompetencat kyçe. P.sh. “Zgjidhja problemore” përfshin shumë nga strategjitë e zgjidhjes së situatave të ndryshme problemore në shoqëri dhe në jetën e përditshme duke përdorur teknologjinë.

Për të realizuar lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës së TIK-ut mësuesi ndjek këto hapa:

- përzgjedh rezultatin/et e të nxënies për kompetencat kyçe që synon të arrijë nxënësi;
- zbërthen në rezultate të nxënies për kompetencat kyçe për secilin vit mësimor rezultatin/et e të nxënies për shkallë, për kompetencat kyçe;
- përzgjedh rezultatin/et e të nxënies për shkallë për kompetencat e lëndës së TIK-ut që synon të arrijë nxënësi;
- zbërthen në rezultate të nxënies për kompetencat e lëndës së TIK-ut për vit mësimor;
- përzgjedh përmbajtjen/et mësimore, mjetet digjitale, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënies të kompetencave digjitale në një vit mësimor, si dhe rezultatet e të nxënies për kompetencat kyçe në një vit mësimor;
- planifikon mësimdhënien duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do t'i arrijë rezultatet e të nxënies brenda vitit shkollor;
- kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave, projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënies për vit mësimor.

4. Rezultatet kryesore të të nxënës sipas kompetencave kyç që realizohen nëpërmjet lëndës së TIK-ut

Kompetenca digjitale - *Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin*

Nxënësi:

- përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive;
- përdor mjetet digjitale për të përpunuar, krijuar, realizuar dhe demonstruar tema mësimore nëpërmjet pjesëve të filmuara apo të animuara;
- gjen, organizon, analizon, përpunon dhe përdor informacionin nga një shumëllojshmëri burimesh dhe mediash;
- merr njohuritë bazë për sistemet e duhura kompjuterike (hardware, software, networks dhe softet e ndryshme);
- zhvillon aftësitë krijuese, duke zbatuar njohuritë e marra në shkencën kompjuterike dhe mediat digjitale;
- diskuton për avantazhet dhe disavantazhet e përdorimit të teknologjive në jetën e individit, shoqërisë apo komunitetit.

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - *Nxënësi komunikon në mënyrë efektive*

Nxënësi:

- përdor TIK-un në mënyrë efektive gjatë komunikimit dhe ndërveprimit me të tjerët në jetën e përditshme, duke përfshirë edhe të nxënës të informacioneve të reja dhe kryerjen e detyrave shkollore;
- prezanton një projekt (artistik, humanitar, eksperimentues etj.) nga fusha të ndryshme mësimore për një temë të caktuar, duke përdorur në mënyrë efektive teknologjinë informative dhe teknologji të tjera.

Kompetenca e të menduarit - *Nxënësi mendon në mënyrë krijuese*

Nxënësi:

- krahason të paktën tri burime të ndryshme informacioni për trajtimin e një teme, argumenton saktësinë, rrethanat, gjen ngjashmëritë dhe dallimet duke u bazuar në kriteret e përcaktuara më parë, i prezanton gjetjet kryesore para të tjerëve në forma të ndryshme shprehëse, duke përdorur teknologjinë e informacionit;

- prezanton me sukses rezultatet e punës së një detyre eksperimentale për një temë të caktuar nga ndonjë fushë mësimore (p.sh., nga shkencat, nga teknologjia etj.) të realizuar në laborator ose në ambientet e shkollës apo diku tjetër, përmes përdorimit të teknologjisë së informacionit, jep argumente që lidhin rezultatet e punës eksperimentale me udhëzimet teorike;
- skicon me një grup të nxënësish, një faqe të internetit për përdorim interaktiv nga ana e nxënësve lidhur me tema nga fusha të ndryshme mësimore, e mirëmban atë sipas rregullit dhe paraqet një model të nxitjes së moshatarëve që t’i përdorin informacionet në mënyrë të përgjegjshme.

Kompetenca e të nxënit - *Nxënësi mëson për të nxënë*

Nxënësi:

- shfrytëzon, në mënyrë të pavarur dhe efektive, teknologjinë e informacionit dhe burimet e tjera të informimit për të mbledhur materiale për zgjidhjen e një problemi apo detyre të caktuar, të cilat më pas i analizon, i klasifikon dhe i paraqet para të tjerëve përmes TIK-ut dhe ndonjë forme tjetër të shprehjes;
- paraqet idetë personale para të tjerëve për mënyrën e zhvillimit të një aktiviteti të caktuar, duke dhënë mendime të argumentuara për rezultatet e pritura (në formë skice, grafiku, vizatimi, shkrimi, vepre artistike etj.).
- shfrytëzon, në mënyrë të pavarur, udhëzimet e dhëna në ndonjë burim informacioni për të kryer një veprim, aktivitet, detyrë ose për të zgjidhur një problem që kërkohet prej tij, vlerëson vetë performancën dhe rezultatin e arritur.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin - *Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive*

Nxënësi:

- përgatit, prezanton, drejton dhe merr pjesë në një fushatë informimi për qytetarët në lidhje me një fushë apo temë të caktuar, duke u mbështetur në ide të reja, bazuar në rezultate të pritshme të përcaktuara qartë (p.sh., fushatë informimi për mbrojtjen e mjedisit, për sigurinë, për shëndetin etj.);

Kompetenca personale - *Nxënësi bën jetë të shëndetshme*

Nxënësi:

- ndërmerr aktivitete për shmangien e paragjykimeve, stereotipave në shkollë dhe në shoqëri dhe për promovimin e vlerave të qëndrueshme shoqërore, duke ilustruar ato me shembuj pozitivë nga ngjarje e individë të njohur;
- gjykon mënyrën e komunikimit, të sjelljeve dhe të qëndrimeve që nxisin konflikte ndërpersonale në klasë, në shkollë apo në shoqëri, duke vënë theksin në faktorët që kanë ndikuar në shfaqjen e saj dhe jep shembuj të menaxhimit dhe të zgjidhjes së konflikteve ndërpersonale në mënyrë konstruktive.

Kompetenca qytetare - Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët**Nxënësi:**

- përshkruan, me gojë ose me shkrim, mundësinë e përdorimit të internetit dhe të informacioneve në mënyrë të përgjegjshme për tema të caktuara, si dhe argumenton domosdoshmërinë e përdorimit të drejtë;
- demonstroi veprime të ndryshme që shprehin tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve në komunitetin ku jeton (në klasë, në shkollë, në lagje dhe me gjerë) dhe i shpjegon ato në një debat me të tjerët.

5. Lidhja e TIK-ut me fushat e tjera kurrikulare

TIK-u luan një rol të rëndësishëm në të gjitha fushat e tjera. Ai u shërben të gjitha fushave, duke pasuruar situatat e mësimin në të cilat nxënësi zhvillon kompetencat e tij. Përdorimi i teknologjisë ndihmon në përvetësimin më mirë të lëndëve të tjera nga nxënësi duke i bërë ato më të kuptueshme dhe më tërheqëse. Përdorimi i TIK-ut duhet të shihet si një mjet që i ndihmon nxënësit të përqendrohen më gjatë në klasë, pasi informacioni mund të transmetohet në forma të ndryshme: audio-vizive (eksperimentet virtuale, filmat dokumentarë, prezantime PowerPoint, postera, leximi online, shkrimi në Word, ndarja e informacioneve me shkollat e tjera nëpërmjet e-mail-it).

Gjuhët dhe Komunikimi: Në shkollë duhet të ketë një mbështetje të fortë për lidhjen e të mësuarit në lëndën e TIK-ut me të mësuarit e gjuhës dhe komunikimit. Të mësuarit në lëndën e TIK-ut i jep një përparësi të madhe komunikimit të saktë dhe të qartë. Lënda e TIK-ut ka si rrjedhim

përforcimin e të mësuarit të gjuhës dhe komunikimit. Nxënësit duhet të përshkruajnë objektet dhe ngjarjet; të interpretojnë përshkrimet; të lexojnë dhe të japin instruksione; të gjenerojnë dhe eksplorojnë ide me të tjerët; të shkruajnë përshkrime të shkurtra dhe specifitime, tekste reklamash, raporte vlerësimi dhe ndryshimi dhe të marrin pjesë në grupe diskutimi. Në gjuhët dhe komunikimi nxënësi bën korigjimin në mënyrë automatike të gabimeve ortografike, vendosjen e duhur të sintaksës. Gjatë dërgimit të e-mail-eve shikohet nëse është zgjedhur adresa e saktë dhe nëse është përdorur gjuha e duhur ndaj dërguesit. Gjuhët e huaja mund të përdoren edhe si aftësi ndërkurrikulare. Nxënësve u kërkohet të gjenden informacione nga interneti dhe, më pas, ata mund të hartojnë rregullat e klasës, mund të shkruajnë një bibliografi të vogël për veten, mund të jenë në gjendje të krijojnë një faqe ku të vendosin punime në gjuhë të huaj, si dhe mund të organizojnë postera për tema të ndryshme që prekin jetën e përditshme. Nëpërmjet CD-ROM dhe DVD ata zhvillojnë më shumë fjalorin duke e pasuruar atë dita-ditës. Ana vizuale i ndihmon nxënësit të memorizojnë më shpejt dhe më lehtë shumë fjalë.

Matematika: Kurrikula e lëndës së TIK-ut jep kontekstin brenda të cilit mund të aplikohet dhe të zhvillohet të kuptuarit matematikor, rrjedhshmëria, arsyetimi logjik, mendimi analitik dhe aftësia problem-zgjidhëse.

Nxënësit përdorin TIK-un në lëndën e matematikës për të zhvilluar aftësitë në zgjidhjet problemore, komunikimin dhe arsyetimin. Ata identifikojnë kërkesat e informacionit dhe aksesojnë informacionin; organizojnë, manipulojnë dhe transformojnë të dhëna dhe zhvillojnë interpretimet personale. Ata aplikojnë aftësitë dhe konceptet matematikore dhe numerike dhe përdorin TIK-un për të prodhuar dhe vërtetuar hipoteza për saktësinë dhe paragjykimin. Ata mësojnë për të komunikuar teoritë matematikore, gjetjet dhe kuptimin.

Në matematikë, nxënësit mësojnë metodat statistikore të cilat mund të aplikohen te analizat sasiore të të dhënave në lëndën e TIK-ut. Nxënësit zhvillojnë përdorimin e sistemit metrik në të dyja lëndët; të matematikës dhe TIK-ut. Aftësia për të konvertuar midis njësive metrike te gjatësisë dhe masës dhe shënimit dhjetor në matematikë do t'i mundësojë ata që të paraqesin dhe krahasojnë të dhënat në mënyra të kuptueshme në lëndën e TIK-ut. Nxënësit përdorin kuptimin hapësinor të zhvilluar në matematikë për të aplikuar njohuritë e gjeometrisë, formave dhe këndeve në TIK. Kur konsiderohet një sistem në një gamë të gjerë shkallësh në lëndën e TIK-ut, nxënësit përdorin njohuritë e tyre të kohës dhe intervaleve në matematikë. Lënda e TIK-ut jep mjetet për përpunimet automatike të matematikës të cilat përforcojnë konceptet në matematikë. Aftësia e nxënësve në matematikë për të zgjidhur problemet që përmbajnë ekuacione lineare mund të përdoret në TIK kur studiohen marrëdhëniet sasiore dhe

algoritmat e vizatimit. Në studimin e matematikës nxënësi përdor programin excel për të hedhur të dhëna matematikore. Ata mund ta realizojnë nëpërmjet vizatimit të grafikëve, të cilët mund të shërbejnë më pas edhe për të realizuar analizën e të dhënave. Krijojnë një database ku hedhim të dhënat për nxënësit: emër, mbiemër, ditëlindja, vendlindja etj. Kjo database mund të përdoret më pas për përlogaritje formulash kur nxënësit të kenë përvetësuar excel-in.

Shkencat e natyrës: Lënda e TIK-ut plotëson kurrikulën e shkencave të natyrës. Shkencat zhvillojnë ide që kanë të bëjnë me modele, të rregullit dhe organizimit, të stabilitetit dhe ndryshimit, të shkallës dhe matjes, të materies dhe energjisë dhe të sistemeve si aspekte kyçe të pikëpamjes shkencore për botën. Nxënësit mbështeten mbi këto ide kur krijojnë zgjidhje dhe vlerësojnë rolin e teknologjisë në shoqëri.

TIK-u mbështetet te konceptet e biologjisë, kimisë, fizikës për të zgjidhur problemet dhe skicon zgjidhje për të përmbushur nevojat dhe mundësitë njerëzore. Lidhjet me kurrikulën e shkencave të natyrës lejojnë zbatimet e koncepteve shkencore përmes kritikës dhe zbatimit të njohurive parësore për të projektuar zgjidhje të botës reale që janë të kuptueshme për nxënësit. P.sh., nxënësit zbatojnë njohuritë mbi forcat dhe karakteristikat e vetive të materialeve. Ata kryejnë studime të përshtatshme shkencore të materialeve, proceseve dhe prototipeve.

TIK-u jep shume teknika dhe teknologji për të automatizuar mbledhjen, magazinimin dhe analizën e të dhënave shkencore. Zhvillimi i teknologjive dixhitale si data loggers, spreadsheets, databases, teknologjitë e simulimit dhe të imagjinatës kanë qenë boshti për përparimin në shkenca. Ata janë përdorur për të mbledhur dhe organizuar një gamë të gjerë të dhënash dhe për të tërhequr informacion duke filtruar, analizuar dhe vizualizuar volume të mëdha të dhënash numerike, kategorie dhe strukturore. TIK-u u jep nxënësve aftësitë për të përfaqësuar të dhënat në mënyrat që mundësojnë analizat përlogaritëse. Shkencëtarët përdorin teknologjitë digjitale për të zhvilluar software për të simuluar, modeluar, dhe analizuar sisteme biologjike, kimike dhe fizike. Teknologjitë digjitale u japin nxënësve aftësitë për implementuar dhe fituar një botëkuptim më të thellë të koncepteve dhe modeleve në lëndët shkencore duke ndërvepruar me simulimet.

Shoqëria dhe mjedisi: Në fushën e shoqërisë dhe mjedisit nxënësi përdor TIK-un për të investiguar çështje dhe për të zhvilluar njohuritë e tyre për shëndetin fizik, mendor, emocional, social dhe shpirtëror. TIK-u është përdorur si mjet reflektimi dhe komunikimi për të marrë pjesë në komunitetet bashkëpunuese të të mësuarit lokale dhe globale dhe për të paraqitur dhe vlerësuar informacionin tek të tjerët.

Gjithashtu aftësitë e TIK-ut mund të zbatohen duke përdorur një gamë kontekstesh nga kurrikula e lëndës së gjeografisë. Që në vitet e para nxënësit zgjedhin informacion, gjejnë modele dhe veprojnë me sisteme digjitale krahas zhvillimit të kuptimit hapësinor, veçanërisht kur krijojnë, interpretojnë dhe përdorin hartat. Ata kuptojnë shkallën dhe distancën dhe regjistrojnë të dhënat në lidhje me motin. Ata krijojnë produkte dhe sisteme që matin dhe zhvillojnë më tej të kuptuarit e tyre të influencës së klimës dhe kushteve të motit.

Nxënësit përforcojnë aftësitë dhe kuptimin e tyre mbi teknologjitë digjitale kur studiojnë karakteristikat mjedisore të vendeve, proceseve dhe rëndësisë për njeriun. Gjatë kërkimeve ata mbledhin dhe konvertojnë të dhënat në forma të dobishme duke përdorur spreadsheets, grafikë dhe harta të shpërndarjes. Nxënësit konsolidojnë të kuptuarit e tyre mbi mbështetshmërinë gjatë kohës kur studiojnë rëndësinë e mjedisit biofizik për njeriun dhe kur projektojnë, kur dizajnojnë dhe menaxhojnë projektet që rrisin të kuptuarit e tyre të balancës delikate ndërmjet veprimit të njeriut dhe mjedisit. Përmes TIK-ut, konceptet dhe të mësuarit që adresohen në lëndën e gjeografisë vihen në kontekst përmes projektimit dhe prodhimit të produkteve, shërbimeve dhe mjediseve përmes projekteve specifike të targetuara që lidhin mjedisin me shoqërinë. Nxënësit kritikojnë, dizajnojnë dhe prodhojnë zgjidhje për mjedise të menaxhuara dhe të konstruara. Të mësuarit është një rritje e mëtejshme përmes aktiviteteve autentike që fokusohen mbi zgjidhjet sipërmarrëse dhe inovative drejt nevojave të pikasura.

Historia jep një shteg tjetër për të kuptuar se si zhvillohet TIK-u dhe se si zhvillimi i TIK-ut është burim i fakteve historike dhe artefakteve. Krijimi dhe zhvillimi i teknologjive digjitale ka ndikuar dhe ka influencuar në shoqëri dhe rritje të ardhmes.

Nxënësit përdorin TIK-un në histori që të kontrollojnë dhe vlerësojnë informacionin, zhvillojnë arsyet për vlerësimin e pozitive dhe besimeve, diskutojnë çështje dhe thellojnë interpretimet e tyre për çështjet dhe ngjarjet. Nëpërmjet informacionit dhe rrjeteve, nxënësit hetojnë, mendojnë në mënyrë kritike, bashkëpunojnë, marrin vendime dhe ndërmarrin veprime për çështje të rëndësishme. TIK-u i siguron nxënësve një gamë në rritje të informacionit që të zhvillojnë njohuritë e tyre drejt kronologjisë dhe kuptimit të ngjarjeve dhe çështjeve të veçanta.

Zhvillimi i teknologjive gjeo-hapësinore (p.sh. GIS) mundësojnë studim tepër sistematik për ngjarjet, tendencat dhe çështjet.

Artet: Kurrikula e TIK-ut plotëson kurrikulën e arteve, veçanërisht në aplikimin e elementeve dhe parimeve të projektimit të dizenjës në artet pamore dhe në përdorimin e TIK-ut në artet mediatike. Nxënësit përdorin multimedian në një gamë të fushave të të mësuarit në kurrikulën shkollore për të komunikuar prova të të mësuarit të tyre. Nxënësit përdorin TIK-un që të krijojnë, regjistrojnë dhe të rishikojnë produktet artistike, eventet

dhe shfaqjet. Ata shprehin idetë e tyre dhe komunikojnë me të tjerët. Nxënësit përdorin TIK-un në të gjitha format e arteve dhe gjithnjë e më shumë në format e reja artistike të tilla si multimedia. TIK-u mbështet interpretimin, vlerësimin, analizën dhe krijimin e veprave të artit dhe bën ekzaminimin të pozicionimit të artit në shoqëri.

Edukimi fizik, sporte dhe shëndet: Lënda e TIK-ut mban parasysh edhe atë çka nxënësit mësojnë në lëndën e edukimit fizik. Në fashën e lëvizjes dhe aktivitetit fizik të lëndës edukim fizik, nxënësit zhvillojnë dhe praktikojnë aftësi të vogla koordinuese të cilat i ndihmojnë që ata të zhvillojnë dhe të aplikojnë aftësi manipulative në teknologjinë digjitale. Ata përdorin TIK-un si mjet për të regjistruar praktika të tilla si lëvizja (ecja), ushqimi (dieta), sjelljet dhe për të analizuar, paraqitur dhe transformuar të dhënat e mbledhura dhe informacionin.

6. Kompetencat e lëndës dhe përshkrimi i tyre

Bazuar në këtë program mësimor, lënda e TIK-ut synon të përmbushë 5 kompetencat e lëndës, të cilat lidhen me kompetencat kyçe që një nxënës duhet të zotërojë gjatë jetës së tij dhe që arrihen nëpërmjet 5 tematikave kryesore.

Kompetenca: Hetimi me TIK <i>(Kompetenca e të menduarit dhe e të nxënës)</i>	
<i>Hetojnë dhe bëhen konsumatorë kritikë të informacionit</i>	
Nxënësit : <ul style="list-style-type: none"> ▪ hartojnë një website motor dhe përmirësojnë renditjet e motorëve të kërkimit; ▪ marrin në konsideratë burimet parësore dhe dytësore të kërkimit kur citojnë bibliografitë; ▪ vetëvlerësojnë burimet e veta të informacionit të tilla si website dhe blogje, duke kritikuar besueshmërinë dhe vlefshmërinë e tyre. 	Klasa 11
<i>Hetojnë duke përdorur strategjitë dhe mjetet e duhura</i>	

<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ reflektojnë mbi rezultatet e një loje interaktive edukative ; ▪ identifikojnë strategjitë për sukseset e ardhshme; ▪ krijojnë dhe punojnë me një komunitet online për hulumtim reciprok; ▪ aplikojnë njohuritë e fituara përmes zgjidhjes së problemit në një mjedis simulimi të një konteksti të jetës reale . 	Klasa 11
<p>Kompetenca: Krijimi me TIK (Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin)</p>	
<p><i>Krijojnë, redaktojnë dhe ndajnë informacion dhe ide</i></p>	
<p>Nxënësit :</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ krijojnë produkte media komplekse, bindëse dhe shumë të individualizuara; ▪ zgjedhin, integrojnë dhe vlerësojnë elemente dhe mjete të projektimit për potencialin e tyre për të arritur efektet e dëshiruara; ▪ demonstrojnë përvoja të specializuara digjitale redaktimi. 	Klasa 11
<p><i>Bazohen në konventat e njohura për të shprehur ide dhe informacion</i></p>	
<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ për zgjedhin dhe përdorin sisteme menaxhimi të dhënash të përshtatshme për kërkesa specifike; ▪ diskutojnë të ardhmen e projektimit të produkteve digjitale; ▪ shpjegojnë se si të sigurojnë të drejtat ligjore të pronësisë dhe se si të mbrojnë të drejtat e pronësisë intelektuale. 	Klasa 11
<p>Kompetenca: Komunikimi me TIK (Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit)</p>	
<p><i>Shprehin identitetin, komunikojnë në mënyrë të përshtatshme dhe ruajnë sigurinë dhe privatësinë</i></p>	

<p>Nxënësit :</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ identifikojnë mënyrat e TIK-ut që mund të përdoren për të promovuar të drejtat e njeriut; ▪ demonstrojnë mirëkuptim të legjislacionit të krimit kibernetik; ▪ krahasojnë dhe vlerësojnë se si rrjete të ndryshme online mbrojnë identitetin . 	Klasa 11
<i>Kontribuojnë dhe mësojnë nga të tjerët</i>	
<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ lehtësojnë punën në grupe me softuerë dhe bashkëpunojnë për të gjetur mjete për menaxhim projekti; ▪ krahasojnë dhe vlerësojnë teknologjitë e reja për ndikimin ndaj çështjeve që ata paraqesin. 	Klasa 11
<p>Kompetenca: Menaxhimi dhe operimi me TIK (Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin)</p>	
<i>Përdor procedurat e njohura për të mbajtur një mjedis TIK të sigurt, të mbrojtur dhe efikas</i>	
<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ demonstrojnë njohuri dhe kuptojnë të rejtat e fundit të sigurisë TIK; ▪ diagnostikojnë defektet kompjuterike, i riparojnë ato dhe përmirësojnë sistemet; ▪ sigurojnë të informohen më këshilla për shëndetin dhe për sigurinë TIK-ut në mjedise specifike. 	Klasa 11
<i>Kuptojnë se si sistemet dhe komponentët TIK janë përdorur për të ruajtur dhe rifituar informacionin</i>	
<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ demonstrojnë menaxhim efikas dhe efektiv të skedarëve; ▪ kuptojnë se si një kompjuter kryen logjikën digjitale (duke përdorur sistemin e numrave binarë); ▪ marrin pjesë në hartimin dhe ndërtimin e rrjetit. 	Klasa 11
<p>Kompetenca: Zbatimi i protokolleve dhe praktikave sociale dhe etike kur përdorin TIK (Kompetenca personale dhe kompetenca qytetare)</p>	

<i>Njohin pronësinë intelektuale dhe aplikojnë praktika të sigurisë së informacionit digjital</i>	
<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ në mënyrë të ndërgjegjshme aplikojnë praktika që mbrojnë pronësinë intelektuale; ▪ vlerësojnë rreziqet që lidhen me mjediset online dhe krijojnë strategji të përshtatshme të sigurisë dhe kodeve të sjelljes. 	Klasa 11
<i>Aplikojnë protokollet personale të sigurisë dhe identifikojnë ndikimin e TIK-ut në shoqëri</i>	
<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ përzgjedhin midis protokolleve të përshtatshme për mjete të ndryshme të komunikimit kur bashkëpunojnë me komunitetet lokale dhe globale; ▪ diskutojnë për rolin e TIK-ut në të ardhmen dhe se si ata mund të ndikojnë në përdorimin e tij. 	Klasa 11

7. Koha mësimore

Lënda e TIK-ut zhvillohet për 32 javë mësimore me nga 1 orë secila, pra gjithsej 32 orë për klasë e 13-të. Programi i lëndës së TIK-ut specifikon peshën (orët e sugjeruara) e secilës tematikë për secilën shkallë dhe klasë. Shuma e orëve sugjeruese për secilën tematikë është e barabartë me sasinë e orëve vjetore, të përcaktuara në planin mësimor të arsimit të mesëm të lartë. Kjo ka si qëllim që, përdoruesit e programit të orientohen për peshën që zë secila tematikë në orët totale vjetore.

<i>TIK</i>	Bota e kompjuterit	Përpunimi digjital i të dhënave	Programimi në Ueb	JAVA	Programimi dhe algoritmika	Orë gjithsej
Klasa 13	4 orë	7 orë	5 orë	7 orë	9 orë	32 orë

Në programin e lëndës së TIK-ut për klasën e trembëdhjetë janë paraqitur përmbajtjet e tematikave:

1. Bota e kompjuterit;
2. Përpunimi digjital i të dhënave ;
3. Programimi në Ueb;
4. JAVA;
5. Programimi dhe algoritmika.

Këto tematika janë bazë për të ndërtuar njohuri, shkathtësi, qëndrime e vlera. Tematikat janë bazë për të siguruar rezultatet e të nxënit sipas kompetencave lëndore. Për secilën klasë janë paraqitur tematikat dhe për çdo tematikë janë përcaktuar njohuritë. Koha për secilën tematikë lidhet së pari me rëndësinë e tematikës dhe së dyti me shkallën e vështirësisë së saj për t'u përvetësuar nga nxënësit. Sasia e orëve mësimore për secilën tematikë është rekomanduese. Mësuesit janë të lirë të ndryshojnë me 10% (më shumë ose më pak) orët e rekomanduara për secilën tematikë. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, si dhe ndarjen e orëve sipas tematikave.

Mësuesit dhe hartuesit e teksteve shkollore janë të lirë t'i organizojnë kapitujt dhe renditjen e tyre, por ajo që është e rëndësishme dhe duhet marrë në konsideratë është se tematikat zgjasin përgjatë gjithë vitit shkollor dhe si të tillë kapitujt e teksteve nuk mund të jenë të ndarë, por duhet të kenë ndërlidhje dhe vazhdimësi. Gjithashtu, mësuesit duhet të marrin në konsideratë që situatat janë në qendër të zhvillimit të orës mësimore dhe nëpërmjet situatave të synohet arritja e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve. Për këtë arsye do të ishte dhe në ndihmë të mësuesit nëse tekstet do të ishin të pasura me situata praktike të marra nga jeta e përditshme.

8. Përmbajta e tematikave të programit mësimor të TIK-ut për klasën e trembëdhjetë

8.1 Tematika: Bota e kompjuterit

Përshkrimi i tematikës

Nxënësit zhvillojnë aftësitë e tyre, kreativitetin dhe njohuritë në shkenca kompjuterike, mediat digjitale dhe të teknologjisë së informacionit. Në këtë tematikë nxënësit marrin njohuritë dhe aftësitë e ndërtimit, funksionimit dhe përdorimit të kompjuterit. Ata do të njihen me zhvillimin e sotëm shoqëror. Identifikimi dhe zgjidhja e problemeve ndërmjet komponentëve kompjuterike dhe bashkëveprimi ndërmjet tyre. Rregullat bazë të punës në kompjuter. Nxënësit zhvillojnë njohuri dhe aftësi, që kanë të bëjnë me konceptin e informacionit, klasifikimi dhe llojet e informacionit, matja e informacionit. Disa nga programet aplikative më të përdorshme dhe klasifikimi i tyre në paketa. Rregullat bazë të funksionimit të rrjetit, tipet dhe tipologjinë e rrjeteve.

Rezultatet e të nxënësve për kompetencat e lëndës

Zbatimi i protokolleve dhe praktikave sociale dhe etike kur përdorin TIK:

- *identifikon ndikimin e TIK-ut në shoqëri: vlerëson ndikimin e TIK-ut në vendin e punës dhe në shoqëri, dhe diskuton për rolin e tij në të ardhmen dhe se si ata mund të ndikojnë në përdorimin e tij.*

Menaxhimi dhe Operimi TIK:

<ul style="list-style-type: none"> - <i>zgjedh dhe përdor hardware dhe software</i>: argumenton zgjedhjen dhe optimizon funksionimin e një sërë pajisjesh të zgjedhura dhe funksioneve software për të përfunduar detyra të veçanta, për qëllime të ndryshme dhe në kontekste të ndryshme shoqërore; - <i>kupton sistemet TIK</i>: zbaton të kuptuarit e komponentëve TIK të sistemit të rrjetit për të bërë ndryshime në funksionet, proceset, procedurat dhe pajisjet për të përshtatur qëllimin e zgjidhjes; - <i>menaxhon të dhënat digjitale</i>: menaxhon dhe ruan të dhëna të sigurta në disa medime magazinimi dhe formate. 	
Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës	Aftësitë për realizimin e kompetencave të lëndës
<ul style="list-style-type: none"> ▪ njohin rregullat e mbrojtjes së rrjetit; ▪ zbatojnë mënyrat e sigurimit të rrjetit; ▪ vlerësojnë sigurinë kibernetike. 	<p><i>Nxënësit</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ demonstrojnë kuptim të rreziqeve të sigurisë në rrjet, strategjive mbrojtëse dhe parandaluese; ▪ zbatojnë progresionet e zgjidhjes problemore dhe riparimit për funksionimin efikas të mjeteve; ▪ identifikojnë shqetësimet e shëndetit dhe sigurisë në punë dhe zgjidhjet për mjediset TIK; ▪ ruajnë skedarë në një strukturë të qartë logjike duke demonstruar njohuri të konventave për madhësinë, tipin dhe emërimin e skedarit; ▪ kuptojnë fushën e TIK-ut mjaftueshëm për të qenë konsumatorë efektivë të produkteve dhe shërbimeve TIK; ▪ demonstrojnë kuptim të koncepteve bazë të rrjeteve (network).
<p>Qëndrimi dhe vlerat</p> <p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ ndërgjegjësohen nga viruset dhe spyware dhe pasojat e tyre; ▪ demonstrojnë sjellje korrekte dhe kërkojnë ndihmë kur është e domosdoshme; 	

- demonstrojnë këmbëngulje dhe elasticitet;
- janë të vetëdijshëm për parimet ergonomike;
- ndërjegjësohen se çfarë përbën një mjedis i shëndetshëm dhe i sigurt TIK-u;
- janë të vetëdijshëm se si pajisje hyrëse, dalje dhe magazinimi punojnë së bashku;
- marrin në konsideratë pajtueshmërinë e software-ve dhe hardware-ve.

Aktivite të sugjeruara

- Diskutime në grup për zgjedhjen e strategjisë se ku dhe sa herë do të bëhet magazinimi i të dhënave: në partitionin e ri, memorien e jashtme (usb, hard disk) ose në internet (cloud).
- Me ndihmën e mësuesit/es bëhet përzgjedhja e programit Free ose Open Source të përshtatshme për lehtësimin dhe automatizimin e backup-it.
- Diskutim mbi rolin dhe zhvillimin e kompjuterit në jetën e përditshme. Analizë e varësisë nga kompjuteri.
- Avantazhet dhe disavantazhet në fushat e komunikimit, teknologjisë, sociologjisë, shëndetit etj.

8.2 Tematika: Përpunimi digjital i të dhënave

Përshkrimi i tematikës

Nxënësit në këtë temë mësojnë të përdorin template të ndryshme për të krijuar dhe menaxhuar bazat e të dhënave në mjedisin e Microsoft Access. Ata njohin procedurat dhe teknikat për të krijuar, ruajtur dhe modifikuar tabelat në Access, si dhe për të krijuar formularë për të lehtësuar hyrjen dhe modifikimin e të dhënave. Nxënësit gjithashtu mësojnë të shkruajnë kërkesa (queries) për të nxjerrë dhe manipuluar të dhënat nga bazat e të dhënave. Ata zhvillojnë njohuri dhe aftësi të nevojshme për të punuar me mjedisin e bazës së të dhënave në Access në mënyrë efektive dhe efikase.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat e lëndës

<p>Krijimi me TIK:</p> <ul style="list-style-type: none"> - gjeneron ide, plane dhe procese: zgjedh dhe përdor TIK-un për të artikuluar idetë dhe konceptet dhe planifikon zhvillimin e zgjidhjeve komplekse; - gjeneron zgjidhje për sfidat dhe detyrat në fushën e mësimet: harton, modifikon dhe menaxhon zgjidhje komplekse digjitale ose rezultate krijuese multimodale ose transformime të dhënash për një gamë audiencash dhe qëllimesh. 	
<p>Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ përdorin në mënyrën e duhur template; ▪ njohin dhe vlerësojnë databazat; ▪ njohin objektet dhe databazat; ▪ krijojnë tabelat në ACCESS; ▪ ruajnë dhe modifikojnë tabelat në ACCESS; ▪ krijojnë formularë në ACCESS; ▪ dërgojnë kërkesat (QUERIES). 	<p>Aftësitë për realizimin e kompetencave të lëndës</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ krijojnë produkte digjitale që të informojnë, argëtojnë, ndikojnë apo të bindin; ▪ përcaktojnë karakteristikat e cilësisë së projektimit për një produkt TIK dhe ndjekin specifikimet për të krijuar një produkt; ▪ përdorin funksione redaktimi të avancuara për të përpunuar një produkt digjital për rezultatet e dëshiruara; ▪ mbledhin, analizojnë, paraqesin, organizojnë dhe administrojnë të dhëna me mjete digjitale; ▪ krijojnë produkte digjitale që ilustrojnë një përdorim të gjerë të rregullave të përshtatshme për llojin e tekstit; ▪ demonstrojnë njohuri të ligjeve për pronësisë intelektuale dhe të drejtën e autorit.
<p>Qëndrimi dhe vlerat</p> <p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ zotëron aftësi lidhur me përdorimin efektiv të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit; 	

- demontron, përmes studimit të lëndës TIK-ut aftësitë digjitale, të cilat ndihmojnë në rritjen personale si individ, si dhe në përgatitjen e tij në jetë, në tregun e punës dhe në shoqëri;
- mendon në mënyrë krijuese dhe inovative në lidhje me funksionimin e bazave të të dhënave;
- vlerëson dhe respekton këndvështrime dhe qasje të ndryshme për zgjidhjen e problemeve referuar çështjeve teknologjike;
- tregon integritet në aksesimin dhe përdorimin etik të informacionit;
- ndan me të tjerët përvojat dhe njohuritë e përfutuara nga vëzhgimet individuale.

Aktivitete të sugjeruara

- Mësuesi demontron procesin e krijimit të një baze të thjeshtë të të dhënave në Access duke përdorur tabelat, fushat dhe lidhjet e ndryshme relacionale.
- Nxënësit mund të organizojnë prezantime për të treguar procesin e tyre të punës në krijimin dhe menaxhimin e bazës së të dhënave në Access. Kjo gjithashtu mund të përfshijë shkëmbimin e përvojave dhe zgjidhjeve të ndryshme që ata kanë zbuluar gjatë procesit.
- Jepni ushtrime interaktive për nxënësit, duke i lejuar ata të eksperimentojnë vetë me krijimin e bazave të të dhënave, shtimin e të dhënave në to dhe ndërtimin e relacioneve midis tabelave.

8.3 Tematika: Programimi në Web

Përshkrimi i tematikës

Në këtë tematikë nxënësit marrin njohuri dhe aftësi që kanë të bëjnë me: konceptin e programimit në Ueb, funksionimin e detajuar të të gjithë elementëve të Ueb-it, rolin e HTML/CSS, JavaScript dhe të aplikacioneve në WEB.

Në këtë temë trajtohen ato njohuri të HTML/CSS që shërbejnë për krijimin e një faqe ueb funksionale. Prezantohet JavaScript si një gjuhë script dhe e interpretueshme që realizon komponentët dinamik të një faqe Ueb. Shpjegohet roli që ka gjuha PHP në rritjen e performancës së Ueb-it . Gjithashtu, shpjegohet koncepti i aplikacioneve në Ueb për të bërë dallimin me elementët e tjerë të tij.

<p>Rezultatet e të nxënit për kompetencat e lëndës</p> <ul style="list-style-type: none"> - menaxhojnë dhe organizojnë të dhëna duke përdorur mjete gjuhen e programimit; - mbajnë një koleksion të gjerë të produkteve digjitale që përputhen me konventat e prezantimit të TIK-ut, dhe i transformojnë ato sipas programeve të kërkuar. 	
<p>Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ përdorin strukturat e kontrollit dhe cikleve në JavaScript; ▪ njohin funksionet kryesore të JavaScript; ▪ mundësojnë integrimin e funksioneve të JS tek formularët HTML; ▪ dinë të përpunojnë të dhënat e formularëve me PHP. 	<p>Aftësitë për realizimin e kompetencave të lëndës</p> <p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ krijojnë faqe WEB në HTML duke përdorur Editor të thjeshtë si NotePad++; ▪ përzgjedhin individualisht platformat më të përshtatshme për ndërtimin e faqeve Ueb; ▪ ndërtojnë faqe Ueb dinamike duke përdorur JS; ▪ rrisin krijimtarinë dhe mundësinë e tyre për të ndërtuar faqe ueb më profesionale; ▪ bëjnë dallimin midis gjuhëve të programimit të orientuara për ueb dhe atyre për aplikacione; ▪ strukturojnë konceptin për WEB dhe skemën inxhinierike të ndërtimit të tij.
<p>Qëndrimi dhe vlerat</p> <p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ kanë një koncept shumë të strukturuar dhe inxhinierik për ndërtimin e ueb-it dhe funksionimin e tij; ▪ rrisin kreativitetin duke krijuar faqe ueb të larmishme në saj të njohurive të plota mbi elementët e ndërtimit të faqeve ueb; ▪ adaptohen lehtë ndaj platformave të ndryshme komerciale që ekzistojnë në treg për ndërtimin e faqeve ueb; 	

- përzgjedhin platformat që u përshtaten më mirë gjë që çon në nxitjen e vlerësimit kritik.

Aktivitete të sugjeruara

- Nxënësit kanë njohuri për ndërtimin e faqeve ueb. në një orë praktike nxënësit realizojnë një faqe ueb me të gjithë komponentët që ato kanë mësuar duku i përshtatur një tematike, si p.sh. gatimit, turizmit, apo edhe një sitë mbi aktivitetin e tyre si nxënës.
- Reflektim dhe diskutim për platformat më të mira për ndërtimin e faqeve ueb sipas eksperiencës së tyre.
- Diskutojnë për mundësitë e publikimit të faqes tyre ueb, opsionet më të lira, çfarë duhet bërë për të pasur një domain.
- Përdorin template të gatshme në internet për ndërtimin e faqeve ueb.
- Akumulojnë informacion mbi site-t më të përdorura për shkarkimin e template të gatshme, tutorialeve më të mira për HTML/CSS dhe forumeve më të përdorura për të postuar pyetje të ndryshme apo për të gjetur përgjigje.

8.4 Tematika: Programimi dhe Algoritmika

Përshkrimi i tematikës

Në këtë tematikë nxënësit zhvillojnë dhe aplikojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre që kanë të bëjnë me : Konceptet elementare të programimit, çfarë janë gjuhët e programimit, përse shërbejnë ato. Ne si përdorues apo si programues? Synohet që kjo tematikë ti aftësojë nxënësit të kuptojnë fazat e krijimit të një programi të thjeshtë, siç janë njohja dhe analiza e problemit, krijimi i algoritmit përkatës, hartimi i kodit të programit, ekzekutimi dhe testimi i tij. Nëpërmjet algoritmeve nxënësit zhvillojnë arsyetimin logjik pa u ngarkuar me probleme të vështira programimi. Ata fillimisht do njohin konceptin e bllokskemës dhe algoritmit, më pas do t'u ofrohet mundësia që të njihen me sintaksën bazë të një gjuhe programimi mjaft të përdorur siç është gjuha C++, duke u dhënë mundësi të krijojnë programet e tyre të thjeshta.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat e lëndës

- *Kreativiteti dhe inovacioni duke përdorur teknologjinë:* përdor kompjuterin për të zhvilluar të menduarit krijues dhe konstruktiv apo për të nxitur inovacionin dhe kreativitetin.

Kërkimi dhe gjetja e informacionit: përcakton strategjinë e kërkimit të informacionit; duke përdorur kompjuterin gjen, organizon, analizon, vlerëson, përpunon dhe përdor informacionin nga një shumëllojshmëri e burimeve dhe mediae; përzgjedh burimet e informacionit apo mjetet digjitale bazuar në përshtatshmërinë tyre për kryerjen dhe zgjidhjen e një sërë detyrave.

- *Mendimi kritik, zgjidhja e problemit dhe vendimmarrja:* vlerëson sistemet e informacionit dhe zgjidhjet e tyre në termat e mbledhjes së kërkesave, të rejave dhe qëndrueshmërisë.

Operacionet bazë dhe konceptet teknologjike: Shpjegon se si sistemet e informacionit dhe zgjidhjet e tyre përmbushin nevojat duke marrë parasysh qëndrueshmërinë.

Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës	Aftësitë për realizimin e kompetencave të lëndës
<ul style="list-style-type: none"> ▪ njihen me komponentët e Vizual Basic; ▪ krijojnë një projekt në Vizual Basic; ▪ janë në gjendje të krijojnë një program të thjeshtë; ▪ dinë të ekzekutojnë programin; ▪ janë në gjendje të fusin variablat në program; ▪ dinë të përdorin operatorët aritmetik krahasues dhe logjik; ▪ janë në gjendje të ndërtojnë funksione; ▪ njohin disa funksione të rëndësishme në Vizual Basic; ▪ njohin dhe zbatojnë ciklet në Vizual Basic; ▪ mundësojnë integrimin e databaseve nga programe në Vizual Basic. 	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ konceptojnë algoritmet dhe prezantimin e tyre në diagrame dhe vlerësojnë algoritmet dhe programet përmes gjurmimit dhe testimit të rasteve; ▪ kuptojnë disa algoritme kyçe që reflektojnë të menduarit kompjuterik për shembull, ato për klasifikim dhe kërkim; ▪ përdorin arsyetim logjik për të krahasuar dobinë e algoritmeve alternative për të njëjtin problem; ▪ zbatojnë konceptet e programimit modular, duke aplikuar funksionet dhe procedurat; ▪ përdorin të paktën një gjuhë programimi, për të zgjidhur një sërë problemesh që lidhen me lëndët e tjera; ▪ forcojnë arsyetimin logjik duke u mbështetur në logjikën Booleane.
<p>Qëndrimi dhe vlerat</p>	

Nxënësit:

- ka qëndrim aktiv drejt mbledhjes dhe organizimit të informacionit;
- vlerëson aspektet pozitive të teknologjive për korrigjimin e informacionit;
- është i motivuar të kërkojë informacion dhe ta paraqesë për aspekte të ndryshme të jetës së tij/asaj;
- është kurioz rreth sistemeve të informimit dhe funksioneve të tyre.

Aktivite të sugjeruara

- Analizojnë dhe përshkruajnë një gjuhë programimi që përdoret më shumë. Bëjnë një historik të shkurtër se për çfarë ajo është dizajnuar. Përshkruajnë kodin e burimit, algoritmet specifik dhe logjikën formale brenda saj. Diskutojnë për rëndësinë e njohjes së gjuhëve të programimit.

8.5 Tematika: JAVA

Përshkrimi i tematikës

Nxënësit marrin njohurit për të programuar nëpërmjet gjuhës JAVA, dhe mësojnë të krijojnë programe të thjeshta duke përdorur këtë gjuhë, ata zhvillojnë njohuri thelbësore rreth karakteristikave kryesore të kësaj gjuhe programimi, si sintaksa e saj e veçantë dhe paradigmat e programimit të orientuar nga objekti. Nxënësit eksplorojnë dhe testojnë mjete të ndryshme për të zhvilluar programe në Java, duke përfshirë mjete të integruara për zhvillues (IDEs). Gjithashtu, ata kuptojnë dhe aplikojnë tipet e ndryshme të programeve në Java, duke përfshirë aplikacione dhe applets.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat e lëndës

- Zhvillojnë programe të thjeshta duke përdorur sintaksën dhe konceptet e programimit objekt në Java.
- Zhvillojnë aftësi për të analizuar dhe zgjidhur probleme të ndryshme duke përdorur një përjasje sistematike dhe të strukturuar.
- Aplikojnë konceptet e programimit të orientuar nga objekti, duke përfshirë klasat, objektet, trashëgiminë, polimorfizmin, dhe inkapsulimin.

Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës

Aftësitë për realizimin e kompetencave të lëndës

<ul style="list-style-type: none"> ▪ krijojnë klasat në JAVA; ▪ njohin konstruktorët dhe destrukturorët në JAVA; ▪ dinë të krijojnë objekte dhe të thërrasin metodat e tyre në JAVA; ▪ njohin nocionet publike dhe private; ▪ krijojnë programe në JAVA. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ njohin dhe adaptohen ndaj platformave të ndryshme në treg për ndërtimin e programeve; ▪ testojnë programet, identifikojnë problemet dhe vetë-korrigjohen; ▪ kontribuojnë zgjidhjen e problemeve të hasura gjatë kompilimit dhe ekzekutimit të programeve; ▪ forcojnë aftësinë për të qenë preciz dhe për të pasur një logjik të pastër për zgjidhjen e problemeve. ▪ demonstrojnë ndërgjegjësimit për të rejtat e fundit teknologjike dhe pajisjet e reja.
<p>Qëndrimi dhe vlerat</p> <p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ rritja e shkallës së pavarësisë në punë; ▪ ndërgjegjësohen për dallimin midis gjuhëve të programimit në ueb dhe atyre të aplikacioneve; ▪ forcojnë arsyetimin logjik për zgjidhjen e problemeve; ▪ ndërgjegjësohen për ndihmën ndaj kolegëve. 	
<p>Aktivitete të sugjeruara</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Lejoni nxënësit të zgjedhin temat e tyre për të zhvilluar aplikacione të vogla në Java. Nxënësit mund të punojnë në projektet e tyre, duke përdorur njohuritë e tyre për të krijuar aplikacione të ndryshme dhe për të ndjekur një proces të strukturuar të zhvillimit të programit. ▪ Ofroni ushtrime të ndryshme për zgjidhjen e problemeve në Java për të lejuar nxënësit të praktikojnë njohuritë e tyre dhe për të zgjeruar aftësitë e tyre në programim. 	

9. Udhëzime metodologjike

Përdorimi i metodologjive efikase në procesin e të nxënësve është kusht në rritjen e cilësisë së arritjeve nga ana e nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin që zotëron brenda vetes. Mësimdhënia në lëndën e TIK-ut, synon gjithëpërfshirjen, motivimin, barazinë në të gjitha aspektet dhe bazohet në mësimdhënien dhe nxënien bazuar në kompetenca, në mësimdhënien me në qendër nxënësin dhe në mësimdhënien e nxënien e integruar.

Nxënësit e një klase janë të ndryshëm për sa i përket mënyrës se si ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve konkrete etj. Përpos kësaj, lënda e TIK-ut kërkon që nxënësit të zotërojnë kompetencat kyç, të përvetësojnë konceptet, të zotërojnë shprehjet. Të dyja këto kushte diktojnë nevojën për strategji të ndryshme të mësimdhënies, të cilat përshtaten me objektin e të nxënësve dhe nevojat e nxënësve.

Një mësimdhënie e mirëmenduar dhe e mirëplanifikuar krijon kushtet e nevojshme për një nxënie të suksesshme dhe lehtëson, si punën e mësuesit, ashtu edhe atë të nxënësit. Nxënësit janë aktivë, kur përfshihen në veprimtari, hulumtime, ndërtime ose simulime të njohurive, aftësive, krahasime të rezultateve apo nxjerrje konkluzionesh. Për të siguruar këtë pjesëmarrje aktive të nxënësve, mësuesi duhet të krijojë një atmosferë që i bën ata të ndihen të lirshëm dhe të zhdërvjellët për të zhvilluar njohuritë e tyre në këtë lëndë.

Projektet kurrikulare lejojnë nxënësin të zbatojë njohuritë dhe aftësitë që zotëron nga njëra anë, dhe nga ana tjetër nxënësi arrin të krijojë lidhje integruese me fushat/ lëndët e tjera. Edhe paraqitjet e projekteve, diskutimet, gjatë realizimit të tyre janë mundësi shumë e mirë për përvetësimin e njohurive dhe aftësive të marra në lëndën e TIK-ut por mbi të gjitha të kompetencave kyçe.

Ora e mësimi duhet të bazohet në një tematikë të përshtatur për moshën e nxënësit. Kompjuteri përdoret si mjet për të luajtur me programet, qoftë lojëra zbavitëse mësimore, qoftë programe për shkrim, prerje, prezantime, kërkim në internet ose komunikim. Në këtë mënyrë nxitet kreativiteti, zhvillohet motorika dhe nxitet të menduarit për zgjidhjen e problemeve. Suksesi i kësaj ore mësimore pasqyrohet sidomos në lirinë e fituar të nxënësit për t'i përdorur mjetet e TIK-ut. Nëpërmjet punës në grupe nxënësi vlerëson bashkëpunimin me shokët e shoqet e klasës, krijon lirshmërinë e vendimmarrjes dhe të përgjegjësisë ndaj komunitetit. Njohuritë e përfuara gjatë orës mësimore bëhen më konkrete dhe më të realizueshme nëse detyrat lidhen edhe me veprimtaritë në shkollë dhe me veprimtaritë që nxënësit mund të realizojnë jashtë shkollës. Puna në grup jep mundësi për

debat ose konsultim. Kështu zhvillohet përgjegjësia ndaj komunitetit ose komunikimi me të tjerë, duke fituar siguri vetjake, aftësi në përdorimin e saktë të mjeteve të TIK-ut me një synim të caktuar.

Për nxënësit do të ishin të përshtatshme edhe metodat gjysmë kërkimore për një problem të caktuar. Këto metoda i nxisin nxënësit të kërkojnë vetë në fillim zgjidhjen e problemit dhe më pas, të punojnë në grup për zgjidhjen e plotë të tij. Gjatë këtyre hapave mësuesi ka rolin e lehtësuesit dhe i ndihmon ata të shkojnë drejt zgjidhjes së duhur. Për zhvillimin sa më të mirë të kompetencës digjitale të nxënësit po dhe të kompetencave të tjera kyçe është rëndësishme që gjithë ora e mësimit të jetë e bazuar në situata konkrete të cilat e kërkojnë zgjidhjen e problemit nëpërmjet të mësuarit duke bërë gjithashtu përpunimin e njohurive nëpërmjet punëve praktike.

10. Udhëzime për vlerësimin

Në përputhje me parimet e qasjes së të nxënësive bazuar në kompetenca, vlerësimi konsiderohet si element i mësimdhënies i cili përqendrohet në nivelin e arritjes së kompetencave. Informacioni i siguruar nga vlerësimi i ndihmon mësuesit të kuptojnë anët e dobëta dhe anët e forta të nxënësve në përmbushjen e kompetencave, u jep mundësi të përmirësojnë mësimdhënien dhe të pajisin nxënësin me informacionin përkatës për progresin e tij. Vlerësimi i përmbajtjes lidhet me zotërimin e njohurive dhe demonstrimin e aftësive digjitale nëpërmjet treguesve të besueshëm për progresin e tyre. Në përzgjedhjen e praktikave të vlerësimit, në përcaktimin e kohës së përshtatshme dhe në përzgjedhjen e materialeve duhen pasur parasysh:

- përcaktimi i qëllimit dhe i strategjisë së vlerësimit;
- përzgjedhja e teknikave dhe e instrumenteve të vlerësimit;
- përzgjedhja e veprimtarive që mundësojnë demonstrimin e arritjes së kompetencave;
- përdorimi i vlerësimit për të verifikuar çfarë dinë aktualisht nxënësit;
- dallimi i qartë i qëllimit të detyrës së zgjedhur për vlerësim;
- adresimi i vlerësimit të njohuritë, shprehjet dhe aftësitë ;
- reflektimi i besimit që të gjithë nxënësit mund t'i përmirësojnë arritjet;
- informacioni për rezultatet e vlerësimit motivon nxënësin, të pranojë se gabimi është pjesë e të nxënësive dhe të ndihmojë progresin e mëtejshëm;

- vlerësimi duhet të konsiderohet si pjesë e procesit të mësimdhënie-nxënies dhe jo si veprimtari më vete;
- vlerësimi ndihmon nxënësin të marrë përgjegjësi për veten e tyre, duke përfshirë strategji të vetëvlerësimit dhe të vlerësimit të njëri - tjetrit;
- vlerësimi të jetë gjithëpërfshirës, në kuptimin që t'u sigurojë mundësinë të gjithë nxënësve të demonstrojnë arritjet e tyre.

Vlerësimi është pjesë integrale e procesit të të nxënit. Ai mat shkallën në të cilën kompetencat janë arritur nga nxënësi. Ai përfshin mbledhjen e informacioneve me anë të teknikave të ndryshme të vlerësimit për arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënit në nivel klase dhe shkalle të nxënësit. Me këtë informacion, mësuesi merr vendime për vlerësimin përfundimtar të nxënësve, bazuar në gjykimin e tij për nivelin e zotërimit të kompetencave të lëndës nga ana e nxënësit. Ndërsa vlerësimi u shërben shumë qëllimeve, është e rëndësishme që mësuesi t'ia përshtatë llojin e vlerësimit, qëllimit specifik të synuar. Para marrjes së një gjykimi në lidhje me një aspekt të caktuar të performancës së nxënësit, mësuesi duhet të sigurojë që mënyra e vlerësimit të përdorur të sigurojë informacionin që reflekton saktësisht një aspekt të veçantë të performancës që ka për qëllim të vlerësojë mësuesi. Përdorimi i TIK-ut gjithashtu ndihmon bërjen e vlerësimeve dhe raporteve më efektive për nxënësit dhe mësuesit. Gjatë procesit të vlerësimit në klasë mësuesit duhet të kenë në fokus vlerësimin e arritjeve të nxënësve dhe realizimit të kompetencave kyçe, por dhe kompetencave lëndore.

Vlerësim diagnostikues që zakonisht kryhet në fillim të shkollës apo vitit shkollor, për të identifikuar njohuritë paraprake, interesat ose aftësitë që kanë nxënësit rreth asaj për të cilën po kryhet vlerësimi. Ky informacion përdoret për të orientuar praktikatat e mësimdhënies të mësuesit dhe të nxënit e nxënësve, në mënyrë që të përcaktohen teknikat korrigjuese.

Vlerësim formues ose vlerësimi për të nxënit që është një proces që ndodh gjatë gjithë kohës në klasë dhe informon nxënësit dhe prindërit mbi progresin e nxënësve. Të dhënat dhe informacioni i mbledhur nga vlerësimi për të nxënë përdoren për të përmirësuar procesin e mësimdhënie - nxënies. Fokusi i vlerësimit formues nuk duhet të jetë vlerësimi me notë i nxënësit, por duhet të ndihmojë nxënësin që të përmirësojë të nxënit e tij.

Vlerësim përmbledhës ose vlerësim i të nxënit që kryhet për të përcaktuar çfarë është mësuar pas një periudhe kohe dhe shoqërohet me notë. Vlerësimet përmbledhëse përdoren jo vetëm për të informuar nxënësit e prindërit për progresin e nxënësve, por edhe për të përmirësuar praktikatat

e mësimdhënies dhe të nxënit. Ky vlerësim konsiderohet si vlerësimi i të nxënit dhe i arritjeve të nxënësit. Gjatë vlerësimit mësuesi duhet të mbështetet në një sasi të konsiderueshme të dhënash që përfshihen në këto elemente:

- vlerësimi i përgjigjeve të dhëna nga nxënësi;
- vlerësimi i punës në grup;
- vlerësimi i aktivitetit gjatë debateve në klasë;
- vlerësimi i detyrave të shtëpisë;
- vetëvlerësimi i nxënësit;
- vlerësimi i nxënësve për njëri – tjetrin;
- vlerësimi i detyrave praktike;
- detyrat përmbledhëse në përfundim të një kohe të caktuar ose në fund të vitit shkollor.

Hapat që mund të ndiqen për krijimin e një metodologjie vlerësimi që ndihmon në krijimin dhe vlerësimin e situatës

1. Krijimi i situatës ose problemit

2. Kuadri konceptuale për vlerësimin e arritjeve të nxënësve

3. Raporti ndërmjet kompetencave dhe vlerësimit të arritjeve

4. Vlerësimi nëpërmjet situatave komplekse si alternativë kryesore

5. Ndjekja në mënyrë rigorozë e kriterëve të vlerësimit

8. Buletini shkollor
Fisha informuese
Formati i vlerësimit
Dëftesa

5. Mjetet që ndihmojnë në mbledhjen e informacionit dhe në marrjen e vendimeve

7. Korrigjimi i detyrave, punëve praktike apo detyrave përmbledhëse

9. Realizimi dhe zbatimi me sukses i vlerësimit gjatë dhe mbas procesit mësimor

11. Materialet dhe burimet e mësimdhënies

Si në të gjitha lëndët, tekstet shkollore ofrojnë një burim të vlefshëm për mësimdhënien dhe të nxënit, megjithatë shumë nga aftësitë praktike të TIK-ut mësohen më mirë nëpërmjet demonstrimit të mësuesve. Për arritjen me sukses të kompetencave në fushën e TIK-ut dhe teknologjisë është e rëndësishme të përdoren materiale dhe burime mësimore që japin një informacion të kuptueshëm për moshën e nxënësit dhe që e ndihmojnë atë të zhvillojë aftësi, shkathësi, njohuri dhe qëndrime të nevojshme për të mësuarin gjatë gjithë jetës. Njëri nga burimet e thjeshta mësimore, që përdoret shpesh nga nxënësit dhe mësuesit, është teksti mësimor. Mirëpo me zhvillimin e shpejtë të teknologjisë dhe të shtimit të informacionit digjital, mësuesi duhet ta shohë tekstin më tepër si një burim nxitës, por jo të mjaftueshëm për të zhvilluar kompetencat kyçe të nxënësit. Mësuesit mund të bashkëpunojnë online me mësues të shkollave të tjera për të gjetur burime të besueshme informacioni, që u vijnë në ndihmë jo vetëm nxënësve për të zhvilluar aftësitë e tyre, por edhe mësuesve për të zhvilluar një qasje të re metodike. Nëpërmjet rritjes së shumëllojshmërisë së burimeve në nxësim më shumë nxënësit të zhvillojnë mendimin kritik, krijues dhe problemzgjdhës gjatë procesit mësimor. Disa nga burimet që mund të përdoren nga mësuesit për zhvillimin e orës mësimore mund të jenë: bibliotekat elektronike, broshurat informuese apo ndërgjegjësuese, enciklopeditë, software elektronike në funksion të mësimdhënies/mësimnxënies, studimet shkencore me fokus të teknologjia dhe TIK-u, etj... Gjithashtu në bashkëpunim me nxënësit dhe shkollat mund të organizohen seminare të ndryshme mësimore dhe punimet më të mira të publikohen dhe t'u vihen në dispozicion të gjitha shkollave. Në ditët e sotme, ndodh shpesh që nxënësi të jetë një hap përpara mësuesit për sa u përket informacioneve elektronike, prandaj mësuesit mund të krijojnë forume mësimore bashkë me nxënësit për të krijuar materiale në ndihmë të procesit mësimor.